

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KUVENDI I SHQIPËRISË



AVOKATI I POPULLIT

RAPORT VJETOR

**Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit
1 Janar – 31 Dhjetor
Viti 2005**

Tiranë 2006

Fjala e Avokatit të Popullit

E nderuar Zonja Kryetare e Kuvendit te Republikes se Shqiperise
Te nderuar deputete

Duke patur nderin dhe kenaqesine e veçante te paraqes Raportin e 6-te Vjetor per veprimtarine e Institucionit qe drejtoj, per vitin 2005, me lejoni te deklaroj se Avokati i Popullit vjen para këtij Kuvendi te nderuar me fizionominë e krijuar tashme te një institucioni modern, qe funksionon mire dhe ka integritetin e nevojshëm per t'u mirëkuptuar si nga administrata publike shqiptare, ashtu dhe nga qytetarët shqiptarë, per rolin ne rritje si ndërmjetësues midis tyre, ne rastet e konflikteve individ-administrate.

Te nderuar deputete,

Te gjithë sebashku, si legjislativi, ekzekutivi, gjyqsori, institucionet e shtetit dhe shoqeria civile jemi aktore dhe autore te destinacionit evropjanoperendimor te vendit tone. Tani jemi ne nje moment kur firmat e para te aplikacionit tone per Marreveshjen e Stabilizim Asociimit shenojne arritjen e fazes se pare, por edhe nje fillim te ri te kalvarit progresist te Shqipërise drejt Bashkimit European.

Ndër prioritetet kryesore që Qeveria shqiptare ne bashkepunim me partnerët ndërkombëtarë kanë percaktuar per vendin tone, veç ekonomise, janë fushat e drejtësisë e te punëve të brendshme. Eshte pikerisht problematika e këtyre fushave qe lidhet vetvetiu me të drejtat dhe lirite themelore të njeriut në Shqipëri. Cenimi sadopak i tyre ndikon negativisht jo vetem ne kohezionin e brendshem, por sidomos ne imazhin përtej vendit tonë. Shqetësimi i qytetareve shqiptare, partive tona politike, shoqerise civile ne pergjithesi dhe i faktorit ndërkombëtar ne veçanti për përhapjen e kriminalitetit me të gjitha format e tij, të trafiqeve te çdo forme dhe sidomos të “zënies së shtetit” përmes korrupsionit, tregon se të tilla fenomene, jane simptoma te nje patologjie ekonomike, sociale dhe politike jo vetem te nje vendi te vetem, aq me pak te nje mandati te vetem apo koalicioni qeveritar.

Sakaq, te gjithë jemi te ndergjegjshem se pasojat e këtyre fenomeneve negative rendojne me shume ne shtresat më të dobeta të shoqërisë, te cilat jane pikerisht grupet sociale qe kane nevojë me shume se kushdo per nderhyrjen e Avokatit te Popullit.

Përballë problematikës me të cilën ndeshet shteti dhe shoqëria shqiptare, Avokati i Popullit nuk ka qene e nuk mund te jete thjesht

zedhenes shqetesimesh. Ne funksionin e tij për të ndikuar në mirëqeverisje, Avokati i Popullit ka vlerësuar dhe ka marrë në konsideratë çdo ankese e kërkesë të njerëzve të zakonshëm, të cilëve, para së gjithash, u intereson mirëadministrimi i pushtetit dhe rritja e cilësisë së jetës nga shërbimet që ata presin prej atyre që u paguajnë taksat.

Te nderuar deputete,

Ne kushtet kur kam mundesine te punoj pas nje rotacioni te bute dhe paqesor te pushtetit, ndihem i plotesuar ne funksionin dhe misionin tim si mbrojtës i të drejtave të qytetareve, duke garantuar oponente profesionale për çdo ekip qeverisës, pavarësisht nga ngjyra e tij. Jam koshient të deklaroj se pas shtatorit 2005 është rritur ndjeshmëria dhe përgjegjshmëria e Qeverisë ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit, që padyshim rrit standartet e shtetit ligjor dhe demokracisë në Shqipëri.

Ermir DOBJANI
Avokati i Popullit

Tiranë, 13 shkurt 2006

PERMBAJTJA

	Faqe
Fjala e Avokatit të Popullit	1
Përmbajtja	3
Hyrje	6
Prezantim i shkurtër i Raportit	10

KREU I PARE

1. Struktura, organika dhe cilësitë e personelit të zyrës së Avokatit të Popullit.	12
2. Bashkepunimi dhe mbështetja ndërkombëtare për Institucionin e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2005.	16
3. Buxheti i institucionit për vitin 2005.	22
4. Sfidat dhe objektivat e institucionit për vitin 2006 e në vazhdim.	23

KREU I DYTE

1. Statistika përmbledhëse e vitit 2005.	26
2. Opinione të përgjithshme për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri	29
3. Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë	37
4. Marrëdhëniet e Avokatit të Popullit me publikun dhe median	42
a. Sektori i Pritjes së Popullit	45
b. Ditët e hapura – përvojë për t'u vazhduar	48

5.	Konferenca Kombëtare “ Të gjithë së bashku në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve”.	49
6.	Aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2005.	59

KREU I TRETE

Veprimtaria konkrete e Avokatit të Popullit për ankesat, kërkesat dhe njoftimet, të grupuara sipas institucioneve qeveritare

1.	Këshilli i Ministrave (Qeveria)	62
	Grupi mbikqyres i firmave piramidale	65
	Instituti i të përndjekurve politikë	67
2.	Ministria e Drejtësisë	68
	a. Burgjet	68
	b. Zyrat e Përmbarrimit	82
	c. Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	87
3.	Ankesat për pushtetin gjyqësor dhe administratën gjyqësore.	91
4.	Ankesat për Prokurorinë.	105
5.	Ministria e Brendshme	119
6.	Ministria e Mbrojtjes	177
7.	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.	183
8.	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve.	189
9.	Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës.	233
10.	Ministria e Financave	243
11.	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës	249
12.	Ministria e Shëndetësisë	255
13.	Ministria e Punëve të Jashtme	257
14.	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.	260
15.	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave	261

16. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.	263
17. Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	266
18. Ankesat për Shërbimet Sekrete	267
19. Veprimtaria e Nën Seksionit të të Drejtave të Fëmijëve	269

KREU I KATERT

1. Në ndjekje të rasteve të prezantuara në Raportin vjetor 2004	276
2. Çështje të filluara me iniciativën e Avokatit të Popullit (“ex officio”)	277

ANEKSE

1. Letra falenderimi nga qytetarët	279
2. Tabela dhe grafikët	283

HYRJE

Çfarë është Avokati i Popullit dhe cilat janë parimet e punës së tij

Në një shoqëri të sundimit të ligjit, gjykatat janë mbrojtësit kryesorë të të drejtave të individëve. Avokati i Popullit (Ombudsmani) është një institucion jogjyqësor, është një mjet i veçantë në llojin e tij, që i ndihmon qytetarët, kur këta ndeshin vështirësi dhe ankohen për administratën publike në shtetin e tyre.

Institucioni kushtetues i Avokatit të Popullit, si instancë kombëtare, garante e demokracisë, u parashikua për herë të parë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të miratuar më 28 Nëntor 1998. Kjo Kushtetutë, në 5 nene të saj përcakton detyrat, statusin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit. Në zbatim të saj, në shkurt të vitit 1999, Kuvendi miratoi Ligjin Nr.8454, dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”. Kurse me Ligjin 8600, datë 10.04.2000, bëri një plotësim në nenin 35 të këtij ligji me qëllim që të mbronte pavarësinë e tij nga Qeveria. Pavarësia institucionale dhe kompetencat e Avokatit të Popullit nuk janë privilegje që i jepen Kreut të Zyrës dhe punonjësve të saj, por garanci për të vepruar me profesionalizëm dhe përkushtim gjatë ndërmjetësimit midis qytetarit dhe autoritetit publik, kur ky i fundit me veprime apo mosveprime lejon të shkelen të drejtat e individit, të njohura ligjërish.

Me propozim të një grupi deputetesh, në 12 Maj 2005, me ligjin nr. 9398, Kuvendi i Shqipërisë miratoi disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, duke forcuar me shume kompetencat e Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, duke miratuar legjislacionin për Avokatin e Popullit, ka përcaktuar vlerat dhe parimet mbi të cilat vepron ky Institucion. Ato janë pavarësia, paanshmëria, profesionalizmi dhe konfidencialiteti, të përcaktuara si Parimet e Parisit. Puna e Institucionit të Avokatit të Popullit, këto 6 vjet, ka treguar se në i kemi zbatuar këto parime, të cilat faktikisht janë edhe standarte të nivelit të lartë dhe mbi bazën e të cilave bëhet vlerësimi i këtij institucioni kudo në botë.

Avokati i Popullit, përmes veprimtarisë së tij, ndikon që të afrojë gjithnjë e më shumë administratën publike me qytetarin, të cilit ajo i shërben. Në këtë këndvështrim, misioni i Avokatit të Popullit është të

bëjë sa më transparente Administratën. Ndërkaq, roli i Avokatit të Popullit (Ombudsmanit) nuk kufizohet thjesht tek mbrojtja e të drejtave të qytetarëve në raport me padrejtësitë dhe abuzimet e administratës ose të nëpunësit publik. Përveç mbrojtjes së të drejtave të njeriut, një nga objektivat e tij kryesore është të zhvillojë atë që quhet *kultura e qeverisjes së mirë*. Kjo do të thotë administrim i mirë, çiltërsi, transparencë dhe llogaridhënie e administratës publike para njerëzve që paguajnë taksa për ta mbajtur atë. Avokati i Popullit, përmes rekomandimeve të tij, mundohet të edukojë Administratën, duke e bërë atë të kuptojë rolin e saj të vërtetë ndaj qytetarëve, pra të përqëndrohet te arsyeja e vërtetë e ekzistencës së saj, që mbahet e paguhet nga qytetarët për t'i shërbyer atyre.

Shërbimi i Avokatit të Popullit ndihmon që individëve t'u krijojnë shanse të barabarta, në mënyrë që të mund të trajtohen si të barabartë në çdo marrëdhënie me administratën. Kjo arrihet, kryesisht, me anë të bisedimeve të zhvilluara në bazë të parimit të paanësisë dhe të standarteve më të gjëra të drejtësisë. Tiparet themelore të institucionit të Avokatit të Popullit janë pavarësia nga qeveria dhe nga çdo ndikim politik, lehtësia e kontaktimit, shpejtësia, fleksibiliteti, efektiviteti dhe forca e rekomandimeve të tij. Cilësojmë “forcën e rekomandimeve”, sepse është pikërisht mungesa e forcës detyruese, ajo që kushtëzon edhe praninë sa më të madhe të forcës argumentuese. Është pikërisht kjo “forcë argumentuese” e bazuar në ligj, ajo që e bën rekomandimin e Avokatit të Popullit, nga formalisht “jo detyrues”, në thelb “bindës për t'u zbatuar” nga çdo organ apo autoritet publik.

Ndonëse ombudsmanët nuk kanë fuqi detyruese, ata duhet të ushtrojnë një shkallë të lartë autoriteti bindës, për të ndryshuar mënyrën e sjelljes së administratës dhe autoriteteve publike me rekomandimet e tyre.

Ashtu si në vende të tjera, edhe administrata shqiptare nuk mund t'i shpëtojë lehtë psikologjisë së të qenit “institucion monopol”. Kjo do të thotë se tendenca për të diktuar dhe qenë e mbyllur, më tepër se sa për të dëgjuar dhe sqaruar, është e pranishme, sidomos në sjelljen e saj me qytetarët. Pikërisht, këtu qëndron një drejtim tjetër i punës së Avokatit të Popullit, në përpjekje për ta bërë publikun të kuptojë se të drejtat e tij përbëjnë detyrim për administratën publike.

Vetë fakti i ekzistencës së Institucionit të Avokatit të Popullit ka një ndikim pozitiv në administratë, së paku vetëm për arsyen e thjeshtë se kjo e fundit e di se është një palë e tretë që e vëzhgon performancën e saj në raport me qytetarin. Nga ana tjetër, ne kemi punuar dhe punojmë që njerëzit ta dinë se mund të ankohen pranë nesh, përmes një procedure të thjeshtë e të lehtë dhe pa shpenzime, për ato veprime apo vendime të administratës, që i konsiderojnë të padrejta ose të pafavorshme për ta. Disa nga drejtimet e punës që ne kemi zbatuar për të realizuar sa më sipër

kanë qenë: dhënia e ndihmës ligjore nëpërmjet rekomandimeve dhe këshillave në rastet e konflikteve midis administratës dhe publikut, zbulimi i defekteve të administratës, denoncimi i sjelljeve të këqia të nëpunësve kundrejt qytetarëve, presioni për ndryshimin e procedurave të rënduara dhe të paqarta të Administratës Publike, krijimi i kushteve që qytetarët të gëzojnë të drejtat e tyre në marrjen e informacioneve të nevojshme nga Administrata Publike, nxitja e transparencës së kësaj të fundit në veprimtarinë e saj, angazhimi në rritjen e cilësisë së shërbimeve publike si dhe zgjerimi gjeografik i ushtrimit të kompetencave të Zyrës.

Avokati i Popullit ka deklaruar se nuk është një institucion akuze dhe as gjurmimi ndaj administratës publike në Shqipëri. Kjo sepse për këtë detyrë ka disa organe dhe institucione të tjera të specializuara. Por ne nuk kemi as burimet njerëzore dhe as mjetet e duhura teknike për ta bërë këtë detyrë. Kritikat apo kërkesat tona për masa ndëshkuese ndaj punës së administratës apo zyrtarëve të veçantë, nuk përbëjnë qëllim në vetvete. Ne kritikojmë veprimet ose mosveprimet e administratës në rekomandimet dhe raportet tona, sikurse veprojnë ombudsmanët në të gjitha vendet. Qëllimi ynë nuk është për të punuar kundër institucioneve publike, por as për të marrë meritat e punës së të tjerëve.

Në vendet e tjera ku ky institucion ka qindra apo dhjetra vite që ekziston është vënë re se Ombudsmani mund të ndryshojë pozitivisht imazhin e administratës në publik. Edhe tek ne, kjo ka ndikuar për ta bërë administratën shqiptare më të përgjegjshme për cilësitë e vendimeve të saj dhe për përgjegjësitë ndaj publikut.

Si përfundim, do të thonim se Institucioni i Avokatit të Popullit tashmë është pjesë e atij mekanizmi të kontrollit dhe balancës së pushtetit, i cili, duke qenë pjesë e pushtetit publik, pengon ekzeset e këtij pushteti, madje u mëson autoriteteve parimet e mirësjelljes administrative. Ky institucion punon në funksion të realizimit të asaj që quhet “drejtësi e butë”. Ai është shumë më pak formal se gjykatat, por lehtësisht i arritshëm për të gjithë qytetarët. Duke qenë një institucion i aftë për fleksibilitet dhe shumëdisiplinshmëri, Avokati i Popullit synon dhe ndihmon për standarte të larta të administratës dhe mirëqeverisjes në Shqipëri.

Çdo zyrë ombudsmani në botë, sikundër edhe në Shqipëri, faktikisht ndeshet çdo ditë edhe me forma të rezistencës të organeve të administratës apo të autoriteteve publike. Në kushtet tona, kur institucionet ende rezultojnë jo të mësuara e të konsoliduara me ndërjegjen e shtetit të së drejtës, kjo është edhe më e dukshme. Por, nëse secili do të udhëhiqet nga parimi demokratik i pushteteve të kufizuara, mendojmë se ekzistojnë hapësira të mjaftueshme për njëri-tjetrin, ku bashkëpunimi të jetë sa më efikas. Fakti që ligja i mundëson Avokatit të Popullit ngritjen e problemit si për kryetarin e komunës, ashtu dhe për

ministrin deri në Parlament, tregon qartë se instrumenti ynë kryesor, që është Rekomandimi, kur ka brenda argumentin ligjor, ka edhe forcën reale të “imponimit” të butë. Në kushtet kur kjo bëhet me të vetmin qëllim, për të rivendosur të drejtën e shkelur të qytetarit në raport me administratën, rezultati merr edhe më shumë vlerë, sepse para se të jemi shtetarë, policë, prokurorë apo zyrtarë, të gjithë jemi qytetarë të këtij vendi ndaj të cilit kemi të drejta, por edhe shumë detyrime.

Qëndrimi që administrata mban ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit është tregues i përgjegjshmërisë së saj ndaj shkeljeve që kryen si edhe i faktit se sa e gatshme është ajo për t’i riparuar ato. Prandaj, veprimtaria jonë, ashtu si edhe deri tani, është mirëkuptuar nga shoqëria civile dhe e trajtuar me drejtësi nga të gjitha palët që bëjnë politikën në Shqipëri. Me fuqinë dhe kompetencat që na njohin Kushtetuta dhe Ligji, të provuara tashmë prej gjashtë vjetësh në raportet tona me administratën, kemi krijuar bindjen se hallet e njerëzve, të shprehura në kërkesat dhe ankesat e tyre nuk njohin asnjë ngjyrë politike dhe kemi trajtuar e zgjidhur gjithashtu pa u interesuar se kujt force politike i përket hallexhiu apo kërkuesi.

Duke qënë se në Korrik 2005, pas zgjedhjeve parlamentare në Shqipëri ka ndodhur rrotacion demokratik i pushtetit nga partitë e majta tek ato të djathta, kemi rastin të rideklojmë se Avokati i Popullit në Shqipëri nuk ka qënë, nuk është dhe nuk do të jetë asnjëherë në Opozitë me Qeverinë, pavarësisht se cilat forca politike e drejtojnë atë, por si gjithmonë do të jetë Oponencë për Mirëqeverisje. Ky ka qënë, është dhe do të jetë thelbi i filozofisë së funksionimit të këtij institucioni jo politik. Dhe si i tillë ai duhet pranuar e mirëkuptuar nga të gjitha palët që bëjnë politikën në Shqipëri.

PREZANTIMI I SHKURTËR I RAPORTIT

Viti 2005 shënoi përfundimin e mandatit të parë dhe fillimin e mandatit të dytë të punës për Avokatin e Popullit. Kjo u shoqërua me konstatimin në të njëjtën kohë të rritjes së institucionit dhe respektimit të tij si nga administrata publike, ashtu dhe nga qytetarët të cilët i janë drejtuar Institucionit. Në mbështetje të nenit 26 të Ligjit nr.8454 dt.04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, ndryshuar me ligjin nr. 9398, datë 12.05.2005, Avokati i Popullit, ka përgatitur Raportin e 6-të Vjetor, i cili pasqyron veprimtarinë e Institucionit gjatë vitit 2005. Ky raport është konceptuar në mënyrë të tillë që prej tij të merret një informacion i plotë lidhur me metoden e përdorur dhe fushat e veprimtarisë së institucionit, duke u shoqëruar gjithashtu dhe me të dhëna statistikore.

Raporti përmban katër krerë dhe tre anekse.

Kreu i parë është një prezantim i bërë nga Avokati i Popullit, i cili ndër të tjera i kushton vëmendje bashkëpunimit të Institucionit tonë me zyrat homologe dhe pjesëmarrjes aktive të Institucionit të Avokatit të Popullit në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare. Po kështu ai shpjegon shkurtimisht arritjet e Institucionit dhe objektivat e tij për të ardhmen.

Kreu i dytë ka të bëjë me aktivitete të informimit dhe komunikimit të Institucionit të Avokatit të Popullit. Ky kapitull është ndarë në 5 seksione ku një vënd të veçantë zënë opinionet për situatën e të drejtave të njeriut si dhe për mirëqeverisjen në Shqipëri. Një seksion i veçantë i është kushtuar bashkëpunimit me mediat, që siç kemi përmendur gjithmonë, e kemi parë si mjetin më efikas për të siguruar aksesin e nevojshëm në publik dhe krijimin e individualitetit të domosdoshëm të Institucionit, për ushtrimin e funksionit sipas Kushtetutës dhe Ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Kreu i tretë, i cili zë dhe pjesën më të madhe në raport, ka të bëjë me rastet e trajtuara nga Avokati i Popullit, të ndara sipas ministrive përkatëse dhe organeve të tjera të administratës publike, hetimet e kryera për këto raste dhe rezultatet. Këtu kemi prezantuar dhe mjetet për zgjidhjen e rasteve tipike dhe të përsëritura, të cilat mendojmë se duhet të shërbejnë si udhërrëfyes për veprimet e organeve përgjegjëse të administratës në situata të ngjashme. Ne pasqyrimin e rasteve sipas ministrive, është mbajtur parasysh struktura e re e Keshillit të Ministrave dhe emertimet e reja të disa ministrive. Ky kre gjithashtu përmban rekomandime dhe propozime për eliminimin e shkeljeve dhe

padrejtësive, të cilat janë identifikuar gjatë shqyrtimit të ankesave të paraqitura tek Avokati i Popullit.

Kreu i katërt paraqet shkurtimisht rastet e papërfunduara të prezantuara në Raportin Vjetor 2004, shqyrtimi i të cilave ka përfunduar gjatë vitit 2005 si dhe çështjet e filluara me iniciativë nga Avokati i Popullit.

Në aneksin 1 kemi paraqitur disa nga letrat e falenderimit të qytetarëve drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Aneksi 2 paraqet në mënyrë grafike statistikat e punës së Institucionit.

Në këtë Raport kemi përfshirë edhe shumë analiza të detajuara për ato raste dhe në ato fusha që sipas këndvështrimit tonë përbëjnë elemente kyç dhe të cilave në të ardhmen do t'u kushtojmë më shumë vëmendje.

KREU I PARE

1. Struktura, organika dhe cilësitë e personelit të zyrës së Avokatit të Popullit

Ligji nr. 8600, dt.10.04.2000, “Për disa ndryshime në ligjin 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit””, i jep Avokatit të Popullit të drejtën e përcaktimit të strukturës, dhe numrit të personelit të tij. Kurse pagat janë caktuar me vendim të veçantë të Qeverisë Nr.500, dt.18.07.2003 “Për miratimin e strukturës dhe pagave të punonjësve të Avokatit të Popullit”.

Zyra e Avokatit të Popullit funksionon me tre seksione të specializuara, siç i ka përcaktuar neni 31 i ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”

Seksioni i parë merret me ankesat dhe kërkesat për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre dhe drejtohet nga z. Gëzim Lleshi.

Seksioni i dytë merret me ankesat dhe kërkesat për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura, prokurorinë dhe pushtetin gjyqësor dhe drejtohet nga z. Jorgo Dhrami..

Seksioni i tretë, ose seksioni i përgjithshëm, që drejtohet nga z. Riza Poda, trajton çështjet jashtë fushave të mësipërme, ndjek bashkëpunimin me organizatat joqeveritare dhe kryen studime në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Këtu funksionon edhe nënseksioni i fëmijëve.

Hallkë e rëndësishme e strukturës së institucionit është edhe Kabineti, në përbërje të të cilit janë Shefi i Kabinetit dhe këshilltarët, të cilët janë në vartësi direkte nga Avokati i Popullit.

Sektorët mbështetës që ndihmojnë në realizimin e detyrave kryesore të Institucionit kanë qenë Drejtoria e Personelit dhe Administratës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Sektori i Pritjes së Popullit dhe regjistrimit të ankesave, dhe Sektori i Financës, të cilët janë në varësi direkt të Sekretarit të Përgjithshëm. Për 5 vite zyra ka funksionuar në bazë të strukturës së mësipërme, por ligji ka lënë mundësi për fleksibilitet. Në varësi të prioriteteve të caktuara për të ardhmen kjo

strukturë është ndryshuar për vitin 2006 për të sjellë më tepër efektivitet në punë.


Kuvendi në ligjin për Buxhetin e Shtetit për vitin 2005 ka miratuar 45 punonjës dhe po kaq kanë qenë të punësuar. Nga këta janë 17 juristë që quhen ndihmëskomisionerë të cilët merren direkt me zgjidhjen e ankesave, Juristë janë edhe Shefi i Kabinetit, 2 këshilltarë, 3 komisionerët dhe vetë Avokati i Popullit.

Pjesëmarrja në trajnimet e ndryshme i ndihmëskomisionerëve dhe e punonjësve të tjerë të Administratës, ka ndihmuar në ngritjen e tyre profesionale, gjë kjo që vërtetohet edhe me pajisjen e tyre me certifikatat e marra nga Instituti i Trajnimit të “Departamentit të Administratës Publike”. 3 anëtarë të stafit kanë fitur titullin Master dhe 3 të tjerë janë në proces të fitimit të këtij titulli.

Përsa i përket cilësive profesionale të personelit të zyrës sonë vëmë në dukje se Avokati i Popullit mban titullin “Profesor i Asociuar Doktor” kurse z. Jorgo Dhrami mban gradën shkencore “Doktor i Shkencave Juridike”. Kurse 5 juristë të tjerë aktivizohen për mësimdhënie si pedagogë të jashtëm në Fakultetet e Drejtësisë dhe në Shkollën e Magjistraturës.

Pjesa më e madhe e specialistëve të Zyrës së Avokatit të Popullit zotërojnë dhe përdorin mirë një ose më shumë gjuhë të huaja, kryesisht anglisht, frëngjisht, italisht, rusisht, gjermanisht etj.

STRUKTURA E INSTITUCIONIT TE AVOKATIT TE POPULLIT
Për vitin 2005



Pasqyra nr.2

ORGANIKA E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT Për vitin 2005

Nr.	EMËRTIMI	NËPUNËS
I.	AVOKATI I POPULLIT	(1)
II.	KABINETI Shefi i Kabinetit Zëdhënës i Avokatit të Popullit Këshilltarë të Avokatit të Popullit Sekretare e Avokatit të Popullit	(5) 1 3 1
III.	SEKSIONI I ORGANEVE TË ADMINISTRATËS QENDRORE DHE VENDORE Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + Rregjistruese	(6) 1 4 1
IV.	SEKSIONI I SHËRBIMEVE TË VEÇANTA Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + rregjistruese	(8) 1 6 1
V.	SEKSIONI I PËRGJITHSHËM Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + rregjistruese	(6) 1 4 1
VI.	SEKRETARI I PËRGJITHSHËM	(1)
VII.	DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË Drejtor Përgjegjës i sektorit të përkthimit dhe bibliotekës	(2) 1 1
VIII.	DREJTORIA E PERSONELIT DHE ADMINISTRATËS Drejtor Shef Sektori Shofer Pastrues	(11) 1 1 7 2
IX.	SEKTORI I FINANCËS Shef Sektori Llogaritar i parë, Arkëtar Magaznier	(3) 1 1 1
X.	SEKTORI I PRITJES SE POPULLIT Shef Sektori Ndihmeskomisioner	(2) 1 1
XI.	SEKTORI I SEKRETARISE DHE ARKIVIT Shef Sektori Arkivist+sekretare e Sekretarit të Përgjithshëm	(2) 1 1

Punonjës gjithsej të Institucionit të Avokatit të Popullit kanë qenë 45 veta

2. Bashkëpunimi dhe mbështetja ndërkombëtare për Institucionin e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2005

Duke patur parasysh statusin unik të Ombudsmanit, ka rezultuar që ky institucion forcohet më shumë dhe zhvillohet më tej kryesisht përmes bashkëpunimit me zyrat homologe si dhe pjesëmarrjes aktive në forumet ndërkombëtare, cilësuar joformalisht si Familja Ndërkombëtare e Ombudsmanit. Për organizmat ndërkombëtare, Ombudsmani dhe institucione të tjera të ngjashme përbëjnë elementin themelor të infrastrukturës së të drejtave të njeriut në një shoqëri demokratike. Në perspektivën e integritit të vendit tonë, përderisa legjislacioni i Komunitetit Evropian është i detyrueshëm për secilin Shtet Anetar, ky legjislacion, sidomos për kushtet e Shqipërisë, është burim reference edhe për institucionin e Avokatit të Popullit, sidomos për argumentimin e rekomandimeve, dërguar administratës. Kjo është arsyeja që ne marrim pjesë aktivisht në rrjetin e komunikimit dhe bashkëpunimit me zyrat e ombudsmanëve të rajonit, në kuadrin e Institutit Evropian të Ombudsmanit.

Avokati i Popullit është aktualisht anëtar me të drejta të plota i Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit, i Ombudsmanit Evropian, i Shoqatës së Ombudsmanit Frankofon, si dhe në Shoqatat e Ombudsmanëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, TOA dhe USOA. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia Avokati i Popullit i realizon përmes pjesëmarrjes në aktivitete si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

I. Aktivitete te organizuara nga Keshilli i Europes:

1. Keshilli i Europes dhe Komisioni Evropian ne bashkepunim me Ministrine e Drejtesise te Republikes se Shqiperise organizuan me 3 maj 2005, ne Strasbourg, France, Konferencen e 7-te mbi reformen gjyqesore dhe ligjore ne Shqiperi. Kjo konference ishte pjese e “ Planit te Dyte te Veprimit per funksionimin efektiv te sistemit gjyqesor ne Shqiperi” nenshkruar ne 23 Maj 2001 nga autoritetet shqiptare dhe perfaqesuesit e Komisionit Evropian dhe te Keshillit te Europes. Nje Komisioner i Avokatit te Popullit perfaqesoi Institucionin tone ne kete konference.

II. Aktivitete te organizuara nga Organizata e Kombeve te Bashkuara (OKB):

1. Nje perfaqesues i Zyres se Avokatit te Popullit mori pjese ne Tavolinen e Rrumbullaket te Institucioneve Kombetare per te Drejtat e Njeriut dhe te Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, bashkeorganizuar

nga Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara dhe Komisionit Kombëtar për të Drejtat e Njeriut të Indisë, në New Delhi, Indi, më 29 nëntor-1 dhjetor 2005.

Objektivi kryesor i kësaj tryeze ishte diskutimi rreth forcimit të rolit dhe aftësive të institucioneve kombëtare për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore.

III. Konferenca të tjera ndërkombëtare:

1. Komisioneri i Avokatit të Popullit mori pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Ombudsmanit Europian që u mbajt në Insbruck më 21 janar 2005, qëllimi i së cilës ishte votimi i presidentit të ri të Institutit të Ombudsmanit Europian.

2. Në Mars 2005, dy përfaqësues të Zyres së Avokatit të Popullit morën pjesë në 50 vjetorin e krijimit të Zyres së Ombudsmanit të Mbrojtjes së Danimarkës. Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit dhënë kontributin e tyre në këtë aktivitet, duke folur në emër të Zyres për profilin e saj në Shqipëri dhe marrëdhëniet me administratën publike.

Më këtë rast, Ministri i Kulturës, Z. Blendi Klosi, i dorëzoi Z. Hans Gammeltoft-Hansen, Ombudsmanit Parlamentar të Danimarkës Medaljen e Mirënjohjes, akorduar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Z. Alfred Moisiu, për kontributin e tij në ngritjen dhe mirëfunksionimin e Institutit të Avokatit të Popullit në Shqipëri.

3. Më 10-13 prill 2005, një delegacion i kryesuar nga Avokati i Popullit, mori pjesë në Konferencën Vjetore të Shoqatës së Ombudsmanëve Amerikane, (TOA), që zhvilloi punimet në Atlanta, Georgia, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës me temë “Te Zhvillojme Paqen duke u bërë Ombudsmanë edhe më efektive në shekullin 21”. Në vijim u zhvillua një vizitë zyrtare pranë Zyres së Ombudsmanit të shtetit të Iowa-s që është njëkohësisht edhe Presidenti i Institutit Nderkombëtar të Ombudsmanit, për të vendosur lidhje me direkte me këtë zyrë.

4. Avokati i Popullit mori pjesë në delegacionin me përfaqësues të institucioneve shqiptare që me ftese të Organizatës Nderkombëtare të Migracionit me qendër në Tiranë dhe Athinë, realizuan një vizitë zyrtare në Athinë, Greqi, më 25-27 maj 2005. Qëllimi i kësaj vizite ishte zbatimi i disa prej masave të parashikuara në Planin Kombëtar të Veprimit që lidhet me përmirësimin e imazhit të emigrantëve, përmirësimin e shërbimeve konsullore, mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve, mobilizimin e diasporas etj. Vizita pati rendesi sepse u ngritën problemet që kanë dalë nga ligji grek për emigrantet.

5. Një përfaqësues i Institutit të Avokatit të Popullit mori pjesë në Mbledhjen Vjetore të Shoqatës “Për Kerkime Ligjore” që u zhvillua

ne Ankara, Turqi me 25 qershor 2006. Shoqata “Per Kerkime Ligjore” e krijuar ne vitin 1989, eshte nje bashkim vullnetar i avokateve dhe juristeve te Turqise qe ka per qellim fuqizimin dhe konsolidimin e shtetit te se drejtes dhe respektimin e te drejtave dhe lirive themelore te njeriut.

6. Ne daten 19- 22 Shtator 2005, nje delegacion i kryesuar nga Avokati i Popullit, mori pjese ne Konferencen e 26-te Vjetore te Shoqates se Ombudsmeneve te Shteteve te Bashkuara, USOA e cila i zhvilloi punimet ne Tennessee, Nashville, te Shteteve te Bashkuara te Amerikes. Nder çeshtjet kryesore qe u trajtuan ne kete konference, ishin dhe ato qe kishin te benin me elementet e nje zyre eficente te Ombudsmanit, teknikat e mediacionit, teknikat e dialogut me ankuesit, puna me mediat dhe zyrtaret e zgjedhur, etika ne shekullin e 21-te etj. Ne Washington DC u zhvilluan takime ne Departamentin e Shtetit dhe ne Qendren Kombetare Amerikane per femijet e humbur dhe shfrytezuar. Çeshtjet kryesore qe u diskutuan kishin te benin me politikat e antitrafikimit, iniciativat dhe programet e bashkepunimit privat dhe publik ne luften kunder trafikimit te femijeve, bashkepunimin nderkombetar dhe asistencen, roli i FBI-se ne hetimet kunder trafikimit etj.

7. Me ftese te Institutit te Ombudsmanit European (EOI), nje perfaqesues nga Institucioni i Avokatit te Popullit mori pjese ne Asamblene e Pergjithshme te Jashtezakonshme te EOI-se qe u mbajt ne Vilnius, Lituani, me 24 shtator 2005. Institucioni yne eshte anetar votues i kesaj shoqate qe ne vitin 2000.

8. Konferenca Kombetare e Mbrojtesve Civile te 15 Provincave Autonome te Italise u mbajt ne Rome, me 30 shtator 2005. Në Itali mungon nje institucion i vetem kombetar i Ombudsmanit. Qellimi i pjesemarrjes ne kete konference ishte interesimi i Avokatit te Popullit ne Shqiperi per te vendosur kontakte me kreret e 15 Zyrave Rajonale te Mbrojtesve Civile ne Itali (Diffensore Civico), per t’u kerkuar ketyre te fundit nje ndihme me te madhe per pritjen e ankesave te shqiptareve qe jetojne e punojne ne Itali, per problemet qe ata ndeshin me administratat perkatese te vendit fqinj.

9. Me ftese te Ombudsmanit grek per te drejtat e femijeve, nje Komisioner i Avokatit te Popullit mori pjese ne konferencen rajonale qe u zhvillua ne Selanik, Greqi , me 11-12 tetor 2005 me teme: “Ombudsmani per te Drejtat e Femijeve ne Europen Juglindore”. Kjo konference u dha mundesi pjesemarrjesve te diskutonin problemet e çeshtjeve qe ankimohen prane zyrave te ombudsmeneve lidhur me te drejtat e femijeve si dhe te shkembenin idete dhe eksperiencat, duke identifikuar praktikat me te mira te punes se perditeshme te tyre.

10. Zyra e Ombudsmanit te Krahines Autonome te Vojvodines (Serbi-Mali i Zi) dhe Zyra vendore e OSBE-se bashkeorganizuan

Konferencen me teme “Ombudsmeni dhe Çështjet e Minoriteteve” që u zhvillua në Novi Sad me 20-21 Tetor 2005. Në këtë konferencë mori pjesë një përfaqësues i Zyres së Avokatit të Popullit.

Konferenca u zhvillua me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shumë zyrave të Ombudsmanit në Rajon, të vendeve nordike si dhe nga Ombudsmeni Europian.

11. Avokati i Popullit mori pjesë në një takim të përbashkët të personaliteteve nga SHBA dhe Evropa lidhur me çështjen e femijeve të rrembyer e të shfrytëzuar, zhvilluar me 25-27 tetor 2005, në Buonas, Lucerne të Zvicrës. Ai e shfrytëzoi këtë takim për të vendosur kontakte me qendrat perkatese në SHBA dhe Europë, me qëllim të bashkëpunimit në rastet e zhdukjes së femijeve shqiptare.

12. Avokati i Popullit mori pjesë në Kongresin e 4-të të Shoqatës së Ombudsmanëve dhe Mediatorëve Frankofone, që zhvilloi punimet në Paris me 28-30 Nëntor 2005, nën kujdesin e Mediatorit të Republikës Franceze, Z. Jean-Paul Delevoye si dhe Mediatorës së qytetit të Parisit, Zj. Frederique Calandra. Institucioni i Avokatit të Popullit është anëtar votues i kësaj shoqate qysh nga viti 2000.

Në këtë aktivitet ndërkombëtar morën pjesë më shumë se 40 delegacione nga 32 vende të Botës si dhe ishin të ftuar personalitete të shquara franceze dhe të huaj të fushës së jurisprudencës, ekonomisë dhe të drejtave të njeriut.

Gjatë punimeve të këtij kongresi u trajtuan çështje lidhur me kontributin e Shoqatës së Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Frankofonisë (AOMF) në ndërtimin e një sistemi frankofon në rang global, të aftë për të promovuar të drejtat e njeriut dhe dialogun mes kulturave.

IV. Vizitat e Ombudsmanëve të shteteve të tjera në Shqipëri

1. Me 17-19 Janar 2005 erdhi për herë të katërt në Shqipëri mbështetesi kryesor për ndërtimin dhe mirë funksionimin profesional të këtij Institucioni, Z. Hans Gammeltoft – Hansen, Ombudsmeni Parlamentar i Danimarkës.

Qëllimi i kësaj vizite ishte që Z. Gammeltoft-Hansen, i cili prej 18 vjetësh drejton një nder zyrat me të mira të ombudsmanëve në botë, të bënte vlerësimin e tij për progresin e këtij Institucioni gjatë 5 viteve të punës së tij, për efektshmerinë e ndihmës daneze për këtë institucion si dhe të bëjë përcaktimi i bashkëpunimit për të ardhmen.

2. Një delegacion i Zyrës së Ombudsmanit të Krahinës Autonome të Vojvodinës, kryesuar nga kreu i këtij institucioni, Z. Petar Teofilović ishte në Tiranë nga data 24-26 prill 2005.

Delegacioni mori pjesë në një seminar me ekspertët e Avokatit të Popullit, ku u njoh me praktikat e punës së këtij institucioni dhe arritjet e tij gjatë pesë viteve të funksionimit, bëri vizita në burgje dhe u prit nga autoritete të larta të shtetit.

3. Ombudsmani i Republikës së Maqedonisë, Z. Ixhet Memeti erdhi në Tiranë për një vizitë tre ditore, me 9-11 Qershor 2005.

Gjatë vizitës ai u njoh nga afër me punën e Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri dhe u prit nga autoritetet më të larta të Shtetit Shqiptar.

4. Ombudsmani Parlamentar i Republikës Greke, z. Jorgos Kaminis bëri një vizitë zyrtare në Tiranë me 14-16 shtator 2005.

Vizita u bë në kuadrin e bashkëpunimit midis dy zyrave homologe, me theks të veçantë vëmendjen që Ombudsmani grek i ka kushtuar mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve shqiptarë në Greqi. Gjithashtu u vendos për një bashkëpunim të thelluar në të ardhmen për shkëmbimin e përvojave reciproke me vizita të ekspertëve përkatës, të cilët do të punojnë për periudha të shkurtra pranë zyrave përkatëse, për aktivitete të përbashkëta në kuadrin e shkëmbimeve dypalëshe dhe shumëpalëshe etj.

Gjatë kësaj vizite zyrtare, Ombudsmani grek u prit nga autoritetet e larta të shtetit.

5. Ombudsmani i Republikës së Austrisë dhe Zëvendës-presidenti i Institutit Nderkombëtar të Ombudsmanit, z. Peter Kostelka bëri një vizitë zyrtare në Tiranë nga data 16-18 tetor 2005.

Kjo vizitë u realizua në kuadrin e bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh që Zyra e Avokatit të Popullit ka vendosur me institucionet homologe dhe forumet e tyre ndërkombëtare.

Gjatë qëndrimit në Shqipëri Ombudsmani i Republikës së Austrisë, u prit nga autoritetet më të larta të shtetit shqiptar.

V. Vizitat e Avokatit të Popullit në zyrat e Ombudsmanëve të vendeve të tjera

1. Avokati i Popullit bëri një vizitë zyrtare në Poloni, nga 31 Maj deri me 2 Qershor 2005, në kthim të vizitës zyrtare që Ombudsmani i Republikës së Polonisë, z. Andrzej Zoll bëri në Tiranë në vitin 2004. Kjo sepse bashkëpunimit me Zyren e Ombudsmanit Polak, në i kushtojmë rëndësi të madhe, pasi kjo Zyrë është ndër me të mirat në Evropën Lindore dhe Qendrore, sikunder ka ligjin më të fortë për funksionimin e nje Zyre të Avokatit të Popullit.

Bisedimet u përqendruan në rritjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave midis dy zyrave, me interesim të veçantë rritjen e efikasitetit të Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri.

Gjate vizites ne Poloni, Avokati i Popullit eshte pritur nga autoritete te larta polake.

2. Me ftese te Ministrit te Kontrollit te RP te Kines, Z. Li Zhilun, Avokati i Popullit kreu nje vizite zyrtare ne Kine, nga 19 deri 24 Qershor 2005, ku u prit nga autoritete te larta kineze dhe shkembu mendime per ritjen e bashkepunimit sipas fushave te veçanta, ku veprimtaria e ketij institucioni perputhet.

Vizita u perqendrua ne njohjen e pervojave perkatese te te dy institucioneve, ku nje theks i veçante iu kushtua metodave te mbikqyrjes dhe kontrollit te administratave dhe nepunesve te tyre si dhe masave parandaluese per mbrojtjen e nepunesve publike nga korrupsioni dhe veprimet abuzive e te paligjshme.

Avokati i Popullit u prit ne takim te veçante edhe nga Zevendeskrjetarja e Asamblese Kombetare te RP te Kines, Zj. Gu Xiao Lian dhe autoritete te larta ne Pekin dhe ne provinca, qe u shprehen per zhvillimin e metejshem te marredhenieve, jo vetem midis dy institucioneve homologe, por edhe ne teresi midis shtetit shqiptar dhe kinez.

3. Nga 18 deri 21 Gusht 2005, Avokati i Popullit beri nje vizite zyrtare ne Rajonin Autonom te Valeëd Aostes, Itali, i ftuar nga zonja Maria Grazia Vacchina, Mediatore Rajonale e Vale d'Aostes dhe njekohesisht Presidente e Shoqates Nderkombetare te Mediatoreve dhe Ombudsmaneve te Vendeve Frankofone.

Avokati i Popullit bisedoi me homologen Vacchina, per çeshtje qe kane te bejne me integrimin e komunitetit shqiptar ne Itali dhe ne veçanti ne rajonin e Vale d' Aostes, lidhur me mundesite e intensifikimit te bashkepunimit mes te dy zyrave si dhe per probleme te Shoqates Nderkombetare te Mediatoreve dhe Ombudsmaneve te Vendeve Frankofone.

Gjate qendrimin te tij ne Aosta, Avokati i Popullit u prit gjithashtu nga Presidenti i Keshillit Rajonal te Rajonit Autonom te Valda Aostes, Ego Peron si dhe nga Kryetari i Bashkise se Aostes, Z. Guido Grimod.

VI. Vizitat per shkembim eksperience dhe trajnime te stafit te zyres se Avokatit te Popullit

1. Me ftese te Komisionit Europian, TAIEX unit, nje perfaqesues nga Zyra e Avokatit te Popullit mori pjese ne Seminarin me teme "Mbrojtja e te Dhenave" qe u zhvillua ne Bruksel, me 27 janar 2005.

2. Me 21-25 shkurt 2005, nje grup ekspertesh te Zyres se Avokatit te Popullit moren pjese ne trajnimin e organizuar prane Zyres se Ombudsmanit te Polonise ne Varshave, mbeshtetur nga Zyra e OSBEse ne Tirane.

3. Dy perfaqesues te Avokatit te Popullit moren pjese ne Seminarin “Trajtimi nga Ombudsmeni i Ankesave mbi Mjedisin” qe u zhvillua ne Liqeni i Prespes, Greqi, me 10-12 qershor 2005, organizuar nga Programi Eunomia i Ombudsmanit te Greqise.

Ky seminar synonte trajtimin e ceshtjeve qe lidheshin me mbrojtjen e ambjentit, si te trajtoheshin keto ankesa ne nje menyre te koordinuar dhe te unifikuar si dhe identifikimin e praktikave me te mira per kete ceshtje te zyrave te Ombudsmaneve.

4. Me 24-26 shtator 2005 dy perfaqesues te zyres se Avokatit te Popullit moren pjese ne trajnimin dy ditor qe u zhvillua ne Sofie, Bullgari, me 24-26 shtator 2005, organizuar nga Qendra Europiane per Ceshtje te Minoritetit.

5. Ne kuader te aktivitetit “Vleresim nga afer” mbeshtetur nga programi Eunomia dhe me inisiative te Ombudsmanit te Greqise per shkembim stafesh dhe eksperiencash, nje perfaqesuese e stafit te Avokatit te Popullit shkoi per nje trajnim 1 mujor prane zyres se Ombudsmanit te Greqise ne Athine, me 1-30 tetor 2005.

6. Gjithashtu, ne periudhen 15 nentor-15 dhjetor 2005, per te njejten arsye, nje eksperte nga zyra e Ombudsmanit te Greqise erdhi ne Zyren e Avokatit te Popullit te Shqiperise .

3. Buxheti i Institucionit per vitin 2005

Per te funksionuar me efijence nje institucion i ri siq eshte Avokati i Popullit, kerkohet jo vetem mbeshtetje politike, institucionale, potenciale njerzore, por dhe mbeshtetje financiare. Mbeshtetja financiare per Institucionin tone nga Komuniteti Nderkombetar dhe pikerisht nga qeveria Daneze nepermjet projektit Danida ka qene prezente, konkrete dhe efektive qe nga momenti i krijimit te institucionit deri ne shtator te vitit 2003. Me pas nuk kemi patur mbeshtetje te fuqishme financiare nga jashte, por nga buxheti i shtetit shqiptar buxheti ka qene i mjaftueshem.

Per vitin 2005 na eshte dhene nje buxhet ne shumen 85.000.000 leke ose rreth 850.000 USD, i cili per periudhen objekt raportimi eshte konsumuar ne masen 98.40% e konkretisht: Shif tabelen

Persa i perket shpenzimeve te buxhetit ato jane perdorur per paga punonjesish, dieta brenda dhe jashte vendit, blerje kancelerie, karburanti, parkim automjetesh, shpenzime per energji elektrike, impulse telefoni, ruajtje te institucionit me roje private, pritje te delegacioneve te huaja etj. Parate per investimet nuk jane harxhuar te gjitha per shkak se nuk na u vune ne dispozicion disa zyra ne Tirane dhe nuk u miratua hapja e zyrave rajonale ne rrethe.

Nr. Llog.	Emertimi	Plan leke	Realizim leke	Realiz. %
600	Pagat	42.906.000	42.904.029	100 %
601	Sigurim shoqëror	7.000.000	7.000.000	100 %
602	Shpenzime operative	27.794.000	27.787.397	100 %
605	Kuote anetaresie	300.000	276.309	92 %
231	Investime	7.000.000	5.665.123	81 %
	Totali	85.000.000	83.632.858	98,4 %

Ne lidhje me kuotat e anetaresise për institucionet ndërkombëtare ne bejme pagesen ne Institutin European te Ombudsmaneve; Instituti Nderkombetar i Ombudsmaneve, Shoqata e Ombudsmaneve Frankofone; Shoqatat e Ombudsmaneve ne Shtetet e Bashkuara te Amerikes, TOA dhe USOA.

Për vitin 2006 buxheti për shpenzimet operative është shkurtuar në masën 40 përqind. Për këtë ne paraqitëm kundërshtimet tona në Komisionet Parlamentare për Buxhetin dhe Çështjet Ligjore. Sidoqoftë do të punojmë që të tërheqim më tepër donacione të huaja për institucionin, nëpërmjet projekteve të përbashkëta në fushën e të drejtave të njeriut.

4. Sfidat dhe objektivat e Institucionit për vitin 2006 e në vazhdim

Përtej përsosjes së legjislacionit dhe zgjedhjes së Ombudsmanit, ajo që ka më shumë rëndësi është mirëfunksionimi i institucionit. Sfidat e përhershme për Avokatin e Popullit është funksionimi i tij si institucion i pavarur shërbimi për qytetarët, të drejtat e të cilëve mund të shkelen eventualisht nga Administrata Publike Shqiptare.

Duke ndjekur ankesat rast pas rasti, ne kemi rekomanduar masa administrative dhe dhënë opinione për parandalimin e shkeljeve nga Administrata Publike në të ardhmen.

Në funksion të këtyre sfidave që mbeten të tilla edhe për të ardhmen, do të vazhdojmë t'i kushtojmë vëmendje të veçantë ndër të tjera këtyre objektive:

- 1- Njohja dhe veprimi sipas kompetencave të shtuara nga ndryshimet ligjore të aprovuara nga Parlamenti Shqiptar në Maj 2005.
- 2- Angazhimi më i madh për ndjekjen e rasteve me vetiniciativë, fokusuar në mbrojtjen e të drejtave që prekin grupe të mëdha njerëzish apo nga grupet më në nevojë e më të prekshëm.
- 3- Angazhimi i Zyrës për trajtimin e rasteve të personave të zhdukur, për të krijuar një regjistër të plotë dhe një rrjet bashkëpunimi me ministritë e linjes dhe prokurorinë, me përfaqësitë shqiptare jashtë vendit, me zyrat homologe si dhe me organe të medias investigative.

- 4- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Parlamentin për ta informuar më mirë për situatën e të drejtave të njeriut dhe shkeljet e administratës publike në Shqipëri dhe nxitja e iniciativës legjislative të deputetëve, për të bërë rregullimet e duhura ligjore sipas rekomandimeve tona.
- 5- Forcimi i bashkëpunimit në të gjitha hallkat e Administratës publike shqiptare për rritjen e standarteve të qeverisjes ose thënë më thjeshtë, për mirëqeverisje. Në mënyrë të veçantë do synohet për zbatimin e Rregullores që po përgatitet bashkë me projektin “Për shtetin ligjor në Shqipëri” të USAID-it, për të drejtën e informimit të publikut me dokumentet zyrtare.
- 6- Krijimi i Rregjistrimit të trajtimit të të dhënave personale, siç e kërkon neni 15 i ligjit 8517 datë 22.7.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- 7- Forcimi i bashkëpunimit me organizma të shoqërisë civile si grupe “presioni” pozitiv mbi administratën. Ky bashkëpunim si dhe ai me Mediat do të konsolidojë më tej arritjet e deritanishme, me synim rritjen e efektshmërisë së ndërhyrjeve të Institucionit tonë për ngulitjen e praktikave të mira administrative.
- 8- Vazhdimi i veprimtarisë ndërgjegjëse të publikut dhe administratës për vendin dhe rolin e Avokatit të Popullit. Organizimi i ditëve të hapura në mënyrë periodike në zona të ndryshme të vendit, duke zbatuar edhe forma të tjera për t’ju afruar sa më shumë publikut.
- 9- Publikimi më mirë dhe më shumë i problemeve kryesore të evidentuara nga shkeljet e Administratës Publike në fushën e të drejtave të njeriut. Krahas kësaj, Avokati i Popullit do të nxjerrë këtë vit edhe Gazetën e tij, e cila do të promovojë më mirë veprimtarinë konkrete në trajtimin e rasteve.
- 10- Hapja e zyrave rajonale dhe caktimi i përfaqësuesve vendorë të Avokatit të Popullit sa më shpejt të jetë e mundur mbetet një objektiv i parealizuar për arsye që nuk varen nga Zyra por, për mosdhënie buxheti nga Kuvendi.
- 11- Mirëfunksionimi i nënseksionit për mbrojtjen e të drejtave të femijëve, duke konsoliduar bashkëpunimin me organizmat e huaja si Save the Children dhe UNICEF, sipas rekomandimeve të Konferencës Kombëtare të Dhjetorit 2005.
- 12- Angazhimi i mëtejshëm për rritjen cilësore dhe sasiore të nivelit të raportimeve pranë organizmave ndërkombëtare. Kjo do të bëhet si në përditësimin e raporteve të paraqitura nga pala shtetërore, ashtu edhe të njohjes me raportet alternative, të përgatitura nga organizma të shoqërisë civile.
- 13- Rritja e racionalitetit të shpërndarjes dhe menaxhimit të rasteve në varësi të rritjes së volumit të punës. Zbatimi më i shpeshtë i

mediacionit në punën tonë, dhe funksionimi i një njesie të veçantë pranë zyrës për këtë qëllim. Kjo do të kushtëzohet edhe nga trajnimi i kësaj njesie në zyra të tjera homologe që e aplikojnë këtë teknikë të re për ne.

- 14- Ruajtja e qëndrueshmërisë teknike, e kushtëzuar kjo deri diku edhe nga ajo financiare. Rrjeti i sistemit informativ kërkon mirëmbajtje të vazhdueshme. Rritja e ngarkesës së punës ka bërë të domosdoshme nevojën për shtesën e ambjenteve përkatëse për krijimin e Arkivit të Institucionit, për risistemimin e Zyrës së Pritjes së Popullit si dhe për një akomodim më të mirë të stafit të ekspertëve që duhet të rritet. Pritet të realizohet sistemimi në zyrat e reja, sepse këto që kemi do t'i marrë Parlamenti shqiptar.
- 15- Qëndrueshmëria financiare mund të vihet në pikëpyetje, pasi shteti shqiptar është i detyruar të ndjekë një politikë të rreptë fiskale, përmes shkurtimit të buxhetit. Ritmet e deritanishme të suksesit, veç përkushtimit të stafit drejtues dhe të specialistëve, janë kushtëzuar në një masë thelbësore edhe nga hetimet në vend që kanë shumë shpenzime, por dhe nga frekuenca e trajnimeve që ne kemi realizuar, si duke shkuar në zyra homologe, ashtu edhe duke ftuar ekspertë të huaj në Shqipëri. Por në buxhetin e akorduar nga shteti për vitin 2006, janë bërë rreth 40% shkurtime të shpenzimeve operative, gjë që rrezikon kryerjen me cilësi të detyrës dhe as që mund të bëhet më fjalë për trajnime me para nga buxheti i akorduar nga shteti. Për të përballuar këtë sfidë duhet të bashkëpunojmë dhe të tërheqim më tepër donacione të huaja për institucionin.

Garanci për përballimin e këtyre sfidave dhe të tjerave që lidhen me to është përvoja e deritanishme si dhe ndërgjegjësimi në rritje i organeve të administratës publike për përmbushjen e standarteve të mirëqeverisjes.

KREU I DYTË

1. Statistika përmbledhëse e vitit 2005

(Rastet sipas fushave përkatëse dhe mënyra e përfundimit të tyre)

Prioritetet e vendosura nga Avokati i Popullit për vitin 2005, kanë qënë rritja e efektivitetit të zyrës dhe promovimi i shtetit të së drejtës, mirëqeverisja dhe respektimi i të drejtave të njeriut si dhe njohja e problemeve të qytetarëve jo vetëm në Tiranë, por në të gjithë vendin. Gjatë këtij viti ne kemi synuar të jemi “imediati” në përgjigjen ndaj ankuesve dhe “praktik”, që do të thotë marrja e iniciativave për të rritur në maksimum shërbimin ndaj qytetarëve.

Ne kemi nënvizuar dhe në raportet e mëparshme se qëllimi i Institucionit të Avokatit të Popullit është të luftojë që t’i sigurojë gjithë qytetarëve që i drejtohen atij, të marrin ndihmën ose këshillat e nevojshme në kohën dhe mënyrën e duhur. Tashmë jemi të bindur se qytetarët nuk do të adresonin përsëri tek ne problemet e tyre, nëse nuk do të kishin besim në zgjidhjen e tyre. Gjatë vitit 2005, ne vazhduam të provojmë se ky besim ekziston. Këtë e provon fluksi i rritur i ankesave të qytetarëve që ka shqyrtuar Institucioni gjatë vitit 2005.

Gjatë periudhës 1 Janar - 31 Dhjetor 2005 janë trajtuar nga Zyra e Avokatit të Popullit **4361** ankesa, kërkesa dhe njoftime (duke përfshirë dhe ato të Zyrës së Pritjes së Popullit, të cilave ju është dhënë përgjigje menjëherë). Nga **4361** ankesa, **408** kanë qënë të mbartura nga viti 2004, **2300** janë raste të regjistruara në vitin 2005 dhe **1653** janë raste të cilave iu është dhënë përgjigje menjëherë në Zyrën e Pritjes së Popullit. Ankesa, kërkesa dhe njoftime të cilat i janë nënshtruar shqyrtimit nga ana e Zyrës sonë kanë qënë **2708**, ose **188** më shumë se në vitin 2004. Nga këto, **280** ankesa ose rreth **10%** e tyre kanë kaluar për shqyrtim në vitin 2006. Gjatë vitit 2005 janë përfunduar së shqyrtuari gjithsej **2428** ankesa, nga të cilat ka rezultuar se **1142** ankesa, ose **47%** e tyre, kanë qënë jashtë juridiksionit dhe kompetencës. Por për këto ankesa është bërë punë efektive, sepse qytetarët janë sqaruar për rrugën që ata duhej të ndiqnin për zgjidhjen e problemit të prezantuar tek ne. **626** ose **26%** e ankesave kanë rezultuar të padrejta, kurse **582** ose **24%** e tyre janë zgjidhur në favor. Për **22** ankesa, ose **1%**, rekomandimet drejtuar organeve përkatëse të administratës për shkelje të konstatuara prej tyre, nga zyra jonë, janë

refuzuar. Për **56** raste, ose **2%** të tyre, të paraqitura për shqyrtim pranë nesh, ankuesit kanë hequr dorë gjatë procesit të shqyrtimit. Për ankesat e gjetura të bazuara, për **124** prej tyre janë bërë rekomandime apo propozime përkatëse me shkrim, drejtuar autoriteteve publike me qëllim që të rritet cilësia e administrimit publik dhe të sigurohen standarte mirëqeverisje. Për pjesën tjetër zgjidhjet pozitive janë arritur që në fazën e marrjes së shpjegimeve apo ndërmjetësimit tonë verbal me organet e Administratës Publike, të cilat pas komunikimit me ne, kanë rregulluar gabimin e bërë ose kanë hequr dorë nga qëndrimet refuzuese apo negative që kanë mbajtur me ankuesit. Rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit dhe të pranuara nga organet të cilave ato u janë drejtuar tregojnë për ndërhyrje të argumentuara nga institucioni ynë për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura qytetarëve.

Në këtë Raport Vjetor do të prezantojmë, ashtu si dhe vitet e kaluara, rastet e trajtuara nga Zyra e Avokatit të Popullit, të ndara sipas Ministrive përkatëse dhe organeve apo enteve të tjera të Administratës Publike Shqiptare në vartësi të tyre, ndaj të cilave janë drejtuar ankesat apo kërkesat, duke shprehur shpesh dhe opinionet tona për fushat përkatëse.

Më poshtë po paraqesim numrin e ankesave, kërkesave apo njoftimeve të trajtuara në vitin 2005, të ndara për Këshillin e Ministrave dhe sipas Ministrive përkatëse, organeve apo enteve të tjera të administratës publike.

1. Këshilli i Ministrave	25 , nga të cilat për:
vetë Qeverinë	15
a. Grupin Mbikqyrës të Firmave Piramidale	8
b. Instituti i Integritit të ish të Përndjekurve politikë	2
2. Ministria e Drejtësisë	301 , nga të cilat për:
vetë ministrinë	17
a. Burgjet	99
b. Zyrat e Përmbarrimit	102
c. Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	83
3. Organet e pushtetit gjyqësor	
Gjykatat	388
4. Prokuroria	197
5. Ministria e Brendshme	465 , nga te cilat për:
(Ish Ministria e Rendit Publik së bashku me ish Ministrine e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit)	

Ish Ministrinë e Rendit	157
Ish Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit vetë ish MPVD-në	308, nga të cilat për: 11
Organet e pushtetit vendor	
a. Komunat	51
b. Bashkite	212
c. Prefekturat	4
d. Qarqet	7
dh. Gjëndja Civile	23
6. Ministria e Mbrojtjes	107
7. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (Ish Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale)	147 , nga të cilat për:
vetë ministrinë	14
a. Institutin e Sigurimeve Shoqërore	126
b. Shërbimi Social Shtetëror	7
8. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (Ish Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit)	136 , nga të cilat për:
Ish Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit	104, nga të cilat për:
vetë ish MRRTT	17
a. Ndërtimet pa leje	70
b. Ujësjellës kanalizime	10
c. Enti Kombëtar i Banesave	7
Ish Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit	32, nga të cilat për:
Vetë ish MTT-në	19
a. Albtelekom	10
b. Posta Shqiptare	3
9. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (Ish Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe ish Ministria e Industrisë dhe Energjitikës)	59 , nga të cilat për:
Vetë Ish Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit	7
Ish Ministria e Industrisë dhe Energjitikës	52, nga të cilat për:
Vetë ish MIE-në	7
KESH	45

10. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (ish Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit)	11
11. Ministria e Financave	47 , nga të cilat për:
vetë ministrinë	37
a. Agjensinë Kombëtare të Privatizimit	10
12. Ministria e Arsimit dhe Shkencës	51
13. Ministria e Shëndetësisë	18
14. Ministria e Punëve të Jashtme	50
15. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (Ish Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve)	5
16. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (Ish Ministria e Mjedisit)	6
17. Shërbimet Sekrete	8
18. Komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave	39
Të tjera	240
TOTALI	2300 ankesa

Për shkak të ndërgjegjësimit të publikut të shërbimit që kryen Institucioni i Avokatit të Popullit, sikundër rezulton dhe nga shifrat e përmendura më sipër, ngarkesa e punës së institucionit ka qënë në rritje krahasuar me vitin 2004.

2. Opinione të përgjithshme për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri

Avokati i Popullit është i vetmi institucion kombëtar me status kushtetues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri. Prandaj mendojmë se në këtë Raport vjetor kemi të drejtë për të dhënë konsiderata të veçanta apo të përgjithshme për çështje të të drejtave të njeriut. Në lidhje me gjendjen e të drejtave dhe lirive të individëve në Shqipëri jemi shprehur çdo vit në Raportet tona, apo në analiza, diskutime apo rekomandime, kur kemi analizuar raste apo fusha të caktuara. Por për disa probleme që do të prezantojmë më poshtë, nuk jemi bazuar vetëm në ankesat e paraqitura tek Institucioni ynë, por dhe në informacionet e marra nga organizatat jofitimprurëse për fusha të veçanta të së drejtës, nga sondazhet e publikuara në Mediat shqiptare, si dhe në raportet e organizmave dhe institucioneve prestigjioze kur flasim për gjendjen e të

drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri, siç janë ato të Bashkimit Europian, Këshillit të Europës, Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Human Rights, Amnesty International, Komitetet e të drejtave të njeriut pranë organizmave të Kombeve të Bashkuara, Komiteti Shqiptar i Helsinkit etj.

Dihet se në Republikën e Shqipërisë janë miratuar pothuajse të gjitha ligjet specifike që kanë si objekt respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Vendin kryesor e zë Kushtetuta shqiptare e vitit 1998 që ka përcaktuar qartë se “të drejtat e njeriut dhe liritë themelore janë të patjetërsueshme dhe i takojnë çdo njeriu me lindjen e tij”. Ajo gjithashtu thekson që “njohja dhe respektimi i të drejtave të njeriut është detyrë e shtetit”. Por hartimi i ligjeve të reja nuk është i mjaftueshëm. Aftësia për t’i zbatuar ato mirë është një element po aq thelbësor i garantimit të demokracisë dhe sundimit të ligjit. Tashmë në Shqipëri është fakt që në drejtim të zbatimit me efikasitet të kuadrit ligjor pozitiv hasen një sërë problemesh serioze që kërkojnë zgjidhje. Në këto kushte në jetën e përditshme ndeshim mjaft fenomene negative, që në thelb janë shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut.

E drejta e jetës, si e drejtë themelore e njeriut ka qenë në qendër të Konferencës Kombëtare që Avokati i Popullit organizoi në Dhjetorin e vitit 2001. Synimi i saj ishte inicimi i një strategjie kombëtare të përbashkët nga të gjithë organet shtetërore dhe OJF-të, për masat parandaluese të ngutshme dhe të qëndrueshme, në mbrojtje të së drejtës së jetës dhe në veçanti, ndaj fenomenit të gjakmarrjes. Konkluzionet dhe rekomandimet e kësaj konference janë publikuar qysh në fillim të vitit 2002. Por këto rekomandime, sidomos gjatë viteve 2002-2004 nuk janë zbatuar nga të gjitha autoritetet, të cilave ato u janë drejtuar. Masat parandaluese ndaj gjakmarrjes mesa duket ju lanë vetëm disa organizatave joqeveritare apo punës spontane të organeve të pushtetit vendor. Presidenti i Republikës, disa herë publikisht ka vazhduar të kërkojë që organet shtetërore të merren më shumë me gjakmarrjen.. Është pozitive se pas vitit 2004 ka patur një angazhim më serioz ndaj gjakmarrjes. Ministria e Rendit ka krijuar një task force në Shkodër dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Është diskutuar për një projekt për të mbledhur bashkë fëmijët e ngujuar që të vazhdojnë shkollat. Po kështu edhe për një “qytet” ku të mblidhen e të ruhen familjet e kërcënuara nga gjakmarrja. E rendësishme është se Kuvendi ka miratuar Ligjin nr.9389 date 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër Gjakmarrjes”. Por për fat të keq deri tani, pas rreth 9 muajsh, Këshilli Koordinues nuk është mbledhur asnjë here. Gjithashtu edhe Këshilli i Ministrave nuk ka nxjerrë aktet nënligjore përkatëse në zbatim të këtij ligji. Mendojmë se e rendësishme është që të

gjitha institucionet qeveritare e kanë kuptuar se duhet të angazhohen më seriozisht për këtë “plagë” që e bën të papranueshme Shqipërinë në familjen e madhe të Bashkimit European.

E drejta e jetës në Shqipëri, si e drejtë themelore e njeriut, vazhdon të jetë e rrezikuar për sa kohë që armët vazhdojnë të jenë pa kontrollin e duhur në duart e popullsisë civile. Këto armë përditë marrin jetë njerëzish nëpërmjet krimeve brenda familjes, vetvrasjeve, krimeve me dashje apo pakujdesive në administrimin e tyre. Ashtu siç e kemi prezantuar dhe në Raportet e mëparshme, ligji për mbledhjen e armëve nuk ka dhënë dhe nuk po jep rezultatet e pritshme. Ndonëse nga policia ka patur disa rezultate të bujshme për trafikun e armëve dhe zbatimin e ligjit për armëmbajtësit pa leje është forcuar, numri i armëve pa leje në duart e popullsisë është ende i madh. Për t’i dhënë fund kësaj gjendje mendojmë se çarmatimin nuk mund ta presim që ta bëjnë vetëm strukturat e Policisë së Shtetit. Duhet gjetur zgjidhje të reja që mund të jenë që nga kombinimi i pagesës për çdo armë të dorëzuar deri tek ligjësimi i mbajtjes së armës nga çdo individ i rritur, i përgjegjshëm dhe pa precedentë penale. Psikologjia na ndihmon të kuptojmë se konflikti ndërmjet njerëzve nuk degjeneron deri tek përdorimi i armës sa kohë se secili e din që të gjithë kanë armë me leje në posedim.

Liritë dhe të Drejtat Vetjake si liria e shprehjes, e shtypit, medias e televizionit, liria individuale, paprekshmëria e banesës, liria e fshehtësia e korrespondencës janë të garantuara me ligj. Për to ka patur dhe do të ketë ankesa apo dhe mbrojtje të tyre si nga ana e Avokatit të Popullit ose me anë të proceseve gjyqësore. Por mendimi ynë, ashtu sikundër është thënë dhe më parë, është se këto të drejta dhe liri përgjithësisht respektohen. Janë ndëshkuar shkaktarët, kur pas proceseve ligjore të rregullta janë vërtetuar shkelje të tyre të kryera nga autoritete publike, apo nga individë të veçantë që ju kanë cënuar këto të drejta, në rastet që janë ankuar tek Avokati i Popullit apo në organet gjyqësore.

Liria e ndërgjegjes dhe e fesë njihen dhe respektohen nga shteti.

Avokati i Popullit ka ndjekur me vemendje njoftimet e paraqitura nga media lidhur me impaktin negativ që po krijojnë në komunitetet fetare të ndryshme, ndertimi i objekteve të kultit, si kryqet, teqete, xhamite, varrezat, si vende të shenjta etj, vend e pa vend, me ose pa leje. Këto janë sulme ndaj shëndetit dhe interesit publik në teresi, të garantuara si nga Kushtetuta e vendit, ashtu edhe nga Kartat dhe Konventat nderkombetare për të drejtat e njeriut në teresi dhe për lirinë fetare në veçanti.

Në kemi shprehur mendimin se procedura e dhënies së lejes për ndërtime të tilla, dokumentacioni që duhet të plotësohet si dhe organi që duhet të jetë kompetent për miratimin e lejes së ndertimit, duhet t’i

pershtaten nje rregulli specifik ligjor, dhe konkretisht kemi propozuar plotesimin e Ligjit "Per Urbanistiken", duke parashikuar qe KRRTSH-ja te jete organi i vetem qe duhet te miratoje vendimin per dhenien e lejes se ndertimit per objekte kulti, pasi te kete marre edhe mendimin e Komitetit Shteteror te Kulteve.

Kete kufizim te te drejtave te organeve te pushtetit vendor, por edhe te komuniteteve fetare, e argumentojmë duke u bazuar ne nenin 17 te Kushtetutes, pika 1 e te cilit justifikon kufizime te tilla me ligj per "nje interes publik ose mbrojtjen e te drejtave te te tjereve ... ne perpjestim me gjendjen qe e ka diktuar kete kufizim".

Avokati i Popullit eshte i ndjeshem ndaj aktit te rrezimit te Kryqit, në Bushat të Shkodrës po aq sa dhe ka qene i ndjeshem edhe ndaj aktit te dhunimit te Xhamise se Tabakeve në Tiranë ne ditet e para te vitit. Per kete arsye u ka kerkuar organeve te policise dhe prokurorise te zbardhin ngjarjet dhe te vene para pergjegjesise autoret dhe ideoret e ketyre akteve te denueshme penalisht. Ne kushtet kur solidariteti brendafetar perben nje norme te respektueshme te besimit, shteti duhet ta konsideroje kete fakt per te ballafaquar dhe parandaluar pasojat reale qe mund te sjellin akte te tilla per te sotmen dhe te ardhmen e vendit dhe te qytetareve te tij. Avokati i Popullit është bashkuar me deklaratat e drejtuesve fetare se besimi ruhet ne shpirt e ne ndergjegje dhe shfaqet brenda institucioneve dhe ndertesave te kulteve. Por shteti shqiptar dhe Administrata Publike etj nuk duhet te qendrojne indiferente. Prandaj, kemi rekomanduar që Policia Ndertimore duhet te zbatoje pa hezitim ligjin dhe te prishe çdo simbol fetar te ngritur pa leje, qofte ne Shkoder, Sarande, Elbasan apo gjetke. Per kete Avokati i Popullit i rekomandon edhe drejtuesve fetare te bashkepunojne me Policine Ndertimore per prishjen e çdo simboli fetar te ngritur pa leje.

Avokati i Popullit nuk ka munguar te trajtoje ankesa qe lidhen me respektimin e lirise se shprehjes dhe te besimit privatisht dhe publikisht, dhe ne çdo rast ka mundur te arrije zgjidhje me mirekuptim te ketyre rasteve, te bera keto publike jo si qellim ne vetvete, por per te krijuar shembullin pozitiv te trajtimit te tyre konform ligjit dhe ne frymen e kartave nderkombetare.

Për lirinë e shtypit, medias e televizionit, duhet thënë se vazhdon të ketë raste kur kjo liri është shkelur. Por mediat tona duket se po ndergjegjësohen, sepse më pare nuk e konsideronin shkelje të jepnin me hollësi të dhënat personale që shkelin të drejtën e privacisë, të rregulluar nga dispozitat e Ligjit nr. 8517, datë 22.07.1999, "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Më e theksuar ka qenë kjo kur ka patur akuza për vepra penale dhe, aq më tepër, kur janë të akuzuar dhe të dëmtuar të miturit apo femrat e shfrytëzuara për trafiqe të paligjshme, për krime

seksuale në familje etj. Më pak se në vitet e shkuara, gazetarët kanë rendur të marrin intervista dhe të botojnë foto, me identitete të plota e të sakta për fëmijë të vetëruarë apo femra të dhunuara si nga trafikantët, përsëritës të krimet seksuale apo prindër dhunues. Nuk duhet harruar se publikimi i këtyre fakteve i sjell dëme të pariparueshme auditorit, sidomos fëmijëve apo personit të dhunuar. Është fakt se për shkak të mungesës së nivelit të duhur arsimor, kulturor e juridik, personat e cënuar nuk kanë ngritur padi apo bërë ankesa, por kjo nuk do të thotë se këto shkelje nuk ekzistojnë. Rol të madh parandalues duhet të lozin shoqatat e gazetarëve, nëpërmjet aftësisë profesionale të tyre. Por edhe institucioni ynë duhet të bëjë më shumë në këtë drejtim, duke vepruar me inisiativë për të ngritur opinionin publik kundër këtyre shkeljeve.

Liritë dhe të Drejtat Politike, si e drejta e zgjedhjeve, e organizimit, e tubimeve dhe manifestimeve paqësore, janë të garantuara me ligj. Të gjitha institucionet publike punojnë që ato të respektohen. Për fat të keq vazhdojnë diskutimet dhe dyshimet, mungesa e besimit reciprok për proceset elektorale të shkuara, atë për zgjedhjet parlamentare të vitit 2005 dhe zgjedhjet e ardhshme lokale 2006. Natyrisht ka dhe do të ketë opinione të ndryshme në këto drejtime, sidomos nga partitë politike dhe ne jemi të paanshëm në këto diskutime. Avokati i Popullit është shprehur pozitivisht për masat legjislativë dhe ato administrative për të zbatuar Rekomandimet e ODIHR-it. Kur ka qenë rasti kemi punuar konkretisht për respektimin e të drejtës themelore të votës së lirë për çdo qytetar të Republikës së Shqipërisë, duke dhënë edhe rekomandime konkrete për të mos lejuar asnjë mundësi manipulimi nga cilado palë apo subjekt elektorale. Në vitin 2003, duke marrë shkas nga ekzistenca e të vdekurve në regjistrat e gjendjes civile, rekomanduam që të hiqeshin ata nga listat e zgjedhjeve. Ky rekomandim u muar pa sukses. Por gjatë zgjedhjeve të vitit 2005 nuk u arrit të realizohej pastrimi i listave elektorale nga të vdekurit. Pozitive është që po punohet të bëhet pastrimi i plotë i listave.

Veç krijimit të Regjistrat të saktë të zgjedhësve ne patëm rekomanduar që të ndryshohej Kodi Zgjedhor dhe të caktoheshin gjykatësit që të bëjnë numërimin e votave dhe nxjerrjen e rezultateve të votimit, në prani të komisionerëve të caktuar nga subjektet elektorale. Pjesa e rekomandimit që numërimi i votave të bëhet në zonat zgjedhore është pranuar dhe zbatuar. Kurse në vend të gjyqtarëve u pranua zgjidhja e krijimit të skuadrave të numërimit të votave në prani të komisioneve dhe Mediave. Por edhe procesi elektorale i vitit 2005 nuk u quajt i pakontestueshëm dhe në axhendën e organizimeve ndërkombëtare vazhdon sllogani se “në Shqipëri akoma nuk realizohen të gjitha standartet për zgjedhje të lira e të ndershme.”

Për zgjedhjet e ardhshme do të rekomandonim që në vend të skuadrave të numërimit të përdorëshin skanerët elektronikë për të numëruar votat. Kjo zgjidhje veçse zhduk subjektivizmin njerëzor, është edhe me mjaft përfitim ekonomik. Kështu rezulton që për zgjedhjet lokale 2006 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar nga buxheti i shtetit rreth 95.000.000 lekë. Po të blesh me këto para mjetet elektronike (skanerët), nuk do të ketë nevojë të harxhosh para të tjera për zgjedhjet që do të zhvillohen pas vitit 2006. Institucioni i Avokatit të Popullit mbështet mendimet që të ndryshohet Kushtetuta që Kuvendi të përbëhet vetëm nga 100 deputetë, të zgjedhur me sistem proporcional. Kjo do ta bënte fushatën elektorale më të qetë, për shkak se nuk do kishte personalizim në zona, partite politike do kishin më tepër mundësi për të përfshirë në listat e tyre grate dhe figurat e tyre më aktive dhe nga profesione të tilla, si juriste, ekonomiste, sociologe etj, me qëllim që Parlamenti të jetë sa më cilësor në veprimtarinë e tij.

Në lidhje me trafikun e qënieve njerësore nuk duhen mohuar rezultatet pozitive të viteve të fundit që kanë patur të bëjnë sidomos me rritjen e kontrollit të kufijve. Këtë e vërteton vetëm fakti se tashmë shqiptarët nuk mund të kalojnë ilegalisht nga Shqipëria direkt në Itali, dhe janë kapur në tentativë duke kaluar nga vende të treta p.sh. në Kroaci. Trafikimet e femrave për prostitucion dhe ato të fëmijëve në çdo formë janë zvogëluar dhe çdo ditë e më tepër flitet për vënie para ligjit të cilitdo që ka kryer vepra të tilla, sidomos në vitet e shkuara.

Avokati i Popullit gjatë shqyrtimit të ankesave konkrete, sidomos për abuzime me fëmijët ka shqyrtuar nëse janë zbatuar detyrimet që rrjedhin nga nenshkrimi i konventave nderkombetare apo nga legjislacioni vendas. Në këto raste ndërhyrjet e Avokatit të Popullit kanë qenë frutdhënëse, jo vetëm sepse janë vene në levizje strukturat e përmbarimit, ato të shkollës apo të ndihmës sociale, por se duke ju bërë këtyre rasteve edhe publiciteti i nevojshëm, është krijuar precedenti pozitiv, janë hartuar Rekomandime për Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Rendit, Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministrinë e Arsimit dhe shumë struktura të tjera, për t'i sensibilizuar që të kontrollojnë e t'u kërkojnë llogari organeve të tyre vartëse, për të vlerësuar në radhë të parë interesin e fëmijëve. Këtij qëllimi i shërbeu edhe organizimi në dhjetor 2005 i Konferencës Kombëtare "Të gjithë së bashku në mbrojtje të fëmijëve", për të cilën është folur me hollësi në këtë Raport.

Në bashkëpunim me "Save the Children", qysh në vitin 2004 në zyrën tonë ka filluar funksionimi i një nënseksioni që merret në mënyrë specifike me problemet e fëmijëve në Shqipëri. Synimi është që edhe në Shqipëri të krijohet një autoritet i fortë shtetëror, i cili jo vetëm që do të nxitë autoritetet dhe organet shtetërore për zhvillimin e fëmijëve, por do

të jetë edhe një organ specifik si mbrojtës i të drejtave të fëmijëve. Por për këtë kuptohet që duhet vullnet politik, angazhim financiar si dhe ndryshimet e duhura në legjislacion, kushte të cilat kërkojnë disa kohë që të plotësohen. Ky projekt tashmë ka gjetur një financim për 3 vjet nga Agjensia Ndërkombëtare Suedeze e Zhvillimit (Sida).

Ministria e Drejtësisë së bashku me Komisionin Europian, Unicefin dhe Sidan kanë filluar një projekt të posaçëm për hartimin e ligjeve të posaçme për të drejtat e fëmijëve, krijimin e një sistemi gjyqësor dhe penitenciar, të veçantë për minorenët, krijimin e qendrës për edukimin e minorenëve, por mundësisht edhe një burg të veçantë për minorenët.

Në lidhje me të drejtat e grave, konstatohet që vitet e fundit ka rënie të trafikut të femrave në mënyrë të ndjeshme. Kjo ka ardhur edhe si rrjedhojë e fushatave ndërgjegjësuese të ndërmarra nga OJF-të e ndryshme në media, shkolla, universitete etj. Por kryesore ka qenë ndjekja dhe zbatimi me rreptësi i ligjit ndaj trafikantëve, miratimi dhe zbatimi i politikave dhe programeve të posaçme për mbrojtjen e viktimave të trafikut, si dhe monitorimin e këtij procesi nga organizmat që janë krijuar enkas nga strukturat qeveritare. Por çështjet që kanë të bëjnë me keqtrajtimin bashkëshortor apo dhunën në familje ndaj grave dhe vajzave janë të shumta. Situata duket që përmirësohet ngadalë, prandaj puna parandaluese nuk duhet lënë vetëm në dorë të organizatave joqeveritare.

Organizmat ndërkombëtare rekomandojnë në vazhdimësi që shteti shqiptar duhet të ndërmarrë hapa të menjëhershme për ndryshimin e sjelljes së publikut ndaj pjesëmarrjes së gruas në çështjet publike, si dhe të marrë në konsideratë miratimin e një politike pozitive veprimi në këtë drejtim. Shteti duhet të marrë masat e duhura për të siguruar pjesëmarrjen efikase të gruas në jetën politike, publike si dhe në sektorë të tjerë të shtetit. Ndryshimi i sistemit elektoral do t'i jepte më tepër hapësirë pjesëmarrjes së grave në jetën publike dhe do rriste nivelin e tyre të përfaqësimit në organet e zgjedhura.

Ristrukturimi i Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, mendojmë se duhet të ketë mjete efektive për të ndikuar që të ruhen dhe zbatohen të drejtat e grave, për të përmirësuar trajtimin dhe pozitën e femrave në familje dhe në shoqërinë shqiptare. Gjithashtu vlerësohet pozitivisht ngritja e nënseksionit për Çështjet e Minorenëve dhe barazisë Gjinore pranë Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë në Parlamentin Shqiptar.

Trajtimi i të dënuarve dhe të paraburgosurve në dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë, megjithë përmirësimet nga viti në vit,

vazhdon të ketë probleme dhe ankesa. Edhe trajtimi i të sëmurëve mendorë në spitalet tona psikiatrike vazhdon të jetë problem shqetësues.

Qeveria Shqiptare duhet t'i kërkojë më tepër llogari institucioneve vartëse të drejtësisë, policisë e mjekësisë që të punojnë më seriozisht për zbatimin e vendimeve të saj, për t'i ndarë përgjegjësitë për këta persona. Mund të themi se kjo Qeveri ka filluar ta bëjë më mire këtë detyrë dhe angazhim të saj.

Institucioni i Avokatit të Popullit është i ndërgjegjshëm se ndonëse ka mjaft përmirësime në trajtimin e të dënuarve dhe të të paraburgosurve në dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë, ka patur mjaft ankesa dhe kërkesa për të cilat kemi bashkëpunuar mirë me Ministrinë e Drejtësisë dhe atë të Rendit. (të Brendshme)

Ne kemi bërë hetimet përkatëse për rastet arbitrare të arrestimit dhe ndalimit, përdorimin e dhunës nga oficerët e policisë, keqtrajtimin e të ndaluarve në dhomat e paraburgimit si dhe përdorimin e dhunës për të detyruar të ndaluarit të pranojnë fajin. Gjithashtu ne kemi rekomanduar masa të rrepta për eliminimin e të gjitha rasteve të keqtrajtimit nga punonjësit e policisë.

Edhe për prokurorinë dhe gjykatat vazhdohet të ketë një numër të madh ankesash tek Avokati i Popullit, sidomos të vonesës së paarsyeshme (zvarritjeve) të çështjeve gjyqësore, duke kërkuar që të paraburgosurit e padënuar të dalin para gjyqit sa më shpejt që të jetë e mundur.

Duke patur këtë situatë edhe ne kemi rekomanduar vazhdimisht se duhet vazhduar puna për përmirësimin dhe hartimin e ligjeve të reja, për të cilat kemi bërë edhe propozime konkrete për luftën kundër korrupsionit brenda sistemit gjyqësor; zbatimin pa kushte të vendimeve gjyqësore; reforma për përjasjen e legjislacionit vendas me marrëveshjet ndërkombëtare, përmirësimi i marrëdhënieve konkrete të punës së përditshme midis prokurorisë, policisë gjyqësore dhe gjykatave kundër krimit të organizuar etj.

Kuvendi i Shqipërisë ka ratifikuar edhe Kartën Sociale të Ndryshuar, por duhet shumë punë që kjo Kartë të zbatohet në praktikë. Kuptohet që për kushtet e Shqipërisë jo të gjitha të drejtat ekonomike dhe sociale mund të realizohen plotësisht. Ndonëse mund të jetë e pamundur për çdo njeri të ketë një punë, Qeveria duhet të përpiqet maksimalisht për të krijuar mundësira punësimi e banimi, shanse të barabarta dhe një mjedis të përshtatshëm për të punuar, duke vënë në punë sidomos inspektoriatet e shumta të punës apo ato mjekësore për të kontrolluar respektimin e kushteve të punës.

Avokati i Popullit si institucion që ka dalë nga Parlamenti e ka të qartë rolin dhe ka bërë dhe do të vazhdojë të bëjë pa u lodhur apo pa u

dekurajuar detyrën e tij kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Shqipërisë. Dihet nga të gjithë se përgjegjëse për gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në çdo vend janë Parlamenti dhe Qeveritë që dalin prej tij. Përmirësimi i mëtejshëm i gjëndjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri, varet gjerësisht nga njohja dhe respektimi i shtetit të së drejtës, rritja e përgjegjshmërisë të të gjithë Administratës publike shqiptare për rëndësinë që kanë të drejtat e njeriut në botën e sotme, të cilat janë kusht primar për proceset e afrimit dhe bashkimit të Shqipërisë me Vendet e Bashkimit Europian.

3. Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë

Tashmë, pas rreth 6 vjetësh të veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit, për të gjithë është e qartë se Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka ndikuar mjaft për forcimin dhe konsolidimin e tij. Kjo sepse tashmë dihet se “Ombudsmani është krahu i zgjatur i Parlamentit mbi Administratën Publike, me qëllim që gjatë zbatimit të ligjit, të punojë që të arrihen qëllimet e ligjvënësit”. Gjatë vitit 2005, ashtu si edhe në të gjitha vitet që nga krijimi i tij, Avokati i Popullit ka vazhduar të informojë herë pas here me shkrim ose verbalisht Kryesinë e Kuvendit, si dhe komisionet parlamentare përkatëse për veprimtarinë e tij ose ka bashkëpunuar me grupe deputetësh për çështje të veçanta.

Kemi marrë pjesë në diskutime të projektligjeve, si dhe kemi dërguar edhe rekomandime për çështje të ndryshme. Synimi ka qenë që deputetët në komisionet parlamentare jo vetëm të informohen për veprimtarinë dhe opinionet tona, por edhe që të ndërmarrin inisiativën legjislative për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve, kur i vlerësojnë me vend Rekomandimet që kemi bërë. Ne falenderojmë në mënyrë të veçantë deputetët, zotërinjtë Neritan Ceka, Luan Skuqi, Lufter Xhuveli, Ndre Legisi dhe ish deputetin z. Qazim Tepshi, që si grup deputetësh iniciuan ligji nr.9398 datë 12.5.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin “Për Avokatin e Popullit”.

Kryesia e Kuvendit është treguar e gatshme dhe në çdo rast ka pritur homologët e Avokatit të Popullit që kanë zhvilluar vizita zyrtare tek ne, si dhe ka shprehur opinionet pozitive të Kuvendit për veprimtarinë tonë. Në tërësi mund të themi se i kemi plotësuar objektivat e pikave 1 dhe 7 të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të dates 7 mars 2005 “Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2004”. Rezoluta kërkonte që për vitin 2005 t’i kushtohej vëmendje e veçantë “bashkëpunimit të vazhdueshëm me Kuvendin, jo vetëm për të informuar më mire për situatën e të drejtave të njeriut dhe

shkeljet e administrates publike në Shqipëri, por edhe për të bërë ndryshimet e nevojshme ligjore që do të sillnin një efektivitet më të madh të zyrës së Avokatit të Popullit”.

A- Në Raportet tona vjetorë nga viti 2001 e në vazhdim ne i bëjmë të ditur Kuvendit se i kemi rekomanduar Qeverisë që të marrë masa për të përgatitur disa ligje e akte të tjera që të plotësohen detyrimet që rrjedhin nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Me këtë rast vemë në dukje se për dy çështje detyrimet e përcaktuara nga nenet 10 dhe 44 të Kushtetutës nuk janë plotësuar.

1. Detyrimi i Qeverisë për lidhjen e marrëveshjeve me bashkësitë fetare, siç kërkon neni 10 i Kushtetutës. Rezulton se megjithëse kanë kaluar 7 vjet nga miratimi i Kushtetutës së 28 nëntorit 1998, shteti shqiptar ka ratifikuar vetëm marrëveshjen me Komunitetin Katolik, me ligjin nr. 8902 datë 23.05.2002 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta”. Përsa i përket Komunitetit Musliman Shqiptar, Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe Kryegjyshitës Botërore Bektashiane, projekt marrëveshjet janë hartuar nga Komiteti Shtetëror i Kulteve dhe u është dërguar për komente tre entiteteve të mësipërme, para se këto projekt marrëveshje t’i paraqiten Qeverisë Shqiptare. Për këto projekte vetëm Kisha Ortodokse ka bërë komentet përkatëse dhe projekt marrëveshja rezulton të jetë paraqitur pranë Zyrës së Kryeministrit të Shqipërisë qysh në muajin Prill 2005.

Marreveshjet e kërkuara nga neni 10 i Kushtetutës janë bërë të domosdoshme dhe urgjente, sepse duhet që në të njëjtën kohë të pajtohen interesat e shtetit tonë laik me ato të bashkësive të ndryshme fetare, me qëllim që të garantohet respektimi i bindjeve fetare të secilit person, por edhe të ruhet karakteri laik i shtetit dhe shoqërisë sonë. Në mënyrë të veçantë në këto marrëveshje ne kemi rekomanduar se duhet rregulluar kufizimi për të mosmbajtur brenda ambienteve të shkollave publike sende apo veshje që tregojnë përkatësinë fetare siç është p.sh. përvoja franceze, apo kufizime të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme nga ekspertët e fushës. Kuptohet se këto kufizime nuk duhen lënë në diskrecionin e rregulloreve të shkollave, sepse kjo është një shprehje vullneti administrativ antikushtetuese. Në këtë mënyrë do të arrihet edhe përputhja e legjislacionit tonë me kërkesat e Konventave dhe akteve të tjera ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Qysh nga viti 2001 e në vazhdim ne kemi bërë rekomandime për tre ish kryeministrat paraardhës si dhe kemi përmendur këtë çështje në Raportet tona vjetore në Kuvend. Faktikisht të gjithë e kanë pranuar në

parim Rekomandimin e mësipërm, por realisht është lidhur vetëm një marrëveshje nga tre apo katër të tilla që ne mendojmë se duhen.

Për nxitjen e këtij procesi, ja kemi kujtuar edhe Qeverisë së re të drejtuar nga Kryeministri Berisha në dhjetor 2005 detyrimin e plotësimit të detyrës që rrjedh nga neni 10 i Kushtetutës. Theksojmë përsëri se plotësimi i këtij detyrimi duhet shpejtuar, me qëllim që të rregullohen ligjërisht çështje të tilla siç janë propaganda fetare tek fëmijët, dhe tendencat për të penetruar në institucionet shkollore publike mbulimi i trupit dhe i kokës nga femrat, rritja e mjekrës nga meshkujt, të devijimit të riteve tradicionale të fesë islame në zona të prapambetura, por edhe ndërtimi i kryqeve, varrezave etj, pa leje në vende publike, çka mund të përbëjë një rrezik për traditën shqiptare të harmonisë fetare në të ardhmen.

2. Rekomandimi për nxjerrjen e ligjit për rehabilitimin apo zhdëmtimin nga aktet apo veprimet e paligjshme të organeve shtetërore, siç kërkon neni 44 i Kushtetutës. Qeveria ja ka ngarkuar si detyrë Ministrisë së Drejtësisë që të përgatitë projektligjin qysh në vitin 2003. Por akoma nuk kemi dijeni që ky projekt nga Qeveria t'i ketë kaluar Kuvendit për miratim.

B. Gjatë vitit 2005, i kemi nisur direkt Kuvendit këto Rekomandime për përmirësimin e ligjeve; me qëllim që deputetët të marrin nismë legjislative:

1. Rekomandim drejtuar Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, me qëllim që të dënuarve që kanë ndenjur në dhomat e paraburgimit tej kohës mbasi vendimi i tyre kishte marrë formë të prerë, t'u llogaritet kjo kohë sipas nenit 57 të Kodit Penal, pra një ditë paraburgim baraz me një ditë e gjysmë burgim. Rekomandimi në parim u pranua, por ju dërgua Ministrisë së Drejtësisë me qëllim që ta përfshinte në paketën e ndryshimit të ligjeve penale, të realizuara në vitin 2004. Për fat të keq deri tani kjo ministri nuk ka paraqitur ndonjë projekt dhe si rrjedhojë mjaft persona të dënuar nuk kanë përfituar nga kjo gjendje paraburgimi që shkel të drejtat e tyre. Ky rekomandim është i përsëritur, prandaj do synojmë që një grup deputetësh të paraqesin projekt ligjin e duhur, sepse rruga e inisiativës legjislative nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë është mjaft e gjatë.

2. Propozimi për një ndryshim në ligjin nr.8434 datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" drejtuar Kryetares së Kuvendit më datë 8.11.2005

Rekomandimi synon të rregullojë një ndër problemet e parregulluara si duhet me ligj, siç është çështja e afatit të qëndrimit në detyrë të Kryetarëve dhe Zëvendëskryetarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe atyre të Apelit.

Në këtë Rekomandim argumentohet se duke shqyrtuar ligjin nr.8436 datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, del se kryetarët dhe zëvendëskryetarët e këtyre gjykatave janë të pakufizuar në afat në këto detyra drejtuese me karakter administrativ. Ata mund të qëndrojnë në këto detyra derisa do të dalin në pension në moshën 65 vjeç.

Dihet se të gjitha postet drejtuese në administratën tonë publike, pjesë e së cilës është edhe administrata gjyqësore, fitohen me konkurs dhe janë të kufizuara në afat për qëndrimin në detyrë. Në këtë rast ka një përjashtim nga rregulli, i cili në vetvete nuk ndikon pozitivisht për mirëfunksionimin e drejtësisë, shpesh mbulon të metat, mund të krijojë një frymë mbytëse ndaj kritikës dhe nuk lejon ngritjen në përgjegjësi të gjyqtarëve të rinj që janë futur në punë pas konkurseve nga shkolla e Magjistraturës.

Në këto kushte, me qëllim që të rritet mirëfunksionimi i gjyqësorit shqiptar, propozohet që në nenin 24 të ligjit nr.8436 datë 28.12.1998 (me ndryshimet e bëra në këtë ligj) të shtohet një nen me këtë përmbajtje:

“Kryetarët dhe zëvendëskryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të Apelit emërohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë me konkurs për një periudhë prej 5 vjetësh pa të drejtë rikonkurimi të menjëhershëm. Personat që janë emëruar në këto detyra para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të qëndrojnë në detyrë derisa të plotësojnë 5 vjet dhe, nëqoftëse e kanë plotësuar këtë afat, do largohen nga detyra 2 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji”. Verbalisht kemi marrë përgjigje se ky rekomandim është pranuar në parim dhe po përgatitet projekti përkatës nga organet kompetente.

3. Propozim për ndryshime në ligjin nr.9209 datë 23.03.2004 “Për legalizimin e shtesave në ndërtim”. Ky rekomandim i është drejtuar Komisioneve përgjegjëse Parlamentare më datën 16.03.2005 dhe Qeverisë Berisha më datën 16.09.2005. Faktikisht rekomandimi është pranuar dhe siç dihet projekti përkatës që është përgatitur është akoma më i zgjeruar dhe besojmë se do miratohet së shpejti në Kuvend.

4. Rekomandimi për përfshirjen në paketën fiskale lidhur me ndërmarrjen e iniciativës ligjore për parashikimin ligjor të termit “taksë e drejtpërdrejtë” në Ligjin nr. 8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” si dhe në Ligjin nr. 8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore” për cilësimin ligjor të llojeve të “taksave vendore të drejtpërdrejta” për efekt të përjashtimit të veteranëve të luftës, invalidëve, dhe të të verbërve. Rekomandimi është pranuar zyrtarisht nga Ministria e Financave, nuk ka pasoja financiare dhe do ta ndjekim që të miratohet sa më shpejt në vitin 2006.

C. Gjithashtu gjatë vitit 2005 Kryesia e Kuvendit apo Komisionet e Përhershme parlamentare janë informuar me shkrim për:

1. Informacion për detyrat që dalin nën frymën e Vëzhgimeve dhe Rekomandimeve të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës datë 16.03.2005.
2. Informacion për një shtesë në ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, datë 16.03.2005.
3. Informacion për rekomandimet për rritjen e transparencës dhe zbatimin e ligjit për të drejtën për informim për dokumentet zyrtare, duke përgatitur një rregullore tip, datë 12.10.2005.
4. Informacion për shfuqizimin sa më shpejt dhe moszbatimin më tej të Udhëzimit të Ministrit të Rendit Publik Nr.168, datë 20.10.1993, “Për rregullat e shoqërimit të shtetasve në Komisariate, Reparte, Posta të Policisë dhe zyra të tjera të tyre”, si dhe përgatitjen, miratimin dhe vënien në zbatim të Rregullores së re të shoqërimit të shtetasve në zyrat e Policisë. Marrjen e masave për ndërtimin dhe komplementimin me orenditë e domosdoshme të dhomave të pritjes së popullit dhe të mbajtjes së personave të shoqëruar në organet e Policisë, datë 13.10.2005.
5. Informacion mbi problemet që kanë dale nga ankesat lidhur me marrëdhëniet e punës, datë 14.10.2005.
6. Informacion për problemet që kanë dale nga ankesat për Ligjin nr.7501, datë 19.07.2001 “Për Tokën”, dhe aktet e tjera nënligjore që dalin në zbatim të tij, datë 14.10.2005.
7. Informacion për zbatimin e ligjit dhe kryerjen e veprimeve ligjore për lirimin e godinave të studentëve të zëna në mënyrë të paligjshme, datë 18.10.2005
8. Informacion në lidhje me përgatitjen e akteve të reja nënligjore, në zbatim të Ligjit nr.9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e Autorit dhe të drejtat e tjera lidhur me të”, datë 18.10.2005.
9. Informacion për punimet në objektin “Sistemimi i Nyjes së Zogut të Zi, përfshi dhe nënkalinin”, datë 24.11.2005.
10. Informacion për aktivitetin e përbashkët me OSBE-në dhe zyrën e Ombudsmanit Polak, për aksesin e Avokatit të Popullit mbi vendimet gjyqësore të formës së prerë, datë 25.11.2005.

Pa u vetëkënaqur për sa më sipër, për të ardhmen ndjejmë si detyrë që të informojmë më tepër Kuvendin si për veprimtarinë tone, ashtu dhe për gjendjen e ligjshmërisë dhe të zbatimit të të drejtave të njeriut nga ana e Administratës Publike Shqiptare. Gjithashtu duhet të shfrytëzojmë akoma më tepër mundësinë për të rekomanduar në komisionet parlamentare marrjen e inisiativës legislative direkt nga deputetët, në

interes të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njerëzve në Shqipëri.

4. Marrëdhëniet e Avokatit të Popullit me Publikun dhe Median

Nje Ombudsman apo Avokat i Popullit eshte aq i zoti sa edhe shkalla e tij e njohjes. Per ta bere te mundur kete, qytetaret duhet ta dijne qe ai ekziston. Sukses i vertete eshte ateherë kur njerezit jo vetem e dine qe Avokati i Popullit ekziston, por edhe menyren se si duhet te drejtohen tek ai, dhe ku, kur dhe si ta arrijne ate. Pra, qytetaret duhet ta dijne se tek ai mund te drejtohenpa shumë burokraci.

Ne zbatim edhe te Rezolutes se Kuvendit, miratuar me 7 Mars 2005, Avokati i Popullit i ka kushtuar rendesi publikimit me mire dhe me shume te problemeve kryesore te evidentuara nga shkeljet e administrates publike ne fushen e te drejtave te njeriut, duke kerkuar edhe masa ndaj personave pergjegjes, sipas ligjit

Performanca e tërë kontakteve të përfaqësuesve të Institucionit tonë me individin, administratën dhe publikun në tërësi ka si rezultante imazhin institucional, duke reflektuar kompetencat dhe juridiksionin që atij i njeh Kushtetuta dhe Ligji “Për Avokatin e Popullit”.

Marrëdhëniet publike fillojnë që nga elementet etike në kontaktet e para me ankuesit, deri tek ato institucionale me zyrtarët e shtetit, pavarësisht nga hierarkia. Natyrisht që dimensionin e tyre më të plotë, marrëdhëniet publike e fitojnë përmes marrëdhënieve me pushtetin e katërt, pra me shtypin e shkruar dhe median në tërësi.

Po ne zbatim te pikave te Rezolutes se Kuvendit te vitit te kaluar, Avokati i Popullit ka rritur bashkepunimin me median, duke konsoliduar me tej arritjet e deritanishme, me synim rritjen e efektshmerise se nderhyrjeve te tij per ngulitjen e praktikave te mira administrative.

Avokati i Popullit e ka bërë të mundur njohjen dhe promovimin e punes e tij duke qene ne kontakt te perditshem me gazetaret dhe furnizuar ata me informacione ne menyre profesionale, larg çdo inercie sekretomanie, pa rendur pas lajmeve qe shkaktojne skandale, por edhe pa u lidhur duart atyre vetem me njoftime per shtyp.

Duke rritur shkallen e njohjes, ndryshuar dhe forcuar imazhin si dhe pozicionuar Institucionin drejt ne opinionin publik, na rezulton qe te kemi krijuar integritetin e nevojshëm per te realizuar komunikimin me mjedisin dhe integritetin tone institucional ne shoqerine shqiptare.

Marrëdhëniet me median gjithmonë i kemi parë me përparësi, sepse kemi patur dhe kemi si objektiv të rrisim besueshmërinë e publikut ndaj institucionit tonë në praktikë. Jemi të bindur se **suksesi** arrihet duke

u bazuar në dy shtylla, të cilat janë zgjidhjet me **kompetencë** profesionale dhe **transparenca** në punën tonë. Ajo që kemi synuar është mënjanimi i çdo elementi demagogjik në marrëdhëniet me median. Ne mendojmë se këtë e kemi arritur, duke zbatuar një strategji disi të veçantë të informimit për punën tonë. Modeli tashmë i konsoliduar në marrëdhëniet me median është përqendruar në tre nivele komunikimi. E para, mediave u kemi dhënë materiale, kryesisht mbi bazën e rasteve konkrete. E dyta, jemi munduar të bëjmë përgjithësime, duke shpjeguar rolin, kompetencat dhe juridiksionin tonë pas çdo rasti konkret, të trajtuar gjithmonë me mjaft transparencë nga ekspertët tanë. E treta, njoftimet për shtypin, të shpërndara për median sipas rasteve dhe aktivitetit të Zyres, pasqyrohen brenda ditës edhe në faqen tonë elektronike.

Përmes Medias ne jemi njohur edhe me ankimet e mjaft njërëzve, por dhe me prioritetet e Qeverisë shqiptare. Në këtë mënyrë, fokusin e punës tonë e kemi drejtuar për të krijuar precedentë në ato sektorë të qeverisjes, tek të cilët kërkohet krijimi dhe rritja e standarteve për shërbimet publike, presioni për uljen e kostos së këtyre shërbimeve, domosdoshmëria e zbatimit të vendimeve gjyqësore, të drejtat e fëmijëve, zbatimi i të drejtës së informimit, përmirësimi i legjislacionit për pronësinë, lufta kundër korrupsionit, kundër abuzimeve të zyrtarëve si dhe fusha të tjera që janë pasqyruar në kreun përkatës sipas rasteve. Tek media kemi patur aleatin më të sigurtë për tu bërë pjesë e opinionit publik, në rastet kur na është dashur të ndeshemi me rezistencën e atyre zyrtarëve publikë, të cilët fatkeqësisht ende e konsiderojnë rekomandimin e Avokatit të Popullit si diçka bezdisëse. Aq më shumë ne rastet kur harrojnë se ky instrument, vërtetë është jo detyrues formalisht, por sa kohë që ai është i bazuar në ligj, është e qartë se askush nuk i shpëton detyrimit për zbatimin e tij.

Duke ndarë vlerësimin se gazetarët janë “rojtarë publikë”, bashkëpunimin me ta e kemi parë si mjetin, pa të cilin edhe publiku nuk do të dinte si të na drejtohej, sikunder edhe zyrtarët nuk do të njiheshin me forcën praktike të instrumentit tonë të vetëm, që është Rekomandimi i bazuar në ligj dhe i përpiluar me fuqinë më të madhe të mundshme argumentuese.

Larmia e problematikës, që është pasqyruar në Media është pa komente në tabelat përkatëse me statistikën e mbulimit mediatic. Në një farë mënyre, duke u nisur qoftë edhe nga titujt e informacioneve, bëhet e qartë edhe veprimtaria që kemi kryer dhe sa kemi mundur ta bëjmë të njohur atë për publikun.

Informacionet nga shtypi përbëjnë bazën e një drejtimi të rëndësishëm të punës tonë, sikunder është vënia në lëvizje edhe me iniciativë, parashikuar nga neni 13-te i Ligjit “Për Avokatin e Popullit”. I

gjithë spektri i shtypit të përditshëm, atij periodik shqiptar si dhe shërbimi i plotë i ATSH-se, filtrohet posaçërisht çdo ditë në zyrën tonë.

Në strategjinë e mbulimit mediatik janë patur parasysh si ndërgjegjësimi i publikut, ashtu edhe efekti edukativ i informacionit. Kjo është bërë me pasqyrimin e vazhdueshëm në Mediat të të gjitha rasteve, kur administrata na ka mirëkuptuar, duke rivendosur të drejtën e shkelur të qytetarit.

Mjetet që kemi përdorur kanë qënë ato të parashikuara në strategjinë që kemi formuluar që në fillim të veprimtarisë sonë njohëse dhe sqaruese për grupe të ndryshme të komunitetit. Produktet e Zyres së Avokatit të Popullit si broshura “Avokati i Popullit në Shqipëri – Ombudsmani Parlamentar” (ne shqip, anglisht, dhe së shpejtë edhe në frëngjisht) posterat tematikë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përmbledhjet me tituj “Akte ligjore në ndihmë të të burgosurve shqiptarë jashtë vendit” si dhe “E drejta e informimit – e drejtë themelore e njeriut”, apo pesë fletëpalosje për grupe të ndryshme interesi, përmes të cilave shpjegojmë rolin, kompetencat dhe rrugët si mund t’i drejtohen Avokatit të Popullit kanë qënë në qarkullim përgjate gjithë vitit. Dokumentari njohës dhe promovues për Institucionin e Avokatit të Popullit tashmë është vënë në dispozicion dhe transmetuar në shumicën e televizioneve lokale dhe kombëtare. Të disponueshme kanë qënë edhe pesë spotet televizive që informojnë publikun për shërbimet që ne ofrojmë dhe rrugët e përfitimit të këtyre shërbimeve. Instalimi i teknologjisë informative na ka mundësuar që tashmë të kemi edhe faqen tonë në Internet, ku të interesuarit mund të gjejnë të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me zyrën tonë dhe aktivitetin që kryen ajo. Mbulimi mediatik ka qënë gjithmonë në përshtatje me problematikën dhe intensitetin e punës që institucioni ka kryer. Krahas formave të mesiperme, në fillim të këtij viti ne kemi filluar edhe botimin e nje gazete të Institucionit të Avokatit të Popullit, ku profili yne institucional do të shfaqet nje here ne tre muaj me tere problematiken e vet, nëqoftëse do vazhdojë mbështetja me buxhet nga Agjensia Ndërkombëtare e Frankofonisë.

Duke bërë herë pas here një analizë të secilit seksion për punën e kryer, ne kemi punuar paralelisht edhe për zbatimin e pikave bazë të strategjisë sonë në fushën e marrëdhënieve me publikun, sidomos përmes Medias. Në tërësinë e saj, kjo **Strategji** e mbulimit mediatik, si pjesa thelbësore e **Marrëdhënieve me Publikun** është formuluar që në vitin 2000 dhe është publikuar edhe në raportet e viteve të mëparshme.

a) Sektori i pritjes së popullit

1. Organizimi i punës

Avokati i Popullit i ka kushtuar në vazhdimësi një rendësi kryesore funksionimit në çdo kohë, pa pengesa, me kulture e profesionalizëm, zyrës së Pritjes së Popullit. Në këtë zyrë qytetarët që vijnë për ankesa apo kërkesa, ndjehen të mirëpritur siç duhet dhe përfitojnë aty çfarë mund t'u frojë institucioni ynë. Këtu qytetarët, në çdo orë të ditës, gjatë orarit zyrtar, mund të paraqesin ankesat apo kërkesat e tyre dhe të marrin sqarimet e nevojshme.

Këmbëngulja jonë që ky shërbim që i afrohet qytetarëve të jetë sa më cilësor, ka rritur besimin tek ta, e për rrjedhojë është rritur numri i shtetasve që përfitojnë nga ky shërbim. Fakti që numri i ankesave apo kërkesave çdo vit në këtë zyrë ka ardhur në rritje, është një tregues më shumë për avantazhet që gjejnë qytetarët në këtë zyrë. Në vitin 2005 krahasuar me vitin 2004 numri i ankesave është 28% më i madh ose 546 ankesa, kërkesa më shumë.

Sektori i pritjes së popullit çdo ditë u ka dhënë ndihmë qytetarëve të paraqitur si nëpërmjet përpilimit të ankesës ose kërkesës që ata parashtrojnë, ashtu dhe nëpërmjet orientimeve e këshillimeve ligjore profesionale, kur çështja që prezantohet si shqetësim nuk përbën objekt të veprimtarisë së Avokatit të Popullit. Nga kjo zyrë qytetarëve u bëhet e njohur në çdo kohë informacioni i kërkuar dhe njohja me legjislacionin në fuqi si dhe u jepen sqarime të mëtjshme për rrugën që ndiqet pas ankesës së bërë.

Ndryshe nga më parë, këtë vit nga Zyra e Pritjes së Popullit janë pranuar ankesa të qytetarëve dhe kur ata kanë kërkuar konsulencë juridike, duke ju kthyer përgjigje me shkrim. Kjo për një arsye të thjeshtë, pasi mosha e madhe e ankuesve si dhe shkalla e njohjes së legjislacionit nga qytetarët është e ulët, por dhe për pamundësinë e tyre ekonomike për t'ju drejtuar zyrave private juridike.

2. Statistikat përmbledhëse

Në lidhje me statistikat e vitit 2005 numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Pritjes së Popullit është 2486 ankesa/kërkesa. Në paqyrën e mëposhtme janë ankesat e paraqitura çdo muaj dhe numri i pranimet të atyre, që kanë qënë brenda juridiksionit dhe kompetencave të Avokatit të Popullit.

Muaji	Ankesa gjithësej	Pranuar për shqyrtim	
Janar	126 “-“	49 “-“	“-“
Shkurt	132 “-“	90 “-“	“-“
Mars	610 “-“	108 “-“	“-“
Prill	174 “-“	85 “-“	“-“
Maj	147 “-“	88 “-“	“-“
Qershor	200 “-“	63 “-“	“-“
Korrik	118 “-“	33 “-“	“-“
Gusht	-	-	
Shtator	193 “-“	54 “-“	“-“
Tetor	168 “-“	115 “-“	“-“
Nëntor	509 “-“	93 “-“	“-“
Dhjetor	109 “-“	55 “-“	“-“
Totali	2486 “-“	833 “-“	“-“

Pra nga numri i përgjithshëm i ankesave apo kërkesave të paraqitura pranë Zyrës së Pritjes së Popullit janë pranuar për shqyrtim 833 ankesa/kërkesa ose 35.5%. Ato kanë gjetur pasqyrim në pjesët e tjera të raportit sipas fushave dhe organeve të administrates publike.

Zyra e Pritjes së Popullit duke përmbushur detyrat e saj funksionale gjatë vitit 2004, ka pritur, trajtuar, këshilluar, orientuar dhe kthyer përgjigje të menjëhershme për 1653 ankesa, ose 66.5% të numrit të përgjithshëm të individëve apo kërkesave dhe ankesave të paraqitura. Këta qytetarë për vetë llojin dhe klasifikimin e ankesës apo kërkesës së paraqitur, janë klasifikuar në dy grupe si më poshtë:

1. Ankesa apo kërkesa që janë konstatuar jashtë juridiksionit dhe kompetencave të Avokatit të Popullit janë 467 ose 30% të numrit të përgjithshëm të pritur.
2. Individë të paraqitur për këshillime apo ndihmë të ndryshme ligjore janë 1146 ose 70% të numrit të përgjithshëm të pritur.

3. Problematikat e shfaqura

Nga problemet e prezantuara nga individë të ndryshëm pranë Zyrës së Pritjes, edhe këtë vit rezulton se shumica e ankesave, kërkesave apo njoftimeve të paraqitura drejtohen kundër vendimeve të gjykatave të të gjitha niveleve. Tregues i saj është përqindja 12.5% e ankesave jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit, të cilat janë për vendimet e gjykatave. Qytetarët ankohen se këto vendime mbartin padrejtësi, pavërtetësi, paragjykim dhe njënashmëri. Për këto ankesa apo kërkesa duhet bashkëpunuar më mirë me Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Ministrinë e Drejtësisë.

Një problem tjetër që është evidentuar gjatë pritjes së qytetarëve janë edhe konfliktet e shumta të pronësisë ndërmjet tyre, si dhe me pushtetin vendor.

Ashtu si dhe në vitet e kaluara ka mjaft ankesa të shoqëruara me protestë për procedurat e aplikimit për vizë në ambasadat e huaja në Shqipëri dhe sjellje aspak dinjitoze të autoriteteve të huaja jashtë vendit me individët shqiptarë. Ato zënë 8% të ankesave të cilat janë jashtë juridiksionit tone. Nga dëshmitë është evidentuar se përfaqësitë diplomatike veçanërisht Greke dhe Italiane, veprojnë me mungesë respekti, dinjiteti, rregulli dhe lehtësie gjatë aplikimit për vizë të qytetarëve shqiptarë. Gjatë refuzimit të vizës që përfaqësitë konsullore italiane apo greke bëjnë ndaj individëve, shpesh ato nuk japin arsyen e refuzimit. Për shumë individë është e pamundur e drejta e ankimit për këtë refuzim, pasi organi i cili shqyrton këto ankesa ndodhet në shtetin e huaj dhe në Shqipëri nuk ekziston një infrastrukture e mirëfilltë ndihme ligjore private avokatore për ndjekjen e ankesave në gjykatat e huaja. Ky fenomen haset shpesh edhe për personat të cilët shpallen të padëshirueshëm në shtetet fqinje dhe dëbimi i tyre nuk ka mundësi reale ankimi pasi afatet për ta kryer këtë janë të shkurtra. Edhe për këto ankesa duhet bashkëpunuar më mire me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Një grupim tjetër ankesash e kërkesash jashtë juridiksionit dhe kompetencave të Avokatit të Popullit, por që gjithësesi bëhen prezent dhe jepen orientime nga ana e zyrës tone janë edhe ato të cilat bëjnë fjalë për konfliktet familjare dhe personale që qytetarët kanë ndërmjet tyre si dhe marrëdhëniet midis qytetarit dhe subjekteve juridike private që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës që vendosen mes tyre.

Ankuesve iu është bërë e qartë se Avokati i Popullit është i gatshëm të ndërhyjë me kompetencat që i jep ligji vetëm kur organet apo autoritetet për të cilat ka ankesa apo kërkesa janë pjesë e Administratës Publike dhe nuk konstatohet angazhimi dhe përkushtimi i duhur institucional. Në rastet e tjera qytetarëve i është ofruar këshillim ligjor ose orientim dhe sugjerim për zgjidhjen e problemeve të prezantuara.

Nga konkluzionet e arritura si rrjedhim i një eksperience prej më shumë se 5 vjetësh të Zyrës së Pritjes së Popullit dhe të marrëdhënieve me individët në përgjithësi, mendojmë se angazhimi ynë i mëtejshëm është i domosdoshëm veçse duhet thelluar më tej metoda e punës për t'i ardhur sa më tepër në ndihmë qytetarëve që kërkojnë ndihmën e Avokatit të Popullit.

b. “Ditët e hapura” – Përvojë për t’u vazhduar

Për të qenë më afër publikut dhe për të ofruar më shumë ndihmë në zgjidhjen e problemeve konkrete të prezantuara edhe gjatë vitit 2005, Institucioni i Avokatit të Popullit ka zbatuar një formë të re komunikimi të drejtpërdrejtë me qytetarët, që ne e kemi quajtur “Ditët e hapura”.

Në kushtet e një decentralizimi gjithnjë e në rritje në favor të kompetencave të qeverisjes vendore, Avokati i Popullit mendon se më e mira është që problemet të zgjidhen atje ku lindin dhe me personat që me dashje apo nga padituria, ua krijojnë atyre këto probleme.

Ne e kemi konsideruar zbatimin e “Ditëve të hapura” një praktikë shumë efiçente që shkurton së tepërmi procedurat burokratike, rrugët e gjata drejt Tiranës, shpenzimet ekonomike, e pse jo, edhe manipulimet e mundshme me të drejtat e qytetarëve. Nëse procedurat zbatohen me korrektesë, qytetari nis të rrisë besimin tek shteti i vet, tek institucionet dhe ligji.

Në muajt Tetor-Nëntor 2005, Institucioni i Avokatit të Popullit, organizoi “Ditët e hapura”, në 38 qytete të vendit. Gjatë këtyre ditëve, u pranuan 411 ankesa nga qytetarët, 287 prej të cilave iu nënshtruan shqyrtimit të mëtejshëm nga ana e zyrës sonë, kurse 124 të tjera rezultojnë të ishin jashtë kompetencës dhe juridiksionit të Avokatit të Popullit. Kuptohet që në shifrat e sipërpërmendura, nuk është përfshirë numri i atyre qytetarëve që kanë kërkuar këshilla ligjore për probleme të ndryshme dhe që janë orientuar me mjaft profesionalizëm për rrugën që duhej të ndiqnin për realizimin e të drejtës së pretenduar prej tyre. Takimeve tona nëpër rrethe në “ditët e hapura” u kanë paraprirë bisedat në televizione lokale me ekspertë të Zyrës së Avokatit të Popullit, që publiku të njihet më pare me kompetencat dhe rolin e Avokatit të Popullit, me qëllim që ky i fundit të ishte sa më ndihmues për qytetarët. Nga takimet me qytetarët, rezultoi se në shumicën e rasteve objekti i ankesave të tyre, kishte të bënte me objektivat sociale të shtetit (punësimi, strehimi, ndihma sociale etj), me mosekzekutim të vendimeve gjyqësore, me procedurat e ndjekura nga Zyrrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, konflikte të lindura në marrëdhëniet e punës, probleme të lindura në lidhje me shtesat e pensioneve apo dhe probleme të tjera.

Përvoja e fituar në “Ditët e Hapura” por dhe në disa takime e inspektive me grupe pune, me objekt të caktuar siç janë inspektimet në burgje, takime me efektiva të reparteve ushtarake etj, për t’u njohur nga afër me shkeljet e të drejtave të cilat janë të sanksionuara me ligj, na ka nxjerrë si domosdoshmëri që kjo punë të thellohet në të ardhmen.

Avokati i Popullit do te organizojë punën në të ardhmen që këto takime të shtrihen më shumë atje ku ka jetë kolektive si në konvikte të

shkollave të larta e të mesme, në shkolla, në shtëpitë e të moshuarve e të jetimëve si shtresa në nevojë e pa mbrojtje. Në këto takime do të organizohet më mire puna për njohjen e institucionit të Avokatit të Popullit, shërbimin që ofron Avokati i Popullit për këto shtresa kjo si nëpërmjet bisedave ashtu dhe me shfaqje të dokumentarit për institucionin e Avokatit të Popullit.

Ka disa vjet rresht që Avokati i Popullit ka menduar dhe kërkon që shërbimin e tij ta ofroj në disa rrethe të largëta të vendit. Por megjithë përpjekjet tona të cilat do të sjellin shumë avantazhe për qytetarët, kjo nuk po realizohet, përsëri për mungesë buxheti. Shpresojmë që të mbahet parasysh në vitin tjetër.

5. Konferenca Kombëtare

“Të gjithë së bashku në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve”

Sipas nenit 30 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, Institucioni ynë në bashkëpunim me organizatat joqeveritare duhet të organizojë, të paktën një herë në vit, veprimtari kombëtare për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë. Në zbatim të këtij detyrimi, më datën 15 Dhjetor 2005, u zhvillua Konferenca Kombëtare “Të gjithë së bashku në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve”.

Mbledhja e Komitetit të të Drejtave të Fëmijës pranë Kombeve të Bashkuara, mbajtur në Gjenevë në Janar 2005 mori në shqyrtim Raportin fillestar të paraqitur nga Shteti Shqiptar për zbatimin e Konventës të të Drejtave të Fëmijës dhe i dërgoi Qeverisë Shqiptare vëzhgimet përfundimtare dhe rekomandimet përkatëse. Vëzhgimi dhe Rekomandimi 13 i referohen Zyrës së Avokatit të Popullit dhe Seksionit për të Drejtat e Fëmijëve: *“Komiteti e mirëpriti informacionin lidhur me krijimin e Institucionit të Avokatit të Popullit në vitin 2000 dhe së fundi krijimin e Seksionit për të Drejtat e Fëmijëve, brenda institucionit të Avokatit të Popullit. Komiteti vëren se ekzistojnë disa plane për zgjerimin dhe njohjen e Seksionit të ri. Megjithatë, Komiteti shqetësohet pasi niveli i ndërgjegjësimit të fëmijëve në shërbimet e Zyrës së Avokatit të Popullit mund të jetë i ulët.*

Komiteti rekomandon që Shteti Palë të mundësojë pajisjen e Seksionit të ri të Avokatit të Popullit me burimet e përshtatshme financiare dhe njerëzore, për të siguruar funksionimin e tij të plotë, duke përfshirë ndërgjegjësim me anë të fushatave dhe të lejojë marrjen e ankesave nga fëmijët dhe raportimin për zbatimin e të drejtave të fëmijëve”.

Duke pasur parasysh sa me sipër, në kuadrin e masave me karakter ndërjegjësues që rekomandoi Komiteti, Avokati i Popullit ia kushtoi Konferencën vjetore situatës së të drejtave të fëmijëve në Shqipëri dhe rolit të Nenseksionit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në kuadrin e masave me karakter institucional në mbrojtje të këtyre të drejtave. Për përgatitjen e Konferencës u punua gjatë gjithë vitit 2005, duke shqyrtuar të gjitha ankesat që lidhen me të drejtat e fëmijëve gjatë viteve 2000-2005, problemet që kanë dalë si në drejtim të legjislacionit që mbron të drejtat e fëmijëve, ashtu dhe të zbatimit konkret të tij nga ana e organeve të administratës publike shqiptare.

Ky aktivitet u organizua me inisiativë të Institucionit të Avokatit të Popullit, në bashkëpunim me Organizatat UNICEF dhe Save the Children, Shqipëri. Konferenca trajtoi kryesisht politikat qeveritare në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, problemet e punës së ndaluar të fëmijëve, të trafikimit të fëmijëve, të arsimit fillor të detyrueshëm, roli i OJF-ve si dhe përvoja e Ombudmanëve të tjerë në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve. Shqipëria ka marrë përsipër shumë angazhime për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. Serioziteti i këtyre angazhimeve duket në ratifikimin që në vitin 1992 të Konventës së OKB “Mbi të drejtat e fëmijës”, e cila përbën traktatin e parë universal që rregullon të drejtat e njohura botërisht për fëmijët dhe i detyron shtetet për respektimin e tyre. Për të gjithë është më se e qartë se ratifikimi i Konventave ndërkombëtare nuk është një qëllim në vetvete, por është shprehje zyrtare e angazhimit të shtetit dhe shoqërisë për të garantuar zbatimin e të drejtave të parashikuara në to.

1. Konferenca konstatoi se fëmijët i ndjejnë më shumë, si për mirë, ashtu dhe për keq, pasojat e veprimeve ose mosveprimeve të qeverisjes. Pothuajse çdo ligj apo çdo vendim i qeverisë, në çdo fushë, ndikon tek fëmijët në mënyrë direkte apo indirekte. Me siguri mund të themi se gjendja e fëmijëve, e edukimit dhe shëndetit të tyre është një barometër matës i saktë i ndryshimeve social ekonomike në çdo shtet.

Si elemente mjaft pozitive u konsideruan edhe miratimi i Strategjive Kombëtare si:

-Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe për Mbrojtjen e Fëmijëve, Viktima të Trafikimit, miratuar me VKM nr.171 datë 11.02.2005.

-Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara, miratuar me VKM nr.8 datë 7.01.2005.

-Strategjia Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së Minoritetit Rom, miratuar me VKM nr.633 datë 18.09.2003.

-Strategjia Kombëtare për Fëmijët 2005-2010, miratuar me VKM nr.368 datë 31.5.2005 si dhe Plani i Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët 2005-201, miratuar me VKM nr.487 datë 8.06.2005.

2. Në përputhje me Planin Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Shqiptar me atë të Bashkimit Evropian, brenda një periudhe kohore 2005-2008, do të behen ndryshime në legjislacionin e brendshëm për miratimin e paketës Ligjore “Mbi Drejtësinë për të miturit”. Realizimi i këtij procesi, konsiderohet një hap i rëndësishëm drejt anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Këtij procesi i shërbejnë dhe dy projektet lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe përkatësisht nga Ministria e Drejtësisë dhe Avokati i Popullit në bashkëpunim me UNICEF-in , Save the Children, etj.

3. Qeveria ka bërë përpjekje të vazhdueshme për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore në përgjithësi dhe të fëmijëve në veçanti. Por është varfëria e familjeve të fëmijëve që trafikohen, diskriminimi që vuajnë shumica prej këtyre familjeve në jetën sociale, por edhe në arsim dhe në tregun e punës, si dhe mungesa e një sistemi të plotë funksional për mbrojtjen e fëmijëve që e bëjnë të lehtë abuzimin me këta fëmijë. Fëmijët, kontigjent për trafikim janë kryesisht nga familje me probleme ekonomike e sociale. Mënyra më efikase për të parandaluar trafikimin e fëmijëve si brenda vendit, ashtu dhe jashtë tij është dhënia e mundësive reale për jetesë dhe zhvillim këtyre familjeve.

4. Legjislacioni i punës ndalon shfrytëzimin e punës së fëmijëve, por ende përdoren mënyra të ndryshme për shfrytëzimin e punës dhe diskriminimin në trajtimin e tyre. Impakti i programeve, politikat dhe kontrolli për mënjanimin e punësimit të fëmijëve janë ende të pamjaftueshme. Puna e fëmijëve mbetet veprimtari e fshehtë nga subjektet private. Bashkëpunimi me shkollën, familjen e komunitetin për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve është i pamjaftueshëm.

5. Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe mirëqënies së nënave dhe fëmijëve nuk çon vetëm në një shoqëri më të shëndetshme, por edhe në pakësimin e pabarazive dhe varfërisë. Sëmundjet e shpeshta dhe kequshqyerja ndikojnë negativisht në zhvillimin psikologjik, përmasat trupore dhe forcën e fëmijëve. Ekzistojnë mjaft probleme në informimin, edukimin dhe komunikimin shëndetësor, sidomos për fëmijët me zhvillim të vonuar mendor.

6. Reformimi i sistemit shkollor parauniversitar synon riorganizimin dhe modernizimin e sistemit të shkollimit në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit, krijimin e hapësirave demokratike të respektimit të të drejtave të fëmijëve dhe hapjen e rrugës për integrimin e arsimit tonë në Europë. Në këtë fokus, futja e mësimin të të drejtave të fëmijës në

programet shkollore synon të sigurojë njohjen dhe përvetësimin e të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të fëmijëve, duke i përfshirë këto në të gjitha veprimtaritë e shkollës.

7. Sistemi aktual i drejtësisë penale për të mitur është më shumë i orientuar drejt ndëshkimit të personit të mitur sesa rehabilitimit të tij. Në praktikën e gjykatave shqiptare, zbatimi i masave shtrënguese dhe të dënimit me burgim nuk shihen gjithnjë si mjeti i fundit. Për shkak të mungesës së akteve nënligjore dhe strukturave përkatëse, prokurorët dhe gjyqtarët vihen shpesh në pozitë të vëshirë lidhur me trajtimin e të miturit. Para tyre shtrohen vetëm dy alternativa: ose të lënë të miturin të lirë dhe pa kontroll ose të marrin masën e arrestit ndaj tij. Ndihma ligjore jo vetëm ofrohet nga avokatë të rinj dhe me përvojë të pakët profesionale, por në të shumtën e rasteve ata nuk janë të specializuar në çështjet e drejtësisë për të mitur.

Përsa i përket ndihmës psikologjike, me përjashtim të gjykatës së krimeve të rënda dhe gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, ku ky shërbim ofrohet, në gjykatat e tjera, gjyqtarët hasin në vështirësi për të garantuar këtë shërbim ndaj të miturve. Deri më sot është shkelur rëndë kërkesa e ligjit për gjykimin e të miturve nga gjyqtarë të seksioneve të të miturve, pasi *seksionet e të miturve* nuk janë ngritur ende.

8. Ajo që vazhdon të mbetet shqetësuese në lidhje me respektimin e të drejtave të minorenëve fokusohet kryesisht me kushtet e qëndrimit të tyre në dhomat e paraburgimit në mjaft raste së bashku me të rriturit, në kundërshtim të plotë me legjislacionin Shqiptar dhe me standartet ndërkombëtare. Ka nevoja për forcimin e kapaciteteve administrative dhe njerëzore të strukturave të përfshira në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të të miturve.

9. Monitorimi i respektimit të të drejtave të miturve në kontakt me sistemin e drejtësisë penale është një element mjaft i rëndësishëm. Krahas rolit të prokurorisë dhe të gjykatës, rëndësi kanë organet monitoruese të jashtme, ndër të cilat Institucioni i Avokatit të Popullit dhe organizatat jofitimprurëse monitoruese të të drejtave të njeriut. Të drejtat e fëmijëve janë parë me prioritet nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Institucioni i Avokatit të Popullit që në fillimet e punës së tij, ka qënë tepër i ndjeshëm lidhur me respektimin e të drejtave të fëmijëve. Ankesat e trajtuara kanë qënë të ndryshme dhe të larmishme. Ndërhyrja e Avokatit të Popullit ka qënë në dy drejtime:

Së pari, në drejtim të konstatimit të shkeljeve dhe të problemeve lidhur me legjislacionin konkret;

Së dyti, të ndërhyrjes në organet shtetërore që kanë kompetencë zgjidhjen e ankesave dhe marrjen e masave parandaluese për mospërsëritjen e shkeljeve në të ardhmen.

10. Organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja kanë bërë një punë të mirë në drejtim të ndihmës për fëmijët, duke realizuar vetë ose në bashkëpunim me institucionet shtetërore shqiptare projekte të veçanta. Por duhet punuar më tepër për të organizuar koordinimin për bashkërendimin e projekteve që ndërmerren, me qëllim që të jenë më efektive dhe të mos ketë përplasje midis tyre.

Mbi bazën e përfundimeve dhe konstatimeve të mësipërme Konferenca doli me rekomandime, disa nga të cilat janë përfshirë edhe në Strategjitë përkatëse të miratuara:

1. Për fëmijët jetimë që mbahen në institucione, duhet bërë:

-Modelimi i shërbimeve alternative të shtëpive familje, të cilat po eksperimentohen.

-Nxitja e birësimeve të hershme të fëmijëve që janë braktisur dhe veçanërisht fëmijëve me probleme shëndetësore.

-Investime në infrastrukturën e institucioneve rezidenciale, rritja e kapaciteteve të stafëve për të rritur cilësinë e shërbimeve.

-Implementimi i standardeve të përgjithshme dhe të fëmijëve për shërbimin në institucione rezidenciale.

2.Për fëmijët jetimë pa prindër ose me një prind që nuk jetojnë në institucione, duhet bërë:

-Ngritja e strukturave të nevojshme dhe krijimi i një sistemi të identifikimit të nevojave të fëmijëve jetimë, atyre me një prind dhe me probleme sociale në nivel vendor.

-Zbatim programesh për mbështetjen e familjeve me shumë fëmijë, me aftësi të kufizuar ose probleme sociale për punësim, trajnim profesional apo ndihmë ekonomike.

-Të zbatohen masat shtrënguese ndaj prindërve që braktisin fëmijët, i detyrojnë të punojnë, apo nuk i dërgojnë ata në shkollë, etj.

3. Per fëmijët e braktisur të rrugës, duhet bërë:

-Rritja e llojshmërisë së shërbimeve, si: shtëpitë familje pranë institucioneve rezidenciale publike dhe jopublike, qendrat ditore, komunitare etj. -Zgjerimi i shërbimit të kujdestarisë.

-Sigurimi i birësimit të hershëm.

-Mbështetje për familjen, që fëmijët të ndjekin shkollën.

-Marrje masash mbrojtjeje nga strukturat ligjore në rastet e neglizhencës, abuzimit apo dhunës.

-Masa shtrënguese ndaj prindërve që braktisin fëmijët, apo nuk i dërgojnë ata në shkollë, i detyrojnë të punojnë etj.

4. Për fëmijët e trafikuar, është e rëndësishme:

-Implementimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të fëmijëve. Hartim e zbatim politikash që adresohen drejt

parandalimit, mbrojtjes, kthimit vullnetar të asistuar, riatdhesimit dhe riintegrimin të fëmijëve të trafikuar.

-Bashkëpunim dhe koordinim ndërmjet institucioneve dhe partnerëve që punojnë në fushën e trafikimit të fëmijëve.

-Rikthimi në shkollë i fëmijëve të trafikuar dhe në rrezik trafikimi, që nuk kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm dhe ofrimin e alternativave për formim profesional për të rinjtë në moshë pune.

-Një dëshirë e vullnet më i madh i forcave të rendit për të zbuluar e vënë para ligjit shfrytëzuesit e këtyre fëmijëve, do të mbronte qindra fëmijë të detyruar me forcë për të mos patur fëmijëri.

-Përgatitja e politikave të detajuara për kthimin, mbrojtjen, trajtimin dhe riintegrimin psikosocial të viktimave të trafikut, të shoqëruara këto politika me akte të zbatimit të tyre nga institucionet publike dhe OJF.

-Krijimi i një fondi të veçantë për mbrojtjen e fëmijëve viktimë të trafikimit si dhe për OJF-të që punojnë në këtë fushë për të siguruar rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri.

-Të forcohet lufta kundër korrupsionit dhe përfshirjes së strukturave policore në trafikimin e fëmijëve.

-Të realizohet rritja e kapaciteteve profesionale të strukturave policore që punojnë në sektorët e antitrafikut, sidomos për fëmijët.

-Të sigurohet bashkëpunim transnacional midis qeverisë sonë dhe atyre të vendeve fqinje për luftën kundër trafikimit të fëmijëve, si dhe mbrojtjen e fëmijëve viktimë të trafikimit, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe.

5. Për fëmijët Romë, duhet bërë:

-Përmirësimi i kushteve ekonomike, të shëndetit, të arsimimit, kulturës etj, për mirërritjen dhe zhvillimin e fëmijës.

-Regjistrimi dhe sensibilizimi i komunitetit, për të përfituar nga legjislativi në fuqi. Regjistrimi i fëmijëve si masë për mbrojtjen e tyre nga abuzimi dhe krijimi i mundësive për zhvillim.

6. Për fëmijët që punojnë duhet bërë:

-Evidentimi, vlerësimi dhe adresimi i drejtë i këtij problemi, kundër praktikave të rrezikshme dhe shfrytëzuese të punës dhe trafikimit të fëmijëve për tërheqjen nga puna dhe trafikimi, dhe referimin e rasteve.

- Forcimin i kapaciteteve në nivel qendror dhe lokal, i cili do të arrihet nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë me të gjitha institucionet dhe strukturat që lidhen me punën e fëmijëve si Bashkia, Zyra e Punës, Arsimi, Policia, Shëndetësia si dhe partnerët socialë.

-Forcimi i kapaciteteve të Inspektoriatit të Punës dhe partnerëve të tjerë mbi Sistemin e Monitorimit të Punës së Fëmijëve.

-Finalizimi i “Raportit Kombëtar dhe Planit Strategjik mbi politikat

kombëtare lidhur me çështjen e punës së fëmijëve në Shqipëri”, që do të lehtësojë procesin e implementimit të këtyre politikave nëpërmjet përfshirjes së një rangu të gjerë aktorësh dhe institucioneve aktive në adresimin e këtyre problemeve, si në nivel qendror edhe atë lokal.

7. Për fëmijët me aftësi të kufizuara, duhet bërë:

-Përpunimi i një plani kombëtar për fëmijërinë e hershme, për punë të integruar për këtë grupmoshë me ministrinë e linjës.

-Krijimi i një strukture të veçantë për fëmijët, brenda së cilës të ketë një njësi për fëmijërinë e hershme.

-Rritja e financimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara brenda buxheteve të ministrive të linjës.

-Përmirësime të mëtejshme të shërbimeve ditore dhe komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilat aktualisht janë ende të pamjaftueshme;

-Hartim programesh për trajnimin e tyre profesional, integrimin në jetën komunitare;

-Eliminimi i të gjitha pengesave në mjedis për lëvizje dhe komunikimin e kësaj kategorie fëmijësh;

-Mundësimi i përjashtimit nga të gjitha taksat për OJF që punojnë për fëmijët me aftësi të kufizuara, do të nxiste financimin e mjaft projekteve edhe nga donatorë të huaj në Shqipëri.

8. Reformimi i Sistemit të Shërbimeve Shoqërore, si një proces mjaft i rëndësishëm, nëpërmjet:

-Decentralizimit, pra transferimit të qendrave të shërbimeve rezidenciale në varësi të njësisve të qeverisjes vendore, brenda 3 viteve të ardhshme.

-Ngritjes së shërbimeve të reja shoqërore në komunitet. Prioritet duhet të kenë fëmijët jetimë, të braktisur dhe të rruges, të trafikuar, që punojnë, me aftësi të kufizuara, fëmijët romë, që braktisin shkollën, të dhunuar, të pashoqëruar në emigracion, të abuzuar etj.

-Deinstitutionalizimi, nëpërmjet transformimit të shërbimeve rezidenciale në shërbime të lëvizshme me bazë komunitare. Ky proces do synojë:

-Parandalimin e pranimeve dhe qëndrimeve të panevojshme në institucione rezidenciale.

-Sigurimin e alternativave të tjera për strehimin, trajtimin, edukimin dhe rehabilitimin e individëve që nuk e kanë të nevojshme qëndrimin në institucione rezidenciale.

-Përmirësimin e kushteve, përkujdesjes dhe trajtimit për individët që kanë nevojë për përkujdesje në qendra rezidenciale.

-Mundësimi i shërbimeve alternative: shërbime ditore, sigurimi i familjeve kujdestare dhe birësuese.

-Të reduktohet kërkesa për të vendosur fëmijët në qendrat rezidenciale, nëpërmjet edukimit për planifikimin familjar, parandalimin e braktisjes së fëmijës, prezantimin e shërbimeve etj.

-Zbatimi i standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale.

-Duhet të zbatohen politika sociale bashkëkohore në mbrojtje të interesave të fëmijëve jashtë kujdesit prindëror nëpërmjet zhvillimit të formave alternative të përkujdesit të cilat u ofrojnë fëmijëve përkujdesje afatgjatë në një familje apo ambient të ngjashëm me të.

-Rritja e pjesëmarrjes së pushtetit vendor në hartimin dhe zbatimin e politikave sociale të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

-Krijimi i sistemit për mbrojtjen e fëmijëve të shtrirë në të gjithë instancat e pushtetit vendor.

Si konkluzion garantimi i cilësisë së Shërbimeve Shoqërore duhet të arrihet nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të standardeve, licensimit të operatorëve publikë e privatë që ofrojnë shërbime dhe inspektimit për zbatimin e standardeve.

9. Për shëndetin e fëmijëve në përgjithësi, duhet bërë:

-Përmirësimi i shërbimeve të shëndetit të nënës dhe fëmijës në këto drejtime:

i.Përmirësimi dhe integrimi i strukturave të shërbimit shëndetësor të gruas dhe fëmijës në të gjitha nivelet e kujdesit.ii.Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të nënës dhe fëmijës në të gjitha nivelet e kujdesit, nëpërmjet unifikimit të protokolleve standart për ndjekjen e shëndetit të gruas dhe fëmijës.

iii.Ngritjes së nivelit teknik të personelit shëndetësor, nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm të gjithë stafit shëndetësor që punon në këto shërbime.-Përmirësimi i legjislacionit në mbrojtje të shëndetit të fëmijëve. Vijimësia e procesit të përpunimit të Kartës së të drejtave të fëmijëve në spital me qëllim që tu garantohen fëmijëve të shtruar në spital të drejtat e tyre për të jetuar, për të zhvilluar, për të qënë të mbrojtur dhe për të qënë pjesë e procesit pa dallim dhe nënvlerësim.

-Zbatimi me rigorozitet i sistemit të vaksinimit dhe rivaksinimit.

-Promovimi dhe edukimi i një mënyre ushqyerje dhe jetese të shëndetshme në familje dhe komunitet.10.Për arsimimin e fëmijëve, drejtimit kryesorë ku do të përqëndrohet veprimi i të gjitha institucioneve arsimore, në të ardhmen, për të siguruar një nivel të lartë të edukimit, përvetësimit dhe zbatimit të të drejtave të fëmijëve janë:

-Sistem arsimor cilësor, duke i kushtuar kujdes të veçantë edhe arsimit jopublik, me qëllim që kontrolli i shtetit me anë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës mbi programet, cilësinë e mësimdhënies dhe kushtet e jetesës dhe të shkollës të jetë më efektiv dhe më i shpeshtë.

-Të futet sa më shpejt njohja e të drejtave të fëmijës në kurrikulin shkollor.

-Sigurimi i informacionit të detajuar për arsimin, duke nxitur komunitetin që të jetë më i interesuar.

-Përfshirja e fëmijëve në vendimarrje në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit, krijimin e hapësirave demokratike të respektimit të të drejtave të fëmijëve dhe hapjen e rrugës për integrimin e arsimit tonë në Europë.

-Plotësimi i Dispozitave Normative të Shkollës që do të sanksionojnë realizimin e të drejtës së fëmijëve për tu bërë pjesë e vendimarrjes për problemet që lidhen me procesin mësimor, veprimtaritë brenda dhe jashtë shkollës si dhe përcaktimi i instrumenteve dhe modaliteteve që do të bëjnë efektive këtë pjesëmarrje.

- Sigurimi i informacionit të detajuar për arsimin. Mbi këtë bazë të dhënash do të orientohen ndërhyrjet politike në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve për tu siguruar një shërbim arsimor cilësor, pavarësisht përkatësisë etnike, fetare, gjendjes shoqërore, shëndetësore etj.11.Për Drejtësinë për të miturit, duhet bërë:

-Miratimi i paketës ligjore “*Mbi Drejtësinë e të Miturve*”, si dhe ngritja e strukturave përkatëse për zbatimin e tij.

-Realizimi i ndarjes së të miturve të dënuar dhe atyre të paraburgosur krejtësisht në ambiente të veçanta. Pjesë e reformës duhet të jetë edhe sistemi i paraburgimit dhe vuajtjes së dënimit për të miturit. Në institucionet ekzistuese duhet të merren masa për përmirësimin e infrastrukturës së tyre me qëllim që këto vende të ofrojnë kushte për edukimin dhe riintegrimin e të miturve. -Përfshirja e punonjësit social në çdo institucion të vuajtjes së dënimit. -Krijimi dhe vënia në funksionim i një Instituti Riedukimi për të Miturit. -Ngritja e seksioneve për gjykimin e të miturve në gjykata të rretheve gjyqësore. -Specializimi i gjyqtarëve që do të gjykojnë çështjet e të miturve në seksionet e posaçme. -Përmirësimi i ligjit “Mbi organizimin dhe veprimtarinë e Komitetit Shqiptar të Birësimin” dhe ligjit “Për statusin e jetimit”. -Në këtë proces reformimi të sistemit të drejtësisë penale, mbrojtja e të miturve duhet të shihet në të dy këndvështrimet: mbrojtja e të miturve si autorë dhe si viktima të krimit.

12. Konferenca insistoi se të gjitha organet shtetërore dhe organizatat jofitimprurëse duhet të merren më shumë me problemin e fëmijëve të ngujuar nga gjakmarrja, të cilëve ju janë mohuar të drejtat që iu takojnë, përfshirë këtu edhe të drejtën për arsimim.

Së fundmi, u rekomandua dhe:

13-Krijimi i sistemit bashkëkohor të grumbullimit të të dhënave, duke u mbështetur mbi treguesit e matjes së mirëqënies shoqërore të

fëmijëve, në veçanti të atyre që iu përkasin grupeve shoqërisht të përjashtuara.

14-Nga ana e pushtetarëve lokalë duhet të mbështeten OJF-të dhe organizatat me bazë në komunitet dhe kur është e nevojshme duhen krijuar mekanizma për të lehtësuar pjesëmarrjen e shoqërisë civile në çështje që lidhen me fëmijët.

15-Ndërmarrja e fushatave të vazhdueshme të sensibilizimit në bashkëpunim me të gjithë aktorët e interesuar në këtë fushë për të siguruar rritjen e ndjeshmërisë së publikut kundër çdo lloj dhune, por në mënyrë të veçantë dhunës ndaj fëmijëve;

- Në përfundim Konferenca konkludoi se, *ngritja e sistemit të avancuar dhe bashkëkohor për mbrojtjen e fëmijëve do të jetë një premisë për të përmirësuar gjendjen e tyre, duke treguar se shteti shqiptar duke luftuar në mënyrë institucionale dhe konkrete çdo formë dhune, keqtrajtimi dhe abuzimi ndaj tyre, merr përsipër përgjegjësinë për jetën dhe cilësinë e jetës së fëmijëve.*

* * *

Zhvillimi i kësaj Konference, pjesëmarrja e Kryetares së Kuvendit dhe e drejtuesve të disa ministrive kryesore, e përfaqësuesve të organizatave jofitimprurëse që punojnë për të drejtat e fëmijëve, si dhe fjalimet, problemet dhe sugjerimet e tyre për çështjet e trajtuara në Konferencë, janë një tregues që premtojnë për ndryshime pozitive në drejtim të respektimit të të drejtave të fëmijëve në të ardhmen.

Sipas mendimit të përgjithshëm, Konferenca ia arriti qëllimit të caktuar për sensibilizimin dhe angazhimin më të madh të të gjitha organeve dhe autoriteteve të administratës publike shqiptare për zbatimin e Kushtetutës, akteve të njohura ndërkombëtare, ligjeve përkatëse si dhe rekomandimeve të kësaj Konference. Rekomandimet ju dërguan Kuvendit, Kryeministrit dhe gjithë ministrive që përfshihen në fushën e të drejtave të fëmijëve. Materialet e Konferencës do të botohen dhe shpërndahen gjithë të interesuarve.

Të shpresojmë se rekomandimet e kësaj Konference do të vlerësohen me seriozitet dhe do fillojnë të implementohen nga gjithë organet kompetente.

6. Aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2005

Krahas ndjekjes së problematikës së përditshme, për të shqyrtuar ankesat e qytetarëve, Avokati i Popullit ose përfaqësues të tij, kanë marrë pjesë duke dhënë kontributin e tyre në aktivitete të ndryshme, organizuar nga organizma qeveritare dhe të shoqërisë civile. Ashtu siç kemi theksuar dhe në Raportin Vjetor 2004 një gjë e tillë ka qenë dhe mbetet një angazhim sa institucional, aq edhe qytetar i Institucionit të Avokatit të Popullit, për tu investuar dhe thënë fjalën e tij për një problematikë edhe më të gjerë se ajo që paraqitet në statistikat e punës së tij normale.

Më poshtë po ju njohim thjesht me tematikën e këtyre aktiviteteve, duke menduar të paraqesim edhe grupet e interesit, të synuara prej tyre.

1. Konferencë Kombëtare me temë: “Për Migracionin” organizuar nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe IOM-i, Shkurt 2005.
2. Seminar me temë: “Të drejtat e personave me aftësi të kufizuar” organizuar nga Fondacioni ASSED, me qendër në Zvicër, Shkurt 2005.
3. Seminar me temë: “Kodi i Procedurave Administrative” organizuar nga USAID dhe Instituti për Studime Publike dhe Ligjore, Shkurt 2005.
4. Tryezë e rumbullakët me temë: “Probleme të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore” organizuar nga Ministria e Drejtësisë, Shkurt 2005.
5. Pjesëmarrje në diskutimet për reformën në burgje, organizuar nga OSBE-ja, Shkurt dhe Maj 2005.
6. Seminar me temë: “Demokraci dhe ndërmjetësim” organizuar nga Ministria e Drejtësisë, Mars 2005.
7. Seminar me temë: “Të drejtat e konsumatorëve”, organizuar nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorëve pranë Ministrisë së Ekonomisë, Mars 2005.
8. Seminar me temë; “Për sindikalizmin në Policinë e Shtetit”, organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim”, Mars 2005.
9. Seminar me temë: “Mbrojtja e të dhënave personale” organizuar nga Ministria e Integritit dhe Këshilli i Evropës, Prill 2005.
10. Konferencë Kombëtare me temë: “Zgjidhja e konflikteve me pajtim dhe jashtëgjyqësisht”, organizuar nga Fondacioni “Për zgjidhjen e konflikteve me pajtim”, Prill 2005.
11. Seminar me temë: “Promovimi i të drejtave të të miturve për një demokraci gjithëpërfshirëse dhe një qytetari aktive në Shqipëri”,

- organizuar nga Qendra Sociale Murialdo, Fier dhe Drejtoria Arsimore Fier, Maj 2005.
- 12.Seminar me temë “Për Bashkimin Evropian”, organizuar nga ITAP, Qershor 2005.
 - 13.Seminar me temë: “ Diskutim mbi Raportin Vjetor 2004 te Avokatit të Popullit për problemet e pushtetit vendor” organizuar nga Shoqata e Juristëve të Komunave dhe Bashkive, Qershor dhe Dhjetor 2005.
 - 14.Seminar me temë: “Përmbledhje e legjislacionit shqiptar për shëndetin mendor”, organizuar nga Ministria e Shëndetësisë, Shtator 2005.
 - 15.Seminar me temë: “ E drejta e informimit dhe organet e qeverisjes vendore”, organizuar nga Këshilli i Evropës, Shtator 2005.
 - 16.Konferencë me temë: “ Besimi publik - Sfidë për policinë”, organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Shtator 2005.
 - 17.Seminar me temë: “Për vlerësimin e zbatimit të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare nga Shqipëria”, organizuar nga Komiteti Këshillimor i KE-së dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Shtator 2005.
 - 18.Tryezë e rrumbullakët me temë: “Për prezantimin e monitorimit të zbatimit të të drejtës për informim”, organizuar nga Qendra për Studime Parlamentare, Tetor 2005.
 - 19.Konferenca Vjetore “Iniciativa Shqiptare:Koordinimi i veprimeve në luftë kundër trafikimit njerzor”, organizuar nga USAID dhe CAAHT, Tetor 2005.
 - 20.Seminar me temë: “Rastet e shkeljeve ligjore të gjykatave shqiptare” organizuar nga Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut, Nëntor 2005.
 - 21.Seminar me temë: “Në pervjetorin e Ditës të Ndërgjegjësimit të Pronës” organizuar nga Shoqata Kombëtare “Pronësi me Drejtësi”, Dhjetor 2005.
 - 22.Seminar me temë: “Reforma për drejtësinë për të miturit në Shqipëri”, organizuar nga Ministria e Drejtësisë, Komisioni Evropian, SIDA dhe UNICEF, Dhjetor 2005.

Në të gjitha këto aktivitete dhe të tjera të një rëndësie më të vogël, Institucioni i Avokatit të Popullit ka promovuar rolin, kompetencat dhe juridiksionin e tij në ndërveprimin me institucionet e tjera shtetërore dhe ato të shoqërisë civile. Problematika e diskutuar në to na ka ndihmuar në sqarimin e pozicioneve të ndryshme, në të cilat ndodhemi, në raport me instancat të cilave u drejtohem, nisur nga ankesat konkrete që vijnë pranë

zyrës tonë. Kjo pjesëmarrje aktive do të vazhdojë të jetë përparësi e punës tonë edhe në të ardhmen, pasi bashkëpunimin me organet e administratës publike si dhe me organizmat e shoqërisë civile e shohim si domosdoshmëri për perfeksionimin e mëtejshëm të punës tonë.

KREU I TRETE

Veprimtaria konkrete e Avokatit të Popullit për ankesat, kërkesat dhe njoftimet (rastet), të grupuara sipas institucioneve qeveritare

1. Këshilli i Ministrave (Qeveria)

Në zbatim të detyrës së tij kryesore, mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri, Avokati i Popullit ka informuar, rekomanduar apo i ka bërë propozime Kryeministrit dhe ministrave për të gjitha çështjet kryesore që kanë dalë gjatë punës së tij. Pavarësisht nga forma në të cilën janë paraqitur opinionet e Avokatit të Popullit, mendojmë se, në një tërësi ose pjesë të mënyrës, ato kanë ndikuar në rritjen e standarteve të mirëqeverisjes.

Nga janari deri në gusht 2005, Qeverisë, të kryesuar nga ish kryeministri, zoti Fatos Nano, i kemi dërguar zyrtarisht këto rekomandime, propozime apo informacione:

1. Informacion për rekomandimin drejtuar ish Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, z. Fino, për përsheptimin dhe përfundimin sa më të shpejtë të punës së grupit të ngritur pranë kësaj ministrie për ndërhyrjet e paligjshme të bëra në pallatet "Shallvare" dhe "Agimi" për mundësimin e fillimit të ndërhyrjeve rehabilituese në këto pallate, datë 22.02.2005.
2. Rekomandim për zgjidhjen e rasteve të mos marrjes së tokës bujqësore në pronësi nga familjet bujqësore, datë 09.03.2005. Këshilli i Ministrave miratoi VKM nr.291, datë 6.5.2005 "Për disa ndryshime në VKM nr.230 datë 22.07.1991 "Për krijimin e Komisioneve të Tokave" ku i është dhënë një zgjidhje e pjesshme rekomandimit, duke shtuar paragrafe që detyrojnë komisionet e tokave në fshatra dhe komuna të trajtojnë familjet që ende nuk kanë gjetur zgjidhje ligjore.
3. Informacion për detyrat që dalin nën frymën e Vëzhgimeve dhe Rekomandimeve të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, datë 16.03.2005.
4. Propozim për ndryshime në Ligjin nr.9209 datë 23.03.2004 "Për legalizimin e shtesave në ndërtim", datë 16.03.2005.

5. Rekomandim për përshpejtimin e procedurave lidhur me funksionimin e Komisionit shtetëror Tre palësh si dhe nxjerrjen e akteve nënligjore për ish të përndjekurit politikë, datë 24.03.2005.
6. Rekomandim lidhur me shfuqizimin e një pjesë të Urdhërit Nr.110, datë 20.04.2004, "Mbi miratimin e strukturës së policisë Elektrike", të Ministrit të Industrisë dhe Energjitikës, datë 31.03.2005.
7. . Informacion për projektligjin për emigrantët që po përgatitet në Greqi, datë 10.06.2005.

Kurse nga shtatori deri në fund të vitit 2005 Qeverisë, të kryesuar nga kryeministri, zoti Sali Berisha, i kemi dërguar zyrtarisht këto rekomandime, propozime apo informacione; përveç atyre që ju janë dërguar veçanërisht ministrave të ndryshëm.

1. Rekomandim për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr.9209 datë 23.03.2004 "Për legalizimin e shtesave në ndërtime", datë 16.09.2005. Pranuar dhe përgatitur projektligji.
2. Informacion për marrjen e masave të nevojshme për trajtimin me ushqim të personave të ndaluar dhe të arrestuar të cilët mbahen në Komisaritet e Policisë, datë 16.09.2005.
3. Informacion në lidhje me aktivitetin e Avokatit të Popullit në kuadër të uljes së tarifave të telefonisë, datë 16.09.2005.
4. Informacion për ankesat e ardhura në Institucionin e Avokatit të Popullit për Policisë gjatë viteve 2000-2004 dhe çfarë rekomandimesh të rëndësishme duhen zbatuar sidomos për personat që shoqërohen dhe pyeten nga Policia, datë 7.10.2005.
5. Informacion për problemet që kanë dalë nga ankesat për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, datë 10.10.2005.
6. Informacion për problemet e shfaqura në punën e organit të Policisë së Ndërtimit, datë 10.10.2005.
7. Informacion për problematikën që kanë dalë nga ankesat për Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sha), datë 11.10.2005.
8. Rekomandime për rritjen e transparencës dhe zbatimin e ligjit për të drejtën për informim për dokumentet zyrtare, duke përgatitur një rregullore tip, datë 12.10.2005. Treguar gatishmëri bashkëpunimi.
9. Rekomandim për çbllokimin e situatës së krijuar nga mosfutja në përdorim e letrave me vlerë dhe bonove të privatizimit, datë 12.10.2005. Pranuar dhe përgatitur projektligji.

10. Informacion për shfuqizimin sa më shpejt dhe moszbatimin më tej të Udhëzimit të Ministrit të Rendit Publik Nr.168, datë 20.10.1993, “Për rregullat e shoqërimit të shtetasve në Komisariate, Reparte, Posta të Policisë dhe zyra të tjera të tyre”, si dhe përgatitjen, miratimin dhe vënien në zbatim të Rregullores së re të shoqërimit të shtetasve në zyrat e Policisë etj., date 13.10.2005. Pranuar.
11. Informacion mbi problemet që kanë dale nga ankesat lidhur me marrëdhëniet e punës, datë 14.10.2005.
12. Informacion për zbatimin e ligjit dhe kryerjen e veprimeve ligjore për lirimin e godinave të studentëve të zëna në mënyrë të paligjshme, datë 18.10.2005.
13. Rekomandim për përshpejtimin e procedurave lidhur me funksionimin e Komisionit shtetëror Tre palësh si dhe nxjerrje e akteve nënligjore për ish të përndjekurit politikë, datë 02.11.2005.
14. Propozim për përmirësimin e VKM Nr.552, datë 27.11.1999, për akordimin e pensioneve policëve të vrarë para vitit 1998, datë 02.11.2005.
15. Informacion për praktikën e ndjekur për prishjen e objektit të ngritur në afërsi të fakultetit të Mjekësisë, nga firma “TID” shpk, datë 08.11.2005.
16. Propozim për një ndryshim në ligjin nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, datë 08.11.2005. Pranuar në parim.
17. Rekomandim në lidhje me përgatitjen e akteve të reja nënligjore, në zbatim të Ligjit nr.9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e Sigurimeve, risigurimeve dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”, datë 18.11.2005.
18. Informacion për punimet në objektin “Sistemimi i Nyjes së Zogut të Zi, përfshi dhe nënkalimin”, datë 24.11.2005.
19. Informacion për aktivitetin e përbashkët me OSBE-në dhe zyrën e Ombudsmanit Polak, për aksesin e Avokatit të Popullit mbi vendimet gjyqësore të formës së prerë, datë 25.11.2005.
20. Rekomandim për zbatimin e nenit 10 të Kushtetutës për lidhjen e marrëveshjeve me bashkësitë fetare, datë 09.12.2005.
21. Rekomandim për ndryshimin dhe përmirësimin e përmbajtjes së nenit 86 të Kodit Penal, për veprën penale të torturës, datë 16.12.2005. Pranuar.
22. Rekomandim për rregullimin ligjor të ndërtimeve të objekteve fetare, datë 28.12.2005.

Siç shihet, sapo filloi veprimtarinë e saj, për një periudhë të shkurtër 4 mujore, Qeveria është informuar për mjaft probleme që ka hasur gjatë veprimtarisë së tij institucioni i Avokatit të Popullit, por që lidhen në mënyrë të pazgjidhshme edhe me objektivat e saj që janë mirëqeverisja dhe lufta kundër korrupsionit. Në përgjithësi rekomandimet tona janë mirëpritur dhe nga Qeveria ka mirëkuptim për t'u marrë me problemet dhe impenjim për t'i zgjidhur ato.

Kryeministri është informuar rast pas rasti edhe në lidhje me problemet me interes për Qeverinë që kemi diskutuar me homologët gjatë takimeve në Shqipëri, raporteve të tyre apo vizitave tona jashtë shtetit.

Grupi Mbikqyrës i Firmave Piramidale pranë Këshillit të Ministrave

Veprimtaria e Grupit Mbikqyrës pranë Këshillit të Ministrave, ka qene një nga problematikat e trajtuara nga ana e institucionit tonë edhe gjatë vitit 2005.

Numri i ankesave të marra nga ana jonë për këtë vit është 8. Kanë përfunduar së shqyrtuari, dhe rezultojnë katër prej tyre të pabazuara, kurse kater te tjerat jashtë juridiksionit dhe kompetencës sone.

Problemet e parashtruara në ankesat e marra në shqyrtim kanë qenë:

1. Për zvarritje dhe bllokim në procesin e kthimit të parave kreditorëve të ish firmave piramidale nga ana e Grupit Mbikqyrës.
2. Për mosdhënie informacioni të saktë lidhur me procedurat e likuidimit per kreditorët e firmave piramidale.

Problemi i mospërfundimit të plotë të procesit të transparencës dhe mospërcaktimi i afateve konkrete të procesit të kthimit të parave ndaj kreditorëve të firmave piramidale, gjykojmë se tanimë ka kaluar në kuadrin e përcaktimit të afateve të shlyerjes së përqindjeve përkatëse, dhe të shumave të derdhura nga ana e kreditorëve në firmat piramidale.

Megjithatë gjykojmë se transparenca e munguar në punën e administratorëve të firmave piramidale dhe të Grupit Mbikqyrës pranë Këshillit të Ministrave, vazhdon të mbetet problem, fakt që është evidentuar cdo vit, por edhe në ankesat e shqyrtuara prej nesh në vitin 2005.

Kështu në procesin e shpërndarjes së parave sipas përqindjes përkatëse të depozituar në firmat piramidale, për të cilat ka përfunduar procesi i administrimit dhe transparencës, del se ka probleme lidhur me gjeneralitetet e pakta që kanë kreditorët në listat e këtyre kompanive piramidale. Gjykojmë se ky problem, duhej të ishte kapercyer me kohë, pasi në punën që është bërë nga administratorët përkatës të firmave piramidale për listat e kreditorëve të këtyre firmave, të dhënat personale

në listë, duhej të ishin të plota dhe të mjaftueshme për shmangjen e një fenomeni të tillë, sepse kur është e dukshme se koha në dispozicion për këtë qëllim ka qënë mëse e mjaftueshme.

Problem kryesor mbetet mosinformimi ne kohe i qytetareve sipas dispozitave te Kodit te Procedurave Administrative ne kuptimin qe, p.sh. zoterimi i nje kontrate orgjinale nga ata, por mospasja e emrit ne lista, qe si pasoje sjell dhe mosnjohjen e kontrates nga administratoret, keta te fundit t'i orientonin ne kohe qytetaret per ndjekjen e rruges gjyqesore per vertetimin e qenies kreditor tek firmat piramidale.

Lidhur me sa është evidentuar më sipër po paraqesim dy raste tipike të shqyrtuara nga ana jonë:

1. *Shtetasi N.T*, në ankesën e tij ka ngritur pretendimin se administratorët e firmes ‘Kamberi’ në mënyrë të paargumentuar kanë bllokuar kthimin e shumave të lekëve të akorduara në favor të qytetarëve kreditorë. Konkretisht ai ka sqaruar se ka nje kontrate origjinale te tij me perfaqesues te firmes Kamberi”, ku ai rezulton kreditor i saj.

Me marrjen në shqyrtim të kësaj çështje nga ana jonë, është kërkuar informacion nga Administratorët e Shoqërisë “Kamberi”, lidhur me vërtetësinë e pretendimeve në fjalë dhe të mundësisë reale që ekziston për zgjidhjen e këtij problemi.

Administratori i shoqërisë në administrim “Kamberi sh.p.k” ka sqaruar se ankuesi ne fjale nuk e ka emrin ne listat e kompjuterizuara prandaj dhe nuk i jane kthyer leket. Nderkohe sipas ligjit, ankuesi duke qene se pretendon se ka nje kontrate origjinale duhet t'i drejtohet gjykates per zgjidhjen e ketij problemi. Por sic e thame me lart, ky lloj informacioni ankuesit mund t'i ishte dhene nga vete administratori i shoqerise, per te mos lejuar zvarritje te metejshme.

Nga ana jone ankuesi u sqarua per ndjekjen e problemit gjyqesisht, ndërkohë që çështja në fjalë është konsideruar si e pabazuar në pretendimet që ngrihen.

2. *Shtetasi F.B*, ne ankesen drejtuar Avokatit te Popullit, shpreh shqetesimin lidhur me veprime te parregullta te procedures se ankandit per objektin “ish parku komunal i transportit me vendndodhje ne afersi te shkolles Hasan Prishtina, prone e shoqerise ‘Vefa ne administrim”. Sipas tij, ankandi per shtepine ku banonte, qe u shit bashke me parkun komunal, u be pa zbatuar procedurat ligjore per njoftim zyrtar te daljes ne shitje te ketij objekti. Madje u be fare pa ankand dhe fakti qe ai banonte ne ate objekt me kontrate te rregullt qeraje prej disa vitesh nuk u mor parasysht.

Ne kerkuam shpjegime prane administratoreve te shoqerise Vefa dhe Qendres se Ankandeve.

Nga informacioni i ardhur prej tyre na rezulton se ata i jane shmangur dhenies se pergjigjeve per sa pretendonte qytetari (shkelje

procedurash ankandi). Ata shpjegonin se ankuesi ishte me qera ne kete objekt vetem per nje muaj, si dhe kishte marre persiper qe ne asnje moment nuk do te sillte pengesa per shitjen e objektit.

Nga gjithë sa u shqyrtua rezultonte se ky objekt tashme ishte shitur, pra nepermjet nje kontrate shitje i ishte dhene dikuj tjetër, dhe bazuar mbi kontraten e shitjes mund te ishte bere dhe regjistrimi i prone.

Ne keto kushte ne e orientuam ankuesin qe per pretendimet e tij se bashku me dokumentacionin perkates, qe t'i drejtohej Gjykates se Faktit Tirane, ku mund te kerkonte pavlefshmerine e aktit te shitjes se ketij objekti, duke qene se tashme vec nepermjet gjykates, mund te anullohej nje kontrate shitje, apo te ç'regjistrohej nje prone nga Zyra e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme.

Instituti i Integritit të të Përndjekurve Politikë (IIPP)

Gjatë vitit 2005, ndaj Institutit të Integritit të të Përndjekurve Politikë (IIPP) janë bërë 2 ankesa dhe ato kanë rezultuar jashtë kompetencës sonë.

Një problem, i paraqitur në një numër të konsiderueshëm ankesash edhe para vitit 2005 është ai i mospërfitimit të statusit të të përndjekurit politik. Ky problem prek rreth 200 persona që presin të fitojnë statusin e ish të përndjekurit politik, dhe që nëpërmjet statusit, pretendojnë të përfitojnë të gjitha benefitet që mund të përfitohen prej zotërimit të tij. Kjo si pasojë e mosfunksionimit të Komisionit Shtetëror Trepalësh si organi kompetent për dhënien e së drejtës së Statusit të ish të Përndjekurit Politik. Ky komision ka funksionuar gjatë periudhës Nëntor 1993-Korrik 1997. Më pas edhe pse ka qenë detyrim ligjor ekzistenca e tij, ky funksionim është ndërprerë. Ndaj në kuadër të një prej detyrave të tij, asaj të mirëfunksionimit të administratës publike, Institucioni i Avokatit të Popullit në mars 2005 i rekomandoi ish Zv.Kryeministrit përshpejtimin e procedurave për ngritjen e Komisionit Tre Palësh si organ kompetent për dhënien e së drejtës së Statusit të ish të Përndjekurit Politik dhe nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 1 dhe 2 të Ligjit. Nr.9260, datë 15.07.2004 “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr.7748, datë 29.07.1993 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist” i ndryshuar. Në nëntor 2005 këtë rekomandim ia kemi dërguar dhe Qeverisë të drejtuar nga Kryeministri Z.Sali Berisha, dhe po presim përgjigje për të.

2. Ministria e Drejtësisë

Gjatë vitit 2005 janë trajtuar gjithësej 301 ankesa e kërkesa që kanë të bëjnë me autoritete në juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë, e konkretisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Zyrat e Permbarimit, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme etj.

Edhe gjatë vitit 2005 bashkëpunimi me këtë ministri ka rezultuar efektiv dhe cilësor, sidomos pas Shtatorit 2005.

A. Ankesat për burgjet dhe administratën e burgjeve

Në lidhje me burgjet dhe personelin e burgjeve kemi patur 99 ankesa. Burgjet janë institucione të mbyllura dhe liria në të gjitha shprehjet e saj është e kufizuar dhe të drejtat e të burgosurve mund të shkelen më lehtë. Ne kemi patur gjithmonë parasysh thënien e ish ministrit britanik, përgjegjës për burgjet Z. Jack Straw ku thotë se: “Mënyra si i trajtojnë shoqëritë ata të cilëve u është hequr liria, është provë vendimtare e përkushtimit ndaj të drejtave të njeriut”. Prandaj nga ana jonë, ankesave nga këta persona ju është kushtuar dhe do t’i kushtohet vëmendje e veçantë. Gjatë vitit 2005, punonjës të stafit të Avokatit të Popullit kanë vizituar të gjitha burgjet dhe paraburgimet që janë në vartësinë e Ministrisë së Drejtësisë, ashtu si dhe dhomat e izolimit të komisarivateve të policisë në rrethe. Në këto të fundit qëndrojnë të burgosur, për të cilët vendimi i gjykatës ka marrë formën e prerë si dhe të paraburgosurit, që presin të gjykohen. Në fund të vitit 2005 ka patur 2592 të burgosur në burgje dhe 73 të dënuar me vendim të formës së prerë që mbaheshin në dhomat e izolimit të komisarivateve të policisë. Po kështu kanë qënë dhe 671 persona nën hetim në paraburgimet pranë Komisarivateve të Policisë që akoma janë në vartësi të Ministrisë së Brendshme sepse akoma nuk kishte përfunduar gjykimi i tyre. Gjithashtu në paraburgimet e Burgut 313 Tiranë, Burgut 302, Burgut të Shënkollit në Lezhë si dhe në paraburgimin e Vlorës, që tashmë janë në administrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, janë edhe 816 të paraburgosur. Pra gjithësej kanë qënë 4152 persona të privuar nga liria, nga 4487 persona që ishin në fund të vitit 2004, pra 335 persona më pak.

Gjatë vizitave në këto institucione janë takuar personalisht 348 të dënuar apo të paraburgosur. Në 143 raste ankesat e të dënuarve janë bërë me shkrim.

TE ARRESTUAR NE SHKALLE REPUBLIKE NE DHOMAT E IZOLIMIT
NE VARETSI TE MINISTRISE SE BRENDSHME

Tabela 1

Rrethet	Të arrestuar	Me vendim të formës së prerë	Të mitur	Gra
Berat	46	3	3	
Durrës	162	4	8	
Krujë	33	4	6	
Dibër	17	10		
Mat	25	2	1	
Elbasan	62	3	3	
Librazhd	7			
Gramsh	8	1		
Fier	83	6	4	
Lushnjë	42	8	1	
Gjirokastrë	29	5	2	
Përmet				
Tepelenë	16	9		
Kukës	21	1	4	
Tropojë	11	1		
Korçë	75	5	7	
Pogradec				
Lezhë	2			
Kurbin				
Shkodër	20	1	2	
Pukë				
Malësi Madhe				
Sarandë	33			
Tiranë				
TOTALI	692	73	35	

Gjithsej janë ankuar 222 persona, ku përfshihen të burgosur, familjarë të tyre apo personel i administratës së burgjeve për çështje që lidhen me administratën gjyqësore, të prokurorisë dhe burgjeve.

Në shoqëritë demokratike, ligji mbështet dhe mbron vlerat themelore të shoqërisë. Më e rëndësishmja e këtyre është respekti për dinjitetin e lindur të qënjeve njerëzore. Një nga sprovat më të mëdha në respektimin e natyrës njerëzore qëndron në mënyrën si i trajton shoqëria ata që kanë shkelur, apo që akuzohen se kanë shkelur ligjet penale. Këta janë persona që mund të kenë treguar mungesë respekti për dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Personeli i burgut luan rol të veçantë në emer të pjesës tjetër të shoqërisë në respektimin e dinjitetit të tyre, pavarësisht nga krimi që ata mund të kenë kryer. Parimi i respektimit të të gjitha qënieve njerëzore, pavarësisht nga e keqja që kanë bërë, është cituar nga

ish-i burgosuri më i famshëm dhe ish-president i Afrikës së Jugut, Nelson Mandela:

“Thuhet se askush nuk e njeh me të vërtetë një komb, pa u futur njëherë brenda burgjeve të tija. Një komb nuk duhet të gjykohej nga mënyra si i trajton qytetarët e tij shembullorë, por ata më të këqijtë”.

Kjo është baza mbi të cilën duhet të ngrihet menaxhimi i burgjeve, para së gjithash, brenda një kuadri etik. Kjo domosdoshmëri nuk duhet të harrohet kurrë nga administratorët e lartë apo nga personeli i burgut që punon drejtëdrejt me të burgosurit.

Si veçori të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2005 për burgjet, përmendim organizimin e inspektimeve në të gjitha burgjet shqiptare, në dhomat e izolimit si dhe në Spitalin e Burgjeve, për të parë nga afër zbatueshmërinë e Ligjit Nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, të “Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, dhe “Rregulloreve të Brendshme të Burgjeve” etj.

Në Shqipëri, nga njeri vit në tjetrin vjen duke u rritur dhe konsoliduar besimi i publikut në drejtim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të burgosurve dhe të paraburgosurve. Edhe në vitin 2005 të burgosurve ju është ardhur në ndihmë nëpërmjet linjës telefonike për të bërë falas ankesat e tyre. Është verifikuar disa herë dhe ka rezultuar se ajo ka funksionuar rregullisht. Në disa raste (që janë përfshirë në numrin përgjithshëm të ankesave) të burgosurit ankesat i kanë paraqitur nëpërmjet telefonit që është vendosur në dispozicion të tyre. Kjo tregon për një hapje akoma më të madhe të burgjeve shqiptare dhe është një arritje në drejtimin e duhur e institucionit të Avokatit të Popullit. Telefonata ka patur edhe nga të burgosurit tanë në Greqi. Por ka patur edhe ankesa nga të burgosur se nuk janë lejuar të marrin në telefon.

Të ndarë sipas burgjeve, gjëndja e ankesave paraqitet si më poshtë:

1. Nga burgju 313 Tiranë	janë ankuar	26
2. Nga burgju 302 Tiranë	janë ankuar	25
3. Nga burgju 325 Tiranë	janë ankuar	12
4. Nga burgju i Lushnjës	janë ankuar	1
5. Nga burgju i Tepelenës	janë ankuar	3
6. Nga burgju i Burrelit	janë ankuar	17
7. Nga burgju i Vaqarrit	janë ankuar	8
8. Nga Spitali burgjeve	janë ankuar	2
9. Nga burgju i Rrogozhinës	janë ankuar	3
10. Nga burgju i Krujës	janë ankuar	12
11. Nga burgju i Peqinit	janë ankuar	12
12. Nga paraburgimet	janë ankuar	17
13. Nga burgjet jashtë vëndit	janë ankuar	5

Në këtë numër nuk janë përfshirë ankesat apo kërkesat me shkrim të familjarëve të burgosurve si dhe kërkesa të tjera që janë paraqitur nga drejtoritë e burgjeve, komisariatet e policisë në rrethe, punonjës të administratës së burgjeve dhe të policisë së burgjeve.

Të ndarë sipas gjinisë, në 132 raste kanë bërë ankesë burrat, në 12 raste gratë dhe në rastet e tjera ankesat apo kërkesat janë dërguar nga drejtoritë e burgjeve, komisariatet e policisë në rrethe apo familjarët e të burgosurve dhe të paraburgosurve.

Sipas mënyrës së përfundimit ankesat paraqiten si vijon:

Për vitin 2005 janë përfunduar 216 ankesa apo kërkesa të ardhura me shkrim, nga 218 të ardhura, ndërsa janë në shqyrtim 2 çështje.

Nga këto 47 ose 22.2 % prej tyre janë zgjidhur në favor, 131 janë jashtë juridiksioni dhe kompetencës, 36 janë konsideruar si të padrejta, 2 raste janë në shqyrtim.

GJENDJA DHE AKTIVITETI NE BURGJE DHE PARABURGIME

Nr.	Emërtimi i Institucionit të Riedukimit dhe Burgut	Gjendja										
		Burra		Gra		Të mitur		Psiqikë		Totali	Kapaciteti	Mbipopullim
		Të dënuar	Të arrestuar	Të dënuara	Të arrestuara	Të dënuar	Të arrestuar	Burra	Gra			
1	Burgu 313 Tiranë	7	365		36		20			421	395	26
2	Burgu 325 Tiranë	60		67						127	140	-13
3	Burgu Vaqarr	164				14				178	150	28
4	Burgu Lushnjë	287								287	240	47
5	Burgu Burrel	221								221	195	26
6	Burgu Tepelenë	106								106	105	1
7	Spitali i Burgjeve	22	12	2	4			55	2	97	80	17
8	Burgu 302 Tiranë		184							184	182	2
9	Burgu Rrogozhinë	416								416	380	36
10	Inst. Veçantë Krujë	202								202	200	2
11	Paraburgimi Vlorë	1	66				2			69	46	23
12	Burgu Peqin	771								771	700	71
13	Burgu Lezhe	240	169							309	528	-219
TOTALI		2592	596	69	40	14	22	55	2	3388	3341	47

Nga 12 ankesat e mbartura nga viti 2004 në vitin 2005 janë përfunduar 12, 7 prej tyre të pabazuara, 3 jashtë juridiksioni dhe kompetence, 1 me rekomandim pranuar, 1 me rekomandim refuzuar.

Duke bërë grupimin sipas natyrës së ankesave rezulton:

1. Mjaft të burgosur janë ankuar se mbahen padrejtësisht në dhomat e izolimit të komisariateve të policisë, në të njëjtën kohë kur vendimet e gjykatave kanë kohë që kanë marrë formën e prerë.

Ata kanë pretenduar se ju është shkelur e drejta e njohur nga neni 462 i K.Pr.Penale që urdhëron ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit të gjykatës që ka marrë formën e prerë.

Numri i ankesave të kësaj natyre për vitin që raportojmë në krahasim me vitin 2004 është në zbritje. Institucioni i Avokatit të Popullit ndërmori një proces hetimi, në përfundim të të cilit, rezultoi se ende në dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë në rrethe, kishte dhe vazhdon të ketë një numër jo të vogël të dënuarish. Me 31. 12. 2005 ndodheshin 73 të dënuar me vendim të formës së prerë në dhomat e izolimit (ndërkohë që me 31.12.2004 ndodheshin 189 vetë), të cilët qëndrojnë në kundërshtim të hapur me 462 të K. Pr. Penale. Shkaku i qëndrimit të këtyre të burgosurve në këto ambiente është mungesa e kapaciteteve në burgje.

Për rastet konkrete të të dënuarve që bëjnë ankesat me shkrim pranë zyrës së Avokatit të Popullit, ne kemi ndërhyrë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve që ata të dërgohen sa më parë në burgje, si rrjedhojë ata janë transferuar nga dhomat e paraburgimit për në sistemin e burgjeve. Por këta nuk kanë përfituar nga rregulli i Nenit 57 të Kodit Penal që koha e qëndrimit në këto dhoma paraburgimi të llogaritet një ditë paraburgim baras me një ditë e gjysëm burgim. Për këtë ne kemi bërë edhe rekomandimin e përsëritur drejtuar Kuvendit dhe Ministrisë së Drejtësisë për të bërë ndryshime në ligj.

Ashtu si edhe më parë, problemi i të dënuarve me vendim të formës së prerë që mbahen në dhomat e izolimit pa të drejtë ka qënë dhe do të mbetet, një nga drejtimit kryesore të punës sonë deri në zgjidhjen përfundimtare të tij.

Në takimet me drejtuesit e Ministrisë së Brendshme dhe atyre të Ministrisë së Drejtësisë në vazhdimësi është kërkuar që të përfundojë sa më shpejt kalimi gradual i dhomave të izolimit në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë, deri në zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi. Kështu në takimet që kemi patur gjatë vitit 2005, drejtuesit e Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë u angazhuan se do të merrnin masa për zgjidhjen përfundimtare të problemit. Ky problem është ndjekur

dhe vazhdon të ndiqet në vazhdimësi, duke bërë presion mbi Ministrinë e Drejtësisë dhe Administratën e Burgjeve për të zbatuar menjëherë V.K.M Nr. 327, datë 15.05.2003, për kalimin e sistemit të paraburgimit në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë.

Zyra jonë është duke e ndjekur këtë problem mbasi deri tani, faktikisht kanë kaluar në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë vetëm dhomat e izolimit në Vlorë, Qarkut Shkodër dhe Qarkut Lezhë.

Ne mendojmë se ka edhe rrugë të tjera për zgjidhjen e këtij problemi kaq delikat.

Një nga problemet kryesore është niveli i mbipopullimit. Gjithmonë, kjo është më keq për të paraburgosurit dhe personat që presin gjykimin. Problemi i mbipopullimit ka marrë forma çnjerëzore në shumë ambiente paraburgimi si në Vlorë, Durrës, Berat, Krujë etj, Mbipopullimi është në mënyrë të dukshme më i keq kur të burgosurit apo të paraburgosurit duhet të kalojnë pothuajse gjithë kohën në këto qeli ose dhoma dhe që dalin jashtë tyre për një periudhë të shkurtër kohe. Edhe në burgje me nivel të lartë mbipopullimi ka hapësira që nuk përdoren, si p.sh. Burgu 302 Tiranë, Burgu 313 Tiranë, Burgu i Peqinit dhe Burgu i Shënkollit në Lezhë. Në këto burgje ka korridore të gjata dhe të gjëra të cilat mund të përdoren për të lejuar grupe të burgosurish të dalin nga qelitë gjatë ditës për t'u përfshirë në forma të ndryshme aktivitësh.

Problemi i mbipopullimit të burgjeve nuk mund të zgjidhet vetëm duke ndërtuar burgje të reja. Më shumë rëndësi duhet t'i jepet në radhë të parë punës parandaluese që duhet të bëjë gjithë shoqëria dhe shteti Shqiptar, dhe së dyti prokuroritë dhe gjykatat duhet të bëjnë një politikë më të drejtë në zbatimin e masave alternative të dënimit. Prokurorët duhet të jenë më racionalë, jo çdo gjë duhet të zgjidhet me burg. Kufizimi i lirisë është një masë ekstreme, e cila duhet të jepet dhe të përdoret vetëm nëse masa të tjera alternative do të ishin pa vënd për shkak të rrezikshmërisë së krimit të kryer dhe autorit. Këto janë rekomandime të përsëritura jo vetëm të Avokatit të Popullit, por edhe të organizmave ndërkombëtare që merren me këto probleme.

**INFORMACION MBI GJENDJEN DHE PËRBËRJEN E TË DENUARVE
PËR MUAJIN DHJETOR 2004**

Emërtimi	Nën 18 vjeç	18-25 vjeç	26-45 vjeç	46-60 vjeç	Mbi 60 vjeç	Totali.	Vjedhje me dhunë	Vjedhje	Vrasje	Plagosje	Marredheni e Seksuale	Droga	Të tjera	0-1 vjet	1-2 vjet	2-5 vjet	5-15 vjet	16-25 vjet	Përfjetshëm	Aktiv punë
Burgu 313		2	3	2		7	1	1	2			3			1	3	3	1		4
I.R.325 (B)		24	28	8	18	78	6	27	16	2		2	25	17	13	19	20	9		25
I.R.325(G)		16	31	18	1	66		4	39			2	21	2	2	15	27	20		24
I.R.Lushnj		44	172	68	4	288	58	21	109	9	5	56	30	2	6	35	149	96		92
B. Burrel		48	136	29	11	224	60	1	144		1	4	14	1	2	9	95	91	26	32
B.Tepelen		10	82	13	2	107		29	66		4	1	7			2	27	50	28	8
B. Vaqarr	16	40	103	24		1833	42	14	80	3	13	26	5		4	26	125	28		39
B. 302		4	4	2		10	2	1	2		2		3		1		7	2		3
B. Rrogizhi		103	269	35	4	411	81	33	123	10	26	37	101	2	5	74	291	39		87
B. Kruje		98	108	36	40	203	17	20	126	5	11	10	14		5	35	116	47		23
B. Peqin		191	505	70	9	775	46	174	352	14	25	68	96	7	25	88	353	257	45	97
B. Lezhe		65	142	31	2	240	71	29	74	5	19	21	21	8	21	67	108	36		35
Shuma	16	566	1583	336	91	2592	384	354	1133	48	106	230	337	39	85	373	1321	675	99	469

2. Të sëmure mendore që mbahen ende padrejtësisht në spitalin e burgut.

Të burgosurit dhe të paraburgosurit gëzojnë të drejtën themelore për të gëzuar shëndet të mirë, si mendor ashtu edhe fizik, si dhe vazhdojnë të gëzojnë të drejtën për të gëzuar kujdes shëndetësor në një standart që është të paktën në nivelin e standartit që i sigurohet komunitetit të gjërë. Pakti ndërkombëtarë “Për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore” (neni12) përcakton”:

“Kushdo ka të drejtë për të gëzuar në standartet maksimale të mundshme shëndet mendor dhe fizik”.

Përveç të drejtave themelore që gëzojnë të gjithë personat, të burgosurit gëzojnë edhe disa të tjera për shkak të statusit të tyre. Kur shteti u heq njerëzve lirinë, merr përsipër përgjegjësinë të kujdeset për shëndetin e tyre si në lidhje me kushtet nën të cilat i mban ata, ashtu edhe në lidhje me trajtimin individual që mund të jetë i nevojshëm si rezultat i këtyre kushteve.

Shëndeti i mirë është shumë i rëndësishëm për këdo. Ai ka një rëndësi jashtëzakonisht të veçantë në komunitetet e mbyllura të burgjeve dhe paraburgimeve. Për nga natyra, kushtet në burg mund të kenë ndikim dëmtes, si në mirëqenien mendore, ashtu edhe atë fizike të të burgosurve. Për këtë, administrata e burgjeve ka përgjegjësi jo thjesht të sigurojë kujdes mjekësor, por edhe të krijojë kushte që promovojnë mirëqenien, si të të burgosurve, ashtu edhe të personelit të burgjeve. Të burgosurit nuk duhet të largohen nga burgu në gjëndje më të keqe se ajo që kishin kur u futën në burg. Kjo duhet të zbatohet për të gjitha aspektet e jetës në burg e veçanërisht për shëndetin. Në vendin tonë, përdorimi në rritje i denimeve të gjata apo të përjetshme po çon në një shtim të problemeve shëndetësore që lidhen me moshën në popullsinë e burgjeve. Kjo kërkon nga administrata e burgjeve që të bëjë planifikimet e duhura për problemet shëndetësore. Vendi ynë ka vështirësi të mëdha për të siguruar kujdes shëndetësor të standarteve të larta për popullsinë në përgjithësi. Edhe në këto rrethana të burgosurit kanë të drejtë dhe duhet të gëzojnë kujdesin më të madh të mundshëm shëndetësor dhe pa pagesë. Komiteti European për Parandalimin e Torturës (KEPT) ka deklaruar që edhe në periudha të vështirësive të mëdha ekonomike, asgjë nuk mund ta justifikojë shtetin të mos përmbushë përgjegjësinë për t’u siguruar kushtet bazë të jetës atyre të cilëve ai u ka hequr lirinë. KEPT-ja, gjithashtu, e ka bërë të qartë që kushtet bazë të jetesës përfshijnë edhe paisjet dhe medikamentet e përshtatshme dhe të mjaftueshme shëndetësore. Në zbatim të këtyre rekomandimeve, administrata e burgjeve duhet të plotësojë parasëgjithash të gjitha burgjet e vendit me personelin e nevojshëm dhe sipas profilit të shërbimit shëndetësor.

Sidomos, në Burgun e Krujës, ku vuajnë denimin të denuar me probleme të rënda të shëndetit mendor dhe të denuar të moshave të vjetra.

Edhe në vitin 2005, problemi i personave për të cilët gjykata ka marrë masën mjeksore të mjekimit të detyruar nuk ka marrë ende zgjidhje. Gjatë vitit 2005 specialistë të zyrës së Avokatit të Popullit kanë bërë inspektime në Spitalin e Burgjeve për të parë gjëndjen e të sëmurëve mendorë për të cilët gjykatat kanë marrë masën mjeksore të mjekimit të detyruar dhe padrejtësisht mbahen në kushte burgimi. Nga këto inspektime doli se këta persona ndonëse nuk janë të denuar, mbahen ende brënda sistemit të burgjeve. Nga hetimet e ndërmara nga ana jonë, veç të tjerash pengesë për zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi rezulton se është edhe mosplotësimi nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë të akteve nënligjore për ruajtjen e këtyre personave. Për këtë kemi rikërkuar zbatimin e rekomandimit të bërë qysh me datën 13.05.2002: për plotësimin e kërkesave të Ligjit Nr.8092, datë 03.02.1996 “Për Shëndetin Mendor”, për të nxjerrë rregulloren “Për masat e sigurimit të personave për të cilët gjykata ka marrë masën mjeksore të mjekimit të detyruar”.

Pra ky ligj përcakton detyrimin e Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Mjedisit për të miratuar rregulloren e masave të sigurimit për personat që kanë kryer një vepër penale dhe është vendosur nga gjykata mjekimi i detyrueshëm në institucione psikiatrike. Por megjithëse kanë kaluar rreth 9 vjet nga dita kur ka hyrë në fuqi ligji “Për shëndetin mendor”, një rregullore e tillë ende nuk ka dalë. Aktualisht të gjithë të dënuarit me mjekim të detyruar qëndrojnë në kundërshtim flagrant me ligjin në një pjesë të Spitalit të Burgjeve. Ky qëndrim ka sjellë moszbatimin e nenit 28 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që përcakton se çdo person i tillë ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij dhe ka lënë shteg për të abuzuar në drejtim të kërkesave ligjore për të drejtat e liritë e këtyre personave, duke i dëmtuar edhe më tepër nga ana mendore.

Në përgjigje të këtij rekomandimi Ministria e Shëndetësisë e ka quajtur të zgjidhur problemin me kalimin kapital që ka bërë të godinës së Spitalit të Krujës në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë. Kurse Ministria e Drejtësisë në përgjigje të këtij rekomandimi kishte marrë angazhimin se me hapjen e Burgut të Krujës do të fillojë së funksionuari edhe rregullorja e kërkuar nga ana jonë.

Në realitet Burgu i Krujes ka filluar nga aktiviteti, por funksionon përsëri si burg dhe jo si institut mjekësor që të sistemohen personat e sipërpërmendur. Ka patur ankesa se të sëmurëve këtu nuk u janë siguruar ilaçet. Në kushtet kur ligji ndalon sistemimin e këtyre personave brenda sistemit të burgjeve nuk duhet marrë në konsideratë pretendimi i sistemimit tyre në këtë burg. Gjatë vitit 2005 zyra jonë ka insistuar pranë

të dy ministrive për nxjerrjen e rregullores dhe përcaktimin e vendit ku do të shkojnë këta persona, por ende nuk është miratuar as rregullorja dhe as vendi i trajtimit tyre.

Ne mendojmë se ka munguar vullneti i Qeverisë për zgjidhjen e këtij problemi. Këtë konkluzion e nxjerrim duke parë kohën tepër të gjatë prej 9 vjetësh që ka kaluar që nga hyrja në fuqi e Ligjit “Për shëndetin mendor”. Edhe gjatë viteve, 2005 së bashku me Ministrinë e Drejtësisë ne jemi bërë bashkëautorë të një projekti për zgjidhjen e këtij problemi duke i propozuar qeverisë mënyrat e zgjidhjes.

Edhe për të ardhmen sistemimi i këtyre personave, ashtu siç është përcaktuar në ligj, do të jetë një nga përparesitë e punës sonë.

3. Ushtrim dhune dhe shkelje të tjera nga Policia e burgjeve

Menaxhimi i burgjeve, para së gjithash, dyhet të bëhet brenda një kuadri etik. Ata të cilët janë përgjegjës për administrimin e burgjeve duhet ta kenë përherë parasyshë këtë parim. Ata duhet të kuptojnë se nuk janë thjeshtë roje, me të vetmen detyrë heqjen e lirisë së njerëzve. Pa dyshim, nuk janë xhelatë që kanë për detyrë të japin ndëshkime më të mëdha se ato të vendosura nga autoritetet gjyqësore. Përkundrazi, ata duhet të ndërthurin rolin e tyre të mbikëqyrjes së të burgosurve me një rol edukativ dhe reformues. Personeli i burgut duhet të ketë cilësi personale që i lejon të komunikojnë në mënyrë të barabartë, njerëzore dhe të drejtë me të gjithë të burgosurit, përfshirë këtu edhe ata më të vështirët dhe më të rrezikshmit.

Në vendin tonë, publiku ka shumë pak njohuri për burgjet, personelin e burgjeve apo punën e tyre. Ndërsa shqëria jonë, përgjithësisht, e njeh vlerën thelbësore të punonjësve në sektorin e shëndetësisë dhe të arsimit, personeli i burgjeve nuk e merr një vlersim të tillë publik. Në këto kushte, Ministria e Drejtësisë dhe administratorët e lartë të burgjeve duhet të konsiderojnë krijimin e një programi të edukimit publik dhe të nxisin interesin e medias për të edukuar shoqërinë për rolin e rëndësishëm që ka personeli i burgjeve në mbrojtjen e shoqërisë.

Pas miratimit nga Kuvendi të Ligjit Nr.9071, datë 22.05.2003 “Për një ndryshim në ligjin nr.8328 datë 16.04.1998 ”Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” dhe të Ligjit Nr.9398, datë 12.05.2005 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, Avokati i Popullit ose personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në burgje, në vende ku policia ose prokuroria mbajnë persona të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar (të paraburgosurit), në reparte ose institucione shtetërore, në spitale psikiatrike, në azile, në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e

shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Në zbatim të këtij ligji nga ekspertët e zyrës së Avokatit të Popullit janë organizuar inspektime të hollësishme në Burgun “Ali Demi Tiranë, Burgun e Krujës, Burgun e Lezhës, Burgun e Burrelit, Burgun e Peqinit, Burgun 302 Tiranë, si dhe janë vizituar edhe burgjet e tjera si Burgu i Lushnjës, Burgu i Rrogozhinës, Burgu i Tepelenës dhe Burgu i Vaqarrit. Këto inspektime u organizuan me iniciativën e Avokatit të Popullit për shkak të të dhënave që dispononte Institucioni i ynë se në burgje përdorej dhunë nga ana e policisë së burgjeve. Pas këtyre inspektimeve të hollësishme rezultoi se kishte patur raste edhe për përdorim të dhunës nga ana e policisë së burgjeve, siç ishte rasti i Burgut 302, në të cilin me dt.08.11.2005 me iniciativën e Avokatit të Popullit është bërë një inspektim për ngjarjen e ndodhur në këtë burg me dt.06.11.2005 rreth orës 22.00. Po kështu në Burgun e Peqinit me dt.24.12.2005. Konstatimet tona ju bënë prezent në një takim Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe Drejtorit të Policisë së Burgjeve. Ankesa për keqtrajtime nga Policia e Burgjeve pranë zyrës së Avokatit të Popullit kanë bërë të dënuarit vazhdimisht. Ankesat e tyre janë verifikuar nga zyra jonë dhe shumë prej tyre kanë rezultuar se ishin të pabazuara. Me miratimin e të drejtës së Avokatit të Popullit për të bërë vizita në burgje pa autorizim, si dhe për të organizuar inspektime në burgje është krijuar një mundësi shumë më efektive për mbrojtje të të drejtave dhe lirive të të dënuarve. Praktika e inspektimeve do të bëhet më e shpeshtë në të ardhmen, aq shumë sa po shtohen të dhënat se është shtuar dhuna në burgje muajt e fundit.

4. Ankesa të të burgosurve kundër vendimeve të gjykatave

Edhe gjatë vitit 2005 në zyrën tonë kanë vazhduar të vijnë ankesa të të dënuarve kundër vendimeve të gjykatave të cilat i kanë deklaruar ata fajtorë. Në ankesat e tyre ata pretendojnë se nuk janë fajtorë për veprat për të cilat janë dënuar, duke pretenduar se gjykatat nuk kanë vlerësuar drejt provat në ngarkim të tyre. Numri i këtyre ankesave për vitin 2005 është 98. Pavarësisht se Avokati i Popullit në bazë të ligjit nuk ka në juridiksion shqyrtimin e vendimeve të gjykatës, në të gjitha këto raste nga ana jonë ankuesve ju është treguar rruga që ata duhet të ndjekin për të realizuar të drejtën e pretenduar prej tyre, me kërkesë për rishikimin e vendimit pranë Gjykatës së Lartë. Kjo sepse pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.9398 datë12.05.2005 Avokatit të Popullit i është dhënë e drejta të presë ankesa ndaj vendimeve të gjykatave, por nuk janë bërë ndryshimet në Kodet e Procedurës Penale dhe Civile, për të realizuar këtë të drejtë.

5. Grevat e urisë

Avokati i Popullit në disa raste që është vënë në dijeni nga media apo nga administrata e burgjeve për hyrjen në greva urie të të denuarve, ka qenë ndermjetës midis administratës dhe të burgosurve. Në disa raste, ndërhyrja e Avokatit të Popullit ka qënë e suksesshme sepse të dënuarit kanë ndërprerë grevën e urisë, pasi ju janë plotësuar më parë ato kërkesa apo ankesa për të cilat kanë patur të drejtë. Ndërsa, në rastet kur ata kanë përdorur këtë mjet si presion për ndryshimin e vendimit të gjykatës, ju është bërë e qartë se ankesa nuk ishte në juridiksionin tonë dhe se çështja nuk zgjidhej me grevë urie, por duke apeluar në organet më të larta të gjyqësorit. Duke ndjekur në vazhdimësi fenomenin e shpeshtë të grevave të urisë nëpër burgje, Zyra e Avokatit të Popullit ka dalë në konkluzionin se grevat e urisë nëpër burgje nuk bëhen sipas udhëzimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Urdhërit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Pothuajse në të gjitha rastet e grevave të urisë, të burgosurit që pretendojnë se janë në greva urie nuk marrin ushqimin e burgut, ndërkohë që ushqimet nga familja mbahen në dhoma ku bëhet greva. Drejtuesit e burgut, duke mos dashur të konfliktohen me të burgosurit, bëjnë sikur ju besojnë atyre që janë në greva urie, ndërkohë edhe të burgosurit bëjnë sikur janë në grevë urie. Për këto arsye, grevat e urisë po bëhen shumë të shpeshta nëpër burgje.

6. Ankesa për transferime të padrejta nga një burg në tjetrin

Në disa raste të dënuarit janë ankuar për transferime të padrejta ose kanë kërkuar të transferohen nga njëri burg në tjetrin në zbatim të nenit 31 të Ligjit Nr.8328 dt.16.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të denuarve me burgim” ku thuhet: *“duhet të favorizohet kriteri i caktimit të të denuarve në institucione pranë vendbanimit të familjeve të tyre.* Në të gjitha rastet që të dënuarit janë ankuar se ndaj tyre nuk është respektuar kriteri i caktimit të tyre në institucione pranë vendbanimit të familjeve të tyre, pas ndërhyrjes së zyres tonë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve është bërë i mundur transferimi i tyre.

Nga verifikimet tona është vërtetuar se në disa raste transferimi i të denuarve nga një burg në tjetrin është bërë në kundërshtim me kriteret ligjore. Gjatë viteve kemi konstatuar se transferimi i të denuarve nga një burg në një tjetër është përdorur si masë disiplinore, veprim që bie në kundërshtim të hapur me Ligjin Nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të denuarve me burgim”. Konstatojmë se si burg ku transferohen të dënuarit e vështirë dhe të rrezikshëm po përdoret Burgu i Burrelit. Ne do propozojmë që për shkak të kushteve jo të mira, Burgu i Burrelit të mbyllet. Avokati i Popullit nëpërmjet rekomandimit në këto raste ka kërkuar anulimin e urdhrave të transferimit. Kërkesa jonë në shumë raste është quajtur e drejtë dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është vendosur transferimi i tyre në një burg afër vendbanimit të

të familjeve të tyre. Por kemi patur edhe raste kur nga Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve është refuzuar, pa u argumentuar, rekomandimi i Avokatit të Popullit. Si p.sh. rasti i të denuarit M.Ç. që është transferuar për thyerje te disiplinës nga Burgu i Peqinit për në Burgun e Burrelit, ndërkohë që dy prindërit e tij të moshës mbi 75 vjeç banojnë në Vlorë.

7. Ankesa të të dënuarve të ekstraduar nga Greqia që vuajnë dënimin në burgjet shqiptare

Edhe gjatë vitit 2005 kemi patur shumë ankesa nga të denuarit e transferuar nga Greqia për të vuajtur dënimin në Shqipëri.

Nga ankesat e tyre dhe nga takimet e vazhdueshme që kemi patur me ta ka rezultuar se këta të burgosur ndonëse i kishin kaluar të gjitha shkallët e gjyqimit në Greqi, pretendonin se ishin dënuar padrejtësisht ose se janë denuar me masa denimi shumë të rënda për shkak se janë shqiptarë.

Ata janë sqaruar se vendimet e gjykatave greke janë jashtë juridiksionit të zyrës sonë dhe se shqyrtimi i këtyre vendimeve nga gjykatat tona nuk mund të bëhet. Disa vendime unifikuese të Gjykatës së Lartë i ndalojnë gjykatat tona që të marrin në shqyrtim vendimet e dhëna nga gjykatat greke.

Ky problem është duke u ndjekur në kuadrin e hetimit të rastit që ka filluar me inisiativë zyra jonë, ku pretendohet që gruaja që është paraqitur para gjykatës greke si përkthyes nuk di fare gjuhën shqipe.

Ne mendojmë se mbajtja e dy të dënuarve, të denuar nga gjykata greke, duke patur si përkthyes greken Niki Vavacula e cila nuk dinte fare gjuhën shqipe, pa u rishikuar vendimi i tyre është një shkelje e rëndë e të drejtave të tyre. Gjithashtu, zyra jonë ka tërhequr nga burgjet vendimet e të gjithë të dënuarve në Greqi dhe që aktualisht vuajnë dënimin në Shqipëri për shqyrtimin rast pas rasti nëse pretendimet e tyre kanë bazë ligjore. Në këtë çështje bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve nuk ka qënë i mirë. Sepse kjo Ministri nuk na ka siguruar kopje të plota të vendimeve të shkallës parë.

8. Ankesa të familjareve të shtetasve shqiptarë që vuajnë dënimin në burgjet e shteteve të tjera

Për vitin 2005 ka patur 3 ankesa nga të denuar dhe familjarë të tyre, me anën e të cilave ata kanë pretenduar se ndaj të afërmeve të tyre në burgjet në Irland, Itali dhe Greqi përdoret dhunë, se ata nuk kanë asnjë dijeni për shkaqet e burgosjes së fëmijve të tyre etj. Ata në ankesat dhe kërkesat e tyre kërkojnë përshpejtimin e procedurave për transferimin e tyre nga burgjet e vendeve të huaja për të vuajtur dënimin në burgjet shqiptare. Këto ankesa ju janë dërguar Ombudsman-ve në këto vende.

* * *

Nga analiza e ankesave dhe kërkesave të të burgosurve që ndodhen në burgje dhe në dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë, del se gjatë vitit 2005, veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit duhet të synojë në realizimin e rekomandimeve kryesore për Qeverinë, për Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe për Ministrinë e Brendshme dhe konkretisht:

1. Shpejtimin e procedurave për marrjen në dorëzim nga Ministria e Drejtësisë të dhomave të izolimit në të gjithë vëndin.

2. Sistemimin në një institut mjekësor të personave për të cilët gjykata ka vendosur mjekimin e detyruar, ashtu siç kërkon ligji.

3. Mbi bazën e ankesave të të burgosurve, duke parë se në disa raste vetë ligji ishte bërë shkak për shkeljen e disa te drejtave të të burgosurve dhe të paraburgosurve, mbështetur në ligjin për Avokatin e Popullit, kemi bërë edhe rekomandime për ndryshimin e akteve ligjore që lidhen me të drejtat e të burgosurve. Konkretisht të dënuarve që janë mbajtur në qelitë e paraburgimit nuk ju njihet dhe nuk ju llogaritet kjo kohë si paraburgim. Shkaku i shkeljes së të drejtës së të paraburgosurve është bërë neni 7 i ligjit nr.7941, datë 27.01.1995, “Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, i cili përcakton se: “Me paraburgim do të kuptojmë ditët e qëndruara në ndalim dhe arrestim në burg. Kur arrestimi nuk është ndërprerë, periudha e paraburgimit do të konsiderohet nga dita e ndalimit, derisa vendimi i gjykatës ka marrë formën e prerë”.

4. Gjithashtu duke parë se një pjese të madhe të të dënuarve nuk ju sigurohet e drejta për të votuar në zgjedhjet për pushtetin lokal, Zyra jonë do t’u kërkojë forcave politike parlamentare që në kuadrin e përgatitjeve të ndryshimit dhe reformimit të legjisllacionit për zgjedhjet të marrë parasysh edhe rekomandimet tona që të gjithë të paraburgosurve dhe te denuarve t’ju sigurohet mundësia për të votuar.

5. Gjithashtu i kemi ridërguar Ministrisë së Drejtësisë rekomandimet e mëposhtëme, për të cilat ndonëse kemi marrë përgjigje se janë pranuar si të drejta, në realitet nga ana e kësaj Ministrie nuk janë bërë hapa konkrete për vënien në zbatim të angazhimeve të marra:

a. Rekomandim për plotësimin e kërkesave të ligjit nr.8328 dt.16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim.”

Megjithëse kanë kaluar më se 8 vjet nga dita kur ka hyrë në fuqi ligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, gjithë të burgosurit që punojnë në burgje, marrin një shpërblim simbolik 90 lekë në muaj. Për çdo një muaj pune deri tani përfitonin 3.9 ditë burgim. Por me Urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm me Nr.3223 Prot. të dt.08.10.2004, është urdhëruar që të gjithë të dënuarve që kanë përfituar ditë burgu nëpërmjet punës t’ju hiqen. Për këtë qëllim Avokati i Popullit i ka dërguar rekomandim Prokurorit të Përgjithshëm “Për rregullimin e çështjes së uljes së denimit për të denuarit që punojnë në burgje dhe

marrjen e masve për korrigjimin e pasojave të aktit të nxjerrë nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën Nr.3223, datë 08.10.2004 dëguar Prokurorive në Rrethe”. Kjo çështje po ndiqet nga ana jonë. Aktualisht në sistemin shqiptar të burgjeve janë të punësuar 469 të denuar.

b. Rekomandim për krijimin e kushteve të nevojshme për funksionimin e Komisionit Mbikqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve me Burgim, sipas kreut të tretë të ligjit nr.8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e Vendimeve Penale”

Nga shqyrtimi i çështjes prej zyrës sonë rezulton se ngritja e këtij komisioni ka përfunduar dhe se është miratuar vendimi për shpërblimin e antarëve të këtij komisioni, por Komisioni me sa jemi në dijeni nuk ka filluar të funksionojë siç duhet.

c. Katër Rekomandime për Marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin pa të meta të Ligjit Nr.8328, dt 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të denuarve me burgim”, sigurimin e kushteve të jetesës në Burgjet e Lezhës, të Krujës, të Burrelit dhe Burgut të grave.

6. Rekomandim që të shfuqizohet Rregullorja “Për Sigurimin dhe Trajtimin e të Paraburgosurve” miratuar me Urdhërin e Ministrit të Rendit Nr.1075, datë 15.09.1999 dhe të urdherohet hyrja në fuqi e Rregullores “Per Organizimin e Funksionimin e Sistemit të Paraburgimit”, miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë Nr.3750/2, datë 23.07.2003.

Institucioni i Avokatit të Popullit mbetet në pritje të zbatimit të rekomandimeve të sipërpërmëndura, të cilat sipas Ministrisë së Drejtësisë do të jenë pjesë e një pakete të re ligjore dhe nënligjore që po përgatitet të miratohet.

b) Ankesat për Zyrat e Përmbarrimit

Edhe për vitin 2005 problemet lidhur me zvarritjet në ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë, nga Zyrat e Përmbarrimit në rrethe kanë zënë për qindje jo të vogël në ankesat e drejtuara institucionit tonë.

Kështu për vitin 2005 janë regjistruar 102 ankesa nga kreditorë të ndryshëm, 27 më pak se në vitin 2004. Pretendimet për të drejtat e shkeluara, në shumicën dërmuese, kanë të bëjnë me zvarritje nga Zyrat e Përmbarrimit në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Ndërsa pjesa tjetër ka si shqetësim kundërshtimet ndaj veprimeve, mosveprimeve dhe vendimeve të përmbarruesve gjyqësorë gjatë procesit të ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë. Nga këto janë përfunduar 88 ankesa, nga të cilat 28 janë zgjidhur në favor të ankuesve. Nga këto kemi 8 rekomandime të cilat janë pranuar pozitivisht. Ankesat e tjera, kanë rezultuar 43 të pabazura dhe 14 jashtë kompetencës.

Ndersa 14 ankesa te tjera kanë kalur për vazhdimin e shqyrtimit në viti 2006.

Gjithashtu, nga viti 2004 kanë qënë të mbartura edhe 72 çështje të të njëjtës natyrë nga te cilat kanë përfunduar 71, nga te cilat 17 jane zgjidhur ne favor te ankuesve kurse 1 eshte mbartur për vitin 2006.

Ankesat e tjera kanë rezultuar te pabazuara, mbasi kane kerkuar pezullim te ekzekutimit te titujve ekzekutive nga Gjykata e Larte.

Shumë ankesa kanë qënë jashtë juridiksionit, pasi kishin të bënin me ankime kundër vendimeve të pezullimit apo te pushimit të çështjes nga përmbaruesit gjyqësor. Për këto vendime ju është sugjeruar ankuesve që të ankohen në gjykatën kompetente në bazë të nenit 617 të Kodit të Proçedurave Civile.

Ankesat kane qene pothuajse për te gjitha Zyrat e Përmbarimit, por me te shumta per Zyrat e Permbarimit Lezhe Korçë, Vlorë, Durres, Tirane, Kavaje dhe Tropoje.

Nga keto Zyra rezulton, se me shume çeshtje përmbarimore pas ndërhyrjes tonë, janë përfunduar nga Zyra e Përmbarimit Tiranë. Statistikat tona tregojnë se kjo Zyrë ka edhe një pjesë tepër të madhe të praktikave të të gjithë sherbimit Përmbarimor në rang vëndi.

Në marrëdhënie me Avokatin e Popullit kjo Zyrë, së bashku me atë të rrethit Lezhë, dhe Vlore kërkesave tona ju përgjigjen brënda afateve të kërkuara dhe të shoqëruara edhe me kopjet e akteve dhe veprimeve proçeduriale përmbarimore të kryera. Më pas renditen për sa u takon çështjeve të ekzekutuara, pas kërkesave të institucionit tonë, Zyrat e Përmbarimit Korçë, Durrës, Sarandë, Kavaje etj. Ndërsa nga Zyra e Përmbarimit Tropojë kemi shumë pak përgjigje dhe ato me shumë vonesë.

Një pjesë e konsiderueshme e ankimeve, siç u përmend pak më lart, ka të bëjë me mos ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga debitorët institucione buxhetore që janë detyruar për kthim shumash monetare të caktuara. Ky problem ka qene i mbartur nga viti në vit, thuajse me të njëjtën vlerë debiti, ka përbërë shqetësimin kryesor si për Shërbimin Përmbarimor, ashtu edhe për institucionin e Avokatit të Popullit dhe veçanërisht për protagonistët kryesorë, gjyqfituesit, të cilët nuk kane mundur te realizojnë të drejtën e fituar në rrugë gjyqësore. Sic u tha edhe me lart, pjesa me e madhe kane te bejne me detyrime te pashlyeshme prej institucioneve buxhetore ndaj gjyqfituesve persona fizike. Ky detyrim persa i takon ceshtjeve te rregjistruara ne zyrat e permbarimit nga viti 2002 deri ne 6 mujorin e pare te vitit 2005 ka qene rreth 6 milion dollare. Edhe keto shifra tregojne ne vetvete se interesimi i shtetit per te zbutur efektin e borxheve ndaj kreditoreve ka qene me parametra teper te ulet. Justifikimi mbetet i njejte pamundesia financiare e buxhetit te shtetit.

Ky problem u kap me shume pergjegjesi nga kryeministri Zoti Sali Berisha qysh ne Shtator 2005, i cili caktoi si objektiv kryesor te Qeverise se tij shlyerjen deri ne Dhjetor 2005 te te gjithë vendimeve te tilla.

Si rezultat ky angazhim është raportuar se eshte plotesuar për rreth 90% të vendimeve gjyqësore ku pale debitore janë institucionet buxhetore.

Ndersa ankesat e tjera kane te bejne me mosrrikthimin ne pune te gjyqfituesve, mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore per trajtimin me toke bujqësore nga komisionet e tokave te fshatrave dhe komunave, etj

Ne nderhyrjet tona me mjetet ligjore qe na ka vene ne dispozicion ligji, jemi perpjekur ne rradhe te pare te terheqim vemendjen e Qeverise dhe institucioneve buxhetore debitore, per ndryshimin e mentalitetit te tyre qe konsiston ne moskonceptimin e drejte te fuqise se vendimit gjyqësor te formes se prere. Shpesh ka patur raste qe ekzekutimin e kane konsideruar si jo te detyrueshem per zbatim, si fakultativ, per te mosthene qe nuk jane te pakta rastet kur merrnin guximin te te shpreheshin qe vendimet jane ne kundershtrim me ligjin, etj.

Një problem tjetër që duhet prekur, është edhe niveli jo gjithmone i kenaqshem i cilësisë së veprimeve të përmbauesve gjyqësore, bazuar në kerkesat e kapitullit përkates të Kodit të Proçedurës Civile. Në shumë raste, gjatë verifikimeve të ankesave me dosjet përmbaimore, rezulton se ka veprime ose mosveprime, që janë tregues të mangësive të formimit profesional, pavarësisht shkakut apo motivit konkret, si: mungesë e njohjes së legjislacionit civil dhe atij proçedural civil, keq interpretim të dispozitivit të vendimit gjyqësor, nënvleftësim, harresë, ngutje, etj.

Nder shkaqet kryesore qe kane penguar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore te formes se prere ka qene edhe qendrimi jo konseguent i përmbauesve per zbatimin e kerkesave te ligjit. Jane jo te pakta rastet kur përmbauesit gjyqësore zbatojne nenin 606 te K.Procedures Civile per denim me gjobe te drejtuesve qendror e lokal te cilet nuk zbatojne vendimet gjyqësore dhe thajse nuk zbatohet fare neni 320 i K.Penal per pengim ekzekutimi ndaj ketyre drejtuesve.

Qëndrime të tilla kane ulur besimin e shtetasve ndaj organeve dhe nëpunësve të administratës, cënojnë reputacionin e shkallën e besueshmërisë të sistemit tonë të drejtësisë, brënda dhe jashtë vëndit, pjesë integrale e të cilës është edhe ekzekutimi përfundimtar i asaj të drejte që fitohet në rrugë gjyqësore.

Nga ankesen e marre prej P.M rezulton se Zyra e Permbarimit Korçë ka sekestruar banesen e ketij shtetasi i cili ne fakt nuk ka qene realisht debitori i kerkuar. Edhe pse ka kembengulur me te drejte qe personi i kerkuar nuk jam une, kjo zyre ka vazhduar te gjitha procedurat duke mos hezituar aspak nga fakti qe ne kete qytet ndodheshin dy persona me te njejtin emer e mbiemer.

Natyrisht mbas nje veprimi te tille ankuesi ne fjale ka kerkuar qe te demshperblehet per demin pasuror dhe ate moral qe kane shkaktuar me veprimet e tyre te paligjshme ne nxjerrjen e titullit ekzekutiv. Mbas u end per me shume se dy vjet zyrave te shtetit per te ekzekutuar nje vendim gjyqesor te formes se prere, nuk arriti te kishte asnje dobi. Se fundi ne qytetin e tij vajti nje grup komisioneresh i Avokatit te Popullit, per ditet e hapura i cili mori gjithë praktiken e tij. Jo me shume se nje muaj mbas berjes se kerkeses, zyra jone shqyrtoi me shume kujdes dosjen e tij arriti te binde me arsyetim ligjor kete zyre per zbatimin sa me te shpejte te ketij vendimi gjyqesor ne favor te qytetarit.

Gjithashtu konstatohet se ka zvarritje të pamotivuara në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në lirim e banesave, Tipike janë zvarritjet në ekzekutimin e një vendimi të tillë për lirim banese, nga Zyra e Përmbarrimit Tirane në favor të kreditorës A.Z. Ajo shprehu shqetesimin e saj lidhur me mosekzekutimin e vendimit te formes se prere ku Gjykata e Shkalles se Pare kishte vendosur deklarimin e pavlefshem te kontrates se shitblerjes duke detyruar Ndermarrjen Komunale te lidhe kontaten e privatizimit per apartamentin e saj. Mbas 7 vjetesh sorrollatje kjo zyre ende nuk e kishte ekzekutuar kete vendim. Mbas insistimit dhe kembnguljes se bere nga ana jone kjo zyre ne harkun e nje muaji arriti te ekzekutonte kete vendim te detyryshem per ta.

Ndërsa ankimi tjetër i ankuesit M.H gjithashtu lidhur me zyren e Përmbarrimit Tirane kishte te bente me ekzekutimin e vendimit te formes se prere ku Gjykata e Apelit Tirane kishte vendosur pagesen e çmimit te papaguar per sherbimin e kryer duke urdheruar zyren e permbarrimit ti paguante shumen e 7% te derdhur nga ankuesi ne parapagimin e shumes se takses permbarrimore. Rezulton se kjo ankese eshte zgjidhur pozitivisht ne hark kohor te shkurter.

Rast tjetër që duhet përmendur është ankuesi LL.P i cili ankohej lidhur me mosekzekutimin e plote te vendimit gjyqesor per detyrimin e Z.B. te kthente shumen e marre hua si dhe interesat bankare qe rrjedhin prej saj. Ne procesverbalet e mbajtuara si dhe ne pergjigjen e marre prej zyres se permbarrimit Vlore rezultonte se vendimi ishte ekzekutuar teresisht, nderkohe qe pjesa tjetere e dispozitivit te vendimit ndaj interesave bankare ngelej e paekzekutuar.

Mbas berjes se rekomandimit nga zyra jone, e cila u pranua pozitivisht nga Zyra e Përmbarrimit Vlore, arriem te veme ne vend te drejten e shkelur te qytetarit i cili endej zyrave te permbarrimit prej 3 vjetesh.

Gjithashtu vlen per t'u përmendur rasti i ankuesit A.F, i cili ankohej lidhur me mosekzekutimin e vendimit te formes se prere te Gjykates se Rrethit Vlore ku ishte vendosur detyrimi i S V te lironte

siperfaqen prej 1350 m². Mbasi kerkuam te informohemi mbi shkaqet e mosekzekutimit te vendimit nga ana e zyres se permbarimit Vlore na vune ne dijeni se vendimi i mesiperm nuk eshte ekzekutuar pasi nga ana e ankuesit nuk eshte bere i mundur sigurimi i mjeteve per prishjen e objektit.

Ne rekomandimin e bere nga ana e Institucionit tone Drejtori i Pergjithshme i Permbarimit vendimin e pezullimit te ekzekutimit e konsideroi te kundraligjshem per arsyet se ne Kodin e Procedures Civile ne menyre taksative percaktohet se kur mund te pezullohet ekzekutimi, dhe ne asnje nga nenet nuk shprehej se kreditori duhet te gjeje vete mjetet prishese. Nga ana e Drejtorise se Pergjithshme te Permbarimit rekomandimi yne u pranua pozitivisht.

Te njejtin problem kemi konstatuar edhe ne kerkesen e ankuesit I. A drejtuar Zyres se Permbarimit Kruje ku morem te njejten pergjigje edhe nga kryetari i kesaj zyre mbas te ciles beme rekomandimin perkates.

Mosekzekutimin e vendimeve gjyqesore te formes se prere duke e konsideruar si problem shqetesues ne te cilin jemi ndeshur vazhdimisht gjate viteve te fundit, por nisur edhe nga angazhimi i Qeverise per ekzekutimin e vendimeve gjyqesore te formes se prere deri ne dhjetor 2005, Avokati i Popullit, pergatiti nje material pergjithesues, per vitet 2000-2005 te cilen ja derguam Ministrit te Drejtesise Z.Aldo Bumci.

Me kete material pergjithesues trajtuam problemet me tipike qe kane dale nga ankesat, per mosekzekutimin e vendimeve gjyqesore te formes se prere, te dhëna rreth veshtiresive qe ndeshen nga ky shërbim gjatë procesit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore me debitorët institucione buxhetorë.

Pergjigjja pozitive e Ministrit te Drejtesise na ben me dije se ne kuadrin e prioriteteve qe ka ndermarre Qeveria e re e ka vleresuar me seriozitetin maksimal kete problem, duke evidentuar dhe pengesat e karakterit subjektiv qe e pengojne permbushjen e kesaj te drejte qytetare. Njekohesisht shprehet angazhimi i Qeverise ne zgjidhjen e problemit qe lidhet me mosekzekutimin e vendimeve gjyqesore dhe vecenarisht nga Institucionet buxhetore ne cilesine e debitorit

Gjithashtu shprehen gadishmerine e tyre qe ne baze te tagrave qe ju jep ligji duke kerkuar keshtu nga Drejtoria e Permbarimit Gjyqesor qe permbaruesit ne ushtrimin e detyres se tyre te jene konsequent ne zbatimin e ligjit, si dhe te zbatojne me rreptesi sanksionet ligjore ndaj personave qe me veprimet e tyre behen pengese ne ekzekutimin e vendimeve gjyqesore.

Mendojmë se eshte koha për institucionet që administrojnë financat shtetërore, qe të ballafaqohen me këtë realitet, të mbajnë pergjegjesitë që ju takojnë dhe të punojnë për zbutjen e problemit me mundësitë reale financiare të disponueshme. Gjithashtu i duhet kushtuar vëmendje

forcimit të ndjenjës së përgjegjësisë së administratorëve shtetërore në raport me ligjin, që në veprimtarinë e tyre të përditëshme në marrëdhënie me individët, të jenë të kujdesshëm në raporte të tilla të ndjeshme, si në respektimin e pronës private, të marrëdhënieve të punës, të interesave të tjera të ligjshme të individëve, pasi cënimi i tyre pa të drejtë, jo vetëm që cenon demokracinë, por rëndon buxhetin e shtetit.

Tani mund të themi se Shërbimi Përmbartimor ka arritur të dukshme nga viti në vit. Kjo edhe si rezultat i plotësimeve me akte normative në funksion të ushtrimit të veprimtarisë, por edhe të rritjes së nivelit të kontrollit nga Drejtoria e Përgjithshme dhe e kriterëve të vendosura për matjen e punës së çdo përmbartuesi, gjë që ka çuar në largimin nga shërbimi të një numri jo të vogël përmbartuesish.

Institucioni i Avokatit të Popullit edhe në të ardhmen do t'i kushtojë vëmendjen e duhur problemeve të përmbartimit gjyqësor në rastet e konstatimeve të veprimeve apo mosveprimeve që çenojnë të drejtat dhe interesat e ligjshme të palëve në procesin gjyqësor.

c) Ankesa për zyrat e regjistrimit të pasurive të palujtëshme (ZRPP)

Në vitin 2005 këto zyra kanë kaluar në varësi të Ministrisë së Drejtësisë

Për vitin 2005 pranë Institucionit tonë kanë ardhur 83 ankesa, afersisht tre herë më shumë se një vit më parë, që si objekt të tyre kanë patur pretendime për zvarritje në regjistrimin e pasurisë të tyre të palujtëshme, veçanërisht të oborreve të banesave private dhe mos marrjen e certifikatës së pronësisë. 13 ankesa të tjera kanë qënë të mbartura nga viti 2004. Nga të gjitha këto çështje, janë shqyrtuar 74, nga të cilat 19 janë zgjidhur në favor të ankuesve, ndërsa 22 të tjera kanë kaluar për shqyrtim të mëtejshëm për vitin 2006.

Konstatojmë se edhe për këtë periudhë kohore, bashkëpunimi dhe mirëkuptimi midis ZRPP në rrethe dhe Institucionit të Avokatit të Popullit ka vazhduar të jetë i mire, duke i veçuar në sensin pozitiv. Të gjitha kërkesave tona për shpjegime dhe sqarime ju janë përgjigjur në kohë dhe me argumenta ligjorë nëse qëndron apo jo ankimi i shtetasve, shoqëruar edhe me kopjet e veprimeve të kryera për kalimin e pronësisë për çdo praktikë. Ankesat që janë zgjidhur pozitivisht në favor të ankuesve ju përkasin respektivisht ZRPP të rretheve Vlorë, Tirane, Berat dhe Korçë.

Pas verifikimeve të ankesave, nuk ka rezultuar të këtë qënë e shoqëruar me veprime ose mosveprime të punonjësve të ZRPP të kryera në kundërshtim me Ligjin "Për regjistrimin e pasurive të palujtshme". Shkak i vonësive të kontestuara, vazhdon të jetë mosplotësimi i saktë nga

ana e ankuesve, i dokumentacionit për aplikim. Pas sugjerimit tonë për plotësimin e këtyre mangësive, kërkesat e tyre janë realizuar nga ZRPP. Këtu mund të përmendim rastin e ankuesit F.F. që prej dy vitesh nuk po mund të realizonte regjistrimin fillestar dhe marrjen e çertifikatës së pronësisë në ZRPP të rrethit Tiranë, të banesës së tij pronë private. Pasi plotësoi aktet me dokumentat që i mungonin, ju bë regjistrimi dhe ju dha edhe çertifikata e pronësisë. Të njëjtin problem ka ngritur edhe shtetasi M.S. banues në Krujë, që ju bë i mundur regjistrimi i pasurisë së palujtëshme, njohur dhe kthyer fizikisht me vendim të KKK të Pronave, pasi plotësoi edhe proces verbalin e dorëzimit të truallit nga organi përkatës i pushtetit vendor. Veçojmë për nivelin e mirë të bashkëpunimit Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Palujtëshme në rrethin e Tiranës dhe të Vlorës duke marrë për kriter rastet e zgjidhura shpejt dhe thjeshtë vetëm në sajë të kërkesave tona. Edhe këtë vit, në asnjë rast të shqyrtuar, nuk ka rezultuar që veprimet ose mosveprimet për të cilat ankohen qytetarët, të kenë ardhur nga qëndrime dhe praktika abuzive të punonjësve të tyre ose për zbatim të gabuar të ligjit “Për regjistrimin e pasurive të palujtëshme” dhe të Rregullores të Brëndëshme të këtyre Zyrave. Të gjitha rastet e tjera, përveç atyre të përfunduara në favor të shtetasve, kanë rezultuar të pa bazuara ose jashtë juridiksionit tonë, pasi kanë qënë në vetvete konflikte pronësie që kërkojnë zgjidhje gjyqësore. Janë të pabazuara për faktin se thuajse të gjithë ankuesit konsiderojnë veprime korruptive dhe cënim të të drejtave të tyre, kur vihen në dijeni se pjesa e pronës që mendonin se ju rridhte nga trashëgimia, në sajë të veprimeve të tilla të trashëgimlënsve, që në të gjallë të tyre, me testament dhe kontrata dhurimi, kanë shprehur vullnetin për kalimin e pronësisë personave të veçantë ose në favor të një trashëgimtari, duke përjashtuar trashëgimtarët e tjerë nga kjo pronësi. Ndërsa pjesa që është vlerësuar jashtë kompetencave tona, por që përsëri ankuesit akuzojnë ZRPP se : “ju ka vjedhur ose tjetërsuar pronën e tyre në favor të personave të tretë”, nuk është gjë tjetër veçse bllokimi me të drejtë i pasurisë, pasi me vendim të KKK të Pronave, të Komisioneve të tokave ose me vendime gjyqësore të formës së prerë, janë krijuar mbivendosje pronash. Këto pasoja janë rrjedhim i veprimeve të nxituara të organeve të ngarkuara nga ligji për kalimin e pronësisë, të cilat pa bërë verifikimet e duhura japin, kthejnë në pronësi apo pjestojnë prona që pjesërisht apo tërësisht janë të regjistruara në emër të pronarëve të tjerë, duke krijuar në fakt një konflikt të ri pronësie. Edhe mos regjistrimin e oborrit funksional të banesave private, që siç duket do të vazhdojë edhe për disa vjet të tjerë për shkak të proceseve gjyqësore për fitimin e këtyre pasurive me parashkrimin fitues, nga ZRPP të rretheve në mungesë të akteve ligjore për fitimin e pronësisë, ankuesit i pretendojnë si të drejta të shkelura haptazi nga këto zyra, pasi sipas tyre kanë me dhjetra vjet që e shfrytëzojnë apo mbajnë këtë truall. Për të mos thënë se ka edhe raste kur

qytetarët blejnë banesa të paregjistruara ose të regjistruara me vërtetim gjyqësor të faktit, dhe mos regjistrimin e tyre dhe mos dhënien e certifikatës së pronësisë, pasi janë ndërtime të paligjeshme, e vlerësojnë si të qëllimshëm dhe me motive korruptive. Me këto konstatime, nuk kemi për qëllim mbrojtjen e veprimeve të ndonjë punonjësi të këtyre zyrave, që në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës të tyre, mundohen të përfitojnë materialisht nga personat që paraqiten në sportelet e ZRPP. Nëse do të konstatojmë ose do të konsatojmë raste të kësaj natyre, në asnjë rast nuk do të hezitohet dhe nuk do të na mungojë vullneti për të bërë kallzim penal pranë organit të akuzës, siç mund ta bëjë edhe çdo aplikues nëse konstaton se ka elementë të mitmarrjes, falsifikimit të dokumentave apo të shpërdorimit të detyrës

Siç e përmendëm edhe më lart, mos njohja e ligjit dhe mos përgatitja e dokumentave të duhura për regjistrimin fillestar të pasurive të palujtshme, janë shkaku kryesor që mosveprimet e ZRPP në rrethe, një pjesë e madhe e individëve t'i konsiderojnë shkelje të të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme.

55 ankesa kanë qënë të pabazuara, pasi regjistrimi nuk ju është bërë për shkak të mbivendosjes së pronave me njëra tjetrën dhe të mos pasjes së aktit të pronësisë për oborret funksionalë. Ankuesit janë orientuar rast pas rasti dhe j'u është sugjeruar forma dhe menyra e veprimeve që duhet të bëjnë, përfshirë edhe ndjekjen e rrugës gjyqësore për zgjidhjen e konflikteve të pronësisë në rastet e mbivendosjeve të pasurive, ose për fitimin e pronësisë së oborreve të banesave private me parashkrimin fitues. Një mangësi që sjell zvarritje në shqyrtimin e këtyre ankesave dhe keq kuptime në marrëdhëniet tona me ankuesit, megjithë premtimet e dhena për çdo vit nga Kryeregjistruesit, janë vonesat e pajustificuara në kthimin e përgjigjeve nga disa ZZPP në rrethe, që nuk respektojnë afatet ligjor në kthimin e përgjigjeve apo të ecurisë së rekomandimeve konkrete, duke shkelur Kodin e Proçedurave Administrative.

Problem i evidentuar dhe ngritur për trajtim edhe gjatë vitit 2005, ka qënë ai i hezitimit të pakuptueshëm të ndonjë Zyre të Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme për regjistrimin e pasurive të fituara me vendim gjyqësor të formës së prerë, duke shkelur haptazi të drejtat dhe interesat e ligjshme të individëve që kanë fituar gjyqësisht një të drejtë të shkelur.

Zyra qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme duhet të unifikojë sa më shpejt praktiken e Zyrave në vartësi të saj, për zbatimin e kërkesave të pikës 3 të nenit 142 të Kushtetutës që i detyron organet shtetërore të ekzekutojnë vendimet gjyqësore të formës së prerë. Çdo kontestim ndaj këtyre vendimeve gjyqësore, duhet bërë vetëm në rrugë gjyqësore, me anë të rishikimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, parashikuar në nenin 494 të Kodit të Proçedurës Civile. Në të kundërt, të

jene koshiente ne respektimin e pavaresise te pushtetit gjyqesor dhe te veprojne ne regjistrimin e tyre.

Po ashtu ka nevojë urgjente rishikimi i “Rregullores për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme” miratuar në vitin 1999 dhe me disa ndryshime të bëra në vitin 2000. Praktika më se dhjetë vjeçare e këtyre Zyrave, ka evidentuar raste të veçanta që nuk gjejnë zgjidhjen në këtë Rregullore, duke çuar në bllokimin e pronave dhe në shkeljen e të drejtave të ligjeshme të pronareve nëpërmjet mosdhënies të certifikatës së pronësisë. Fjala është për ato raste që kanë të bëjnë me kalimin nga hipoteka në Regjistrin e Pasurive të Palujtshme (regjistrimi fillestar) dhe përgatitjen e Kartelës së Pasurisë së Palujtshme, për banesat e ndërtruara para vitit 1974, që mund të kenë ndonjë mangësi jo esenciale në dokumentat hipotekore. Kështu, kur mungon për shëmbull leja e ndërtimit në hipotekë, por ndodhet vërtetimi i organeve shtetërore lokale, kompetente në bazë të legjislacionit të kohës për dhënien e lejes së ndërtimit, dhe kur mbi keto pasuri nuk ka pretendime pronësie nga persona të tretë ose mbivendosje, bën të domosdoshme saktësim dhe shtesa në Rregulloren e larpërmëndur, për zgjidhje në favor të aplikuesve. Në praktikën botërore, ku përvoja në këtë fushë është shumë më e madhe se tek ne, duke kalur provat apo testimet e kohës, ka shumë raste analoge që zgjidhen lehtë dhe shpejt në rrugë administrative.

Një problem tjetër i cili do një optikë më racionale, është ai i rritjes së shkallës së transparencës të ZRPP në marrëdhëniet dhe komunikimin e tyre me qytetarët. Forcimi i infrastrukturës së tyre, siç është rasti i përmiresimeve rrënjësore me ambientet e reja të funksionimit të ZRPP te rretheve Vlorë, Berat, etj, ku përveç të tjerave, është rritur ndjeshëm numuri i sporteleve dhe i juristëve që kontaktojnë direkt gjatë gjithë orarit zyrtar me aplikuesit, padyshim që, do t’u shërbejë më mirë nevojave të qytetareve dhe do të çojë në fund të fundit në rritjen e besimit të tyre ndaj këtyre “bankave të pasurive të palujtshme”.

Problem i madh dhe që mendojmë se duhet ndjekur me përparësi këtë vit, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, është përfundimi sa më shpejt i projektit të menaxhimit të këtyre pasurive nga Njësia e Menaxhimit të Projektit për Sistemin e Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme. Ka zona të tëra, sidomos rurale, që ende nuk kanë hyrë në sistem, nuk janë regjistruar në ZRPP të rretheve, duke u bërë kështu shqetësim i ligjshëm për pronarët në kufizimin që i bëhet tagrit kryesor të tyre, të drejtës për tjetërsimin e tyre. Nga ana tjetër, përfundimi sa më shpejt i këtij procesi do të ndikonte realisht në zgjerimin sa më eficient të tregut të pasurive të palujtshme. Në këtë sistem, për shkaqe të ndryshme, nuk janë regjistruar rreth 25% e pasurisë së palujtshme private ose shtetërore. Organet kompetente duhet të ballafaqohen më këtë problem për sigurimin e fondeve të nevojshme

për vazhdimin dhe përfundimin e projektit të menaxhimit në sistemin e regjistrimit.

Siç theksuam në fillim, për Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme ka patur dhe ka mjaft ankesa, të shoqëruara me akuza për korrupsion. Por nga paraqitja e mësipërme duket sikur nga ana jonë ato merren në mbrojtje. Duam të theksojmë, se ne nuk e përjashtojmë edhe korrupsionin e nëpunsave të këtyre Zyrave. Por siç shpjegojmë, burimet e ankesave shpesh herë janë veprime të organeve apo personave të organeve të tjera, që me dashje apo pakujdesi kryejnë veprime apo japin dokumenta që krijojnë konflikte për pronat. Zbardhja e këtyre veprimeve të parregullta ose korruptive, për shkak të kohës që ka kaluar, nuk është gjë e lehtë, për shkak edhe të amnistive të aplikuara, por edhe të mungesës së burimeve njerëzore që ka Zyra jonë.

3. Ankesat për pushtetin gjyqësor dhe administratën gjyqësore.

Institucioni i Avokatit të Popullit bashkë me gjykatat janë dy institucionet më të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ndihma e institucionit të Avokatit të Popullit i cili është jashtë gjyqësorit, luan një rol të rëndësishëm për rritjen e efikasitetit dhe besimit të publikut tek gjyqësori.

Në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, juridiksioni i Avokatit të Popullit në lidhje me gjyqësorin është i tillë që as prek dhe as rrezikon pavarësinë e gjyqtarëve në dhënien e vendimeve gjyqësore.

Nga praktika disa vjeçare del se ne kemi patur mirëkuptim, me gjyqësorin. Edhe në të ardhmen marrëdhëniet tona do vazhdojnë të jenë korrekte në këtë drejtim. Kjo sepse të gjithë jemi të interesuar që të realizohen e të respektohen me përpikmëri të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Avokati i Popullit në punën e tij gjatë verifikimit të ankesave dhe kërkesave, ka dhënë ndihmën e duhur në punën e gjykatave duke njoftuar në çdo rast Ministrin e Drejtësisë, apo Inspektoriatin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për shkelje të ndryshme proceduriale të konstatuara nga gjyqtarë të veçantë, si dhe për shkelje të ndryshme të kryera nga administrata e gjykatave.

Gjithashtu, Avokati i Popullit ndihmon edhe duke kërkuar që administrata shtetërore, të zbatojë patjetër vendimet gjyqësore, kur ato kanë marrë formë të prerë. Në këtë mënyrë ne ndihmojmë që të rritet autoriteti i pushtetit gjyqësor ndaj degës së ekzekutivit, e cila ka treguar sidomos deri para shtatorit me qëndrimet e saj se nënvlerëson fuqinë e vendimeve gjyqësore duke i bërë në këtë mënyrë një dëm të madh moral dhe ekonomik shtetit të së drejtës.

Avokati i Popullit gjatë këtyre 6 viteve, ka patur akses të kufizuar në gjykatë, në asnjë rast ai nuk ka prekur apo cënuar pavarësinë e gjyqësorit.

Kuvendi i Shqipërisë me ligjin Nr.9398 dt.12.05.2005 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ndryshuar me ligjin Nr.8600 dt.10.04.2000, ka parashikuar disa të drejta dhe kompetenca të tjera të reja në funksion të forcimit të veprimtarisë së tij. Këto shtesa dhe ndryshime u bënë duke u bazuar në eksperiencën e fituar dhe përvojën e mirë të Ombudsmanëve të vendeve të tjera, në mënyrë të veçantë të Ombudsmanit të Polonisë.

Tani në paragrafin e fundit të nenit 25 të këtij ligji parashikohet se: “Avokati i Popullit pranon, ankesa, kërkesa ose njoftime për shkeljen e të drejtave të njeriut që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë dhe procedurat gjyqësore.

Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prek pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimeve.”

Në ligjin ekzistues me Nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” institucioni ynë kishte pengesë ligjore për pranimin e ankesave dhe kërkesave ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe si të tilla ato janë refuzuar. Ndërsa me këto ndryshime të ligjit ne jemi të detyruar për ti pranuar ato në çdo rast. Tani del problemi se cili do të jetë mjeti ligjor i reagimit të Avokatit të Popullit ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Për zgjidhjen e këtij problemi është e nevojshme që të bëhen disa shtesa dhe plotësime të domosdoshme dhe urgjente si në Kodin e Procedurës Penale ashtu edhe në Kodin e Procedurës Civile nga Parlamenti. Problemin ja kemi shtruar Kuvendit dhe Qeverisë të cilët duhet të marrin inisiativën legislative.

1. Ankesat për Gjykatat.

Gjatë vitit 2005, ndaj gjykatave kanë ardhur për shqyrtim gjithsej 388 ankesa, nga të cilat 199 prej tyre kanë qënë kundra vendimeve gjyqësore dhe si të tilla ato janë refuzuar sepse kanë qënë jashtë juridiksionit tonë.

Por 189 ankesa të tjera, duke i analizuar ato sipas objektit të tyre, del se kanë qënë në këto drejtime dhe për këto probleme :

- Personat ankohen për zvarritje pa arsye të justifikuara dhe pa shkaqe ligjore të gjykimeve nga gjykatat për çështje të ndryshme në fushën penale ose civile.

- Kërkohet ndihma e Avokatit të Popullit për të përfaqësuar palët ndërgjyqësore në shkallët më të larta gjyqësore, mbasi ato nuk kanë të ardhura dhe mundësi ekonomike për të marrë e paguar avokat mbrojtës privat.

- Shtetasit ankohen sidomos për rastet e gjykimeve në mungesë nga gjykata me arsytim se atyre u ka kaluar afati i ankimit, si rezultat i mos komunikimit të vendimeve gjyqësore dhe ndonëse ato i drejtohen gjykatave me kërkesë për rivendosje në afat, ato u rrëzohen nga gjykata si të pa bazuara.

- Ankesa për qëndrime dhe veprime të njëanshme të gjyqtarëve të veçantë gjatë gjykimeve të çështjeve të ndryshme në fushën penale ose civile dhe kërkohet ndihma e Avokatit të Popullit për përjashtimin e tyre nga gjykimi i këtyre çështjeve.

- Ankesa ndaj vendimeve gjyqësore dhe kërkohet ndihma e Avokatit të Popullit për pezullimin e tyre derisa të përfundojë shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë.

- Ankesa ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë kur ato kanë zbuluar prova të reja shpresore, dhe kërkohet ndihma e Avokatit të Popullit për t'ju drejtuar me kërkesë për rishikim vendimi, Gjykatës së Lartë.

- Ankesa ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë duke pretenduar se nga gjykatat nuk janë respektuar të gjitha kërkesat për një proces jo të rregullt ligjor dhe kërkohet ndihma e tij që çështja e tyre të dërgohet për gjykim në Gjykatën Kushtetuese, që vendimet gjyqësore të shpallen antikushtetuese.

- Ankesa ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë të gjykatave, për të cilat janë ezauruar të gjitha mjetet e ankimit, duke përfshirë edhe gjykimin kushtetues dhe kërkohet ndihma ligjore për ta dërguar çështjen për gjykim në Gjykatën e Strasburgut.

- Ankesa ndaj vendimeve gjyqësore për masa dënimi të rënda dhe është kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit në Gjykatën e Apelit ose në Gjykatën e Lartë, me qëllim që ndaj tyre të zbatohet *Amicus Curiae* (miku i gjykatës).

- Ankesa për zvarritje të padrejta nga administratat e gjykatave për vonesa në dërgimin e dosjeve për gjykim në Gjykatat e Apelit apo në Gjykatën e Lartë dhe anasjelltas.

- Ankesa të tjera se ndonëse kanë kërkuar kopje vendimi gjyqësor ato nuk u jepen nga administrata gjyqësore.

- Përsëri kanë ardhur ankesa nga familjarët e viktimave të cilët ankohen ndaj gjykatave ose gjyqtarëve të veçantë se ndaj autorëve të krimit sidomos për vrasje, janë dhënë masa dënimi të buta si rezultat i veprimeve të hapura korruptive.

- Ankesa kanë ardhur edhe ndaj gjyqtarëve të veçantë të Gjykatave të rretheve apo të Gjykatave të Apelit dhe kërkohet që ndaj tyre të fillohet procedimi disiplinor nga Ministri i Drejtësisë, për shkelje të ndryshme në kryerjen e detyrës së tyre dhe për korrupsion.

Është pozitiv fakti se gjatë vitit 2005 nga ankesat e ardhura ndaj gjykatave në 40 raste, ato janë zgjidhur në favor të ankuesve.

a) Ankesat e ardhura ndaj Gjykatave të Rretheve Gjyqësore

Nga 388 ankesa të ardhura gjithsej për vitin 2005, ndaj Gjykatës së Shkallës së Parë kanë ardhur gjithsej 230 ankesa.

Në shumicën e rasteve ka rezultuar se ankuesit nuk kanë patur të drejtë mbasi gjyqtarët e akuzuar për shkelje kanë bërë “ kujdes “ që nga ana ligjore të mos vërtetohet ndonjë shkelje e ligjeve.

Ja disa nga rastet e ankesave ndaj gjykatave që janë zgjidhur në favor gjatë këtij viti :

1.Në ankesën e tij shtetasi G.A. nga Tirana, është ankuar se djali i tij, G.A. ka 2 vjet që mbahet i arrestuar dhe është dënuar padrejtësisht me 8 vjet burgim nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, për veprën penale të vjedhjes me armë.

Gjatë këtij gjykimi ankuesi ka pretenduar se në vendin e ngjarjes janë gjetur dhe fiksuar edhe gjurmë gishtash të identifikuara që nuk dalin të djalit tij, por të një personi tjetër dhe konkretisht të shtetasit Sh.N. i cili ndodhej i arrestuar dhe po gjykohej nga Gjykata e rrethit Tiranë, midis të tjerave edhe për akuzën e vjedhjes me armë që akuzohej djali i tij.nga studimi i dosjes se vendimi gjyqësor ishte tepër i dyshimtë dhe i pa argumentuar në prova, prandaj, u ndërhy në organet kompetente për një zgjidhje sa më të drejtë dhe të shpejtë të saj.

Duke qënë se dosja ndodhej për gjykim në Gjykatën e Lartë, asaj ju bë rekomandim për shpejtim gjykimi si dhe që nga ana e saj të mbahen parasysh gjatë gjykimit të çështjes rrethanat e reja të zbuluara për zgjidhjen sa më drejtë të çështjes në themel.

Gjykata e Lartë me vendimin Nr.719 dt.20.10.2005 vendosi prishjen e vendimit nr.19 dt.13.12.2004 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, dhe kthimin e çështjes për për rigjykim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, me vendimin nr.55 dt.13.12.2005 vendosi prishjen e vendimit nr.16 dt.05.07.2004, të Gjykatës për Krimet e Rënda Tiranë, dhe pushimin e çështjes ndaj të pandehurit G.A, mbasi nuk vërtetohet fajësia e tij duke urdhëruar lirimin e tij të menjëhershëm nga salla e gjyqit.Rivendosja e drejtësisë në këtë rast është një sukses i madh.

2. Në ankesën e tij shtetasi F.L. nga rrethi i Mirditës, është ankuar ndaj Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila zvarrit pa shkaqe ligjore gjykimin e një çështje penale ndaj vëllait tij Z.L, midis të tjerave në lidhje me shqyrtimin e kërkesën së tij për shuarjen e masës së sigurimit me arrest në burg, mbasi i kanë kaluar të gjitha afatet ligjore të paraburgimit.

Nga ana e kësaj gjykate u vlerësua kërkesa jonë dhe u bë e mundur shpejtimi i këtij gjykimi dhe zgjidhja e problemit sipas kërkesave të ligjit.

3. Në ankesën e tij shtetasi S.Ç. nga rrethi i Durrësit është ankuar se djali i tij R.Ç. është dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, me 25 vjet burgim, vendim i cili është prishur si i pa bazuar në ligj nga Gjykata e Apelit Durrës. Ai parashtron gjithashtu, se ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, ka ushtruar rekurs Prokurori i Apelit dhe Gjykata e Lartë po zvarrit gjykimin e çështjes duke patur parasysht faktin se atij i ka kaluar afati ligjor i paraburgimit, dhe për rrjedhojë masa e sigurimit me arrest në burg duhej shuar. Mbi ndërhyrjen tonë u arrit shpejtimi i këtij gjykimi.

4. Në ankesën e tij shtetasi P.B. nga qyteti i Tiranës është ankuar ndaj Gjykatës së rrethit Tiranë, e cila po gjykon një çështje penale në mungesë ndaj vajzës së saj S.B, pa i siguruar një avokat mbrojtës për mbrojtjen e të drejtave të saj të ligjshme gjatë gjykimin.

Nga verifikimi ynë rezultoi se gjykata i ka caktuar asaj një avokate kryesisht. Por në datën e gjykimin të çështjes, ajo nuk ishte paraqitur për shkaqe ligjore dhe gjykata kishte caktuar një datë tjetër për gjykimin e saj, për të siguruar pjesmarrjen e avokates mbrojtëse në gjykim.

Në përfundim u bë e mundur që, mbas ndërhyrjes tonë, nga Gjykata e rrethit u muarën të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e avokatit privat mbrojtës të gjykuarës në mungesë.

5. Në ankesën e tij shtetasi S.Xh. nga rrethi i Bulqizës është ankuar për zvarritje të pajustificuara në gjykimin e një çështje penale nga Gjykata e rrethit Bulqizë. Nga verifikimi ynë rezultoj se ankuesi i është shmangur hetimit dhe gjykimin të çështjes duke u larguar jashtë shtetit në Itali. Prandaj procedimi penal ndaj ankuesit është dërguar për gjykim në mungesë në Gjykatën e rrethit Bulqizë.

Gjykata e rrethit Bulqizë, mbasi ka studjuar fashikullin e dosjes ka vendosur kthimin e çështjes për plotësim hetimesh përsëri Organit të Prokurorisë. Organi i Prokurorisë ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore në mungesë të ankuesit, në praninë e avokatit të caktuar kryesisht, por nuk e ka dërguar akoma për gjykim në gjykatë pasi po kryen edhe disa veprime të tjera hetimore.

6. Në ankesën e tij shtetasi F.K. nga rrethi i Fierit është ankuar ndaj Gjykatës së rrethit Fier, për zvarritje pa shkaqe ligjore në gjykimin e një çështje penale ndaj djalit të tij E.K. Mbi ndërhyrjen tonë u bë e mundur që nga ana e kësaj gjykate të merren të gjitha masat e nevojshme jo vetëm për shpejtimin e gjykimin të kësaj çështje, por edhe për përfundimin e saj. Raste të tilla janë të shumta.

7. Në ankesën e tij shtetasi A.B. nga Kosova është ankuar ndaj Gjykatës së rrethit Vlorë, e cila zvarrit pa shkaqe ligjore gjykimin e një çështje civile me objekt, lënien e fëmijës së tij për rritje dhe edukim.

Nga ndërhyrja e jonë u bë e mundur jo vetëm shpejtimi i këtij gjykimi, por edhe përfundimi i saj duke u vendosur zgjidhja e çështjes në favor të ankuesit.

8. Në ankesën e saj shtetësja D.D. nga qyteti i Tiranës, është ankuar midis të tjerave ndaj Gjykatës së rrethit Lezhë, e cila në kundërshtim me kërkesat e ligjës procedurale civile ka vendosur gjykimin e një çështje civile të vajzës saj, me objekt zgjidhje martesë, e cila aktualisht ndodhet e sëmurë e shtruar në Spital në Tiranë. Ankuesja pretendoi se vajza e saj ka lejen e banimit në Tiranë dhe atje mund të gjykohej edhe çështja.

Mbi ndërhyrjen tonë u bë e mundur që gjykata ta analizojë më drejtë problemin duke u bazuar në kërkesat e Kodit të Proçedurës Civile dhe në përfundim vendosi deklarin e moskompetencës së gjyimit të çështjes dhe dërgimin e dosjes për gjykim në Gjykatën e rrethit Tiranë.

9. Në ankesën e saj shtetasi K.K. nga rrethi i Beratit është ankuar ndaj Gjykatës së Apelit Vlorë, për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjyimit të një çështje civile nga viti 2003.

Nga verifikimi ynë rezultoj se avokati i palës së paditur i ka kërkuar Gjykatës së Apelit Vlorë, pezullimin e gjyimit të kësaj çështje derisa të përfundojë një çështje tjetër, e cila ishte në gjykim po nga Gjykata e Apelit Vlorë.

Gjatë gjyimit të kësaj çështje është konstatuar se gjyqtari relator i kësaj çështje, ka marrë pjesë në gjykimin e një çështje tjetër me objekt detyrim për njohje pronësie dhe ka bërë heqje dorë nga gjykimi i kësaj çështje. Në përfundim me vendimin nr.36 dt.21.01.2005 Gjykata e Apelit Vlorë, ka vendosur përfundimin e gjyimit të kësaj çështje.

10. Në ankesën e tij shtetasi Sh.T. nga qyteti i Tiranë ankohet ndaj Gjykatës së rrethit Tiranë, e cila ka gjykuar një çështje penale ndaj M.M. ku ankuesi si përfaqësues i shoqatës që përfaqëson ka ngritur padi civile në proçesin penal, dhe gjykata ka vendosur rrëzimin e saj.

Ankuesi ka bërë ankim ndaj këtij vendimi dhe administrata e gjykatës nuk pranon të dërgojë dosjen për gjykim në Gjykatën e Apelit. Mbi ndërhyrjen tonë u bë e mundur pregatitja e dosjes, komunikimi i ankimit dhe dosja u dërgua për gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

11. Në ankesën e saj shtetësja D.D. nga qyteti i Durrësit është ankuar ndaj Gjykatës së Lartë, se megjithse ajo kishte përfunduar gjykimin e një çështje civile, pa shkaqe ligjore nuk i jepej një kopje vendimi gjyqësor për ta kundërshtuar atë në Gjykatën Kushtetuese, për një proçes jo të rregullt ligjor.

Mbi ndërhyrjen tonë u bë e mundur plotësimi i kësaj kërkesë mbasi shkaku i mos dhënies së vendimit gjyqësor ishte se ai nuk ishte firmosur nga një prej gjyqtarëve, pra për shkaqe teknike sepse ai, ndodhej me shërbim jashtë shtetit.

12. Në ankesën e tij shtetasi B.B. i dënuar në burgun e Krujës, është ankuar se megjithëse kishte kërkuar disa herë një kopje vendimi gjyqësor nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me të cilin ai është dënuar me 10 vjet burgim për veprën penale të vrasjes me dashje, ai nuk i jepej.

Ankuesi ka pretenduar se vendimi nuk i jepej pa shkaqe ligjore nga administrata gjyqësore dhe ai e kërkonte atë, për të ushtruar kërkesë për rishikim vendimi në Gjykatën e Lartë. Mbi ndërhyrjen tonë u bë e mundur sigurimi i kopjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe nga ana tjetër ankuesi u orjentua të kërkonte ndihmën e një avokati mbrojtës privat, për përgatitjen e kërkesës dhe të dokumentave të nevojshme dhe për të bërë edhe mbrojtjen e tij në gjykatë.

13. Në ankesën e tij shtetasi Z.Gj. nga rrethi i Kurbinut është ankuar për zvarritje pa shkaqe ligjore, ndaj Gjykatës rrethit Kurbin për gjykimin e një çështje civile.

Nga verifikimi ynë rezultoj se çështja e tij është rregjistruar në gjykatë me dt.09.11.2004 dhe ka përfunduar së gjykuari me vendimin Nr.31 dt.16.06.2005 ku ishte vendosur pushimi i gjykimit të çështjes.

Nga ana e jonë ankuesi u sqarua për rrugët ligjore si të ankimit të saj në shkallët më të larta të gjykimit, ashtu edhe atë të vënies në lëvizje të kësaj çështje, duke hartuar një kërkesë padi të re.

14. Në ankesën e tij shtetasi V.T. nga qyteti i Durrësit është ankuar se megjithëse kishte kërkuar dy kopje vendimi gjyqësor nga Gjykata e Apelit Durrës, ato nuk i jepeshin atij pa shkaqe ligjore nga administrata e asaj gjykate. Nga ana e jonë ju kërkuan shpjegime kësaj gjykate si dhe kopjet e vendimeve gjyqësore. Nga ana e saj na u kthye përgjigje si dhe na u dërguan edhe kopjet e vendimeve gjyqësore të kërkuara.

Në disa ankesa të ardhura nga familjarët e viktimave të cilët kanë qënë të revoltuar dhe janë ankuar për veprime korruptive të gjyqtarëve të veçantë të Gjykatave të rrethit dhe të Gjykatave të Apelit.

Në këto raste nga ana e jonë në zbatim të kërkesave të nenit 17/b të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ankesat së bashku me dokumentat përkatëse i janë dërguar për shqyrtim organit kompetent, Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në këto ankesa bëhet fjalë se gjyqtarë të veçantë gjatë kryerjes së detyrës së tyre, janë treguar të njëanshëm dhe jo objektiv, duke dhënë dënime të buta, në saj të veprimeve të hapura korruptive.

Po kështu në disa raste të tjera ankuesit, duke qënë të mërzhitur nga tejzgjatja e proceseve gjyqësore nga njëra shkallë e gjykimit në tjetrën nuk binden me përgjigjen tonë, sidomos me arsyetimin se vendimet gjyqësore janë jashtë juridiksionit tonë. Ankuesit në përgjithësi këmbëngulin se Avokati i Popullit duhet që të bëjë patjetër vlerësimin e vendimeve gjyqësore, mbasi ato në disa raste janë hapur të padrejtë.

Ato paraqesin tek ne edhe dokumenta apo prova të tjera shkresore me të cilët kërkojnë të na bindin me çdo kusht se ato kanë të drejtë, por kjo e drejtë atyre nuk u jepet nga gjykatat, mbasi ato janë të korruptuara.

Në lidhje me ankesat e ardhura gjatë kësaj periudhe ne kemi bërë sqarimet e duhura, se për vendimet gjyqësore nuk mund të ndërhyhet nga ne derisa, të bëhen ndryshimet përkatëse në Kodin e Proçedurës Penale ashtu edhe në Kodin e Proçedurës Civile, nga Kuvendi i Shqipërisë.

Pra institucioni ynë për momentin nuk mund të reagojë ndaj një vendimi gjyqësor të formës së prerë, për ta vlerësuar atë nëse është ose jo i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Në lidhje me problemet e zvarritjeve të gjykimeve për çështje penale, del nevoja e rishqyrtimit të dispozitave në Kodin e Proçedurës Penale, me synim shkurtimin e afateve si të hetimit, ashtu edhe të gjykimit. Kjo sepse në afatet ekzistuese lihet shteg për abuzim nga punonjës të veçantë, si nga organi i proçedimit penal, ashtu edhe nga gjykatat gjatë gjykimit të tyre. Për afatet e hetimit dhe gjykimit ka vend të bëhet një studim duke patur parasysh kohën kur kodet është miratuar, me qëllim rishikimin e tyre për të ardhmen mbasi zvarritja e gjykimeve cënon direkt të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Edhe në drejtim të zvarritjeve të gjykimeve civile ka vend që duke u bazuar në ankesat e ardhura tek Avokati i Popullit dhe shkaqet e tyre të bëhen propozimet e nevojshme për ndryshim ligji duke përcaktuar afate të tjera më të arsyeshme gjykimi. Për një ulje të ndjeshme të zvarritjeve të gjykimeve ka vend të rishikohen edhe kompetencat e gjykimit të çështjeve të ndryshme nga me 3 gjyqtarë të bëhen me 1 gjyqtar. Kjo duke patur parasysh se gjyqtarët e një gjykate shpesh janë konsumuar dhe për zgjidhjen e çështjes me vendim të KLD-së komandohen ose caktohen gjyqtarë nga rrethet e tjera.

b) Ankesat ndaj Gjykatave të Apelit

Gjatë vitit 2005, ndaj Gjykatave të Apelit kanë ardhur gjithsej 74 raste. Vendin kryesor të këtyre ankesave e zënë ato me objekt kundërshtim vendimi gjyqësor për të cilat, kemi vendosur refuzimin e tyre mbasi ato kanë qënë jashtë juridiksionit tonë. Në këtë drejtim gjatë këtij viti kanë ardhur 52 raste.

Për 22 raste të tjera ankesat kanë patur si objekt shkelje të ndryshme proçedure, shpejtim gjykimi, zvarritje të padrejta të gjykimeve, ose janë kërkuar kopje vendimi nga gjykata për të ushtruar rekurs brenda afatit ligjor, për vonesa të padrejta në drejtim të dërgimit të dosjeve për gjykim, etj.

1. Shtetasi M.L. nga qyteti i Lezhës është ankuar ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit të Gjykatës së Rrethit Lezhë. Nga ankuesi është kërkuar ndihma

jonë për ta përfaqësuar gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe të vendoset pezullimi i ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Nga ana e jonë janë bërë sqarimet e nevojshme se institucioni ynë nuk ka të drejtë të përfaqësoj palët në gjykim dhe nga ana tjetër ne nuk kemi të drejtë, të vendosim pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Në këtë drejtim ne kemi orjentuar ankuesin që të marrë avokat privat për mbrojtjen e tij dhe nga ana tjetër t'i drejtohet me një ankesë të veçantë Gjykatës së Lartë me të cilën t'i kërkojë asaj pezullimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

2. Shtetësja N.Z. nga qyteti i Gramshit është ankuar ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, e cila ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së rrethit Gramsh, duke e deklaruar atë fajtores për veprën penale të rrahjes dhe dënimit e saj me gjobë.

Po kështu ajo ka kërkuar nga ana e jonë që të ndërhyhet për anulimin e ekzekutimit të vendimit mbasi, Prokurori i çështjes ka lëshuar menjëherë urdhërin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, për Zyrën e Përmbarimit Gramsh, kjo ka njoftuar se në rast se nuk paguan dënimin e dhënë me gjobë, do propozojë që ndaj ankuses të vendoset zevendësimi i këtij dënimi nga me gjobë, me burgim.

Nga ana e jonë janë bërë sqarimet e nevojshme ligjore dhe është orientuar ankuesja që për pezullimin e ekzekutimit të vendimit t'i drejtohet Gjykatës së Lartë, me rekurs ndaj vendimeve gjyqësore.

3. Shtetasi Sh.N. nga fshati Baz i rrethit Mat, është ankuar ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit të Gjykatës së rrethit duke kërkuar përfaqësimin e Avokatit të Popullit, gjatë gjykimit të kësaj çështje në Gjykatën e Lartë.

Nga ana e jonë ankuesit i janë bërë sqarimet e nevojshme se për përfaqësimin e tij në Gjykatën e Lartë, ai duhet që të sigurojë ndihmën e një avokati mbrojtës privat, mbasi ligji "Për Avokatin e Popullit" nuk i jep të drejtë që të përfaqësojë direkt palët në proceset e tyre gjyqësore.

4. Shtetasi P.P. nga qyteti i Fierit është ankuar ndaj Vendimit të Gjykatës Apelit Vlorë, me të cilin është vendosur ndryshimi i vendimit të Gjykatës së rrethit Fier, dhe rrëzimin e kërkesës tij si e pa bazuar në ligj.

Ankuesi pretendon se Gjykata e Apelit Vlorë, në gjykimin e kësaj çështje ka kryer shkelje të rënda proceduriale që kanë sjell për pasojë humbjen e të drejtave të tij të pronësisë.

Nga verifikimi ynë rezultoi se me vendimin Nr.906 dt.26.05.2005 të Gjykatës së Lartë, është vendosur lënia në fuqi e vendimit Nr.71 dt.02.03.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Nga ana e jonë ankuesi është sqaruar se nga ana e jonë nuk mund të ndërhyhet për prishjen e vendimeve gjyqësore. Por nga ana tjetër ai është orientuar t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duke argumentuar se përse ndaj tij gjykatat gjatë zhvillimit të gjykimit të kësaj çështje civile kanë zhvilluar një proces të parregullt ligjor.

5. Në ankesën e saj shtetësja H.H. nga qyteti i Tiranës është ankuar ndaj Gjykatës së Apelit Tiranë, duke pretenduar se nga ana e saj ka një zvarritje të gjatë dhe të pajustificuar në gjykimin e një çështje civile.

Nga ana e jonë u bë ndërhyrja e nevojshme në Gjykatën e Apelit duke kërkuar mundësinë e shpejtimit të kësaj çështje. Gjykata mbasi analizoi shkaqet e paraqitura nga ankuesja, vendosi shpejtimin e gjykimit të kësaj çështje.

6. Në ankesën e tij shtetasi S.D. nga qyteti i Tiranës është ankuar ndaj Gjykatës së Apelit Korçë, e cila pa shkaqe ligjore zvarrit dërgimin e një dosje civile për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Nga verifikimi ynë rezultoi se gjykimi i kësaj çështje është zhvilluar në mungesë të palëve dhe gjykata ka vendosur komunikimin e vendimit. Nga ana tjetër mbasi janë bërë rekursat dhe kundrerekursat ndaj vendimeve gjyqësore, janë bërë edhe komunikimet e tyre palëve ndërgjyqësore.

c) Ankesa drejtuar Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë

Nga Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2005, i janë përcjellë për trajtim Këshillit të Lartë të Drejtësisë 27 ankesa të shtetasve dhe subjekteve të tjera.

Inspektoriatit i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në zbatim të Ligjit Nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, neni 16, pika 1, gërma “a”, në konsideratë dhe të përcaktimeve të Ligjit Nr.8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 41, ka trajtuar dhe është në proces e sipër verifikimi të ankesave të përmendura më lart.

Rezulton që të ketë përfunduar trajtimi i 18 ankesave, si më poshtë:

1. Ankesa e shtetasit Ilirjan Dida, ku në përfundim të trajtimit është konkluduar se nuk kishte vend për verifikim disiplinor të rastit që lidhej me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

2. Ankesa e shtetasit Marketin Topallaj, ku në përfundim të verifikimit është konkluduar se nuk kishte më vend për verifikim disiplinor të rastit që lidhej me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Farije Budo.

3. Ankesa e shtetasit Kol Deda, ku në përfundim të verifikimit është konkluduar se nuk kishte më vend për verifikim disiplinor të rastit që lidhej me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Parashqevi Ademi.

4. Ankesa e shtetasit Aleko Afezulli, ku në përfundim të verifikimit është konkluduar se nuk kishte më vend për verifikim disiplinor të rastit

që lidhej me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gerd Hoxha.

5. Ankesa e shtetasit Krenar Haxhi, ku në përfundim të verifikimit është konkluduar se nuk kishte më vend për verifikim disiplinor të rastit që lidhej me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Enkelejda Kashuri.

6. Ankesa e shtetasës Dallandshe Spahiu, ku në përfundim të verifikimit është konkluduar se nuk kishte më vend për verifikim disiplinor të rastit që lidhej me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, Nazmi Troka dhe se ajo veprimtari gjyqësore e atij gjyqtari do të merrej në konsideratë në kuadrin e vlerësimit profesional të tij.

7. Ankesa e shtetasit Veli Demaliaj, ku në përfundim të verifikimit është konkluduar se nuk kishte më vend për verifikim disiplinor të rastit që lidhej me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Vjollca Spahiu, duke i sugjeruar ankuesit që nëse dispononte prova që vërtetojnë atë fakt të pretenduar nga ai për veprime korruptive të gjyqtarës, ankesën, kallëzimin, t'ia paraqiste institucionit të prokurorisë, që është autoriteti i vetëm shtetëror për ushtrimin e ndjekjes penale.

8. Ankesa e shtetasit Simon Duka, ku në përfundim të verifikimit është konkluduar se nuk kishte më vend për verifikim disiplinor të rastit që lidhej me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Rasim Doda dhe se ajo veprimtari gjyqësore e atij gjyqtari do të merrej në konsideratë në kuadrin e vlerësimit profesional të tij.

9. Ankesa e shtetasës Fabiona Lukaj, ku në përfundim të verifikimit është konkluduar se nuk ekzistonin të dhëna të mjaftueshme për të inicuar fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Aleks Nikolli.

10. Ankesa e shtetasës Ismete Masmuça, ku në përfundim të verifikimit është konkluduar se nuk kishte më vend për verifikim disiplinor të rastit që lidhej me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Artur Kalaja.

11. Ankesa e shtetasit Mark Pepkolaj, ku është konkluduar se trajtimi i saj ndaj veprimtarisë së përmbaruesve dilte tej detyrave funksionale të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

12. Ankesa e shtetasit Rauf Shehu, ku në përfundim të verifikimit është konkluduar se nuk kishte më vend për verifikim disiplinor të rastit që lidhej me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke i sugjeruar ankuesit që nëse dispononte prova që vërtetojnë atë fakt të pretenduar nga ai për veprime korruptive të gjyqtarëve, ankesën, kallëzimin, t'ia

paraqiste institucionit të prokurorisë, që është autoriteti i vetëm shtetëror për ushtrimin e ndjekjes penale.

13. Ankesa e shtetasit Eqerem Mehmeti, ku në përfundim të verifikimit është konkluduar se nuk kishte më vend për verifikim disiplinor të rastit që lidhej me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Gazmend Begaj.

14. Ankesa e shtetasit Ferit Koçi, ku në përfundim të verifikimit është konkluduar se nuk ekzistonin të dhëna të mjaftueshme për të inicuar fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, Arjan Qafa.

15. Ankesa e shtetases Banu Salibasha, ku në përfundim të verifikimit është konkluduar se nuk kishte më vend për verifikim disiplinor të rastit që lidhej me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Zihni Shahu, duke iu dërguar materialet përkatëse për trajtim Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Dhomës së Avokatisë Elbasan, kur është vlerësuar se rasti lidhej me etikën profesionale të avokatit Gëzim Kovaçi.

16. Ankesa e shtetasit Jani Xhumari, etj, ku në përfundim të verifikimit paraprak është konkluduar që ajo veprimtari gjyqësore në atë rast e gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Elona Stavri, të merret në konsideratë në rastin e vlerësimit të konstatimeve të bëra për atë gjyqtare nga kontrolli i përgjithshëm i ushtruar në këtë gjykatë.

17. Ankesa e shtetasit Maliq Hoxha, ku në përfundim të verifikimit paraprak është konkluduar dhe tërhequr me shkrim vëmendja gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, Tritan Hamitaj, për mospërfundimin në një kohë të arsyeshme të gjykimit, ndërkohë që rasti do të vazhdojë të verifikohet dhe më tej deri në përfundim të atij gjykimi.

18. Ankesa e shtetases Fatmira Polo, e verifikuar gjatë vitit 2004, ku në përfundim të atij verifikimi është konkluduar se nuk kishte më vend për verifikim disiplinor të rastit që lidhej me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Klodiana Gjyzari.

Gjithashtu, rezulton që të jenë në trajtim e sipër 9 ankesa, si më poshtë:

1. Problematika e ngritur mbi shqetësimin e subjektit, Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, lidhur me trajtimin e zgjidhjen nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të konflikteve gjyqësore midis këtij subjekti dhe Shoqërive “Vodafone” dhe “AMC”, ku verifikimi nuk ka përfunduar ende për shkak se disa nga ato raste gjyqësore janë për trajtim para Gjykatës së Apelit Tiranë dhe, për të konkluduar rreth respektimit të ligjit nga gjyqtarët e gjykatës së shkallës së parë është vlerësuar i domosdoshëm përfundimi paraprakisht i kontrolleve gjyqësore për ato raste.

2. Ankesa e shtetasit Agron Kabili ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, trajtimi i të cilës është në momentet përfundimtare të vlerësimit.

3. Ankesa e shtetasit Kadri Hoti ndaj çështjeve të pasurisë së deklaruar nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe që lidhet me veprimtarinë e tyre gjyqësore të realizuar në vitin 1996, po trajtohet për identifikimin dhe evidentimin e të dhënave të vlefshme për kontrollin që mund të ushtrohet nga Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

4. Ankesa e shtetasit Novruz Veizi ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, Sotira Nako, verifikimi i të cilës është në proces e sipër në rrethanat kur ai proces gjyqësor nuk kishte përfunduar.

5. Ankesa e shtetasit Muharrem Jakupi ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Guxim Boci dhe Desart Avdullaj, verifikimi i të cilës është në proces e sipër në rrethanat kur ai proces gjyqësor nuk kishte përfunduar.

6. Ankesa e shtetasit Mark Bobnaj ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Hasan Selimi, trajtimi i të cilës është në momentet përfundimtare të vlerësimit.

7. Ankesa e shtetasit Selaudin Maxhuni ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës, është në momentet e para të verifikimit kur ankesa ka mbërritur në fund të muajit dhjetor 2005.

8. Ankesa e shtetasit Kujtim Plangarica ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Bujar Musta, porsa ka filluar verifikimi kur ankesa ka mbërritur në fund të muajit dhjetor 2005.

9. Ankesa e shtetasës Prene Sefgjini ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Gramoz Levanaj, porsa ka filluar verifikimi kur ankesa ka mbërritur në fund të muajit dhjetor 2005.

d) Ankesat ndaj Gjykatës së Lartë

Dihet se Gjykata e Lartë nuk ka lidhje vartësie nga Ministria e Drejtësisë, por ne e kemi radhitur në këtë kre, për shkak të problemeve që ngrenë shtetasit për këtë gjykatë, që janë pothuaj të njëjlojta me ato që ngrenë edhe për gjykatat më të ulta.

Në vitin 2005, kundër Gjykatës së Lartë kanë ardhur gjithsej 30 ankesa. Në 18 raste ankesat kanë qënë kundra vendimeve të Gjykatës së Lartë. Nga ana e jonë janë bërë sqarimet e nevojshme duke i orientuar ankuesit që në rast se kanë argumenta ligjore që ndaj tyre nuk është zhvilluar nga gjykatat një proces i rregullt ligjor, mund t'i drejtohen me kërkesë Gjykatës Kushtetuese.

Në 6 raste ankesat kanë qënë për shpejtim gjykimi dhe në 2 raste ankusit kanë kërkuar kopje vendimi gjyqësor.

Ja disa nga rastet e ankesave të paraqitura gjatë vitit 2005, në Gjykatën e Lartë :

1. Shtetasi N.B. nga qyteti i Durrësit është ankuar ndaj vendimit Nr.640 dt.26.09.2005 të Kolegjit Penal Gjykatës së Lartë me të cilin është vendosur ndryshimi i vendimit penal të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe Gjykatës së Apelit Durrës, duke shfuqizuar aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal për pezullimin e ekzekutimit të pjesës së pavuajtur të dënimit me burgim për djalin e tij të mitur E.B. dhe lënien në fuqi të vendimeve të gjykatave për dënimin e tij me 2 vjet burgim.

Nga ana e jonë janë bërë sqarimet e nevojshme se ne si institucion nuk mund të ndërhyjmë për prishjen e vendimeve gjyqësore. Por ankuesi mund t'i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, në rast se ka argumenta se gjykatat ndaj djalit të tij kanë zhvilluar një proces të parregullt gjyqësor.

2. Shtetësja V.N. nga qyteti i Durrësit është ankuar ndaj vendimit nr.1410 dt.24.06.2004 të Gjykatës së Lartë, duke kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit për prishjen e tij.

Nga verifikimi rezultoj se ankuesja i është drejtuar me kërkesë për rishikim vendimi Gjykatës së Lartë, dhe ka kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit, për ta përfaqësuar në gjykim kur të shqyrtohet çështja e saj nga Gjykata e Lartë.

3. Shtetësja D.D. nga qyteti i Tiranë është ankuar ndaj vendimit dt.3.03.2005 të Gjykatës së Lartë, dhe ka kërkuar ndihmën tonë për prishjen e tij. Mbasi u bënë verifikimet e nevojshme ankuesja u orjentua se në bazë të nenit 131 shkronja " f " të Kushtetutës ajo mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, për të argumentuar se ndaj saj gjykatat nuk kanë zhvilluar një proces të parregullt ligjor.

4. Shtetasi S.P. nga qyteti i Tiranës është ankuar ndaj vendimit Unifikues Nr.31 dt.14.04.2003 të kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili u heq mundësinë punonjseve të policisë për ti kthyer në punën e mëparëshme në rrugë gjyqësore edhe në rastet kur ato largohen padrejtësisht nga puna dhe kjo vërtetohet gjyqësisht. Gjykatat duke u bazuar në vendimin Unifikues të kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë, në shumicën e rasteve shprehen për shfuqizimin e urdhërit për përjashtimin e tyre nga Policia e shtetit dhe ndaj tyre vendoset vetëm për të drejtën e dëmshpërblimit për 1 vit kohë.

Duke analizuar vendimin konkret nga ana e jonë u bë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese duke u bashkuar me ankuesin S.P. Gjykata Kushtetuese në seancë pregatitore vendosi, mospranimin e kërkesës tonë me arsyetimin se Avokati i Popullit nuk legjitimohet si palë në këtë gjykim.

5. Shtetësja R.G. nga qyteti i Tiranë është ankuar ndaj Gjykatës së Lartë, duke kërkuar që kur të shqyrtohet kërkesa e saj për rishikim vendimi të mosmarrin pjesë gjyqtarët e Kolegjit Civil të cilët kanë shprehur mendim negativ për rrëzimin e kërkesës saj, kur ato kanë gjykuar këtë çështje në Gjykatën e Lartë të çuar mbi bazë të rekursit.

6. Shtetasi S.R. nga qyteti i Tiranës është ankuar ndaj administratës gjyqësore të Gjykatës së Lartë e cila nuk e sqaron në lidhje me një vendim gjyqësor të marrë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vitin 1994. Nga verifikimi ynë rezultoi se me vendimin nr.1857 dt.21.11.1994 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është vendosur prishja e vendimit të Gjykatës së rrethit Fier dhe dërgimi i çështjes për gjykim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues.

7. Shtetasi M.N. nga qyteti i Tiranës është ankuar ndaj Gjykatës së Lartë e cila në Dhomën e Këshillimit ka vendosur mospranimin e rekursit të tij. Nga ana e jonë janë bërë sqarimet e nevojshme ligjore duke e orientuar që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, për të parashtruar se gjykatat ndaj tij kanë zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor.

8. Shtetësja Xh.J. nga qyteti i Laçit është ankuar se Gjykata e Lartë po zvarrit pa shkaqe ligjore gjykimin e një çështje civile duke parashtruar edhe disa shkaqe ligjore për të bërë të mundur shpejtimin e gjykimit të kësaj çështje. Nga verifikimi ynë u bë i mundur shpejtimi i gjykimit të kësaj çështje.

9. Shtetësja D.D. nga qyteti i Durrësit është ankuar se ndonëse Gjykata e Lartë ka vendosur përfundimin e gjykimit të çështjes asaj nuk i jepet kopja e vendimit gjyqësor. Mbi ndërhyrjen tonë u bë e mundur marrja e kopjes së vendimit i cili nuk ishte dhënë për arsye teknike.

4. Ankesat për Prokurorinë

Sipas Kushtetutës sonë edhe Prokuroria nuk bën pjesë në juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë, por për lehtësi studimi e kemi përfshirë pas saj.

Veprimtaria e punës së Avokatit të Popullit, në shqyrtimin e ankesave të shtetasve ndaj organit të Prokurorisë ka konsistuar në zbatimin korrekt dhe objektiv të Kushtetutës, ligjit që normon punën tonë dhe ligjit procedural penal.

Qëndrimi ynë është se, duke konstatuar shkeljet reale të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve që janë subjekte në procesin penal, si dhe duke bashkëpunuar me prokurorinë ato duhet t'i shërbejnë qëllimit të mirë për përmirësimin e punës së prokurorisë dhe ngritjen e saj në nivelet bashkëkohore.

Për vitin 2005 në Institucionin tonë 350 shtetas të ndryshëm kanë paraqitur 197 ankesa apo kërkesa, të cilat kanë patur për objekt

veprimtarinë e punës së organit të Prokurorisë. Mënyra e përfundimit të ankesave për vitin 2005 është: 62 ankesa janë zgjidhur në favor ose 31.5 përqind, 43 ankesa kanë qënë jashtë juridiksionit, 62 ankesa jashtë kompetence, 24 ankesa kanë qënë të pabazuara dhe 1 ankesë ka hequr dorë të ankuesi. Aktualisht për vitin 2006 kanë kaluar për shqyrtim 5 ankesa. Për vitin 2005 ka patur 47 ankesa më shumë se viti 2004. Kjo sepse në ndryshimet e bëra në ligjin nr.9398 datë 12.5.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8454 datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ndryshuar me ligjin nr. 8600 datë 10.4.2000” janë qartësuar edhe më shumë disa marrëdhënie të Avokatit të Popullit me prokurorinë.

Gjatë vitit 2005 janë shqyrtuar dhe 12 ankesa të mbartura nga viti 2004, të cilat kanë përfunduar. Mënyra e zgjidhjes së tyre ka qënë: 4 ankesa janë zgjidhur në favor, 6 ankesa kanë qënë jashtë kompetence, 1 ankesë ka qënë e pabazuar dhe 1 ankesë në shqyrtim.

Edhe për vitin 2005 ankesat e shtetasve ndaj veprimtarisë së organit të Prokurorisë janë shqyrtuar me përparësi. Për ankesat që kanë qënë brënda kompetencës sonë, Avokati i Popullit ka bërë vlerësimet e rastit dhe ka urdhëruar kryerjen e procesit të hetimit nëpërmjet realizimit të veprimeve të nevojshme si, marrja e deklarimeve të shtetasve të ndryshëm, kqyrjes së dokumentave, kryerjes së ekspertimeve mjekoligjore ose teknike me specialistë të fushave përkatëse, apo duke studjuar dosje hetimore për të cilat prokuroria kishte vendosur pushimin apo pezullimin e çështjes penale.

Për mjaft ankesa është shkuar në vëndbanimin e ankuesit ose kërkuesit, apo janë kryer veprimet në vënd, duke marrë dhe shpjegimet apo informacionin e nevojshëm në organin e Prokurorisë, ndaj të cilit shtetasi ka bërë ankimin.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur me preçedencë dhe ankesat e shtetasve apo shoqatave që përfaqësojnë interesa të një grupi të caktuar personash, si Shoqata “Tragjedia Otrano Maj 2000”, Shoqata Kombëtare “9 janari 2004”. Ai gjithashtu ka vlerësuar dhe ndjekur me përparësi njoftimet e ardhura nga Kuvendi i Shqipërisë.

Për vitin 2005 vihet re se ankesa apo kërkesa në Institucionin e Avokatit të Popullit janë paraqitur dhe nga njësitë e qeverisjes vendore në rrethe si: nga Komuna Fratar Mallakastër, Bashkia e Urës Vajgurore Kuçovë. Shqetësimi i tyre ka konsistuar kryesisht në probleme që shqetësojnë komunitetin si, për dënim të autorit të vrasjes së shtetasit B.P, apo për fillim hetimi për dëmtime të shkaktuara në kanalizime, ujësjellës e rrugë nga firma private që kryejnë aktivitetin e tyre në atë territor.

E veçanta në ankesë kërkesat apo njoftimet për vitin 2005, janë dhe ato të bëra nga Ombudspersoni i Kosovës, nga Shoqata apo shtetas shqiptarë me banim në Kosovë etj.

Kështu, Ombudspersoni i Kosovës ka kërkuar ndërhyrjen e zyrës sonë për verifikimin e pretendimeve të dy të arrestuarve Q.A. dhe A.R. nga Kosova, hetuar nga Prokuroria e rrethit gjyqësor Durrës. Më konkretisht prej tyre, pretendohet se akuzoheshin padrejtësisht dhe hetimet ndiqeshin me masë sigurimi “arrest në burg”. Shqetësimi i shtetasve kosovarë ishte dhe për kushte tejet të vështira në dhomat e paraburgimit të Komisarariatit të Policisë Durrës. Me marrjen e këtij njoftimi, menjëherë kanë shkuar për verifikim në vënd dy punonjësit e ngarkuar nga Avokati i Popullit. Përfundimisht është sqaruar se personat e sipërpërmëndur ndodheshin me masë sigurimi “arrest në burg “ për veprat penale të *“falsifikimit të letërnjoftimeve apo vizave”* dhe *“falsifikim të vulave, stampave ose formularëve”*. Me të dy personat e arrestuar është marrë takim dhe gjatë bisedës janë bërë sqarimet e nevojshme. Nga ana tjetër u komunikua me drejtues të organit të Prokurorisë së rrethit gjyqësor Durrës, të cilëve ju bë prezent shqetësimi i shtetasve kosovarë. Tek ata gjetëm predispozicionin e duhur bazuar dhe në ligj, në kërkesën që do të paraqitej para Gjykatës për masë të lehtë të dënimi ndaj të arrestuarve.

Përsa i përket shqetësimit të të arrestuarve për kushte jo të mira në dhomat e paraburgimit në Komisarariatit të Policisë Durrës, pas verifikimit ato ju bënë prezent drejtuesve të Komisarariatit dhe Drejtorisë së Policisë së Qarkut Durrës. Shqetësimi i shtetasve kosovarë është i njëjtë me të tjerë të cilët kanë paraqitur ankesa gjatë vitit 2003-2005 në institucionin tonë dhe kemi folur në pjesën e ankesave për burgjet dhe policinë.

Pranë Zyrës sonë i është drejtuar dhe Këshilli *Për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut* në Kosovë, lidhur me ankesën e familjes së shtetasit Y. B, person i larguar nga Durrësi në drejtim të Italisë qysh në vitin 1994. Prej atij momenti, familjarët e tij nuk ka asnjë dijeni për fatin e djalit të tyre, kurse ankesa e shtetasit M. K. nga Prishtina është për moskthim të mjetit të sekuestruar nga Prokuroria Durrës, të cilin e ka patur në pronësi të tij me dokumentacion të rregullt etj.

Ka patur dhe një kërkesë të shtetasit belge A. B, e cila ka kërkuar ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit për të sqaruar arësyet e arrestimit dhe mbrojtjen me avokat të bashkëshortit të saj shqiptar A.B, hetuar nga Prokuroria e rrethit Tiranë. Për këtë kërkesë, jo vetëm janë kryer verifikimet e nevojshme në Prokurorinë e rrethit, por dhe është kontaktuar me bashkëshortin e saj të arrestuar, të cilit i janë dhënë sqarimet e nevojshme. Mandej i është kthyer përgjigje dhe bashkëshortes së tij.

Gjatë shqyrtimit të ankesave për vitin 2005, vihet re se objekti i tyre është i njëjllotë me objektin e ankesave të paraqitura edhe gjatë vitit 2004. Në mënyrë të grupuar shtetasit ankohen ndaj Prokurorisë :

1. *Për zvarritje në hetimin e çështjeve penale.*

Raste të tilla mund të përmëndim ankesat e shtetasve A.B. dhe A.G. nga Tirana, M.K. nga Berati, Z. D. dhe D.N. nga Durrësi, J.M. nga Fieri, B.SH. nga Patosi etj.

Rast i dukshëm është hetimi i proçedimit penal Nr.1346 të vitit 2004, të Prokurorisë së rrethit gjyqësor Durrës për veprën penale të *“shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë”*, i cili bën fjalë për ngjarjen kriminale me pasojë vdekjen e teknikut të elektrikut L.N, gjatë riparimit të një difekti në rrjetin elektrik të tensionit të lartë, pranë kabinës elektrike në fshatin Xhafzotaj Durrës. Pavarësisht nga kryerja e veprimeve të nevojshme hetimore, akti i ekspertimit teknik është mundur të kryhet vetëm më datën 06.10.2005, kohë për të cilën nga ana e organit të Prokurorisë nuk ishte konkluduar për mënyrën e zgjidhjes përfundimtare të proçedimit penal.

Prokuroria e rrethit gjyqësor Shkodër, mbi bazën e materialit kallëzues të ardhur nga Komisariati i Policisë në Malësinë e Madhe, më datën 15.04.2005 ka filluar proçedimin penal Nr.190, për veprën penale të *“vjedhjes me armë të kryer në bashkëpunim”* në ngarkim të pandehurëve N.SH. dhe T.U. Deri në momentin e verifikimit të ankesës së të arrestuarit N.SH. në muajin dhjetor 2005, hetimet e proçedimit penal nuk kishin përfunduar dhe për rrjedhojë, çështja nuk ishte dërguar në gjyq.

Mbi bazën e ankesës së shtetasit K.B. nga Korça, Prokuroria e rrethit gjyqësor më datën 15.02.2005, ka filluar proçedimin penal Nr.71 për veprat penale të *“falsifikimit të dokumentave”* dhe *“ekspertimit të rreme”*. Janë kryer veprime hetimore, mandej është marrë dhe zgjatje afati. Përfundimisht pas 8 muajve, më datën 10.10.2005 çështja penale është pushuar, me arësyetimin se për rastin konkret ndodhemi para një konflikti civil.

Rast tjetër është ai i proçedimit penal Nr. 290, hetuar nga Prokuroria e rrethit gjyqësor Durrës, filluar më datën 04.04.2005, për veprat penale të *“vjedhjes së pasurisë”* dhe *“falsifikimit të dokumenteve”* ku megjithë veprimet e kryera por pa u marrë person konkret në përgjegjësi penale, më datën 08.09.2005, pra pas 5 muajve është vendosur pushimi i çështjes penale

Në Institucionin e Avokatit të Popullit një numur të konsiderueshëm ankuesish nga rrethe të ndryshme të vendit ngrenë shqetësimin për zvarritje në hetimin e çështjeve penale për krime të rënda si *“vrasje”*, *“shfrytëzim të prostitucionit”* etj. Si të tilla janë ankesat e shtetasve J.M nga Fieri për vrasjen e djalit të tij R.M, ngjarje e ndodhur më datën 28.01.2004. Hetimet e çështjes kanë përfunduar më datën 20.10.2004 dhe mandej çështja është dërguar në gjyq. Në këtë çështje janë marrë në përgjegjësi penale 4 shtetas të cilët janë ndjekur me masë sigurimi *“arrest në burg”*; ankesa e shtetasit D.D. nga Kurbini për djalin e tij të arrestuar, K.D etj.

Ankesa e shtetasës S.K. nga Elbasani e cila, ka bërë kallëzim penal për rrëmbim të vajzës së saj M.K. Prokuroria e rrethit Tiranë më datën 30.07.2004 ka filluar procedimin penal për veprën penale të “*Shfytëzimit të prostitucionit*”. Pas kryerjes së veprimeve hetimore organi i Prokurorisë më datën 25.10.2004, ja ka kaluar çështjen penale për kompetencë Prokurorisë për Krime të Rënda dhe procedimi penal ndodhet në fazën e hetimit.

Zvarritjet e tejzgjatura në hetimin e çështjeve penale shpesh nuk kanë qënë justifikuese.

2. Për moskryerje të hetimeve të gjithanshme dhe objektive.

Të tilla janë rastet e ankesave të shtetasve S.B. e D.H.I. nga Tirana, Z.K. nga Shkodra, shtetasi E.D. nga Dibra, E.M dhe N.G. nga Tirana, A.Ç. dhe P.K. nga Elbasani etj.

Më konkretisht ankesat e tyre kanë konsistuar në: mosvënien para përgjegjësisë ligjore të autorit dhe bashkëpunorve në kryerjen e krimit; në mosnjoftimin e akuzave për të gjitha veprat e kryera nga të pandehurit; në mosnxjerrjen e motiveve që kanë shtyrë autorët në kryerjen e veprës penale; në ndryshimin e kualifikimit të veprës nga një vepër më e rëndë në veprën më të lehtë në ngarkim të pandehurit; në moskryerjen e ekspertimeve të ndryshme mjeko-ligjore apo tekniko-grafike të nënshkrimit etj.

Kështu, Prokuroria e rrethit gjyqësor Elbasan pas kallëzimit penal të shtetasit L.Q, edhe pse ka filluar procedimin penal për veprën penale të “*falsifikimit të dokumenteve*” në ngarkim të shtetasit A. J. pa kryer ekspertimin tekniko-grafik të dokumentit “*Akti marrjes së tokës në pronës*”, ka vendosur padrejtësisht pushimin e çështjes penale. Ky vendim pas kundërshtimit nga ana e ankuesit në Gjykatë, është shfuqizuar. Por përsëri Prokuroria ka pushuar çështjen. Mandej çështja ka ndjekur instancat e tjera të gjyqësorit dhe, deri në momentin e verifikimit nga ana e zyrës sonë, çështja ka qënë në proces gjykimi nga Gjykata e Apelit Durrës.

Në ankesën e tij shtetasi E.D. nga Klosi i Matit, ankohet ndaj Prokurorisë për mosmarrje në përgjegjësi penale të njërit prej autorëve të vrasjes me dashje të djalit të tij XH. D, ngjarje e ndodhur më datën 11.02.2004. Fillimisht nga Prokuroria janë arrestuar shtetasit V.D. e M.XH. si persona të dyshuar për këtë vrasje dhe mandej është pushuar akuza në ngarkim të shtetasit M.XH. Në përfundim i pandehuri V.D. është dërguar në gjyq me akuzën e *plagosjes së rëndë me pasojë vdekjen*.

Avokati mbrojtës i të pandehurit Z.K. është ankuar ndaj Prokurorisë së rrethit gjyqësor Shkodër, për mosmarrjen në përgjegjësi penale të shtetasit K.RR. si bashkëpunëtor në krim i implikuar nga i pandehuri A.G, gjatë deklarimeve të dhëna në seancën e vleftësimit të masës së sigurimit, dhe për rrjedhojë nuk ka pranuar kërkesën e tij. Nga

verifikimi i bërë kësaj ankese konstatohet se ndonëse në ngarkim të shtetasit K.RR materialet janë veçuar, në përfundim organi i Prokurorisë pa kryer hetime të gjithanëshme dhe objektive ka vendosur pushimin e çështjes,

Shtetësja S.B. nga Tirana, nëpunëse ka paraqitur kallëzim penal për *“fyerje e goditje për shkak të detyrës”*, kryer nga shtetasi S.H. me detyrë shtetërore. Mbi këtë bazë Prokuroria ka filluar procedimin penal Nr. 765 të vitit 2005, vetëm për veprën penale të *“fyerjes për shkak të detyrës”*. Mandej pa marrë në konsideratë konkluzionin e aktit mjeko-ligjor që bëntë fjalë dhe për dëmtime të shkaktuara ankueses, ka vendosur padrejtësisht pushimin e çështjes.

Prokuroria e rrethit gjyqësor Elbasan ka filluar procedimin penal për veprën penale të *“prodhimit e shitjes së lëndëve narkotike”*, në ngarkim të shtetasve S.K. dhe B.K, për të cilën babai i të pandehurit S.K, shtetasi XH.K. ka paraqitur ankesë pranë zyrës sonë për arrestim të paligjshëm dhe hetime të njëanëshme. Në përfundim Prokuroria duke mos patur provat e nevojshme në ngarkim të pandehurëve ka vendosur pushimin e procedimit penal dhe lirimimin e të arrestuarve pas 5 muajve.

3. *Për mosvënie në lëvizje, apo mosvlerësim të kallëzimit të shtetasve*, si p.sh. ankesat e shtetasve F.B. nga Gjirokastra. N.L. nga Lezha, V. Ll. nga Saranda etj.

Rast flagrant është ankesa e shtetasës N.M. nga Tirana, e cila ngre shqetësimin se nga ana e punonjsve të policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Nr. 2, nuk është hetuar vdekja e bashkëshortit të saj D.M, i cili ishte duke punuar në ndërtimin e një pallati të firmës *“Skënderi”* pranë stadiumit *“Dinamo”*, ngjarje kjo e ndodhur më datën 14.02.2002. Megjithë interesimin që shtetësja kishte bërë në polici dhe prokurori, nga ato organe nuk kishte marrë asnjë përgjigje lidhur me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Mbi shqetësimin e shtetasës N.M. është urdhëruar kryerja e nje hetimi nga ku rezultoi se: në Komisariatin e Policisë Nr. 2 Tiranë nuk figuronte asnjë dokument që të pasqyronte të dhëna lidhur me problemin në fjalë. Po kështu dhe në Prokurorinë e rrethit Tiranë rezultoi se nga ana e Komisarariatit të Policisë nuk janë dërguar materiale kallëzuese apo mbi bazë vëndngjarje të cilat, të bënin fjalë për aksidentimin me vdekje të shtetasit D.M. Pas kryerjes së hetimit, Avokati i Popullit duke konstatuar se ankesa e shtetasës N.M ishte e drejtë, i dërgoi Prokurorisë së rrethit Tiranë rekomandimin për fillimin e hetimit për veprën penale të *“shpërdorimit të detyrës”* në ngarkim të oficerëve të policisë gjyqësore, rekomandim i cili është pranuar dhe procedimi penal ndodhet në hetim.

4. *Për mosnjofitim apo njofitim me vonesë për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimit apo përfundimit të çështjes penale*, si p.sh ankesat e

shtetasve A.Ç nga Durrësi, J.D. nga Elbasani, R.XH. nga Vlora, E.B nga Tirana etj.

Kështu, shtetasi XH.I. nga Tirana, ka paraqitur kallëzim penal pranë Prokurorisë së rrethit Tiranë për *marrje të padrejtë të fëmijve nga ish bashkëshortja e tij*, e cila pas rregjistrimit me vonesë të tij, materialin ja ka dërguar Komisarariatit të Policisë Nr.3 Tiranë për verifikim. Kjo në një kohë që duke respektuar kërkesat e nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, I dëmtuari akuzues, materiali kallëzues i shtetasit XH.I. duhej t'i dërgohej gjykatës për kompetencë, mbasi dhe vepra penale e mësipërme që parashikohet nga neni 127 të Kodit Penal është në kompetencë të gjykatës, dhe prokurori mund të merrte pjesë në gjykimin e saj.

Shtetasi U.R. nga Peshkopia, ka paraqitur kallëzim penal pranë Prokurorisë për keqtrajtim nga ana e punonjësve të policisë rrugore, dhe ndërsa është akuzuar për veprat penale të *“goditjes dhe fyerjes për shkak të detyrës”*, kallëzimi i tij si i dëmtuar nuk është vlerësuar.

Shtetësja M.L. nga Tirana, qysh më datën 02.11.2004 ka paraqitur kallëzim penal në Prokurori për veprën penale të *“shkatërrimit të pronës”*. Janë kryer verifikime dhe vetëm pas katër muajve e konkretisht, më datën 21.03.2005 është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

Shtetasi XH. K. nga Lushnja, më datën 13.04.2005 ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Lushnje, por vetëm pas 3 muajve e konkretisht më datën 13.07.2005, Prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

Shtetasi M.M. nga Tirana më datën 31.08.2004 ka paraqitur kallëzim penal, për të cilin është vendosur mosfillim procedimi penal datë 27.09.2004. Nuk ka marrë asnjë dijeni në rrugë zyrtare dhe pas interesimit të tij është vënë në dijeni për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimit më datën 18.07.2005.

5. *Për bllokime apo sekuestrime te sendeve prove materiale sidomos per automjetet dhe kthimin e tyre me vonesë*, si p.sh ankesa e shtetasit M.K. nga Prishtina e Kosovës të cilit nuk i është kthyer mjeti që ka patur në pronësi me dokumente të rregullta, qysh në fazën e hetimit; ankesa e shtetasit S. V. nga Tirana, për mosdhënie të dokumenteve si libreza pensioni etj, të sekuestruara gjatë hetimit etj.

Në ankesën e tij shtetasi M.TH. nga Saranda, ankohej ndaj Prokurorisë së rrethit gjyqësor Vlorë e cila, nuk ka kthyer mjetin që kishte në pronësi të tipit “autobuz” qysh në fazën e hetimit duke mos respektuar kërkesën e parashikuar në pikën 2 të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale Disponimi i provës materiale. Por ja ka lënë atë në ruajtje personit të cilin ankuesi e kishte kallëzuar për veprën penale të *“vetgjyqësisë”*. Nga ana e jonë është ndërhyrë tek drejtuesi i Prokurorisë i cili ka ngarkuar punonjës të Prokurorisë për verifikimin në vënd të problemit

dhe marrjen e masave të nevojshme me qëllim ndërprerjen e këtij veprimi.

Pas dërgimit të çështjes në gjyq, gjykata e rrethit gjyqësor Vlorë ka vendosur kthimin e sendit provë materiale ankuesit M.TH.

6. Për akuzë të padrejtë apo rëndim të akuzavë në ngarkim në momentin e marrjes në përgjegjësi penale.

Raste të tilla janë ankesat e shtetasve H.K, J.SH dhe S.E nga Tirana, E.TH. nga Kavaja, M.S, dhe B.B. nga Shkodra, SH.T. nga Fieri, D.H. nga Korça etj.

Në ankesën e tij shtetasi F.L. nga Kavaja, ankohej ndaj Prokurorisë për akuzë të padrejtë për vepra penale të pakryera prej tij. Kështu, pas përfundimit të hetimit të proçedimit penal për veprën penale të “*kalimit të paligjshëm të kufirit*”, gjykata e rrethit gjyqësor Kavajë e ka dënuar atë me 5 vjet burgim dhe 6 milion lek gjobë. Por pas verifikimit të pretendimeve të të pandehurit, gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit dhe lirimin e menjëherëshëm për arsye se ai ishte dënuar për të njëjtën veprë penale, nga gjykata italiane e Brindizit.

Rast tjetër është ankesa e shtetasit Z.RR. nga Lushnja, i cili ankohet ndaj prokurorisë së rrethit Tiranë për akuzë të padrejtë ndaj djalit të tij E.RR. si antar i “*bandës së Lushnjes*”. Pavarësisht nga sa sipër pas kalimit të akteve të këtij proçedimi penal për kompetencë në Prokurorinë për Krime të Rënda, akuzat përfundimtare në ngarkim të djalit të ankuesit, ka qënë ajo e “*moskallëzimit të krimit*”.

Gjatë shqyrtimit të disa ankesave është konstatuar se, organi i Prokurorisë ka vepruar në mënyrë të nxituar dhe të pabazuar në verifikimin e ngjarjes me të gjithë elementët që përbëjnë veprën penale, apo duke mosvlerësuar të dhënat e paraqitura me qëllim fillimin e hetimit të proçedimit penal. Pas studimit nga ana e jonë është vënë re se mosfillimi i proçedimit penal nuk ka qënë rezultat i hetimit të gjithanshëm dhe objektiv, e për rrjedhojë i është rekomanduar prokurorisë shfuqizimi i vendimit të mosfillimit, siç është ankesa e shtetasit I.L. nga Kukësi, apo kur në materialet e paraqitura e ngjarjen e ndodhur ka patur elementë të veprës penale ka rekomanduar fillimin e hetimit si p.sh. mbi ankesën e shtetasit N.M. nga Tirana.

7. Për shkelje proçeduriale në kryerjen e veprimeve hetimore.

Të tilla janë ankesat e shtetasve E.M, B.LL. nga Tirana, P.A. nga Lezha, G.M. dhe RR.M. nga Durrësi etj.

Këto shkelje kanë konsistuar në mosfiksimin dhe mosvlerësimin e sendeve apo provave të tjera të gjetura gjatë kqyrjes së vëndit të ngjarjes, me qëllim kthimin e tyre personave të dëmtuar apo interesuar. Të tilla janë ankesa e shtetasit E. M. nga Tirana për Prokurorinë Durrës, apo në moskryerjen e veprimeve të domosdoshme që lidhen me: marrjen e kallëzimit dhe përpilimin e vendimit për kryerjen e ekspertimit mjeko-

ligjor kur nga ana e të pandehurit pretendohet për ushtrim dhune gjatë marrjes në pyetje nga policia gjyqësore; në pyetjen e *personit ndaj të cilit zhvillohen hetime* pa praninë e avokatit kur ai është kërkuar prej të pandehurëve; në mosnjohimin e familjarëve në rastet e ndalimit apo arrestimit në flagrancë; në mosnjohjen e të pandehurit dhe avokatit mbrojtës me vendimin për zgjatjen e afatit të hetimit të çështjes, në mosnjohjen me materialet e çështjes në përfundim të hetimit etj.

Në ankesën e tij shtetasi B.LL. nga Tirana, ankohet ndaj oficerëve të policisë gjyqësore të prokurorisë Tiranë A.Ç. dhe A.M. të cilët në kundërshtim me rregullat proceduriale kanë kryer kontroll banese në mënyrë të kundraligjshme, dhe me të drejtë nga seksioni ushtarak i Prokurorisë është filluar poçedimi penal për veprën penale të *shpërdorimit të detyrës*.

Në ankesën e tij shtetasi RR. M. nga Durrësi, ankohet ndaj prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme A.V, i cili ka marrë në pyetje të arrestuarin pa praninë e avokatit mbrojtës dhe mandej ka urdhëruar punonjësit e policisë për sjelljen e të arrestuarit forcërisht në dhomën e hetimit. Mbi këtë bazë pas rekomandimit tonë për fillimin e hetimit për veprën penale të kryerjes së “*veprimeve arbitrare*” nga shefi i rendit të Komisarariatit të Policisë Durrës shtetasi A.B. dhe komandanti i grupit të gatëshëm G.P, Prokuroria e rrethit gjyqësor Durrës ka filluar poçedimin penal. Aktualisht çështja penale ndodhet në hetim.

Për veprime të kundraligjshme të kryera nga prokurori A.V. është rekomanduar Prokurorit të Përgjithshëm marrja e masave disiplinore, rekomandim i cili nuk është vlerësuar dhe është refuzuar.

Në ankesën e saj shtetësja G.M. nga Durrësi, ankohet për veprime jo korrekte të kryera nga prokurori S.K. gjatë ushtrimit të funksionit shtetëror dhe mbi këtë bazë, pas rekomandimit tonë Prokuroria e Përgjithshme ka vendosur ndaj tij si masë disiplinore transferimin në një rreth tjetër.

B. Gjatë vitit 2005 në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë paraqitur ankesa shtetas nga rrethe të ndryshme të vëndit, për moszbulimin dhe vënien para përgjegjësisë penale të autorëve të vrasjeve të fëmijëve apo të afërmëve të tyre, ngjarje të ndodhur kryesisht gjatë vitit 1997. Të tilla raste janë ankesa e shtetasit K.F. nga Elbasani për vrasjen e djalit të saj G.F, shtetasi E.GJ. nga Korça për vrasjen e djalit A.GJ. në Korçë. Këto ankesa kanë qënë më të pakta në numur krahasuar me vitin 2004. Kjo dhe për faktin se nga ana e Prokurorisë janë rifilluar një numur i konsiderueshëm i çështjeve të pezulluara sidomos për vrasje të ndodhura në periudhën e trazirave të vitit 1997.

- Për vitin 2005 në Institucionin e Avokatit të Popullit ka një numur të konsiderueshëm ankesa të shtetasve për rastet e pezullimit të hetimit për ngjarje kriminale me pasoja të rënda, sidomos për krimin e “vrasjes”,

“shfrytëzimit për prostitucion” etj. Të tilla janë ankesat e shtetasve R.S. nga Cërriku për vrasjen e djalit të saj A.S, ngjarje e ndodhur qysh në vitin 2003; ankesa e shtetasit S.GJ. nga Lezha për pezullimin e hetimeve për plagosje të rëndë të vëllait të tij M.GJ, ngjarje e ndodhur në vitin 2003; shtetasi J.Ç. për vrasjen e djalit të tij A.Ç, ngjarje e ndodhur në vitin 1999 ndërsa hetimet janë pezulluar në vitin 2000; ankesa e shtetasit I.Ç. nga Pogradeci për vrasjen e djalit të tij A.Ç, ngjarje e ndodhur në vitin 1998; ankesa e shtetasit N.H. po nga Pogradeci për trafikim të vajzës së tij për prostitucion, ngjarje e ndodhur në muajin shkurt të vitit 2004 etj.

Konstatohet se për këto çështje të cilat fillojnë mbi bazën e ngjarjes dhe që jo vetëm janë me rrezikshmëri të madhe shoqërore, por dhe që trondisin komunitetin e më gjërë, ndonëse janë kryer veprimet e para hetimore të domosdoshme, nuk është predispozicioni i duhur për kryerjen e veprimeve të gjithanshme për zbulimin e autorit të veprës penale, si dhe mungon bashkëpunimi mes prokurorisë e policisë kriminale. Për rrjedhojë, hetimet pezullohen dhe materialet e çështjes i dërgohen policisë kriminale. Atje shpesh nuk ka asnjë impenjim për bashkëpunim për ndjekjen në vazhdimësi të çështjes dhe analizën e tyre të herëpashershme. Në këto kushte ato mbeten pa veprime nga policia kriminale.

Nga ana e jonë për një pjesë të mirë të këtyre rasteve është bërë verifikimi në vënd, duke u marrë kontakt si me drejtues të Prokurorisë, ashtu dhe të policisë kriminale. Nga studimi i materialeve vihet re se, pas pezullimit të hetimit të procedimit penal, nuk kryhen veprimet e mëtejshme nga policia kriminale si dhe nuk bëhen analizat përkatëse me organin e Prokurorisë. Në takimet e kryera keni orientuar dhe insistuar në kryerjen e shpejtë të veprimeve dhe ndjekjen në vazhdimësi të çështjeve të pezulluara.

- Gjatë studimit të ankesave apo kërkesave të shtetasve për vitin 2005 konstatohen raste kur, prej tyre kërkohet konsulencë juridike për mënyrën e veprimit të mëtejshëm për problemin që ata i shqetëson. Të tilla janë rastet e shtetasve A.X. nga Tirana e cila kërkonte vërtetim nga Prokuroria për qëndrimin e djalit të saj në dhomat e paraburgimit për periudhën 1996-1997 dokument i nevojshëm për organet e drejtësisë italiane; Shtetësja L.Q. nga Elbasani e cila ka kërkuar ndërhyrjen e Zyrës sonë për rrugët që duhet të ndiqte me qëllim shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vdekja e bashkëshortit të saj në Fabrikën e çimentos; Shtetasi A. K. nga Bilishti që kërkon ndërhyrje për falje të djalit të tij të dënuar; Shtetasi SH.L. nga Skrapari mbi shqetësimin për veprime të kundraligjshme të kryer nga bashkëfshatari i tij etj.

Në këto raste nga ana e jonë shtetasit janë sqaruar sipas rastit, për të drejtën e parashikuar në nenin 283 të Kodit të Procedurës Penale me qëllim bërjen e kallëzimit penal tek ofcieri i policisë gjyqësore apo prokurori, plotësimin e materialeve të kallëzimit sipas kërkesave të

parashikuara në ligj, paraqitjen në prokurori të dokumenteve origjinale, të drejtën për rishikimin e vendimit penal që ka marrë formë të prerë dhe dërgimin e saj pranë Gjykatës së Lartë duke respektuar kërkesat e neneve 449-453 të Kodit të Proçedurës Penale, duke dërguar dhe fotokopje të neneve respektive që bëjnë fjalë për këtë institut, dërgimin e formularit me dokumentet e nevojshme për faljen që bën Presidenti i Republikës etj, për dokumentet dhe proçedurat që duhet të ndjekin për rastet kur ankesa i drejtohet Gjykatës së Strasburgut etj.

Kështu, në ankesën e tij shtetasi A.M. nga Fieri është ankuar ndaj Prokurorisë për mosmarje të kallëzimit penal për falsifikim të dokumenteve ndonëse ishte në proçes gjyqësor civil në Gjykatën e rrethit gjyqësor Fier me objekt *“pjestim pasurie”* Kështu, shtetasi A. M. ka pretenduar se nota e transkriptimit në favor të shtetasit J.M ka qënë e falsifikuar.

Në këtë rast ankuesit ju bë e qartë e drejta e tij për *goditje të aktit për falsitet* parashikuar nga neni 270 të Kodit Civil, menjëherë pas konstatimit në seancë gjyqësore dhe mandej për detyrimin që ka gjykata e cila shpall shkresën si të falsifikuar duke ja dërguar organit të Prokurorisë.

Në ankesën e tij shtetasi B.SH. nga Fieri, ka kërkuar ndërhyrjen tonë jo vetëm për shpejtimin e hetimit të proçedimit penal ndaj autorëve të veprave penale të *“trafikimit të femrave për prostitucion në bashkëpunim”* dhe *“shfryëzim prostitucioni në rrethana rënduese”* në dëm të vajzës së tij, por dhe ndihmë për mbrojtjen si dëshmitar mbasi kishte patur kërcënime serioze për jetën.

Mbi këtë shqetësim ankuesi u sqarua me qëllim që këtë kërkesë ta paraqiste tek drejtuesi i Prokurorisë së rrethit, ndërsa nga ana e jonë u bisedua me drejtues të krimit të organizuar të Ministrinë e Punëve të Brëndëshme, të cilët ishin të predispozuar për mbrojtjen e ankuesit sipas ligjit.

Në ankesën e tij shtetasi SH.L, nga Librazhdi sqaron se ishte larguar për një kohë të gjatë jashtë vëndit në Belgjikë, dhe prezantonte shqetësimin se nga ana e shefit të policisë kriminale (aktualisht larguar nga detyra) ishte thirrur dhe venë në dijeni se, ishte nën hetim për një vrasje të ndodhur në fshatin e tij, para 15 vjetëve. Në këto rrethana, pas komunikimit me punonjësit e policisë kriminale dhe drejtuesin e Prokurorisë, ankuesi u sqarua në rrugë zyrtare se ndaj tij nuk kishte problem për ndjekje penale.

Ka edhe ankesa kur shtetasit ngrenë shqetësimin për masë të ulët dënimi për autorët e veprave penale ku ata ose pjestarë të familjes janë të dëmtuar si p.sh. ankesa e shtetasit R.S. nga Librazhdi për vrasjen e vajzës S.S. ndaj Prokurorisë së rrethit Korçë, shtetasi G.G. nga Shkodra për vrasjen e djalit të tij I.G; kërkesa e familjarëve *“Todi”* në Divjakë të

Lushnjes për ndërhyrje në Prokurori me qëllim dhënien e dënimit maksimal dhe sipas ligjit të autorit të vrasjes së djalit të tyre M.T, ngjarje e ndodhur në gusht të vitit 2005.

Nga ana e jonë ankuesit janë sqaruar për mosndërhyrjen e Avokatit të Popullit në pavarësinë e organeve të drejtësisë. Pavarësisht nga sa sipër shqetësimi i tyre mbetet një problem që mendojmë se duhet rregulluar për të futur të drejtën e ankimit të viktimës që të kundërshtojë vendimet gjyqësore.

- Shqetësim i shtetasve për vitin 2005 ka qënë dhe mosndjekja e problemeve të tyre prej Institucioneve që u janë drejtuar, lidhur me humbjen e të afërmeve të tyre vite më parë. Të tilla janë rastet e ankesave të shtetasve Z.Y. nga Tirana për humbjen e vajzës së saj M.D. në vitin 1995; L.K. nga Tirana për nipin e saj GJ.GJ. larguar nga Shqipëria qysh në vitin 1992; ZH.A. nga Tirana për zhdukjen e djalit të saj A.A. në gusht të vitit 1996; I.Ç. nga Berati për zhdukjen e vëllait të tij I.Ç. larguar në drejtim të Greqisë në vitin 1993; I.M. nga Peshkopia për zhdukjen e djalit të tij A.M. në vitin 1995 në drejtim të Italisë; M.Z.P. nga Lezha për zhdukjen e nipit të tij N. D.D. larguar në drejtim të ish Jugosllavisë në vitin 1989. Vërehet se, nuk është bërë vlerësimi i nevojshëm si nga Prokuroria, ashtu dhe policia kriminale si organe kompetente për ndjekjen e këtyre ankesave me natyrë kriminale. Në këto rrethana shtetasit bëjnë përpjekjet e tyre në Institucione të tjera, por pa asnjë rezultat.

Nga ana e zyrës sonë janë kryer verifikimet e nevojshme si në organet e Prokurorisë, Policisë ashtu dhe në Drejtorinë Konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Nga ana tjetër janë orientuar ankuesit për të paraqitur kallëzime penale pranë Prokurorisë. I tillë është rasti i shtetasit K.SH. nga Shkodra, i cili më datën 14.04.2005 ka bërë kallëzim penal për vrasjen e djalit në Greqi. Prokuroria duke vlerësuar kallëzimin e tij, ka filluar procedimin penal duke kryer një sërë veprimesh hetimore të nevojshme apo dhe dërguar lëtrëporosi Ministrisë së Drejtësisë të Greqisë, me qëllim sqarimin e rrethanave të ngjarjes, etj.

Avokati i Popullit pas bisedimeve me Komitetin e Helsinkit Greqi dhe vënien dijeni për një numur të konsiderueshëm fëmijë shqiptarë të humbur, ka kryer hetime me familjarë të tyre kryesisht në Korçë, ka siguruar e financuar prokurat përkatëse nga prindërit për t'ja deleguar Komitetit grek të Helsinkit, autorizimin e veprimeve ligjore në emër të atyre fëmijëve, një pjesë e të cilëve ndodhej në Institutin “Agia Varvaras” të Athinës.

Në ankesën e tij shtetasi H.O. nga Kukësi, ngre shqetësimin dhe ankohet ndaj autoriteteve maqedonase, me qëllim zbardhjen e së vërtetës për vrasjen e djalit të tij N.O. në Tetovë të Maqedonisë, ngjarje e ndodhur më datën 21.12.2003. Duke vlerësuar këtë shqetësim nga ana e Zyrës së Avokatit të Popullit është komunikuar personalisht me Avokatin e

Popullit të Maqedonisë, të cilët kanë qënë të predispozuar jo vetëm duke ndjekur ecurinë e hetimit nga Prokuroria Publike e Tetovës, por dhe kanë marrë takim me ankuesin R.O, cilit i kanë marrë sqarime e të dhëna të rëndësishme me qëllim zbulimin e autorit, veprës penale dhe motive të kryerjes së krimit.

- Për periudhën që analizohet ka patur dhe raste kur, shtetas të ndryshëm ankohen për “mbyllje” të çështjeve për veprën penale të *“shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”* me pasoja të rënda për jetën apo shëndetin e shtetasve. Të tilla janë ankesat e shtetasve N.L, K.N, dhe P.XH nga Korça, V.I. nga Berati, B.SH. nga Fieri, D.H. nga Elbasani.

Nga studimi dhe analiza e bërë ankesave të paraqitura në Institucionin tonë arrijmë në përfundimin se, nga ana e Prokurorisë jo gjithmonë bëhet vlerësimi i duhur i këtyre çështjeve, të cilat fillojnë mbi bazën e ngjarjes, dhe kërkojnë kryerje të shpejta të veprimeve të para hetimore të papërsëritshme, njohuri profesionale në fushën autoteknike dhe objektivitet. Njëanshmëria, dhënia e konkluzioneve të pasakta dhe të padrejta në aktet e ekspertimit mjeko-ligjor ose autoteknik, moskryerja e veprimeve të gjithanëshme, janë pasoja të vendimeve të pabazuara të ndërmara nga policia gjyqësore e të miratuara nga Prokuroria. Nga ana tjetër, ato sjellin zvarritje në hetimin e çështjeve penale dhe pasoja të tjera që lidhen me probleme sociale, deri në acarimin e marrëdhënieve ndërmjet autoreve të veprës me familjarët e të dëmtuarëve apo viktimave të shkaktuara nga vepra penale. Veç sa sipër, këto qendrimë ndikojnë negativisht në rritjen e numurit të aksidenteve në shkallë vëndi, i cili për vite me radhë është mjaft shqetësues.

Pikërisht mbi këtë shqetësim qytetar, duke konstatuar se në vitet e fundit *aksidentet rrugore janë konsideruar si “vrasësit” kryesore të shqiptarëve* me gati 1 të vdekur dhe 2 të plagosur në ditë, nga ana e jonë janë kërkuar informacione të hollësishme Prokurorive në rrethe të ndryshme të vëndit për veprën penale të *“shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”* me pasojë vdekje apo dëmtime në shëndetin e shtetasve për periudhën 5 vjeçare 2001-2005. Informacionet u janë kërkuar kryesisht Prokurorive të rretheve të mëdha dhe, kur në territorin që ato ushtrojnë ndjekjen penale kalojnë autostrada apo superstrada dhe lëvizja e mjeteve është tepër e madhe. Pas marrjes së të dhënave të nevojshme, mbi studimin që do të realizohet do të ngrihen problemet e nevojshme në formë përgjithësimi të cilat mendojmë t’ja dërgojmë Institucioneve shtetërore si: Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Këshillit të Ministrave.

C. Nga shqyrtimi i ankesave të ndryshme që janë konsideruar të drejta për shkeljet e konstatuara, Avokati i Popullit i ka paraqitur

Prokurorit të Përgjithshëm, apo drejtuesve të Prokurorive në rrethe 8 rekomandime, nga të cilat 5 janë pranuar, 2 rekomandime janë refuzuar dhe 1 rekomandim është në shqyrtim.

Pra, konstatohet se rekomandimet e Avokatit të Popullit, përgjithësisht janë pranuar. Në mënyrë të grupuar rekomandimet tona drejtuar organit të Prokurorisë, paraqiten si më poshtë:

1. Rekomandim drejtuar Prokurorit të rrethit Tiranë *“për fillimin e hetimit për veprën penale të shpërdorimit të detyrës’ parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal , në ngarkim të oficerëve të policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë, datë 02.11.2005. (Ankesa e shtetases N. M. nga Tirana). Rekomandimi është pranuar.*

2. Rekomandim drejtuar Prokurorit të rrethit gjyqësor Kavajë, *për kryerjen e riekspertimit autoteknik për veprën penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor* datë 07.03.2005 (Ankesa e shtetasit R.B. nga Kavaja) Rekomandimi është pranuar.

3. Rekomandim drejtuar Prokurorisë së rrethit gjyqësor Fier, *për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal Nr. 32 të vitit 2005, për veprën penale të “shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, datë 13.04.2005.(Ankesa e shtetasit I.L. nga Peshkopia). Rekomandimi është pranuar.*

4. Rekomandim drejtuar Prokurorisë së rrethit gjyqësor Durrës, *“për fillimin e hetimit në ngarkim të shtetasit A. B. me detyrë shef i rendit në Komisariatin e Policisë Durrës, për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 të Kodit Penal. (Ankesa e shtetasit R. M. nga Durrësi). Rekomandimi është pranuar.*

5. Rekomandim drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, *për marrjen e masës disiplinore ndaj Prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme A. V, datë 28.06.2005. Rekomandimi nuk është pranuar, e mandej është dërguar përsëri shkresë me sqarime dhe argumenta Prokurorit të Përgjithshëm i cili akoma nuk ka reaguar ndaj saj.*

6. Rekomandim drejtuar Ministrit të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, *“Për rregullimin e çështjes së uljes së dënimit për të dënuarit që punojnë në burgje dhe marrja e masave për korigjimin e pasojave të aktit të nxjerrë nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën Nr. 3223 datë 08.10.2004, dërguar Prokurorive në rrethe, datë 22.09.2005. (Ankesa e të dënuarve Z.F. dhe Gj.R. Burgu Burrel). Rekomandimi është në shqyrtim dhe nuk ka ardhur përgjigje.*

7. Rekomandim drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm *për marrjen e masave disiplinore ndaj prokurorit të Prokurorisë Durrës S. K., datë 27.10.2005. (Ankesa e shtetases G.M.). Rekomandimi është pranuar.*

8. Rekomandim drejtuar Prokurorit të rrethit gjyqësor Durrës, *për fillimin e hetimit për humbjen e shtetasit kosovar Y. B. nga Prizreni i*

Kosovës, datë 01.11.2005. (Ankesa e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Kosovë). Rekomandimi nuk është pranuar.

D. Gjatë shqyrtimit të çështjeve që kemi paraqitur për keqtrajtime apo veprime arbitrare të organeve të policisë ndaj qytetarëve organi i prokurorisë ka filluar procedimin penal ndaj personave përgjegjës, por në përfundim ka vendosur pushimin e hetimit. Raste të tilla kanë qënë ankesa e shtetasit F.H. nga Tirana për ushtrim dhune nga inspektori i policisë kriminale të Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë; ankesa e shtetasit Y.L. po nga Tirana për shoqërim pa shkaqe ligjore në organin e policisë. Mbi rekomandimin tonë për fillim hetimi Prokuroria e rrethit Tiranë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

Avokati i Popullit problemet kryesore i ka biseduar e zgjidhur me Prokurorin e Përgjithshëm, zotin Sollaku. Prokurorët e rretheve kanë vlerësuar më me korrektësi rekomandimet tona. Por ka edhe raste që ngurojnë të dërgojnë informacione apo akte, s’japin për studim dosjet penale për të cilat janë pushuar hetimet prej tyre, por për të cilat ka patur ankesa nga shtetasit, megjithëse me ndryshimet e bëra në maj 2005 në ligjin “Për Avokatin e Popullit” janë qartësuar më tej kompetencat tona edhe në marrëdhënie me prokurorinë.

5. Ministria e Brendëshme

Past shtatorit 2005 në Ministrinë e Brendëshme bëjnë pjesë ish Ministria e Rendit Publik dhe ish Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit. Prandaj ankesat për këto janë trajtuar së bashku.

A. Pranimi dhe shqyrtimi me përparësi dhe me rigorozitet i ankesave dhe kërkesave ndaj organeve të ish Ministrisë së Rendit Publik dhe të Policisë së Shtetit ka qënë dhe do të vazhdojë të mbetet një nga prioritetet tona kryesore. Kjo jo vetëm për faktin se ky organ i administratës publike përbën strukturën që përfaqëson fuqinë shtrënguese të shtetit, por edhe për vetë specifikën e Policisë Shqiptare, e cila krahas arritjeve pozitive, vazhdon të ketë në radhët e saj elementë të pakulturuar, të papërgatitur profesionalisht, të pa trajnuar me konceptet e shtetit ligjor dhe respektimit të të drejtave të Njeriut, të korrupsuar etj.

Në institucionin tonë për sektorin e policisë gjatë vitit 2005 kanë ardhur gjithsej 157 ankesa, kërkesa apo njoftime. (Në këtë numër nuk përfshihet numri i ankesave të mbartura nga viti 2004). Nga këto, 75 prej tyre janë bërë nga banorë të Tiranës, ndërsa 82 nga banorë të rretheve të ndryshme të vendit. Kanë përfunduar 135 ankesa si vijon: 45 ose rreth 33% janë zgjidhur në favor, 15 kanë qënë jashtë juridiksionit, 71 kanë qënë të padrejta, kurse 4 ankues kanë hequr dorë. Janë mbartur për shqyrtim në vitin 2006, 22 ankesa.

Gjatë këtij viti për rastet që kemi vërtetuar shkeljet e ligjit janë bërë 6 rekomandime për fillimin e ndjekjes penale, nga të cilat janë pranuar 4, është refuzuar 1 dhe është në shqyrtim 1. Janë bërë dhe 6 rekomandime për dhënien e masave disiplinore, të cilat janë pranuar të gjithë. Në bazë të rekomandimeve tona Prokuroritë e Rrethit Tiranë dhe Durrës kanë filluar ndjekjen penale ndaj disa punonjësve të policisë të Komisarariatit të Policisë Nr. 1 dhe 2 Tiranë dhe Durrës dhe janë dhënë 8 masa disiplinore ndaj punonjësve të policisë që kanë bërë shkelje të ligjeve.

Ankesat e trajtuara ndahen sipas problemeve të mëposhtme:

I. Ankesat për keqtrajtim të shtetasve.

Këto ankesa janë vlerësuar më tepër sepse kur ato kanë rezultuar të vërteta, kanë qënë shkelje të rënda të nenit 25 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që parashikon se: *“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues”*. Njëkohësisht ato janë edhe dhunime të rënda të nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gjithashtu, ia vlen të vemë në dukje faktin se këtë vit, ato kanë qënë në rritje në krahasim me vitin e kaluar dhe sidomos në muajt e fundit.

Në institucionin tonë janë bërë 30 ankesa për keqtrajtime të shtetasve nga Policia e Shtetit, nga të cilat janë përfunduar 27. Mënyra e zgjidhjes së tyre është: 4 janë vlerësuar të drejta, 22 të pa bazuara dhe 1 ankues ka hequr dorë.

Për rastet kur kemi vërtetuar pretendimet e ankuesve për keqtrajtime nga punonjësit e Policisë kemi bërë rekomandime organeve përkatëse. Gjatë këtij viti, vetëm për rastet e keqtrajtimit, i janë bërë 4 rekomandime organit të Prokurorisë për fillimin e ndjekjes penale, nga të cilat 3 janë pranuar dhe 1 është në shqyrtim.

Si raste të vërtetimit të ankesave për keqtrajtime të shtetasve mund të përmëndim:

1. Ankesa e shtetasit M. Ll., banues në rrethin e Durrësit, i cili ankohej ndaj Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë për keqtrajtimin e djalit të tij P.Ll. dhe kontroll të paligjshëm banese. Sipas tij, në datën 12.03.2005, djali i tij P. Ll. ishte shoqëruar nga punonjësit e policisë të Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë për vjedhje makinash. Ankuesi pretendonte se në datën 13.03.2005, në shtëpinë e tij kishin shkuar disa punonjës policie të këtij komisarati dhe i kanë bërë kontroll banese pa patur ndonjë vendim gjyqsor dhe se për kontrollin e bërë nuk kishin mbajtur e lënë procesverbal atij. Gjithashtu, ai pretendonte se në Polici djali i tij ishte mbajtur i shoqëruar tej afateve ligjore dhe ishte keqtrajtuar. Bashkë me ankesën e bërë, ankuesi na solli edhe disa fotografi të bëra djalit të tij në ambientet e Gjykatës ditën kur ishte bërë vlerësimi i masës

së sigurimit. Nga fotografitë e bëra P. Ll. dukeshin qartë shënjat e dhunës së ushtruar ndaj tij në pjesë të ndryshme të këmbëve.

Nga hetimet e bërë nga ana jonë dhe verifikimet në Komisaratin e Policisë Nr. 2 Tiranë rezultoi, se shtetasi P. Ll. ishte ndaluar për veprën penale të vjedhjes (vjedhje makinash). Në banesën e tij kishte shkuar një grup punonjësish policie me në krye inspektoret e policisë kriminale Albert Hoxha dhe Dritan Male, të cilët duke qënë në kushtet e flagrancës kishin shkuar për të ushtruar kontroll banese në shtëpinë e autorit të vjedhjes. Meqenese autori nuk kishte banese por jetonte në një barake të ndërtuar me dërrasa dhe objekti i kontrollit të banesës ishte gjetja dhe sekuestrimi i makinave të vjedhura, të cilat nuk ndodheshin në oborrin e vendit të banimit, ata nuk e bënë atë. Me personin e ndaluar kishin punuar specialistët e policisë kriminale Ilirjan Balla dhe Skënder Hita. Nga kqyrja e regjistrit të personave të shoqëruar në polici, rezultoi se shtetasi P. Ll. ishte shoqëruar tre herë në këtë Komisarjat.

Shoqërimi tre ditë radhazi në polici dhe për të njëjtin problem (i dyshuar si autor i vjedhjes së makinave) i shtetasit P. Ll., ditën e parë 9 orë, ditën e dytë 12 orë dhe ditën e tretë 10 orë, ishte bërë në kundërshtim të plotë e të hapur me nenin 45 të ligjit Nr. 8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”. Sipas kësaj dispozite, Policia mund ta shoqërojë një person në zyrat e veta, kur janë kushtet e parashikuara nga neni 27 i Kushtetutës, por shoqërimi nuk mund të zgjasë më shumë se 10 orë. Në fakt ai ishte mbajtur i shoqëruar në Polici për të njëjtin problem 31 orë, pavarësisht ndërprerjeve me qëllime kamufluese, dhe gjatë qëndrimit të tij në Polici, me të ishin kryer veprime hetimore. Theksojmë se edhe brenda kësaj kohe, në një rast, ai ishte mbajtur i shoqëruar 12 orë, pra 2 orë mbi kohën maksimale të lejuar nga ligji.

Instituti i Mjekësisë Ligjore bëri ekzaminimin e tij dhe na dërgoi aktin përkatës. Nga akti i ekspertimit rezultoi se në trupin e shtetasit P. Ll. u konstatuan dy hematoma, dëmtime të shkaktuara me mjete të forta, të cilat hynin në kategorinë e atyre që kanë shkaktuar humbje të përkohshme për punë deri në 9 ditë.

Në përfundim të hetimit të kësaj ankese ne arritëm në konkluzionin se shtetasi P. Ll. i ishin shkelur rëndë të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura dhe garantuara nga neni 25 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 3 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, si dhe neni 27, pika 2 dhe neni 45 i ligjit Nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

Me veprimet e tyre punonjësit e policisë Ilirjan Balla dhe Skënder Hita, kishin konsumuar elementët e figurës së veprës penale të kryerjes së veprimeve arbitrare, të parashikuar nga neni 250 i K.Penal.

Për këto arsye, i rekomanduam Prokurorisë së Rrethit Tiranë fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të punonjësve të policisë Ilirjan

Balla dhe Skënder Hita, të cilët kishin kryer këto veprime të kundërligjshme. Rekomandimi u mirëprit, Prokuroria filloi ndjekjen penale dhe çështja është në hetim.

2. Ankesa e shtetasit F. H., anëtar i Shoqatës “Gay Albania”, i cili ankohej se në datën 08.06.2005, në orën 22.30, tek Sahati në qendër të Tiranës, ishte kapur dhe shoqëruar nga furgoni i policisë në Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë. Ai pretendonte se një punonjës policie e kishte spërkatur me spray lotësjellës në kohën e shoqërimit dhe më pas gjatë qëndrimit në Polici ishte rrahur e keqtrajtuar me kabëll nga një punonjës i policisë kriminale, emrin e të cilit nuk ka mundur ta mësojë. Nga goditjet atij i ishin shkaktuar dëmtime në kurriz e në këmbët dhe i kishin ngelur shënjat e dhunës në trup. Gjithashtu, ankuesi pretendonte se gjatë qëndrimit në Polici ishte fyer dhe diskriminuar për shkak të qënies së tij homoseksual.

Nga aktdëshmia mjekoligjore rezultoi se në trupin e shtetasit F. H. u konstatuan tre dërmishje dhe katërmbëdhjetë ekimoza. Këto dëmtime ishin shkaktuar me mjet të fortë mbretës dhe hyjnë në kategorinë e dëmtimeve që kanë shkaktuar pa aftësi të përkohshme për punë deri në 9 ditë.

Gjithashtu, nga ana jonë iu kërkuan shpjegime Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë, i cili na informoi se ishte i vërtetë fakti që shtetasi F. H. ishte shoqëruar në Polici për verifikim, por nuk pranonte faktin që ai ishte keqtrajtuar, diskriminuar e fyer.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese ne arritëm në konkluzionin se shtetasit F. H. i ishin shkelur rëndë të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura dhe garantuara nga neni 25 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 3 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e drejtave dhe lirive themelore të njeriut, neni 27, pika 2 dhe neni 45 të ligjit Nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”. Me veprimet e tyre punonjësit e policisë të Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë kishin konsumuar elementët e figurës së veprës penale të kryerjes së veprimeve arbitrare, të parashikuar nga neni 250 i K.Penal.

Për këto arsye, i rekomanduam Prokurorisë së Rrethit Tiranë fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të punonjësve të policisë të Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë që kishin kryer veprime të kundërligjshme. Rekomandimi u mirëprit. Prokuroria filloi ndjekjen penale, por pas hetimeve të kryera e pushoi atë.

3. Ankesa e shtetasit V. P., me banim në Tiranë, i cili na shkruante se në datën 09.11.2005, i kishin shkuar në shtëpi disa punonjës të policisë të Komisarariatit të Policisë Fier dhe kishin bërë kontrollin e banesës së tij, në prezencë të nënës dhe familjarëve të tjerë me të cilët ai bashkejeton. Ankuesi në atë kohë nuk ndodhej në shtëpi, por ata e kishin kërkuar nëpërmjet telefonit celular, duke e thirrur që të paraqitej në postën e

policisë në Laprakë. Rreth orës 14.00, ai ishte paraqitur në postën e policisë në Laprakë dhe u takua me ta. Punonjësit e policisë së Komisarariatit Fier, të cilët ishin disa, e kishin pyetur atë rreth një vrasje të ndodhur në Fier më dt. 04.11.2005, duke i kërkuar që ai të pranonte autorësinë e saj. Meqënëse ai nuk e ka pranuar kryerjen e vrasjes, sepse sipas tij nuk ishte autori i saj, ata e kishin keqtrajtuar atë duke e goditur në pjesë të ndryshme të trupit me grushta dhe shkop gome. Ai pretendonte se megjithëse nuk ua ka mësuar emrat atyre që e keqtrajtuuan, në qoftëse do t'i paraqiteshin për njohje ishte në gjëndje t'i njihte. Ata e kishin mbajtur atë në postën e policisë në Laprakë dhe të nesërmen bashkë me babanë e tij e kishin shoqëruar në Komisariatin e Policisë Fier. Së bashku me ankesën, ai na solli edhe kopje të dy procesverbaleve të kontrollit të banesës së tij, të bëra më dt. 04.11.2005 dhe 09.11.2005, të cilët ishin përpiluar nga oficerët e policisë gjyqsore të Komisarariatit të Policisë Fier Mareglen Sala dhe Erjon Brinja (*sqarojmë se formulari i një procesverbali ishte marrë në Komisariatin e Policisë Nr. 3 Tiranë dhe nuk i ish in bërë ndryshimet përkatëse. Aty figuronte se Erjon Brinja ishte efektiv i Komisarariatit të Policisë Nr. 3 Tiranë dhe jo i Komisarariatit të Policisë Fier, siç ishte realisht*). Meqënëse ankuesi kishte shënja të dukëshme dhune në trup, nga ana jonë u muar vendimi i kryerjes së ekzaminimit mjekoligjor të tij. Nga akt dëshmia mjekoligjore rezultoi se tek i dëmtuari V. P. ishin konstatuar katër hematoma, të shkaktuara me mjet të fortë mbretës, të cilët hynin në kategorine e atyre dëmtimeve që nuk kanë sjellë për pasoje humbjen e aftësisë së përkohshme për punë në masën mbi nëntë ditë pushim. Pretendimet e ankuesit për keqtrajtim nga punonjësit e policisë u provuan edhe nga babai i tij Z. P., i cili u pyet nga ana jonë.

Në përfundim të hetimit të kësaj ankese ne arritëm në konkluzionin se shtetasit V. P. i ish in shkëlur rëndë të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura dhe garantuara nga neni 25 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 3 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe neni 27, pika 2 dhe neni 45 e ligjit Nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

Me veprimet e tyre punonjësit e policisë gjyqsore të Komisarariatit të Policisë Fier, Erjon Brinja, Mareglen Sala e të tjerë, kishin konsumuar elementët e figurës së veprës penale të kryerjes së veprimeve arbitrare, të parashikuar nga neni 250 i K.Penal.

Për këto arsye, i rekomandua Prokurorisë së Rrethit Tiranë fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të tyre. Rekomandimi është bërë kohët e fundit dhe është në shqyrtim.

4. Ankesa e shtetasi Rr. M. nga rrethi i Durrësit, i cili ankohej ndaj punonjësve të policisë të Komisarariatit të Policisë Durrës dhe Shefit të

Rendit Abdulla Buceza, për keqtrajtimin e djalit të tij R. M., i arrestuar në dhomat e paraburgimit të këtij Komisariati.

Nga verifikimet e bërë nga ana jonë në Prokurorinë e Rrethit Durrës dhe në dhomat e paraburgimit në Komisaratin e Policisë rezultoi se shtetasi R. M. ndodhej në dhomat e paraburgimit të Komisarimit të Policisë Durrës nga data 15.04.2004, duke u akuzuar për vrasjen e një shtetasi shqiptar në Londër. Më datën 19.04.2005, kishin shkuar në dhomën e hetimit për të marrë në pyetje të paraburgosurin R. M., prokurori Ardian Visha së bashku me hetuesit anglezë, përkthyesin dhe prokurorin e çështjes z. Ilir Turja.

Nga ana e prokurorit Ardian Visha të paraburgosurit i është thënë se: “Ne kemi fakte që ju jeni autor i krimit dhe në rast se do të pranosh fajësinë, nga 25 vjet burgim që parashikon dënimin kjo vepër penale do të ulim 8 vjet. Prandaj prano fajin dhe se me ndihmën tonë mund të bësh gjithsej 5 vjet burgim”. I paraburgosuri i është shprehur se, nuk ishte fajtor dhe nuk mund të merrte përsipër një krim që nuk e kishte kryer. Pas kësaj bisede, prokurori i çështjes z. Ilir Turja ka dalë nga zyra.

Në prani edhe të hetuesve angleze prokurori Ardian Visha i ka thënë të paraburgosurit se: “Ai ishte fajtor dhe do të deklaronte si të thoshin ata, dhe në përfundim të pyetjes do të firmoste”. I paraburgosuri R. M. i ka thënë prokurorit që pyetja dhe dhënia e shpjegimeve të tij të bëheshin në praninë e avokatit mbrojtës P. Ç.. Prokurori Visha i ka thënë: “Që nuk i interesonte prania e avokatit mbrojtës”, ndërsa i paraburgosuri ka insistuar që prania e avokatit i interesonte atij. Prokurori Ardian Visha ka filluar të bërtiste duke i thënë që ai do të bënte ashtu siç i thoshte ai etj. Në këto rrethana i paraburgosuri R. M. është ngritur në këmbë dhe ka dalë jashtë nga zyra e hetimit që ndodhet në katin e tretë, duke shkuar në dhomën e tij të paraburgimit, e cila ndodhej në katin e dytë të asaj ndërtese.

Pas disa minutash në dhomën e tij kishin shkuar policët e shërbimit, të cilët i kishin thënë atij të shkonte në dhomën e hetimit mbasi e kërkonte prokurori Ardian Visha. Ai i ka sqaruar ata dhe policët e tjerë që erdhën më vonë se, do të shkonte në dhomën e hetimit vetëm duke qënë avokati i tij mbrojtës.

Pas ardhjes së Shefit të Rendit Avdulla Buceza, ai ka urdhëruar policët Genc Peka dhe Lul Gjuzi që të merrnin me forcë të paraburgosurin dhe ta çonin në dhomën e hetimit. Punonjësit e policisë kanë kapur nga të dy krahët të paraburgosurin R. M. për ta nxjerrë nga dhoma, por ai i ka kundërshtuar duke tërhequr trupin prapa me qëllim për të mos dalë nga dhoma. Pikërisht në këto momente Shefi i Rendit Abdulla Buceza e ka qëlluar në ballë të paraburgosurin me radion e policisë që mbante në dorë, duke i shkaktuar plagë dhe hemoragji.

Në këtë gjëndje dhe me forcë punonjësit e policisë e kanë çuar të paraburgosurin në dhomën e hetimit, por prokurori Ardian Visha duke e parë që ai ishte i dëmtuar dhe nga plaga rridhte gjak, ju ka thënë policëve ta çonin në dhomën e paraburgimit dhe ashtu u veprua.

Duke analizuar në tërësi veprimet e prokurorit Ardian Visha dhe Shefit të Rendit Abdulla Buqeza, konstatoam se:

Prokurori Ardian Visha duke marrë në pyetje të paraburgosurin R. M. pa praninë e avokatit mbrojtës, kishte shkelur një të drejtë kushtetuese që parashikohet në nenin 31 pika “ç” të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe nenet 6, 48 dhe 256 të Kodit të Proçedurës Penale. Për këto arye nga ana e jonë iu rekomandua Prokurorit të Përgjithshëm marrja e masës disiplinore ndaj tij.

Ndërsa Shefi i Rendit Abdulla Buqeza, jo vetëm ka urdhëruar punonjësit e policisë, vartës të tij që të marrin me forcë të paraburgosurin për ta çuar në dhomën e hetimit në kundërshtim me ligjin, por edhe ka kryer me dashje veprime të kundërligjshme duke e qëlluar atë me radion e policisë dhe shkaktuar dëmtime në ballë.

Duke parë në vënd dëmtimet e të paraburgosurit R. M. dhe me kërkesën e të dëmtuarit vendosëm kryerjen e ekspertimit mjekoligjor të tij. Mbi këtë bazë u bë ekzaminimi i tij nga Instituti i Mjekësisë Ligjore Tiranë. Për të bërë të mundur ekzaminimin e të paraburgosurit, me shkresën e datës 06.05.2005, i kemi kërkuar Drejtorit të Policisë së Qarkut Durrës marrjen e masave për dërgimin e të paraburgosurit R. M. në Institutin e Mjekësisë Ligjore Tiranë, me qëllim vënien në dispozicion të ekspertëve mjekoligjore për ekzaminim. Nga policia e Durrësit u zvarrit me dashje ky ekzaminim, megjithatë më datën 10.06.2005, u bë ekzaminimi i të paraburgosurit. Nga akti i ekspertimit mjekoligjor rezultoi që në trupin e shtetasit R. M. u konstatuan një cikatrice (vrahje) në pjesën e përparme të sheshit të kokës në mesin e tij dhe 2.8 cm larg kufirit të ballit, me ngjyrë trëndafil me dimensione 2.3x03 cm. Këto dëmtime ishin shkaktuar me mjet të fortë mbretës. Dëmtimet e mësipërme hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve që kanë shkaktuar paaftësi të përkohëshme në punë në masën mbi nëntë ditë dhe ishin shkaktuar në një kohë rreth një muaj më parë nga koha e ekzaminimit.

Në përfundim të hetimit të kësaj ankese arritëm në konkluzionin se Shefi i Rendit të Komisarariatit të Policisë Durrës Abdulla Buqeza, gjatë ushtrimit të detyrës kishte kryer veprime arbitrare, të cilat preknin lirinë e shtetasit, e për rrjedhojë me këto veprime ai kishte konsumuar elementët e figurës së veprës penale të kryerjes së veprimeve arbitrare, parashikuar nga neni 250 të Kodit Penal.

Për këto arsye, i rekomandua Prokurorisë së Rrethit Durrës fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të punonjësit të policisë Abdulla

Buqeza. Rekomandimi u mirëprit, Prokuroria filloi ndjekjen penale dhe çështja është në hetim.

Ndërsa lidhur me zvarritjen e bërë nga punonjësit e policisë për dërgimin e të paraburgosurit në Institutin e Mjekësisë Ligjore për ekzaminim, nga ana jonë iu rekomandua Drejtorit të Policisë të Qarkut Durrës, dhënia e masave disiplinore ndaj punonjësve të policisë Abdulla Buqeza, me detyrë Shefi i Rendit, Hekuran Çeka, me detyrë Komandant i Repartit dhe Genc Peka, me detyrë Komandant Toge, të cilët kishin “humbur” shkresën tonë. Rekomandimi u pranua dhe atyre iu dhanë masat disiplinore.

II. Ankesat për veprime të tjera të paligjshme nga policia.

Kanë qënë 77 ankesa për veprime arbitrare të punonjësve të policisë, nga të cilat 6 për kontrole të paligjshme banese e lokali; 8 për arrestime, ndalime dhe shoqërime të paligjshme; 23 për mos evidencim apo mos ndjekje të kallzimeve apo të ankesave; dhe 40 për veprime të tjera të kundërligjshme, si për sende të sekuestruara apo bllokuara nga policia; për veprime korruptive; për gjoba të padrejta; etj. Si raste të zgjidhjes pozitive mund të përmëndim:

1. Ankesa e shtetasit Y. L. banues në Tiranë, i cili na shkruante se një ditë nga mezi i muajit Mars 2005, kishte bërë fjalë me një grua të fisit të inspektorit të policisë kriminale të Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë Enea Kaci. Disa ditë më pas, më datë 06.04.2005, ankuesi kishte qënë duke udhëtuar me makinën e tij dhe pa patur ndonjë shkak ligjor ishte ndaluar nga punonjësi i policisë Enea Kaci dhe një polic, të cilët e kishin shoqëruar në Komisariatin e Policisë Nr. 1 Tiranë. Enea e ka pyetur atë për ngjarjen e ndodhur me gruan e fisit të tij dhe ai ka dhënë shpjegimet përkatëse. Pas kësaj, Enea e ka kërcënuar ankuesin duke i thënë se njërezit e saj do ta vrisnin familjarisht dhe pas këtyre fjalëve e ka goditur atë me grushta në trup. Në këtë moment kanë ndërhyrë dy punonjës policie që u ndodhën aty dhe e kanë tërhequr Enean. Pas këtij momenti Enea Kaci e ka futur ankuesin në dhomën e paraburgimit dhe e ka mbajtur aty 8 orë.

Nga verifikimet që bëmë rreth kësaj ankese në Komisariatin e Policisë Nr. 1 Tiranë dhe pyetja e inspektorit të policisë kriminale Enea Kaci, rezultoi se ai e kishte shoqëruar ankuesin në polici për arsye se ishte kontigjent. Me këtë veprim të kryer ndaj ankuesit Y. L., punonjësi i policisë Enea Kaci i kishte shkelur rëndë të drejtat dhe liritë themelore atij, të mbrojtura dhe garantuara nga neni 27, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 44 dhe 45 të ligjit Nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”. Shoqërimi i ankuesit në Polici ishte bërë në kundërshtim me kriteret ligjore të parashikuara në dispozitat

ligjore të cituara më sipër, dhe për rrjedhoj nga ky veprim atij i ishte cënuar padrejtësisht liria.

Në përfundim të shyrimit të kësaj ankese arritëm në konkluzionin se punonjësi i policisë Enea Kaci kishte konsumuar elementët e figurës së veprës penale të kryerjes së veprimeve arbitrare të parashikuar nga neni 250 i K.Penal.

Për këto arsye, i rekomandua Prokurorisë së Rrethit Tiranë fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të punonjësit të policisë Enea Kaci. Mirëpo rekomandimi nuk u mirëprit dhe Prokuroria padrejtësisht nuk filloi ndjekjen penale të kërkuar nga ana jonë.

2. Ankesa e shtetases B. Z. banore e rrethit Korçë. Ajo na shkruante se kishte patur një problem në muajin Gusht 2004, por inspektori i policisë së zonës Tasun Çoçi e kishte zvarritur dhe nuk e kishte ndjekur atë, si dhe nuk i është dhënë vendim për ekzaminim mjekoligjor. Për këto shkelje të ligjit, ajo pretendonte se ishte ankuar tek eprorët e punonjësit të policisë, deri tek drejtori, por nuk i ishte zgjidhur problemi që kishte dhe se ndaj punonjësit të policisë nuk ishte marë ndonjë masë disiplinore për shkeljen e bërë. Gjithashtu, ajo pretendonte se bashkëshortit të saj i ishte bërë presion se do ta fusnin në burg në qoftëse do të vazhdonte të ankohej për të vënë në vënd dinjitetin e saj.

Në bazë të kërkesës tonë, Komisariati i Policisë Korçë, na informoi se ankuesja kishte bërë ankesë tek oficeri i rojes për vjedhjen e pasurisë së saj (misrin në arë) nga shtetasi P. M. Më pas ajo e ka akuzuar atë drejtpërdrejtë për këtë vjedhje dhe ai e kishte fyer e rrahur atë. Pas kësaj ngjarjeje, ajo ishte ankuar përsëri tek specialisti i policisë së zonës Tasun Çoçi, i cili pasi e ka dëgjuar B. Z. për fyerjen dhe rrahjen e ndodhur, i ka thënë asaj që të bënte ankesë në gjykatë, etj.

Nga ankesa e shtetases B. Z. dhe nga përgjigjia e Komisarariatit të Policisë Korçë rezultoi se, asaj nuk i ishte mbajtur kallzim nga ana e policisë për vjedhjen e ndodhur, por ajo ishte përcjellë duke i thënë që të shkonte në gjykatë për fyerjen dhe rrahjen e bërë. Ky veprim, mosmbajtja e kallzimit për vjedhjen e ndodhur asaj dhe moskryerja e veprimeve proceduriale lidhur me të, binte ndesh me dispozitat e Kodit të Proedurës Penale dhe konkretisht me nenet 280 e vijues të tij, në të cilat është parashikuar marrja dijeni e policisë për veprën penale, veprimtaria me inisiativë e policisë gjyqsore, marrja e kallzimit dhe referimi i veprës penale tek prokurori, sigurimi i burimeve të provave, marrja e të dhënave të tjera, kontrollimet, sekuestrimet etj. Megjithëse nga ana e M.R.Publik dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ishte folor shumë për evidentimin e të gjitha veprave penale të ndodhura dhe administrimin e kallzimeve lidhur me to, dhe për këtë qëllim ishin nxjerrë edhe aktet përkatëse si, Urdhëri i Ministrit të Rendit Publik Nr. 2005, dt. 05.10.2004 dhe Urdhër-Shërbimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.

13/229, dt. 05.10.2004, siç rezultoi e provuar në rastin konkret, nga ana e Komisarariatit të Policisë Korçë nuk ishin zbatuar detyrimet ligjore. Nga drejtuesit e Policisë të këtij Komisaritati dhe të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Korçë, e cila u vu në dijeni nga ana jonë, nuk ishte analizuar ankesa dhe nuk ishte mbajtur qëndrim ligjor edhe pas dërgimit të shkresës tonë.

Për të rivendosur në vënd të drejtat ligjore të ankueses B. Z. dhe me qëllim mospërsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen, i rekomandua Drejtorit të Policisë së Qarkut Korçë, të merrte masat e nevojshme për marrjen dhe administrimin e kallzimit të shtetases B. Z., për vjedhjen e pasurisë së saj nga shtetasi P. M.. Gjithashtu, i rekomandua që të analizonte këtë ngjarje dhe të merrte masa disiplinore ndaj punonjësve të policisë që nuk kishin zbatuar detyrat ligjore për marrjen dhe administrimin e kallzimit të ankueses, si dhe masat disiplinore të jepeshin në prezence të efektivit të policisë me qëllim që të parandaloheshin shkelje të tilla në të ardhmen. Rekomandimi u mirëprit, të dëmtuarës iu muar kallzimi dhe punonjësit të policisë Tosun Çoçit iu dha masë disiplinore.

3. Ankesa e shtetasit S. K., banor i qytetit Rrogozhinë. Ai na shkruante se në mënyrë të përsëritur djemtë e tij keqtrajtoheshin nga punonjësit e Policisë Kavajë dhe Rrogozhinë. Pa patur asnjë shkak ligjor banesa e tij ishte bërë objekt i kontroleve të paligjshme, ndërsa dy djemtë e tij S. K. e A. K. shoqëroheshin në polici dhe keqtrajtoheshin fizikisht. Sipas tij, ngjarja e fundit kishte ndodhur më datë 24.02.2005, me djalin A. K., i cili kishte qënë duke punuar, por ishte marrë nga punonjësi i policisë Shaban Xhameta duke i thënë se e kërkonte shefi. Në këtë kohë disa punonjës policie të ardhur nga Kavaja, me në krye inspektorin e policisë kriminale Gramoz Dafkun, kishin bërë kontrollin e shtëpisë së ankuesit, pa patur ndonjë vendim gjyqësor. Gjatë kontrollit ata i kishin marrë armën e gjahut, të cilën ai e kishte me leje. Mirëpo pas kontrollit nuk kishin mbajtur asnjë procesverbal për kontrollin e ushtruar në banesë dhe për marrjen e armës së gjahut. Djali i tij ishte dërguar e mbajtur në Komisariatin e Policisë Kavajë tërë natën. Rreth orës 23.30 policët kishin shkuar përsëri në shtëpinë e tij dhe kishin kërkuar djalin tjetër të tij, por nuk e kishin gjetur atë. Ai duke qënë i rregullt kishte shkuar vetë në Policinë e Rrogozhinës, dhe me kërkesë të Gramozit është paraqitur rreth orës 24.00 në Komisariatin e Policisë Kavajë, mirëpo është mbajtur deri në orën 16.00 të ditës tjetër. Pasi djali i tij, i cili shkoi vetë në polici, kishte dalë nga policia, i kishte thënë të jatit se ishte rrahur nga punonjësit e policisë Gramoz Dafku dhe Besnik Lubaj.

Në bazë të kërkesës tonë, Komisaritati i Policisë Kavajë, midis të tjerave na informoi se kontrolli i banesës së ankuesit ishte bërë sepse kishin patur informacione se djemtë e ankuesit ishin autorë të mundëshëm

të vjedhjes së firmës “AEK”. Mbi këto informacione kishin bërë edhe shoqërimin e tyre në Polici. Ndërsa bllokimi i armës së gjahut ankuesit i është bërë për arsye se ai, pasi i ishte dhënë leja e armës, ishte dënuar nga Gjykata me vendim të formës së prerë për veprën penale të armëmbajtjes paleje (automatik).

Nga verifikimet që u bënë nga ana jonë rezultoi, se kontrolli i banesës së ankuesit nga inspektori i policisë kriminale dhe oficer i policisë gjyqsore Erjon Ahmeti ishte bërë në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në nenin 202 të K.Pr.Penale dhe nenin 43 të Ligjit Nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”. Gjithashtu konstatoam se, ndonëse bllokimi i armës së gjahut ankuesit i është bërë konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, mbajtja e saj në këtë gjëndje për rreth 3 muaj dhe pa marrë vendim nga komisioni i dhënies dhe heqjes së armëve, për heqjen e lejes dhe armës së gjahut atij nuk ishte korrekt. Ky qëndrim i Policisë vinte në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 1288, dt. 09.08.2000, pikën 3, ku përcaktohet se, *komisioni mblidhet jo më pak se një herë në muaj* dhe pikën 30, ku përcaktohet se, *shtetasve u hiqet arma e dhënë me leje vetëm pasi ka dalë vendimi i komisionit të dhënies dhe heqjes së armëve*.

Për këto arsye, i rekomandua Shefit të Komisarariatit të Policisë Kavajë t’i jepte masë disiplinore punonjësit të policisë Erjon Ahmeti dhe atë t’ia komunikonte në prezencë të efektivit të policisë me qëllim parandalimin e shkeljeve të tilla në të ardhmen. Gjithashtu, i rekomandua që të mblidhte sa më shpejt komisionin e dhënies e heqjes së armëve dhe të shqyrtonte e vendoste për rastin e shtetasit S. K. Rekomandimi u mirëprit dhe u zbatua me korrektesë.

4. Ankesa e bërë nga familjarët e të ndjerit A. D., i cili më datën 25.02.2005, u vra me pistoletë në ambjentet e Komisarariatit të Policisë Nr. 4 Tiranë.

Nga ana jonë për zbardhjen e ngjarjes së ndodhur u kryen hetimet përkatëse, si pyetja e ish Shefit të Policisë Kriminale të Komisarariatit të Policisë Nr. 4 Tiranë Artan Cuku, pyetja e inspektorëve të policisë kriminale të këtij Komisaritati Elvis Shehu dhe Ardian Qirkollari, e n/oficerit të rojes Nuredin Nurja, i cili ishte me shërbim ditën e ndodhjes së ngjarjes, pyetja e policëve të Postës së Policisë Vorë Artier Taçi dhe Qemal Ruçi, pyetja e policëve të grupit të gatshëm Shahin Shehu dhe Ajet Mazelli, pyetja e shtetasve P. D., F. D., M. Gj. dhe Z. T.. U bë kqyrja e librit të shoqërimit të personave në polici dhe librit të shënimeve ditore të shërbimit të informacionit në Komisariatin e Policisë nr. 4 Tiranë. Gjithashtu, morëm dhe administruam edhe aktet e ekzaminimit kriminalistik dhe mjekoligjor, të bëra nga Instituti i Policisë Shkencore dhe Instituti i Mjekësisë Ligjore Tiranë.

Nga hetimi i këtij rasti ne nuk siguroam të dhëna që të hidhnin poshtë pretendimet e Artan Cukut, se viktimi A. D. vrau veten. Por konstatoam se nga ana e punonjësve të policisë të Komisarariatit Nr. 4 Tiranë ishin kryer disa shkelje të normave të punës, siç mund të përmëndim:

a) Shoqërimi nga policët Shahin Shehu, Ajet Mazelli dhe Mehmet Lika i shtetasit A. D., nga Posta e Policisë Vorë për në Komisariatin e Policisë Nr. 4 Tiranë, duke e lidhur me pranga, ishte bërë në kundërshtim me aktet normative në fuqi, pasi ai jo vetëm kishte qënë në cilësinë e personit të shoqëruar, por ndërkohë ai nuk kishte bërë asnjë lloj rezistence ndaj policisë për t'u shoqëruar. Përkundrazi, i është bindur në mënyrë të menjëhershme Policisë për të shkuar i shoqëruar në atë vënd ku Policia mendonte dhe dëshironte.

b) I shoqëruari ishte i pajisur me pasaportën e tij personale, dhe z. Cuku, nga krahasimi i tij me fotografinë e të vëllait, arriti në konkluzionin se ai nuk ishte i kërkuari B. D.. Duke u ndodhur përballë këtij fakti ai nuk kishte arsye që ta merrte në zyrë atë për verifikim. Në se do të dyshonte për fallsifikim të pasaportës, atë mund ta bënte pa e marrë në zyrë të shoqëruarin.

c) Mbajtja e pistoletës nga Artan Cuku, pa këllëf, nën rrip dhe të mbushur me fishekë në fole, ishte në kundërshtim me nenin 106, pika 18, gërma "a" të Rregullores së Brendëshme të Policisë së Shtetit, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 1933, datë 19.12.2003. Në këtë rregullore parashikohet se: *"Mbajtja e pistoletës në situatat e përditëshme, bëhet në brez, në anën e djathtë ose të manjtë, sipas lehtësisë së përdorimit, e futur në këllëf, e siguarur që të mos dalë në mënyrë të pavullnetëshme, pa fishekë në folenë e fishekut dhe në siguresë"*. Shkelja e këtyre rregullave nga Artan Cuku, duke u mbështetur në shpjegimet e tij, ka krijuar kushtet për viktimën në kryerjen e vetvrasjes.

ç) Marja e armës së Artan Cukut nga viktimi, tregon pakujdesi të rëndë, paaftësi dhe pazotësi profesionale e fizike të tij.

Ndonëse në rastin konkret punonjësi i policisë Artan Cuku nuk u muar në përgjegjësi penale, u provua plotësisht që ai kishte përgjegjësi disiplinore.

Për këto arsye, i rekomandua Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit t'u jepte masa disiplinore oficerit të policisë kriminale Artan Cuku, si dhe punonjësve të policisë të grupit të gatshëm Shahin Shehu, Ajet Mazelli dhe Mehmet Lika, të cilët bënë shoqërimin me pranga të të ndjerit A. D. nga Posta e Policisë Vorë në Komisariatin e Policisë Nr. 4 Tiranë. Gjithashtu, i rekomandua që shkeljet e mësipërme, si dhe dhënia e masave disiplinore të përgjithësoheshin në të gjithë efektivin e Policisë së Shtetit me qëllim parandalimin në të

ardhmen të rasteve të tilla. Mirëpo gjatë kohës që ankesa ishte në shqyrtim nga ana jonë, z. Artan Cuku ishte ndëshkuar me masë disiplinore, duke u shkarkuar nga detyra dhe emëruar në një detyrë më të ulët. Ndërsa punonjësve të tjerë të policisë nuk ju dhanë masat disiplinore me pretendimin se kishte kaluar afati i dhënies së tyre i parashikuar në Rregulloren e Disiplinës.

5. Shtetasi B. E., banor i qytetit të Vorës, na shkruante se më dt. 27.06.2005, djali i tij i mitur, i quajtur A. E., i datëlindjes 05.03.1990, ishte arrestuar nga Komisariati i Policisë Nr. 3 Tiranë. Arrestimi ishte bërë sepse dyshohej për vjedhje. Ankuesi pretendonte se pyetja e djalit të tij ishte bërë në kundërshtim me ligjin, pa prezencën e mbrojtësit dhe të një kujdestari. Sipas tij, punonjësit e policisë që e kishin shoqëruar atë, e kishin rrahur dhe se këtë veprim e kishin parë banorët e pallatit ku ai banon. Gjithashtu, ai pretendonte se nga ana e punonjësve të policisë i janë kërkuar rroba për djalin, të cilat ai ua kishte sjellë. Rrobat që kishte veshur djali nuk i ishin kthyer dhe ky fakt i krijoi dyshimin se edhe në Polici djali ishte keqtrajtuar.

Nga ana jonë iu kërkuan shpjegime Komisarariatit të Policisë Nr. 3 Tiranë lidhur me pretendimet e ankuesit. Në përgjigjen e dërguar, ky komisarariat na informoi se shtetasi i mitur A. E. ishte arrestuar në flagrancë, sepse ishte autor i një vjedhje të ndodhur në teritorin e këtij komisarariat. Policia nuk pranoi se ai ishte keqtrajtuar dhe për shkak të kohës relativisht të gjatë që kishte kaluar nga arrestimi i tij edhe ne nuk mundëm të provonim këtë pretendim të ankuesit. Mirëpo nga verifikimet e bëra në dosjen penale të A. E. konstatuam se ai ishte pyetur nga oficeri i policisë gjyqsore Hajri Kushe pa prezencën e mbrojtësit ligjor. Sipas policisë, ishtin bërë përpjekjet, por nuk ishte mundësuar sigurimi i tij.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj arritëm në konkluzionin se pyetja e të arrestuarit të mitur A. E., nga inspektori i policisë kriminale Hajri Kushe ishte bërë në kundërshtim me dispozitat e K.Pr.Penale, sepse në bazë të nenit 296/1 të K.Pr.Penale, të dhënat atij i duheshin marë *në praninë e detyrueshme të mbrojtësit të tij*. Vendimi i gjykatës për arrestimin e tij ishte marë e bazuar në provat e sekuestruara atij nga ana e policisë. Pavarësisht se gjykata e kishte vlerësuar të ligjshëm arrestimin e tij, inspektori i policisë kriminale që ka edhe atributet e oficerit të policisë gjyqsore nuk mund të përjashtojë nga përgjegjësia disiplinore.

Këto veprime të tij, përbëjnë shkelje të rëndë ligjore dhe konkretisht të pikave 1 dhe 3 të nenit 54 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që thotë se: *“Fëmijët, të rinjtë, ... kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi...”* dhe të pikës 2 të nenit 27 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, që thotë se: *“Gjatë përmbushjes së detyrës punonjësit të policisë nuk i lejohet të kryejë ndaj individëve veprime të pabazuara në*

ligj, ndëshkime ose trajtime çnjerëzore apo denigruese si dhe çdo lloj torture”.

Për këto arsye, i rekomandua Shefit të Komisarariatit të Policisë Nr. 3 Tiranë t’i jepte atij masë disiplinore në bazë të ligjit Nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” dhe masën disiplinore t’ia komunikonte në prani të efektivit me qëllim që të parandalohen shkelje të tilla në të ardhmen. Rekomandimi u mirëprit dhe u zbatua.

6. Rasti i filluar me inisiativë nga ana jonë për vetvarjen e shtetasit A. B. në ambjentet e Komisarariatit të Policisë Nr. 3 Tiranë, në mëngjezin e datës 07.10.2005. Nga ana jonë u bënë verifikimet përkatëse, u pyetën punonjësit e policisë që kishin dijeni për ngjarjen dhe kishin patur kontakte me të shoqëruarin dhe familjarët e tij, si dhe bëmë kqyrjen e vëndit të ngjarjes. Nga dokumentacioni i administruar dhe verifikimet e bëra rezultoi se më datë 06.10.2005, rreth orës 23.00, mbi bazën e ankimit të shtetasës Z. B. (nënës së tij), për keqtrajtim dhe kërcënime serioze për vrasjen e saj, nga ana e djalit të vet, viktimës A. B., punonjësit e policisë të Komisarariatit të Policisë Nr. 3 Tiranë, kishin shoqëruar këtë të fundit, në ambjentet e këtij komisarati. Viktima A. B., gjatë shoqërimit të tij, ishte mbajtur në një nga dhomat e katit të parë të ndërtesës së komisarariatit, që përdoret si dhomë shoqërimi për personat e shoqëruar dhe i siguruar me dryn. Shoqërimi i tij kishte vazhduar në këtë gjendje deri ditën e nesërme më dt. 07.10.2005, ora 08.30, kur nga ana e punonjësit të policisë së informacionit të këtij komisarati ishte konstatuar vdekja e papritur e të shoqëruarit.

Trajtimi i tij në këtë mënyrë, duke u mbajtur në një dhomë të kyçur nga ana e jashtëme e portës hyrëse, ka qënë në kundërshtim me rregullat ligjore në përgjithësi, si dhe me Udhëzimin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 168, datë 20.10.1993 “Për shoqërimin e shtetasve në komisarate, reparte, posta të policisë dhe në zyra të tjera të tyre”, i cili ishte në zbatim. Sipas pikës 4 të Udhëzimit të Ministrit të Rendit Publik Nr. 168, datë 20.10.1993, *“personi që ka kryer ose dyshohet se ka kryer një vepër penale që dënohet me heqje të lirisë, sigurohet duke u vendosur në dhoma të posaçme të cilat për nga ndërtimi janë të njëjta me dhomat e paraburgimit. Për sigurimin e tyre vendosen punonjës policie për të mos lejuar largimin e tyre në mënyrë arbitrare”*. Ky Udhëzim nuk bënë fjalë për mbajtjen e tyre në dhoma shoqërimi, dyert e të cilave të mbyllen me dryna, siç ishte vepruar në rastin konkret me të ndjerin A. B.. Ndonëse rastin e kishte në hetim organi i Prokurorisë, ku edhe do të arrihet në një përfundim mbi ekzistencën ose jo të veprës penale dhe të autorit të saj, ne konstatuam se mbajtja e të ndjerit A. B. në një dhomë të mbyllur me çelës nga jashtë, ka qënë një shkelje e rëndë e të drejtave të tij të mbrojtura me ligj.

Në përfundim të verifikimeve të kësaj çështjeje, arritëm në konkluzionin se, në Komisarariat e Policisë Nr. 3 Tiranë ishte bërë metodë pune mbajtja e personave të shoqëruar, duke përfshirë edhe rastin konkret me të ndjerin A. B., në dhoma shoqërimi, dyert e të cilave mbylleshin me dryna. Ky veprim vinte në kundërshtim si me rregullat ligjore në përgjithësi, ashtu dhe me Udhëzimin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 168, datë 20.10.1993.

Për këtë arsye, i rekomanduam Drejtorit të Policisë të Qarkut Tiranë t'u jepte masa disiplinore drejtuesve të Komisarariatit të Policisë Nr. 3 Tiranë. Gjithashtu i rekomanduam, që kjo shkelje, si dhe masat disiplinore të dhëna, të përgjithësohen në të gjitha Komisarariatet e Policisë së Qarkut Tiranë, me qëllim parandalimin në të ardhmen të rasteve të tilla.

Rekomandimi u mirëprit, u dhanë masa disiplinore ndaj dy punonjësve të policisë dhe ndërkohë Shefi i Komisarariatit u shkarkua nga detyra dhe u transferua në një detyrë tjetër.

7. Ankesa e shtetasit L. B., banor i qytetit Gramsh. Ai na shkruante nga Italia, se prej disa vitesh kishte shkuar në Itali si emigrant ekonomik dhe ishte i pajisur me dokumenta të rregullta nga autoritet italiane. Gjate kësaj kohe kishte hyrë e dalë disa herë në Shqipëri konform ligjit në Vënd Kalimet Kufitare. Më 23 Dhjetor 2004, ai kishte hyrë në Rinas, por ishte ndaluar nga Policia Shqiptare për disa orë, për shkak se i dilte emri në kompjuter si person që kishte probleme me drejtësinë shqiptare. Pasi i kishin kontrolluar dokumentat, të cilat kanë rezultuar të rregullta e kanë lënë të lirë. Mbas këtij rasti, gjatë vitit 2005, ai kishte ardhur disa herë në Shqipëri duke hyrë në Portin e Durrësit. Mirëpo edhe aty ishte ndaluar e izoluar për disa orë nga policia e jonë, gjithmon me të njëjtin pretendim se i dilte emri në kompjuter. Nga punonjësit e policisë i ishte thënë që të mbante me vete edhe dokumenta të tjera si çertifikatën e lindjes me fotografi dhe vërtetime nga gjykata e prokuroria ku të vertetohej se ai nuk kishte probleme penale. Ishte pajisur edhe me këto dokumenta dhe përsëri ai kishte patur shqetësime gjatë hyrje-daljeve në VKKufitare Shqiptare. Kopje origjinale të këtyre dokumentave ankuesi na i kishte dërguar edhe neve së bashku me ankesën. Ankuesi kërkonte ndihmën tonë që t'i zgjidhej ky problem dhe t'i hiqej emri nga kompjuteri, pasi ai ishte i rregullt, nuk kishte precedentë penale dhe pengesa ligjore për të realizuar të drejtën kushtetuese të lëvizjes së lirë për jashtë shtetit.

Për të bërë të mundur zgjidhjen e kësaj ankese, ne iu drejtuam Drejtorisë së Policisë Kufitare dhe Migracionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të cilës i rekomanduam verifikimin e rastit konkret dhe zgjidhjen e tij në se nuk kishte pengesa ligjore. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën e datës 12.12.2005, u informuam se në sistemin kompjuterik të vendosur në Pikat

e Kalimit të Kufirit ishin regjistruar dy shtetas me emrin e ankuesit si persona që kishin probleme me organet e drejtësisë. Pas ndërhyrjes sonë për ankuesin ishte bërë ndryshimi i nevojshëm në sistemin kompjuterik dhe pas kësaj ai nuk do të kishte probleme të kësaj natyre në të ardhmen. Në prag të festave të fundvitit 2005, ankuesi erdhi në Shqipëri dhe na njoftoi se në vendin e hyrjes nuk i ishte sjellë më asnjë shqetësim nga punonjësit e policisë.

8. Ankesa e familjarëve të shtetasës së mitur G. S., me banim në qytetin e Burrelit. Ata na shkruanin se fëmija i tyre, me moshe 3 vjeçe e 6 muajshe ishte shumë e sëmurë nga zemra dhe në rrezik për jetën. Mjeku kurues, nëpërmjet epikrizës së lëshuar në datën 13.07.2005, kishte konstatuar gjëndjen e rëndë shëndetësore të saj. Nisur nga gjëndja shëndetësore e të sëmurës dhe ekzaminimet Kliniko-Laboratorike, mjeku kishte rekomanduar ndërhyrje kirurgjikale jashtë shtetit në një kohë sa më të shpejtë në klinikë kardiokirurgjikale, pasi ishte i pamundur realizimi i ndërhyrjes në vendin tonë. Me përpjekjet e familjarëve dhe të afërmëve të saj ishte bërë e mundur që ndërhyrja kirurgjikale të bëhej jashtë shtetit nëpërmjet një shoqate austriake, e cila kishte marrë përsipër edhe shpenzimet financiare. Pas rekomandimit të mësipërm të mjekut, nëna e saj, nga mezi i muajit korrik 2005, ishte paraqitur në Komisaratin e Policisë Burrel dhe kishte aplikuar për pajisjen e vajzës së saj me pasaportë duke dorëzuar të gjitha dokumentat e kërkuara nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi, duke përfshirë edhe epikrizën e vajzës. Ankuesit së bashku me ankesën na sollën edhe fotokopje të dokumentave të dorëzuara në Polici si, çertifikatën e lindjes me fotografi të fëmijës, çertifikatën familjare të saj, prokurën e posaçme të të atit të saj, i cili emëronte si përfaqësuese të tij të posaçme bashkëshorten e vetë, të cilës i kishte dhënë të drejtën e pajisjes me pasaportë të vajzës dhe deklaratën noteriale e bërë nga nëna e saj, e cila jepte pëlqimin për pajisjen me pasaportë të fëmijës së saj. Mirëpo pajisja e fëmijës së tyre me pasaportë nuk ishte bërë edhe pse kishte kaluar afati i parashikuar në ligjin përkatës. Shkaku i mospajisjes me pasaportë ishte, se i ati i saj ishte në kërkim nga Policia. Për këtë problem familjarët e saj ishin ankuar tek drejtuesit e Komisarariatit të Policisë Burrel dhe në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Dibër, por përsëri nuk ju ishte zgjidhur problemi.

Nga ana jonë, për të sqaruar këtë ankesë dhe pretendimet e ankuesve, në datën 02.09.2005, u komunikua në telefon me Shefin e Komisarariatit të Policisë Burrel, z. Ilir Musta. Ai na sqaroi se e njihnte problemin dhe se Gloria nuk pajisej me pasaportë sepse sipas tij kishte pengese ligjore, e cila ishte “*qënia në kërkim e babait të saj*”. Gjithashtu, ai na informoi se këtë problem e njihnin edhe titullarët e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Dibër, nga ai varej.

Ne konstatuam se qëndrimi i mbajtur nga organet e Policisë, Komisariati i Policisë Burrel dhe Drejtoria e Policisë e Qarkut Dibër, në trajtimin e këtij rasti, ishte antikushtetues, i kundërligjshëm dhe antihuman njëkohësisht sepse me këtë qëndrim mosveprues të saj, Policia po rrezikonte shumë dhe me dashje indirekte jetën e kësaj fëmije të pafajshme.

Për të bërë të mundur rivendosjen në vënd të së drejtës kushtetuese dhe ligjore të shkelur shtetases së mitur G. S., i rekomanduam Drejtorit të Policisë së Qarkut Dibër që të pajiste me pasaportë në mënyrë të menjëhershme (*urgjente*) shtetasen G. S.. Gjithashtu, në rekomandim i bëmë të ditur se në qoftë se nuk do ta zbatonin brenda 5 ditëve rekomandimin tonë, nga ana jonë do t'i kërkohej organit të prokurorisë fillimi i ndjekjes penale për shkelësit e ligjit. Rekomandimi u mirëprit, asaj iu dha menjëherë pasaporta dhe drejtuesve të Komisariatit të Policisë Burrel iu dhanë masa disiplinore.

9. Ankesa e shtetasit A. K. banor i qytetit Kavajë, Ai na shkruante se në datën 27.01.2005, rreth orës 0.30 kishte qënë së bashku me një shok duke udhëtuar nga Kavaja për në Tiranë me makinën e tij të markës BENZ. Në afërsi të hotel "Egnatia" ai ishte ndaluar nga një grup policësh me në krye Shefin e Rendit të Komisariatit të Policisë Kavajë Arjan Kita, i cili i ka urdhëruar policët për t'i shoqëruar ata në polici. Pasi janë çuar në Komisaratin e Policisë Kavajë, ata ishin mbajtur aty deri në orën 9.00 dhe nuk ju ishte thënë shkak i shoqërimit në polici, si dhe nuk ishin pyetur nga asnjë punonjës policie. Gjithashtu, ankuesi pretendonte se makinën ia kishin mbajtur në polici në mënyrë të kundërligjshme dhe pa mbajtur ndonjë procesverbal bllokimi apo dokument tjetër.

Nga ana jonë u komunikua me drejtuesit e Komisariatit të Policisë Kavajë, duke i kërkuar arësyet e shoqërimit të ankuesit dhe shokut të tij në polici, shkaqet e bllokimit të automjetit të tij, si dhe për mosmbajtjen e dokumentacionin përkatës. Përgjigjia e tyre ishte, se shoqërimi i tyre ishte bërë për arsye verifikimi. Meqënëse nuk ndodheshim në rastet ligjore të shoqërimit të shtetasve në zyrat e policisë dhe nuk kishte shkaqe ligjore për bllokimin e automjetit, i rekomanduam dhënien e menjëhershme të automjetit ankuesit dhe mos përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhem. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.

10. Ankesa e shtetasit V.Gj., banor i qytetit Tiranë. Ai na shkruante se kishte bërë aplikimin për t'u pajisur me pasaportë për jashtë shtetit në Komisaratin e Policisë Nr. 2 Tiranë. Pas afatit një mujor të prodhimit të saj, ai kishte shkuar në Sektorin e Pasaportave të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë për marrjen e saj, por atë nuk ia jepnin dhe ndërkohë i thoshnin që të vinte ditë tjetër. Ai i shqetësuar, ishte interesuar në Komisaratin e Policisë Nr. 2 Tiranë, ku kishte bërë aplikimin. Aty kishte marrë përgjigje se dokumentat ishin nisur në Sektorin e Pasaportave.

Ankuesi kishte shkuar përsëri në këtë sektor, nuk e kishte marrë pasaportën dhe nuk i jepeshin sqarime për arësyet e mos dhënies së saj.

Nga verifikimet që u bënë nga ana jonë në Komisariatin e Policisë Nr. 2 Tiranë, rezultoi se ky komisarjat i kishte përcjellë dokumentat e ankuesit në Sektorin e Pasaportave. Ndërsa në Sektorin e Pasaportave u informuam se dokumentat e ankuesit kishin ardhur në këtë sektor, por për shkak të rrëmbujës së shkaktuar për arësye të rikonstruksionit të godinës, praktika e tij nuk po gjendej. Meqënëse mosgjendja e dokumentave të ankuesit kishte ndodhur për shkak të pakujdesisë së punonjësve të këtij sektori, nga ana e tyre u kërkua që ankuesi të vinte e të përsëriste aplikimin, ndërsa shpenzimet e bëra për të dytën herë do të paguheshin nga punonjësi që kishte humbur dokumentat. Ne e njoftuam ankuesin që të shkonte në Polici, ai shkoi dhe problemi iu zgjidh.

III. Ankesat për largime nga puna të punonjësve të ish M.R.Publik dhe të Policisë së Shtetit, si dhe ankesat për mos respektimin e të drejtave të tyre.

Në Institucionin tonë kanë paraqitur ankesa 22 oficerë, policë dhe punonjës të tjerë të strukturave mbështetëse të ish M.R.Publik për largime të padrejta nga puna. Sipas tyre, ankuesve nuk ju është komunikuar motivacioni dhe shkaqet ligjore të largimit nga puna, nuk janë thirrur e dëgjuar sipas procedurave përkatëse kur ju jepen masa disiplinore. Ndërsa në disa raste të tjera atyre ju atribuohen motivacione të pavërteta, subjektive dhe denigruese.

Gjatë viteve të fundit nga autoritetet e ish M.R.Publik dhe të Policisë së Shtetit është propaganduar kryerja e reformës në Polici. Mirëpo, në fakt nga krerët e tyre nuk janë publikuar kriteret ligjore të saj, nuk ka patur transparencë dhe objektivitet gjatë këtij procesi të rëndësishëm për të pastruar radhët e Policisë nga të pa aftët dhe të korrumpuarit. Edhe kur është folur për kritere profesionale dhe rezultate në punë si kritere bazë për bërjen e reformës, ato kanë mbetur një farsë dhe në realitet nuk janë zbatuar. Në emër të reformës apo “luftës kundër korrupsionit, për të vendosur rend brenda rendit”, figura të rëndësishme të Policisë së Shtetit, si drejtorë apo shefa komisarjati janë shkarkuar nga detyra, përjashtuar nga policia apo kallzuar për ndjekje penale. Ky fenomen, për veç pasojave negative që ju sjell të ndëshkuarëve, duke ju ndërprerë marrëdhëniet e punës, sjellë në të njëjtën kohë edhe pasoja morale dhe humbjen e besimit të publikut ndaj këtyre organeve. Gjithashtu, ai i shkakton edhe një dëm të konsiderueshëm ekonomik buxhetit të shtetit në përgjithësi dhe buxhetit të vetë këtyre organeve në veçanti. Krerëve të M.R.Publik dhe të Policisë duhet t’ju tërheq vëmëndjen fakti, se shumë nga të akuzuarit dhe të përjashtuarit nga Policia, kanë fituar pafajësinë nga organet e drejtësisë për akuzat e bëra

dhe/apo të drejtën e dëmshpërblimit në rrugë gjyqsore për përjashtim të padrejtë nga Policia. Edhe ky fakt është një tregues real, se akuzat e ngritura apo përjashtimet e bëra për shumë punonjës policie nuk kanë qënë të motivuara dhe të bazuara në ligj e në prova. Shkarkimet nga detyra të drejtuesve të Policisë pa mbushur disa muaj në vëndin e punës nuk mund të ndikojnë në rritjen e besimit publik ndaj Policisë. Edhe në se ato bëhen të drejta për shkak të shkeljeve ligjore apo të Kodit Etik, përseri ka vënd për kritika, sepse personat e tillë nuk janë studjuar mirë para emërimit në detyrë. Gjithashtu, kjo është edhe një tregues i faktit se emërimet në detyra të punonjësve të policisë nuk bëhen gjithmonë mbi bazë të kriterëve ligjore, profesionale e morale njëkohësisht, por mbi baza njohjesh personale, përkatësive politike dhe për interesa të ngushta.

Si shëmbuj të zgjidhjes pozitive në favor të ankuesve mund të përmëndim:

1. Ankesat e disa ish punonjësve të Policisë me kontratë, të cilët kishin dalë në lirim për shkak të shkurtimit të funksionit organik. Ata na shkruanin, se pas lirit nga Policia kishin plotësuar dhe dorëzuar në M.R.Publik dokumentacionin e nevojshëm për përfitimin e pensionit të parakohshëm sipas ligjit përkatës. Ankuesit pretendonin, se megjithëse kishte kaluar një kohë relativisht e gjatë nga bërja e dokumentave, ata nuk e kishin përfituar të drejtën ligjore, marrjen e pensionit të parakohshëm.

Nga ana jonë iu kërkuan shpjegime Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit na ktheu përgjigje duke na informuar se: “Bazuar në Ligjin Nr. 8087, datë 13.03.1996 dhe Ligjin Nr. 8521, datë 30.07.1999 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, për plotësimin e dokumentacionit, veç të tjerash, në modelarin 2/1 kërkohet paga referuese në datën e daljes në rezervë, lirim dhe paga referuese kur mbush moshën 47 vjeç, e llogaritur për funksionin organik që ka patur. Në këto kushte duhet bërë njësimi i gradës ushtarake në atë policore. Për këtë është përgatitur Urdhëri i Ministrit të Rendit Publik, pritët miratimi i tij dhe pastaj do të procedohet më tej”.

Nga verifikimet e bëra lidhur me këtë ankesë arritëm në konkluzionin se ish punonjësve të Policisë me kontratë, të cilët kishin dalë në lirim për shkak të shkurtimit të funksionit organik, ju ishin shkelur të drejtat ligjore financiare. Shkak për shkeljen e të drejtave të tyre, mos përfitimin e pensionit të parakohshëm, ishte bërë mungesa e akteve nënligjore, duke përfshirë edhe Urdhërin e Ministrit të Rendit Publik “Për njësimin e gradave ushtarake në ato policore”, si dhe mungesa e bashkëpunimit të strukturave të M.R.Publik me Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Për të këto arsye, i rekomanduam Ministrit të Rendit Publik dhe ISSH marrjen e masave të nevojshme për të bërë të mundur zgjidhjen sa

më shpejt të problemit të ankuesve. Rekomandimi u mirëprit dhe për zgjidhjen e këtij problemi, Instituti i Sigurimeve Shoqërore nxori shkresën Nr. 2068, dt. 07.10.2005. Menjëhere pas dërgimit të kësaj shkrese, nga strukturat përkatëse të M. Brendshme u plotësua dokumentacioni për çdo aplikues për pension të parakohshëm dhe iu dërguan Zyrrave Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, duke e zgjidhur përfundimisht problemin e tyre.

2. Ankesa e shtetasit A. S., i cili na shkruante se kishte qënë sportist, peshëngritës i Dinamos për 11 vjet, pjestar i ekipit kombëtar të peshëngritjes dhe se 3 herë rrjesht në vitet 1980; 1981 dhe 1982 ishte shpallur kampion kombëtar. Pas lënies së sportit ai kishte punuar shofer në Parkun e M.R.Publik dhe se në vitin 1997 ishte larguar padrejtësisht nga puna. Pas largimit të padrejtë nga puna ishte ankuar në disa organe shtetërore deri në organet më të larta të administratës shtetërore. Sipas tij, ishte urdhëruar rikthimin i tij në punë, por ky urdhër nuk ishte zbatuar nga strukturat përkatëse të M.R.Publik. Ai na shkruante se për zvarritjet e bëra për rikthimin e tij në punë, ishte takuar edhe me titullarët e Ministrisë së Rendit Publik, por përveç marjes së premtimeve, nuk ishte bërë i mundur rikthimi i tij në punë.

Nga verifikimet e bëra nga ana jonë u konkludua se ankuesi ishte larguar padrejtësisht nga puna dhe se ai nuk kishte asnjë pengesë ligjore e morale për rikthim në punë. Të ndodhur në këto kushte i rekomanduam M.R.Publik dhe më pas M.Brendshme rikthimin e tij në punë. Rekomandimi u mirëprit dhe ankuesi u rikthye në punë.

3. Ankesa e shtetasit V. M., ish punonjes policie, me detyrën e specialistit në Zyrën e Armatimit dhe të Pajisjeve Speciale të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Ai na shkruante se me Urdhër të Ministrisë së Rendit Publik ishte larguar nga Policia e Shtetit me motivacionin “Për shkurtim të funksionit organik”. Sipas tij, në fakt funksioni organik (vendi i punës) i tij nuk ishte shkurtuar edhe pas bërjes së strukturës së re organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Gjatë punës në Polici, ai kishte dhënë një kontribut shumë të madh në detyrë që nga viti 1997 dhe deri në momentin e largimit, si dhe nuk kishte marrë asnjë masë disiplinore. Ankuesi ngrinte edhe shqetesimin e ligjshëm, se reforma në Polici nuk po bëhej në bazë të konkurimit të vlerave, por mbi bazën e njohjeve personale të drejtuesve të saj. Largimi i tij nga puna ishte i padrejtë edhe për faktin, se ai ishte me arsim të lartë, kishte dhënë disa provime pasuniversitare duke përfshirë edhe gjuhën e huaj dhe kishte bërë disa kualifikime në sektorin e vetë. Gjithashtu, ai pretendonte se motivacioni i largimit të tij nga detyra ishte i pavërtetë, dhe ishte vendosur për të justifikuar si të ligjshëm largimin nga Policia.

Për të sqaruar pretendimet e ankuesit, ne i kërkuam shpjegime Ministrisë së Rendit Publik për shkakun dhe motivin ligjor të largimit

ankuesit nga Policia. Ministri me shkresë na informoi se ankuesi ishte larguar nga Policia me motivacionin “Për shkurtim të funksionit organik”. Largimi i tij ishte bërë në mbështetje të nenit 20, pika 1, gërma “ç” të ligjit Nr. 8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” dhe për shkak të ndryshimeve të strukturës e përbërjes organike të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Gjithashtu, na informoi se largimi i tij nga puna kishte të bënte edhe me mospërputhjen e funksionit organik me specialitetin për të cilin ishte diplomuar (Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficereve, specialiteti tanke).

Nga verifikimet e bëra nga ana jonë rezultoi se pretendimet e ankuesit për mos shkurtimin e funksionit organik të vëndit të tij të punës ishin të vërteta, sepse në fakt ky funksion ishte edhe në strukturën e re të Policisë së Shtetit. Pra shkurtimi i funksionit organik, që kishte shërbyer si “shkak ligjor” për largimin e ankuesit nga Policia nuk qëndronte. Për rrjedhojë, në rastin konkret, nuk qëndronte edhe baza ligjore e largimit të tij nga Policia, gërma “ç” e pikës 1 të nenit 20 të ligjit Nr. 8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, sepse në fakt nuk kishte patur shkurtim të funksionit organik. Ndërkohë duhet të shtojmë se, ndonëse ankuesi nuk kishte specialitetin përkatës, ai kishte 8 vjet që punonte në polici dhe kishte bërë disa specializime për sektorin që kishte mbuluar. Në se do të ishte ky fakt shkak i vërtetë i largimit të tij nga Policia, atëhere urdhëri i largimit të tij do të bëhej me këtë motivacion dhe jo me atë që ishte bërë në fakt, për shkurtim të funksionit organik.

Të ndodhur para këtyre fakteve, arritëm në konkluzionin se ankuesi ishte larguar padrejtësisht nga puna. Për të rivendosur në vend të drejtën e shkelur atij, i rekomandua Ministrit të Rendit Publik që të ripranonte në Polici atë. Mirëpo, megjithëse e kemi përsëritur rekomandimin, nuk na është kthyer përgjigjia për shqyrtimin e tij.

4. Ankesa e disa punonjësve të Arkivit të M.R.Publik. Ata na shkruanin se në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 726, datë 21.12.2000, “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, pika 7, ju takonte të paguheshin me shtesë mbi pagën bazë mujore, në masën deri në 30 %, sipas sektorëve, por përveç shtesës prej 5 %, ajo nuk ju ishte dhënë. Sipas tyre, të gjitha dokumentat kishin kaluar dhe miratuar në sektorët përkatës të M.R.Publik, por ishin bllokuar padrejtësisht dhe në kundërshtim me aktin normativ të cituar më sipër nga strukturat drejtuese të M.R.Publik.

Për të marë një informacion të plotë dhe të saktë rreth kësaj ankese, ne i kërkuam shpjegime Ministrit të Rendit Publik. Megjithëse kaloi shumë kohë tej afatit ligjor dhe megjithë interesimin tonë të vazhdueshëm, përgjigjia e kërkuar nuk na erdhi.

Duke studjuar me vëmëndje ankesën dhe bazën ligjore të saj, rezultoi se punonjësit e Arkivit të M.R.Publik kanë të drejtë të marin

shtesë mbi pagën bazë mujore për punë të dëmshme për shëndetin në masën deri në 30 % sipas sektorëve dhe specialiteteve përkatëse. Në fakt, ata kanë marë dhe marin aktualisht vetëm 5 % të shumës që ju takon dhe prej disa vitesh padrejtësisht nuk ju është paguar pjesa tjetër në masën deri në 25 % të pagës bazë mujore.

Për të rivendosur në vënd të drejtat ligjore që ju janë shkelur ankuesve, i rekomandua ish Ministrit të Rendit Publik marrjen e masave të nevojshme për dhënien e shtesës deri në masën 30 % mbi pagën bazë mujore punonjësve të Arkivit të M.R.Publik sipas sektorëve dhe specialiteteve përkatëse. Mirëpo, rekomandimin megjithëse e kemi përsëritur edhe Ministrit të Brendshëm, ai nuk është shqyrtuar akoma.

5. Ankesa shtetasi B. K., ish Drejtor i Drejtorisë Qëndrore të FS & FNSH. Ai na shkruante se gjatë gjithë punës së tij në këtë detyrë dhe në ato të mëparshme në Polici kishte patur rezultate të larta, vlerësime pozitive, nuk kishte marë asnjë masë disiplinore dhe se kishte bërë disa trajnime e kualifikime. Me urdhër të Ministrit të Rendit Publik datë 12.02.2004, ai ishte përjashtuar nga Policia e Shtetit padrejtësisht. Ndaj kësaj mase disiplinore të padrejtë dhe ekstreme, ai kishte bërë ankim në Komisionin Qëndror të Disiplinës të Policisë së Shtetit. Ky Komision, kishte vendosur ta konsiderojë të tejkaluar urdhërin për përjashtimin e tij nga Policia dhe i kishte rekomanduar Ministrit të Rendit Publik rikthimin e tij në strukturat e Policisë së Shtetit. Mirëpo, megjithëse kishin kaluar disa muaj nga marrja e këtij vendimi, ankuesi nuk ishte rikthyer në Polici.

Nga verifikimet e bëra rezultoi se në propozimin e Komisionit të Disiplinës, Ministri i Rendit Publik kishte bërë shënimin që të verifikohej qëndrimi i tij në media dhe në vartësi të këtij problemi do të procedohej më tej. Sektorët dhe personat që kishin bërë verifikimet, kishin informuar strukturat përkatëse se qëndrimi i ankuesit ndaj medias kishte qënë korrekt dhe se nuk kishte cënuar normat e punës. Edhe pas këtyre verifikimeve nuk kishte patur zgjidhje të problemit. Nga Drejtoria e Burimeve Njërëzore e M.R.Publik u informua se që ai të kalonte në emërtesë duhej të propozohej nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, por propozimi nuk ishte bërë.

Ne i bëmë disa shkresa Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit lidhur me këtë problem. Por përveç përgjigjeve formale dhe justifikuese që na kthyeu, prej tij nuk u ndërmorë ndonjë veprim konkret për të vënë në lëvizje rikthimin e ankuesit në Polici.

Nga ana jonë u arrit në konkluzionin se përjashtimi nga Policia e Shtetit i ankuesit B. K. ishte bërë në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me kriteret ligjore.

Për të bërë të mundur rivendosjen në vënd të të drejtës së shkelur ankuesit, i rekomandua Ministrit të Rendit Publik që të ripranonte në

Policinë e Shtetit ish punonjës in e policisë B. K.. Mirëpo rekomandimi në mënyrë të padrejtë nuk pranua.

6. Ankesa e vëllait të ish punonjës it të policisë A. B., efektiv i Policisë Berat, v rarë aksidentalisht pas shërbimit më datë 27.12.2004, nga një automjet. Ai na shkruante se i ndjeri A. B. kishte lënë bashkëshorten dhe dy fëmijë të mitur. Bashkëshortja ishte e papunë, nuk kishte marë asnjë ndihmë financiare nga M.R.Publik dhe nuk i ishte lidhur pension suplementar familjar. Sipas ankuesit, drejtuesit e M.R.Publik dhe të Policisë kishin premtuar ta ndihmonin familjen e tij, duke ia futur bashkëshorten në punë në Komisar iatin e Policisë Kuçovë dhe se fëmijëve do t'iu lidhej pension, por në fakt nuk ishte bërë asnjë veprim konkret në ndihmë të tyre. Gjithashtu, ai pretendonte se kishte bërë disa ankesa në organet drejtuese të Policisë, por kishte marrë vetëm premtime.

Nga ana jonë iu kërkua informacion Drejtorisë Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë e Policisë së Qarkut Berat rreth kësaj ankese. Prej tyre u informuam se familja e tij nuk mund të përfitonte nga VKM Nr. 552, dt. 27.11.1999 “Për trajtimin ekonomik financiar të familjeve të punonjësve të policisë që humbin jetën ose plagosen për shkak të detyrës”, sepse ai nuk ishte v rarë në krye dhe për shkak të detyrës.

Mirëpo në bazë të Ligjit Nr. 8087, dt. 13.03.1996 dhe Ligjit Nr. 8521, dt. 30.07.1999 “Për sigurimin shoqëror suplementar të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, familjes së tij i takonte të merte pension suplementar familjar. Për këtë i rekomanduam Drejtorisë së Policisë të Qarkut Berat që të përgatiste dokumentat e nevojshme për përfitimin e tij. Ndërsa ankuesit i sugjeruam që bashkëshortja e tij ta ndiqte këtë problem në Agjensinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe po të ishte e nevojshme edhe në Drejtorinë Rajonale përkatëse. Nga Drejtor ia e Policisë e Qarkut Berat u informuan se megjithë vështirësitë e shumta për shkak të organikës dhe arsimit, bashkëshortja e të ndjerit do të sistemohej në punë, në Komisar iatin e Policisë Kuçovë. Për këtë kishte dalë edhe urdhëri përkatës dhe ajo filloi punë.

7. Ankesa e punonjës it të policisë Q. H., efektiv i Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë. Ai na shkruante se më datën 03.05.2003, i ishte dhënë grada “Agjent”, ndërkohë që në bazë të dispozitave ligjore i takonte grada më e lartë. Ai nuk ishte dakort me gradën e dhënë dhe më datë 05.05.2003, kishte bërë ankesa pranë komisionit të dhënies së radave. Meqënëse problemi u bë publik në media, më datë 16.05.2003, ai u përjashtua nga Policia. Pas ankesës në Institucionin tonë dhe pas rekomandimit të bërë nga ana jonë, ankuesi u rikthye në detyrë më datë 16.11.2003, duke iu dhënë e njëjta gradë “Agjent”. Ai bëri përsëri ankesë në komisionin e shqyrtimit të ankesave për gradat, por megjithëse kaluan disa muaj nuk mori përgjigje prej tij.

Nga ana jonë iu kërkuan shpjegime Zv/Ministrit të Rendit Publik, i cili na informoi se ankesa e shtetasit Q. H. për rishikimin e gradës së dhënë nuk ishte shqyrtuar akoma, pasi nuk kishte komision të ngritur për këtë qëllim. Megjithatë, ai na premtoi se sapo të mundesohej krijimi i Komisionit të Gradimeve për rishikimin e gradave, kërkesa e tij do të merej në konsideratë. Mirëpo, megjithëse kaloi më se një vit, përsëri ankuesi nuk mori ndonjë përgjigje për shqyrtimin e ankesës së tij. Me shkresat tona i kërkua shpjegime Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për ankesën e bërë në Institucionin tonë nga shtetasi Q. H. Pas kësaj këkese, nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë, me shkresën Nr. 10140/1, dt. 25.06.2005, u informuam se kërkesa e Q. H. për rritje grade ishte diskutuar e trajtuar në Komisionin e Shqyrtimit të Gradave të kësaj Drejtorie dhe më datë 22.06.2005, praktika e tij ishte dërguar për kompetencë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë.

Meqënëse përgjigjia e mësipërme nuk ishte përfundimtare, iu drejtua përsëri Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke i kërkua shpjegime rreth ankesës dhe për qëndrimin e mbajtur në lidhje me shqyrtimin e saj. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me shkresën Nr. 300 Prot., dt. 20.10.2005, në pikën 6 të saj, midis të tjerave na informoi se: "...Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë ju ka dërguar përgjigjet *për zgjidhjen e ankesës*, përkatësisht me shkresat Nr. 10140/1, dt. 25.06.2005 dhe Nr. 10140, dt. 25.08.2005".

Në fakt, Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë, me përgjigjen e datës 22.06.2005, të cilën e cituam më sipër, na informoi se Komisioni i Shqyrtimit të Gradave të kësaj Drejtorie e kishte trajtuar kërkesën e tij dhe më datë 22.06.2005, praktika e tij ishte dërguar për kompetencë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë. Ndërsa me shkresën e datës 25.08.2005, ndërmjet të tjerave na informoi se bazuar në kreun II, neni 9, pika 2 të ligjit Nr. 8643, dt. 20.07.2000 "Për gradat në Policinë e Shtetit" gradimi nga grada policore "Agjent" në gradën policore "Agjent i parë" kërkon vjetërsi kohe 4 vjet.

Përgjigjet e Policisë, si ajo e Drejtorisë së Përgjithshme ashtu edhe ato të Drejtorisë së Qarkut Tiranë nuk ishin korrekte dhe në të njëjtën kohë ishin kontradiktore ndërmjet tyre sepse:

Së pari, ajo që është më e rëndësishmja, kjo ankesë nuk ishte zgjidhur akoma, siç pretendohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në përgjigjen e dërguar, megjithëse kishin kaluar dy vjet.

Së dyti, ankuesi nuk kërkonte gradimin nga "Agjent", në gradë më të lartë "Agjent i parë" për shkak të mbushjes së vjetërsisë 4 vjet duke mbajtur gradën "Agjent", siç pretendonte në përgjigjen e dytë Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, por ai ishte ankuar për dhënien e padrejtë dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të gradës minimale "Agjent".

Së treti, në se Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë do t'i përmbahej qëndrimit të shprehur në shkresën e datës 25.08.2005, atëhere përse ajo ia dërgoi Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit praktikën e ankuesit me shkresën e dt. 22.06.2005, kur kishte mundësinë që të merrte vendim duke ja refuzuar ankesën atij.

Së katërti, ankesa e ankuesit për gradën e dhënë ishte plotësisht e ligjshme. Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta universale e ankimit në rrugë administrative kundër një akti administrativ, i cili në rastin konkret ishte urdhëri përkatës për dhënien e gradës ankuesit. Në mënyrë të posaçme, ankimi për gradën është një e drejtë që bazohet në pikën 14 të Urdhërit të Ministrit të Rendit Publik Nr. 1484, dt. 18.06.2001 "Për krijimin e Komisioneve të Gradimeve" dhe në pikën 8 të Urdhër – Shërbimit Nr. 1172, dt. 04.04.2003, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit "Për përbërjen dhe procedurat e Komisionit të Gradimeve të Rolit Bazë". Në të njëjtën kohë, ankesa e tij mbështetej edhe në dispozitat e Kodit të Proçedurave Administrative dhe konkretisht në Seksionin VI me titull "Ankimi administrativ", neni 135 e në vijim. Në këto dispozita është parashikuar detyrimi i organeve të administratës për të shqyrtuar ankimin si dhe proçedura e shqyrtimit të tij.

Së pesti, në Policinë e Shtetit kishte një praktikë të mirë për pranimin dhe zgjidhjen e ankesave të punonjësve të policisë për gradat, e cila është zbatuar në bazë të Urdhërit të Ministrit të Rendit Publik Nr. 1861, dt. 20.05.2003.

Së gjashti, nga ky veprim neglizhues, ankuesit i ishte shkelur e drejta e shqyrtimit të ankimit administrativ dhe për rrjedhojë, në bazë të nenit 137/3 të K.Pr.Administrative, ai nuk mund t'i drejtohej gjykatës pa ezauruar këtë proçedurë.

Për këto arsye, i rekomandua Ministrit të Brendshëm marrjen e masave të nevojshme për të bërë të mundur shqyrtimin nga komisioni përkatës të ankesës së punonjësit të policisë Q. H.. Rekomandimi është bërë kohët e fundit dhe jemi në pritje të shqyrtimit të tij. Kjo ankesë është e mbartur që nga viti 2004.

IV. Ankesat për mos zbatimin e vendimeve gjyqsore të formës së prerë.

Ky problem ka qënë i njohur dhe i pranishëm pothuajse në të gjitha organet e administratës publike shqiptare. Kështu për vitin 2005 ndaj ish Ministrisë së Rendit Publik dhe institucioneve apo organet e tjera në varësi të saj janë bërë 8 ankesa për mosekzekutim të vendimeve gjyqsore për kthimin në punë, për dëmshpërblimin për kohën e qëndrimit pa punë, si dhe për dëmshpërblimin për përjashtim të pa drejtë nga Policia. Megjithëse zbatimi i vendimeve gjyqsore është një detyrim kushtetues,

vetëm Qeveria e re tregoi vullnetin dhe seriozitetin e duhur për respektimin e tij. Si raste të zgjidhjes pozitive mund të përmëndim:

1. Ankesa e shtetasit B. D., banor i fshatit Pobrat të rrethit Berat. Ai na shkruante se më dt. 04.03.1999, tre kriminelë që ndiqeshin nga Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë të Policisë, kishin hyrë në shtëpinë e tij dhe kishin marrë peng vajzën e tij 7 muajshe të quajtur J. D. Gjatë asgjësimit të kriminelëve nga forcat e policisë, ishte plagosur rëndë në bark dhe në këmbë vajza e tij. Menjëherë asaj i ishte dhënë ndihma e shpejtë, duke operuar në Spitalin Ushtarak, por fatkeqësisht ia prenë këmbën e djathtë. Mendimi i mjekëve specialist ishte se asaj i duhej vënë proteza, e cila ndërrohet çdo 6 muaj deri në moshën 20 vjeçare dhe se kjo ndërhyrje mjekësore bëhet vetëm jashtë shtetit. Me ndihmën e Ministrisë së Shëndetësisë, ajo ishte dërguar në një nga spitalet e Italisë. Sipas tij, shpenzimet mjekësore për kurimin e vajzës dhe vendosjen e protezës në këmbë i kishin kushtuar mbi 10 milion lekë, të cilat fillimisht ankuesi i kishte përballuar vetë, duke shitur shtëpinë e pronat që kishte dhe me ndihmën e të afërmëve të tij. Me shumë mundime, pas rreth një viti, ai mundi të merrte nga buxheti i shtetit shumë më pak se shpenzimet e kryera, vetëm 3 milion lekë. Mjekët italianë e kishin këshilluar që vajza duhej kontrolluar e mjekuar çdo muaj në Itali, ndërsa proteza i duhej ndërruar çdo 6 muaj. Ankuesi në mënyrë të vazhdueshme i kishte kërkuar Ministrisë së Rendit Publik që ta ndihmonte atë, siç i ishte premtuar nga drejtuesit e saj në kohën kur i ndodhi kjo fatkeqësi, por as ndihma dhe as dëmshpërblimi i cili përbën një detyrim ligjor nuk iu dhanë.

I detyruar nga qëndrimet e kundërligjshme të drejtuesve të Ministrisë së Rendit Publik, ankuesi kishte ngritur padi në gjykatë ndaj Ministrisë së Rendit Publik, me objekt shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga dëmtimi i shëndetit. Gjykata e Rrethit Berat me vendimin Nr. 894, datë 08.12.2003, kishte vendosur detyrimin e Ministrisë së Rendit Publik (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë) t'i kthente paditëses J. D. shumën 9.602.042 lekë, si shpërblim për dëmtimin e shëndetit. Kundër këtij vendimi ishte bërë ankim nga M.R.Publik në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila me vendimin e saj Nr. 389, datë 14.09.2004, kishte vendosur mospranimin e ankimit. Meqënëse vendimi ishte i formës së prerë, nga Gjykata e Rrethit Berat me vendimin Nr. 275, datë 18.11.2004, ishte lëshuar Urdhëri i ekzekutimit të tij. Pas marrjes së vendimit gjyqsor, ankuesi i ishte drejtuar Drejtorisë Juridike dhe Përfaqësimit Ligjor pranë Ministrisë së Rendit me kërkesë për të ekzekutuar vendimin gjyqsor të cituar më sipër, duke i dorëzuar edhe kopje të tij dhe të urdhërit të ekzekutimit të tij, mirëpo vendimi nuk po ekzekutohej dhe ai po sorollatej për disa muaj. Në Drejtorinë Juridike dhe Përfaqësimit Ligjor, i ishte thënë se nuk po e ekzekutonin atë sepse do të bënin rekurs në Gjykatën e Lartë.

Nga ana jonë ky rast që po trajtonim u konsiderua shumë i dhimbshëm që prekte e sensibilizonte çdo qenie njerëzore. Pavarësisht nga rrethanat e ndodhjes së ngjarjes, e cila përbënte një fatkeqësi, pasojat e së cilës do ta shoqëronin të dëmtuarën dhe prindërit e saj për tërë jetën. Ministria e Rendit Publik dhe Policia e Shtetit si përfaqësues të shkaktarëve të dëmit duhet të sensibilizoheshin për t'ia lehtësuar sadopak dhimbjen të dëmtuarëve dhe jo t'ia shtonin atë. Mirëpo në fakt, qëndrimi i mbajtur për trajtimin e këtij rasti nga drejtuesit e Ministrisë së Rendit Publik nuk ishte ligjor e moral njëkohësisht.

Detyrimi i organeve shtetërore, duke përfshirë edhe Ministrinë e Rendit Publik, për të ekzekutuar vendimet gjyqsore përbën detyrim kushtetues të parashikuar nga neni 142, pika 3 të Kushtetutës sone, ku thuhet se: *"Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqsore"*.

Pavarësisht nëse ishte bërë apo do të bëhej rekurs ndaj këtij vendimi gjyqsor nga ana Ministrise se Rendit Publik, përderisa nuk ishte marrë vendim nga Gjykata e Apelit Vlore ose nga Gjykata e Lartë për pezullimin e ekzekutimit të tij, në bazë të neneve 469 ose 479 të K.Pr.Civile, Ministria e Rendit Publik nuk kishte asnjë të drejte ligjore për të mos e ekzekutuar atë.

Për zgjidhjen e kësaj ankese, i rekomandua ish Ministrit të Rendit Publik z. Toska ekzekutimin e vendimit gjyqsor të cituar më sipër. Meqënëse ai nuk na e ktheu përgjigjen e rekomandimit brënda afatit ligjor, i kërkua atij me shkrim kthimin e përgjigjes. Pas kësaj shkrese, Drejtoria Juridike dhe Përfaqësimit Ligjor e M.R.Publik na ktheu përgjigje, e cila nuk ishte aspak e mbështetur në ligj, por vetëm në justifikime të pabazuara. Ne iu drejtuam përsëri Ministrit të Rendit Publik, duke e kundërshtuar këtë përgjigje dhe i sugjeruam atij që t'i thërriste ndërjegjes dhe të reagoonte ndaj këtij rasti. Gjithashtu, i kujtuam se mos ekzekutimi i këtij vendimi në mënyrë vullnetare nga ana e Ministrisë së Rendit Publik, do ta detyronte ankuesin që t'i drejtohej Zyrës së Përmbarrimit për të bërë ekzekutimin e detyrueshëm të tij. Dhe në se do të kalohej në ekzekutimin e detyrueshëm, përveç pasojave morale do të kishin edhe pasojat ligjore financiare për pagimin e 7 % të shumës prej 9.602.042 lekë, si detyrim për shpenzimet përmbarrimore. Fatkeqësisht ish Ministri Toska përsëri mbajti një qëndrim të amoralshtëm dhe të kundërligjshëm. Megjithatë, pas ndërrimit të Ministrit të Rendit Publik z. Toska, me Ministrin e Brendshëm z. Olldashi, rekomandimin e cituar më sipër ia drejtuam këtij. Ai e mirëpriti atë dhe mbajti një qëndrim ligjor e korrekt duke e ekzekutuar menjëherë.

2. Ankesa e shtetasit H. H., ish punonjës policie në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Berat. Ai na shkruante se në vitin 2002 ishte liruar nga Policia me motivacionin "Për suprimim të strukturës organike". Pas

largimit nga Policia, ai nuk ishte trajtuar financiarisht në bazë të ligjit. Për të zgjidhur problemin ankuesi i ishte drejtuar Gjykatës së Rrethit Durrës, e cila me vendimin Nr. 722, dt. 16.04.2004, kishte vendosur pranimin e kërkesës së tij dhe detyrimin e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Berat t'i paguajë menjëherë dy paga mujore dhe tre vjet pagesën kalimtare në masën 50 % të pagës referuese, duke filluar nga data e ndërprerjes së marrdhënieve financiare më 16.09.2002. Ky vendim ishte lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin Nr. 438, datë 30.09.2004. Meqënëse vendimi kishte marrë formë të prerë dhe për të ishte lëshuar urdhëri i ekzekutimit, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Përmbartimit Berat. Por ajo megjithë përpjekjet e bëra nuk kishte mundur ta zbatonte vendimin sepse kishte ndeshur në pengesa të kundërligjshme të organeve të Policisë.

Nga ana jonë iu kërkuan shpjegime Drejtorisë së Policisë së Qarkut Berat për shkaqet ligjore të moszekutimit të këtij vendimi gjyqsor. Ajo na informoi se nuk e kishte zbatuar këtë vendim sepse nuk ishte dakort me të dhe se kundër tij kishte bërë rekurs në Gjykatën e Lartë.

Pavarësisht në se ishte bërë apo jo rekurs ndaj këtij vendimi gjyqsor nga ana e kësaj drejtorie, përderisa nuk ishte marrë ndonjë vendim nga Gjykata për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit Durrës, Nr. 722, dt. 16.04.2004, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin Nr. 438, datë 30.09.2004, në bazë të neneve 469 ose 479 të K.Pr.Civile, Drejtoria e Policisë e Qarkut Berat nuk kishte asnjë të drejtë ligjore për të mos e ekzekutuar atë.

Për të bërë të mundur rivendosjen në vend të të drejtës kushtetuese dhe ligjore të shkelur ankuesit, i rekomanduam Drejtorit të Policisë të Qarkut Berat të ekzekutonte sa më shpejtë vendimin gjyqsor të cituar më sipër. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.

3. Ankesa e shtetasit E. K., ish punonjës policie në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë. Ai na shkruante se gjatë punës në Polici kishte patur rezultate të mira dhe për këtë ishte vlerësuar nga eproret dhe ishte emëruar në detyra të ndryshme si, inspektor rendi, komandant skuadre, n/oficer roje dhe kishte mbajtur gradën policore "Asistent i parë". Me Urdhërin e Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë Nr. 5280/1, dt. 26.05.2003, ishte përjashtuar nga Policia me motivacionin se, "nuk kishte zbatuar urdhërin e komandantit, ishte larguar nga vendi i shërbimit, kishte përdorur pije alkoolike në masën e dehjes duke kryer veprime që cënonin figurën e Policit të Shtetit". Urdhërin e përjashtimit nga policia e kishte konsideruar të padrejtë dhe motivacionin e tij të pavërtetë. Për këtë arsye kishte bërë ankesë në rrugë administrative në Komisionin Qëndror të Disiplinës, por nuk kishte marrë përgjigje prej tij. Më pas ai i ishte drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me kërkesë padi. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin

Nr. 4800, dt. 15.10.2004, kishte vendosur pranimin e kërkesë padisë dhe anulimin e Urdhërit të Drejtorit të Policisë së Qarkut Tirane Nr. 5280/1, dt. 26.05.2003. Vendimi i gjykates kishte marrë formë të prerë. Mirëpo pas përfundimit të gjyqit edhe Komisioni Qëndror i Disiplinës e kishte shqyrtuar ankesën tij. Me vendimin e dt. 31.08.2005, ai kishte vendosur se përjashtimi i tij ishte i pabazuar dhe i kishte propozuar Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë rishikimin e masës së dhënë. Ankuesi pretendonte se pas fitimit të gjyqit dhe vendimit të Komisionit Qëndror të Disiplinës i ishte drejtuar me kërkesë Drejtorisë të Policisë të Qarkut Tiranë për rikthimin e tij në punë, por kërkesa e tij padrejhtësisht nuk ishte marë në konsideratë.

Duke e konsideruar të drejtë ankesën e tij, ne i rekomanduam Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë që ta rikthente në Polici ankuesin E. K.. Rekomandimi u mirëprit dhe nga kjo drejtori u informuam se ajo kishte filluar procedurat për ripranimin e tij në strukturat e Policisë.

V. Rekomandime për parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit dhe shkeljeve të ligjit nga Policia.

Në raportet e viteve të fundit, në mënyrë të përsëritur kemi bërë disa rekomandime, për të cilat gjykuan se respektimi i tyre do të sillte parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit dhe të shkeljeve të ligjit nga policia. Megjithëse ato ja dërguam ish Ministrisë së Rendit Publik dhe në muajtë e fundit të viti 2005 edhe Ministrisë së Brendshme, konstatojmë se edhe pas këmbënguljes tonë të vazhdueshme, pjesa më e madhe e tyre nuk janë zbatuar. Kështu p.sh. mund të përmëndim:

1. Nuk janë marrë masat e nevojshme që të sigurohet e drejta e vizitës nga një mjek për personat e privuar nga liria, qysh në fillim të privimit të tyre nga liria. Kjo e drejtë duhet gjithashtu të nënkuptojë të drejtën që këta persona kanë për t'u ekzaminuar nëse ata dëshirojnë nga një mjek i zgjedhur prej tyre.

Për realizimin e kësaj të drejte gjithashtu duhet që:

- Të gjitha ekzaminimet mjekësore të personave të privuar nga liria e tyre prej policisë duhet të jenë larg dëgjimit, dhe vetëm nëse kundërshton mjeku. Për ndonjë rast të veçantë, larg edhe shikimit të punonjësve të policisë kur ata vizitohen nga mjeku.

- Rezultatet e çdo ekzaminimi, si dhe çdo deklaratë e bërë nga personi i vizituar, duhet të shënohen nga mjeku dhe të jenë në dispozicion të personit të privuar nga liria dhe të avokatit të tij.

2. Personave të privuar nga liria prej policisë, nuk u dorëzohen formulare ku të pasqyrohen e saktësohen të drejtat e tyre. Këta formulare duhet që të jenë të disponueshëm edhe në gjuhë të huaj. Për më tepër, të

interesuarit duhet të ftohen që të firmosin një deklaratë që ata kanë qënë të informuar mbi të drejtat e tyre.

3. Nuk është nxjerë udhëzimi (kod i sjelljes) për marrjen në pyetje nga policia. Ky kod duhet ndër të tjera të trajtojë aspektet e mëposhtme; t'i tregohet sistematikisht të ndaluarit identiteti i personave të pranishëm gjatë marrjes në pyetje (emri dhe/ose matrikuli); kohëzgjatja e lejuar e një seance pyetjesh; periudhat e pushimit ndërmjet këtyre seancave dhe pauzat gjatë marrjes në pyetje; vendi apo vendet ku mund të mbahet një seancë e tillë; nëse do t'i kërkohet të ndaluarit të qëndrojnë në këmbë gjatë marrjes në pyetje; dhe që ndalohet marrja në pyetje e personave nën ndikimin e drogës, alkoolit, ilaçeve ose nën një gjëndje tronditjeje. Ky kod duhet gjithashtu të parashikojë që të shënohet sistematikisht momenti i fillimit dhe i përfundimit të çdo marrje në pyetje, identitetin e çdo të pranishmi gjatë çdo seance pyetjeje, si dhe çdo kërkesë të formuluar nga i ndaluari gjatë kësaj seance. Situata e personave veçanërisht të pambrojtur (për shëmbull, minorenët, personat e prekur nga sëmundje ose mangësi mendore) duhet të bëhen objekt i garancive specifike.

4. Nuk zbatohen të drejtat e mësipërme edhe për personat e mbajtur nga policia për qëllime administrative. Në disa raste kemi konstatuar se “shoqërimi në polici” përdoret ndaj personave të dyshuar për një veprë penale. Pra shoqërimi përdoret për të sqaruar veprime administrative me qëllim hetimesh për vepra penale dhe mbas kohës së “shoqërimit” bëhen veprime proceduriale të ndalimit ose arrestimit. Po kështu kemi konstatuar disa raste të kryerjes së veprimeve që çojnë në kërkimin dhe mbledhjen e të dhënave në mënyrë të paligjshme, duke shkelur pikën 2 të nenit 32 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Të dhëna të tilla mund të përmëndim ato që janë marrë nën efektin e dhunës fizike.

5. Nuk është nxjerë nga autoritetet policore qarkorja që të sqarojë se koha e mbajtjes së personit, për arsye administrative ose gjyqsore duhet të llogaritet brënda afatit kohor të caktuar për paraqitjen e një personi para një gjyqtari, që, sipas nenit 28 të Kushtetutës, është jo më tepër se 48 orë. Nga verifikimi i disa ankesave ka rezultuar se koha e ndalimit ose arrestimit fillon pas asaj të shoqërimit, që në disa raste edhe ajo ka qënë tej afatit ligjor.

6. Titullarët dhe kuadrot drejtues të Policisë nuk ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm në lidhje me librat e rregjistrimit dhe të mbajtjes së personave në ambjentet e policisë, me qëllim që ato të plotësohen saktë e të mos manipulohen për të mbuluar shkeljet e ligjit. Kemi konstatuar disa raste që shënimet në këto rregjistra nuk përputhen me kohën e saktë të qëndrimit të tyre në polici, ndërsa në raste të veçanta ata nuk rregjistrohen.

7. Nuk ka ndryshuar koncepti për personat e shoqëruar në polici, të cilët duhet të mbahen në dhoma shoqërimi dhe jo ndalimi, jo të prangosur

ose në dhoma të mbyllura me dryn, siç veprohet në disa raste. Në këto kushte ndodhi edhe vdekja e shtetasit A.B. në Rajonin nr.3 Tiranë. Po kështu nuk ka ambiente për të shoqëruarit e mitur dhe femra. Dhomat duhet të jenë me kushte të përshtatshme higjienosanitare dhe të pajisura me karrige e tavolina. Këto mangësi fatëkeqësisht janë të pranishme dhe shumë të dukëshme edhe në Komisariatet e Policisë në Kryeqytet, ku pretendojmë dhe synojmë të kemi një Polici më të kulturuar dhe më të civilizuar.

8. Nuk janë ndryshuar e përmirësuar kushtet e mbajtjes së të ndaluarëve e të arrestuarve në dhomat e paraburgimit në ambientet e policisë, me qëllim që:

- të respektohen në mënyrë strikte kriteret e parashikuara lidhur me çështjen e hapësirës minimale për të ndaluarin, si dhe
- të ndahen të rriturit nga minorenët dhe t'i kushtohet këtyre të fundit një vëmendje e veçantë në planin e shëndetit dhe të edukimit.

9. Nuk u mundësua akoma kalimi i dhomave të paraburgimit dhe i personelit të tyre nga vartësia e ish Ministrisë së Rendit Publik në atë të Ministrisë së Drejtësisë. Megjithëse ky proces filloi me Drejtorinë e Policisë së Qarkut Vlorë, Tiranë dhe Shkodër, ai nuk mundi të realizohej sipas Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Rendit Publik dhe të Ministrit të Drejtësisë në disa Drejtori e Komisariate Policie. Kjo do të krijonte mundësinë për të vënë efektimisht në jetë të gjitha dispozitat e caktuara në “Rregulloren mbi sigurimin dhe trajtimin e të burgosurve”, të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.96 datë 09.03.2000.

Për veç zbatimit të rekomandimeve të mësipërme, nga organet e Policisë duhet të punohet më shumë për të zbatuar një nga detyrat kryesore institucionale të saj të përcaktuara në nenin 3 të ligjit Nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, atë të mbrojtjes së ushtrimit të lirive dhe të drejtave të personit. Për realizimin e kësaj detyrë është e domosdoshme që:

1. T'i jepet një përparësi më e madhe edukimit dhe formimit profesional në vazhdimësi të punonjësve të policisë të të gjitha roleve dhe gradave. Në këto programe duhet të zërë një vënd të rëndësishëm edukimi i tyre me ndjenjën e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut. Niveli kulturor e profesional, njohja dhe respektimi i të drejtave të njeriut, si dhe aftësia komunikuese të jenë kriteret përcaktuese në rekrutimin, mbajtjen në punë dhe përzgjedhjen në emërimet e ngritje në detyrë të punonjësve të policisë të të gjitha roleve.

2. Duhet që autoritetet politike dhe teknike të niveleve më të larta të dalin herë pas here, më shpesh dhe më fort, me mesazhe të qarta që dënojnë rreptë keqtrajtimet nga policia. Ky veprim duhet të përsëritet me intervale të rregullta nga drejtuesit në të gjitha shkallët e Policisë. Kjo në

veçanti t'u theksohet punonjësve të policisë të ngarkuar me marrjen në pyetje të personave të privuar nga liria.

3. Në të gjitha ambjentet e policisë të vendosen menjëherë posterat e përgatitura në bashkëpunim me institucionin tonë, të cilat bëjnë fjalë për respektimin e të drejtave të njeriut dhe parandalimin e dhunës nga punonjësit e policisë. Ato do të shërbejnë si një kujtesë e vazhdueshme për punonjësit e policisë dhe do t'i ndihmojë ata në zbatimin me rigorozitet të ligjit. Është konstatuar se ato që janë vënë, janë hequr pa shkak.

4. Bashkëpunimi i Ministrisë së Brendshme dhe i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me Institucionin e Avokatit të Popullit, në kuadër të punës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, megjithëse ka qënë i mirë, duhet të rritet e përsoset më tej në të ardhmen. Me ardhjen e z. Olldashi në krye të Ministrisë së Brendshme, kemi patur marrdhënie më korrekte se më parë. Ky fakt është një tregues pozitiv i mirëkuptimit që ky dikaster dhe organet e tij vartëse duhet të kenë ndaj rekomandimeve dhe kritikave tona për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë edhe ato të punonjësve të policisë.

VI. Rekomandime dhe propozime në fushën legjislative.

Gjatë shqyrtimit të disa ankesave të ndryshme ne konstatuam se disa akte normative ligjore e nënligjore që ishin në zbatim binin ndesh ose ishin nxjerë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe shkelnin në mënyrë masive të drejtat e qytetarëve dhe të punonjësve të Policisë së Shtetit. Ndërsa disa të tjera nuk zbatoheshin në favor të punonjësve të policisë.

Kështu p.sh. mund të përmëndim:

1. Rekomandimi drejtuar Ministrit të Drejtësisë që t'i propozonte Kuvendit ndryshimin dhe përmirësimin e përmbajtjes së nenit 86 të Kodit Penal, për veprën penale të torturës. Në nenin 86 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë është parashikuar vepra penale e torturës. Ky nen parashikon se: *“Tortura, si dhe çdo akt tjetër çnjërzor apo poshtëruës dënohen me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet”*. Siç konstatohet lehtë, ky nen dhe i formuluar në këtë mënyrë, nuk përkufizon se çfarë është tortura dhe ndërkoh nuk përputhet me përkufizimin e bërë në *“Konventën kundër torturës dhe dënimeve a trajtimeve të tjera mizore, çnjërzore ose degraduese”*, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 10 Dhjetor 1984.

Në nenin 1 të kësaj Konvente parashikohet se: *“Sipas qëllimeve të kësaj Konvente, me termin “torturë” kuptohet çdo veprim, me anën e të cilit një personi i janë shkaktuar me dashje dhimbje ose vuajtje të rënda, fizike ose mendore, me synim për të marrë prej tij ose prej një tjetri*

informata ose pohime, për ta ndëshkuar për një veprim që ai ose një person tjetër ka kryer ose dyshohet që e ka kryer, për ta frikësuar ose për të bërë presion mbi të, ose për të frikësuar a për të bërë presion mbi një person tjetër, ose për çdo motiv tjetër të bazuar në një formë të çfarëdollojshme, ku një dhimbje e tillë ose vuajtje të tilla janë shkaktuar nga një person zyrtar ose nga çdo person tjetër që vepron me titull zyrtar ose me nxitjen e tij ose me miratimin e tij të shprehur ose të heshtur. Ky term nuk përfshin dhimbjen ose vuajtjen që janë pasojë vetëm e sanksioneve të ligjshme, që janë pjesë e pandarë e këtyre sanksioneve ose janë shkaktuar prej tyre”.

Duke e krahasuar përmbajtjen e nenit 86 të Kodit tonë Penal me përmbajtjen e nenit 1 të Konventës, rezulton se dispozita e Kodit tone Penal duhet të ndryshojë e të përmirësohet, duke u përputhur plotësisht me përmbajtjen e Konventës. Kjo domosdoshmëri parashikohet edhe në pikën 2 të nenit 1 të Konventës ku thuhet: “*Ky nen nuk cënon asnjë instrument ndërkombëtar ose asnjë ligj kombëtar që përmban ose mund të përmbajë dispozita të një karakteri më të gjërë*”. Kjo do të thotë që Konventa pranon dispozita më të gjëra për torturën, por kurrësi dispozita më të ngushta siç është aktualisht në Kodin tonë Penal.

Përsa më sipër, i rekomandua Ministrit të Drejtësisë që t’i propozonte Kuvendit ndryshimin dhe përmirësimin e përmbajtjes së nenit 86 të Kodit Penal sipas përmbajtjes së nenit 1 të Konventës së cituar më sipër. Nga Ministri i Drejtësisë u informua se rekomandimi u mirëprit dhe do ta merrte në konsideratë maksimalisht atë në kuadrin e ndryshimeve që do t’i bëheshin Kodit Penal.

2. Propozimi drejtuar Ministrit të Rendit Publik për shfuqizimin e Udhëzimit të Ministrit të Rendit Publik Nr. 168, dt. 20.10.1993 “Për rregullat e shoqërimit të shtetasve në Komisariate, Reparte, Posta të Policisë dhe zyra të tjera të tyre”. Gjatë shqyrtimit të disa ankesave të ardhura në Institucionin tonë, për shoqërimet në Polici të qytetarëve të ndryshëm, si dhe nga hetimi i disa ngjarjeve të rënda, të vdekjes së shtetasve në zyrat dhe në ambientet e Policisë, si në Komisariatet e Policisë në Mirditë dhe në ato Nr. 3 dhe 4 në Tiranë, konstatuam se:

Në pjesën më të madhe të Komisariateve të Policisë të Republikës së Shqipërisë, mungojnë dhomat e pritjes dhe të shoqërimit të shtetasve në organet e Policisë. Ndërsa në disa Komisariate të tjerë, ato nuk janë të kompletuara me kushtet normale higjienosanitare dhe me pajisjet e nevojshme si tavolina, karrike etj. Personat e shoqëruar në Polici mbahen në dhoma të cilat nga ndërtimi dhe kushtet janë të njëjta me dhomat e izolimit dhe të mbyllur me çelës. Veç kësaj, për mungesë profesionalizmi, nuk bëhen kontrole të plota për t’u hequr këtyre personave çdo send që mund të përdoret për vetvrasje, “vdekje në duart e Policisë”. Kjo gjëndje ndikon shumë në uljen e autoritetit të shtetit në përgjithësi dhe të imazhit

të Policisë së Shtetit në veçanti, si dhe në humbjen e besimit publik të saj në komunitet.

Shoqërimi dhe trajtimi i të shoqëruarve në organet e Policisë bëhej në bazë të Udhëzimit të Ministrit të Rendit Publik Nr. 168, dt. 20.10.1993 “Për rregullat e shoqërimit të shtetasve në Komisariate, Reparte, Posta të Policisë dhe zyra të tjera të tyre”.

Nga ana jonë u konstatua se ky udhëzim “de jure” ishte shfuqizuar dhe nuk duhej të zbatohet më tej për arësye se:

Së pari, nga përmbajtja e tij rezultonte se, ai ishte nxjerrë në bazë dhe për zbatim të Ligjit Nr. 7692, dt. 31.03.1993 “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”, si dhe të nenit 27 të Ligjit Nr. 7504, dt. 30.07.1991 “Për Policinë e Rendit”. Mirëpo, aktet ligjore ku ishte mbështetur udhëzimi, Ligji Nr. 7692, dt. 31.03.1993 “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”, i cili është shtojcë e Ligjit Nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, ishin shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Kushtetutës tonë të vitit 1998 dhe konkretisht nga neni 182 i saj. Ndërsa Ligji Nr. 7504, dt. 30.07.1991 “Për Policinë e Rendit” ishte shfuqizuar nga Ligji Nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” dhe konkretisht nga neni 70 pika 2 e tij.

Së dyti, në nenin 45 të Ligjit Nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, është parashikuar e drejta e Policisë për të bërë shoqërimin e personave në zyrat e saj ose organin urdhërdhënës, në kushtet e parashikuara nga neni 27 i Kushtetutës. Pra vetë Ligji organik i Policisë së Shtetit për rastet e shoqërimit të personave në Polici, i referohet Kushtetutës në fuqi dhe jo akteve ligjore të cituara në paragrafin e mësipërm.

Së treti, Ligji “Për Policinë e Shtetit”, ka zgjeruar e përmirësuar të drejtat e personave të shoqëruar në Polici. Konkretisht në nenin 45, pika 2, parashikohet se, *në çdo rast shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë*, ndërkohë që në udhëzimin në fjalë koha e shoqërimit parashikohej deri në 12 orë. Ndërsa po në nenin 45, pika 3, parashikohet se, *personi i shoqëruar gëzon të gjitha të drejtat e njohura nga neni 28 i Kushtetutës*.

Së katërti, neni 48 i Ligjit “Për Policinë e Shtetit” detyron që të bëhet, miratohet dhe zbatohet Rregullore e veçantë, ku të parashikohen procedurat e shoqërimit të personave në Polici, gjë që nuk ishte bërë.

Së pesti, mbajtja në fuqi “de facto” dhe zbatimi i tij krijonte premisa për shkelje të të drejtave të njeriut të njohura nga Kushtetuta, Ligji Nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” dhe Ligji Nr. 9109, dt. 17.07.2003 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”.

Përsa më sipër, i propozuam Ministrit të Rendit Publik dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit që të bënin aktin formalo juridik të shfuqizimit të Udhëzimit të Ministrit të Rendit Publik Nr. 168,

dt. 20.10.1993 “Për rregullat e shoqërimit të shtetasve në Komisariate, Reparte, Posta të Policisë dhe zyra të tjera të tyre”. Bazuar në nenin 48 të Ligjit “Për Policinë e Shtetit, i propozuam përgatitjen, miratimin dhe vënien në zbatim të Rregullores së re të shoqërimit të personave në Polici. Në rregulloren e re, midis të tjerave, duhet të parashikohet në mënyrë të plotë dhe me korrektesë mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të shoqëruar, të sanksionuara në Kushtetutën dhe në aktet e tjera normative të zbatueshme në vendin tonë. Gjithashtu, i propozuam marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin ose hapjen e dhomave të pritjes së qytetarëve dhe të mbajtjes së personave të shoqëruar në organet e Policisë brenda standarteve që garantojnë jetën dhe sigurinë e tyre, si dhe kompletimin e tyre me kushtet higjienosanitare dhe me orenditë e domosdoshme. Rekomandimi, megjithëse me vonesë, u mirëprit dhe u pranua.

3. Propozimi drejtuar Ministrit të Brendshëm për ndryshimin dhe përmirësimin e “Rregullores së Shërbimeve të Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Rendit Publik Nr. 1749, dt. 29.07.2005. Siç përshkruam më sipër, nga ana jonë iu propozua ish Ministrit të Rendit Publik shfuqizimi i Udhëzimit të Ministrit të Rendit Publik Nr. 168, dt. 20.10.1993 “Për rregullat e shoqërimit të shtetasve në Komisariate, Reparte, Posta të Policisë dhe zyra të tjera të tyre”, si dhe përgatitjen, miratimin dhe vënien në zbatim të rregullores së re të shoqërimit të personave në polici. Gjithashtu, në propozim sugjeruam që në rregulloren e re, midis të tjerave, të parashikoheshin mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të shoqëruar, të sanksionuara në Kushtetutën dhe në aktet e tjera normative të zbatueshme në vendin tonë.

Propozimi u pranua dhe me Urdhër të Ministrit të Rendit Publik Nr. 1749, dt. 29.07.2005, u miratua “Rregullorja e Shërbimeve të Policisë së Shtetit”, e cila shfuqizoi Udhëzimin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 168, dt. 20.10.1993 “Për rregullat e shoqërimit të shtetasve në Komisariate, Reparte, Posta të Policisë dhe zyra të tjera të tyre”.

Rregullat dhe procedurat për shoqërimin e shtetasve në organet e policisë janë të përcaktuara në nenet 61-70, kreu XII të kësaj rregullore. Gjithashtu, për këtë qëllim ishte hartuar dhe dërguar strukturave vendore të Policisë së Shtetit Letërporosia Nr. 481, dt. 11.08.2005 “Për një kuptim dhe zbatim sa më të drejtë për shoqërimin e shtetasve në organet e policisë”, firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Ne e mirëpritëm qëndrimin e mbajtur me këtë rast. Mirëpo nga studimi i tyre konstatoam se Letërporosia Nr. 481, dt. 11.08.2005 “Për një kuptim dhe zbatim sa më të drejtë për shoqërimin e shtetasve në organet e policisë”, i ishte afruar rekomandimit tonë, ndërsa “Rregullorja e Shërbimeve të Policisë së Shtetit”, nuk parashikon dhe garanton si duhet mbrojtjen e të drejtave të personave të shoqëruar në organet e policisë. Në

radhë të parë duhej të ishte bërë dallimi i personave të shoqëruar, pra i atyre që dyshohen ose kanë kryer veprë penale nga ata që shoqërohen për kundërvajtje administrative apo për t'u pyetur për të sqaruar ngjarje të ndryshme. Kështu p. sh. mund të përmëndim në Rregullore se:

a) Neni 65, pika 1/a, ku parashikohet kontrolli personal i personit të shoqëruar. Ky veprim bie ndesh me nenin 37/3 të Kushtetutës tonë, ku thuhet se: *“Askujt nuk mund t'i bëhet kontroll vetjak jashtë procesit penal, me përjashtim të rasteve të hyrjes në territorin e shtetit dhe të daljes prej tij ose për të mënjanuar një rrezik që i kanoset sigurimit publik”*. Siç është parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore, policia shoqëron në organet e saj kategori të ndryshme personash, si ata që dyshohen si autorë të veprave penale, ashtu edhe të tjerë për t'i identifikuar, për t'i pyetur etj. Për këto arsye ajo nuk ka të drejtë dhe nuk mund t'i bëjë kontroll personal të gjithë të shoqëruarëve në organet e saj, por vetëm në rastet e gërmës “g” të pikës 1 të këtij neni. Pra gërma “a” duhet shfuqizuar.

b) Neni 66, pika 1/3/a, ku parashikohet mbajtja e prangosur e personit të shoqëruar në zyra dhe mos heqja e prangave pa patur arsye të përligjura. Mirëpo në zyra, personi çohet për t'u pyetur dhe pyetja e tij i prangosur bie ndesh me parimet themelore të së drejtës. Po kështu mund të themi se jo çdo person i shoqëruar në organet e policisë dhe në zyrat e saj duhet prangosur. Pra këto raste duhen saktësuar (dalluar) mirë.

c) Neni 69, në pikat 5 dhe 6, ku bëhet fjalë për marjen e shpjegimeve personit të shoqëruar, duke përfshirë edhe personat e dyshuar si autorë të veprave penale. Edhe në Letërporosinë nuk është parashikuar e drejta kushtetuese e sanksionuar në nenin 28/1 të saj ku thuhet se: *“Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin , si dhe t'i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij”*. Kjo e drejtë e personit të shoqëruar, e cila në të njëjtën kohë përbën edhe detyrim për punonjësit e policisë është parashikuar edhe në nenin 45, pika 3, të Ligjit Nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, ku thuhet se: *“Personi i shoqëruar gëzon të gjitha të drejtat e njohura nga neni 28 i Kushtetutës”*. Ky kre i rregullores vjen në kundërshtim edhe me gërmën “e” të nenit 2 të ligjit Nr. 9109, datë 17.07.2003, “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, ku është parashikuar e drejta e avokatit të japë ndihmë juridike nëpërmjet: *“pranisë si mbrojtës në kohën e shoqërimit, ndalimit, arrestimit, gjatë procesit të hetimit, shqyrtimit gjyqsor të personave në çështjet penale”*. Në të njëjtën kohë, rregullorja nuk përputhet edhe me nenin 7 të po këtij ligji, ku parashikohet se: *“Avokati ka të drejtë të takojë personin e mbrojtur prej tij, në mënyrë private dhe pa kufizim kohor, në çdo gjëndje*

të kufizimit të lirisë personale...”. Në fakt dhe, edhe sipas nenit 61/2 e rregullores së cituar më sipër, shoqërimi i personit në organin e policisë duhet të kuptohet dhe të vlerësohet si privim i lirisë së tij, për aq kohë sa ai do të jetë në mjediset e shoqërimit.

ç) Gjithashtu, në rregullore nuk është parashikuar detyrimi i punonjësve të policisë që kur shoqërojnë në organet e policisë të mitur të njoftojnë menjëherë prindërit apo kujdestarët e tyre dhe pyetja të bëhet në praninë e tyre.

Problemet e trajtuara më sipër janë të një rëndësie të veçantë dhe në fund të fundit kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të garantuara nga aktet normative të brendshme dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Shteti Shqiptar. Mbrojtja dhe ushtrimi i tyre nga qytetarët është në të njëjtën kohë edhe detyrë institucionale e Policisë së Shtetit, e parashikuar në pikën 1, gërma “b” e Ligjit Nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”. Rëndësia e këtij problemi është i lidhur edhe me faktin, që nga njëra anë, pasqyron natyrën demokratike të shtetit, kurse nga ana tjetër, tregon se sa shteti punon për respektimin dhe garantimin e të drejtave kushtetuese të shtetasve. Kështu, punonjësit e policisë edukohen e detyrohen për të respektuar të drejtat dhe liritë e shtetasve, si dhe mënjanohet përsëritja e rasteve të shkeljeve të të drejtave të personave të shoqëruar në organet e policisë. Kjo shërben si garanci në respektimin e të drejtave ligjore të personave të shoqëruar në organet e policisë.

Përsa më sipër, i propozuam Ministrit të Brendshëm marrjen e masave të nevojshme për ndryshimin dhe përmirësimin e Kreut XII (shoqërimi i personave) të “Rregullores së Shërbimeve të Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Rendit Publik Nr. 1749, dt. 29.07.2005, si dhe për hartimin e Metodikës së njoftimit të akuzës dhe të marjes në pyetje të personave që dyshohen si autorë të veprave penale ose që kanë dijeni për rrethanat e hetimit. Gjithashtu në këtë propozim i shprehëm edhe gadishmërinë e Institucionit tonë që të ndihmonim me konsulencë juridike që dispozitat në fjalë të bëheshin në përputhje me Kushtetutën dhe në respektim të të drejtave të njeriut. Propozimi është bërë kohët e fundit dhe jemi në pritje të shqyrtimit të tij.

4. Propozimi drejtuar Ministrit të Rendit Publik për të bërë ndryshimet përkatëse në Rregulloren e Institutit të Policisë Shkencore, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 751, datë 16.10.2003. Nga hetimi i disa ankesave të shtetasve për ngjarje të rënda të ndodhura në ambjentet e Policisë, familjarët e viktimave shprehnin dyshime se provat manipuloheshin nga ekspertët e Institutit të Policisë Shkencore, të cilët janë pjesë e Policisë së Shtetit, me qëllim për të mbrojtur kolegët e tyre.

Në fakt, në një rast që lidhej me vrasjen e shtetasit A. D., në kqyrjen e vendit të ngjarjes kishin marrë pjesë ekspertët e Institutit të Policisë Shkencore të cilët kishin bërë kqyrjen dhe ekspertimet përkatëse. Këto veprime ata i kishin kryer në bazë të Rregullores së Institutit të Policisë Shkencore, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 751, datë 16.10.2003.

Për të eliminuar dyshimet që mund të kenë familjarët e palës së dëmtuar, ne gjykuam që në rastet e ndodhjes së ngjarjeve të rënda në ambjentet e Policisë ose të ngjarjeve të tjera të rënda të cilat kanë si autorë ose të dyshuar punonjës policie, në kqyrjen e vendit të ngjarjes dhe në kryerjen e veprimeve ekzaminuese, bashkë me ekspertët e Institutit të Policisë Shkencore, të jenë të pranishëm edhe ekspertë privatë të fushave përkatëse të zgjedhur nga familjarët e të dëmtuarëve.

Përsa më sipër, i propozuam Ministrit të Rendit Publik që të bënte ndryshimet përkatëse në Rregulloren e Institutit të Policisë Shkencore, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 751, datë 16.10.2003, duke parashikuar që në rastet e ndodhjes së ngjarjeve të rënda në ambjentet e Policisë ose të ngjarjeve të tjera të rënda të ndodhura jashtë ambjenteve të Policisë, por që kanë si autorë ose të dyshuar punonjës policie, në kqyrjen e vendit të ngjarjes dhe në kryerjen e veprimeve ekzaminuese të marim pjesë edhe ekspertë privat të specialiteteve përkatëse. Mirëpo përgjigjia e këtij rekomandimi nuk na ka ardhur akoma, megjithëse e kemi përsëritur atë.

5. Rasti i bërë publik në Gazetën “Panorama” të datës 02.09.2005, në të cilën ishte botuar artikulli me titull, “*Policët mbajnë me bukë kinezët e arrestuar*”. Sipas artikullit, disa shtetas kinezë ishin arrestuar nga Policia Shqiptare dhe mbaheshin në dhomat e paraburgimit të Komisarariatit të Policisë Nr. 4 Tiranë, por nuk trajtoheshin me ushqim, sepse Ministria e Drejtësisë, të cilës i kishte kaluar paraburgimi, nuk e merrte përsipër sigurimin e ushqimit të tyre. Të ndodhur në këto kushte punonjësit e policisë i ushqenin të huajt dhe në rastin konkret kinezët me lekët e tyre. Gjithashtu, në artikull shkruhej se ky shqetësim ishte ngritur nga drejtuesit e Komisariateve të Policisë tek instancat eprore, por problemi nuk ishte zgjidhur.

Për shkak të rëndësisë së veçantë që paraqiste rasti, nga ana e jonë u çmua që këtë çështje ta trajtonim me inisiativë. Nga verifikimet e bëra në Komisarariatet e Policisë të Rrethit Tiranë, si dhe në shkallë Republike, të cilat nuk i administrojnë më dhomat e paraburgimit, rezultoi se në rastet kur Policia, ndalonte apo arrestonte persona të caktuar si të dyshuar për kryerjen e një vepre penale ose të kapur në flagrancë, për kohën që këta persona, (një, dy apo më tepër ditë), mbaheshin në këto Komisariate, pa kaluar akoma në dhomat e paraburgimit, nga ana ushqimore trajtoheshin me mbetjet e gjellëve të mencave të Policisë në këto

Komisariate ose i sigurohej ushqimi nga familjet e tyre. Trajtimi i tyre bëhej në këtë mënyrë për faktin se, si Ministria e Rendit Publik ashtu edhe ajo e Drejtësisë, në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 327, datë 15.05.2003 “Për kalimin e sistemit të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë”, Urdhërit të përbashkët të nxjerrë në bazë të këtij vendimi nga Ministri i Drejtësisë Nr. 3750, dt. 10.07.2003 dhe Ministri i Rendit Publik Nr. 1883, dt. 16.07.2003, nuk kishin caktuar fonde financiare për këto raste. Mos sigurimi i tyre për anën ushqimore, jo vetëm se binte ndesh me rregullat ligjore, por edhe nga pikëpamja humane ishte i palejueshëm. Kjo anomali ishte më e evidente, sidomos për ato raste, kur personi i ndaluar apo i arrestuar nga Policia, nuk i përkiste rrethit ku mbahej, dhe familjarët e tij, duke qënë larg si distancë, sigurimin e ushqimit të tyre nuk e realizonin dot, ose e realizonin me shumë vonesë, ndërkohë kur njeriu i tyre qëndronte i izoluar në Komisaritet e Policisë, pa ngrënë ushqim.

Nga ana jonë kjo situatë u vlerësua e papranueshme, sepse nga njëra anë dobësonte reputacionin e shtetit, kurse nga ana tjetër në mënyrë të padrejtë shkelte rëndë të drejtat themelore të këtyre shtetasve. Prandaj gjykuam se kjo çështje duhet të bëhej objekti i një preokupacioni urgjent i të dy Ministrive, në mënyrë që kjo gjëndje aspak ligjore, të gjente rregullimin e menjëhershëm ligjor.

Për këto arsye, i rekomanduam Ministrin të Brendshëm dhe Ministrin të Drejtësisë që të merrnin masa të menjëhershme për zgjidhjen e problemit të trajtimit me ushqim të personave të ndaluar dhe arrestuar që mbaheshin në Komisaritet e Policisë. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.

6. Propozimi i përsëritur drejtuar disa Qeverive dhe së fundi edhe asaj aktuale për të përmirësuar V.K.M. nr. 552, datë 27.11.1999, “Për trajtimin ekonomik e financiar të familjarëve të punonjësve të policisë të vrarë e plagosur për shkak të detyrës”. Qëllimi i këtij rekomandimi ishte që V.K.M të shtrij fuqinë vepruese edhe para vitit 1999 dhe prej tij të përfitojnë edhe familjarët e punonjësve të policisë të vrarë apo plagosur gjatë viteve 1991-1998. Për këtë problem ne kemi bërë disa rekomandime, të cilat i kemi pasqyruar edhe në raportet vjetore të mëparshme. Fillimisht pati një reagim pozitiv nga Qeveria në vitin 2003, e cila i kërkoi M.R.Publik që të studionte problemin dhe të bënte propozimin përkatës. Mbi këtë bazë M.R.Publik përgatiti propozimin për përmirësimin e V.K.M dhe nga ish Ministrat e Rendit Publik u premtua edhe në Parlament se nga Qeveria do të përmirësohej së shpejti Vendimi. Por veç premtimit problemi nuk pati ndonjë avancim e konkretizim, megjithëse ne kemi qënë në ndjekje të vazhdueshme të tij. Meqënëse Qeveria e re ka në programin e saj bërjen e reformave me karakter popullor dhe për vitin 2006 e shtoi buxhetin e Ministrisë së Brendshme

dhe të Policisë së Shtetit, shpresojmë që ky problem do të gjejë zgjidhje përfundimtare. Shpresat tona bazohen edhe në faktin se kohët e fundit Qeveria ka demonstruar vullnet të mirë për kompesimin e disa shtresave të popullsisë të cilat janë më në nevojë. Pjesë e kësaj kategorie popullate janë edhe familjarët e punonjësve të policisë të vrarë apo të plagosur në krye të detyrës, shumica e të cilave janë pa strehim dhe pa mjetet minimale të jetesës.

7. Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 31, datë 14.4.2003. Nga shqyrtimi i disa ankesave të ish punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të Gardës së Republikës, të cilët ankoheshin se megjithëse ishin përjashtuar padrejtësisht nga puna, gjykatat nuk i rikthenin ata në punë për shkak të Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bshkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 31, datë 14.4.2003. Me këtë vendim është vendosur se: *“me anë të ankimit në gjykatë punonjësi i policisë, ashtu si dhe një numër tjetër punonjësish publike që kanë detyra të caktuar shërbimi ndaj shtetit, për shkak të të cilave veprojnë si përfaqësues të shtetit për mbrojtjen e interesave të tij, nuk mund të realizojnë gjyqësisht rikthimin në detyrën që kanë pasur, edhe në qoftë se provohet që janë larguar prej saj pa shkaqe të përlligjura”*. Ky vendim është botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 76 të vitit 2003, për njësimin e praktikës gjyqsore.

Duke e studjuar me vëmëndje dhe kujdes këtë vendim, rezulton se ai shkel hapur të drejtat ligjore të punonjësve të Policisë e të tjerëve dhe bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me disa ligje të tjera dhe konkretisht me:

a) Nenin 7 të Kushtetutës ku përcaktohet se: *“Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin e pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqsor”*. Gjykata e Larta, e cila është pjesë e pushtetit gjyqsor, nuk mund të marrë atributet e pushtetit ligjvënës, siç ka bërë në rastin konkret duke marrë rolin e ligjvënësit. Në fakt ky vendim po shërben si bazë ligjore në gjykimin e padive të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të Gardës së Republikës. Edhe pse ligji “Për Policinë e Shtetit” është i mangët lidhur me parashikimin e të drejtës së rikthimit në punë në rrugë gjyqsore të punonjësve të Policisë, kjo s’i jep të drejtë Gjykatës të kryejë detyrën e pushtetit ligjvënës. Pra në rastin konkret ajo ka dalë tej të drejtës që i kanë dhënë asaj dispozita kushtetuese, neni 141/2 dhe neni 481 i K.Pr.Civile, për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqsore, e cila duhet të ushtrohet dhe realizohet në përputhje të plotë dhe jo në kundërshtim me aktet normative.

b) Nenin 44 të Kushtetutes, ku përcaktohet se: *“Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se*

është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore”.

Sipas fjalorit të shqipes së sotme, botim i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë i vitit 1984, faqe 1015, *rehabilitim d.m.th. t'i kthesh dikujt zyrtarisht të drejtat që i ka humbur ose që i janë hequr gabimisht; t'i kthesh ose t'i vesh përsëri në vend dikujt emrin e mirë ose nderin që i ishte përlyer.* Pra nga ky shpjegim e sqarim i fjalorit, kuptohet qartë që në rastet e përjashtimit të pabazuar nga policia apo garda, e drejta kryesore që i hiqet ose i humbet padrejtësisht punonjësit të policisë ose të gardës nga akti i paligjshëm i organeve shtetërore (urdhëri i përjashtimit nga Policia apo Garda e Republikës), është e drejta për punë. Dhe që ta rehabilitosh atë do të thotë që t'i rikthesh atij të gjitha të drejtat që i ka humbur ose i janë hequr gabimisht, ku vendin kryesor e ze rikthimi në punë, kur provohet gjyqsisht se ai është hequr padrejtësisht nga puna. Nuk ka dhe nuk mund të ketë *de jure e de facto* rehabilitim të një personi të hequr padrejtësisht nga puna vetëm me faktin e dëmshpërblimit të tij me pagën e një viti pune, siç është vendosur me Vendimin Unifikues të cituar më sipër. Duke e analizuar e interpretuar me kujdes këtë të drejtë kushtetuese, rezulton se kushdo që është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore, ka të drejtë:

Në radhë të parë të rehabilitohet dhe zhdëmtohet në përputhje me ligjin, dhe në radhë të dytë, ose zhdëmtohet në përputhje me ligjin. Kjo e drejtë zgjedhjeje, e të parës *rehabilitim dhe zhdëmtim* ose e të dytës *zhdëmtim*, do të varet nga vetë i dëmtuari dhe jo nga ndonjë organ tjetër, qoftë ky edhe gjykata. Pra nga kjo dispozitë kushtetuese kuptohet qartë dhe saktë se në qoftë se i dëmtuari nga akti administrativ kërkon në rrugë gjyqësore *rehabilitimin dhe zhdëmtimin* e tij, gjykata nuk mund t'ia mohojë ato kur konstaton dhe pranon se akti administrativ është i kundërligjshëm.

c) Vendimi Unifikues Nr. 31, datë 14.4.2003, vjen në kundërshtim me nenin 32/5 të ligjit Nr. 8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, në të cilin është parashikuar e drejta e punonjësit të policisë *për t'u ankuar edhe drejtpërdrejtë në gjykatë në rastet e përjashtimit nga policia.* Përderisa është parashikuar e drejta e ankimit në gjykatë e punonjësit të policisë, kuptohet që ai do t'i kërkojë gjykatës rivendosjen në vend të të gjitha të drejtave të shkeluara atij nga urdhëri i përjashtimit, dhe e drejta për t'u rikthyer në punë është primare.

Arësytimi i Gjykatës së Lartë se, *meqënëse ligji “Për Policinë e Shtetit” nuk shprehet për rikthimin në punë të punonjësve të policisë, gjykata nuk e ka një të drejtë të tillë, dhe se në rastet e shqyrtimit të një ankimi për përjashtim nga detyra ajo ka vetëm të drejtë të konstatojë ose të verë në dukje shkeljen e ligjit, nuk është i drejtë.* Pavarësisht se ligji “Për Policinë e Shtetit” nuk shprehet për rikthim në punë të punonjësve të

policisë, duhet theksuar se ai (ligji) *ju jep atyre të drejtën e ankimit në gjykatë* dhe nuk i kufizon të drejtat dhe kërkimet e punonjësit të policisë në ankimin (kërkesë padinë) drejtuar gjykatës kundër urdhërit të përjashtimit ose lirimit. E drejta e ankimit në gjykatë kundër urdhërit të përjashtimit ose lirimit nga policia apo puna është një e drejtë personale. Ashtu si në çdo rast tjetër të shqyrtimit gjyqsor, ushtrimi i kësaj të drejte, e ve detyrimisht gjykatën para zgjidhjes së problemit të çështjes që shqyrton. Nuk mund të kuptohet roli i gjykatës dhe sidomos roli i vendimmarrës i saj, vetëm me konstatimin apo vënien në dukje të shkeljes, siç shprehet Gjykata e Lartë në Vendimin Unifikues. Ligji nuk kufizon mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga gjykata dhe për rrjedhojë, kur paditesi kërkon rikthim në punën e mëparshme dhe gjykata konstaton e pranon se ai është larguar padrejtësisht nga puna, ajo ka të drejtë dhe detyrim njëkohsisht të vendosë për rikthimin në punë të tij.

ç) Gjykata në rastin konkret ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 1/2 të K.Pr.Civile, sipas të cilit: *“Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arësytim se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë”*. Pra edhe pse ligji “Për Policinë e Shtetit” nuk parashikon drejtpërdrejtë kthimin në punë, kjo nuk legjitimon Gjykatën e Lartë të vendose rregulla që zenë vendin e ligjit.

d) Gjithashtu, ai vjen në kundërshtim dhe me vendimin e Gjykatës së Strasbourg-ut në çështjen Pellegrin kundër Francës. Gjykata e Lartë, megjithëse i referohet këtij vendimi, ajo e keqinterpretonte atë. Në vendimin e Gjykatës së Strasbourg-ut bëhet fjalë *“për disa poste që kanë të bëjnë me përgjegjësi në sektorin publik, që janë në interesin e përgjithshëm, ose me pjesmarrje të ushtrimit të pushteteve që jepen prej të drejtës publike. Mbajtësit e posteve të tilla përdorin një pjesë të pushtetit sovran të shtetit. Për rrjedhojë, shteti ka një interes ligjitim për të kërkuar prej këtyre nëpunësve një detyrim të veçantë besimi dhe besnikërie”*. Nga kjo referencë kuptohet qartë që bëhet fjalë për poste të larta drejtuese në sektorin publik, pjesë e të cilit është edhe Policia e Shtetit. Duke ju referuar akteve normative për Policinë e Shtetit, punonjësit e policisë ndahen në katër role (nivele apo kategori), roli bazë, roli i mesëm, roli i lartë dhe roli madhor. Dhe nëse gjykatat tona do t'i referohen vendimit të Gjykatës së Strasbourg-ut, duhet t'i referohen vetëm kur kanë çështje në gjykim me punonjësit e policisë të rolit madhor dhe jo me punonjësit e roleve të tjera. Ky konkluzion del edhe nga vetë vendimi Gjykatës së Strasbourg-ut, e cila shprehet se, *“Nga ana tjetër, në lidhje me postet e tjera, të cilat nuk kanë këtë aspekt të administrimit publik”, nuk ka interes të tillë”*. Pra kuptohet qartë se, *detyrimi i veçantë besimi dhe besnikërie*, nuk kërkohet për punonjësit e policisë të roleve të tjera dhe sidomos për punonjësit e thjeshtë të Policisë apo të Gardës që

mund të jenë edhe roje të objekteve, patrullë, polic trafiku, magazinier, kujdestar, inspektor etj, por për drejtuesit kryesorë më të lartë të saj.

Aresytimi në Vendimin Unifikues dhe në vendimet gjyqësore që i referohen atij nuk gjen mbështetje as në ligjet e mëposhtëme:

a) Nr. 8670, dt. 26.10.2000 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 28 të të cilit parashikohet e drejta e ushtarakut që kur mosmarrveshjet nuk zgjidhen, të ankohet në gjykatë dhe se (pika 3) “*Kur akti i shfuqizuar nga gjykata ka të bëjë me nxjerrjen në rezervë ose me lirim të ushtarakut, ai ka të drejtë të rikthehet në detyrën e mëparshme ose në një detyrë tjetër të njëjtë me atë të mëparshmen*”.

b) Kodin e Punës, ndryshuar me Ligjin Nr. 9125, datë 29.07.2003, neni 146 (i ndryshuar), sipas të cilit: “*Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arësyeshme është e pavlefshme. Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim gjykate të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim*”.

c) Nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, në dispozitat e të cilit parashikohet se, kur nëpunësi civil largohet padrejtësisht nga puna ka të drejtë të ankohet në Komisionin e Shërbimit Civil dhe në gjykatë. Këto organe *kur konstatojnë se ai është larguar padrejtësisht nga puna vendosin rikthimin e tij në vendin e punës*.

Pra edhe nga këto akte normative, të cilat mbrojnë kategori të ndryshme punonjësish, duke përfshirë edhe ata të administratës publike, rezulton se Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 31, datë 14.04.2003, duke mos i kthyer në punë punonjësit e policisë (të cilët janë pjesë e administratës publike), i shkel hapur të drejtat ligjore dhe i diskriminon ata. Megjithëse ai është antikushtetues dhe antiligjor ka sjellë dhe vazhdon të sjellë pasoja të pallogaritshme për punonjësit e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës e të tjerë.

Fatkeqësisht, paditësi në çështjen konkrete të shqyrtuar nga Kolegjet e Bashkuara, ish punonjës policie i rolit bazë (polic), nuk kishte shfrytëzuar të drejtën ligjore kushtetuese për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e tij.

Në një rast konkret, i cili lidhej me ish punonjësin e policisë S. P., Institucioni ynë së bashku me ankuesin iu drejtua Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e këtij vendimi. Por Gjykata Kushtetuese duke u mbështetur në anën formale, për shkak të mosqënies tonë palë në atë proces gjyqësor civil, e rrëzoi kërkesë tonë. Po mundohemi të gjejmë rrugë të tjera juridike për ta ndrequr këtë padrejtësi të madhe në dëm të punonjësve të policisë, që përveç të tjerave kanë në rrezik çdo ditë edhe jetën e tyre për të mbrojtur liritë dhe të drejtat e qytetarëve të tjerë.

B- Ish Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit

Për vitin 2005 Institucioni ynë ka ndjekur 22 ankesa me këtë Ministri, nga të cilat 11 prej tyre janë mbartur nga viti 2004. Nga ky numër ankesash, 21 prej tyre kanë përfunduar dhe 1 ankese është ende në shqyrtim e sipër. Nga 21 ankesat që kanë përfunduar, 3 prej tyre kanë qenë jashtë juridiksionit, 4 ankesa janë të pa bazuara, 5 janë zgjidhur në favor të ankuesve dhe 9 ankesa kanë qenë jashtë kompetence.

Problematika e ankesave ka qënë e njëjtë me atë të prezantuar edhe në Raportet e mëparshme, kryesisht mos përfitimi i ndihmës nga shteti në raste fatkeqësish që kanë ndodhur nga forcat madhore, si zjarre, përmbytjet, shembje banesash nga rrëshqitjet e tokave, etj. Kjo ngjashmëri buron nga fakti se mungesa e deritanishme e fondeve me destinacion të tillë, ka sjellë mbartjen e ankesave me të njëjtën objekt nga viti në vit dhe për pasojë dhe mos zgjidhjen e tyre në favor të ankuesve.

Në ankesat e tyre pretenduesit e shkeljes së të drejtave, kërkojnë zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.206 datë 26.03.1998 “Për kriteret e pjesëmarrjes së shtetit në përballimin e dëmeve në raste fatkeqësish”. Nga shqyrtimi i ankesave ka rezultuar se kërkimet e shtetasve, pjesërisht janë të drejta dhe burojnë nga vetë aktet ligjore dhe nënligjore. Por zgjidhja e tyre në favor të ankuesve paraqitet e pamundur për pamundësi financiare të buxhetit të shtetit.

Nga ish Ministria e Pushtetit Vendor, e cila aktualisht me strukturimin e ri të organeve qendrore është përfshirë në Ministrinë e Brendshme, në vijimësi të ndjekjes së ankesave, jemi informuar se ka vështirësi në sigurimin e fondeve me destinacion të tillë dhe prandaj numri i ankesave sa vjen dhe shtohet. Duke qënë se fondet për ndihmë jepen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, me vendime të veçanta të Qeverisë janë akorduar disa herë fonde, kur problemi ka qënë masiv dhe kur fatkeqësitë natyrore kanë prekur zona dhe shtresa të gjera të popullsisë, sikurse është dhe akordimi i fondeve për zonat e përmbytura nga rreshjet e fundit në zonat jugore dhe veriore, apo zonat ku ka patur rrëshqitje masive të tokës dhe si rezultat janë shkatërruar shumë banesa dhe janë shpërngulur mjaft familje.

Në këtë kontekst mendojmë se për ankesat që janë grumbulluar dhe vazhdojnë të evidentohen aktualisht nga Ministria e Brendshme, është e nevojshme të përcaktohen prioritetet, sikundër janë rastet kur fatkeqësitë natyrore kanë qënë me pasoja të rënda për një jetesë normale. Edhe gjatë këtij viti është ende evident problemi i paraqitur nga Kryesia e fshatit Nimçe, Komuna Topojan, Kukes, e cila na paraqet shqetësimin që ka ardhur si rezultat i rrëshqitjeve masive të tokës në këtë zonë, fakt i cili ka sjellë vështirësi të shumta për një jetesë normale, pasi rrezikon shembjen

e shtëpive dhe ka ndërprerë komunikimin me zonën. Këtij fenomeni kete vit i jane shtuar dhe shume te tjera qe kane ardhur se fundi nga rreshqitjet masive te tokes, sikurse eshte rasti ne zonen e Elbasanit dhe zona te tjera te cilat nga raportet perkatese te eksperteve kane rezultuar si toka te pabanueshme. Për këtë gjendje të krijuar në vijimësi Institucioni ynë, ka rekomanduar ndihmë dhe mbështetje nga shteti dhe strukturat e tij, duke i bërë thirrje për një sensibilizim dhe nxitje në zgjidhje të problemit, por problemi është evident, per mungese fondesh.

Ne ndjekje te problemeve gjate ketij viti, serisht eshte verejtur mungesa e transparencës dhe informimit të publikut, për veprimet dhe procedurat që ndërmarren për këto raste, per shperndarjet e fondeve dhe trajtimin e ceshtjeve rast pas rasti. Gjithashtu do të ripërmendim këtu dhe mungesën e plotë të informimit për ekzistencën e tregut të sigurimeve, të cilat nëse do të operojnë intensivisht sipas objektit të veprimtarisë, mbulojnë financiarisht një pjesë të madhe të fatkeqësive natyrore. Detyrimi ynë ligjor dhe institucional, ka qene dhe është të nxisim dhe sensibilizojmë organet qendrore që çdo vit të programojnë fonde me destinacione të tilla, si dhe pranë organeve të pushtetit vendor, të cilat nga ana e tyre, duhet të menaxhojnë mirë burimet financiare, në favor të zgjidhjes së shqetësimeve jetike të komunitetit. Në këtë drejtim do të vazhdojmë të synojmë, në mënyrë që të garantojmë rritjen e besimit për zgjidhjen e ankesave të shtetasve.

Ne raportin vjetor te vitit 2004 me ish Ministrine e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, prezantuam ankesen e një grupi punonjësish të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të cilët pretenduan se nga ana e kesaj Ministrie nuk janë përmbushur disa kërkesa të Ligjit Nr.8766 datë 5.04.2001 “Për mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin” në trajtimin e efektivave të kësaj strukture. Rekomandimi i Zyres tone per kete rast u zgjidh gjate vitit 2005, pasi u ngrit grupi i punes per ndjekjen e procedurave për zbatimin e plotë të detyrimeve ligjore e nënligjore, per perfitimin e te drejtave ne trajtimin e këtyre efektivave.

Vecojme me kete Ministri ankesen e S.H. i cili pretendonte zbatimin e Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.151, date 25.04.2002 “Per statusin e Deshmorit te Atdheut”, sepse djali i tij ishte deshmor i atdheut dhe duhej te perfitonte shumen prej 150.000 lekesh per shpenzimet e varrimit si dhe ndihme per familjen ne masen e tri pagave minimale. Per kete ceshtje i jemi drejtuar Ministrit te Brendshem dhe jemi ende ne shqyrtim e siper, duke besuar ne nje zgjidhje pozitive te favorshme per kete kategori ankuesish.

Ankesat për organet e pushtetit vendor (Komunat, Bashkitë, dhe Prefekturat)

Gjatë vitit 2005 kemi patur 372 ankesa, nga te cilat 273 jane ankesa te ketij viti dhe 99 jane mbartur nga viti 2004. Problematika e tyre është e larmishme dhe natyrisht jo e panjohur, pasi është prezantuar edhe në Raportet e mëparëshme.

a. Ankesa për komunat

Nga 67 ankesa që kemi shqyrtuar me Komunat, 16 prej tyre janë të mbartuara nga viti 2004. Nga këto, 11 çështje janë ende në shqyrtim dhe 56 janë përfunduar, nga të cilat 11 janë në favor, 24 jashtë juridiksionit dhe 17 konsiderohen ankesa të pa bazuara dhe 4 ankesa jane jashte kompetences. Nga ky total 4 ankesa kane perfunduar me rekomandime. Objekti i ankesave të paraqitura gjatë këtij viti, ka qenë i ndryshëm, duke filluar që nga konfliktet e pronësisë në procedurat e ndjekura gjatë ndarjes së tokave nga Komisionet e Ndarjes së Tokave, të cilat trajtohen në një zë të veçantë më poshtë dhe deri tek problemet jetike të komunitetit, si perfitimet e ndryshme qe rrjedhin nga aktet ligjore dhe nenligjore, zvarritje procedurash administrative, mungese informimi, apo ndërprerje e padrejtë e ndihmës ekonomike, mos përfitim i përkrahjes sociale, apo largime nga puna të pamotivuara, etj.

Fenomenet e shfaqura, si dhe problemet ekzistuese, te evidentuara vit pas viti janë më të dukshme në këto nivele vendore, sepse dhe niveli profesional nuk është në standartet që kërkon koha. Kjo sjell që vlerësimet dhe qëndrimet e tyre në raport me shkeljet e konstatuara, të mos gjejnë në kohën e duhur zgjidhjen ligjore të domosdoshme. Shpesh nga mos njohja e akteve ligjore dhe nënligjore, komunat jo vetëm që nuk shqyrtojnë dhe zgjidhin probleme, por nuk kthejnë as përgjigje ankuesve për sa kërkojnë. Sikurse e kemi konstatuar edhe me pare, Kodi i Proçedurave Administrative, në shumë raste nuk njihet, por edhe kur njihet ose nuk zbatohet ose keqpërdoret për interesa të caktuara dhe shkaqe të pajustificuara.

Nga numri i shumte i ankesave qe kemi ndjekur vecojme specifiken e ankeses se paraqitur nga shtetasi A. M., banues ne fshatin Pojan, Korce, me anen e te ciles shprehet shqetesimi per praktiken qe ndjek Komuna Pojan per mos dhenien e çertifikatave dhe te dhenave te tjera, nga ana e Zyres se Gjendjes Civile te te njejtes Komune, shtetasve qe nuk kane shlyer taksen e tokes. Nepermjet kesaj ankese shtetasi A.M kerkoi nderhyrje per anullimin e ketyre praktikave qe kane veshtiresuar marredheniet e individeve me organet vendore te pushtetit.

Ne ndjekje te ketij rasti me kryetarin e komunes, i beme te ditur mendimin e institucionit tone, se nuk jemi dakort me praktikat e ndjekura ne kete rast nga Komuna dhe Keshilli i Komunes. Nxjerrjen e urdherave

administrative, per te mos ju sherbyer ne asnje Zyre te Komunes shtetasve qe nuk kane paguar taksen per token, e vleresuar si nje veprim antikushtetues, te paligjshem, jashte kompetencave te Kryetarit te Komunes dhe te Keshillit te Komunes dhe qe cenon rende jo vetem te drejttat e tyre per marrjen e dokumentave vetjake dhe te drejten per t'u informuar, por edhe marrdheniet e njesive te pushtetit vendor dhe te Zyrave qe funksionojne prane tyre, me zgjedhesit. Kjo nuk do te thote ne asnje menyre, se marrim ne mbrojtje veprimet e individeve te veçante per mos pagimin e taksave. Por terheqim vemendjen e organeve vendore per faktin, qe nje shkelje e ligjit nuk mund te riparohet ose te rivendoset, me nje shkelje tjeter te ligjit; per me shume qe te nderpriten arbitrarisht te gjitha marrdheniet e shtetasve me zyrat e atashuara prane pushtetit vendor.

Duke i vleresuar veprimet dhe Urdherat Administrative te Komunes dhe Keshillit te Komunes Pojan te rrethit Korçe, qe subjektet taksapagues qe nuk kane shlyer taksen per token, mos t'u sherbehet ne asnje zyre te Komunes dhe mos t'ju jepet asnje informacion apo shkrese sado e thjeshte, si te marra ne kundersiztim me frymen e Kushtetutes, me te gjitha aktet ligjore dhe nenligjore dale ne mbrojtje te te drejtave te tilla si e drejta e informimit dhe e mos cenimit te tyre pa nje proces te rregullt gjyqesor, Institucioni i Avokatit te Popullit ne perputhje me detyrimet e tij kushtetuese, rekomandoi qe te anulohen te gjitha urdherat administrative dhe te gjitha praktikatat qe kane nderprere marrdheniet e shtetasve me te gjitha Zyrat prane Komunes, per faktin e mos pagimit te taksave vendore dhe te mos perseriten me ne te ardhmen. Ne vazhdim te ndjekjes se ceshtjes, Kryetari i Keshillit te Komunes Pojan, reflektoi vullnetin e pushtetit lokal per zbatimin e rekomandimit dhe nderprerjen e menjehershem te menyrave te tilla te jashteligjeshme te komunikimit te tyre me zgjedhesit.

Ne vijim te ankesave me Komunat mund te permendim shqetesimin e nje pjese te komunitetit te fshatit Shendelli per problemin e tokes bujqesore, te mos dhenies te perkrahjes familjeve ne nevoje, mos regjistrimin e femijeve ne Zyren e Gjendjes Civile dhe te tjera qe kane te bejne me sherbimet.

Zyra jone me t'u njohur me kete ankese urdheroi nje grup ekspertesh, me ne krye nje nga zevendesat e Avokatit te Popullit, per te kontaktuar me perfaqesuesit e pushtetit lokal, per te kqyrur ne vend, pra ne Komunat e Xarres, dinamikën e ceshtjeve te ngritura nga komuniteti.

Pas verifikimeve konstatuam se problemet ishin te shumta, jo vetem si pasoje i shpernguljes te familjeve nga zonat veri-lindore dhe shkaqeve ne pergjithesi objektive ne te tilla raste, por edhe te veprimeve te ngatheta te organeve te pushtetit vendor. Per keto shkaqe kerkuam nga Komuna dhe Keshilli i Komunes Xarre, nga ish Keshilli i rrethit Sarande

dhe Prefektura Vlore, si organe kompetente te caktuara nga ligji, angazhim me te madh per zgjidhjen e problemeve te tilla jetesore si per sigurimin e ujit dhe dritave, te krijimit te kushteve te shkollimit te femijve, te shendetesise dhe te sherbimeve te tjera. Aktualisht sikunder u pranuan nga ankuesit, Shendellia eshte miratuar ligjerisht si fshat dhe pushteti lokal eshte aktualisht ne nje shkalle me te larte impenjimi, qe ne kushtet konkrete dhe me fonde te kufizuara te kete arritje te dukeshme.

Ne kete fshat nje problem tjetër i evidentuar eshte ai i pajisjes me toke bujqesore ne pronesi ose ne perdorim. Ne kete rast iu shpjegua Ligji nr.7501, date 19.7.1991 “Per token”, sipas te ciles familjeve pretenduese per token bujqesore e kane marre ne pronesi sasine e tokes sipas perberjes familjare te dates 1 Gusht 1991, ne vend banimet e tyre te mepareshme. Sipas ketij ligji asnje subjekt nuk mund te pajiset dy here me toke bujqesore ne pronesi. Nga ana tjetër, dhenia e tokes bujqesore shteterore ne perdorim ose me qira eshte e ndalur. Me akte ligjore dhe nenligjore te meparshme, por edhe ne nenin 28 te Ligjit nr.9235, date 29.7.2004, “Per kthimin dhe kompensimin e prones” parashikohet qe : “Per tokat qe jane ne pronesi te shtetit, organet kompetente te administrates publike ndalohen te lidhin kontrata posedimi a pronesie me te trete deri ne perfundim te procesit te kthimit dhe kompensimit te prones”. Kryetari i Komunes, per kete problem na shpjegoi se te gjitha familjet e fshatit Shendelli, aktualisht kane nje sasi toke bujqesore shteterore qe e punojne dhe gezojne frutat e tyre dhe per te cilen nuk ju eshte kerkuar dhe marre asnje qira apo takse.

Serisht evidente gjate ketij viti kane qene problemet e shperndarjes se tokes, per shkaqe nga me te ndryshme sikurse eshte rasti i nje ankuesi nga fshati Gramsh, Komuna Dushk, rrethi Lushnje, i cili pretendonte se Komisioni i Tokës, nuk i ka dhënë tokë bujqësore në pronësi në bazë të Ligjit nr.7501, datë 19.7.1991. Gjate shqyrtimit te ceshtjes ankuesi u sqarua se ne zbatim të VKM nr.255, date 2.8.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, Komisioni i Tokës së fshatit do të japë në pronësi tokat e mbetura, të konvertuara sipas koeficientëve të përcaktuara në të.

Gjithashtu e informuam se në bazë të VKM nr. 231, datë 19.5.1993 “Për tokat qe refuzohen të merren në pronësi ose në përdorim dhe zgjidhjen e kërkesave të shtetasve për lënien e tokës”, familjet që e refuzojnë atë për çfarëdo shkak, nuk trajtohen më me tokë, e cila në këto raste kalon në pronësi të shtetit.

Gjate vitit 2005 specifikisht mund te bejme prezent edhe ankesen e S.S, me ane te se ciles pretendon zbatimin e Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.332, date 29.05.2003 “Per disa shtesa e ndryshime ne vendimin nr.326 date 21.06.1993, te Keshillit te Ministrave, “Per kriteret e trajtimit te invalideve te luftes kunder pushtuesve nazifashiste te popullit shqiptar”. Keshtu ai na informoi se te jatin e ka patur invalid te

luftes, per kete arsye, ai pretendon t'i japin nje shume prej 150.000 lekesh per shpenzimet e vdekjes se babait te tij, por Komuna nuk e likuidon per mungese fondesh.

Vendimi i mesiperm me ndryshimet e metejshme, ka te percaktuar se;

“Kur **invalidi i luftes** vdes **komuna** ose bashkia i ben nderimet perkatese dhe perballon shpenzimet e varrimit, duke i dhene familjes se te ndjerit 150.000 leke. Ne shpenzimet e varrimit perfshihen arkivoli, transporti, qendrimi ne morg, ceremonia dhe dreka”.

Nga kjo dispozite kuptohet se detyrimin per pagimin e kesaj shume e ka komuna ose bashkia dhe nuk ka te beje me detyrueshmerine e organeve te tjera, si Sigurimet Shoqerore per pagimin e kesaj shume.

Duke vleresuar problemin ne teresi, gjykuam se ankuesit i takon ta marre ate shume lekesh dhe Komuna si organ i detyruar nga ligji dhe nga ana tjetere, Komuna duhet ta permbushë kete detyrim ligjor. Ky detyrim eshte i percaktuar mjaft qarte me Vendimin e Keshillit te Ministrave te lartpermendur. Prandaj dhe per kete arsye i rekomanduam Komunes Dishnice, gjetjen e hapësirave ligjore per sigurimin e shumes ne favor te ankuesit. Kjo ankese eshte ne shqyrtim e siper pasi ende nuk disponojme asnje pergjigje.

Gjatë shqyrtimit të ankesave me Komunat, është vërejtur se në disa raste në këto struktura, aktet administrative apo shkallët e ankimit administrativ, nuk njihen ose ndërmerren veprime nga kryetarët e komunave që kapërcejnë kompetencat e tyre. Gjithashtu janë shfaqur dhe zvarritje e neglizhenca në trajtimin e problemeve, mos angazhim për zgjidhjen e fenomeneve, sidomos në zonat rurale. Kjo dhe për faktin se duke qenë të veshur me mandat zgjedhor, Kryetarët e Komunave e konsiderojnë veten të pacënueshëm edhe në rastet kur shkelin ligjin në mënyrë sistematike, me dashje apo për qëllime abuzive.

b. Ankesat për bashkitë

Gjatë vitit 2005 në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë mbërritur 212 ankesa kundrejt Bashkive. Gjithashtu jane ndjekur dhe 81 ankesa te mbartura nga viti 2004, pra gjithsej jane shqyrtuar 293. Nga këto janë përfunduar 252 dhe janë ende në shqyrtim 41 ankesa. Nga totali i ankesave të përfunduara kanë rezultuar 59 ankesa në favor të ankuesve, 102 prej tyre jashtë juridiksionit, 43 ankesa jashtë kompetente dhe 48 ankesa të pa bazuara. Nga keto 10 ankesa kane perfunduar me rekomandime. Problematika e çështjeve është e ndryshme dhe e shumëllojshme. Natyrisht edhe këtë vit prezantohen probleme dhe fenomene, të cilat nuk janë të panjohura dhe të paditura, porse zgjidhja e tyre është ende larg pasi kërkon kohë, investime, burime njerëzore dhe financiare dhe për më tepër projekte dhe strategji të qarta afat gjata dhe

afat shkurtëra, duke përcaktuar më parë prioritetet dhe alternativa zgjidhje. Shumica e objektit të ankesave të mbërritura gjatë këtij viti ka patur në qendër të vëmendjes, çështjen e strehimit si një problem madhor, i prekshëm, jetik, por praktikisht ende i pazgjidhshëm. Zgjidhja pjesërisht e strehimit të familjeve të pastreha nga renia e skemave piramidale natyrisht është një hap i madh përpara, që rrit besimin dhe shpresën në materializimin e politikave të zgjidhjes së këtij problemi. Megjithatë ende ka shumë për të bërë në këtë drejtim. Duke shpresuar se aktet e fundit ligjore dhe nënligjore që kanë dalë nga Qeveria për zgjidhjen e strehimit, si dhe prioriteti i saj në këtë drejtim, do të zgjidhin hap pas hapi këtë problem kombëtar dhe madhor, besojmë se dhe kategoritë e tjera të pastreha do të përfitojnë nga këto politika sociale të shtetit. Megjithatë gjatë trajtimit të këtyre ankesave ka patur pretendime nga ankuesit, se mungon transparenca në përzgjedhjen e kategorive apo në vendimarrjet për zgjidhjen e këtyre çështjeve dhe sidomos në vendimet që marrin këshillat bashkiake, për të cilat pretendohet se asnjëherë nuk dihen kriteret vlerësuese e radha e trajtimit të shtetasve. Mungon informimi publik për ditën e mbledhjeve, apo dhe rendin e ditës të mbledhjeve të këshillave bashkiake, të cilat duhet të jenë publike dhe të njohura, me qëllim që personat e interesuar të jenë pjesë e kësaj procedure, për të cilët janë direkt të interesuar dhe për të cilat duhet të vihen në dijeni, qoftë dhe se kur praktikisht mund të zgjidhen shqetësimet e tyre. Në këtë drejtim është e nevojshme të rritet transparenca nga organet e pushtetit vendor, për t'i bërë të njohur taksapaguesve dhe zgjedhësve të tyre punën dhe arritjet për zgjidhjen e këtij problemi madhor, si dhe strategjitë përkatëse, pasi shpesh shtetasit nuk informohen në kohë për kuadrin ligjor ekzistues dhe në këtë mënyrë humbasin dhe afatet ligjore për mbrojtjen e interesave të tyre të ligjshme. Këto organe, duke qenë se ushtrojnë veprimtarinë mbi bazën e parimit të autonomisë dhe vetëqeverisjes, duhet që të rritin bashkëpunimin me komunitetin për tërheqjen e mendimit të tyre, për alternativat dhe kohën e zgjidhjes. Për gjithë kuadrin ligjor që trajton strehimin, shtetasit janë krejtësisht të pa informuar, pasi shpesh nuk dinë se ku duhet t'i kërkojnë të drejtat e tyre.

Sikurse edhe vitin e kaluar janë konstatuar mjaft raste kur Bashkitë nuk shfrytëzojnë mjetet ligjore për zgjidhjen e ankesave të shtetasve, nuk shfrytëzojnë kompetencat që u jep Ligji Nr.8652 datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes vendore", duke hezitur në nxjerrjen e urdhërave administrative, duke i treguar qytetarëve rrugën gjyqësore. Ndërkohë që sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit të sipërcituar, ato kanë të drejtë të ndërmarrin procedime të tilla, duke marrë në shqyrtim dhe vendosur edhe për ankimet administrative. Ndërsa në mjaft raste të tjera i tejkalojnë këto kompetenca, duke marrë përsipër detyra funksionale të cilat nuk i takojnë.

Vecojme ketu ankesen e disa shtetasve ne Tirane te cilet u ankuan per gjobat qe Policia Bashkiake ka aplikuar per parkime te automjeteve ne vende te gabuara. Pretendohej se Policia Bashkiake bllokonte mjetin ne nje vend ku nuk kishte asnje table treguese, per ndalim parkimi duke i vendosur nje gjobe me vlere prej 5000 leke, nepermjet nje dokumenti ne te cilen shkruhej *“kundravajtje per pengese pastrim qyteti”*, duke e shoqeruar kete veprim edhe me bllokimin e mjetit. Ç’bllokimi i mjetit diktohej vetem duke bere pagimin e gjobes. Ky veprim pretendohej nga ankuesi se eshte krejtesisht i pa baze, ne nje vend ku nuk ka asnje table treguese, kur mungon teresisht informimi dhe ku qytetaret penalizohen rende duke i bllokuar mjetin, ne varesi te pagimit te gjobes per ta çbllokuar. Atyre me kete rast u mohohet dhe mundesia e apelimit te kesaj gjobe, pavaresisht nese jane te drejta apo jo, duke i vene qytetaret para nje alternative detyruese, pagimi i gjobes-çbllokimi i mjetit. Kjo eshte nje shkelje e rende e te drejtave te qytetareve. Nga shqyrtimi i kesaj ankese, doli se ishin rreth 290 raste te tilla.

Konstatuam se veprimet e Policise Bashkiake ne vendosjen e gjobave nuk ishin veprime te bazuara ne ligj dhe ishin aplikuar ne kapercim te kompetencave qe i jep ligji Nr.8335 date 23.04.1998 *“Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.8224 date 15.05.1997 “Per organizimin dhe funksionimin e Policise Bashkiake...”*, neni 8 pika 6 ne te cilen percaktohet se: *“Policia e Bashkise ka per detyre te ndaloje, te shmange e prishe ndertimet e paligjshme, te ndaloje zenien e paligjshme te trojeve dhe te ndertesave te objekteve publike te bashkise apo komunes si dhe te organizoje lirimin e tyre”*. Zbatimi ne praktike i kesaj dispozite, ne rastin konkret apo ne raste te tjera analoge me te, eshte i gabuar pasi kufijte dhe funksionet e pushteteve te administrates publike jane te ndara dhe nuk mund te konkurrojne e dublojne njeri tjetrin.

Nga pershkrimi i ketij kuadri ligjor, verehet lehtesisht se ne veprimet e Policise Bashkiake ka perplasje me Policine Rrugore gjate ushtrimit te kompetencave. Por perderisa ne ligjin organik te Policise Bashkiake eshte percaktuar se *“ushtron funksionet qe nuk jane ne kompetence te autoriteteve te tjera shteterore”*, ky rast perjashtimor ben qe rastet e shkeljeve te mesiperme ne vendosjen e masave administrative te gjobave, te jene atribuite vetem te Policise Rrugore dhe si rrjedhore Policia Bashkiake s’mund te aplikojte te tilla gjoba.

Por ne vendosjen e gjobave nga Policia Bashkiake krahas shkeljes si me siper, rezulton te kete dhe shkelje te tjera te karakterit procedural.

Se pari vendosja e unifikuar e gjobes, vetem ne masen 5000 leke do te thote te mos shqyrtosh rast pas rasti shkeljen dhe rendesine e saj. Duke anashkaluar shqyrtimin e ketyre rrethanave rast pas rasti, (vetem ne pak kohe jane vendosur dhe vjele 290 gjoba) vetvetiu lind dyshimi per nje

paragjykim ne vendosjen e kesaj mase administrative, pavaresisht nga shkelja dhe rendesia e saj.

Se dyti gjate ushtrimit te kompetencave te saj Policia Bashkiake, ka bere edhe nje tjetër shkelje, duke perdorur mjetin bllokues ne vendet e konsideruara parkime te gabuara apo zenie te hapësires publike, megjithë mungesen e sinjalistikes nga ana e Bashkise. Ne rastet kur Policia Bashkiake ka perdorur pajisjen per bllokimin e mjeteve, nisur nga fakti se qendrimi ne keto vende sjell çrregullime ne qarkullim dhe ne sherbimet qe ofron Bashkia per komunitetin, ka ndodhur pikerisht e kunderta, pasi ky bllokim deri ne likuidimin e gjobes ka shkaktuar si pasoje kaos ne trafik, zenien e hapësira publike nga keto mjete te bllokuara, si dhe ç'rregullim ne sherbimet publike te ofruara per shtetasit.

Se treti, me veprimet e Policise Bashkiake, pra ç'bllokimi i mjetit i kondicionuar deri ne likuidimin e gjobes, shtetasve u eshte mohuar dhe e drejta e ankimit, nje e drejte e cila eshte e garantuar nga Kushtetuta dhe aktet e tjera ligjore dhe nenligjore.

Ne keto kushte nga sa parashtruam me siper, vleresuar se veprime te tilla pa asnje baze ligjore jo vetem qe bien ndesh me frymen e legjislacionit tone, por ato ndikojne ne uljen e autoritetit dhe besueshmerise se qeverisjes vendore.

Per kete ceshtje i rekomanduam Bashkise Tirane konstatimin absolutisht te pavlefshem te akteve administrative, nepermjet te cilave jane vendosur 290 gjoba, dhe marrjen e masave ndaj personave qe kane urdheruar dhe zbatuar kete shkelje, si dhe mosperseritjen ne te ardhmen e shkeljeve te tilla, qe bien ndesh me aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi dhe me te drejtat e njeriut. Reagimi nga ana e Bashkise ishte pozitiv, sepse procesi i nisur u pezullua, per te studiuar hapat dhe procedurat administrative qe ishin ndjekur per kete ceshtje.

Shtetasit B.D, i cili ne emer te disa subjekte ndertuese te interesuara per te ndertuar ne territorin e ish uzines "Enver", kane paraqitur shqetesimin e tyre, ne lidhje me mosdhenien e lejeve te ndertimit nga ana e institucionit dhe e strukturave perkatese ne Bashkine Tirane per kete zone.

Sikunder ata pretendojne, nga ana e Bashkise Tirane nuk jepen me leje ndertimi ne kete zone, duke u bllokuar nje proces i cili realisht po u shkakton nje dem te madh ketyre subjekteve.

Nga ky shqyrtim u evidentua mosveprim i Bashkise ne lidhje me procesin e plotesimit te dokumentacionit te nevojshem, qe duhej t'i dergohej prej kohesh Ministrise te Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes.

Ky dokumentacion do te mundesoje pergatitjen e gjithë procedures se nevojshme dokumentare, per paraqitjen dhe miratimin ne Qeveri te vendimit perkates per transferimin ne pronesi te Bashkise Tirane per nevoja publike te disa pronave (uzina etj).

Per rrjedhoje ky vendim do te mundesoje edhe zhbllokimin e situates, persa i perket dhenies se lejeve te ndertimit, ne kete zone.

Per rivendosjen ne vend te se drejtes se shkelur per kete ceshtje i drejtuam nje rekomandim Bashkise Tirane ne menyre qe te zhbllokohet dhe pershpejtohet procedura per dergimin ne nje kohe sa me te shpejte te dokumentacionit te nevojshem, Ministrise te Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, per pergatitjen e projekt-vendimit per transferimin ne pronesi te Bashkise Tirane per nevoja publike, te disa pronave, ne territorin e ish uzines "Enver". Ne pergjigje te ketij rekomandimi u informuam se jane ndermarre hapat dhe kryer veprimet per te bere te mundur realizimin e kesaj te drejte te kerkuar.

Nje tjetër rast tipik qe do te donim te veconim ne kete prezantim lidhur me mosveprimin e pushtetit vendor, eshte ankesa e shtetasit F. J. i cili pretendonte per mosveprim te Bashkise Kelcyre dhe Policise te Ndertimit, dega Gjirokaster, per ekzekutimin e vendimit nr.79/1 date 28.03.2003 te Keshillit te Rregullimit te Territorit, te Qarkut Gjirokaster.

Sikunder ai pretendonte sipas nje vendimi te KRRT te Qarkut Gjirokaster duhej te prisheshin rrethimet e objekteve te qytetareve M.A. dhe J. P. ne pjesen veriore te banesave te tyre, ne menyre qe te hapej rruga publike perkatese ne gjeresi 3 m, sipas studimit urbanistik te miratuar per lagjen e spitalit, Kelcyre. Mosveprimi ne kete ceshtje konsistonte ne faktin se nuk mund te behet ekzekutimi i vendimit ne fjale, pa u bere me pare shpronесimi ndaj shtetasve qe cenohen ne prone nga ky vendim.

Per kete ceshtje nepermjet mediacionit u gjet nje zgjidhje alternative, ne perputhje me planin rregullues te qytetit Kelcyre, te miratuar me vendim te KRRT-se se Rrethit Permet nr.240 date 18.08.1995.

Sikurse me te gjitha organet e pushtetit qendor dhe vendor edhe me Bashkite, ka qene evident problemi i mos ekzekutimeve te vendimeve gjyqesore te formes se prere. Mund te permendim ketu ankesen e shtetases E.SH nga qyteti i Fierit, e cila na shprehu shqetesimin per mosekzekutimin e nje vendimi gjyqesor te Gjykates se Shkalles se Pare Fier, ne te cilet parashikohej detyrimi i Bashkise per t'i likuiduar pagesen ankueses.

Avokati i Popullit per rivendosjen e te drejtave ne vend i rekomandoi Bashkise, shlyerjen e detyrimit monetar ne favor te ankueses E.Sh., te drejte te cilen ajo e kishte perfituar me vendim gjyqesor te formes se prere. Jemi informuar se per permbushjen e ketij detyrimi, jane kryer te gjitha veprimet dhe procedurat e nevojshme ligjore.

Raste te tjera analoge te mos ekzekutimit te vendimeve gjyqesore dhe vendimeve te Komisionit te Sherbimit Civil, te cilat ende nuk kane gjetur rrugen e zgjidhjes jane edhe ato qe i takojne shtetasve I.B dhe D.K

nga Peqinit. Te dy ankuesit jane larguar nga puna me akte administrative te Kryetarit te Bashkise Peqin duke qene pjese e sherbimit civil.

Avokati i Popullit, duke e vleresuar si absolutisht te padrejte qendrimin refuzues te Kryetarit te Bashkise i shpjegoi se:

Çdo drejtues i institucioneve te administrates publike duhet te kete te qarte se; vendimet e Komisionit te Sherbimit Civil ne baze te nenit 8 pika 3 te ligjit Nr.8549 date 11.11.1999 "Statusi i Nepunesit Civil" jane te detyrueshme per zbatim nga te gjithë institucionet e administrates publike qendrore dhe vendore.

Edhe per keto ceshtje Avokati i Popullit i rekomandoi Bashkise Peqinit ekzekutimin e vendimeve te Komisionit te Sherbimit Civil, duke i rikthyer ne detyren e meparshme ankuesit dhe pagimin e pages per kohen e qendrimit pa pune, por keto rekomandime dhe ky detyrim ligjor rezulton ende i refuzuar nga Kryetari i Bashkise Peqinit, i cili me keto mosveprime krahas shkeljes se te drejtave ndaj shtetasve, rendon dhe buxhetin e shtetit, pasi detyrimi financiar vazhdon deri ne ekzekutimin e vendimit.

Nje rast tipik qe mendojme te prezantrojme dhe qe lidhet me tejkalime te ushtrimit te kompetencave te pushtetit vendor, nepermjet veprimeve dhe mos veprimeve te kundraligjshme, eshte dhe rasti i Bashkise Pogradecit, e cila ka nxjerre urdherit administrativ Nr 11. date 14.2.2005, te Kryetarit te Bashkise Pogradec, me titull :”Mos kryerjen e sherbimeve per qytetaret te cilet nuk kane paguar taksat vendore”.

Nga Bashkia u informuam se ky urdher administrativ ben fjale per ato raste kur individe te ndryshem jane debitore ndaj Bashkise, pra qe nuk kane paguar taksa, tatime dhe detyrime te tjera. Per kete arsye ndaj tyre, sipas urdherit, duhet mbajtur qendrim duke mos iu sherbyer nga asnje zyre e Bashkise. Dhe jo vetem kaq, por ndaj punonjesve qe nuk zbatojne kete urdher do te merren masa administrative.

Avokati i Popullit i rekomandoi Bashkise Pogradecit revokimin e urdherit administrativ *Nr 11. date 14.2.2005* si akt administrativ i pavlefshem. Rekomandimi u mireprit dhe u zbatua, duke u revokuar dhe rivendosur keshtu ne vend te gjitha te drejtat e shkelura kundrejt qytetareve. Analog me kete rast kemi ndjekur me iniciative edhe urdherin Nr.29 date 12.08.2005 te Kryetarit te Bashkise Bilisht, i njejte ne permbajtje me urdherin e cituar me lart nxjerre nga Kryetari i Bashkise Pogradecit. Edhe per kete ceshtje paraqitem rekomandimin tone, i cili u shfuqizua pjeserisht vetem per disa sherbime.

Megjithëse ne veprimtarine e organeve te pushtetit vendor, verehen perpjekje per me shume profesionalizem dhe kulture konformë frymes se ndertimit te nje shteti ligjor, ende eshte larg standateve qe kerkon koha. Per kete arsye gjithmone kemi menduar dhe gjykojme se ka nevojë për një oponencë konstruktive të vazhdueshme, e cila në rastet konkrete që

kemi ndjekur me këto organe, jemi munduar t'ia servirim me profesionalizëm e objektivitet.

c. Ankesat për prefekturat

Gjithsej kemi trajtuar 6 ankesa me prefekturat për këtë vit, nga të cilat 2 janë të mbartura nga viti 2004. Te gjitha këto janë përfunduar, nga të cilat 2 janë në favor të ankuesve, 4 janë jashtë juridiksionit.

Nga shqyrtimi i ankesave me Prefekturat vërehet se kryesisht shkeljet e të drejtave kanë ardhur si rezultat i moszbatimit të procedurave administrative në procedimet e ndryshme që ndërmarin këto organe për zgjidhjen e problemeve me komunitetin, largimet nga puna, etj.

Prefekti duke qenë një hallkë e posaçme ndërmjetëse midis pushtetit qendror dhe vendor, duhet të bashkerendojë punën dhe veprimtarinë me këto institucione dhe në këtë këndvështrim janë konstatuar raste të zvarritjeve të procedurave administrative, mungesë transparence, apo dhe mos informim për veprimet apo mosveprimet e këtij organi. Vecojme ankesën e paraqitur nga ankuesi B.D nga qyteti i Durrësit i cili iu drejtua Prefekturës së Qarkut Durrës, pasi kjo e fundit i pezullonte lejen e ndertimit ankuesit dhe pretendonte prej tij, se kjo bëhej pa shkaqe të arsyeshme. Duke qenë se kërkesave të ankuesit, kjo Prefekturë nuk i pergjigjej, duke tejkaluar të gjitha afatet ligjore, kerkoi nderhyrjen e Avokatit të Popullit. Zyra jone mori ne shqyrtim rastin duke ndermjetesuar prane kesaj Prefekturë, e cila me vonesat e saj ne disponimin e pergjigjeve ndaj ankuesit, po shkelte ne vijimesi te gjitha afatet ligjore dhe siguroi informacionin e kerkuar.

Ne vijimesine e rasteve me kete organ vecojme ankesën e V.R. i cili shpreh shqetesimin lidhur me shkeljen e procedurave ligjore per ndertimin e nje banese nga qytetari Dh. V. Ankuesi pretendonte se qytetari kufitar me pronen e tij, po i cenonte pronesine sepse nuk respektonte distancën e lejuar sipas ligjit Nr.8405 date 17.09.1998 “Per Urbanistiken” dhe Rregullores se Urbanistikes.

Nga kendveshtrimi i ligjit per “Urbanistiken”, rezultoi se banesa e ankuesit vertet cenohej nga ndertimi i baneses se qytetarit Dh.V.ne menyre te ndjeshme.

Keto shkelje ligjore u verifikuan ne vend nga zyra jone, e cila iu drejtua Prefekturës së qarkut Tirane, duke kerkuar qe te verifikohet ligjishmeria e lejes se ndertimit per kundravajtesin. Gjate shqyrtimit te ceshtjes, me pas u vendos nxjerrja e aktit te pezullimit te ndertimit e cila konkluido i dhe me nje vendim per prishjen e ndertimit te paligjshem qe cenonte pronesine e ankuesit.

Ne perfundim mund te themi se Prefekturat në zbatim të Ligjit Nr.8927 datë 25.07.2002 “Për Prefektin”, duhet të rrisin rolin e tyre kontrollues mbi administrimin dhe veprimtarinë e organeve të pushtetit

vendor në të gjitha hallkat e tij, si dhe kontrollin e bazueshmërisë ligjore të të gjitha akteve që nxjerrin këto organe, për t'u prerë rrugën veprimeve të kundraligjishme dhe abuzive që në fillim, me qëllim që situata të mos derivojë dhe të sjellë pasoja të pariparueshme sociale dhe ligjore për shtetasit.

d. Ankesat per Keshillat e Qarqeve

Ankesa, nga te cilat 9 prej tyre jane mbartuar nga viti 2004. Nga keto 15 kane perfunduar dhe 1 eshte ende ne shqyrtim e siper. Nga numri i ankesave te perfunduara, 4 kane qene ne favor te ankuesve, 9 jashte juridiksionit dhe 2 te pa bazuara.

Edhe gjate ketij viti jane evidentuar probleme lidhur me mos ekzekutime vendimesh gjyqesore apo te vendimeve te Komisionit te Sherbimit Civil, apo zvarritje proceduriale ne ndjekjen e ceshtjeve, kerkesave apo ankesave te shtetasve.

Do te veconim ankesen e E.K nga qyteti i Elbasanit, lidhur me moszbatimin e vendimit te Komisionit te Sherbimit Civil Nr. 268 date 30.12.2004, nga ana e Keshillit te Qarkut Elbasan.

Megjithese ankuesi ezauroi te gjitha mjetet ligjore ne mbrojtje te te drejtave te tij legjitime, deri ne Gjykatën e Larte, Keshilli i Qarkut Elbasan, vazhdon te refuzoje zbatimin e ligjit dhe te shkele dispozitat kushtetuese.

Avokati i Popullit duke e konsideruar qëndrimin e kryetarit te keshillit te qarkut Elbasan, si absolutisht të padrejtë, dergoi sqarime te metejshme, duke besuar ne nje qendrim reflektues te tij kundrejt ligjit.

Qëndrime të tilla, si kjo e kryetarit te Keshillit te Qarkut Elbasan, pa bazë ligjore jo vetëm vijnë ndesh me tërë frymën e legjislacionit shqiptar e aktet ndërkombëtare, por ulin autoritetin dhe besueshmërinë e institucioneve të pavarura dhe cënojnë rëndë autoritetin e shtetit dhe qeverisjes, duke shkelur rëndë të drejtat ligjore të nëpunësit të shërbimit civil.

Duke patur mendimin absolut që administrata publike udhëhiqet nga parimi i transparencës e ligjshmërisë, duke vlerësuar si detyrë imperative obligimin për të çuar përpara demokracinë dhe respektimin e të drejtave e lirive themelore të shtetasve, rekomanduami per kete rast, marrjen e masave per zbatimin e vendimeve gjyqesore ne favor te ankuesit E.K. por serisht pergjigjia e disponuar nga Keshillit te Qarkut Elbasan, ishte e pa precedent pasi ai i kerkonte ankuesit t'i drejtohej perseri gjykates, nderkohe qe shkallet e gjyqesorit ishin shfrytezuar teresisht.

dh. Ankesat për Gjëndjet Civile

Edhe gjate ketij viti prane Zyres tone jane trajtuar ankesa te cilat lidhen me sherbimin e Zyrave te Gjendjes Civile. Keshtu jane shqyrtuar 27 ankesa, nga te cilat 4 jane mbartur nga viti 2004. Nga te gjitha keto 26 kane perfunduar dhe 1 ankesa eshte ne shqyrtim. Nga ankesat e perfunduara 10 kane rezultuar te zgjidhura ne favor te ankuesve, 8 kane qene te pa bazuara dhe 7 jashte juridiksionit. Gjithashtu eshte bere nje rekomandim, i cili eshte ende ne shqyrtim per mos disponim te pergjigjes

Pjesën më të madhe të ankesave për Zyrat e Gjendjes Civile, e zënë ato per te cilat pretendohet mosveprim apo mos informim te shtetasve per ligjin e ri te gjendjes civile dhe per rrjedhoje mos plotesim te kerkesave te tyre, e ne ndonje rast zvarritje te procedurave gjatë trajtimit të ketyre kerkesave.

Ne numrin e ankesave lidhur sherbimet qe ofron kjo Zyre, pjesa me e madhe ka qene ne favor te ankuesve, pasi ata jane orientuar dhe sqaruar per rrugen e zgjidhjes qe duhet te ndjekin dhe procedurat paraprake bazuar ne ligjin Nr.8950 date 10.10.2002 “Per Gjendjen Civile”.

Permendim ankesen e shtetasit I.P, i cili pretendonte se pengohej pa te drejte per marrjen e certifikates familjare dhe martesore nga ana e Zyres se Gjendjes Civile Nr.7 Tirane. Nepermjet mediacionit tone me kete Zyre, shtetasit ne fjale iu siguruan te dy dokumentat qe kerkonte.

Ne vijim te ankesave qe vlen te permendim me Zyrat e Gjendjes Civile, per te cilen ne perfundim te shqyrtimit u paraqit nje rekomandim, eshte ajo e shtetases M.H. e cila kerkonte nga Zyra e Gjendjes Civile Nr.3 Tirane, t'i bente ndryshimet e emrit dhe mbiemrit, nipit te saj ne Greqi.

Pasi u mor kjo ankesa ne shqyrtim rezultoi se nepunesja e gjendjes civile, pasi kishte bere ndryshimin e mbiemrit nuk pranonte te bente dhe ndryshimin e emrit, sepse kishte dale Udhezimi nr.13, date 19.12.2002 i Ministrit te Pushtetit Lokal, pika “3” (a) ne te cilin citohet se;

“Deri ne leshimin e numrit te indentitetit, i cili eshte numer unik i paperseritshem qe verteton identitetin e shtetasve, duhet;

“Te mos behet ndryshimi i emrit ose i mbiemrit per te njejtin shtetas”.

Per kete ceshtje u sqaruam se ekziston nje kufizim i perkohshem i te drejtes te parashikuar ne nenin 37 te Ligjit nr.8950 date 10.10.2002, “Per Gjendjen Civile”, kufizim i cili sipas tyre nuk cenon thelbin e lirive dhe te drejtave te njeriut.

Nisur nga ky qendrim per udhezimin ne fjale, analizuam legjislacionin perkates dhe ne vijim parashtruam se :

Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise neni 118, pika 1 e saj eshte percaktuar se;

“ Aktet nenligjore nxirren ne baze dhe per zbatim te ligjeve nga organet e parashikuara ne Kushtetute”.

Nga pikepamja juridike del qarte se udhezimi nxirret vetem ne baze e per zbatim te ligjit. Ky eshte nje kusht i domosdoshem qe duhet kuptuar drejte. Ne asnje rast udhezimi nuk mund te kufizojte te drejta qe ligji i lejon.

Nderkohe ne preambulen e udhezimit te siperpermendur, thuhet se ky i fundit eshte mbeshtetur ne nenin 37, te Ligjit nr.8950, date 10.10.2002 “Per Gjendjen Civile”, ku percaktohet se :

“Ndryshimi i emrit dhe i mbiemrit behet pas miratimit te kerkeses se shtetasit nga drejtuesi i zyres se gjendjes civile, ku ka regjistrin themeltar”.

Pra nga dispozita e lartpermendur ndryshimi i emrit dhe i mbiemrit mund te behet njekohesisht nga i njejt person. Vete ligji ka perdorur lidhezen “dhe”, duke ia dhene te drejten per ndryshim identiteti individit si per emrin dhe per mbiemrin.

Nderkohe Udhezimi Nr.13, i dates 9.12.2002, ka kufizuar ndryshimin e emrit dhe te mbiemrit, deri ne leshimin e numrit te identitetit si numer unik dhe i paperseritshem. Megjithese ky udhezim e ka lidhur kete ngushtim te se drejtes se individit, me momentin e daljes se numrave te identitetit, perseri nuk ka te percaktuar qarte kohen se deri kur vlen ky udhezim, pra sa do te jete kohezgjatja e pajisjes se qytetareve me karta identiteti. Ne llogjiken e rastit ne fjale duhet te pranojme se deri ne pajisjen me numra identiteti, qytetaret nuk mund te ushtrojne te drejten e tyre per ndryshim te emrit dhe mbiemrit. Ata thjesht duhet te presin ne perfundimin e ketij procesi pa afat ?.

Ne nenin 37 ne piken 1 te po ketij ligji, jane percaktuar arsyet e mosndryshimit te emrit dhe mbiemrit te nje personi ndaj te *cilit ka kallezim ose ka nisur procedimin penal, deri ne perfundimin e tij*. Pra vetem nese ndodhet para ketyre dy rasteve nepunesi i gjendjes civile nuk mund ta beje ndryshimin e emrit dhe mbiemrit, kurse ne raste te tjera eshte e lejueshme. Per te evituar cdo rast abuzimi ne ndryshimin e identitetin, mund te udhezohen drejtuesit e zyrave te gjendjes civile qe kerkesat e personit, te jene te shoqeruara me vertetim nga policia, prokuroria dhe gjykata per statusin e tyre, nese kane kallzim apo ndjekje penale ne ngarkim.

Nga sa me lart rezulton se referuar nenit 37 te ligjit te siperpermendur, individi mund te kerkoje njekohesisht ndryshimin e emrit dhe mbiemrit, nderkohe qe udhezimi e pengon individin te beje kete ndryshim.

Per sa me siper, gjykuam te rekomandonim revokimin e Udhezimit Nr.13 dt.19.12.2002 “Per procedurat e ndryshimit te emrit dhe mbiemrit”, per te cilen nuk kemi marre asnje pergjgje. Se fundi ky rekomandim eshte percjelle dhe Ministrit te Brendshem, pasi ky sherbim aktualisht eshte ne varesi te ketij Dikasteri.

6. Ministria e Mbrojtjes

Per vitin 2005 ndaj strukturave te Ministrisë së Mbrojtjes janë trajtuar 116 kërkesa e ankesa nga subjekte ushtarake apo ish ushtarake. Nga këto 9 kërkesa apo ankesa të mbartura nga viti 2004 janë përfunduar. Për vitin 2005 janë përfunduar 113 nga ankesat e paraqitura. Janë në shqyrtim edhe 3 ankesa që i përkasin muajit dhjetor 2005.

Duke analizuar në tërësinë e tyre ankesat e ardhura në Institucionin tonë për vitin 2005, konstatohet se ato janë bërë kryesisht nga oficerë, nënoficerë, nga punonjës civilë, ushtarë, si dhe ushtarake të dalë në rezervë.

Nga ankesat e përfunduara gjatë vitit 2005, rezulton se 44 ankesa ose 38.9 përqind e tyre kanë gjetur zgjidhje pozitive. Ky është një tregues mjaft i kënaqshëm që tregon efikasitetin e punës sonë si dhe bashkëpunimin e frytshëm me Ministrinë e Mbrojtjes. Ndërsa 21 ankesa ose 18.5 përqind kanë qënë jashtë kompetencës tonë, 39 ose 34.5 përqind kanë qënë ankesa te pabazuara, një ankesë ka përfunduar me heqje dorë nga ankuesi.

Gjatë vitit 2005 zyra e Avokatit të Popullit ka marrë takim me rreth 450 subjekte ushtarake. Në këto takime ata kanë prezantuar ankesat e tyre. Për ato raste që ata kanë gjykuar të bëjnë ankesat me shkrim, ato i kanë bërë me shkrim. Numri i ankesave për vitin 2005 është 44 raste më i madh se në vitin e kaluar. Kjo rritje përbën numrin e ankesave me shkrim nga ushtarët, të marra gjatë organizimit të ditëve të hapura në repartet ushtarake. Kjo vërteton se konkluzioni ynë i bërë prezent në raportin vjetor të vitit të kaluar se ushtarët e kanë të vështirë dhe ngurojnë ti drejtohen zyrës sonë, ka qënë i drejtë. Ashtu siç ishim angazhuar në raportin vjetor të vitit të kaluar, gjatë vitit 2005 nga ana jonë u organizuan ditët e hapura në disa reparte ushtarake ku kishte grumbullime të mëdha ushtarësh. Kështu organizuam takime me marinarë të Qendrës Stërvitore Pashaliman Vlorë, me ushtarë të Brigadës së Stërvitjes Bunavi, me ushtarë e oficerë të repartit të Poshnjës në Rrethin e Beratit etj. Në këto takime oficerë, nënoficerë dhe ushtarë prezantuan ankesat e tyre, të cilat kishin të bënin kryesisht me problemet:

1. Të mobilizimit në shërbimin ushtarak në kundërshtim me ligjin.
2. Të keqtrajtimit të ushtarëve apo marinarëve nga ana e komandantëve të tyre.
3. Të mosnjohjes së vjetërsisë së shërbimit si ushtarak, në ato raste kur më parë kanë punuar si punonjës civil në këto reparte ushtarake.

4. Të mospagesës së shërbimit 24 orësh dhe punës në ditet e pushimit të oficerëve e nënoficerëve.
5. Të kushteve të jetesës dhe të banimit në repartet ku kryejnë shërbimin.

Mbi bazën e ankesave të oficerëve dhe ushtarëve zyra jonë dërgoi rekomandimet përkatëse. Pas përgjigjeve të dërguara nga komandat e reparteve rezultoi se ato janë vënë në lëvizje dhe për ato çështje që ishin në vartësi të tyre, brenda një kohe shumë të shkurtër kanë bërë përmirësimin e disa prej kushteve të jetesës.

Nga takimi që u organizua në Brigadën e Stërvitjes në Bunavi ushtari V.T. prezantoi ankesën e tij se ishte thirrur në shërbimin e detyrueshëm ushtarak në kundërshtim me ligjin. Për këtë zyra jonë bëri verifikimet e nevojshme dhe në përfundim, na rezultoi se ishte e vërtetë se i sipërpërmenduri ishte thirrur për të kryer shërbimin ushtarak në kundërshtim me ligjin, mbasi ishte kryefamiljar dhe bashkëjetonte vetëm me gjyshen e tij shumë të moshuar, pa asnjë të ardhur. Sa më sipër ne bëmë rekomandimin për lirim të tij nga shërbimi ushtarak. Në përgjigje të këtij rekomandimi, nga Drejtoria e Personel-Organizimit pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kemi marrë konfirmimin se është bërë urdhëri për lirim të tij nga ushtria.

Gjatë vitit 2005, në tre raste, zyra jonë është përballur me ankesa të ushtarëve që bëjnë fjalë për keqtrajtimin e tyre, nga komandat e reparteve. Në Brigadën e Stërvitjes Bunavi ushtar F.D. u ankua se nga ana e komandantit të tij D.H. ishte keqtrajtuar duke e goditur me shkelm në organet gjinitale. Për këtë zyra jonë ndërmori një hetim të hollësishëm duke bërë edhe aktin përkatës të ekspertimit, nga ku në përfundim rezultoi se ankesa e ushtarit ishte e drejtë. Për këtë do të kërkohej nisja e procedimit penal ndaj oficerit D.H. Por ndërkohë ankuesi hoqi dorë nga ankesa. Të detyruar nga ky fakt, duke mos na lejuar ligji të vepronim, çështja u arkivua. Por përpjekjet tona për të zbuluar dhe për të parandaluar raste të kësaj natyre vazhduan.

Në Qendrën Stërvitore Pashaliman F.Ç. dhe M.B u ankuan se në kundërshtim flagrant me ligjin ata kanë qënë nën trysni të fyerjeve dhe rrahjeve nga oficerët A.L dhe O.V. Për këtë të dy të sipërpërmendurit në prani të rreth 150 marinarëve dhe oficerëve të këtij reparti pranuan fajin dhe kërkuan falje. Lidhur me ndjekjen e mëtejshme të rastit, ankuesit hoqën dorë duke u mjaftuar me faljen e kërkuar nga oficerët por pavarësisht nga kjo, zyra jonë nëpërmjet rekomandimit i kërkoi komandës së repartit që të marrë masat e nevojshme për të mos u përsëritur në të ardhmen veprime të kësaj natyre.

Pas shqyrtimit të problemeve kryesore të cilat na janë bërë prezent nëpërmjet ankesave të subjekteve ushtarake del përsëri në pah, që ankesat

e ushtarakëve apo ish ushtarakëve që ndërpresin karrierën, apo e kanë ndërprerë atë, kohë më parë në kuadrin e reformës në Forcat e Armatosura qysh nga viti 1992 e në vazhdim, zenë një vënd të konsiderueshëm.

Këta persona ankohen se, jo vetëm që masa e pensionit të tyre është më e ulët se pensioni i kolegeve të tyre që kanë dalë në pension pas vitit 1993, edhe pse kanë qënë të barazvlefshëm në detyrë, por dhe për të kundërshtuar inisiativën e Kryeministrit, për të ndryshuar ligjin nr. 9418 datë 20.05.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Kërkesa apo ankesa të kësaj natyre kanë paraqitur jo vetëm individë të caktuar, por edhe shoqata e grupime të tjera ish ushtarakësh.

Avokati i Popullit qysh më datën 29.11.2003 i ka drejtuar Kryeministrit z. Fatos Nano, rekomandimin në lidhje me shqyrtimin dhe kalimin në Kuvend të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8087, datë 13.03.1996, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Kombëtar në Republikën e Shqipërisë”. Me nxjerrjen e akteve të tjera zbatuese si dhe me inisiativat që janë marrë kohët e fundit për të bërë disa ndryshime në ligjin “Për pensionet suplementare” shpresojmë që këto probleme të marrin zgjidhjen e duhur.

Zyra jonë në fazën kur akoma nuk kishte hyrë në fuqi ligji, (mbasi ai hynte në fuqi më 1 janar 2006), nuk mund të ndërhynte. Për këtë problem përgjigja jonë ka qënë se është e drejta e Qeverisë të bëjë propozime për ndryshime në ligje.

Është për tu përmendur fakti se, pak nga këta subjekte kundërshtojnë daljen në rezervë pasi, për një gjë të tillë, në përkrahje të reformave në Forcat e Armatosura, ata janë ndërgjegjësuar. Por ankesat e tyre kanë të bëjnë me mospërfitimet e të drejtave që ju siguron atyre ligji nr. 8087, datë 13.03.1996 dhe ndryshimet përkatëse të mëvonshme të këtij ligji. Jo gjithmonë nga strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe disa komanda ushtarake është vepruar me korrektesë, drejt dhe në kohë, në mënyrë që këta ushtarakë, pas ndërprerjes së karrierës, të përfitojnë atë çka ju takon me ligj.

Nga përgjithësimi i këtyre rasteve, ne kemi arritur në konkluzionin se gjatë zbatimit të reformës, në mënyrën se si është vepruar ka patur shkelje të të drejtave të kësaj kategorie ushtarakësh. Ankesat e tyre janë bërë prezent tek ne gjatë vitit 2005 dhe kanë përbërë një pjesë të rëndësishme të punës sonë.

Konkretisht, pas hetimit tonë për këto ankesa doli se, Ministria e Mbrojtjes pas përcaktimit të kriterëve të reformës si mosha, profesionalizmi dhe përkushtimi në detyrë, ka filluar në vazhdimësi procedurat e ndërprerjes së marrëdhënieve të karrierës së oficerëve aktivë

të planifikuar për t'u larguar. Por këto procedura, nuk u kryen gjithmonë konform ligjit dhe akteve nënligjore, por u veprua në mënyrë të tillë, që solli hapur shkeljen e të drejtave e tyre, sepse ushtarakët e sipërpërmëndur u lanë “ushtarakë aktivë”, por pa pagesë e në dispozicion për muaj të tërë. Kështu në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë inspektori i M.C.R në Prefekturën e Gjirokastrës z. N.K. Ankuesi ka pretenduar se në bazë të urdhërit të Ministrit nr.5647, datë 29.05.2003 ka dalë në rezervë. Sipas urdhërit të Ministrit marrëdhëniet financiare i ndërpriten më 01.06.2003, kurse sipas urdhërit të Prefektit marrëdhëniet financiare i ndërpriten në datën 20.05. 2002, d.m.th rreth 12 muaj përpara daljes së urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes, që e ka nxjerrë në lirim më datë 01. 06.2003. Në këtë mënyrë është shkelur e drejta e tij, për t'u trajtuar me pagë për një periudhë 12 mujore. Për këtë nga ana jonë është ndërmar një proces hetimi, çështja është në shqyrtim.

Veç problemeve të sipërpërmëndura, për vitin 2005 në Institucionin tonë oficerë të ndryshëm kanë paraqitur ankesa të tjera, të cilat në mënyrë të grupuar paraqiten si më poshtë:

-Për nxjerrjen në lirim apo largime të padrejta nga puna.

Kështu G. M. oficer në Qendrën Stërvitore Pashaliman është ankuar se ka dalë në rezervë pa asnjë motivacion. Nga verifikimet tona doli se ende nuk ka dalë në rezervë dhe është angazhuar në kursin e lartë të oficerave, për përparim në gradë.

B.H, A. B., janë ankuar pranë Institucionit të Avokatit të Popullit se janë nxjerrë në rezervë në kundërshtim me ligjin. Në realitet nga verifikimet tona doli se janë nxjerrë në rezervë për shkak se nuk kanë përparuar në gradë, për rrjedhojë largimi i tyre nga detyra ka qënë i drejtë.

- Ankesa të punonjësve civilë, të cilët janë ankuar se koha që kanë punuar në ushtri si civil nuk ju njihet si vjetërsi shërbimi si ushtarakë, ndonëse tashmë kryejnë detyra si ushtarakë. Për këtë zyra jonë ka hyrë në një dialog konstruktiv me Ministrinë e Mbrojtjes dhe ky problem është zgjidhur me ligj vetëm për punonjësit e kundërzbulimit.Ndërsa për punonjësit e tjerë koha e shërbimit si punonjës civil nuk mund të njihet për efekt të vjetërsisë në punë si ushtarak. Ministria e Mbrojtjes për të minimizuar pasojat sociale dhe ekonomike që vijnë nga dalja e papunë e këtyre punonjësve, ka paraqitur projektligjet apo projektvendimet përkatëse.

Numri i përgjithshëm i ankesave të ardhura për vitin 2005, kundër Komisionit të Statusit të Veteranit dhe Dëshmorit të Atdheut ka qënë 28 ankesa ose rreth 26 përqind e numrit të ankesave të regjistruara për vitin 2005. Mënyra e përfundimit të tyre ka qënë: 10 ankesa janë zgjidhur në favor, 12 ankesa kanë qënë jashtë kompetence, kurse 6 ankesa të pabazuara. Objekti i ankesave të paraqitura ka qënë për përfitimin e statusit të veteranit, për statusin e dëshmorit, apo dhe për përfitime shtesë

që rrjedhin nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.190, datë 03.05.1995, për veteranët të cilët gjatë luftës kanë qënë në burgjet nazifashiste brënda apo jashtë vëndit

Qysh në fillim konstatojmë se Ministria e Mbrojtjes ka bërë vlerësimin e veteranëve duke paraqitur projektet e nevojshme dhe Qeveria ka nxjerrë Vendimet përkatëse. “Për rritjen e masës së shpërblimit të veteranëve të LANÇ-it të popullit shqiptar” etj.

Nga shqyrtimi i disa ankesave për këtë kategori personash, (veteranët e luftës) doli se dokumentat e paraqitura prej tyre pranë Komisionit Qëndror të Statusit të Veteranit, janë paraqitur jashtë afatit ose paraqitja e dokumentave me vonesë është bërë mbi bazën e një vendimi të gjykatës për rivendosjen e afatit.

Në këto rrethana, për ta zgjidhur këtë situatë, u bashkëpunua dhe me Departamentin e Veteranëve në Ministrinë e Mbrojtjes ku gjetëm mirëkuptim dhe predispozicionin e duhur. Nga bashkëpunimi rezultoi se pranë atij Departamenti, numri i veteranëve që kishin paraqitur ankesa ishte shumë më i madh se sa i janë drejtuar Institucionit tonë. Konkretisht janë rreth 2000 persona në shkallë vendi duke pritur shqyrtimin e dokumentave. Nga këta 1500 veteranë, kanë dërguar përsëri dokumentat në Komisionin Qëndror të Statusit të Veteranit dhe Dëshmorit të Atdheut, ndërsa 500 persona pretendojnë të marrin statusin me vendim gjykate si dhe mjaft të tjerë që pretendojnë të marrin Statusin e Veteranit të Luftës.

Personat e mësipërm i kishin paraqitur dokumentat e mësipërme jashtë afatit të përcaktuar pas datës 30 Korrik 2002.

Me qëllimin e mirë për të vënë në vënd të drejtën e kësaj kategorie personash të cilët janë me moshë mbi 70 vjeç, me kushte jetese e mundësi të pakta financiare për të përballuar jetesën, dhe për t’ju dhënë një satisfaksion moral dhe material, Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrin të Mbrojtjes, ndërmarjen e inisiativës për hartimin e projektvendimit të Qeverisë, për caktimin e një afati të ri për paraqitjen e dokumentave pranë Komisionit Qëndror të Statusit të Veteranit të Luftës. Ndonëse Ministria e Mbrojtjes ishte dakort me këtë dhe e paraqiti draftin e shtyrjes së këtij afati, ai nuk u pranua nga Ministria e Financave. Ministria e Mbrojtjes është angazhuar për ta paraqitur përsëri draftin për shtyrjen e afatit të shqyrtimit të dokumentave të veteranëve, duke e argumentuar bindësisht domosdoshmërinë e marrjes së një vendimi të tillë nga Qeveria. Për këtë zyra jonë në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes do të vazhdojë përpjekjet për të realizuar këtë angazhim. Por nga ana jonë nuk jemi mjaftuar me kaq, duke gjykuar se V.K.M-ja nr. 748, datë 11.11.2004 ka krijuar një hapësirë për të aktivizuar Komisionin Qëndror të Statusit të Veteranit në rastet kur vendos gjykata për ta njohur këtë status, ju është rekomanduar ankuesve të kundërshtojnë vendimet e refuzimit të Statusit të veteranit në gjykatë.

Ka disa ankesa për ndërprerjen e pagës së grave të officerëve (pagë për papunësi). Kështu D. K. ankohet se i është ndërprerë paga për papunësi. Për këtë problem zyra jonë që në vitin 2004 e në vazhdim, ka hyrë në një dialog konstruktiv me Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e cila mori angazhimin për të hartuar sa më parë draftin që do të përcaktonte shpërblimin për pagë papunësie të grave të oficerave ashtu siç urdhëron ligja për statusin e ushtarakut. Në këtë kuadër Avokati i Popullit i ka dërguar Ministrisë së Mbrojtjes rekomandimin për shpejtimin e procedurave për nxjerrjen sa më parë të akteve zbatuese të ligjit “Për Statusin e Ushtarakut”. Në përgjigje të këtij rekomandimi njoftohemi se ai është konsideruar i drejtë. Me vendimin nr.854, datë 17.12.2004, Qeveria ka miratuar vendimin, “Për kriteret dhe masën e përfitimit të pagesës së papunësisë për bashkëshortin/en e ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura”. Kështu ankesat e kësaj kategorie edhe për vitin 2005 përfundimisht janë zgjidhur në favor të ushtarakëve që janë ankuar pranë zyrës sonë si dhe shumë ushtarakëve të tjerë, të cilëve ju ishte mohuar kjo e drejtë, por gjithmonë kur paga e papunësisë ka qënë dhënë edhe pas datës 14.05.2004.

Një prioritet i rëndësishëm i punës së Avokatit të Popullit që nga viti 2000 ka qënë zgjidhja e ankesave të ushtarakëve aktiv në lidhje me trajtimin e tyre financiar, për shkak të natyrës së vështirë të punës apo punës me orar të zgjatur etj. Nga raportet e mëparshme Avokati i Popullit ka rekomanduar nevojën e trajtimit financiar më të mirë të ushtarakëve aktiv apo për çeljen e fondeve për trajtimin financiar edhe të ushtarakëve të dalë në rezervë apo lirim. Me V.K.M-në nr.791, datë 26.11.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.839, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e ushtarakëve aktiv të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, janë bërë shtesa në pagë për punë të vështira të ushtarakëve aktiv; shtesa për kushte të veçanta pune dhe shërbimi; shtesa në pagë sipas gradës dhe viteve të shërbimit si dhe shtesa për punë të vështira dhe të dëmshme për shëndetin. Këtë ne e vlerësojmë si një arritje të suksesshme për realizimin e objektivave tona në mbrojtje të të drejtave të ligjshme të njeriut, në sajë të një bashkëpunimi të ngushtë me Ministrinë e Mbrojtjes. Duke shqyrtuar shifrat për ankesat mund të pohojmë se puna me ankesat që lidhen me Ministrinë e Mbrojtjes ka qënë e suksesshme. Por këtë konkluzion nuk e nxjerrim vetëm nga shifrat. Është kënaqësi të raportojmë se Ministria e Mbrojtjes është një nga dikasteret e Administratës sonë Publike ku ne gjithmonë, qysh në fillim të veprimtarisë sonë në vitin 2000 kemi gjetur partnerë të gatshëm për të bashkëpunuar në mënyrë institucionale, me qëllimin e mirë dhe të vetëm për zgjidhjen e drejtë të problemeve dhe shqetësimeve të ushtarakëve.

Bashkëpunimi i mirë me Ministrinë e Mbrojtjes është realizuar në kontaktet direkte me drejtues dhe specialistë të drejtorive përkatëse, të ngarkuara për problemet dhe shqetësimet e ankesave të ushtarakëve si me Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Departamentin e Veteranëve, me Drejtorinë Juridike etj, duke rritur në këtë mënyrë dhe përgjegjësinë e të gjitha strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes, për të trajtuar më me kujdes problemet dhe për të respektuar të drejtat e ligjshme të ushtarakëve. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe informacioni i dërguar Ministrisë së Mbrojtjes në muajin tetor 2006, pas fillimit të punës së Qeverisë Demokratike, ku parashtronim ankesat dhe problemet e pazgjidhura si duhet gjatë periudhës 2000-2004.

Ky mirëkuptim dhe bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes shikohet nga ana jonë si arritje e suksesshme në realizimin e objektivave tona në mbrojtje të të drejtave të ligjshme të njeriut, duke synuar që këtë eksperiencë të mirë ta shtrijmë edhe me dikastere të tjera. Ai ka konsistuar dhe në mirëpritjen, vlerësimin e pranimin e rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit.

Në Prioritetet e Punës së Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2006 përsëri do të jenë organizimi i ditëve të hapura dhe inspektimeve me grup ekspertësh në reparte të ndryshme, që lidhen me Komandat e Forcave Tokësore, Ajrore dhe Detare, me qëllim tërheqjen e ankesave dhe nga ushtarët e nënoficerët e Forcave tona të Armatosura, bashkëpunimi më i ngushtë me Drejtorinë e ndryshme në Ministrinë e Mbrojtjes dhe strukturat e tjera ushtarake për zbatimin korrekt të ligjit dhe zgjidhjen e drejtë të ankesave të ushtarakëve.

Si konkluzion, e gjithë kjo pjesë e punës sonë me këto subjekte ka shërbyer mjaft pozitivisht për realizimin e objektivit kryesor të punës së Institucionit tonë, për të mbrojtur të drejtat e njeriut, duke ndikuar në këtë mënyrë në mirëadministrimin e pushtetit dhe mirëqeverisjen edhe në Forcat e Armatosura.

7. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Numri i ankesave të shqyrtuara nga Institucioni ynë lidhur me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, (ish Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale) si dhe të institucioneve në varësi të saj, Institutin e Sigurimeve Shoqërore Shtetërore, Shërbimin Social Shtetëror dhe filialet e tyre në rrethe ka qenë 156. Nga këto 14 çështje kanë qenë për vetë Ministrinë. Ndërsa ankesa dhe kërkesa të mbartura nga viti 2004 e që janë shqyrtuar në vitin 2005 kanë qenë 42. Problematika e ankesave të trajtuara ka qenë thuajse e njëjtë me ato të viteve të mëparshme.

Po përmendim një rast me iniciativë i ndërmarrë nga Zyra jonë që ka përfunduar me zgjidhje pozitive.

Mediat transmetuan njoftimin për rritjen e numrit të sëmurëve si pasojë e helmimeve në ambientet e fabrikave të prodhimit të këpucëve Tiranë. Këtë çështje e verifikuam menjëherë në Klinikën e Sëmundjeve Profesionale Tiranë, ku ishin shtruar pacientet. Nga të dhënat spitalore u evidentua se shumica e pacienteve ishin femra, të cilat në shumicë i përkisnin moshës 14-18 vjeç. Të gjithë patën shfaqur sptoma të njëjta dhe diagnozë të përgjithshme rritjen e fenoleve në gjak si pasojë e helmimit me lëndë të dëmshme për organizmin. Pacientet në një numër të konsiderueshëm nuk ishin të siguruara dhe ankoheshin për kushtet jo normale të punës.

Në vijim të hetimeve, u organizua takim me Drejtorin e Inspektoratit Shtetëror të Punës, i cili u angazhua të kryejë veprime të menjëhershme inspektimi ndaj këtyre subjekteve. Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të inspektimeve të mëparshme rezultoi se Inspektorati Shtetëror i Punës kishte kryer gjatë vitit 2005 inspektimet përkatëse ndaj subjekteve të mësipërme.

Avokati i Popullit duke parë kontraditën e madhe që ekzistonte midis inspektimeve shtetërore ndaj kushteve të punës dhe situatës konkrete që paraqitej nga të dhënat spitalore për sëmundjet profesionale dhe denoncimet e vetë punonjësve, konkludoi se kontrollet e ushtruara nga Inspektorati Shtetëror i Punës ishin të pamjaftueshme, formale dhe nuk pasqyronin në të vërtetë gjendjen e vendeve të punës, punëtorëve dhe shëndetit të punëtorëve. Nga ana e Inspektoratit Shtetëror të Punës Tiranë nuk ishin bërë përpjekje serioze për identifikimin e problemeve gjatë inspektimeve pararendëse, mosveprim i cili ka gjeneruar në realitet pasoja negative për shëndetin e punonjësve dhe në kushtet normale të punës.

Si rrjedhim duke i konsideruar këto mosveprime të organeve të administratës publike si shkaktare kryesore të mosparandalimit të gjendjes aktuale në fabrikat e këpucëve në Tiranë, i rekomanduam Inspektoriatit Shtetëror të Punës si dhe Inspektoriatit Sanitar Shtetëror:

1. Ushtrimin e menjëhershëm të kontrolleve ndaj subjekteve private që zhvillojnë veprimtari në prodhimin e këpucëve, duke hetuar mbi shkaqet e sëmundjeve profesionale dhe parandalimin e pasojave të mëtejshme.

2. Marrjen e masave paraprake për një kontroll të plotë, të gjithanshëm, objektiv, që do t'i shërbejnë qëllimit të përbashkët për zbardhjen e mangësive në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive punëtore.

Tashmë Drejtoria e Shëndetit Publik Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Inspektoriatit Shtetëror të Punës i janë përgjigjur pozitivisht rekomandimit tonë, duke hartuar një program pune konkret për inspektimin sanitar në të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtarinë

për "prodhimin e këpucëve" në rajonin e Tiranës. Sidoqoftë këtë çështje do ta mbajmë në monitorim të vazhdueshëm.

a) Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Gjatë vitit 2005 ankesa të drejtuara ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore kanë qenë 126. Nga këto ankesa janë përfunduar 111 dhe kemi akoma në proces shqyrtimi 15 prej tyre. Nga ankesat e përfunduara kanë rezultuar 41 të pabazuara, 47 jashtë juridiksioni, 23 të zgjidhura në favor të ankuesve.

Konstatohet se problematika e tyre është thuajse e njëjtë me vitet paraardhëse. Kështu qytetarët ankohen për masën e përfitimit të pensionit të pleqërisë, mostrajtimin si invalid në grupin përkatës dhe pagesën specifike, mospërfitim kompensimesh nga sistemi i Sigurimeve Shoqërore, mospërfitim pensioni familjar, si dhe për problematika të tjera, si shtyrje afati për dalje në pension, të masës së pensionit familjar, mospërfitim të shtesave mbi pension, diferenca në masat e pensioneve, zvarritje të procedurave nga organet kompetente etj. Gjithkush e kupton se sistemi i sigurimeve shoqërore është një sistem kompleks. Por nga ana tjetër asnjë nuk do të ishte dakort që trajtimi i përcaktuar në termat e barazisë dhe përcaktimit taksativ të përfitimit, të shihej dhe të linte shijen e diskriminimit.

Përgjithësisht nga këto ankesa kemi evidentuar se shpesh herë ankuesit nuk kanë konsumuar shkallët e ankimit administrativ brenda strukturave të ISSH-së, pra nuk ankohen në shkallët e Apelit për pretendimet e tyre. Në këto raste ndërhyrja jonë ka qenë e favorshme duke i dhënë mundësinë qytetarit të qartësohet për problemin e tij, pa i hyrë procedurave të zgjidhura administrative nëpërmjet komisioneve. Këtë veprim i kemi orientuar ta kryejnë në një moment të dytë, në qoftë se nuk mbeten të kënaqur dhe t'i drejtohen komisioneve përkatëse të Apelit.

Në vijim po paraqesim disa çështje të përfunduara gjatë vitit 2005, të cilat kanë rezultuar të zgjidhura pozitivisht.

1. Qytetari K.Rr nga Elbasani u ankua për mospërfitimin e pagesës së përkujdesit ndaj fëmijës së tij të paralizuar, dhe kjo arsyetuar me faktin që familja e tij nuk është e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike.

Rezultoi se tashmë nga ana e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është përgatitur projektvendimi "Për kriteret dhe masën e përfitimit të pagesës së personave me aftësi të kufizuara". Në këtë projektvendim pagesa e kujdestarit nuk është e kushtëzuar me përfitimin e ndihmës ekonomike. Pas miratimit nga Këshilli i Ministrave kjo i jep zgjidhje një sërë ankesash me të njëjtin objekt, që kemi pasur pranë Zyrës sonë.

2. Nisur nga ankesa e një studenteje 23 vjeçare, e cila kërkonte pension familjar pas vdekjes së të shoqit, konstatuam nevojën e një shtese

në nenin 40 të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Ndaj i rekomanduam Institutit të Sigurimeve Shoqërore, e më pas i propozuam Komisionit parlamentar për Çështjet Kushtetuese, Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, plotësimin e nenit 40, në mënyrë që në kushtet e përfitimit të pensionit familjar duhet të shtohet dhe shprehja “bashkëshorti ose bashkëshortja, student nën moshën 25 vjeç”. Por me ndryshimet e fundit të miratuara, një përcaktim i tillë nuk u pasqyrua në Ligjin përkatës.

3. Qytetari B.K banues në Tiranë u ankua për moskomisionimin dhe mospërfitimin e pensionit të invaliditetit për bashkëshorten e tij L. K, e cila ishte përpjekur për tu komisionuar pranë KMCAP-it Tiranë, por pa rezultat. Pas kërkesave tona për shpjegime pranë këtij organi administrativ, ankesa e tij tashmë ka marrë zgjidhjen pozitive dhe L.K ka përfituar invaliditetin e pjesshëm me Vendimin e KMCAP-it Epror.

Po kështu duhet të theksojmë faktin se nga trajtimi i mjaft ankesave, të cilat pas shqyrtimit kane rezultuar të pabazuara, është arritur sqarimi ligjor i problemeve të parashtruara nga ankuesit.

Në bazë të të gjitha evidentimeve, statistikave dhe observimeve të nxjerra si dhe bazuar në rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit që ndikon dhe përçon vizionin e mirëqeverisjes, është arritur në konkluzionin se Qeveria Shqiptare së bashku me institucionet e tjera përkatëse, duhet të jetë më efektive, më reale dhe më e përgjegjshme, në politikat që lidhen me përcaktimin e masës së pensioneve.

Ky konkluzion ka dalë pasi shumica e ankuesve problemin e masës së pensionit që ata përfitojnë, e shohin në këndvështrimin e një diskriminimi që u bëhet atyre nga shteti për punën që ata kanë bërë për vite me radhë. Ata kërkojnë të ketë edhe një bazë më të mirë për politikat shtetërore që zhvillohen në këtë drejtim. Kjo lloj politike, do të përkonte më mirë edhe me objektivat sociale të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ku një ndër pikat kryesore është synimi për standartin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor të mundshëm, si dhe përkujdesja dhe ndihma për të moshuarit, jetimët dhe invalidët. Këto zhvillime në fushën e legjislacionit për sigurimet shoqërore nuk kanë kaluar pa reagime të publikut, të cilat janë përcjellë dhe në ankesat që i janë drejtuar Institucionit tonë. Në këto ndryshime kemi të bëjmë me politika që vetë shteti ndjek në këtë fushë dhe ato dalin jashtë juridiksionit të veprimtarisë tonë.

Tashmë me ndryshimet e fundit në ligjin për sigurimet shoqërore është shtuar një nen i posaçëm lidhur me të drejtën për informim. Në këtë kuadër, Avokati i Popullit e ka parë punën e tij të orientuar drejt informimit të qytetarëve për zhvillimet e herëpashershme lidhur me ecurinë e përmirësimeve në Ligjin “Për Sigurimet Shoqërore” dhe

mbajtjen në kontakt të vazhdueshëm të tyre për fazat e rishikimit të këtij legjislacioni.

Bashkëpunimi me administratën lokale e qendrore të sigurimeve shoqërore ka qenë rezultativ, duke vërejtur një përgjegjshmëri në rritje të saj, si kundrejt qytetarit dhe kundrejt Institucionit të Avokatit të Popullit.

b) Ndihma dhe Përkujdesi Shoqëror

Ankesa në këtë fushë të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit për vitin 2005 rezultojnë 17. Nga këto janë përfunduar 13, nga të cilat 6 kanë rezultuar të pabazuara, 3 jashtë juridiksionit, 4 ankesa në favor të ankuesve dhe janë akoma në proces shqyrtimi 4 të tjera.

Kryesisht këto ankesa kanë konsistuar në pretendime për masën e përfitimit të ndihmës ekonomike, ndërprerjen e ndihmës ekonomike, mospërfitim nga e drejta e kujdestarisë.

Në vijimësi, po paraqesim disa nga ankesat tipike të trajtuara në këtë fushë.

1. Ankuesi K. M, banues në Komunën Gostinë, Elbasan, paraqiste shqetësimin për mospërfitimin e ndihmës ekonomike, shumë të nevojshme për mbijetesën e familjes së tij.

Pas shqyrtimit të kësaj ankese, dhe kërkesës për shpjegime që i dërguam Zyrës së Ndihmës Ekonomike dhe Përkrahjes Sociale të Komunës Gostinë, kjo familje u sistemua në skemën e ndihmës ekonomike. Kjo pagesë i filloi që nga muaji Mars 2004.

2. Shtetasi I.S, nga Komuna Cakran, Fier u ankua për ndërprerjen e ndihmës ekonomike.

Pasi kryem verifikimet e nevojshme pranë Zyrës së Ndihmës Ekonomike dhe Përkrahjes Sociale, në Komunën Cakran, Fier, rezultoi se ankuesi nuk kishte paraqitur dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar për përfitimin e ndihmës ekonomike si familje bujqësore.

Nga Komuna na u konfirmua se pasi ankuesi të plotësonte dokumentacionin e nevojshëm, menjëherë do të përfshihej në skemën e ndihmës ekonomike.

3. Kërkesës sonë për shpjegime lidhur me një ankese të disa banorëve të Shtëpisë së të Moshuarve–Azilit të Pleqve Tiranë, për zhvendosjen e tyre në një tjetër ndërtesë, Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror i ka kthyer përgjigje se Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në zbatim të Strategjisë afatmesme të Shërbimeve Shoqërore ka hartuar një plan veprimi afatmesëm për transformimin e Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror nën administrimin e pushtetit vendor dhe transformimin e qendrave rezidenciale të përkujdesit në Qendra të hapura ndaj nevojave të komunitetit. Realizimi i këtyre proceseve do të bëhet në mënyrë graduale mbi një plan të detajuar dhe me përgatitjen e infrastrukturës së

nevojshme, hartimin e akteve nënligjore si dhe me përgatitjen e kapaciteteve profesionale të strukturave të pushtetit vendor.

Në këtë kontekst, një nga masat e marra është edhe kthimi i qendrës ditore Kamëz në Qendër Polivalente që do të ofrojë shërbime për të moshuarit e braktisur dhe shërbime ditore për të moshuarit e komunitetit.

Lidhur me problemin e përfitimit të pagesës së kujdestarisë për të cilin kemi raportuar dhe në raportet e mëparshme, qëndrimi i Zyrës sonë ka qenë që ky lloj përfitimi nuk duhet dhe s'ka pse të lidhet me skemën e ndihmës ekonomike. Rekomandimi i bërë nga ne që në vitin 2002, është konsideruar i drejtë dhe ligjor, dhe tashmë në Ligjin e ri nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, që ka hyrë në fuqi këtë vit reflektohen ndryshimet e mësipërme.

Ajo që është konstatuar dhe që vazhdimisht i është vënë theksi nga Zyra jonë gjatë trajtimit të ankesave lidhur me shërbimin social, është se mundësitë e vendit për të siguruar shëndetin dhe mirëqënien e popullsisë janë kompromentuar nga infrastruktura e dobët, lëvizjet e mëdha demografike, mungesat e përkohshme të stabilitetit të brendshëm dhe kapacitetet e dobëta teknike të strukturave përkatëse. Në këtë kontekst kemi vëmë në dukje se ristrukturimi dhe reformimi i shërbimeve sociale bazë është një element prioritar në uljen e varfërisë.

Tashmë me Ligjin e ri nr.9355 datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, është përcaktuar shprehimisht se “*Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale harton programin e kalimit të institucioneve të përkujdesit shoqëror në varësi të pushtetit vendor, duke filluar nga viti 2005 deri në vitin 2007*”. Ndaj vitin 2006 mund ta konsiderojmë një vit pune intensive për hartimin e nxjerrjen e një sërë akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e Ligjit të ri.

Tashmë me VKM nr.8 të datës 7.01.2005, është miratuar “Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara”, e cila ka si qëllim të përgjithshëm sigurimin e një përmirësimi të dukshëm në statusin dhe cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë. Strategjia përmban si objektiv realizimin e një studimi për legjislacionin e personave me aftësi të kufizuara i cili do të vlerësojë dhe propozojë ndryshime për të shmangur pabarazitë dhe diskriminimin midis grupeve të personave me aftësi të kufizuara që janë krijuar me legjislacionin ekzistues. Në këtë kuadër Zyra e Avokatit të Popullit do të ndjekë në vijimësi, këtë proces ndryshimesh ligjore që përmban vetë Strategjia e lartpërmendur, me synim shmangien e pabarazisë në trajtimin e kësaj kategorie personash.

Gjithashtu e konsiderojmë të nevojshme të theksojmë se treguesi kryesor i rezultateve për këtë ministri nuk duhet të jetë vetëm numri i reformave të marra apo akteve ligjore të përgatitura, por numri i të

punësuarve në secilin rreth. Pikërisht ritmet e rritjes së punësimit dhe jo ritmet aktuale në të cilat ndodhemi, do të sillnin ndryshime dhe ulje të nivelit të varfërisë, duke patur parasysh që me punësimin janë të lidhura dhe përfitimi ose mospërfitimi i ndihmës ekonomike ose uljet apo rritjet në kontributet e sigurimeve shoqërore.

8. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve

Gjatë vitit 2005 ka patur 21 ankesa për vete Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacioneve dhe organeve në varesi të saj, e emertuar në shtator 2005 si Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Nga këto, 2 ankesa kanë qenë të mbartura nga viti 2004 dhe kanë perfunduar gjatë vitit 2005, 9 ankesa kanë qenë të pabazuara, 7 ankesa kanë qenë jashtë kompetencës dhe juridiksionit, 1 ankesë është ende në shqyrtim, 4 ankesa janë zgjidhur në favor të ankuesit dhe krahas tyre janë paraqitur edhe 2 rekomandime.

1. e letren drejtuar Avokatit të Popullit, nga kryeredaktori i një gazete të përditshme, ishte paraqitur ankesa, lidhur me mosinformimin dhe mosdhenien e një kopje të dokumentacionit zyrtar të kërkuar prej tij nga ana e ish-Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, për sa i përket dokumentave të një procedurë, sipas së cilës, janë shpërndarë pa tender rreth 40 miliona USD.

Avokati i Popullit, kreu menjëherë nderhyrjet dhe verifikimet e nevojshme pranë zyrave përkatëse në varesi të kësaj ministrie. Në perfundim u arrit që në përgjigje të kërkesës tone, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve vuri në dispozicion të ankuesit kopje të dokumentave që ndodheshin pranë arshives së saj, të cilat lidheshin me vendimet e datës 30.07.2004 të Qeverisë, me nr.528, 516, 530, 529, 506, 505, 521, 522, 517 dhe 507. Gjithashtu drejtoria në fjale informoi se për tenderat e zhvilluar pranë saj, për të cilat ankuesi ishte i interesuar, dosjet e ofertave financiare, ndodheshin pranë komisionit hetimor parlamentar, i ngritur pranë Kuvendit. Gjithsesi pas nderhyrjes tone është mundësuar marrja e një pjese të dokumentacionit të kërkuar nga ana e ankuesit. Për pjesën tjetër u keshillua që të paraqiste kërkesë pas perfundimit të hetimit parlamentar.

2. Pranë Istitucionit të Avokatit të Popullit u dërgua një ankesë nga një grup shoferesh të autobuzëve të linjave, me objekt zbatimin e ndryshimeve të bera në Ligjin “Për Transportet Rrugore”. Në njërën nga ndryshimet ishte përcaktuar kufizimi i shërbimit për furgonet ose ndryshe autoveturat 8+1 vende. Duke qenë se kjo dispozitë përmiresonte ndjeshëm pozitën e aktivitetit të autobuzëve, ankuesit kanë kërkuar zbatimin e saj në praktikë, pasi pretendonin se Ish Ministria e

Transporteve dhe Telekomunikacioneve nuk kishte marre asnje mase administrative per kete qellim.

Lidhur me kete ceshtje, Avokati i Popullit kerkoi menjehere shpjegime prane kesaj ministrie, e cila ne pergjigjen e saj informoi se kishte filluar te merrte masat e duhura me ane te nje udhezimi te ish-Ministrit te Transporteve dhe Telekomunikacioneve, duke percaktuar dhe bashkeveprimin me organet e tjera kompetente.

3. Prane Institucionit te Avokatit te Popullit, u paraqit ankesa e nje grupi shoferesh te licensuar per transport udhetaresh taksi 8+1, te cilet ngrinin pretendimet per gjoba te padrejta te vendosura nga Policia Rrugore prane Drejtorise se Policise se Qarkut Fier. Keto gjoba sipas tyre ishin vendosur ne zbatim te nje udhezimi te padrejte te nxjerre nga ish Ministri i Transporteve dhe Telekomunikacioneve Z.Spartak Poçi, ne permbajtjen e te cilit ndalohej qarkullimi i automjeteve 8+1 jashte territorit te licensuar.

Avokati i Popullit, pasi ndoqi dhe verifikoi me interes pretendimet e ankuesve, arriti ne perfundimin se gjobat ishin vendosur nga Policia Rrugore e Drejtorise se Policise se Qarkut Fier, konform Kodit Rrugor, Rregullores per Zbatimin e Kodit Rrugor dhe Ligjit Nr.7697, dt.7.04.1993 "Per Kundravajtjet Administrative". Ne lidhje me udhezimin e Ministrit te Transporteve dhe Telekomunikacioneve, i cili sipas ankuesve ishte bere shkak per vendosjen e gjobave, pas nderhyrjes se Avokatit te Popullit dhe te nje sere sindikatash te tjera te transportit udhetar, u be e mundur qe ky akt te revokohej.

4. Prane Institucionit te Avokatit te Popullit u paraqit ankesa e nje shtetasi banues ne fshatin Çarshove te rrethit Permetit, i cili pretendonte se i ishte shkelur e drejta e pronesise, duke mos e shpronesuar per interes publik per nje veper publike te ndertuar ne token e tij. Sipas tij, megjithese kishin kaluar disa vite, vazhdimisht ishte ankuar prane ish-Ministrise Transportit dhe Telekomunikacionit, firmes ndertuese, Kryetarit te Komunes, por ende nuk kishte marre asnje pergjigje per trajtimin e tij ligjor dhe financiar.

Avokati i Popullit beri verifikimet e nevojshme prane Drejtorise se Pergjithshme te Rrugeve. Sipas pergjigjes se kesaj drejtorie, ankesa e paraqitur ka rezultuar e drejte dhe po kryheshin te gjitha proçedurat per pergatitjen e dokumentacionit per shpronesim dhe pagesen e ankuesit.

Nisur nga ky rast, krahas vleresimit te punes per evidentimin e ketij rasti te vonuar per shpronesim, Avokati i Popullit gjykoi se veprimtaria e instancave te autorizuar per proçedurat e shpronesimit ne ish-Ministrine e Transporteve dhe Telekomunikacioneve dhe Drejtorine e Pergjithshme te Rrugeve ishin bere shkak qe kerkesa legjitime e pronarit te ngelej ne harrese per nje kohe te gjate, duke i cenuar atij ne vazhdimin e drejtat themelore te parashikuara ne nenin 41 dhe 42 te Kushtetutes.

Për të gjitha arsyet e mesiperme, Avokati i Popullit duke konstatuar se ndaj ankuesit ishin shkelur te drejtat e pronesisë për shkak të mosveprimeve në kohë të organeve të administratës publike përfaqësuar nga ish-Ministria e Transporteve dhe Telekomunikacioneve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugeve, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, rekomandoi përshpejtimin e procedurave të shpronësimit në favor të tij, si një veprim që diktohej për të korrigjuar shkeljet ndaj të drejtave të tij si pronar me qëllim rehabilitimin sa më të shpejtë të tij. Gjithashtu u kërkua garantimi i një veprimtarie të rregullt ligjore administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugeve në planin verifikues, me qëllim eliminimin në të ardhmen të parregullsive, të cilat gjenerojnë shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve.

Pasi Drejtoria e Përgjithshme e Rrugeve u njoh me përmbajtjen e këtij rekomandimi, me shkresën e saj nr.3194 Prot. date 13.6.2005, na ka kthyer përgjigje pozitive dhe konkretisht ka sqaruar se mbas marrjes së përgjigjeve nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Permet, Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit Permet dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit Tirane, ka paraqitur me shpejtesi për miratim procedurat e perfunduara për shpronësim në favor të ankuesit.

5. Përveç rasteve të perfunduara dhe të permendura më lart, Avokati i Popullit gjatë vitit 2005 ka paraqitur një rekomandim përgjithësues pranë Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve, ku kërkon ndreqjen e praktikave të paligjshme që aplikohen nga strukturat në varesi të tij për procesin e shpronësimeve. Sipas këtij rekomandimi pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, ishte paraqitur ankesa e A.K banues në Lagjen “28 Nëntori” në Berat, i cili shprehte shqetësimin se nga punimet e kryera që në vitin 2003 për zgjerimin e një aksi rrugor ishte cënuar prona e tij dhe e disa bashkëpronarëve të tjerë, pronë kjo e ligjshme e vërtetuar edhe nga vërtetimet përkatëse të pronësisë të lëshuara nga Z.RR.P.P Berat.

Lidhur me këtë çështje, me VKM. Nr 878, date 22.12.2004 ishte miratuar shpronësimi dhe procedura që do të ndiqej për rastin konkret, ku ndër të tjera parashikohej që: “Shpronësimi duhet të fillojë dhe të përfundojë në muajin dhjetor 2004”. Më tej ankuesi dhe pronarët e tjerë që do prekeshin nga zgjerimi i rrugës, nuk patën kundërshtime me çmimin e përcaktuar për kompesimin e tyre, e megjithatë ata nuk kishin përfituar realisht fondet përkatëse të shpronësimit.

Institucioni i Avokatit i Popullit kreu verifikimet e nevojshme, duke ju drejtuar fillimisht Kryetarit të Bashkisë Berat, si dhe Drejtorisë së Programimit Ekonomik në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për të kërkuar shpjegimet e nevojshme lidhur me pretendimet e ankuesit.

Kryetari i Bashkise Berat, na bëri të njohur se nga ana e Bashkisë Berat ishte dërguar pranë Drejtorisë së Programimit Ekonomik nje kerkese per akordimin e fondit prej 664 mije lekë në programin e investimeve të vitit buxhetor në vazhdim.

Ndërsa nga ana e Drejtorisë së Programimit Ekonomik në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, jemi vënë në dijeni të faktit se në Programin e Investimeve Publike për vitin 2005 nuk është bërë i mundur akordimi i shumës për shpronësimin e ankuesit, pasi nga Bashkia Berat është bërë vënia në dijeni e kësaj Drejtorie vetëm me datë 10.03.2005 dhe fondet e Programit të investimeve Publike për vitin 2005 të miratuara nga Ministria e Financave ishin shpërndarë nga ish-Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit qe me datë 01.02.2005.

Më tej, zv/Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në shkresën e tij thekson se për të bërë të mundur financimin e shpronësimit, kjo duhet të parashikohet në projektprogramin e investimeve publike për vitin 2006, pra të paraqitet si kërkesë për financim nga Bashkia Berat si një detyrim ligjor i pazbatuar.

Nisur nga ky pronocim, Avokati i Popullit gjykon se këto forma burokratike ishin bërë shkak që kërkesa legjitime e ankuesit si pronar, të ngelet në harresë për një kohë të gjatë, duke i cënuar atij në vazhdimësi të drejtat themelore të parashikuara në nenin 41 dhe 42 të Kushtetutës.

Avokati i Popullit nepermjet rekomandimit te bere e ka njohur Ministrin e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve me qendrimin se nuk mund të tolerohet fakti që një pronari të ligjshëm, pra që e ka fituar atë pronë me mënyrat e fitimit të pronësisë të parashikuara në Kodin Civil dhe që e ka të rregjistruar atë pronë në rregjistrat e Z.RR.P.P.-së, duke poseduar kështu një çertifikatë pronësie që është një akt zyrtar që vërteton ligjërisht pronësinë e tij mbi atë pronë, tëi ndërhyhet arbitrarisht dhe në mënyrë abuzive nga organe që nuk kanë asnjë tagër mbi atë pronë, duke mos respektuar edhe procedurën e shpronësimit.

Duke analizuar përgjigjet e mësipërme, Avokati i Popullit gjykoi se procedurat e ndjekura për punimet në këtë segment rrugor në raport me të drejtat legjitime të pronarëve të trojeve janë kryer në kundërshtim të hapur me Ligjin Nr.8561, datë 22.12.1999 *“Për Shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”*.

Ne keto kushte Avokati i Popullit, kerkoi nga Ministri i Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve qe te ushtronte autoritetin e tij per eliminimin e praktikave të padrejta që ndiqen për pronarët që duhet të shpronësohen për interes publik, duke filluar me fazën e shpronësimit dhe pastaj me atë të zbatimit të projekteve dhe fillimin e

procedurave të kompesimit ndaj ankuesit, si një proces ligjor që do të rivendosi në vend të drejtat e tij legjitime. Kjo çështje megjithëse ende në shqyrtim ilustron edhe një herë problematiken që paraqet veprimtaria e institucionet shtetërore në varesi të Ministrisë së Punëve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacioneve, lidhur me perpilimin, evidentimin dhe miratimin e dokumentacionit paraprak të personave që do të shpronësohen për interes publik, në kuadër të punimeve publike në infrastrukturën rrugore.

Eshtë konstatuar mjaft herë se veprimet e nxituara të komisioneve të posaçme të shpronësimeve në ish-Ministrinë e Transporteve dhe Telekomunikacioneve, si dhe trajtimi i shkujdesur i dokumentacionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugeve, kanë shkaktuar mohim të së drejtës së shpronësimit për interes publik. Keto raste, vlejne të përmenden si fenomen, pasi rëndësia e respektimit të të drejtave të pronësive është e një karakteri prioritar në përbushjen e standarteve të shtetit të së drejtës.

Avokati i Popullit vazhdimisht ka nderhyre me rekomandimet përkatëse për të rivënë në vend të drejtat dhe interesat e ligjshme të individëve të dëmtuar nga një proces i parregullt administrativ në kuadrin e shpronësimit. Nderhyrja e Avokatit të Popullit në këto aspekt do të vazhdojë të insistojë në një formatizim të veprimeve dhe procedurave për verifikimin paraprak të pronës, çka do ta bente më të lehtë gjetjen e gjuhës së përbashkët me individët që kërkojnë një të drejtë kushtetuese. Krahas kësaj, bashkëpunimi me i ngushtë në të ardhmen midis Komunave, Bashkive, Komisioneve të Tokave ose Kthimit e Kompesimit të Pronave, ZRPP dhe organeve të transportit gjatë procedurave të shpronësimit për interes publik, do të ndikojë në minimizimin e mosmarrëveshjeve. Gjithashtu, e drejta e apelit administrativ ndaj vendimeve që merr Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve, duhet të garantohet individëve konformë Kodit të Procedurave Administrative, për të mos lënë shkaqe të panevojshme që bëjnë të precipitojnë mosmarrëveshjet në konflikte gjyqësore, të cilat kërkojnë një kohë relativisht të gjatë, shpenzime financiare që demtojnë pozitat ekonomike të individit dhe njëkohësisht ngadalesojnë projektet dhe investimet publike për rrugët etj.

Për këto qëllim Avokati i Popullit do të insistojë edhe në të ardhmen në eliminimin e praktikave të parregullta dhe të paligjshme administrative në fushën e transportit dhe telekomunikacionit rrugor, për të garantuar të drejtat dhe interesat e ligjshme të individëve të parashikuara në kushtetute dhe në legjislacionin në fuqi.

b) Ankesat për ndërtimet pa leje

Dy janë ligjet e miratuara nga ana e Kuvendit të Shqipërisë dhe që kanë hyrë në fuqi gjatë vitit 2004, të cilat synojnë zgjidhjen e çështjes të

ndërtimeve pa leje, Ligji Nr.9209, datë 23.03.2004 “Për legalizimin e shtesave në ndërtime”, dhe Ligji Nr.9304, datë 28.10.2004 “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”.

Objekti i rregullimit të ligjit të parë të sipërcituar, është legalizimi i ndërtimeve, tërësisht ose karabina, me sipërfaqe më të madhe se projekti i miratuar me vendim të KRRT-ve të njësive të qeverisjes vendore.

Ndërkohë objekti i rregullimit të ligjit të dytë, është legalizimi i ndërtimeve pa leje në zonat informale, të përcaktuara sipas procedurave të këtij ligji dhe urbanizimi i zonave të zëna nga ndërtimet e banesave pa leje, të emëtuara “Informale”, për integrimin e tyre në zhvillimin territorial e infrastrukturor të vendit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në to.

Kemi dhënë shpjegimet e mësipërmë për të evidentuar se problemi i ngritur në raportet tona të mëparshme vjetore, ai i mosrespektimit të projekteve të miratuara në lejet e ndërtimit, nga ana e ndërtuesve, gjen rregullim në këtë bazë ligjore të re.

Megjithatë për shkak të një sërë problemesh, sot e kësaj dite evidentohet me lehtësi fakti se, zbatimi i Ligjit “Për legalizimin e shtesave në ndërtime” ka dështuar dhe realisht, ai është kthyer në një ligj të pazbatueshëm.

Ky problem është ngritur si nga ana e Shoqatës të Ndërtuesve të Shqipërisë në dy kërkesa të ndryshme, ashtu dhe nga ana e Institucionit tone nga evidentimi nëpërmjet një shqyrtimi paraprak që i kemi bërë këtij problemi.

Nga ana e Shoqatës të Ndërtuesve të Shqipërisë, në kërkesën e parë për këto çështje, kërkohej thjeshtimi i procedurave dhe dokumentacionit përkatës, por edhe ripercaktimi i një afati të ri për mundësinë e depozimit të kërkesave për legalizim, pranë njësive përkatëse të qeverisjes vendore (pika 1, neni 6, i Ligjit “Për legalizimin e shtesave në ndërtim”), sepse afati 3 mujor ka qenë i shkurtër dhe faktikisht është bërë pengesë kryesore.

Veçantia dhe bazueshmëria e një kërkesë të dytë të paraqitur nga kjo shoqatë po për këto çështje, qëndronte në disa elemente të konceptuar në thelb shumë të detajuar dhe bindës, fakt që nxjerr të nevojshme ndryshimin e bazës ligjore që rregullon këto marrëdhënie.

Perpjekja për zgjidhjen e këtij problemi e konkretizuar me futjen në fuqi të ligjit të sipërcituar, në pamje të parë duket si një sukses dhe zgjidhje përkatëse, por ndryshimet e perfshira në ligj që nga versioni i parë i tij e deri tek ai perfundimtar, tashmë në fuqi, kanë qenë aq thelbesore, sa që duket se është harruar qëllimi kryesor i ligjit; legalizimi i shtesave në ndërtime. Analiza fillestare për hartimin e një ligji që do të zgjidhte këto probleme, ka marrë parasysh dhe ka analizuar një sërë

aktoresh, te cilet marrin pjese dhe ndikohen ne menyre direkte apo indirekte nga ky proces.

Se pari, qytetaret (bleresit e apartamenteve), ne kushtet kur situata mbetet e pazgjidhur, rezulton qe te kene paguar per nje prone e cila nuk mund te ligjerohet ne emer te tyre. Pasoja e pritshme eshte pamundesia per te kryer nje transaksion ligjor me kete prone, si shitje, dhurim, dhenie me qera, apo edhe mosperdorim i saj si garanci hipotekore ne rast te kerkimit te nje kredie bankare.

Se dyti, pushteti vendor, ne kushtet kur problemi mbetet i pazgjidhur, nuk mund te pergatise lejet e shfrytezimit per ndertimet me siperfaqe shtese. Pavaresisht detyres se administrimit te territorit qe mbulon, pushteti vendor ne keto kushte nuk ka mundesine e administrimit efikas te territorit apo infrastruktures perkatese. Ne aspektin ekonomik ky pushtet rezulton me humbje, pasi ai ka ne administrim nje numer te madh objektesh qe ofrojne vetem vleren e tyre te perdorimit dhe jo vleren e tyre te investimit. Ne materialin i cili lidhet me aktivitetin e Bashkise Tirane dhe demin qe i sillet buxhetit te vete bashkise si dhe atij te shtetit, persa i perket moskryerjes se funksionit per identifikimin e siperfaqeve te teperta te ndertimit bere nga ndertuesit, si dhe nga mosdhenie e lejeve te shfrytezimit per qindra pallate te ndertuara, rezulton nje shifer prej qindra milion USD. Kjo gjendje eshte vetem per Bashkine Tirane, nderkohe qe nuk dihet se sa shkon ajo po te analizohen edhe gjithe bashkite e tjera ne rang Republike.

Se treti, per Buxhetin e shtetit, moslegalizimi i shtesave ne ndertime sjell mosarketim te te ardhurave ne formen e;

- tarifave te regjistrimit te pasurive te reja te ndertuara tek zyra e regjistrimit te pasurive te paluajtshme,
- taksave te zhvillimit te infrastruktures per siperfaqet shtese te ndertuara,
- detyrimeve financiare tatimore per siperfaqet shtese,
- gjobave qe ndertuesit duhet te paguajne ne rastin e legalizimit.

Se katerti, vete ndertuesit, vuajne moralisht dhe financiarisht moszgjidhjen e ketij problemi. Duke qene te ndergjegjeshem per shkeljen ligjore te bere ne keto raste, ata jane te gatshem qe ne kuader te zgjidhjes te paguajne gjobat perkatese. Kontradikta me te cilen perballen ndertuesit qendron ne faktin se qytetaret (bleresit), kerkojne regjistrimin e prones te porositur dhe paguar ne çmim, sikurse edhe vete ndertuesit nganjehere te cilet kane mbajtur siperfaqe ndertimi per vete, gjenden ne te njejten situatë sikurse edhe bleresit e tjere.

Se pesti, bankat dhe sistemi financiar i kreditimit ne pergjithesi, ne keto kushte nuk kane mundesine e zgjerimit te rrjetit te kredimarresve edhe me qytetaret (bleresit e ketyre ndertimeve), apo me ndertuesit perkates.

Se gjashti, edhe vete shoqeria jone ne pergjithesi ne menyre direkte apo inditrekte ndikohet nga moszgjidhja e problemit te legalizimit te shtesave ne ndertime. Ky fenomen realisht do te vazhdoje te demtoje ekonomine ne teresi, pasi nuk eshte e mundur te perdoret ne funksion te zhvillimit vlera e investimit te pasurive te paluajtshme te paregjistruara. Eshte e rendesishme te kuptohet perdorimi i vleres se investimit ne ndertimet urbane. Po keshtu moszgjidhja e kesaj çeshtje rrezikon te krijojte precedentin e vazhdimit pa fund te fenomenit te ndertimeve te siperfaqeve shtese tej lejes se miratuar, si dhe te krijimit te nje klime konfliktuale ndermjet ndertuesve e blesesve, ndertuesve dhe pushtetit vendor, blesesve dhe bankave situata qe nuk eshte ne interes te askujt.

Zgjidhja e problemit pra, nuk duhet pare thjesht si perfitim i njeanshem i nje grupimi te caktuar, por si perfitim kompleks i te gjithe aktoreve te sipercituar.

Nga trajtimi i kesaj çeshtje, ka rezultuar se gjendja faktike e ecurise se ketij procesi legalizimi ne njesite e qeverisjes vendore me te medha te vendit, eshte zhgenjyese. Numri i subjekteve te perfshira ne procesin e legalizimit eshte shume me i vogel, sesa numri i subjekteve te cilat jane objekt trajtimi nga rregullimet ligjore te parashikuara ne Ligjin “Per legalizimin e shtesave ne ndertime”, apo me sakte i atyre subjekteve te cilat kane realizuar shtesa ne ndertime tej lejes se ndertimit.

Pra, faktikisht ligji qe doli per te zgjidhur kete problem te madh per komunitetin dhe territorin, mbeti qe te zbatohet vetem per nje numer shume te vogel subjektesh, kur ai realisht i adresohet nje numri shume me te madh subjektesh.

Analiza qe mund t’i behet ketij procesi legalizimi nuk mund te ngelet thjesht ne elemente teknike proceduriale te ligjit ne fuqi, pasi nje analize e hollesishme e permbajtjes se ligjit “Per legalizimin e shtesave ne ndertime”, evidenton qarte dyshueshmerine e mundesise se zbatimit te tij. Ky fakt del nga vete permbajtja e ketij ligji, ku per subjektet ndertuese kerkohet permbushja e disa kerkesave te nevojshme per legalizim. Me ne detaje:

1. Sipas ligjit, subjektet ndertuese; *“Duhet te kene depozituar ne njesine vendore perkatese, brenda dates se hyrjes ne fuqi te ketij ligji, proces-verbalin e perfundimit te karabinase”*. Objekti i ketij ligji jane ndertimet me shtesa tej lejeve te ndertimit, dmth objekte qe jane me shkelje krahasuar me lejen e ndertimit. Eshte me se e kuptueshme qe shume subjekte nuk do ta kene fare kete proces-verbal, (a) per arsye se vete subjektet meqe kane ndertuar objekte me shtesa/shkelje, asnjehere nuk kane kerkuar pajisjen me proces-verbalin e perfundimit te karabinase; (b) per arsye se njesia pergjegjese e qeverisjes vendore nuk e ka leshuar kete proces-verbal, pasi objekti ka rezultuar me shtesa/shkelje.

2. *“Objekti te jete ne perputhje me planet rregulluese te miratuara”*.

Theksojme se flitet per objekte qe jane me shkelje krahasuar me lejen e ndertimit, çka do te thote se kerkesa e ligjit qe edhe objektet me shkelje te jene ne perputhje me planet rregulluese te miratuara te duket si nonsens ne arsyetim.

3. *“Te kene zbatuar funksionet e mjediseve nen toke te objektit ne perputhje me lejen e ndertimit”*. Nderkohe qe ligji vete percakton qe per keto hapesira te konvertuara, subjektet ndertues te paguajne gjoben perkatese, ne kete nen kerkohet qe subjekti “te kete zbatuar” funksionet e mjediseve nen toke. Eshte nje fakt tashme qe, ka shume subjekte qe kane konvertuar hapesirat e ndertuara nen toke nga parkim ne njesi tregtare, njesi keto te cilat u jane shitur bleresve te ndryshem. Ne keto kushte eshte pothuajse e pamundur qe keto mjedise nen toke te zbatohen ne perputhje me lejen e ndertimit, pa shkaktuar probleme shoqerore dhe ekonomike.

4. *“Te mos pengoje realizimin e studimeve te miratuara, te çdo niveli, dhe te mos perbeje rrezik per njerezit dhe mjedisin”*. Kjo kerkese mund te ndahet ne tre pjese, pjesa e pare “te mos pengoje realizimin e studimeve te çdo niveli...”, mbetet i njejti arsyetim si tek pika (2). Pjesa e dyte dhe te mos perbeje rrezik per njerezit...”, gjykojme se ezaurohet nga kerkesa e forte e garancise nga projektuesi i konstruksionit te nderteses mbi qendrueshmerine konstruktive te saj. Pjesa e trete “dhe te mos perbeje rrezik per mjedisin”, krijon hapesira aq te medha interpretative saqe kushdo ne menyre subjektive apo spekulative, mund te pohoje se ndertimi aktual perben rrezik per mjedisin.

5. *“Per siperfaqet tej lejes se miratuar, qe kane cenuar drejtpersedrejti ose terthorazi pronesine private kufitare, te paraqese dokumentacionin e zgjidhjes se konflikteve per pronesine dhe distancat urbane”*. Kjo hapesire ligjore do te krijonte nje situatë qe askush nga ata qe kane cenuar drejtperdrejt ose terthorazi pronesine kufitare, te mund te permbushnin kete kerkese. Pra nga njera ane ligji synon legalizimin dhe nga ana tjeter eshte propozuar nje mekanizem qe nuk mund te ndihmoje legalizimin, perkundrazi e ben ate te pamundur.

Shoqata e Ndertuesve te Shqiperise, garanton nga ana e ndertuesve dy elemente te rendesishem te procesit te legalizimit, qe jane:

- sigurimi i qendrueshmerise konstruktive te ndertimit, i garantuar nga projektuesi i konstruksionit.

- pagesa e gjobave per shkelje te ligjit, siç do te percaktohet ne kete ndryshim legjislacioni te kerkuar.

Ne kete kuader te permiresimit te legjislacioni, kemi gjykuar se i duhet dhene e drejta e legalizimit edhe Njesive Bashkiake te Tiranes, per te shpejtuar procedurat dhe rritur autonome e tyre. Nga ana tjeter ne rastet kur njesite vendore hezitojne dhe zvarritin procedurat, fenomene tashme te perditshme, duhet te zbatohet neni 76 i Kodit te Proçedurave Administrative per pranimin e heshtur te petitionit (kerkeses) per

legalizime ne menyre automatike, kur njesia vendore shkel afatin. Po keshtu, duhet te parashikohen rastet kur subjektet nuk plotesojne dokumentacionet edhe brenda afatit qe do te caktoje ligji i ri, prandaj duhet parashikuar edhe qe t'i drejtohen gjykates me kerkese padi per legalizimin e ndertimit. Hartimi i nje ligji te ri ne kete fryme dhe parashikimi i procedurave te thjeshta administrative per legalizimin ne kete ligj, jane zgjidhjet e mundshme per kete çeshtje. Ne frymen e kesaj kerkese, eshte konceptuar nxjerrja e nje ligji te ri, i cili do te shfuqizojë Ligjin Nr.9209, date 23.03.2004 “Per legalizimin e shtesave ne ndertim”.

Sa me siper, nga ana jone i eshte drejtuar nje rekomandim per realizimin e insiatives legjislative per kete qellim, Ministrit te Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministrit te Financave dhe Ministrit te Drejtesise, duke propozuar edhe nje draft te ligjit. Ky rekomandim eshte pranuar dhe aktualisht ministrite perkatese kane pergatitur draftin e ligjit te ri, eshte miratuar ne Keshillin e Ministrave dhe eshte derguar per votim ne Kuvend.

Në llogjikën e parashikimeve te reja ligjore te bera me hyrjen ne fuqi te Ligjit “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”, evidentojme se eshte ndjekur rruga e duhur ligjore per ekzekutimin e vendimeve të mëparshme të marra nga ana e Policisë të Ndërtimit, për prishjen e ndërtimeve pa leje. Ne rastet e ketyre ndertimeve per te cilat paraprakisht eshte plotesuar formulari i legalizimit, vendimet e organit të Policisë të Ndërtimit jane pezulluar në ekzekutim, deri ne marrjen e një vendimi përfundimtar nga ana e organit të ngarkuar me ligj për shqyrtimin e mundësisë së legalizimit.

Gjatë vitit 2005, për këtë problematikë që lidhet me veprimtarinë në tërësi të organit të Policisë të Ndërtimit, rezulton të jenë marrë në shqyrtim 101 ankesa, nga te cilat rezultojne 70 ankesa te reja dhe 31 ankesa te mbartura. Në specifikë të ankesave të paraqitura në institucionin tonë, me objekt ndërtimet pa leje, rezulton të jenë marrë në shqyrtim 103 ankesa, nga të cilat 101 lidhen me veprimtarinë e organit të Policisë të Ndërtimit, 2 me veprimtarinë e strukturave përkatesë të Bashkive apo të KRRT-ve pranë tyre.

Nga ankesat të cilat lidhen me problematikën e ndërtimeve pa leje, deri në fund të vitit 2005, rezultojnë të përfunduara 86 ankesa dhe akoma në shqyrtim janë 17 ankesa.

Përsa i përket çështjeve të përfunduara, ka rezultuar se janë zgjidhur në favor 22 çështje, jashtë juridiksionit dhe kompetencës 46 çështje, ndërsa për 18 prej tyre jemi ne kushtet e pabazueshmerise se ankeses ose braktisjes së procedimit administrativ të filluar nga ana jonë për shqyrtimin e tyre nga vetë ankuesit, pra jemi në kushtet e heqjes dore të ankuesve nga ndjekja e mëtejshme e çështjeve prej nesh.

Mbartja e problemeve që kanë të bëjnë me ndërtimet pa leje nga ana e organit të Policisë të Ndërtimit, vit pas viti, ka sjelle pasojen që ngarkesa e punës të mos jetë racionale, por të krijojë probleme të funksionimit të këtij organi që shpesh mund të vlerësohen si jo të mirëqena dhe fiktive.

Problematika e shfaqur në vitin 2005 për problemet e ndërtimeve pa leje dhe në veçanti për punën e organit të Policisë të Ndërtimit, konstaton disa çështje që për nga ana teknike evidenton se:

- Rekomandimet e drejtuara nga ana jonë, në të shumtat e rasteve pranohen në heshtje, duke ndërmarrë veprime të ngadalta dhe jo konkludente dhe për më tepër duke mos përmbushur detyrimin ligjor të dhënies së prononcimit zyrtar, sikurse parashikohet në nenin 22, të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, nderkohe që në një shumicë të tyre mbeten pa përgjigje. Ndaj kërkesave tona për marrje masash administrative ndaj punonjësve, të cilët janë bërë shkak për zvarritje dhe moszgjidhje të çështjeve në kohë, organi i Policisë të Ndërtimit në më të shumten e rasteve ka qenë pasiv, me perjashtim të disa rasteve të pakta.

- Ka një mungesë të theksuar dhe neglizhencë krejtësisht të pajustificuar të këtij organi, në dhenien e përgjigjeve apo informacioneve, pas kërkesave të dërguara për këto qëllime nga ana e institucionit tone. Kjo gjë shpeshherë është shoqëruar paraprakisht nga një mungesë transparence prej këtij organi ndaj personave të interesuar, apo edhe publikut në përgjithësi për veprimtarinë e tij. Mungesa e informacionit të kërkuar, jo vetëm është bërë shkak për kohezgjatjen e shqyrtimit të çështjeve nga ana jonë, por shpeshherë realisht n’a ka vënë në pozite shumë të veshtire me vete ankuesit, të cilët i janë drejtuar institucionit tone për një zgjidhje të mundshme. Problematikë shfaqen Degët e Policisë të Ndërtimit, në Tiranë, Durrës, Vlorë, por edhe vetë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë të Ndërtimit. Ndodh që në disa raste, edhe pse jepet informacion në lidhje me çështje të caktuara, ky informacion është i paqarte ose i paplote, fakt i cili n’a detyron t’i ridrejtohem për kështu kështu këtij organi për shpjegime të metejshme. Shpeshherë, sidomos për ndërtimet të cilat gjatë zbatimit të tyre shfaqen me shkelje në zbatim të projektit të miratuar nga ana e Bashkive apo Policisë të Ndërtimit, dhenia e shpjegimeve jashtë afateve të përcaktuara ligjore perkon edhe me hapjen e proceseve gjyqësore në lidhje me këto çështje, gjë që na detyron të nderpresim shqyrtimin e metejshëm të rasteve.

- Vihet re një mosveprim i vazhduar i këtij organi jo vetëm për konstatimin dhe sanksionimin e ndërtimeve të kundraligjshme, por edhe për ekzekutimin e vendimeve të cilat janë marrë ndaj kundravajtësve të ndryshëm, si për sanksionim me gjobe, ashtu edhe për prishje ndërtimesh të kundraligjshme. Pavarësisht aktivitetit mjaft të ngjeshur të këtij organi, nuk mund të justifikohet mosveprimi në raste të veçanta, nderkohe që ka

patur edhe ndonjë rast që mosveprimi ka qenë i qëllimshëm dhe në këtë drejtim. Ne disa raste edhe pse nga ana e Policisë të Ndërtimit, janë pranuar rekomandime të drejtuara nga ana e jone për ekzekutim sa më të shpejtë të vendimeve që janë marre prej saj dhe janë përcaktuar nga ajo vetë afate për ekzekutim të pritshëm, perseri nuk është vepruar, duke bërë që çështjet të mbeten perseri pa zgjidhje.

- Nuk kanë munguar rastet, kur veprimi ka qenë i pjesshëm dhe jo në përputhje me vendimet administrative përkatëse, apo ka qenë i kundraligjshëm nga ana e Policisë të Ndërtimit. Si një fenomen që është konstatuar, është fakti se Policia e Ndërtimit ka patur raste që ka vepruar duke shkatërruar ndërtime, edhe pse ato kanë qenë të legjitimuara me vendime perfundimtare të formës së prerë nga gjykata, apo kur aktet e nxjerra për prishje prej këtij organi kanë qenë pezulluar me vendime gjyqësore të formës së prerë përkatëse, apo shfuqizuar me vendime të tilla. Një rast i tillë është evidentuar në ankesën e shtetasit B.D, kur është vepruar mbi bazën e një vendimi të Policisë të Ndërtimit, dega Tirana Qytet, i cili ishte shfuqizuar me anë të një vendimi të formës të Gjykatës të Shkalles së Parë Tirane. Si i tillë, ky akt administrativ nuk mund të ekzekutohej, pasi nuk kishte më fuqi juridike. Një rast tjetër lidhet me ankesën e shtetasit F.Y, ku nga ana e jone është konstatuar se veprimi i organit të Policisë të Ndërtimit, dega Tirana Qytet, ka të bëjë me ekzekutimin e një akti administrativ, efekti i të cilit ishte pezulluar. Kjo gjë parashikohet shprehimisht në germenin e te pikes 1 të nenit 131 të Kodit të Procedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht se:

“Aktet që nuk mund të ekzekutohen janë:

- ato akte efekti i të cilave është pezulluar”.

Në kuptim të këtij neni, pezullimi është ndërprerje e ligjshme e fuqisë të aktit administrativ, i cili në rastin konkret është realizuar nëpërmjet vendimit përkatës të Gjykatës së Shkalles të Parë, Tirane. Ky vendim, është cilesuar si titull ekzekutiv me anë të një vendimi tjetër të po kësaj gjykate, ndaj edhe gjykata ka leshuar urdherin e ekzekutimit për të. Në këto kushte, Zyra Permbartimore Tirane ka ndërmarrë veprimet proceduriale përkatëse, fakt që nuk përlligj veprimet e Policisë të Ndërtimit në këto raste.

Megjithatë këto raste janë të pakta, kjo tregon se ligjshmeria në veprimtarinë e këtij organi nuk duhet parë vetëm në aspektin e kërkesës për veprim, por edhe në sensin e veprimit në përputhje me ligjin dhe në proporcion me shkëlqjen e bërë nga ana e kundravajtësve.

- Shpeshherë në trajtimin e shumë ankesave vërehet një “lojë” shkresash zyrtare ndërmjet KRRT-ve me Bashkitë apo me degët e Policive të Ndërtimit në lidhje me vendimmarrjen përkatëse për ndërtime të ndryshme të evidentuara si të kundraligjshme. Ky konkluzion bëhet më i prekshëm sidomos në rastet kur midis vetë Drejtorisë të Policisë të

Ndertimit dhe degeve te saj, nuk ka koordinim dhe korrektesi ne afatet dhe detyrat qe lihen ne kuader te hierarkise administrative rast pas rasti. Nje rast i tille eshte konstatuar ne trajtimin e ankeses se shtetasit Sh.Rr nga Shkodra, ku dega e Policise te Ndertimit, Shkoder megjithe nderhyrjen e Drejtorise te Policise te Ndertimit me shkresen perkatese, nuk ka respektuar afatet e vendosura prej kesaj te fundit, per dhenien e informacionit te kerkuar prej nesh.

- Vendimet per pezullim punimesh, si mase parandalimi, ne formen qe nxirren nuk zbatohen dhe nuk imponohen nga ana e organit te Policise te Ndertimit, per subjektin ndaj te cilit nxirren. Eshte fakt se ne shume ankesa per ndertime te kundraligjshme, Policia e Ndertimit, ne zbatim te kompetencave ben pezullimin e punimeve ne objekt, deri ne sqarimin e ceshtjes. Por ndodh rendom qe, edhe pse eshte marrë vendim per pezullim punimesh, firmat e ndertimit apo individe te ndryshem vazhdojne punen, duke e perfunduar ndertimin, derisa ne momentin final te vendimmarrjes ai eshte bere fakt i kryer. Keto veprime thellojne akoma me shume situaten e paligjshmerise.

- Nje tjetër problem i cili është evidentuar gjatë kësaj kohe, sidomos gjatë ekzekutimit të vendimeve për prishje nga ana e organit të Policisë të Ndertimit, për ndertimet pa leje, është ai i moszbatimit të nenit 84, të Ligjit “Për urbanistikën”, që parashikon se:

“Gjobat, shpërblimet dhe shpenzimet e prishjes, të përcaktuara në këtë ligj, paguhen nga kundërvajtësit brenda 5 ditëve, nga data e njoftimit të vendimit të organit të Policisë të Ndertimit, ose nga dita kur vendimi i gjykatës merr formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati paguhet kamatë 2 për qind në ditë deri në një muaj. Pas kalimit të këtij afati (një muaj), organet e Policisë së Ndertimit kërkojnë ekzekutimin e tij në rrugë gjyqësore, sipas ligjeve në fuqi. Gjobat, shpërblimet dhe shpenzimet paguhen në zyren e financës së organit të pushtetit lokal”. E evidentojme këtë fakt, pasi prishja e një ndertimi pa leje është në favor të një komuniteti të caktuar njerezish, por shpenzimet e këtij veprimi, nëse nuk paguhen nga kundërvajtësi, rëndojnë në xhepat e këtij komuniteti. Me sa kemi konstatuar, në asnjë rast shpenzimet për prishje dhe pastrim të territorit nuk i janë ngarkuar kundërvajtësit që ka ndërtuar pa leje. Zbatimi ne praktike i ketij neni do te ndikonte akoma me shume ne edukimin e shtetasve me frymen e respektimit te ligjit.

- Mosushtrimi i kompetences qe neni 6 i Ligjit “Per Policine e Ndertimit” i jep organit te Policise te Ndertimit ne lidhje me pezullimin dhe njoftimin e KRRTRSH-se per vendimet e marra nga Keshilli i Rregullimit te Territorit, kur veren shkelje te ligjit ne vendimet e tyre. Keshtu, gjate praktikes tone te deritanishme jane evidentuar raste, kur per vendime te ndryshme te KRRT-ve, per shkelje te ndryshme ligjore te konstatuara, organi i Policise te Ndertimit, mund te vepronte duke

pezulluar zbatimin e tyre dhe t'ia percillte per shqyrtim KRRTRSH-se, veprim i cili rralle ka ndodhur, duke evidentuar nje qendrim pasiv te ketij organi per ushtrimin e kompetencave te veta, te cilat ne kete rast nuk duhen kuptuar si fakultative por si detyrim ligjor. Po keshtu jane evidentuar edhe raste kur edhe pse mund dhe duhej te ushtrohej kjo kompetence, organi i Policise te Ndertimit, ka preferuar te nxjerre ne tejkalim te kompetencave te tij vendime per prishje, pa ja kaluar çeshtjen per kompetence trajtimi KRRTRSH-se.

Persa i perket aspektit te kuadrit ligjor, konstatojme se:

- Per shkak te nderthurjes se kompetencave apo percaktimeve jo te qarta qe behen ne ligje te ndryshme dhe qe lidhen me kompetencat dhe juridiksionin e Policise te Ndertimit, del e nevojshme pergatitja sa me pare e nje ligji te ri per urbanistiken. Efektivisht, ne disa raste qe jane shqyrtuar nga ana jone jane konstatuar vakume ligjore te cilat nuk i japin mundesi veprimi dhe vendimmarrje, as Policise te Ndertimit dhe as KRRT-ve, ne reference te nenit 77 te Ligjit "Per urbanistiken". Akoma me emergjente e ben kete situatë hyrja ne fuqi e dy ligjeve te reja, perkatesisht, ligji nr.9209, datë 23.03.2004 "Për legalizimin e shtesave në ndërtime" dhe ligji nr.9304, datë 28.10.2004 "Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale".

- Mbetet ende i paqarte ligjerisht, pozicioni detyrues i organit te Policise te Ndertimit, ne rastet kur konstatohet demtim i prones se personave te trete nga ana e firmave te ndertimit, gjate zbatimit te lejeve te ndertimit, per shkak te moszbatimit korrekt te projektit te miratuar, ne reference te ligjit nr.8402, date 10.09.1998 "Per kontrollin e disiplinimit e punimeve te ndertimit".

Pa mohuar punen pozitive qe eshte kryer ne shume zona ndaj ndertimeve pa leje nga ana e Policise te Ndertimit, te gjitha keto konstatime tregojne problematiken ne teresi te ketij organi, problematike e cila nxjerr nevojën e permiresimit te punes, per nje mirefunksionim dhe sherbim korrekt ligjor ndaj qytetareve.

Një nga veçantitë e problematikës së shqyrtuar ne kete fushe është se, për disa çështje të ndjekura në vitin 2004, të cilat kishin përfunduar si jashtë kompetences tone, me veprimin e metëjshem të pritshëm të organit të Policisë të Ndertimit kanë përfunduar pozitivisht. Të tilla janë p.sh ankesa e P.B ndaj mosveprimit të Policisë të Ndertimit, dega Korçe. Po keshtu per çeshtje te caktuara te cilat jane shqyrtuar dhe perfunduar ne vitin 2004, vazhdimi i ndermjetesimit tone per zgjidhjen e çeshtjes ka çuar deri ne pergatitjen e rekomandimeve perkatese gjate vitit 2005 per keto çeshtje, sikurse ankesa e shtetasit Th.Dh ndaj mosveprimit te Policise te Ndertimit, dega Vlore, apo ankesa e shtetasit A.LI ndaj mosveprimit te Policise te Ndertimit, dega Korçe.

Për nga numri i çështjeve të marra në shqyrtim vazhdojnë të ngelen problematike, Degët e Policisë të Ndërtimit, Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan, por edhe vetë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë të Ndërtimit.

Duhet theksuar se edhe këtë vit, një rëndësi e veçantë i është kushtuar ndërmjetësimit direkt për zgjidhjen e çështjeve që i adresohen këtij grupimi, pa pasur nevojë për rekomandim apo propozim me shkrim nga ana jonë. Nje nga nismat e qeverise e cila duhet pershendetur, eshte ajo per marrjen e vendimit per lirimin e oborreve te shkollave, universiteteve dhe ambienteve te tjera te objekteve publike, nga ndertimet e paligjshme te ngritura ne to. Kjo nisme ka gjetur pa dyshim edhe veprimin e menjehershem te organit te Policise te Ndertimit, i cili aktualisht po vazhdon procesin e konstatimit apo te ekzekutimit te vendimeve te prishjes te ketyre objekteve te kundraligjshme.

Në konkretizim të problematikave të mësipërme, po paraqesim disa nga rastet e shqyrtuara nga ana e zyrës sonë:

1. Ankesa e shtetasit N.R nga qyteti i Himares.

Ne letren drejtuar Avokatit te Popullit, ankuesi ka paraqitur nje ankese ne lidhje me mosveprimin e organit te Policise te Ndertimit, dega Vlore, si dhe Policise Bashkiake Himare, persa i perket disa ndertimeve te kundraligjshme te ngritura nga shtetasi A.Th.

Per keto ndertime te kundraligjshme ankuesi ishte ankuar ne nje sere institucionesh dhe organesh dhe megjithese i thuhej se kishte te drejte, perseri nuk veprohej nga ana e organeve perkatese.

Me marrjen ne shqyrtim te kesaj ceshtje nga ana jone i jemi drejtuar me kerkesë për shpjegime, nëpërmjet një procesi ndërmjetësimi aktiv, Bashkise Himare dhe Policisë të Ndërtimit, dega Tiranë. Kështu në përgjigjen e kthyer nga ana e Bashkise Himare, konfirmohej fakti se nepermjet Policise Bashkiake ishin ndjekur gjithe procedurat e nevojshme ndaj ndertimeve te kundraligjshme te shtetasit A.Th, perfshire ketu edhe vendosjen e nje gjobe ne masen 5000 leke. Nderkohe qe per shkak te mosrespektimit te akteve te nxjerra nga ana e ketij institucioni, ky i fundit sqaronte se me shkresen nr.1059, date 14.12.2004, kishte kerkuar nderhyrjen e Policise te Ndertimit.

Nderkohe ne pergjigjen e dhene nga ana e Policise te Ndertimit, dega Vlore, sqarohej se pas verifikimit te kesaj ankese ishin zbatuar procedurat ligjore ndaj ndertimeve te kundraligjshme per kete rast, nga ku ishte nxjerre vendimi per prishje nr.60, date 26.05.2005. Ky vendim sikurse konfirmohej edhe ne pergjigje eshte ekzekutuar ne muajin Korrik 2005, duke dhene nje zgjidhje ne favor te ankuesit.

2. nkesa e shtetases E.M. nga qyteti i Elbasanit.

Ne letren drejtuar Avokatit te Popullit, ankuesja ka paraqitur nje ankese ne lidhje me mosveprimin e organit te Policise te Ndertimit, dega

Elbasan, persa i perket nje ndertimi te kundraligjshem te ngritur nga ana e shtetasit B.S.

Ankuesja ishte ankuar ne Policine e Ndertimit, dega Elbasan, qe ne momentin e fillimit te punimeve te kundraligjshme ne truallin qe ajo posedonte para shtepise se saj. Por edhe pse ishte bere konstatimi i kundravajtjes ne kete rast me ane te proces-verbalit nr.47, date 9.06.2005, perseri nuk kishte veprim nga ana e ketij organi.

Me marrjen ne shqyrtim te kesaj çeshtje nga ana jone i jemi drejtuar me kërkesë për shpjegime, nëpërmjet një procesi ndërmjetësimi aktiv, Policisë të Ndërtimit, dega Elbasan. Ne shpjegimet e dhena nga ky organ, konfirmohej fakti se pasi ishte marre dijoni mbi kete ankese, ishin kryer verifikime ne vend dhe shkelja e konstatuar ishte sanksionuar me vendimin perkates, per prishje te ndertimit te kundraligjshem.

Ky vendim sikurse konfirmohej edhe ne pergjigje eshte ekzekutuar ne muajin Dhejtor 2005, duke dhene nje zgjidhje ne favor te ankuesit.

3. Ankesa e Shoqates te Ndertuesve te Shqiperise.

Ankuesi ka ngritur shqetesimin ne kete çeshtje, lidhur me nje vendim te marre nga ana e organit te Policise te Ndertimit, per prishjen e nje ndertimi te ngritur ne afersi te godines te Fakultetit te Mjekësisë, nga ana e nje firme ndertimi.

Sipas ankeses vendimi per prishjen e nje objekti, i cili eshte ngritur me nje leje ndertimi dhene prej KRRR-se ne Bashkine Tirane, ne nje shesh ndertimi prone private dhe plotesisht ne perputhje me destinacionin e Planit Rregullues te Tiranes, qe eshte ne fuqi, nga ana e Policise te Ndertimit, dega Tirana Qytet, ishte i kundraligjshem.

Per kete arsye nga ana e ankuesit kerkohej qe te respektohej fillimisht vendimmarrja perkatese nga ana e Keshillit te Rregullimit te Territorit te Republikes, per te perligjur me pas nje veprim te mundshem te organeve qe ngarkohen me ligj per ekzekutimin e vendimeve te KRRRTRSH-se. Sqarojme se veç ndertimit i cili kishte leje ndertimi, firma ndertuese ne baze te nje marreveshje me dekanatin e Fakultetit te Mjekësisë, kishte ngritur edhe nje pjese ndertimi pa leje, ndertim i cili nuk ka perbere objekt shqyrtimi nga ana jone ne kete çeshtje, pasi per te kishte kompetence direkte vendim-marrje organi i Policise te Ndertimit.

Me marrjen ne shqyrtim te kesaj çeshtje jane kerkuar shpjegime nga ana e deges te Policise te Ndertimit, Tirane, si dhe nga titullare te Drejtorise te Policise te Ndertimit.

Ne njoftimin perkates qe Policia e Ndertimit, dega Tirana Qytet i bente firmes se ndertimit ne kete rast, behej me dije se ne baze te Proces Verbalit te Konstatimit te Kundravajtjes nr.16, date 28.10.2005 dhe vendimit nr.178, date 28.10.2005, objekti i ngritur ne afersi te godines te Fakultetit te Mjekësisë, do te prishej nga Dega e Policise te Ndertimit

Tirana-Qytet, ne zbatim te nenit 3/3 te Ligjit nr.8408 date 25.09.1998 “Per Policine e Ndertimit”.

Po ne kete njoftim, firma e ndertimit ne fjale urdherohej te prishte vullnetarisht vete objektin, brenda dates 6.11.2005, ne te kundert ky objekt i “kundraligjshem” sipas njoftimit, do te prishej ne daten 7.11.2005 nga Policia e Ndertimit, dega Tirana-Qytet.

Ne perputhje me parashikimet e nenit 82 te Ligjit nr.8405, date 17.09.1998 “Per urbanistiken”, firma e ndertimit ka ndjekur rrugen e ankimit administrativ ndaj vendimit te sipercituar te deges se Tiranes, ankim ne baze te te cilit eshte marre vendimi nr.301, date 7.11.2005 i Drejtorise te Policise te Ndertimit, i cili linte ne fuqi vendimi per prishje nr.178, date 29.10.2005 i Deges te Policise te Ndertimit, Tirana-Qytet.

Duke shqyrtuar me hollesi legjislacionin perkates, ligji “Per urbanistiken” ne paragrafin e pare te nenit 45, percakton shprehimisht se: *“Çdo person fizik e juridik, vendas ose i huaj qe do te ndertoje ne territorin e Republikes se Shqiperise duhet te pajiset me leje ndertimi. Ky eshte dokumentacioni i vetem ligjor mbi bazen e te cilit lejohet ndertimi. Leja e ndertimit i jepet personit juridik ndertues te licencuar”*.

Ne paragrafin e pare te nenit 76 te po ketij ligji, thuhet shprehimisht se:

“Ndertimet e bera pa leje ndertimi jane te kundraligjshme. Ndalohet hipotekimi dhe regjistrimi i tyre ne regjistrat e pasurive te paluajtshme”.

Ne kete rast, per objektin te ngritur karabina prej firmes perkatese te ndertimit, nga ana e kesaj te fundit disponoheshin vendimi per dhenie shesh ndertimi nr.68 date 28.02.2005, si dhe vendimi per dhenie leje ndertimi nr.91 date 18.03.2005 te KRRT-se ne Bashkine Tirane. Vendimi per leje ndertimi kishte marre miratimin per ligjshmerine e tij nga ana e institucionit te Prefektit te Qarkut Tirane, si dhe kishte marre miratimin per fillimin e punimeve nga ana e organit te Policise te Ndertimit.

Ne keto kushte, nuk mundej qe ky objekt te cilesohej apriori nga ana e Policise te Ndertimit si i kundraligjshem. Per pasoje marrja e vendimit nr.178 date 28.10.2005 prej Deges te Policise te Ndertimit, Tirana-Qytet dhe lenia e tij ne fuqi nga ana e Drejtorise te Policise te Ndertimit, bazuar ne nenin 3/3 te Ligjit “Per Policine e Ndertimit”, eshte krejtesisht e gabuar dhe jo ne perputhje me ligjin.

Ky konkluzion behet edhe me i qarte, nese i referohemi permbajtjes se nenit 3/3 te Ligjit “Per Policine e Ndertimit”, ku thuhet shprehimisht se:

“Policia e Ndertimit ka keto kompetenca:

-Te pezulloje e te marre vendim per prishjen e ndertimit te kundraligjshem”.

Ne arsyetimin e dhene ne vendimin nr.301 date 7.11.2005 te Drejtorise te Policise te Ndertimit, citohej se leja e ndertimit dhene me vendimin nr.91 date 18.03.2005, eshte miratuar ne kundershtrim me nenin 62 te Ligjit "Per urbanistiken". Per me teper, ne kete vendim theksohej se kjo leje eshte miratuar ne kundershtrim me VKM nr.45 date 7.02.1990 "Per miratimin e planit rregullues te Qytetit te Tiranes", pasi zona ne fjale ishte percaktuar ne kete plan rregullues si zone universitare.

Fakti eshte se edhe ne vete gjuhen e perdorur ne vendimin e Drejtorise te Policise te Ndertimit, nuk konstatohej kompetenca direkte e organit te Policise te Ndertimit per vendimmarrje perfundimtare ne kete rast.

Ky konkluzion behet me evident, nese i referohemi nenit 6 te Ligjit "Per Policine e Ndertimit", ku thuhet shprehimisht se:

"Policia e Ndertimit pezullon e njofton Keshillin e Rregullimit te Territorit te Republikes te Shqiperise per vendimet e marra nga keshilli i rregullimit te territorit te rrethit ose bashkise, kur veren shkelje ne vendimet e tyre".

Pa paragjykuar ligjshmerine e lejes se ndertimit nr.91 date 18.03.2005, kemi vleresuar dhe konstatuar se ne kushtet e evidentimit te kesaj ceshtje nga ana e organit te Policise te Ndertimit, ky organ ne asnje percaktim ligjor ne fuqi nuk kishte tagren per marrjen e nje vendimi perfundimtar per prishje te objektit te ngritur nga firma perkatese e ndertimit. Gjithe procedura qe mund te ndiqej nga ana e Policise te Ndertimit ne keto raste, ishte procedure paraprake ndihmese dhe pezulluese, ne funksion te ushtrimit te kompetencave ligjore nga ana e Keshillit te Rregullimit te Territorit te Republikes se Shqiperise (KRRTRSH).

Keshilli i Rregullimit te Territorit te Republikes se Shqiperise, si organ vendimmarres ne kete ceshtje, ne perputhje me parashikimet e nenit 146 te Kodit te Procedurave Administrative, por edhe ne analogji te parashikimit te bere ne nenin 10 te Ligjit "Per urbanistiken", mund te merrte vendim per shfuqizimin e lejes se ndertimit, sikurse edhe per lenien ne fuqi te kesaj leje.

Vetem nese KRRTRSH-ja do te vendoste me nje vendim perkates per shfuqizimin e lejes se ndertimit nr.91 date 18.03.2005 te KRRT-se ne Bashkine Tirane, atehere pas percjelljes se ketij vendimi per ekzekutim nga ana e organit te Policise te Ndertimit mund te veprohej. Te gjitha konstatimet e bera ne vendimin nr.301 date 7.11.2005 te Drejtorise te Policise te Ndertimit, duhej te ishin pjese e relacionit qe duhej t'i percillej KRRTRSH-se per kete ceshtje dhe jo pjese e arsyetimit per lenien ne fuqi te vendimit te deges Tirana-Qytet, nr. 178 date 28.10.2005.

Ne perfundim te analizes ligjore per trajtimin e ketij rasti, kemi evidentuar se vendimi i Policise te Ndertimit, dega Tirana-Qytet nr.178

date 28.10.2005, si dhe vendimi i Drejtorise te Policise te Ndertimit nr.301 date 7.11.2005, jane marre ne kapercim te kompetencave te ketij organi, fakt qe ne perputhje me parashikimet e nenit 116/b te Kodit te Proçedurave Administrative, i cileson keto dy vendime si absolutisht te pavlefshme. Ne perputhje me kete Kod, nje akt administrativ absolutisht i pavlefshem nuk sjell pasoja.

Ne perputhje me nenin 21/b te Ligjit nr.8454 date 4.02.1999 “Per Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se:

“Pas perfundimit te hetimit, Avokati i Popullit kryen keto veprime:

- paraqet rekomandime per venien ne vend te se drejtes se shkelur tek organi administrative, qe, sipas tij ka shkaktuar shkelje te te drejtave dhe lirive;

Paraqitja e rekomandimit pezullon pezullon aktet ose veprimet e paligjshme apo te parregullta deri ne shqyrtimin e ketij rekomandimi dhe dhenien e pergjigjes Avokatit te Popullit”,

per kete çeshtje nga ana jone, mund te ishte paraqitur ne daten 7.11.2005 nje rekomandim per pezullimin e ekzekutimit te vendimit nr.178 date 28.10.2005. Faktikisht kjo nderhyrje e jona, realisht u be e pamundur, pasi nderkohe qe ne kontaktuam me organin e Policise te Ndertimit dhe kishim marre ne shqyrtim çeshtjen, objekti i ngritur nga firma e ndertimit po goditej me mjetin “Fadrome” nga punonjesit e ketij organi.

Ne keto kushte i kemi rekomanduar Drejtorise te Policise te Ndertimit dhe deges se saj Tirana-Qytet:

1.Mosperseritjen e praktikave te tilla te kundraligjshme ne te ardhmen.

2.Shqyrtimin e ketij rasti me sy kritik dhe nxjerrjen e pergjegjesive te personave qe kane interpretuar dhe zbatuar gabim ligjin duke iu dhene masa disiplinore administrative.

Ky rekomandim megjithe interesimin tone, nuk ka patur nje pergjigje prej organit te Policise te Ndertimit. Ne mbledhjen e dates 5.12.2005, Keshilli i Rregullimit te Territorit te Republikes se Shqiperise (KRRTRSH), ka vendosur shfuqizimin e aktit administrativ, lejes se ndertimit dhene ne favor te firmes te ndertimit, me vendimin nr.91 date 18.03.2005 te KRRT-se ne Bashkine Tirane. Kjo çeshtje eshte duke u ndjekur nga ana e firmes te ndertimit ne rruge gjyqesore.

Nderkohe verehet fakti se organi i Policise se Ndertimit nuk po vepron me ne rastet kur ka vendime gjyqesore per pezullim te ekzekutimit te vendimeve perkatese per prishje, apo edhe per anullim te ketyre vendimeve.

4. Çeshtja e ndjekur me insiative, lidhur me nenkalimin e Zogut te Zi, Tirane.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me paragrafin e tretë të nenit 13 të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999, ndryshuar me Ligjin nr.9398 datë 12.05.2005 “Për Avokatin e Popullit”, nisur nga shqetësimi i shprehur nga një komunitet i gjere në lidhje me ndërprerjen e punimeve për ndertimin e objektit “Sistemimi i Nyjes së Zogut të Zi, përfshi dhe nenkalimin”, mori në shqyrtim me nismën e vet këtë problem.

Ky pezullim punimesh, ishte pasqyruar në mënyrë të përditshme nga ana e medias dhe si rrjedhojë kishte ngjallur shqetësimin e komunitetit të gjere, për faktin se bëhej fjalë për një nga nyjet kryesore të infrastruktures të qytetit të Tiranës, e cila ndikon në jetën normale të këtij komuniteti, ashtu dhe të të gjithë Shqipërisë, sepse nëpërmjet saj hyjnë e dalin nga Tirana mijëra shtetas jo banorë të Tiranës.

Fakti është se, veç deklaratave dhe prononcimeve në Media të përfaqësuesve të organit të Policisë të Ndertimit, të Bashkisë Tiranë dhe të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, ende nuk kishte një zgjidhje përfundimtare të kësaj çështje, duke sjelle për pasoje demtim real të interesave të komunitetit, nga moszbatimi i projektit tashmë të pezulluar.

Për shqyrtimin sa më objektiv të kësaj çështje, nga ana jone u morën shpjegime dhe kopje të dokumenteve zyrtare nga Bashkia e Tiranës, Drejtoria e Policisë të Ndertimit, si dhe nga ana e firmës të ndertimit “Euroteorema” shpk, e cila zbaton projektin.

Situata faktike e ngjarjes:

Siç është bërë e njohur edhe nga ana e mediave, ka rezultuar se në datën 22.10.2005, Policia e Ndertimit, dega Tirana Qytet, ka bërë një kontroll në kantierin e punimeve të objektit “Sistemimi i Nyjes të Zogut të Zi përfshire dhe nenkalimin” dhe ka urdheruar ndërprerjen e punës nga firma zbatuese, “Euroteorema” shpk.

Pas kontrollit është mbajtur proces-verbali mbi konstatimin e kundërvajtjes me nr.34 datë 22.10.2005, që thotë vetëm se firma zbatuese: *“Ka filluar punimet tek mbikalimi i kryqezimit të Rrugës së Durrësit me unazën (Zogu i Zi), pa bërë njoftimin në degën e Policisë të Ndertimit”*. Po në këtë arsytim si shkelje janë nxjerre nga ana e Policisë të Ndertimit, dega Tirana Qytet dy akte administrative të ndryshme, përkatësisht, vendimi për vendosjen e gjobes nr.3 datë 24.10.2005 dhe akt-pezullimi nr.7 datë 24.10.2005.

Analiza e themelit të çështjes:

Rezultoni që tre aktet administrative që ishin përpiluar gjatë procesit administrativ të filluar prej Policisë të Ndertimit, dega Tirana Qytet, konkretisht proces verbal nr.34 datë 22.10.2005, vendimi për vendosjen e gjobes nr.3 datë 24.10.2005, si dhe akt-pezullimi nr.7 datë 24.10.2005, ishin aktet e vetme administrative që përbenin ligjërisht këtë proces administrativ.

Keto 3 akte kane perbere edhe themelin e objektit te shqyrtimit mbi bazen e jane dhene rekomandimet per zgjidhjen e ceshtjes. Keto akte kane si baze ligjore per nxjerrjen e tyre shkeljen e nenit 9 te Ligjit nr.8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, nga ana e firmes zbatuese “Euroteorema Peqin” shpk dhe nenin 5 te ligjit “Per Policine e Ndertimit”.

Konkretisht ne nenin 9 te Ligjit nr.8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, thuhet se:

“Per te gjitha objektet e perkufizuara ne nenin 3, zbatuesi i punimeve duhet te njoftoje ne seksionin e urbanistikes dhe ne policine e ndertimit ne rreth, perpara fillimit te punimeve.

Ne kete njoftim duhet te shenohen emrat dhe te dhenat e investitorit, te projektuesve, te mbikqyresit te punimeve dhe te zbatuesit. Ne objekt duhet te perpilohet detyrimisht, gjate gjithe kohes, planorganizimi i punimeve: etj dokumentacion”...

Kurse ne nenin 5 te Ligjit nr.8408 date 25.09.1998 “Per Policine e Ndertimit”, thuhet shprehimisht se:

“Policia e Ndertimit ne zbatim te kushteve te ligjit nr.8405 date 17.09.1998 “Per urbanistiken” dhe te ligjit nr.8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, kontrollon dhe merr masat e duhura per pezullimin e punimeve, prishjen e ndertimit te kunderligjshem, si dhe jep denimin me gjobe”.

Duke zbatuar kompetencat e saj ligjore, ne kete rast Policia e Ndertimit, dega Tirana Qytet, kishte vendosur ndaj firmes zbatuese “Euroteorema” shpk, denimin per kundervajtje administrative me gjobe ne masen 200.000 (dyqind mije) leke. Njekohesisht ky organ kishte marre ndaj firmes zbatuese, masen administrative te pezullimit te punimeve ne objekt.

Sipas percaktimeve te bera ne Ligjin “Per urbanistiken”, shkelja e konstatuar ne kete rast nga ana e Policise te Ndertimit, perbente kundervajtje administrative. Nderkohe akt-pezullimi nr.7 date 24.10.2005, ne perputhje me percaktimet e bera ne nenin 78 te Kodit te Proçedurave Administrative, perben dhe cilesohet si vendim i ndermjetem, i marre nga ana e organit te Policise te Ndertimit.

Ne piken 2 te nenit 78 te sipercituar te Kodit te Proçedurave Administrative thuhet:

- *“Vendimi per marrjen e masave te ndermjetme duhet te jete i justifikuar dhe me afat te percaktuar”.*

Kemi konstatuar pra se akt pezullimi, si vendim per marrjen e nje mase te ndermjetme ne kete ceshtje, ka gjetur justifikimin ne faktin se firma zbatuese “Euroteorema” shpk, ne momentin e kontrollit nuk ka zbatuar nje nga kerkesat e ligjit, duke mos i derguar Policise te Ndertimit

njoftimin e fillimit te punimeve me dokumentacionin tekniko-ligjor perkates.

Por gjithashtu kemi konstatuar se ne aktin e pezullimit te punimeve nr.7 date 24.10.2005, nga Kryetari i Policise Ndertimit dega Tirana Qytet, nuk ishte percaktuar afati i pezullimit, sikurse kerkon pika 2 e nenit 78 te Kodit te Procedurave Administrative.

E gjithë kjo procedure e pershkruar dhe analizuar ne menyre analitike nga ana jone, tregon per fillimin dhe vazhdimin e nje procedimi administrativ, i cili sikurse kishte patur gjate zhvillimit te tij vendime te ndermjetme, duhej patjeter qe brenda afateve ligjore te percaktuara, te kishte edhe nje vendim perfundimtar.

Ne trajtimin ligjor te kesaj çeshtje, analiza per afatin percaktues te vlefshmerise duhej t'i referohej Ligjit nr.7697 date 7.04.1993 "Per kundervajtjet administrative". Me konkretisht, ne nenin 14 te ketij ligji, thuhet shprehimisht se:

"Shqyrtimi i kundervajtjes administrative behet brenda 15 diteve nga data e konstatimit te saj, por jo me vone se 2 muaj pas kryerjes".

Kurse ne paragrafin e trete te nenit 4 te ligjit "Per kundervajtjet administrative":

"Keto denime administrative (vendosja e gjobes), ne vartesi nga lloji i kundervajtjes, shoqerohen edhe me masa administrative parandaluese te parashikuara ne ligj".

Akti i pezullimit i dates 24.10.2005 ishte mase parandaluese dhe kishte edhe cilesine e nje vendimi te ndermjetem. Marrja e nje vendimi perfundimtar, duhej te behej brenda nje afati 15 ditor. Fillimi i ketij afati ne kete rast perkante me vete fillimin e procedimit dhe me konkretisht me proces-verbalin e konstatimit te kundervajtjes nr.34 date 22.10.2005, te Policise te Ndertimit, dega Tirana Qytet. Ai perbente bazen qe, ne zbatim te nenit 14 te Ligjit nr.7697 date 7.04.1993 "Per kundervajtjet administrative", te shqyrtohej kjo kundervajtje administrative.

Nderkohe rezultonte se sipas vertetimit per veprim arke ne Raiffeisen Bank, nga ana e "Euroteorema" shpk, me date 27.10.2005, te ishte shlyer detyrimi perkates duke paguar gjoben prej 200.000 leke. Kurse me daten 28.10.2005, sipas akt kontrollit perkates, firma "Euroterorema" i kishte dorezuar Policise se Ndertimit, dega Tirana qytet gjithë dokumentacionin teknik qe kerkohej dhe qe ishte shkaku i konstatimit te kundervajtjes dhe pezullimit te punimeve. Pas plotesimit te kesaj kerkese ligjore dhe pagimit te gjobes, efektivisht nuk ka ekzistuar asnje pengese ligjore per firmen "Euroteorema" shpk, zbatuese per objektin "Sistemimi i Nyjes te Zogut te Zi perfshire dhe nenkalimin", qe te vazhdonte punimet ne kete objekt pas dates 28.10.2005.

Neni 79 i Kodit te Procedurave Administrative, percakton se:

“Vendimet e ndermjetme perfundojne automatikisht ne rastet e meposhtme:

- a) pasi jepet vendimi perfundimtar;*
- b) kur mbaron afati i caktuar per vendimet e ndermjetme;*
- c) kur kalon afati kohor, i parashikuar nga ligji, brenda te cilit duhej te ishte marre vendimi perfundimtar;*
- d) kur nuk ekziston afat kohor i parashikuar nga ligji, vendimet e ndermjetme perfundojne automatikisht kur kane kaluar gjashte muaj nga fillimi i proçedimit.”*

Realisht ne kete çeshtje jemi ne kushtet e parashikuara ne germen (c), te nenit 79, pasi kemi nje afat 15 ditor te parashikuar ne ligj, i cili ka kaluar. Nderkohe Policia e Ndertimit, dega Tirana Qytet, e cila duhej te merrte vendimin perfundimtar per te hequr pezullimin per kete rast, nuk e ka marre kete vendim.

Sipas parashikimeve te Kodit te Proçedurave Administrative, ne lidhje me llogaritjen e afatit per marrjen e vendimeve, duke perjashtuar ditet e pushimit zyrtar, rezulton qe ne daten 11.11.2005, masa e pezullimit e vendosur me akt-pezullimin nr.7 date 24.10.2005, ka rene automatikisht ne cilesine e vendimit te ndermjetem ne kete proçedim administrativ.

Probleme te tjera qe lidhen me çeshtjen

Analiza ligjore e çeshtjes perben edhe thelbin e trajtimit te saj, ne kuadrin e veprimit te administrates publike (Policise te Ndertimit, dega Tirana Qytet), gjate proçedimit administrativ te zhvilluar per kete qellim. Ky sqarim eshte i nevojshem, pasi gjithe pjesa tjeter e çeshtjes rezulton te jete diskutim dhe debat ne largesi nepermjet mediave me argumenta dhe kunderargumenta, ndermjet organit te Policise te Ndertimit, Bashkise Tirane, si dhe Ministrise te Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Ne keto rrethana, kjo pjese ne asnje kendveshtrim nuk mund te perbeje nje proçedim administrativ te nje organi te administrates publike, per me teper nuk perben objekt shqyrtimi nga ana e Ministrise te Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, sikurse nuk perben as objekt shqyrtimi ne kete faze nga ana e Avokatit te Popullit.

Pavaresisht kesaj, ne konstatuar se ne kete çeshtje rezultojne probleme te cilat kane te bejne si me moszbatimin korrekt te ligjit, apo jane çeshtje interpretimi apo edhe pamundesie veprimi per te cilat kemi dhene keto mendime.

1. Moment i cili meriton vemendje, eshte mosaplikimi i formularit 4, qe emertohet Leje Ndertimi. Ne rastet e objekteve qe prokurohen me fonde publike, lejedhenesi dhe subjekti ndertues ne kuptimin klasik shpesh eshte i njejti subjekt. Ne perputhje me nenin 53 te ligjit “Per urbanistiken” per objektet qe prokurohen me fonde shteterore, lejen e ndertimit e merr organi qe miraton fondin, perpara se te jape ne

sipermarrje ndertimin e objektit. Sipas termave qe ndodhen ne Formularin nr.4, ne rastin konkret, subjekt ndertues eshte Keshilli Bashkiak apo edhe vete Bashkia. Por vete keto te dyja nuk kane ndonje license, per ndertim siç kerkon formulari. Pra, leja e ndertimit duhet t'i jepet vete lejedhenesit qe ka edhe cilesine e ndertuesit, fakt qe per nga permbajtja e formularit 4, e ben plotesimin e tij si dokument zyrtar te papershtatshem. Pa paragjykuar procesin e vendimmarrjes nga ana e Bashkise Tirane ne kete rast, por edhe mendimet e bera publike nga ana e Ministrise te Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit per kete çeshtje, gjykojme se duhet te mbahen mire parasysh kerkesat ligjore, te cilat percaktojne vlefshmerine e aktit administrativ. Ne rastin konkret akti administrativ eshte vendimi i KRTRr prane Bashkise Tirane, kurse Formulari nr.4 eshte nje shprehje formale e ketij akti. Mungesa e kesaj forme nuk cenon vlefshmerine e vete aktit dhe as perben shkak qe ne nje procedim administrativ, siç ka ndodhur ne rastin konkret, te konsiderohet si shkak per te penguar nje ndertim. Ne teorine e te drejtes administrative, kerkesat per vlefshmerine e aktit administrativ lidhen me elemente te tilla si kompetenca dhe juridiksioni i organit qe nxjerr aktin administrative; procedura apo forma qe ai duhet te respektoje, si dhe perputhja e sakte e aktit me permbajtjen dhe qellimin e ligjit. Fakti eshte se praktika e perditshme administrative evidenton raste kur akti administrativ ka zbatuar kerkesat qe percaktojne vlefshmerine e tij, por nga forma mund te mos jete i rregullt. Pra percaktimin e parregullshmerise te nje akti mund te ndikojte vleresimi i padrejte ose i papershtatshem i situatave, rrethanave, kushteve, momentit, kohes ose formes apo menyres se nxjerrjes se ketij akti nga organi administrativ. Megjithate duhet kuptuar se pavlefshmeria e aktit nuk lidhet me parregullsine e tij, ose e thene me qarte, parregullsia e aktit nuk eshte e njejte me kunderligjshmerine e tij, pasi parregullsia perben me shume çeshtje oportuniteti se sa çeshtje ligji. Parregullsia e aktit administrativ nuk cenon vlefshmerine e tij. Kete nuk e ka kundërshtuar teorikisht asnje autor ne te Drejten Administrative bashkekohore.

2. Nje tjeter problem i verejtur gjate ketij shqyrtimi, ka qene edhe diskutimi per mungesen e oponences teknike ne proceduren e miratimit te projektit per objektin "Sistemimi i Nyjes te Zogut te Zi perfshire dhe nenkalimin". Ne jemi per ate se duhet patjeter te behet per çdo objekt oponence teknike e rregullt nga institucione te afta, kompetente dhe te licensuara shprehimisht, qofshin ato shteterore, apo edhe private. Bashkia Tirane e shikon te ezauruar kete kerkese proceduriale me oponencen qe i ka bere projektit, permes Keshillit Teknik te Puneve Publike, me specialiste te brendshem si dhe te jashtem. Nga ana tjeter konstatojme se ne zbatim te nenit 6 te Ligjit "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit", si dhe te VKM-se nr.363, date 18.07.2002 "Per vendosjen e

oponences teknike per projektet e ndertimit te objekteve”, Ministri i Rregullimit te Territorit dhe Turizmit ka nxjerre urdherin nr.187 date 21.06.2004 “Per miratimin e kushteve te pergjithshme te akt-marreveshjes dhe objektit te oponencave teknike te projekteve te ndertimit, si dhe caktimi i institucioneve shteterore per kryerjen e tyre”. Pavaresisht parashikimeve rregulluese te ketij urdheri, ky i fundit nuk rezulton te jete botuar ne Fletoren Zyrtare mbas daljes se tij, ne perputhje me kerkesen e paragrafit te pare te nenit 117 te Kushtetutes, fakt qe tregon mosfutjen ne fuqi te ketij akti. Pra, aktualisht Udhezimi i Ministrit ende nuk ka fuqi detyruese juridike ndaj subjekteve te cilave ai i drejtohet. Pra ne rastin konkret, ne kuptimin formal te ligjit, nuk mund te konsiderohet shkelje qe te perbeje shkak per pezullimin e punimeve, sepse nje oponence faktike ekziston, por nuk eshte realizuar nga institucionet qe ka percaktuar Udhezimi i Ministrit. Duke qene ligjerisht ky Udhezim i Ministrit i pa hyre ne fuqi, rrjedhimisht s’ka shkelje ligji.

3. Ne ushtrim te kompetencave, eshte marre edhe nje vendim per pezullim punimesh. Marrja e nje vendimi te tille gjithmone lidhet me arsye ose rrethana te cilat duhet te jene te tilla qe te lidhen me nje situatë ku kerkohet ne menyre te domosdoshme nderhyrja e autoritetit publik, pasi ne te kundert interesave publike mund t’u shkaktohen deme te renda te riparueshme. Pikerisht keto kushte autorizojne ne keto raste organin pergjegjes per kontrollin (Policine e Ndertimit), qe te veproje me nje vendim te ndermjetem, duke marre parasysh ne kete proces vendimmarrje edhe faktin se gjykimi i organit pergjegjes duhet te jete ne proporcion me demin potencial qe e ka diktuar ate.

Askush nuk mund te perjashtoje kontrollin qe ushtrohet ndaj veprimtarise se organeve te pushtetit vendor ne veprimtarine e tyre, por ky kontroll duhet te respektoje parimin e autonomise vendore, si dhe proporcionin e mases se nderhyrjes, duke respektuar njekohesisht proceduren ligjore dhe kompetencen e shprehur qofte ne identifikimin e organit vendimmarres, ashtu edhe ne perputhshmerine e kompetences se tij me kufirin ligjor te percaktuar dhe qellimin e ligjit ne baze te te cilit jepet kjo kompetence.

Por ne kuader te Kartes Europiane te Autonomise Vendore, qe eshte ratifikuar me Ligjin nr.8548, date 11.11.1999, e cila eshte bere pjese e legjislacionit tone te brendshem, nuk duhet te harrojme parimin qe sanksionon ky akt, sipas te cilit kompetencat qe u besohen organeve lokale duhet te jene te plota dhe mund te diskutohen apo te kufizohen nga nje autoritet tjeter, qendror apo rajonal, vetem brenda ligjit. Eshte kuptimplote fakti se me autonome lokale si koncept Karta Europiane e Autonomise Vendore, kupton te drejten dhe aftesine efektive te bashkesive lokale per te rregulluar e drejtuar, brenda ligjit, nen

pergjegjesine e tyre nje pjese te mire te çeshtjeve publike, sikurse edhe eshte infrastruktura urbane ne kete rast.

Edhe ne Kushtetuten tone, autonomise vendore i kushtohet nje vemendje e veçante ne nenin 13 te saj, ku thuhet shprehimisht se:

“Qeverisja vendore ne Republikën e Shqipërisë ngrihet ne baze te parimit te decentralizimit te pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit te autonomise vendore”.

Konkretizimi i ketij parimi kushtetues, eshte bere tashme me futjen ne fuqi te Ligjit nr.8652 date 31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Ne germen a/I, te pikes 4 te nenit 72 te ketij ligji, percaktohet shprehimisht se:

“Duke filluar nga 1 Janari 2001, komunat dhe bashkite jane teresisht pergjegjese per kryerjen e funksioneve te veta te meposhtme:

Ne fushen e infrastruktures dhe sherbimeve publike:

- ndertimin, rehabilitimin dhe mirembajtjen e rrugeve me karakter vendor, te trotuareve dhe shesheve publike”.

Duke interpretuar keto dispozita del se eshte Bashkia e Tiranës teresisht pergjegjese per çdo lloj vendimi per objektin qe ka vendosur te ndertoje, perfshire projektin dhe sasine e fondit per te.

Proçesi i decentralizimit, ka vendosur ne nje marredhenie dualizmi pushtetin qendror me ate vendor ne disa kompetenca te percaktuara ne “Ligjin per Urbanistiken”, prandaj del nevoja e pershtatjes se ketij ligji me Karten Europiane per Autonomie Vendore.

4. Gjate debateve ngrihet edhe çeshtja sikur projekti dhe zbatimi i tij nuk kane respektuar standartet e kerkuara te cilesise se ndertimit dhe si pasoje nuk jepen garanci per te mos rrezikuar jeten e komunitetit. Por ne asnje dokument zyrtar siç e kerkon ligji (faktikisht ne asnje lloj proçesverbali te mbajtur nga Policia Ndertimore) nuk behet fjale per kete pretendim. Pa e paragjykuar çeshtjen, Policia Ndertimore mund t’a bente vete kontrollin dhe ekspertimin per kete çeshtje, ashtu siç edhe ne kemi shprehur gatishmerine te angazhonim grup ekspertesh me kete detyre, gjithmone ne perputhje me kushtet e kerkuara te ligjit tone. Pra n.q.s. pezullimi zyrtarisht do te ishte bere per dyshime qe lidhen me cilesine e punimeve te ndertimit dhe sigurine e jetes se qytetareve.

5. Gjate debateve mediatike te kesaj çeshtje, kane dale edhe probleme qe lidhen me fondet e caktuara per ndertimin e objektit apo taksen qe duhet derdhur gjate marrjes se lejes se ndertimit. Keto jane çeshtje qe futen ne juridiksionin e kompetencat e institucionit tjetër te pavarur kushtetues, Kontrollit te Larte te Shtetit.

Duke iu rikthyer edhe nje here thelbit te çeshtjes i cili ka te beje me aktin e pezullimit te nxjerre nga ana e Policise te Ndertimit, dega Tirana Qytet, kemi theksuar se ne kete rast nga ana e ketij organi eshte cenuar nje nga parimet kryesore te parashikuara ne Kodin e Proçedures

Administrative, parimi i marrjes se vendimeve nga ana e organit te administrates publike, jo ne kohen e duhur. Si rrjedhoje ky mosveprim ka penguar vazhdimin e punimeve dhe sjelle edhe dem ekonomik firmes zbatuese, e cila legjitimohej ne çdo kohe te kerkonte demshperblimin ndaj Policise Ndertimore pas dates 11.11.2005.

Lenia pezull e çeshtjeve krijon pasiguri ne transaksionet e ndryshme, ne rastin konkret jo vetem midis privatit dhe administrates publike. Ne kete kuptim, mosmarrja e nje vendimi perfundimtar lidhur me aktin e pezullimit nr.7 date 24.10.2005, brenda afateve kohore te percaktuara me ligj ka perbere shkak per cenim te te drejtave te nje komuniteti te gjere, pavaresisht se kjo mase pezullimi ligjerisht kishte rene. Ne nje gjykim teresor te ketij problemi faktik te zbatimit te ligjit dhe karakterit vazhdues te veprimtarise se shtetit, kemi arritur ne konkluzionin se pergjegjesia per zbatimin korrekt te ligjit, perben nje proces zinxhir qe sikurse ne kete rast, nuk mund te identifikohet vetem me subjektin e Policise Ndertimore apo Bashkine e Tiranës.

Shqyrtimi i kesaj çeshtje ka nxjerre probleme qe diktojne nevojen e rregullimeve te ligjeve e akteve nenligjore, siç ligji “Per urbanistiken” etj.

Ne keto kushte kemi pergatitur nje rekomandim drejtuar Policise te Ndertimit, dega Tirana Qytet dhe Bashkise Tirane, ku shprehemi qe:

1. Organi i Policise te Ndertimit, te mos pengoje vazhdimin e punimeve ne objektin “Sistemimi i Nyjes te Zogut te Zi, perfshire dhe nenkalimin” dhe te mosperserise praktika te tilla ne te ardhmen.

2. Bashkia e Tiranës te kerkoje ne rruge institucionale qe te perputhen kerkesat e ligjeve me kushtet dhe specifikat qe dalin nga rastet konkrete, duke propozuar ndryshimin apo plotesimin e legjislacionit perkates.

Ndaj ketij rekomandimi ka ardhur nje pergjigje refuzuese nga ana e Drejtorise te Policise te Ndertimit, megjithese ligjerisht nuk ka qene kompetence e saj trajtimi i kesaj çeshtje. Duke i drejtuar objeksionet tona per kete qendrim, njekohesisht kemi njoftuar nderprerjen e shqyrtimit te çeshtjes, e cila tashme eshte bere objekt shqyrtimi gjyqesor.

Ne takimin e zhvilluar ne daten 17.01.2006 ne zyren e Avokatit te Popullit me Presidentin e Kongresit te Autoriteteve Lokale & Rajonale te Keshillit te Europes, z. Giovanni Di Stasi eshte shprehur se ka vizituar ne vend objektin qe po ndertohet tek Zogu i Zi, gje qe realisht nuk do te thote shume si fakt ne vetvete. Por bllokimi i ndertimit te rrugeve nxjerr problemin qe nese Bashkia nuk mund te veproje, atehere ajo nuk ekziston si e tille. Per kete ai ka nenvizuar qarte dy momente:

1. Shkrirjen e KRRT-se aktuale dhe formimin e nje KRRT je te re, sipas parimeve te autonomise vendore.

2. Shkatërrimi i objektit të Zogut të Zi nuk mund të bëhet nga ana e Policisë së Nderimit, pasi është një veprim që është në kundërshtim me parashikimet e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore.

Ai ka theksuar se Këshilli i Europës dëshiron që procesi i demokratizimit dhe decentralizimit të ndodhë në Shqipëri, ndaj edhe kompetencat për të dhënë leje nderimi e me pas për të prishur janë kompetenca që i duhen dhënë një organi në përputhje me këtë Kartë. Për këtë, duhet që të gjitha palët të mbajnë një qëndrim pozitiv në këtë drejtim.

b. Ankesat për Ujësjetes Kanalizimet

Gjatë vitit 2005, janë shqyrtuar 10 ankesa, që kanë patur të bëjnë me ujësjetes dhe kanalizimet. Nga këto 3 ankesa janë zgjidhur në favor, 7 kanë qenë të pabazuara dhe jashtë kompetence. Për një çështje është paraqitur rekomandim i veçantë. Ankesat e zgjidhura pozitivisht po i trajtojmë si raste që ilustrojnë problematikat e ndryshme që hasen në shërbimet publike që ofrojnë këto organe.

1. Prane Institucionit të Avokatit të Popullit, paraqiti ankesën e tij përfaqësuesi i banorëve të pallatit Nr.233 Tiranë. Ai u ankua për mënyrën e gabuar të llogaritjes së konsumit të ujit në apartamentet e tyre nga punonjësit e Ujësjetes-Kanalizimeve sh.a. Avokati i Popullit, pasi u njoh me këtë ankesë, kreu menjëherë verifikimet përkatëse. Në përfundim të tyre arriti të ndihmojë zgjidhjen e çështjes duke sqaruar se faturimi i kryer në bazë të frymëve (në mungesë të sahatit) është realizuar si pasoje e moskordinimit të veprimeve për lidhjet e kontratës së furnizimit me ujë ndërmjet Firmës së Nderimit dhe Ndermarrjes së Ujësjetes-Kanalizimeve sh.a. Në këtë rast pa patur një njoftim për instalimin e matësve është faturuar për frymë. Për këtë keq menaxhim të përlogaritjes së konsumit faturuesja përgjegjëse është pushuar nga puna. Me tej për periudhën e lidhjes së kontratës së firmës e në vazhdim faturuesja e re ka filluar të zbrese detyrimet që rezultuan në bazë të konsumit të ujit sipas matësve dhe faturimi ka vazhduar të ulet gradualisht për sasinë e mbetur të ujit, me qëllim që askush të mos paguajë dy herë të njëjten sasi të konsumuar.

2. Prane Institucionit të Avokatit të Popullit u paraqit një ankesë në të cilën disa banorë të banesës Nr.22 Tiranë, ngriten shqetësimin se Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare me një urdher të paligjshëm kishte ndërprerë furnizimin me ujë të pijshëm që nga Janari 2005. Në këto kushte banorët pretenduan se ndërprerja e furnizimit me ujë nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare është e paligjshme, sepse përmbushjet e detyrimeve kontraktuale, janë pjesë e marrënieve të tyre me Ujësjetes-Kanalizime sh.a Tiranë, i cili është enti kompetent për menaxhimin e rrjetit furnizues me ujë të pijshëm.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me kete ankese dhe kreu nderhyrjet e nevojshme prane institucioneve perkatse, arriti te ndihmoje ne zgjidhjen e shpejte te kesaj ceshtje. Konkretisht nga verifikimet e kryera dhe nga informacionet e vena ne dispozicion nga dy organet e mesiperme rezultoi se banesa Nr.22 Tirane ka patur çrregullime te furnizimit me uje ne disa periudha kohore. Ne keto kushte eshte hartuar dokumentacioni perkates dhe banoreve te kesaj banese i eshte bere nje lidhje e re me rrjetin e ujit te tubacionit te Rruges “4 Shkurti”. Punimet perfunduan me shpejtesi dhe furnizimi ka vazhduar normalisht.

3. Prane Institucionit te Avokatit te Popullit u paraqit nje ankese, ne te cilen pretendohet se Ndermarrja Ujesjelles-Kanalizime sha Tirane eshte duke caktuar tarifa per sherbime te cilat nuk i ofrohen realisht konsumatorit. Konkretisht ne faturen e furnizimit me uje te pijshem dhe per kanalizime ishte kerkuar te paguhej nga ana e subjektit 96leke/m³ per ujin e pijshem dhe 12leke/m³ per ujin e perdorur. Kjo kerkese ankuesit i eshte dukur e pavend, pasi Ujesjelles-Kanalizime sha nuk kane kryer punime per rrjetin e kanalizimeve ne zonen ku ai banon dhe as nuk kryejne sherbime mirembajtje te tij. Ne keto kushte tarifa prej 12leke/m³ eshte konsideruar nga ana e tij e padrejte dhe si e tille ai ka pretenduar qe ajo te mos paguhet per aq kohe sa nuk ofrohet sherbimi i parashikuar.

Avokati i Popullit, pasi mori ne shqyrtim ankesen si dhe pasi kreu verifikimet dhe komunikimet perkatse zyrtare me Ndermarrjen e Ujesjelles-Kanalizimeve Tirane, ka sqaruar ankuesin se faturimi i kryer ne ngarkim te tij, ne lidhje me ujin e perdorur, ka nje gabim tarifor. Ne keto kushte Drejtori i Ujesjelles-Kanalizimeve sha Tirane ka pranuar te ktheje vleren prej 32.688 leke te arketuar gabimisht, duke kompesuar ne kete menyre ankuesin e mesiperme per demin e shkaktuar.

Avokati i Popullit ne kuader te mbrojtjes se te drejtave, lirive dhe interesave te ligjshme te konsumatoreve eshte perpjekur qe ato te gjejne respektin dhe garancite e duhura nga entet publike. Ne kete kendveshtrim, bashkepunimi i kahershem me Ujesjelles-Kanalizimeve sha, ka dhene frytet e duhura ne mjaft aspekte te rendesishme te permiresimit te sherbimeve qe ofrojne strukturat e tij ndaj konsumatorit. Situata qe paraqitet prane Zyres se Avokatit te Popullit tregon se jane shtuar rastet e ankesave per faturime jo te rregullta. Konkretisht, qytetaret ankohen se leximi i matesave te tyre, nuk kryhet ose kryhet duke vene shifra fiktive nga ana e punonjesve te autorizuar te Deges se Shitjes Ujesjelles-Kanalizime sha Qytet.

Avokati i Popullit ka mbajtur ne evidence dhe ka verifikuar here pas here raste te tilla shkeljesh, duke kerkuar madje edhe masa disiplinore ndaj punonjesve pergjegjes. Kjo veprimtari dhe nderhyrjet e shpeshta te kryera prane Ujesjelles-Kanalizimeve nuk kane dhene efektet e duhura per shkak te mangesive qe ekzistojne ne administrimin e rregullt te

procedurave te faturimit. Si rrjedhim per te zbuluar shkakun e kesaj anomalie te vene re eshte bere nje studim pergjithesues i ankesave per zonat me probleme, nga ku eshte konstatuar se punonjësit e leximit të matësave të Ujës-jellës-Kanalizimeve sha

1. Nuk paraqiten sistematikisht ne zone per te ushtruar rregullisht detyren e tyre, por faturojne ne distance me mesatare te muajve paraardhes.

2. Ne rastet e paraqitjes ne zone ka raste qe kryejne nje lexim te parregullt.

3. Nuk arrijne te argumentojne diferencat ne matje dhe shpesh here veprimet e tyre matematikore lene per te deshiruar ne ballafaqim me konsumatoret.

4. Ne rastet e shkeljeve te konstatuara nga qytetaret arrijne te bejne marreveshje individuale jozyrtare me keta te fundit per menyren e kompesimit te “gabimeve” duke faturuar me pak ne muajt ne vazhdim, thjesht per te fshehur shkeljet e kryera.

5. Jo vetem qe nuk njoftojne, por kundershtojne dhe evitojne pranine e banoreve gjate kryerjes se leximit ne mates.

6. Megjithese kane orare pritje me konsumatoret qe ankohen, nuk paraqiten duke lene te pa sqaruar keta te fundit.

Ne problematiken e parashtuar me siper, te bie ne sy se roli dhe detyra qe eshte ngarkuar te kryeje faturuesja ka gjeneruar ne veprime te papergjegjeshme antiligjore qe kane çuar ne konflikte te shpeshta me qytetaret, te cilet kane filluar te humbin besimin ne nje sherbim serioz dhe korrekt qe duhet te ofrohet nga Ujës-jellës-Kanalizimeve sha.

Ne kete shtate, Avokati i Popullit ka propozuar masa konkrete qe kjo gjendje te permiresohet dhe te gjeje rrugen e zgjidhjes per ti dhene fund anomalive administrative, nga te cilat vuan administrimi i ketij enti publik. Konkretisht per ti ardhur ne ndihme mbrojtjes se te drejtave ekonomike te konsumatorit, permiresimit te cilesise se sherbimeve ndaj tij dhe shmangies nga fenomenet qe demtojne imazhin e enteve publike me sherbim furnizimi dhe mirembajtje te rrjetit ujesjelles-kanalizime, Avokati i Popullit gjate vitit 2005 ka rekomanduar prane Ujës-jellës-Kanalizimeve sha disa ndryshime ne procedurat e deritanishme qe aplikohen nga punonjesit e Deges se Shitjes per leximin e matesave te ujit si me poshte vijon:

1. Leximi i matesave te rregullt te konsumatoreve familjare dhe jo familjare te kryhet ne prani te nje perfaqesuesi te pallatit, baneses apo objektit ku do te ushtrohet kjo veprimtari.

2. Punonjesi i ngarkuar me kete detyre, duhet te paracaktoje ditën dhe oraret e duhura brenda te cilave detyrohet te paraqitet per lexim.

3. Ky punonjes ne perfundim te leximit mujor ka detyrimin te pajise perfaqesuesin e konsumatoreve me nje vertetim, ku te pasqyrohet leximi i kryer dhe data e paraqitjes me nenshkrimin e saj.

4. Ne rastet e mungeses se perfaqesuesit gjate leximit, kopja e vertetimit i jepet me firme nje konsumatori tjetër te pallatit, baneses apo objektit fqinjë ose afishohet ne vende te dukshme.

5. Ne rastet e mungeses se perseritur dhe te pajustificuar te punonjesit gjate kohes dhe ores se caktuar per lexim, personi perfaqesues apo çdo konsumator tjetër i interesuar, ka te drejte te njoftoje sportelin perkates te shitjes.

Kjo menyre e re e rregullimit te marredhenieve te paleve gjate permbushjes se detyrimeve qe sjell furnizimi me uje, u mendua te gjente zbatim me ane te nxjerrjes se nje urdheri nga Ndermarrja e Ujesjelles-Kanalizime sha . Ne pergjigjen e tij, ish drejtori Z.Hasalami ka shpjeguar se mjaft rregulla qe propozohen nga Avokati i Popullit jane vene ne zbatim nepermjet udhezimeve te veçanta qe ju jane dhene degeve te shitjeve dhe punonjesve te leximit te ujesjellesit. Por ish drejtori ka pranuar se ekzistojne veshtiresi zbatimi per shkak te permbushjes me te meta te punes nga lexueset, per te cilat masat disiplinore nuk kane qene te pakta. Po ashtu ai sqaroi se nuk jane te rralla rastet e papergjeshmerise qe rezulton ne shfrytezimin e ujit te pijshem nga nje numer i konsiderueshem ankuesish.

Gjithsesi Avokati i Popullit, do te vazhdoje jo vetem te nderhyje per permiresimin e standarteve te sherbimeve qe ofron ky ent, por do te inicioje gjate vitit ne vazhdim nje ekspertize ligjore, lidhur me formen dhe permbajtjen e kontrates se furnizimit te ujit te pijshem me abonentet familjare dhe jo familjare, per ti dhene nje performance bashkekohore mardhenieve kontraktuale qe duhet te ekzistojne midis Ujesjelles-Kanalizimeve sha dhe konsumatorit.

c) Ankesa për Albtelekomin dhe telefonine e lëvizshme

Gjatë vitit 2005 pranë Avokatit te Popullit janë shqyrtuar 12 ankesa për Drejtorinë e Përgjithshme të Albtelekom sh.a dhe filialet e tij nëpër rrethe. Nga keto 2 ankesa kane qene te mbartura nga viti 2004 dhe jane perfunduar gjate vitit 2005, 3 ankesa kane qene te pabazuara, 2 kane rezultuar jashtë juridiksionit dhe kompetencave, 5 ankesa janë zgjidhur në favor të ankuesve dhe eshte hartuar nje rekomandim per te pergjithsuar fenomenet negative te sherbimit dhe permiresimit te tyre.

Disa nga ankesat e zgjidhura pozitivisht dhe problematikat qe hasen ne këtë ent publik, jane parashtruar si më poshtë:

1. Prane Institucionit te Avokatit te Popullit u paraqit nje ankese ne te cilen individi pretendoi se ngjitur me murin e apartamentit te tij ishte vendosur nje kabine telefonike, e cila i shkaktonte per vete menyren e

instalimit nje lageshtire te madhe ne murin e baneses duke u bere shqetesim serioz per shendetin e te gjithë familjes.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me kete ankese, kerkoj menjehere nje informacion te hollesishem nga ana e Albtelekom sha Kukes, lidhur me rrethanat konkrete te çeshtjes dhe me menyren e zgjidhjes se saj.

Ne pergjigjen e tij, Drejtori i Albtelekom sha Rajoni Kukes sqaroi se pas verifikimeve te kryera rezultoi se kabina telefonike ishte shkaktare e demtimit te shendetit dhe prone se ankuesit dhe me kete rast ne kuader te permiresimit te teknologjise se telekomunikacionit u filluan veprimet administrative dhe teknike ne rrjetin e Zones, duke kryer zhvendosjet e rrjetit sipas standarteve bashkekohore.

2. Prane Institucionit te Avokatit te Popullit u paraqit ankesa e nje personi juridik me seli ne Tirane, i cili ngriti shqetesimin se prej mese 1 viti i ishte nderprere linja telefonike. Avokati i Popullit, pasi u njoh me ankesen, pati detyrimin ligjor te nderhynte prane Albtelekom sha Zona Tirana 2, lidhur me shkaqet e vonesave ne ndreqjen e difektit te linjes telefonike dhe afatet konkrete brenda te cilave do te behej e mundur zgjidhja e shpejte dhe perfundimtare e kesaj çeshtje.

Me ane te pergjigjes se tij, Drejtori i Rajonit Tirana 2 ne Albtelekom sha ka sqaruar se linja juaj telefonike eshte nderprere si pasoje e punimeve te pakontrolluara qe jane kryer nga nje firme private ne segmentin rrugor te asaj zone. Per kete problem, jane kerkuar disa here shpjegime prane Bashkise Tirane dhe Firmes se Ndertimit, por ka qene e pamundur te realizohej nje ndreqje e shpejte e difekteve. Ne keto kushte, sipas drejtorit, u pa menjehere e udhes te kryhej nje lidhje linje dytesore per abonentin, deri ne rregullimin e kabllit kryesor.

3. Prane Institucionit te Avokatit te Popullit u paraqit shqetesimi i nje ankuesi, i cili pretendoi se kishte mese 1 muaj qe i ishte nderprere linja telefonike ne menyre te padrejte. Ne keto kushte pasi kishte marre disa here takim me inxhinierin e zones, i cili kishte pranuar shkaqet e difektit, por nuk kishte vene afate per ndreqjen e tij, pretendoi se kjo zgjatje ne kohe e rilidhjes se linjes duhet te nderpritet, duke i dhene zgjidhje sa me te shpejte kesaj çeshtje. Avokati i Popullit, pasi u njoh me kete ankese, si dhe pasi kreu verifikimet perkatse prane Albtelekom sha Zona 1 Tirane, arriti te nxiste kete organ per te nderhyre ne rrjet, duke rilidhur linjen telefonike. Gjithsesi Avokati i Popullit ne kete rast ju kujtoi drejtuesve te Albtelekom sha Zona 1 Tirane, permbajtjen e kontrates se pajtimit te abonenteve, ku per raste difektesh ka disa afate konkrete per ndreqjen e tyre, te cilat variojne sipas specifikave teknike nga tre deri ne gjashte dite.

4. Prane Institucionit te Avokatit te Popullit, u paraqit letra e nje ankuesi, i cili ngriti shqetesimin se nga ana e Albtelekom sha Shkoder nuk ishte bere e mundur pajisja e tij me linje telefonike, megjithese ai

kishte paguar te gjitha detyrimet per pajtimin e ketij sherbimi. Avokatit te Popullit, pasi u njoh me kete ankese dhe kreu nderhyrjet perkatese ne ndihme te zbatimit te detyrimeve te sherbimeve publike nga Albtelekom sha Shkoder, u be e mundur lidhje e linjes telefonike te ketij shtetasi. Gjithsesi ne kete rast Avokati i Popullit vuri ne dukje vonesat e pajustificueshme jashte afateve te parashikuara per instalimin e linjave telefonike nga Albtelekom sha Shkoder dhe kerkoi shmangien e ketij enti nga keto praktika te parregullta ne te ardhmen.

5. Prane Institucionit te Avokatit te Popullit nje grup banoresh te Pallatit Nr.12 Tirane ngriten shqetesimin per faturime te padrejta te llogaritura nga Rajoni i Albtelekom Tirana 2. Konkretisht banoret ankoheshin se gjate muajit Dhjetor 2004 , periudhe ne te cilen sinjali i telefonise fikse ka qene i nderprere si pasoje e demtimeve ne rrjet nga nje firme rikonstruksioni rruges, prane tyre ishte paraqitur fatura e shitjes se sherbimeve telefonike mujore ne nje shume mjaft te larte. Kjo gje eshte kundershuar nga banoret, duke argumentuar se per periudhen e faturuar linja telefonike ka qene e prishur. Ky fakt vertetohej sipas banoreve edhe nepermjet deshmive te zbatuesit te projektit te segmentit te rruges ku po zhvillohen punime, sipas te cilit ne dy tre pjese te kabllit te telefonise fikse ishin shkaktuar demtime me nderprerje te vazhdueshme te linjes.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me kete ankese, kerkoi nga ana e Drejtorise se Albtelekom sha, Rajoni Tirane 2, qe ti percillej nje informacion i hollesishem lidhur me kete problem dhe me masat qe kishin marre per ta zgjidhur ate. Njekohesisht u kerkua qe te vihej ne dispozicion lista analitike e telefonatave te kryera nga banoret per muajin Dhjetor sipas te dhenave te fatures.

Ne pergjigje te kerkeses tone, Drejtori i Rajonit Tirana 2, sqaroi se ishte ne dijeni te demtimit te kabllit te linjes telefonike, por sinjali per abonentet ka funksionuar per nje periudhe te shkurter kohore (javen e pare te Muajit Dhjetor), periudhe ne te cilen ishin kryer edhe thirrjet telefonike nga banoret. Sikunder sqarohet me tej, faturimet jane nje perlllogaritje e sakte e impulseve ne programin kompjuterik te centralit dhe nuk mund te manipulohen. Lidhur me kerkesen per venien ne dispozicion te listes analitike te thirrjeve telefonike per muajin Dhjetor te abonenteve, drejtori u prononcua se aktualisht ky sherbim nuk mund te mundesohet, por eshte duke u punuar per realizimin e tij ne te ardhmen.

Nga faktet dhe prononcimet e paraqitura, Avokati i Popullit, gjykoi se ankesa e banoreve te Pallatit Nr.12 Tirane, pergjithësonte nje mangesi te dukshme ne sherbimet publike qe ofron Albtelekom sha.

Konkretisht venia ne dispozicion e listes analitike nga ana e kesaj kompanie, megjithëse ende e pa mundesuar per abonentet, perben nje element te rendesishem, i cili do te eliminonte ne te ardhmen pretendimet qe ngrihen nga qytetaret per thirrjet e kryera nga telefonia fikse. Perveç

kesaj ky sherbim do te permiresonte dukshem transparencen e veprimtarise se kompanise ndaj abonenteve duke permbushur njekohesisht detyrimet qe rrjedhin nga nje sere dispozitash ligjore.

Avokati i Popullit me ane te nje rekomandimi vuri ne vemendjen e Drejtorit te Pergjithshem te Albtelekom sha rendesine e ofrimin te sherbimit analitik te thirrjeve telefonike. Ai argumentoi kete me faktin se Republika e Shqiperise ka ratifikuar me ane te Ligjit Nr.8430 dt.14.12.1998 “Kushtetuten dhe Konventen e Bashkimit Nderkombetar te Telekomunikacionit ITU (Gjeneve 1992)”.

Kurse ne permbajtje te Nenit 37 pika 3, 4 dhe 6 te Ligjit. Nr.9135 dt.11.09.2003 “Per Mbrojtjen e Konsumatoreve” eshte parashikuar se:

“3. Fatura per sherbimet e telekomunikacionit, shperndare konsumatorit duhet te permbaje informacion te plote lidhur me: listen e numrave te telefonave te thirrur, kohen dhe zgjatjen e telefonatave te bera, numrin e impulseve dhe çmimin total per periudhen e caktuar.

4. Faturat e paraqitura konsumatorit duhet tëi japin atij mundesine per te verifikuar me perpikmeri llogaritjen e shitjes apo sherbimit te siguruar ne nje periudhe te caktuar.

6. Sherbimet ndaj konsumatorit per faturimet do te jene pa pagese”.

Ne vijim te kesaj, per te sqaruar me mire poziten favorizuese qe gjen konsumatori ne keto dispozita, u be e njohur se Ligji Nr. 9135, dt.11.09.2003 “Per Mbrojtjen e Konsumatoreve”, cakton perfundimisht elementet e plote te fatures se sherbimit te telekomunikacionit. Pra krahas te tjerash, ligji parashikon si pjese integrale te fatures fillestare elemente te rinj si lista e thirrjeve dhe kohëzgjatja e telefonatave referuar kohes se kryer. Kjo forme e re e fatures duhet te gjeje zbatim te plote ligjor (pa pagese) dhe nuk duhet te pengohet apo ngaterrohet kurrsesi me aplikimin e sherbimit shtese te fatures (me pagese) qe parashikon Neni 30 paragrafi i fundit i Ligjit Nr.8618 dt.14.06.2000 “Per Telekomunikacionet ne Republiken e Shqiperise”ku thuhet se:

“Me kerkese te perdoruesit, operatori i sherbimeve telefonike publike duhet te siguroje sherbimin me fature te hollesishme, kundrejt nje pagese te arsyeshme”.

Ne dispoziten e mesiperme, ka nje element, i cili e ben faturen te veçante kundrejt pageses. Ky element eshte kerkesa paraprake e perdoruesit, e cila ne dallim nga fatura e thjeshte parashikuar ne Ligjin “Per Mbrojtjen e Konsumatoreve” duhet te aplikohet ne raste te caktuara ne formen e sherbimeve suplementare te kerkuara ndaj kompanise.

Per sa me lart, Avokati i Popullit theksoi faktin se standartizimi i sherbimit ndaj klienteve me liste analitike te thirrjeve telefonike perben nje kusht ligjor dhe nje nevojë imediate per tu realizuar. Ky proces sipas tij duhet te gjente nje perputhje te ngushte midis te drejtave dhe

interesave te ligjshme te abonenteve dhe gadishmerise se Albtelekom sha per te pershpjtuat rritjen e cilesise se sherbimeve qe ofron.

Ne keto kushte, Avokati i Popullit kerkoi nga Drejtori i Pergjithshem i Albtelekom sha dhe nga Bordi Drejtues i kesaj kompanie permiresimin e cilesise se sherbimit te faturimit ndaj konsumatorit te telefonise fikse, duke e plotesuar ate konform Nenit 37 pika 3, 4 dhe 6 te Ligjit. Nr.9135 dt.11.09.2003 "Per Mbrojtjen e Konsumatoreve".

Ne parim nga pergjigja e ardhur nga Albtelekom sha, ky rekomandim u pranua. Qe nga muaji shkurt 2005 eshte instaluar nje aparature qe modelon nje menyre te re analitike per llogaritjen e thirrjeve telefonike, por Albtelekom sha ka pretenduar se sherbimi analitik do te ofrohet abonentit ne çdo rast vetem perkundrejt pageses se kosos.

Aktualisht Albtelekom sha eshte nje kompani me kapital teresisht shteteror, e cila eshte futur ne rrugen e privatizimit dhe se shpejti do te filloje te trajtohet si nje subjekt privat jashte juridiksionit te Avokatit te Popullit. Gjithsesi edhe pse ne kete faze tranzitore, Albtelekom sha ka treguar ane negative te administrimit dhe kujdesit ndaj klienteles. Gjithashtu vete permbajtja dhe verifikimi i ankesave flet per nje sherbim me standarte te ulta qe nuk arrin te krijonte bindjen tek qytetaret dhe publiku i gjere te nje intitucioni serioz dhe eficient.

Sherbimet qe ka ofruar Albtelekom sha nuk kane justifikuar investimet dhe interesin qe eshte treguar si nga partneret nderkombetar ashtu dhe nga Qeveria. Ne Institucionin e Avokatit te Popullit nuk kane qene te pakta ankesat per zvarritje te procedurave per instalimin, rilidhjen, transferimin e numrave te telefonit etj. Kjo gje ka ardhur si pasoje e nje administrate inefficente, e pamotivuar per pune, e cila shpesh here eshte akuzuar per korrupsion. Ne kete kompani megjithe ndryshimet e medha qe jane bere ne kuader te miratimit te rregullores dhe kontrates se re, jane ndjere pengesa te medha ne zbatimin e tyre ne praktike. Ne Albtelekom sha eshte konstatuar ne menyre te vazhdueshme nje paaftesi per te menaxhuar dhe verifikuar ne kohe ankesat e abonenteve. Kjo shtuate ka qene tejet e renduar ne aspektet e verifikimit te impulseve te harxhuara dhe matjeve jo te rregullta. Si rrjedhoje Avokati i Popullit ka kerkuar ne menyre te vazhdueshme qe klauzolat e kontrates se sherbimit te telefonise fikse dhe rregullorja e hartuar ne sherbim te marrëdhënieve me klientin te zbatohen e respektohen si mjeti primar per te arritur standarte te larta ne cilesine e sherbimeve.

Rekomandimet dhe nderhyrjet e meparshme te Avokatit te Popullit kane ndikuar per mbajtjen nen kontroll te tarifave te telefonise fikse, duke mos i ngritur ato, si dhe eshte miratuar metodologjia e kontrollit te tarifave per telefonine fikse. Duke vijuar kete veprimtari doli si detyre prioritare e institucionit te Avokatit te Popullit qe te vazhdone nje bashkepunim te ngushte me Entin Rregullator te Telekomunikacionit, ne

lidhje me permbushjen sa me te shpejte te kerkesave te ligjit per kontrollin e tarifave ndaj operatoreve me fuqi te ndjeshme ne treg per telefonine e lëvizëshme. Konkretisht u planifikua qe ky proces te mbulohej me asistencen tone ligjore dhe te finalizohet me aktet nenligjore perkatese qe do te miratoheshin nga Keshilli i Ministrave (Metodologjia e Kontrollit te Tarifave). Gjithsesi ky bashkepunim me ERT-në lindi ne nje periudhe ku subjektet qe po ofronin sherbimin publik te telekomunikimit mobil ishin pothuajse te privatizuara dhe ne nje suate te tille, Avokatit te Popullit i lindi e drejta te kerkonte me shume kontroll dhe garanci shteterore nga organet e ngarkuara me ligj, per kryerjen e kesaj veprimtarie. Qellimi i Avokatit te Popullit ne kete fushe ishte garantimi i standarteve te larta te sherbimit dhe mbrojtja e te drejtave ekonomike te individeve nga abuzimet dhe perfitimet e pandershme te operatoreve te telefonise së lëvizëshme.

Ne rrjedhim te ketij aktiviteti, gjate vitit 2005 u kerkua nga Enti Rregullator te Telekomunikacioneve (ERT) qe te vinte ne zbatim detyrimet qe parashikon Neni 62 i Ligjit Nr.8618, dt.14.06.2000 "Per Telekomunikacionet ne Republiken e Shqiperise", per miratimin e nje metodologjie te re per caktimin e tarifave per organizmat private me fuqi te ndjeshme ne rrjetet publike telefonike te levizshme (mobile).

Kjo kerkese u paraqit ne kushtet kur ne tregun e telekomunikacionit vendas, operonin organizma me fuqi te ndjeshme ne rrjetet publike telefonike (mobile), per te cilat konsumatorët ankohen per tarifa te larta dhe realizimin e nje fitimi te paarsyeshem. Ne kete rast Avokati i Popullit gjykoi se rregullimi sa me i shpejte me akte nenligjore i metodologjise se caktimit te tarifave te tyre ishte nje detyre qe i perkiste si ERT-se si organ propozues, ashtu dhe Keshillit te Ministrave si organi qe miraton akte te tilla.

Eshte fakt qe keto 5 vjet ERT-ja nuk ka luajtur rolin e saj per te mbrojtur interesat e konsumatorit, per te vene nen kontroll operoret private. Kjo eshte bere me dashje apo pa dashje siç doli edhe nga hetimi i Komisionit Parlamentar. Por fakti eshte se edhe pas 1 viti e gjysem pas ketij komisioni, operoret e telefonise celulare kane mundur te mos vihen nen kontroll per tarifat qe aplikojne, ka nje domethenie. Ato ndonese me imazhin e vet shpallin publikisht se jane operore me mbi 500.000 abonente, nuk e pranojne kete fakt kur shpallen si operore me fuqi te ndjeshme ne treg nga ERT-ja (pra zoteruese te mbi 25% te tregut) duke i kundërshtuar vendimet e saj ne gjykatat shqiptare.

Ne kete kuader, Avokati i Popullit, me qellimin e gjetjes se menyrave ligjore per mbrojtjen e te drejtave ekonomike te qytetareve nga abuzimet me tarifat e telefonise së lëvizëshme, u angazhua qe ne fillim te vitit 2005 te realizonte me ERT-ne nje plan veprimi per venien ne kontroll dhe uljen e ketyre tarifave. Fillimisht Avokati i Popullit konstatoi

se ERT-ja ishte munduar te pajtonte firma te huaja me ane te prokurimit te drejteperdrejt per hartimin e nje metodologjie te caktimit te tarifave. Me tej kjo iniciative e prokurimit te drejteperdrejt ishte refuzuar pa arsye te besueshme per mendimin tone. Keshilli i Ministrave e kishte arsyetuar kete, duke u shprehur se “nuk ka kushte urgjence per prokurim te drejteperdrejt”, ndersa ne gjykuam se pagesat teper te larta te shqiptareve per celularet jane nje urgjence e vonuar. Ndodhur perpara kesaj suate ceshtja kishte ngelur prej shume kohesh pezull. Ne vijim te bashkepunimit te ndersjelle midis Avokatit te Popullit dhe ERT-se u be e mundur nxitja e pershpejtimit dhe perfundimit te hartimit te metodologjise dhe pergatitja e saj per miratim ne Keshillin e Ministrave per te bere te mundur venien e operatoreve AMC dhe Vodafone nen kontroll.

Ne kronologji ERT-ja shpalli fitues te tenderit te hapur nderkombetar nje Shoqeri Gjermane, e cila vazhdoi punen per hartimin e draftit te metodologjise gjate muajit Shtator 2005. Me tej ky dokument ju kalua per oponence operatoreve privat Vodafone dhe AMC. Aktualisht ERT-ja eshte ne fazen perfundimtare te pregatitjes se procedurave per kalimin e ketij dokumenti prane Ministrise se Puneve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacioneve, si autoritet qe do te kaloje propozimin per miratim prane Keshillit te Ministrave.

Por ne paradoks me keto perpjekje, kompanite private Vodafone dhe AMC kane kundersizuar ne rruge gjyqesore vendimet e ERT-se per shpalljen e tyre si OFNT, duke i konsideruar ato te padrejta. Keto veprime kane synuar qellimisht te shmangin detyrimet e tyre nga statusi i OFNT dhe te fitojne te drejta ekskluzive ne caktimin e kushteve te marreshjeve te interkonjeksionit edhe pse ato mund te demtojne ne parim konkurrencen e ndershme te tregut.

Ne kuader te bashkepunimit tone, ERT-ja ka bere te njohur se ne proceset e vazhdueshme gjyqesore me keto kompani, pervecse ka identifikuar qellimin e tyre per te zvarritur ne kohe venien nen kontroll te aktivitetit qe ato kryejne, ka evidentuar edhe disa shkelje gjate dhenies se vendimeve te Gjykates se rrethit gjyqesor Tirane. Konkretisht mbeshtetur ne materialin e vene ne dispozicion nga ERT-ja, Gjykata e Tiranës ne Vendimet Nr.6338 dt.21.12.2004, Nr.3416 dt.01.06.2005 dhe Nr.4892 dt.28.07.2005 ka vene ne dyshim paanshmerine, profesionalizimin dhe kredibilitetin e saj, duke dhene vendime haptazi ne kundersiztim me ligjin, te cilat duke qene te perseritura ne favor te te njejteve subjekte juridik privat, mendojme se kane nje motiv kompromentues qe cenon ne parim pozitat ligjore te ERT-se dhe pergjithesisht interesat e gjera te publikut konsumator.

Ne keto kushte, Avokati i Popullit duke analizuar kete suate ka kerkuar nga ana e Keshillit te Larte te Drejtesise marrjen e masave te menjehershme per inspektimin e ceshtjeve te lartpermendura dhe

nxjerrjen e pergjegjesive perkatse ndaj gjyqtareve. Per kete ceshtje eshte gjykuar se kryerja e veprimeve te diktuar ndaj KLD-se, do te perbeje krahas te tjerash nje avantazh me shume drejt forcimit te shtetit ligjor, shmangies nga abuzimi me detyren dhe intensifikimit te luftes ndaj korrupsionit brenda rradheve te gjyqesorit. Per te gjitha rrethanat e kesaj ceshtje, Avokati i Popullit ka vene ne dijeni Presidentin e Republikes Z.Alfred Moisiu, Kryeministrin Z.Sali Berisha dhe Ministrin e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit Z.Lulzim Basha.

Si konkluzion per sherbimet telefonike fikse dhe të lëvizshme, verejme se ato pasqyrojne ne pjesen me te madhe te tyre mangesi te dukshme administrative dhe manaxheriale, çëka e veshtireson edhe me shume realizimin dhe permbushjen e standarteve te kerkuara nga legjislacioni ne fuqi. Gjithsesi Avokati i Popullit do te vazhdoje te ndjeke me vemendjen me te madhe zbatimin e ligjit dhe detyrimeve institucionale te organeve shteterore kompetente per te garantuar maksimalisht te drejtat dhe interesat ekonomike te konsumatorit ne fushen e telekomunikacioneve.

ç. Posta

Gjatë vitit 2005 pranë Avokatit të Popullit janë shqyrtuar 3 ankesa për Sherbimin e Posta sh.a dhe filialet e saj nëpër rrethe. Nga keto 1 ankese eshte ende në shqyrtim, 1 ankesë ka qene e pabazuar dhe 1 ankese është zgjidhur në favor të ankuesit me ane te paraqitjes se nje rekomandimi, i cili ka patur edhe efekt pergjithësues.

Sherbimi postar eshte nje shoqeri me kapital teresisht shteteror dhe si e tille ai mbulon nje aktivitet te konsiderueshem ne fushen e telekomunikacionit ne vend. Per kete qellim Avokati i Popullit ka filluar te fokusohet gjithnje e me shume ne permbushjen sa me te rregullt dhe brenda standarteve te veprimtarise se ketij sherbimi ndaj individeve, duke kryer madje edhe nderhyrje ligjore per permiresimin e tij. Konkretisht ne vijim do te paraqesim nje rast te zgjidhur pozitivisht, i cili perfaqëson nje praktike pergjithsuese administrative per menyren me ane te se ciles Avokati i Popullit nderhyn prane ketij organi ne mbrojtje te te drejtave dhe interesave te ligjshme te individeve.

Prane Institucionit te Avokatit te Popullit, eshte paraqitur ankese e nje shtetasi, i cili duke qene pensionist me banim ne Korçe, ngriti shqetesimin se punonjaset e Postes se Arkes Nr.3 Korçe kishin refuzuar te pranonin terheqjen e pensionit nga djali i tij, me arsyen se ai nuk disponon autorizim noterial nga babai. Kjo kerkese e Zyres se Postes, ankuesit i eshte dukur e padrejte, pasi ne baze te nenit 73 te Kodit Civil prokura per te terhequr pensione mund te vertetohet edhe nga administratori i lagjes se qytetit ose nga kryeplaku i fshatit. Nisur nga ky

pretendim, qytetari ka kerkuar ndihmen e Avokatit te Popullit per te sqaruar ligjerisht rrethanat e kesaj ceshtje.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me permbajtjen e kesaj ankese, ka kerkuar fillimisht nje informacion te detajuar nga ana e Filialit te Postes sha Korçe, lidhur me menyren se si terhiqen pensionet dhe cila eshte baza ligjore qe zbatohet ne kete rast per te justifikuar formen noteriale te dokumentit te kerkuar.

Me ane te pergjigjes se paraqitur Drejtoresha e Filialit te Postes sha Korçe ka sqaruar se menyra dhe kriteret e terheqjes se pensionit nepermjet zyrave te Postes sha jane te parashikuara dhe zbatohen ne perputhje me Akt-Marreveshjen dt.08.08.2003 te lidhur midis Institutit te Sigurimeve Shoqerore dhe Postes sha Shqiptare me objekt *“Per pagimin e perfitimeve nga Sigurimet Shoqerore”*.

Konkretisht ne permbajtjen e kesaj marreveshje ne paragrafin III Dispozita te Perbashketa pika 2 eshte parashikuar se:

“1.Kur pensionisti nuk ka mundesi te paraqitet ne Zyren Postare te Postes sha Shqiptare per te terhequr pensionin:

a-Pensionistit i dergohet pensioni ne shtepi sipas rregullave te caktuara nga Posta Shqiptare,

b-Pensionisti ka te drejte te autorizojte nje person tjeter me prokure, ne baze te neneve 72 dhe 73 te Kodit Civil. Personi i autorizuar me prokure per terheqjen e pensionit paraqet ne qendrat e pageses keto dokumenta:

-Librezet e pensionit te pensionistit

-Prokuren e perfaqesimit

-Çertifikaten me fotografi te personit te autorizuar per terheqjen e pensionit. (Prokura e perfaqesimit dhe çertifikata me fotografi mbahen nga qendra paguese).

Avokati i Popullit, pasi u njoh dhe analizoi ne teresi permbajtjen e Akt-Marreveshjes ku behej fjale per menyren e terheqjes se pensionit, gjykoi se kjo pjese e ketij dokumenti duhet te zbatohet ne praktike ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe konform interesave ekonomike te pensionisteve. Ky perfundim erdhi si rezultat i sanksionimit te disa lehtesirave qe parashikon Kodi Civil per terheqjen e pensioneve, te cilat nuk jane mbajtur parasysh ne hartimin e Akt-Marreveshjes se mesiperme.

Ne nenin 73 te Kodit Civil midis te tjerash eshte parashikuar se:

“Prokura per te terhequr pensione mund te vertetohet edhe nga a).administratori i lagjes se qytetit ose kryeplaku i fshatit” si dhe nga nje sere drejtues te organeve te tjera shteterore ku personi perfitues eshte i strehuar perkohesisht”. Si rrjedhim i kesaj dispozite eshte e kuptueshme se legjislatori ka dashur te lehtesoje shtresen sociale te pensionisteve nga nje sere veprimesh dhe shpenzimesh te teperta noteriale gjate terheqjes se pensioneve. Kjo per faktin se shpenzimet per noterizime apo per nxjerrjen

mujore te çertifikatave te personit te autorizuar, perveçse perbejne nje rutine burokratike te panevojshme, jane edhe nje shpenzim i konsiderueshem per nivelin e ulet te pensioneve aktuale. Prandaj u propozua heqja e detyrimit per paraqitjen e autorizimit te noterizuar nga perfaqesuesi dhe te çertifikates se tij personale. Keto dy elemente ashtu siç u shprehem edhe me lart mund te zevendesoheshin me autorizimet e sigluara nga organet kompetente dhe me paraqitjen e pasaportes se personit te autorizuar. Kjo praktike perdoret nga Posta Shqiptare, ne rastet e terheqjeve te kolive postare, te cilat gjithsesi kane nje vlere materiale. Ne keto kushte u gjykua gjithashtu se edhe menyra e identifikimit te ishte e nejte me praktika te ngjashme qe aplikohen nga organet e tjera shteterore.

Avokati i Popullit ne kete rekomandim mbajti parasysh jo vetem dispozitat ligjore nepermjet te cilave duhet te rregullohej permbajtja e lartpermdur e Akt-Marreveshjes, por edhe kontributin qe duhet te ofrohet nga administrata publike per te lehtesuar sa me shume moshen e thyer nga orvajtjet e panevojshme burokratike.

Me ane te pergjigjes se paraqitur per kete rekomandim nga Drejtori i Pergjithshem i Postes sha eshte njoftuar se ky organ ne mbeshtetje te propozimeve tona dhe per zbatimin me korrektesi te nenit 73 te Kodit Civil, ka hartuar nje qarkore drejtuar filialeve e degeve te Postes Shqiptare per zbatimin sa me te drejte te dispozitave te Kodit Civil. Lidhur me momentin e dyte te rekomandimit, ku u kerkua heqja e detyrimit per paraqitje dhe te certifikates me fotografi te personit te autorizuar per terheqjen e pensionit, Drejtori pranoi se nje fotokopje e pasaportes se personit ishte e mjaftueshme per identifikimin e tij, aq me teper qe ne prokuren e vertetuar nga noteri, kryeplaku i fshatit apo administratori i lagjes se qytetit, shenohen te gjitha gjeneralitetet e personit te autorizuar (perfshire numrin e pasaportes).

Me ane te reagimit pozitiv te titullarit te Posta sha, Avokati i Popullit jo vetem qe ndihmoi per qartesimin dhe korrigjimin e nje sere veprimesh te parregullta qe kryeheshin nga deget e sherbimit postar ne rrethe, por evidentoi ne parim faktin se sherbimet publike qofte edhe ato te telekomunikacionit, duhet medoemos te permbajne lehtesira konform ligjit, duke u shkundur nga praktika te vjetra burokratike. Gjithsesi pavaresisht kesaj nderhyrje Avokati i Popullit do te vazhdoje te mbaje ne vemendje sherbimet e postes, per te veçuar dhe paraqitur propozime te tjera ne ato raste ku do te konstatohen parregullsi te dukshme ne sherbimin ndaj qytetareve.

d) Ish Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit

a) Ankesa të ndryshme për ish Ministrinë

Për shkak të problematicës së trajtuar e që ka patur të bëjë me ish MRRT dhe Turizmit, në këtë raport po paraqesim në mënyrë të vacantë rastet e trajtuara gjatë vitit 2005 përpara ristrukturimit të Qeverisë.

Për vetë ish Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2005 ka shqyrtuar 24 ankesa, nga të cilat 7 janë mbartuar nga viti 2004. Nga këto kanë përfunduar 21 ankesa dhe 3 janë në shqyrtim të siper. Nga ankesat e përfunduara 3 janë zgjidhur në favor të ankuesve, 4 kanë qënë të pabazuara, 14 kanë qënë jashtë juridiksionit. Nga këto 2 kanë përfunduar me rekomandime.

Nisur nga problematika e ankesave, mund të themi se nuk ka ndryshime të dukshme nga fenomenet e verejtura dhe të pasqyruara në raportet e meparshme. Kryesisht përmendim çështjet që lidhen me strehimin, pasi kjo Ministri akordon dhe delegon fondet perkatese organeve të pushtetit vendor, të cilat nga ana e tyre në bashkëpunim me Entin e Banesave, kanë të drejtën e vendimarrjes për trajtimin e të pastreheve, sipas kategorive respektive.

Gjatë shqyrtimit të ankesave që lidhen me këto Ministri, janë verejtur raste që lidhen me shpronësimet për interesa publike dhe problemet që kanë dalë gjatë këtij procesi, mos përfitim i kompensimeve apo ankesa kundrejt masës së kompensimeve, mos ekzekutim vendimesh gjyqësore, mos zbatimin e ligjit Nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”, etj. Kjo sepse pretendohet, se shtetasit nuk janë të informuar lidhur me akordimin e fondeve të cilat u delegohen organeve vendore, për mbulimin e nevojave të ndryshme të komunitetit. Nga ana e tyre edhe këto të fundit, nuk kanë transparencën e duhur kundrejt komunitetin, në shërbim të të cileve jepen këto fonde, duke lënë shteg për abuzime dhe vlerësime ndoshta dhe të gabuara ndaj funksionareve, apo personave të veshur me pushtet publik.

Në vitin 2005 ka qënë serisht evidente ankesa e shtetasve, që lidhet me moszbatimin e VKM-së Nr.85, datë 2.03.1994 “Për vënien në dispozicion të zonave të banimit për familjet që shpërngulen nga Ujëmbledhësi i Bovillës dhe ato që kanë ndërtuar pa leje, përreth qytetit të Tiranës”, si dhe të nenit 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, çështje e cila është bërë prezent edhe raportet e meparshme. Mund të informojmë se pas rekomandimeve të zyres tone, problemi ka mbetur vetëm në ngritjen e grupit të punës. Por ende nuk ka një zgjidhje përfundimtare në favor të ankuesve, për mungesë fondesh. Duke besuar se angazhimi institucional do të bëjë të mundur zgjidhjen e kesaj çështje, sa të drejtë aq dhe të ligjshme të shpresojmë se në të ardhmen të mund të kemi një zgjidhje pozitive.

Problemet që kanë dalë dhe janë evidentuar deri tani nga ndertimi i Ujëmbledhësit të Bovillës, përveç grupit të mesiperm që lidhen me mos ekzekutim të vendimeve gjyqësore, janë edhe ato të paraqitura nga

familjet e shpernguluara dhe te vendosur ne fshatin Bulçesh i Ri, Bashkia Kamez. Keto familje i jane drejtuar Avokatit te Popullit dhe i kane paraqitur shqetesimin lidhur me vonesat disa vjeçare te organeve qendrore dhe atyre vendore per mos-sistemimin perfundimtar te tyre dhe mos dhenien e kompensimit per shpronесimin e pronave te tyre te palujtshme te permbytura.

Keshtu me VKM-në nr.317, date 19.6.1995 ndryshuar me V.K.M. nr.567, date 2.9.1996 dhe V.K.M nr.297, date 15.5.1998 percaktohen parcelat dhe siperfaqja e pergjitheshme e tokes bujqesore qe vihet ne administrim te Komunes Kamez per sistemimin me truall ndertimi dhe pjeserisht me toke bujqesore per familjet e fshatit Bulçesh, ngarkimin e ish Ministrise se Puneve Publike, te Rregullimit te Territorit dhe Turizmit per ndertimin e objekteve social-kulturore, duke percaktuar daten 31 Mars 1997 si afatin maksimal per perfundimin e punimeve te çvendosjes te fshatit Bulçesh, si dhe caktimin e fondit prej 81.920 mije lekesh per shpronесim dhe sistemimin e familjeve dhe publikimin e listes per shpronесim dhe kompensim te 57 familjeve te fshatrave Zall Mner dhe Bulçesh.

Pikerisht mos zbatimi i ketyre vendimeve nga organet perkatese te administrates qendrore dhe vendore, ishte objekt i ankeses me te cilen kerkohet pershpajtimi i procedurave per realizimin e detyrave te percaktuara ne Vendimet e Keshillit te Ministrave per sistemimin dhe dhenien e mases se vleres per shpronесimet e pasurive te paluajtëshme te permbytura nga Ujembledhesi i Bovilles. Kjo ankese eshte ende ne shqyrtim nga ana e Zyres tone.

Duke qene se problemi i strehimit eshte i mbartur ne vite, fakt i cili shton dhe veshtiresine e zgjidhjes, ne Institucionin tone adresohen shume ankesa me objekt te tille. Ne kete kontekst eshte per t'u pergezuar miratimi i Ligjit Nr.9232, date 13.05.2004 "Per programet sociale per strehimin e zonave urbane", ne te cilen percaktohen rregulla dhe procedurat administrative, per menytrat e sigurimit dhe shperndarjes se fondeve, ne te cilen parashikohen dhe shume alternativa zgjidhje per kategorine e te pastreheve, i dhe shume akte te tjera nenligjore te cilat bejne te mundur zbutjen e ketij problemi madhor kombetar. Keshtu vlen te permendim VKM Nr.814 date 3.12.2004 "Per percaktimin e normave te strehimit", si dhe vendimi "Per dokumentat dhe procedurat qe duhet te ndjekin perfituesit nga ky ligj", si dhe Vendimin per perberjen, organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombetar te Strehimit, se bashku me rregulloren per funksionimin e ketij Komiteti. Pra nismat e ndermarra edhe nga Qeveria aktuale e cila ka treguar vullnetin e nevojshem politik, pasi qe ne fillimet e punes se saj mblodhi Komitetin Kombetar te Strehimit per hartimin e strategjive perkatese, eshte nje tregues se ky problem eshte ne rrugen e drejte te zgjidhjes, per te cilen

deri vjet verehej nje boshllek ligjor, si dhe mungese te strukturave qe bejne te mundur hartimin e politikave per zgjidhjen e strehimit.

Gjate ketij viti me kete Ministri, vecojme ankesen e qytetarit H.Q., banor i fshatit Bushat, te rrethit te Shkodres, i cili prezantonte shqetesimin per mosdhenien e lekeve te shpenzimeve te varrimit per djalin e tij S.C. te vdekur aksidentalisht ne Itali, per te cilen Ministria nuk vepronte, duke zvarritur procedurat e nevojshme 1.1.1990. *Shpenzimet e ketij sherbimi mbulohen nga shteti*".

"Per shtetasit shqiptare qe vdesin jashte territorit te Republikes se Shqiperise, kur shpenzimet e transportit perballohen nga familjaret e te ndjerit , buxheti i shtetit rimbursen nje pjese te ketyre shpenzimeve.

Duke e pare si detyrim ligjor, pas nderhyrjes se Zyres tone, ish MRTT aktualisht Ministria e Puneve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit, i kerkoi Deges se Thesarit celjen e shumes perkatese familjareve te te ndjerit S C.

Gjithashtu, iniciuar nga kjo ceshtje problemi me Ministrine u pa me gjere, duke kerkuar qe kjo e fundit nepermjet Ministrise se Financave, te kerkonte celje fondi shtese jo vetem per ankuesin qe na u drejtua, por dhe per 150 familje te tjera te mbetura pa shlyer per mungese fondesh me kete destinacion.

Meqenese ky problem ka efekte financiare, pra arsyeja e mopermbushjes se ketij detyrimi ligjor aktualisht nga Ministria e Puneve Publike dhe Transportit e Telekomunikacionit eshte mungesa e fondeve, nga Ministria e Financave u kerkua qe ky problem te behet prezent ne projekt- buxhetin e vitit 2006.

Per kete ceshtje evidentuam precedentin e Vendimit te Gjykates te Drejtave te Njeriut ne Strasburg, qe shqyrtoi ne fund te vitit 2004 te paren ceshtje shqiptare Cufaj &Co kunder Shqiperise, qe kishte te bente me mos ekzekutimin e nje vendimi gjyqesor te formes se prere nga nje debitor institucion shteteror, ne te cilen nenvizohej fakti se : "*as mungesa e fondeve nga ana e autoriteteve nuk e justifikon mos ekzekutimin e nje vendimi gjyqesor*".

Nga gama e gjere e ankesave te ndjekura me kete Ministri vecojme ankesen I.B nga qyteti i Gjirokastrës, i cili ngriti shqetesimin per nje vleresim te padrejte te siperfaqes se truallit qe do t'i shpronesohej per interes publik ne shetitoren "18 shtatori" Gjirokaster. Sipas pretendimeve te ankuesit raporti i vleresimit perfundimtar te mbajtur nga Komisioni i Posaçem i Shpronesimit ne Ministrine e Rregullimit te Territorit dhe Turizimit, eshte i pajustificuar dhe teper i ulet krahasuar me vleren e tregut.

Avokati i Popullit, kerkoi te informohej hollesisht nga ana e Komisionit te Posaçem te Shpronesimit ne Ministrine e Rregullimit te Territorit dhe Turizmit (MRTT), lidhur me procedurat ligjore te aplikuar

per vleresimin e truallit dhe menyren nepermjet se ciles do te merrej ne konsiderate pretendimi i ankuesit per nje vlere me te larte.

MRTT-se sot Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve, ka sqaruar se Komisioni i Posaçem i Shpronetimeve do te marre ne shqyrtim kerkesen konform legjislacionit te shpronetimeve. Ne keto kushte Avokati i Popullit garanoi ndjekjen ne vijimesi te ceshtjes prane kesaj Ministrie, pasi dhe kjo e fundit dha garanci per pershejtimin dhe trajtimin korrekt te problemit.

Do te veconim ne problematiken e gjere qe ka kjo Ministri dhe nje grup ankesash, te cilat lidhen me zbatimin e ligjit Nr.9304 date 28.10.2004 “Per legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”. Keshtu eshte evidentuar ankesa e Shoqates se banoreve “Bregalumasi” Laprake, ankesa e Perfaqësise se Bathores, apo e perfaqësise se Komunitetit Paskuqan, te cilat ne thelb lidhen me kundershkrimin qe i behet *metodologjise se propozuar dhe te miratuar nga Kuvendi*, per kryerjen e procesit te legalizimeve.

Nje rendesi te vecante per rregullimin e drejte te ceshtjeve te se drejtes se pronesise, kane dhe ndryshimet e pritshme te ligjit Nr.9235 date 29.07.2004 “Per kthimin dhe Kompensimin e Prones”, te cilat ndodhen ne proces diskutimi ne Komisionet Parlamentare.

Gjithashtu vlen te pershendetet dhe nisma e ndermarre per hartimin e Projektligjit per legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje, i cili keto dite pret te shqyrtohet ne Komisionet Parlamentare. Ky projektligj sipas Qeverise, vendos ne fokus qytetarin e thjeshte dhe shtresat ne nevoje dhe parashikon qe procedurat qe duhet te kryejne personat qe do te legalizojne ndertimet e tyre pa leje, te jene sa me te thjeshta dhe gjithë procesi te perfundoje ne nje kohe sa me te shkurter. Sipas ketij ligji zgjidhja e ofruar nga Qeveria eshte: ”Kompensim i plote me vleren e tregut te te gjithë ish pronareve”.

9. Ministria e Ekonomisë, Tregtise dhe Energjitikes

Per vitin 2005 ka patur vetëm 19 ankesa, ku 17 kane qene per Ministrine e Ekonomisë dhe 2 ankesa per Ministrine e Industrise dhe Energjitikes, te cilat ne Shtator te Vitit 2005 u bashkuan nen emertesën e re si Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes. Nga keto ankesa, 8 prej tyre pas shqyrtimit kane rezultuar te pabazuara dhe jashte juridiksionit, 4 jane zgjidhur ne favor te ankuesve, nga të cilat njëra me ane te nje rekomandimi, 5 kane qene te mbartura nga vitit 2004 dhe jane perfunduar gjate vitit 2005 dhe 2 ankesa vazhdojne te jene ende te shqyrtim. Ne vijim po paraqesim ankesat e zgjidhura pozitivisht, duke nxjerrë edhe problematikat kryesore me te cilat perballet puna e perditshme e Avokatit te Popullit me Ministrine e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes dhe strukturat administrative ne varesi te saj.

1. Prane Institucionit te Avokatit te Popullit, u paraqit ankesa e L.K, ne te cilen ngrihej shqetesimi, lidhur me futjen ne perdorim te letrave me vlere, ne procesin e privatizimit te objekteve, te percaktuara per kete qellim. Sikunder shprehet ankuesi letrat me vlere, megjithese Kuvendi ka miratuar me aktin e tij perkates shtyrjen e afatit te skadences se tyre deri ne vitin 2005, ato nuk jane futur ende ne perdorim per privatizimin e objekteve te rendesishme ne sektoret jostrategjike, nderkohe qe ky proces po vazhdon. Nisur nga rendesia qe paraqiste respektimi i te drejtave ekonomike te fituara me ligj nga shtetasit shqiptar, per te vene ne perdorim letrat me vlere, Avokati i Popullit kerkoi nje informacion te hollësishem ne te gjitha organet kompetente qe kishin per detyre realizimin e kesaj të drejte ligjore. Ne vijim te kesaj, nisur edhe nga nje numer i madh ankesash te paraqitura per kete çështje, Avokati i Popullit paraqiti rekomandim prane Keshillit te Ministrave per te bere te mundur inicimin e nje projekti te ri për futjen në përdorim te letrave me vlere ne tregun e brendshem, propozim i cili u mireprit nga Qeveria Berisha, dhe se fundi u paraqit ne Kuvend per miratim.

2. Prane Institucionit te Avokatit te Popullit shtetasi B.V paraqiti nje ankese lidhur me largimin e tij nga puna si inspektor i Policise Elektrike bazuar ne Urdherin nr.110, date 20.04.2004, “Mbi miratimin e struktures se Policise Elektrike”, te nxjerre nga ish-Ministri i Industrise dhe Energjitikes. Nga shqyrtimi i kesaj ceshtje Avokati i Popullit konstatoi se ne aktin e lirimimit eshte arsyetuar se ankuesi ishte liruar nga detyra per shkak te papajtuësmerise se nivelit arsimor me kriteret e vendosura ne urdhrin e siperpermendur. Lidhur me kete ceshtje, u kerkua nje informacion i gjere per trajtimin e ankeses te ketij ish punonjesi dhe per bazen ligjore të nxjerrjes së ketij urdhri nga ish-Ministri i Industrise dhe Energjitikes.

Sekretari i Pergjithshem i kesaj Ministrie, dergoi nje informacion duke sqaruar se urdhri i siperpermendur ka dale ne baze te Ligjit nr.8637, date 6.7.2000, "Per Policine Elektrike"; ndryshuar me ligjin nr.9170, date 22.01.2004, 'Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr.8637, date 06.07.2000, "Per Policine Elektrike", dhe pikerisht neneve 15 dhe 15/1 ku percaktohet se: *Ngarkohet Ministri pergjegjes per sektorin elektroenergjitik te nxjerre akte nenligjore ne zbatim te nenit 15.*

Ne urdhrin nr.110, date 20.04.2004 "Per miratimin e struktures se Policise Elektrike" ishte percaktuar se specialisti inspektor duhet te kete arsim te larte Ing.Elektrik ose Ushtarak. Duke qene se ankuesi nuk kishte permbushur kete kriter, sepse kishte arsim te larte juridik, kjo perbente shkak per largimin te tij nga puna. Pas analizes te kesaj pergjigje, referuar legjislacionit, Avokati i Popullit konstatoi se ne Ligjin nr.8637, date 6.7.2000 "Per Policine Elektrike" jane percaktuar kriteret qe duhet te kete nje shtetas per t'u pranuar punonjes i policise elektrike, duke mos e theksuar llojin e shkolles se larte, por vetem faktin qe punonjesi te kete nje shkolle te larte ose te mesme.

Nderkohe ne nenin 15 te ligjit te siperpermendur ishte percaktuar ne menyre taksative se;

Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit miraton organiken dhe fondin e pagave per Policine Elektrike, i cili per periudhen deri ne vitin 2000 perballohet nga fondet e Korporates Elektroenergjitike shqiptare dhe pas kesaj periudhe perballohet nga buxheti i shtetit, si dhe lidhjen e pages e te shperblimeve suplementare me realizimin e detyrave.

Me ndryshimet e ketij neni, eshte percaktuar se;

"Ngarkohet ministri pergjegjes per sektorin elektroenergjitik te nxjerre aktet nenligjore ne zbatim te nenit 15 te ketij ligji".

Referuar nenit 15 te ligjit, rezulton qe ministri eshte kompetent vetem per organiken dhe fondin e pagave per Policine Elektrike. Pra per strukturen, atij nuk i ishte dhene kompetence per percaktimin dhe detajimin e kriterëve per marrjen ne pune te punonjesve te policise elektrike. Ndryshe do te kishte qene çeshtja nese me shtesat qe jane bere, te ishte percaktuar se Ministri nxjerr akte nenligjore ne zbatim te nenit 15 dhe nenit 7 (ku jane vendosur kriteret e punesimit te punonjesve) te ketij ligji. Kriteret dhe organika jane koncepte krejt te ndryshme, prandaj dhe ligjvenesit nuk i kishte perfshire ne te njejtin nen ne ligj. Ne kete rast eshte patur parasysh qe lloji i arsimimit eshte kriter punesimit dhe nuk ka lidhje me fondet apo organiken. Pra Ministri mund te percaktonte strukturen sic dhe ka vepruar nepermjet ketij urdhri, pa u futur ne specifikimin e llojit te shkolles se larte qe duhet te kene punonjesit. Ligji i ka kufizuar te drejten e vendosjes se kriterëve Ministrin dhe ai ne asnje rast nuk mund te dale mbi ligjin, siç eshte vepruar ne rastin konkret. Ne rast se Ministri e quante te arsyeshme se specialistet e policise elektrike duhet te kene arsim te

larte ing.Elektrik ose Ushtarak, atehere ai duhet te ndermerrte iniciativen ligjore per plotesime dhe ndryshime ne ligj, ku t'i jepej e drejta e vendosjes se kriterëve te punesimit, por jo te vepronte ne kundërshtim me permbajtjen e vete ligjit ekzistues.

Nisur nga keto arsytetime, del se ish-Ministri i Industrise dhe Energjitikes në kundërshtim me përmbajtjen e ligjit, i ka refuzuar të drejten e punesimit si specialist i policise elektrike ankuesit.

Mbi kete llogjike dhe baze ligjore Avokati i Popullit i kerkoi me ane te nje rekomandimi ish-Ministrin te Industrise dhe Energjitikes revokimin e nje pjese te urdhrin te siperpermendur, rekomandim te cilin ai e refuzoi. Te ndodhur perballe kesaj situate, Avokati i Popullit ju drejtua Kryeministrin, duke kerkuar si organ epror shfuqizimin e asaj pjese te Urdherit nr. 110 date 20.04.2004, ku percaktohej lloji i shkolles se larte per punonjesit e Policise Elektrike. Ne pergjigje te ketij rekomandimi, Kryeministri u pergjigj se eshte kerkuar rishikimi i ketij urdhri nga Ministria e Industrise dhe Energjitikes, procedure ne te cilen do te merreshin parasysh edhe kerkesat ligjore te parashtruara nga ana jone. Ne vijim te kesaj u ngrit edhe nje grup pune nga ana e ish-Ministrise se Industrise dhe Energjitikes. Por per shkak te kundërshtimit te ketij akti administrativ ne rruge gjyqesore nga ana e ankuesit, kjo çeshtje u pezullua per tëu zgjidhur perfundimisht ne rruge gjyqesore. Gjithsesi pa u ndalur ne zhvillimet e mevonshme te kesaj çeshtje, Avokati i Popullit ka krijuar bindjen e plote ligjore se revokimi i nje pjese te urdhrin te lartpermendur, ishte e vetmja rruge per te zbatuar me korrektesi legjislacionin ne fuqi.

3. Prane Zyres se Avokatit te Popullit u paraqit nje ankese nje grup punonjesish te Uzines se Tunelizuar, njesi e Uzines Mekanike të Naftes Kuçove. Objekt i ankeses ishte klasifikimi ne kategorine e dyte te punes per efekt perfitimi te pensionit te pleqerise. Si pasoje moshë e daljes ne pension e tyre ishte 65 vjeç, gje qe nuk i pergjigjej sakrificave dhe kushteve te veshtira ne te cilat ata kishin punuar. Ndaj per kete arsye ata u shprehen se i jane drejtuar Ministrin te Industrise dhe Energjitikes dhe Ministrin te Punes dhe Çeshtjeve Sociale, ne menyre qe të perfitonin ligjerisht nje trajtim te veçante dhe ulje te moshes se daljes ne pension, ashtu si dhe kategoria e pare. Por per kete kerkese nuk kishin marre asnje pergjigje. Avokati i Popullit pasi u njoh me kete ankese, ndermori menjehere nderhyrjet e duhura ligjore prane Ministrise se Punes dhe Çeshtjeve Sociale dhe Ministrise se Industrise dhe Energjitikes.

Ne perfundim te trajtimit te kesaj ceshtje u arrit te sqarohet nga te dyja ministrin se ne zbatim te nje urdhri të kryeministrin, ishte ngritur nje grup nderinstitucional per kryerjen e studimit "*Mundesite dhe menytrat per zbutjen e efekteve qe rrjedhin nga rritja e moshes se daljes ne pension, per punonjesit qe kryejne pune te veshtira*". Ky studim ishte

diskutuar me pas ne mbledhjen e Keshillit Kombetar te Punes dhe i ishin bere edhe plotesimet e rekomanduara. Ne materialet e paraqitura nga Ministria e Industrise dhe Energjitikes ishin perfshire dhe te dhenat e te gjitha shoqerive te naftes, ku perfshihej edhe UMN shpk Kuçove. Me tej, studimi se bashku me variantet e propozuara i ishte paraqitur Keshillit te Ministrave per vleresim dhe miratim.

4. Prane Institucionit te Avokatit te Popullit u be prezent shqetesimi i nje ankuesi, lidhur me nderprerjen e marredhenieve te tij te punes me Ndermarrjen e Trajtimit te Studenteve Nr.1 Tirane, pa asnje baze ligjore apo motivacion. Per kete shqetesim ai sqaroi se ka qene i punesuar ne kete ndermarrje per nje periudhe te gjate ne detyren e sportelistit ne nje godine te Qytetit Studenti. Ne Nentor 2005 ankuesi ka qene me raport mjekesor dhe me paraqitjen e tij ne detyre eshte njoftuar se duhej te largohet nga puna, pa e informuar per motivin e ketij largimi.

Avokati i Popullit pasi u njoh me kete ankese dhe pasi nderhyri prane Drejtorise se kesaj Ndermarrje, me qellim rivendosjen ne vend te se drejtes se shkelur, arriti te binde keta zyrtare mbi qendrimin ligjor qe duhet te mbahej ne rastin konkret, duke ju referuar edhe dispozitave perkatese te Kodit te Punes. Pasi kjo çeshtje u be serish objekt shqyrtimi administrativ ne Drejtorine e Ndermarrjes se Trajtimit te Studenteve Nr.1 Tirane, u arrit te vendosej rikthimi ne detyren e meparshme te ankuesit.

Si konkluzion per veprimtarine e Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes, Avokati i Popullit veren se kjo ministri dhe organet ne vartesi te saj vazhdojne te vuajne nga mosnjohja dhe mos zbatimi i ligjit sipas standarteve bashkekohore te mireqeverisjes. Kjo situatë e njohur nepermjet ankesave konkrete nxjerr detyre per Avokatin e Popullit, që ne te ardhmen te vazhdoje te monitoroje veprimtarine e ketij institucioni, me qellim permbushjen dhe garantimin e te drejtave dhe interesave te ligjshme te individeve.

a) Ankesat për Korporatën Elektroenergjitike (KESH) Sh.A.

Gjatë vitit 2005 Avokati i Popullit ka trajtuar 60 ankesa dhe kërkesa kundër KESH-it, nga te cilat 19 kane qene te mbartura nga viti 2004 dhe 41 kane ardhur gjate vitit 2005. Ankesat e mbartura nga viti 2004 jane perfunduar plotesisht, ndersa nga 41 ankesat e paraqitura gjate vitit 2005, 8 janë zgjidhur pozitivisht, 19 prej tyre mbas verifikimit kanë rezultuar të pabazuara, 11 kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetencave, 3 ankesa vazhdojmë te jene ende në shqyrtim. Krahas ketyre eshte paraqitur edhe nje rekomandim i pranuar pozitivisht per permiresimin e veprimtarise se KESH sha.

Vlen te permendet fillimisht se gjate vitit 2005 te gjitha ankesat e zgjidhura pozitivisht nga ana e Avokatit te Popullit kane qene te lidhura ngushtesisht me nderhyrjet tona prane KESH sha per te persheptuar nje

verifikim dhe zgjidhje të shpejte të ankesave të individëve, në lidhje me faturimet e pasakta dhe rimbursimin e tyre.

Kesh sha vazhdon të mbetet një nga shoqëritë me kapital teresisht shtetëror me ndikim mjaft të madh në të drejtat ekonomike dhe interesat e ligjshme të qytetarëve. Kjo kompani me aksioner të vetëm shtetin, megjithë veprimtarinë e saj funksionale të sigurimit, transmetimit, shpërndarjes dhe faturimit të energjisë elektrike nuk ka mundur të shpëtojë një nivel të lartë keqadministrimi në raport me interesat e qytetarëve. Gjatë gjithë kësaj periudhe kjo korporatë është kritikuar në vazhdimësi për punën e saj dhe për shkeljet e shumta të kontratës së furnizimit me energji apo të ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

Avokati i Popullit ka bërë mjaft ndërhyrje në të kaluarën për të përmirësuar kontratën e furnizimit me energji, për të ulur tarifën e energjisë apo për të përmirësuar shërbimet që Kesh sha ofron ndaj klientëve dhe për të rritur standartet e mirëadministrimit të kësaj shoqërie. Të metat dhe fenomenet negative, të cilat janë hasur në Kesh sha janë detajuar në vijim nëpërmjet disa elementeve kryesore, të cilat në gjykojmë se përbejnë bazën e të metave të punës të KESH sha.

1. Refuzimi i vazhdueshëm i Kesh sha dhe Entit Rregullator të Energjisë për të bashkëpunuar në lidhje me uljen e tarifave të energjisë sipas rezultateve të ekspertizës nga një grup akademikësh dhe shkencetarësh të fushës me asistencën ligjore të Avokatit të Popullit.

Megjithë rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe angazhimin e një sere organesh dhe organizmash të tjera si Akademia e Shkencave, Profesoriati i Universiteteve etj, deri me sot nuk është bërë e mundur që tarifën e energjisë elektrike të ulen sipas përlogaritjeve të nxjerra nga një studim i veçantë dhe mjaft real i një grupi ekspertësh të mbledhur nga organet e sipërpermendura. Kjo iniciativë e vënë edhe në vëmendje të Kuvendit dhe Keshillit të Ministrave ngelet ende një mision që duhet të vazhdojë me këmbëngulje, me qëllim zbatimin e tarifave të arsyeshme konformë legjislacionit në fuqi, kostos, nivelit të varferisë dhe fuqisë paguese të shtetasve.

Sipas të dhënave një kilovat energji elektrike nga hidrocentralet tona prodhohet jo me shumë se 1.5 leke, kurse një kilovat energji elektrike nga importi është blerë dhe blihet rreth 5 leke. Për shitjen, tarifën për popullsinë janë rreth 5 leke kw për 200 kw e para, dhe rreth 9 leke kw mbi sasinë 200 kw në muaj. Këto çmime janë pa TVSH që është 20% mbi këtë çmim. Duke patur parasysh se 2-3 vitet e fundit ka patur rreshje me bollëk në kohën e duhur, energjia e importuar ka qenë në sasi jo të mëdha, përjashtuar dimrin që sapo kalon. Duke qenë se një pjesë jo e vogël e popullatës dhe bizneseve vazhdon të mos paguajë energjinë elektrike (humbjet rreth 40%), barren e tyre e paguajnë konsumatorët e ndërsheëm dhe të ndërgjegjshëm. Po të menaxhohet me mirë prodhimi dhe

shperndarja e energjise elektrike dhe te paguajne te gjithë konsumatorët, Avokati i Popullit mendon se ka vend për të rishikuar tarifën e energjisë drejt uljes së tyre, për të bërë një politikë sociale më efektive. Në realitet kjo situatë e paraqitur nga Avokati i Popullit është bërë shpesh herë objekt debatësh, të cilat u finalizuan me krizën e rëndë energjitike që kaloi vendi ynë në prag të fundvitit si pasojë e një keqmanaxhimi diletant të strukturave të KESH sha.

2. Keqadministrim i procedurave ligjore të faturimit të qytetarëve dhe vazhdimi i aplikimit në disa zona të faturimit afrofe dhe të ndeshkimeve kolektive.

Ndeshkimi kolektiv vazhdon të mbetet një mënyrë mjaft e kontestueshme e veprimtarisë së KESH sha ndaj individëve në të cilët përfshihen pa të drejtë edhe ata që janë të rregullt me pagesat e faturave të energjisë. Kjo masë ekstreme ndaj shkelesve është pranuar si e parregullt edhe nga vete drejtuesit e rinj të KESH sha, nga të cilët është marrë zotimi se ajo do të reduktohet deri në eliminimin e plotë. Për këtë çështje, nga ana e KESH sha janë marrë edhe disa masa administrative, por problem kryesor i realizimit të këtij procesi qëndron në sistemin teknik të shperndarjes, i cili nuk lejon selektimin e abonentëve për të bërë të mundur t'i pritët energjia shkelesve të vertetë. Problem tjetër kryesor vazhdon të mbetet leximi dhe faturimi i energjisë elektrike nga ana e filialeve të Kesh sha. Nga të dhënat e Avokatit të Popullit, instalimi i matësve është bërë në rreth 87%, por punonjësit e KESH sha vazhdojnë të faturojnë në disa zona në mënyrë afrofe, duke shkaktuar në këtë mënyrë një shqetesim të ligjshëm tek mjaft abonentë. Nga ana e Avokatit të Popullit janë bërë rekomandime në tre drejtime; së pari në instalimin e sistemit automatik të faturimit "Billing System", i cili shmang faturimin nga manipulimet perkatese, së dyti; në evidentimin e shkeljeve gjatë matjes dhe denoncimin e tyre pranë strukturave të Kesh sha dhe; së treti në përmirësimin e procedurave të leximit të matësve elektrike nga personeli i KESH sha. Për këtë keqadministrim të këtij procesi mjaft të rëndësishëm, janë marrë masa disiplinore gjatë vitit 2004-2005 për gati 150 faturues. Avokati i Popullit do të vazhdojë të mbajë në vëmendje këto fenomene deri në eliminimin e tyre të plotë.

3. Moshë realizimi i planit deri në fund të vitit 2005 të pajisjes së të gjithë konsumatorëve me matës të rinj.

Gjatë vitit 2004 Kesh sha u angazhua të instalonte të gjitha matësat në shkallë vendi duke plotësuar nevojat e abonentëve me një nga elementet kryesor të shërbimit me energji elektrike. Realizimi i këtij angazhimi u ndoq me mjaft vëmendje edhe nga Avokati i Popullit. Por në përfundim të vitit 2004 u konstatua se Kesh sha nuk mundi të mbajë dot premtimin e dhënë. Kjo mangësi u pasqyrua edhe në raportin e vitit 2004 të Avokatit të Popullit dhe vazhdoi të ndiqej si një detyrë mjaft e

rendesishme edhe ne vitin 2005. Fatkeqesisht nga drejtuesit e rinj te KESH sha jemi njohur me faktin se gjate vitit 2006 do te filloje blerja e matesave te rinj ne rreth 130 000 cope, aq sa eshte edhe vete numri i abonenteve pa matesa. Kjo tregon per deshtimin e nje procesi thelbesor ne punen e KESH sha, i cili shtyn ende edhe per nje kohe te pacaktuar pasigurine e perqasjes se standarteve te kerkuara te sherbimeve ndaj klienteve. Avokati i Popullit do te vazhdoje te ndjeke dinamiken e ketij procesi, pa te cilin nuk mund te kuptohet nje sherbim serioz dhe efektiv i furnizimit me energji elektrike.

4. Mungese e lidhjes se kontratave tip te reja me abonentet e vjeter te cilet kane nenshkruar vetem kontratat e vjetra. Lidhja e kontratave te reja te Kesh sha behet vetem me abonentet e rinj, ndryshe nga sa ka qene premtuar.

Nga te dhenat qe disponon Avokati i Popullit ka dale se kontrata e re e Kesh sha lidhet vetem me abonentet te cilet pajisen per here te pare me kontrate, ndersa me abonentet e vjeter kjo kontrate nuk eshte lidhur ende. Ne kete aspekt vlen per t'eu permendur se me mos lidhjen e kesaj kontrate, midis paleve vazhdojne te mbeten ne fuqi mardheniet e percaktuara ne kontraten e vjeter te furnizimit me energji. Ne kete rast per t'ei ardhur ne ndihme kuadrit ligjor dhe kontraktual midis paleve ne interes te respektimit te dispozitave te reja ne favor te klienteve, Avokati i Popullit nderhyri prane Kesh sha per te sqaruar parimisht kete problem. Nga drejtuesi i ri i Shperndarjes se KESH sha per Tiranen eshte marre angazhimi se kjo procedure e pajisjes me kontratat e reja tip ka filluar te funksionojte dhe ne ndihme te saj po shtypen ne tirazh te madh kontrata te reja per t'ejua shperndare qytetareve.

5. Mungesa e efektshmerise se kontrollit ndaj denoncimeve te qytetareve per aparatet mates te energjise, duke zvarritur dhe shmangur evidentimin ne vend te shkeljeve dhe nxjerrjen e pergjegjesive perkatese.

Megjithat miratimin e nje rregulloreje te plote dhe konforme parametrave, per zgjidhjen e shpejte te ankesave te qytetareve prane filialeve te Kesh sha, eshte vene re se zbatimi i saj ne praktike ka mangesi te dukshme. Ne kete rregullore jane te percaktuara afate konkrete per kryerjen e veprimeve verifikuese, eshte mundesuar kontrolli periodik i kushteve te aparateve mates dhe cilesise se energjise qe ofrohet si dhe eshte percaktuar e plote procedura e ankimit te qytetareve deri ne zgjidhjen perfundimtare te problemit te tyre.

Ne realitet prane Avokatit te Popullit vazhdojne te vijne ankesa te ndryshme per Kesh sha te cilat ne themel parashtrojne shqetesimin per faturime te pasakta, pengim dhe zvarritje te permbushjes te se drejtes se tyre per ankim ne Kesh sha. Madje edhe atehere kur ky ankim eshte bere prane ketyre strukturave, nga ana e Kesh sha nuk jane marre masat e duhura ose ato jane zvarritur ne kohe dhe nuk kane dhene rezultatin e

pritur. Si rrjedhim nga ana e Avokatit të Popullit është shqyrtuar në mënyrë të përgjithshme kjo çështje dhe janë nxjerrë të metat dhe mangësitë që ekzistojnë. Në vijim të kësaj Avokati i Popullit ka nderhyrë me anë të një rekomandimi pranë KESH sha me qëllim përmirësimin e procedurave të ankimit dhe verifikimit të tyre, konformë standarteve të efektshmerisë dhe transparencës së plote.

Avokati i Popullit në këtë dokument ka paraqitur një studim përgjithësues të ankesave për zonat me probleme, nga ku është konstatuar se:

1. Punonjësit e leximit të matësive në Sportelin e Shitjes nuk paraqiten sistematikisht në zonë për të ushtruar rregullisht detyrën e tyre, por faturojnë në distancë me mesatare të muajve paraardhës.

2. Në rastet e paraqitjes në zonë ka raste që kryejnë një lexim të parregullt.

3. Nuk arrijnë të argumentojnë diferencat në matje dhe shpesh herë veprimet e tyre matematikore lene për të dëshiruar në ballafaqim me konsumatorët.

4. Në rastet e shkeljeve të konstatuara nga qytetarët arrijnë të bëjnë marrëveshje individuale jozyrtare me këta të fundit për mënyrën e kompesimit të “gabimeve” duke faturuar me pak në muajt në vazhdim, thjesht për të fshehur shkeljet e kryera.

5. Ata jo vetëm që nuk njoftojnë, por kundërshtojnë dhe evitojnë praninë e banoreve gjatë hapjes së boksit për të kryer leximet në matës.

6. Megjithatë kanë orare pritje me konsumtarët që ankohen, nuk paraqiten duke lene të pa sqaruar këta të fundit.

7. Ata përpilojnë proces verbalë të njëanshëm konstatimi të shkeljeve së bashku me inxhinierin e zonës dhe përgjegjësin pa praninë e konsumatorit përgjegjës, duke mos i lene atij të drejtën të parashtrijë pretendimet dhe sqarimet e nevojshme. Madje ky konsumator njihet me shkeljen e konstatuar vetëm kur verën dyfishim të vlerave të faturuara si pasoje e sanksionit që është marrë si dëm ndaj kompanisë Kesh sha.

Në këto kushte, Avokati i Popullit me autoritetin që i jep kushtetuta dhe ligji, propozoi zgjidhjen e problemit të procedurave të leximit të matësive, nëpërmjet ndryshimeve në procedurat që aplikohen nga punonjësit e Sporteve të Shitjes KESH sha për leximin e matësive elektrik si më poshtë vijon:

1. Leximi i matësive të rregullt të konsumatorëve familjare dhe jo familjare të kryhet në prani të një përfaqësuesi të pallatit, banesës apo objektit ku do të ushtrohet kjo veprimtari.

2. Punonjësi i KESH sha i ngarkuar me këto detyra, duhet të paracaktojë ditën dhe orarët e duhura brenda të cilave detyrohet të paraqitet për lexim.

3. Punonjesi i KESH sha ne perfundim te leximit mujor ka detyrimin te pajise perfaqesuesin e konsumatoreve me nje vertetim, ku te pasqyrohet leximi i kryer dhe data e paraqitjes me nenshkrimin e saj.

4. Ne rastet e mungeses se perfaqesuesit gjate leximit, kopja e vertetimit i jepet me firme nje konsumatori tjetër te pallatit, baneses apo objektit fqinjë ose afishohet ne vende te dukshme.

5. Ne rastet e mungeses se perseritur dhe te pajustificuar te punonjesit gjate kohes dhe ores se caktuar per lexim, personi perfaqesues apo çdo konsumator tjetër i interesuar, ka te drejte te njoftoje sportelin perkates te shitjes.

Avokati i Popullit gjykoi se kjo menyre e re e rregullimit te mardhenieve te paleve gjate permbushjes se detyrimeve qe sjell furnizimi me energji elektrike, u mendua se do te gjente zbatim me ane te nxjerrjes se nje urdheri te ri nga ana e KESH sha. Pervec kesaj kjo menyre e re e korrigjimit te te metave te vena re gjate procedurave te leximit te matesave u konsiderua nga Avokati i Popullit si nje zgjidhje afatgjate, e cila do te jape aspekte pozitive ne ridimensionimin e mardhenieve korrekte midis paleve KESH sha-Konsumator. Ne pergjigje te ketij rekomandimi, Ish Drejtori i Pergjithshem i KESH sha Z.Fatmir Hoxha u shpreh se jane dhene urdherat e nevojshem prane filialeve qe te zbatohet per aq sa eshte e mundur prania e banoreve gjate leximit te matesave si dhe te njoftohet per kohen e sakte ne te cilen do te kryhet leximi mujor. Keto dy orientime te reja ne punen e leximit te matesave jane zbatuar ne disa zona problematike ne Tirane. Aktualisht ky sherbim ka filluar te permiresohet edhe fale nje ndergjegjesimi dhe rendesie qe i kane dhene drejtuesit e rinj te KESH sha ketij fenomeni teper negativ.

6. Vonesa ne kthimin e pergjigjeve dhe komunikimeve zyrtare me Zyren e Avokatit te Popullit, duke zgjatur ne kohe zgjidhjen e problemeve te ngritura nga qytetaret.

Bashkepunimi me Kesh sha megjithese ka njohur perparime te dukshme, ka hasur shpesh here pengesa si pasoje e zvarritjeve ne kohe te kthimit te pergjigjeve dhe komunikimit per probleme te ndryshme me interes te ndersjelle. Shpesh here organeve te Kesh sha i eshte bere i njohur detyrimi ligjor per te bashkepunuar me Avokatin e Popullit dhe per kete qellim jane bere edhe takime te posaçme me drejtues te veçante. Ne kete aspekt mendojme se me permiresimet qe ju bene ligjit per Avokatin e Popullit, bashkepunimi me Kesh sha do te kaloje ne nje faze te re dhe te konsoliduar. Per kete qellim, Avokati i Popullit do te filloje zbatimin e kerkesave per sanksionet ligjore rast pas rasti ndaj punonjesve te Kesh sha, per te realizuar nje ndergjegjesim sa me te qarte per konsequencat negative qe rrjedhin si pasoje e mos bashkepunimit ne interes te mbrojtjes se te drejtave te konsumatorit.

Nje tjeter menyre per te permbushur me shume detyrat tona eshte ekspertiza e vendimeve te ERE-s dhe nxitja e Kesh sha per venien e tyre ne zbatim, ne rast se permbajtja e tyre paraqet nje interes te ligjshem per realizimin e te drejtave te qytetareve.

Prandaj Avokati i Popullit ka filluar te fokusohet ne disa vendime te ERE-s per te cilat KESH sha nuk ka marre asnje mase konkrete per zbatim. Keto vendime konsistojne ne kompesimin per faturimet afrofe (ne rastet kur nuk ka matesa) qe KESH sha ka kryer mbi nivelet e percaktuara nga vendimet e ERE-s. Pervec kesaj po hetojme per faturimet afrofe te kryera nga KESH sha gjate muajve Nentor-Dhjetor 2005, pra gjate krizes se kufizimeve te energjise elektrike, faturime te cilat kemi dyshimin se jane kryer pa mbajtur parasysh zgjerimin e kohes se kufizimeve dhe vendimet perkatese te ERE-s per kete qellim. Ne rast se kjo ceshtje do te konkludohet se permban parregullsi te dukshme dhe shkelje te hapur ndaj vendimeve te ERE-s do te kerkohet kompesimi i menjehershem i te gjitha abonenteve te cilet jane ngarkuar me fature ne menyre te padrejte ne shkalle vendi. Per kete ceshtje Avokati i Popullit ndan te njejtin shqetesim edhe me Kryetarin e ERE-s Z.Pjeter Dema, i cili nga ana e tij me ane te nje shkrese paraqitur prane Zyres se Avokatit te Popullit ka ngritur midis te tjerash shqetesimin per veprime te paligjshme dhe ne kundershtrim te vendimeve te ERE-s, per te cilat KESH sha eshte ndeshkuar se fundi edhe me gjobe.

Nga konstatimet e mesiperme ka rezultuar se puna e Zyres se Avokatit te Popullit duhet te vazhdoje te fokusohet ne problemet me te mprehta qe ngrihen nga qytetaret per Kesh sha, duke kerkuar menyra te reja ligjore dhe administrative per permiresimin e atyre aspekteve te punes se Kesh-it per te cilat ka mjaft pakenaqesi. Konkretisht krahas rekomandimeve qe kemi bere ne lidhje me menyren e leximit te sahateve, tashme do te thellohemi me teper ne disa aspekte jo pozitive qe prezanton zbatimimi i kontrates se furnizimit, si dhe ne dhenien e oponencave per nje organizim sa me mire te punes te filialeve te Kesh sha me ankesat e qytetareve. Gjithashtu do te vazhdojme te insistojme dhe te nxisim Kesh sha per te pajisur brenda vitit 2006 te gjitha abonentet me matesa dhe te kerkojme venien ne pune sa me te shpejte te sistemit automatik te llogaritjes se konsumit te energjise dhe pasqyrimit te tij ne faturat perkatese per te gjitha territorin e vendit. Kjo sfide kemi besimin se do te kapercehet vetem nepermjet nje pune intensive dhe bashkepunimi te ngushte me KESH sha, me qellim arritjen e standarteve te nje sherbimi modern ne furnizimin me energji elektrike ne Shqiperi.

10. Ministria e Financave

Numri i ankesave, kërkesave dhe njoftimeve drejtuar Avokatit të Popullit nga shtetas dhe subjekte tregtare për shkeljen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre nga administrata financiare, ku përfshihen Ministria e Financave, organet doganore, tatim-taksat dhe Agjensia Kombëtare e Privatizimit për vitin 2005 është 47. Nga ky numër, 11 çeshtje i janë adresuar Ministrise se Financave si institucion, 16 çeshtje i janë adresuar Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve dhe degeve ne varesi te saj, 10 çeshtje i janë adresuar Drejtorise se Pergjithshme te Doganave dhe degeve ne varesi te saj, 10 çeshtje i janë adresuar Agjensise Kombetare te Privatizimit. Krahas këtyre ankesave gjatë vitit 2005 janë përfunduar edhe 34 ankesa të mbartura nga viti 2004, nga te cilat 10 kane qene te pabazuara, 15 kane qene jashte juridiksioni, 6 kane qene jashte kompetence, 2 ne favor, nje me rekomandim.

Me poshte do t'i trajtojmë ne menyre te vecante ankesat e lidhura me Ministrine e Financave, Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve, Drejtorine e Pergjithshme te Doganave dhe Agjensine Kombetare te Privatizimit.

Ministria e Financave

Per kete institucion me vete, kemi patur gjithsej 11 ankesa. Nga keto 4 janë konsideruar me mungesë kompetence, 2 ankesa janë zgjidhur në favor që në fazën e parë të ndërhyrjes dhe verifikimit të tyre dhe 5 ankesa janë zgjidhur në favor pas paraqitjes së rekomandimeve përkatëse nga Avokati i Popullit.

Në lidhje me ankesat e drejtuara ketij institucioni, do të trajtojmë disa prej tyre, të cilat paraqesin problematika te mprehta apo që janë zgjidhur në mënyre pozitive.

1. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi O.P. kerkoi nderhyrjen e Institucionit te Avokatit te Popullit, sepse pretendonte perjashtimin nga taksat e drejtperdrejta si veterane lufte, bazuar mbi Ligjin nr.7874, date 17.11.1994 “Per statusin e veteranit te luftes kunder pushtuesve nazifashiste te popullit shqipta”.

Pasi Avokati i Popullit u njoh me kerkesen e tij dhe shqyrtoi legjislacionin perkates konstatoi se edhe ligjet per veteranet, te verbrit dhe invalidet vertete kane te percaktuar perjashtimin e ketyre kategorive nga taksat e drejperdrejta, por nuk percakton se cili eshte koncepti “takse e drejperdrejte” dhe cilat jane taksat e drejperdrejta vendore si dhe taksat e drejperdrejta kombetare.

Per kete arsye iu drejtuam me rekomandim Ministrit te Financave lidhur me ndermarrjen e iniciatives ligjore per parashikimin ligjor te termit "takse e drejperdrejte" ne Ligjin nr. 8977, date 12.12.2002 "Per sistemin e taksave ne Republiken e Shqiperise" si dhe ne Ligjin nr. 8982, date 12.12.2002 "Per sistemin e taksave vendore", lidhur me cilesimin ligjor te llojeve te "taksave vendore te drejperdrejta", per efekt te perjashtimit te veteraneve te luftes, invalideve, dhe te verberve.

Nga Ministri i Financave na u kthye pergjigje se konstatimi yne ishte shume i drejte dhe do merrej ne konsiderate per paketen fiskale te vitit 2007. Por Avokati i Popullit nisur nga fakti se ishte koha kur ne Parlament po shqyrtohej paketa fiskale e vitit 2006, iu drejtua Komisionit te Ceshtjeve Ligjore, Administrates Publike dhe te Drejtave te Njeriut dhe Komisionit te Financave per marrjen ne konsiderate te plotesimeve ligjore. Sidoqofte ceshtja po ndiqet qe te behet ndryshimi i ligjit brenda vitit 2007.

2. Në letrën drejtuar Avokatit të Popullit, Shoqeria "Alsit" Sh.A. me Administrator shtetasin E. B. ka ngritur pretendimin se Ministria e Financave e ka ngarkuar me gjobe te padrejte.

Pasi Avokati i Popullit u njoh me këtë ankesë, i rekomandoi Ministrit te Financave, revokimin e pikes 2 te Urdherit Nr.3787/2, dt.13.06.2005 te Ministrit te Financave per vendosje gjobe ne ngarkim te subjektit.

Ne pergjigje te ketij rekomandimi, Ministria e Financave ka njoftuar Avokatin e Popullit se gjoba e mesiperme eshte revokuar me ane te Urdherit te Ministrit te Financave. Kjo ceshtje eshte marre ne shqyrtim nga zyra jone qe nga viti 2002, kohe kur nepermjet urdhrimit te siperpermendur, subjektit iu pezullua veprimtaria. Subjektit iu dha e drejta nepermjet vendimeve gjyqesore dhe rifilloi veprimtarine ne vitin 2005, por kjo procedure e tejzgjatur administrative dhe gjyqesore, i shkakttoi humbje, duke i demtuar te drejtat dhe interesat ekonomike atij. Nisur nga ky shembull, ne do te theksonim se eshte ne te mire dhe te vete organeve tatimore, qe ne sistemin e tyre primar kane mbledhjen e detyrimeve nga subjektet tatim-pagues, te jene me te kujdesshem ne praktika te tilla qe cenojne interesat ekonomike te subjekteve por, qe ne thelb demtojne vete buxhetin e shtetit, duke mos bere te mundur realizimin e te ardhurave nga fitimet e subjekteve tatim-paguese.

3. Ne letren drejtuar Avokatit te Popullit, shtetesja M. K. me cilesine e zv.kryetares se Shoqates te Hotelerise, ka paraqitur shqetesimin ne lidhje me vjeljen nga organet perkatese kompetente te tarifes per perdorimin e veprave audiovizuale te autoreve vendas dhe te huaj, ndaj hoteleve apo moteleve.

Ne Ligjin "Per te drejten e autorit", nuk jepet ndonje kriter per te percaktuar se ne ç'mase hotelet jane perdorues te veprave te autoreve

shqiptare e te huaj (pronesise intelektuale). Kjo mangesi e ligjit rendohet me teper nga VKM nr.309, date 13.06.2000, i cili percakton tarifa fikse mbi çmimin e dhomes apo çmimet e pijeve ne bar, pa marre parasysh se ne ç'mase perdoren veprat e autoreve nga hotelet,

- VKM-ja vjen ne kundershtrim me Ligjin "Per te drejten e autorit" dhe parimet e percaktuara ne Kodin Civil, pasi percakton tarifa fikse, nderkohe qe ligji percakton caktimin e ketyre tarifave nepermjet kontrates te lidhur mes paleve. Duke caktuar tarifa fikse, VKM-ja cenon respektimin e ketij parimi te percaktuar ne Kodin Civil.

- Ketyre mangesive ligjore u shtohet edhe presioni i agjencise "X", qe ne pamundesi per te negociuar me hotelet, po perpiqet te perdore Policine Tatimore, per te detyruar hotelet te pranojne kushtet e saj.

Per sa me siper, Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrit te Financave dhe Ministrit te Kultures Rinise dhe Sporteve, realizimin e inisiatives ne perputhje me piken 2 te nenit 100 te Kushtetutes te Republikes te Shqiperise, per nxjerrjen e akteve nenligjore ne zbatim te Ligjit "Per te drejten e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me te".

Nga Ministria e Kultures na eshte kthyer pergjigje pozitive per rekomandimin e derguar, duke na sqaruar se jane ne proces te hartimit te projekt-vendimeve perkatese, te cilat shume shpejt do i dergohen Keshillit te Ministrave per miratim.

Aktet e reja nenligjore qe do te nxirren per kete qellim, duhet qe te marrin parasysh dhe te mos perserisin parashikime, te cilat jo vetem krijojne kofuzion, por edhe perbejne shkak per shkelje te te drejtave te subjekteve qe bejne pjese ne Shoqaten e Hotelerise.

4. Ne letren drejtuar Avokatit te Popullit, shtetasi A. K. ka derguar nje ankese, nepermjet se ciles ankohet se i eshte mohuar e drejta e ushtrimit te profesionit si ekspert i vleresimit dhe trajtimit te demeve shendetsore nga Autoriteti Mbikqyres i Sigurimeve (AMS).

Lidhur me kete shqetesim te qytetarit, ne iu drejtuam AMS-se, e cila na argumentoi se asnje nga ekspertet nuk ka license ne kete fushe.

Ligji nr.9267, date 29.07.2004 "Per veprimtarine e sigurimeve, risigurimeve, dhe ndermjetesim ne sigurime dhe risigurime", perben bazen per rregullimin e marredhenies se ndermjetesimit dhe te perfitimeve qe rrjedhin nga te qenit vleresues demesh dhe konsulent ne sigurime. Ne kete ligj, me konkretisht ne nenin 89 te tij, shprehet se: "*Autoriteti licenson vleresuesit e demeve.....*". Pra eshte shprehur qarte ligji ne kete rast per kompetencen e AMS-se, per dhenien e licensave si vleresues demesh dhe konsulent ne sigurime.

Fakti eshte se po ne kete ligj, pikerisht ne nenin 89, pika 2 eshte percaktuar se; "*Kriteret dhe kushtet per dhenien dhe terheqjen e licenses se vleresuesve te demeve percaktohen me vendim te Keshillit te*

Ministrave” si dhe ne nenin 180 te ketij ligji percaktohet se; Ngarkohet Keshilli i Ministrave te nxjerre aktet nenligjore perkatese.

Ne kushte te tilla, Institucioni i Avokatit te Popullit, duke e konsideruar si nje problem shqetesues dhe pergjithsues, jo me vetem si nje rast te vecante te paraqitur prane zyres sone nga A.K, i rekomandoi Ministrise se Financave dhe Autoritetit Mbikqyres te Sigurimeve realizimin e inisiatives per nxjerrjen e akteve nenligjore ne zbatim te Ligjit nr.9267, date 29.07.2004 “Per veprimtarine e Sigurimeve, risigurimeve dhe ndermjetesimin ne sigurime dhe risigurime”.

Nga kjo ministri na ka ardhur pergjigje pozitive se po punohet ne kete drejtim dhe jane hartuar projekt-vendimet perkatese, per te cilat pasi te merret dhe mendimi i operatoreve te tregut do i kalojne Keshillit te Ministrave per miratim.

a) Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve dhe Degeve ne varesi te saj

Per kete organ me vete, kemi patur gjithsej 16 ankesa. Nga keto 4 jane konsideruar me mungese kompetence, 4 jane konsideruar jashte juridiksionit, 3 jane konsideruar te pabazuara, 2 ankesa jane zgjidhur ne favor qe ne fazen e pare te nderhyrjes dhe verifikimit te tyre dhe 3 ankesa jane zgjidhur ne favor pas paraqitjes se rekomandimeve perkatese nga Avokati i Popullit.

Në lidhje me ankesat në fushën tatimore, do të trajtojmë disa prej tyre, të cilat paraqesin problematika te mprehta apo që janë zgjidhur në mënyre pozitive.

1. Në letrën drejtuar Avokatit të Popullit, shtetasi Th.K.shprehte shqetesimin lidhur me detyrën si ish inspektor i Policisë Tatimore pranë Degës Tatimeve Tiranë. Ankuesi na ka bërë prezent ankesen se i jane ndërprere marrëdhëniet e punës dhe nuk zbatohet vendimi gjyqësor i formës së prerë të Gjykatës së Apelit Tiranë,

Avokati i Popullit, pasi u njoh me këtë ankesë dhe kreu verifikimet përkatëse, i dergoi rekomandim Drejtorise se Përgjithshme te Tatimeve per rikthimin e ketij qytetari ne pune. Nga ky organ na u kthye pergjigje pozitive per marrjen e te gjitha masave per rikthimin ne pune te ankuesit.

2. Shtetasi G.Q ankohej per largimin nga puna, nga Drejtoria e Tatimeve ne te cilen kishte kryer detyren e oficerit te Policise Tatimore. Komisioni i Sherbimit Civil me vendimin e tij, vendosi ndryshimin e mases disiplinore te largimit nga sherbimi civil, ne kalimin ne nje detyre me te ulet per nje periudhe 6 mujore.

Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve, e ankimoi kete vendim ne Gjykatën e Apelit Tirane. Kjo gjykate me vendimin e saj ka vendosur rrezimin e kerkese padise duke lene ne fuqi vendimin e Komisionit te Sherbimit Civil.

Pas nderhyrjes se Avokatit te Popullit na eshte kthyer nje pergjigje, sipas te ciles Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve nxorri aktin perkates te rikthimit ne vendin e meparshem te punes, ne Sektorin e Policise Tatimore, ne Degen e Tatimeve Tirane, te ankuesit.

b) Drejtoria e Pergjithshme e Doganave dhe Degeve ne varesi te saj

Per kete organ se bashku me deget e rretheve kemi patur gjithsej 10 ceshtje. Nga keto ankesa, 3 jane ende ne shqyrtim, 3 jane gjetur te pabazuara, 3 jane konsideruar jashte juridiksionit, nje ka perfunduar me rekomandim.

Ne lidhje me ankesat ne fushen doganore, do te trajtojmë vetem njerën qe paraqet problematike te mprehte;

Keshtu ne ankesen e paraqitur nga ana e perfaqesuesit ligjor te shoqerise "X" sh.a, shprehet shqetesimi ne lidhje me refuzimin qe i eshte bere kerkeses se tij nga ana Drejtorise se Pergjithshme te Doganave, per pajisjen me informacionin dhe dokumentacionin, i cili lidhet me veprimtarine e kesaj shoqerie ne organin e doganes.

Per kete rast, nderhyrja e Avokatit te Popullit, bazuar ne kompetencat qe atij i jepen prej ligjit "Per te drejten e informimit me dokumentet zyrtare", konsistoi ne rekomandimin per plotesimin sa me te shpejte te kerkeses se subjektit.

Efektivisht shoqeria "X" sh.a ne perputhje me nenin 51 te Kodit te Procedurave Administrative, ne kete rast eshte cilesuar ne kushtet e personit te drejtperdrejte te interesuar, bazuar kjo ne nje procedim administrativ te organit te doganes ndaj kesaj shoqerie, procedim i cili ka perfunduar me vendimet qe tashme, kerkohet te behen objekt shqyrtimi gjyqesor nga kjo shoqeri.

Ne i kemi kerkuar Drejtorit te Pergjithshem te Doganave, plotesimin sa me te shpejte te kerkeses se paraqitur prej subjektit per dhenien e kopjeve te dokumentave te kerkuar, nga ana e perfaqesuesit ligjor te shoqerise "X" sh.a.

Nga Drejtori i Pergjithshem i Doganave edhe pse ia kemi perseritur dy here kerkesen per zbatimin e rekomandimit tone nuk na eshte kthyer asnje pergjigje. Ceshtja eshte akoma ne ndjekje.

c) Agjensia Kombëtare e Privatizimit

Për vitin 2005 ka patur 10 ankesa ndaj Agjensisë Kombëtare të Privatizimit, të cilat janë përfunduar te gjitha. Nga keto 5 jane konsideruar si të pabazuara, 1 jashtë juridiksionit, 2 jashte kompetence dhe 2 me rekomandime te refuzuara.

Për ankesat që kanë rezultuar të pabazuara ose jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit, ankuesve ju janë sqaruar dispozitat përkatëse

ligjore dhe rruga nepermjet së cilës do të realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshme.

Shqetësimi i evidentuar nga ankesat e këtij viti, kishte të bënte me mosekzekutimin e vendimeve gjyqesore ku pale debitore është AKP-ja. Me keto vendime, nga gjykata është njohur detyrimi në leke i Agjensisë Kombëtare të Privatizimit për individët, që blerjen e objekteve të shitur e kanë bërë pjesërisht në bono privatizimi. Keto vendime nuk ekzekutohen me pretendimin se nuk ka baze ligjore për konvertimin e bonove të privatizimit në leke dhe ka kosto të mëdha financiare për buxhetin e shtetit. Për këtë arsye Ministria e Financave ka ngritur një komision i cili duhet të vlerësojë se çdo veprim me keto lloj vendimesh gjyqesore të formës së prapë. Në mendimet, se është antikushtetuese, interpretimi i vendimeve gjyqesore të formës së prapë nga organet e administratës publike, mosekzekutimi i tyre dhe atëherë me tepër ngritja e komisioneve të cilat kanë si qëllim gjykimin e vendimeve gjyqesore, nëse janë të drejta apo jo. Me objekte të tilla kemi pasur disa ankesa nga individë të ndryshëm pranë zyrës dhe të pakten dy prej tyre kanë perfunduar me rekomandim për ekzekutimin e vendimeve gjyqesore.

Por edhe pas rekomandimeve të dala nga zyra jone për ekzekutimin e vendimeve gjyqesore, nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit është mbajtur i njëjti qëndrim refuzues, me arsyetimin se nuk ka baze ligjore për konvertimin e bonove të privatizimit.

Avokati i Popullit edhe në të ardhmen do të synojë të evidentojë dhe ndërhyjë për fenomene që vihen re në keqadministrimin e organeve të administratës publike financiare në raport me të drejtat dhe liritë themelore të individit si dhe të ketë në vëmendje përmirësimin e mëtejshme qoftë të kuadrit ligjor financiar, ashtu dhe të punës së nëpunësve të administratës financiare, nëpërmjet rekomandimeve dhe kontakteve të vazhdueshme me ta.

Si konkluzion mund të themi se përgjithsisht krahasuar me vitin 2004, zbatimi i ligjit nga organet financiare qëndron në nivel më të kënaqshëm, bazuar mbi tregues të tilla si: respektimi i detyrimit të tyre ligjor për dhënie të shpjegimeve dhe informacioneve Institucionit të Avokatit të Popullit; zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga zyra jone që njëkohësisht tregojnë dhe respektim në nivele më të kënaqshme të ligjit dhe të drejtave të njeriut. Fakt është se rreth 5 vendime gjyqesore të formës së prapë që detyrojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për rikthim në punë të punonjësve, kjo e fundit i ka ekzekutuar; informimi i qytetarëve për rruget e ankimit administrativ brenda strukturave tatimore.

Por akoma vazhdojnë të krijohen dhe të mbeten probleme në fushën financiare; siç janë veprimet e paligjshme të organeve të tatim-taksave, në rastin e parapagimit të tatim-fitimit nga tatim-paguesit, duke mos u rimbursuar shumat e dhëna më tepër se detyrimi i lindur, këtyre të

fundit, zbatimi i legjislacioni tatimori cili me parashikimet qe ka, sjell probleme për tatimpaguesin, - mosbesimi i individëve në zgjidhjen e problemeve te tyre, mosbesim ky i ardhur dhe i krijuar ndër vite nga marrëdhëniet organe tatimore-tatimpagues e shume te tjera.

11. Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Gjatë vitit 2005 rezultojnë 51 ankesa apo kërkesa të ardhura ndaj Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe institucioneve në vartësi të saj. Janë në fazën e shqyrtimit pranë Zyrës sonë 12 ankesa. Në favor janë zgjidhur 11 ankesa apo kërkesa, kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetences 8 ankesa, të pabazuara kanë qenë 18 ankesa dhe për 2 çështje rekomandimi dërguar organit përkatës, është refuzuar. Ndërsa nga viti 2004 janë mbartur për shqyrtim 13 ankesa, nga të cilat 3 janë zgjidhur në favor, 1 jashtë juridiksionit dhe kompetencës, 7 të pabazuara, dhe per 2 çeshtje rekomandimi i derguar eshte refuzuar per t'u zbatuar.

Një numër ankesash kanë patur si objekt problemet e largimeve nga puna të mësuesve. Gjithashtu ka patur ankesa në të cilat është pretenduar zvarritje nga ana e strukturave drejtuese të Fakulteteve lidhur me aplikimin e kuotave shtesë për vazhdimin e studimeve te larta, zvarritje të procedurave për ekuivalentimin e diplomave të individeve të cilët kanë mbaruar studimet jashtë vendit, diskriminim dhe shkelje të ligjeve dhe akteve nënligjore në procedurën e marrjes në punë të stafit akademik nga ana e organeve drejtuese të fakulteteve etj.

Ankesat e trajtuara, kanë nxjerrë në pah një sërë problemesh të cilat kërkojnë përmirësim të punës dhe reagim të organeve përgjegjese.

Nisur nga një ankesë e një grupi ndihmësmësuesish të një prej shkollave të veçanta, është evidentuar se dispozitat normative të arsimit parauniversitar, të cilat kanë hyre në fuqi në vitin shkollor 2002-2003, nuk janë miratuar me një akt konkret të ishMinistrit të Arsimit. Referuar nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, në zbatim të kompetencave të tij, ministri nxjerr urdhra dhe udhëzime. Në këto kushte nevojitet rregullimi sipas kushtetutes i këtij problemi. Duke u ndalur në vazhdim në përmbajtjen e dispozitave normative dhe specifikës së punës në shkollat e veçanta, me qëllim për t'u fokusuar kryesisht në përmbushjen sa më mirë të nevojave të fëmijëve me aftesi të kufizuara, rezulton e nevojshme një rishikim i këtij akti, gjë që është pranuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Një problematikë tjetër e cila bëhet prezente nga ankesat e shqyrtuara, është ushtrimi nga ana e Ministrit të Arsimit, referuar nenit 40 të Ligjit nr.8461 date 25.02.1999 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të kompetencës për shfuqizimin e çdo akti të nxjerrë nga senati i shkollës së larte universitare, nga Këshilli i shkollës së lartë

jouniversitare, Rektori ose drejtori i tyre, në rastet kur këto akte janë në kundërshtim me ligjin.

Lidhur me këtë çështje, është e rëndësishme të theksojmë, se autonomia e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe liria akademike, e garantuar në nenin 57 të Kushtetutës dhe Ligjin Nr. 8461 date 25.02.1999 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, nuk nënkupton mungesë përgjegjesie në rastet e shkeljes së ligjit nga ana e organeve drejtuese të shkollave të larta universitare dhe shkollave jouniversitare.

Kjo kompetencë që me ligj i është akorduar Ministrit të Arsimit, është një formë e kontrollit të brëndshëm të këtyre organeve, e cila rrit përgjegjshmërinë dhe forcon zbatimin e ligjshmërisë nga ana e këtyre të fundit. Mungesa e një formë kontrolli të brëndshëm do të rriste rastet e abuzimeve nga ana e këtyre organeve, në emër të autonomisë dhe lirisë akademike. Por për fat të keq, me sa kemi konstatuar, Ministria e Arsimit dhe Shkencës nguron të zbatojë ligjin në këtë drejtim që të shfuqizojë aktet e paligjshme të dekanëve apo rektorëve, të drejtë që e ka të bazuar në Kushtetutë dhe në ligjin “Për Arsimin e Lartë”.

Nga ankesat e trajtuara përmendim:

1. Shtetasi A.B. ka paraqitur një ankesë lidhur me zbatimin e procedurave nga ana e Fakultetit të Histori-Filologjisë gjate procesit të emërimit të një pedagogu të brëndshëm të ketij fakulteti.

Konkretisht, u konstatua se vendimi i emërimit ka dalë bazuar në nenin 10 paragrafi 3 të Rregullores së ketij Fakultetit ku parashikohet shprehimisht se: *“Për zhvillimin e konkursit, ngrihet një komision i kryesuar nga Dekani”*.

Për të zgjidhur në përputhje me ligjin situatën e krijuar kemi arritur në konkluzionin se ky parashikim i bërë në Rregulloren e brëndshme të Fakultetit Histori-Filologjisë është në kundërshtim me Ligjin Nr.8461 datë 25.02.1999 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Tiranës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës u dërgua një Rekomandim për shfuqizimin e nenit 10 paragrafi 3 të Rregullores së Fakultetit të Histori-Filologjisë, shfuqizimin e vendimit të Dekanit të Fakultetit të Histori-Filologjisë të emërimit të kandidatit, dhe fillimin e procedurave nga fillimi për vendin e punës si asistent pedagog pranë ketij Fakulteti konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Rekomandimi i mesipërm u refuzua nga Dekani i Fakultetit, ndërkohë me ndërhyrjen e Rektorit të Universitetit të Tiranës u arrit të shfuqizohej neni i Rregullores së Fakultetit, por mbetet ende pa u zbatuar pjesa tjetër e rekomandimit për shfuqizimin e vendimit të emërimit.

Me keqardhje konstatojmë se duke moszbatuar plotësisht këtë rekomandim ky fakultet është duke ligjëruar praktika të paligjshme.

2. Ankuesja K.L. është ankuar lidhur me dy vendimet e nxjerra nga ana e Dekanit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, konkretisht akti me objekt *“Vërejtje e rëndë me paralajmërim për përjashtim nga puna për mosparaqitje në punë në datat 02.04.2005 dhe 04.04.2005 dhe largim jashtë shtetit pa lejen e titullarit të fakultetit”* dhe Vendimin me objekt *“Lirimin e Znj.K.L. nga detyra e Përgjegjëses së Departamentit të Gjuhes frenge”*. Ajo ngre pretendimin se keto vendime janë të pabazuara në ligj, dhe në vendimmarrjen e Dekanit ankueses i është shkelur e drejta për të marrë pjesë dhe për t’u dëgjuar para nxjerrjes përfundimtare të akteve të mësipërme.

Në perfundim të shqyrtimit të çështjes kemi arritur në konkluzionin se nga aktet administrative të nxjerra ndaj ankueses, kësaj të fundit i janë shkelur të drejtat e njohura nga Kushtetuta dhe ligjet, konkretisht neni 42 i Kushtetutes dhe neni 47 e 93 i Kodit të Proçedurave Administrative.

Konstatohet se proçesi administrativ, si nga ana e Departamentit dhe nga ana e Dekanit, nuk është zhvilluar në termat e një proçesi administrativ të rregullt dhe sipas proçedurave ligjore, pasi eshte shkelur e drejta për t’u dëgjuar. Kjo e drejte lidhet ngushtësisht me të drejtën për t’u mbrojtur para akuzave në një proçedim administrativ, me qëllim që secila palë të ketë mundësinë të paraqesë përpara organit kompetent ose pjesëmarrësve të gjitha argumentat e nevojshme, apo mjetet juridike të cilat janë të rëndësishme për një zgjidhje sa më të drejtë të çështjes. Ne keto kushte kemi rekomanduar revokimin e akteve e siperpërmendura.

Megjithë ndërhyrjen tonë nga ana e Dekanit, Rekomandimi ynë nuk eshte pranuar.

Në perfundim, duke i gjetur të pabazuara pretendimet e parashtruara nga ana e Dekanit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, i jemi drejtuar Ministrit të Arsimit ku i kemi kërkuar, vënien në vend të të drejtës së shkelur të ankueses, duke urdhëruar shfuqizimin e masës disiplinore si dhe të kthimit për rishqyrtim të vendimit të lirit nga detyra e përgjegjëses së Departamentit, për të zbatuar proçedurat ligjore. Rezulton që ende nuk kemi një përgjigje lidhur me këtë rekomandim.

3. Nisur nga fakti se ne daten 07.10.2005, ne mediat elektronike dhe ato te shkruara, u be prezent si nje problem shume shqetesues, sistemimi ne dhoma i studenteve te cilet rregjistroheshin ne vitin e pare ne shkolle te larte, ne qytetin Studenti, te ndjeshem nga situata e krijuar, me qellimin per te vene ne levizje strukturat shteterore, per permiresimin e kushteve te studenteve dhe perdorimin 100% te kapaciteteve te cilat jane te caktuara per trajtimin e tyre, Institucioni i Avokatit te Popullit ndermori me inisiative nje proçes hetimi.

Ne perfundim te ketij proçesi, rezultoi se, nisur nga kuotat e miratuara me Vendim te Keshillit te Ministrave, te cilat pesuan rritje te ndjeshme ne raport me vitin e kaluar, problemi u paraqit shqetesues per

faktin e rendesishem te zenies se disa prej godinave te cilat jane ne administrim te Ndermarrjeve te Trajtimit te studenteve Nr.1 dhe Nr.3 Tirane , nga ana e personave te cilet kane ardhur nga zona te ndryshme te vendit dhe nuk kane asnje lidhje me Universitetet.

Nga informacioni i cili na u vu ne dispozicion, Ndermarrja e Trajtimit te Studenteve 1, ku perfshihet Qyteti Studenti, pranon studente nga 57 Fakultete te 3 Universiteteve te Tiranës. Kapaciteti aktual i kesaj ndermarrje eshte 6800 studente. Konkretisht jane zene me familjare 4 godina 15a dhe b, 18 dhe 19, nga 232 familje.

Ne rast se keto godina do te ishin te lira, do t'i krijonin mundesi akomodimi edhe 1000 studenteve dhe do te zgjidhte perfundimisht problemin e strehimit te studenteve apo do t'i krijonin kushte me te mira akomodimi studenteve duke caktuar jo me 3 apo 4 persona ne nje dhome, por me pak.

Ndersa persa i perket informacionit te marre nga ana e Ndermarrjes se Trajtimit te Studenteve nr.3, rezulton se kjo e fundit ka ne perdorim gjithsej 10 godina, 8 prej te cilave jane zene forcerisht nga ana e banoreve qe ne vitin 1997. Ne keto godina jane 486 familje te cilat nuk kane lidhur asnjehere asnje kontrate qeraje me ndermarrjen dhe nuk kane shlyer asnjehere detyrimin e tyre ndaj KESH-it dhe Ndermarrjes se Ujesjelles Kanalizimeve per perdorimin e energjise elektrike dhe te ujit.

Nga verifikimi rezulton gjithashtu se nga ana e kesaj Drejtorie jane zhvilluar procese gjyqesore per lirimin e banesave per 100 familje, nderkohe qe per te tjerat nuk eshte ndermarre asnje veprim. Pavaresisht se tashme ekzistojne vendimet e formes se prere dhe per te cilat, megjithese jane leshuar urdhrat e ekzekutimit, ato ende nuk jane ekzekutuar nga ana e Zyres se Permbarimit Tirane.

Sa me siper, referuar fakteve dhe situates se parashtruar del si domosdoshmeri qe nga ana e Ndermarrjes se Trajtimit te Studenteve nr.1 dhe nr.3 te kryhen te gjitha procedurat ligjore per lirimin e ambienteve te zena nga ana e familjeve te cilet rezultojne tashme pa kontrate.

Duke qene se keto ndermarrje tashme jane shoqeri anonime, Institucioni i Avokatit te Popullit ka derguar nje rekomandim duke parashikuar domosdoshmerine qe Keshilli Mbikqyres te nxjerre nje vendim me objekt lirimin e ambienteve te zena nga familjet te cilat tashme nuk kane asnje kontrate duke i caktuar nje afat te arsyeshem per lirimin e tyre. Ne te njejten kohe ne rast se keta banore refuzojne ekzekutimin vullnetar te ketij vendimi, mund të kerkohet ndihma e organeve te ligjit per ekzekutimin e detyrueshem te vendimit per lirimin e ambienteve te zena ne menyre te paligjshme.

Lidhur me çeshtjen i jane derguar rekomandime ne te njejten kohe dhe Ministrit te Arsimit dhe Zyres se Permbarimit Tirane.

Rezulton qe ky problem ende eshte aktual dhe ne rast se nuk nderhyhet ne kohe do te prezantohet si nje problem mjaft emergjent vitin tjeter kur dihet politika e qeverise ne drejtim te liberalizimit te arsimit te larte.

4.Shtetasi P.S. së bashku me një grup mësuesish të shkollës së fshatit Gërdec paraqesin nje ankesë lidhur me vlerën e rimbursimit që i bëhet nga ana e Drejtorisë Arsimore të Qarkut, për realizimin e transportit të tyre nga Tirana në shkollën e fshatit.

Kështu ankuesit paguajnë për transportin e tyre nje vlerë më të madhe se rimbursimi që i realizohet nga ana e Drejtorisë Arsimore.

Lidhur me këtë çështje, konstatojme se tarifat e parashikuara në vendimin e mësipërm duhet të ndryshohen në mënyre që të pershtaten me ndryshimet e kushteve te tregut.

Domosdoshmëria e ndryshimit të këtij vendimi, vjen si llogjikë e ndryshimeve që ka pësuar në vite vendimi i fundit, i Këshillit të Ministrave Nr.146 datë 26.02.1998, i cili megjithese ka kaluar një kohe e gjatë, prej 8 vjetesh nuk është përshtatur me ndryshimin e kushteve të tregut.

Në rastin konkret, pavarësisht se nuk konstatohet shkelje e dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi, vetë përmbajtja e tyre, pra e Vendimit të Këshillit të Ministrave është premisë për shkeljen e të drejtave të kësaj kategorie mësuesish.

Nga korespondenca e zhvilluar ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, rezulton se është ngritur një grup pune për ndryshimin e V.K.M. nr. 146 datë 26.02.1998 “ Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtareve” me përfaqësues të Ministrive që lidhen me objektin e aktit.

5. Shtetesja D.S. pedagoge ne Fakultetin e Bujqesise ka paraqitur nje ankese ndaj vendimit te Keshillit te ketij Fakulteti per heqjen e të drejtës së marrjes në provim të studentëve deri në fund të Janarit të vitit 2006, duke e konsideruar këtë qëndrim, si shkelje të së drejtës së saj për të ushtruar lirisht profesionin.

Ky vendim i marre në mbledhjen e Këshillit të Fakultetit të Bujqësisë të datës 14.06.2005, mes te tjerash në pikën III ka vendosur që gjashtë pedagogëve të këtij fakulteti t’u hiqet e drejta e marrjes në provim të studentëve deri në fund të vitit 2006, kjo bazuar ne nje sondazh te kryer nga ana e studenteve per pedagoge te ketij fakulteti.

Ne lidhje me këtë vendim duhet theksuar se në nenin 15 dhe nenin 16 të Ligjit nr. 8461, datë 25.02.1999 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Institucioni i Avokatit te Popullit ka konkluduar se nuk ekziston asnje sanksionim ligjor për heqjen e të drejtës së pedagogëve për marrjen në provim për një periudhe të caktuar. Gjithashtu kemi evidentuar se mungon baza ligjore e këtij vendimi për heqjen e të drejtës

së marrjes në provim, për arsye se ky i fundit bazohet vetëm në sondazhet e kryera në fakultet dhe në asnjë provë tjetër të njohur nga ligji.

Në vendimin e marrë nga Këshilli i Fakultetit mes të tjerash theksohet se: “ Sondazhi, mbi të cilin mbështetet pezullimi, është kryer në përputhje me të gjitha rregullat nga Dekanati i Fakultetit të Bujqësisë. Duke theksuar se megjithëse këto rregulla dhe kopje të rezultateve të sondazhit, janë kërkuar me insistim nga ana jonë, nuk na u vunë në dispozicion.

Per kete arsye, ne rekomadimin e derguar nga ana e Institucionit tone, eshte sqaruar se, një prej koncepteve që akoma nuk është kuptuar siç duhet dhe praktikuar në shoqërinë shqiptare është edhe praktika e shoqërive demokratike që të mbajnë sondazhe për probleme nga më të ndryshmet në sfera të ndryshme të jetës.

Vlerat e sondazheve janë të gjithanshme, si vjelja e mendimit të njerëzve të lirë, vlerësimi i mendimit të njerëzve të thjeshtë, nxitja e pjesëmarrjes si dhe evidentimi i problemeve ose testimi i efikasitetit të një politike, programi apo projekti, në një grup shoqëror.

Në asnjë mënyrë, rezultatet e sondazhit nuk mund të përdoren si prova që vërtetojnë mitmarrjen e një apo disa pedagogëve. Rezultatet e këtyre sondazheve kanë një karakter të thellë subjektiv, e cila vjen si pasojë e pakënaqësisë apo preferencave të studentëve të ndryshëm përballë një apo disa pedagogëve.

Në rrethana të tilla, dekanati duke u bazuar në parimin e rëndësishëm të paanësisë, presupozon eliminimin e çdo rrethane që rrezikon objektivitetin në marrjen e vendimit.

Institucioni i Avokatit të Popullit vëren se mitmarrja është një fakt shqetësues në sistemin arsimor shqiptar dhe në kuadër edhe të luftës kundër korrupsionit, ne kemi luajtur një rol të rëndësishëm në evidentimin dhe nxjerrjen para organeve të drejtësisë të çdo shtetasi shqiptar ndaj të cilit ka patur ankesa pranë institucionit tonë.

Nëse ka patur me të vertetë të dhëna për mitmarrje ndaj pedagogëve të cituar në vendim, atëherë organet drejtuese të fakultetit duhet të kishin bërë denoncimin përkatës pranë organit të prokurorisë për ndjekjen e mëtejshme të kesaj çështje mjaft të rëndësishme.

Rezultatet e sondazheve në rastin konkret nuk duhet të shërbenin si bazë për marrjen e vendimit nga ana e Këshillit të Fakultetit, pasi kjo do të përbënte një precedent negativ për të ardhmen, por njëkohësisht nuk do të shërbente as rritjes së nivelit të mësimdhënies pranë Fakultetit të Bujqësisë në veçanti dhe fakulteteve të tjera në mbarë Shqipërinë, në përgjithësi.

Sa me sipër duke e konsideruar si shkelje të drejtës së ankueses vendimin e nxjerre, kemi kërkuar revokimin e akteve të nxjerra në kundërshtim me ligjet dhe aktet nënligjore, si dhe kalimin për shqyrtim të

pretendimeve te ngritura për shkelje të ligjit, organeve shtetërore kompetente si dhe eliminimin e praktikave te paparashikuara ligjore gjatë procedurave të vendimmarrjes nga ana e organeve drejtuese në Fakultetin e Bujqësisë.

Megjithë mungesën e pergjigjes zyrtare lidhur me kete rekomandim, nga ankuesja jemi informuar se ky rekomandim eshte pranuar.

Ne tetor 2005 edhe Ministrit te Arsimit dhe Shkences i eshte derguar nje informacion per problematiken qe ka dale nga shqyrtimi i ankesave ne fushen e arsimit në vitet 2000-2004.

12. Ministria e Shëndetësisë

Gjatë vitit 2005 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet në vartësi të saj janë shqyrtuar gjithsej 24 ankesa. Nga këto 6 kanë qënë të mbartura nga viti 2004. Janë përfunduar 21 ankesa, 2 janë zgjidhur në favor, 12 kanë rezultuar të pabazuara dhe 7 kanë qënë jashtë juridiksionit dhe kompetencës. Janë mbartur 3 ankesa për shqyrtim në vitin 2006.

Problematika e çështjeve që kanë të bëjnë me këtë ministri ka qënë kryesisht lidhur me vendimet e lëvizjes në detyrë, transferime, mosrimbursim të ilaçeve, mosrespektim të procedurave të pranimit në punë, me trajtimin e te semureve talasemike, si dhe te trajtimit te semureve me probleme te shendetit mendor etj.

Nga ankesat e përfunduara përmendim;

1. Shoqata e Talasemikeve, aktive ne mbrojtje te shendetit te femijeve te semure nga Talasemia, sidomos pas berjes publike te femijeve talasemike te semure nga marrja e gjakut te infektuar, ka bere prezente nje sere shqetesimesh.

Konkretisht ata kane pretenduar se dhjetra femije qe vuajne nga semundja e Talasemise ne spitalet tona, nuk kane kujdesin e duhur te personelit shendetesor. Ne te njejten kohe kjo shoqate parashtron se ka kerkuar protokoll mjekesor per kete diagnoze, dhe ne kohen e depozitimit te ankeses ky protokoll nuk ishte krijuar. Ne vazhdim te letres se tyre kjo shoqate parashtron se nuk ekziston nje strategji kombetare per sigurimin e gjakut me cilesi dhe ndjekjen nen kontroll te vazhdueshem te ketyre femijeve.

Per te patur nje informacion te sakte te kesaj çeshtjeje shume delikate, Institucioni yne ndermori nje proces hetimi që pefshin si korespondencën zyrtare me Ministrinë e Shendetesise dhe komunikimin e drejteperdrejte me specialiste te fushes, personelit ne Qendren Spitalore “Nene Tereza” si dhe me drejtues te Qendres Kombetare te Gjakut.

Ne perfundim, duke marre shkas dhe nga raporti i paraqitur nga grupi i punes i ngritur me *Urdhërin e Ministrit të Shëndetësisë Nr. 393, datë 15.09.2005* “*Per verifikimin e bartshmerise se talasemikeve te politransfuzuar per HIV Hepatit B Hepatit C*”, kemi konstatuar se:

Ekzaminimi i femijeve talasemike per semundje qe transmetohen nepermjet transfuzionit te gjakut duhet te behet çdo vit. Ky ekzaminim per arsye te mungeses se kushteve nuk eshte kryer rregullisht sidomos ne rrethe, ndersa kontrollet e tjera periodike ne qendren Spitalore Universitare “Nene Tereza” jane kryer rregullisht.

Siç pranohet dhe ne raport, mungesa e zyrtarizimit te ketij protokolli ka qene nje mungese serioze per plotesimin e nevojave mjekesore te talasemikeve. Nga ana tjeter pavaresisht se ne QSUT-ne Tirane jane kryer kontrollet periodike te femijeve , gje qe rezultoi dhe nga verifikimi nga ana jone te disa prej kartelave te disa te semureve talasemike prane kesaj qendre spitalore, ky proces kerkon nje angazhim dhe koordinim me te mire te disa prej specialiteteve mjekesore.

Sipas raportit perfundimtar te grupit te punes rezulton nder te tjera, se ka mungesa te akteve nenligjore ne zbatim te *Ligjit Nr. 8032 date 16.11.1995, “Per sherbimin e transfuzionit dhe kontrollin e gjakut e produkteve te tij dhe transplantimeve”*, duke e vene theksin kryesisht ne mungese te Rregullores se Pergjithshme mbi funksionimin e Sherbimit Kombetar te Transfuzionit dhe te Rregullores mbi Kontrollin e Brendshem dhe te Jashtem te cilesise ne Sherbimin e Transfuzionit te Gjakut.

Sa me siper, ne vijim te konstatimeve, arijme ne konkluzionin se nga ana e Ministrise se Shëndetësisë ka patur mosveprim si ne drejtim te mosnxjerrjes se akteve ne zbatim te *Ligjit Nr. 8032, date 16.11.1995 “Per sherbimin e transfuzionit dhe kontrollin e gjakut e produkteve te tij dhe transplantimeve”*, dhe te ushtrimit te detyrës per funksionimin dhe kontrollin e organeve qe merren me manipulimin e gjakut, produkteve te tij dhe transplanteve. E veme theksin ketu ne mirefunksionimin e organeve te tilla si Komiteti Kombetar i Gjakut si dhe te personelit spitalor ne dhenien konkretisht te ndihmes mjekesore rast pas rasti. Ne kete çeshtje nuk mund te tolerohet qe ne momentin qe kushtet e sherbimit spitalor ne vendin tone kane ndryshuar, protokolli eshte zyrtarizuar vetem pas berjes publike te rezultateve te analizave te disa prej te semureve talasemike.

Nga ana tjeter, duke evidentuar si nje nga faktoret me te rendesishem ne minimizimin e rasteve te tilla ne te ardhmen, rritjen e cilesise se gjakut, pershendesim pregatitjen e strategjise kombetare per sigurine e gjakut, e cila pa dyshim do te shoqerohet me hapa konkrete per implementimin e saj ne te nje te ardhme te afert.

Per sa me siper, si konkluzion te konstatimeve te mesiperme, i jemi drejtuar me nje Rekomandim Ministrit te Shendetesise, ku i kemi kerkuar realizimin e iniciatives, qe ne perputhje me piken 4 te nenit 102 te Kushtetutes te Republikes te Shqiperise, te nxjere aktet nenligjore ne zbatim te *Ligjit Nr. 8032, date 16.11.1995 "Per sherbimin e transfuzionit dhe kontrollin e gjakut e produkteve te tij dhe transplantimeve"* si dhe te filloje nje proçedim disiplinor per evidentimin e pergjegjesive per shkeljet e konstatuara.

2. Shtetasit N.K dhe O.S. kane paraqitur nje ankese ku bejne prezente nje shqetesim i cili lidhet me trajtimin e perhershem ne spitalin psikiatrik te Shkodres te djalit te tyre, meqenese semundja e tij eshte e rende dhe perben kercenim per jeten e familjareve, pasi ai shfaq shenja dhune.

Duke pershendetur strategjine e Ministrise se Shendetesise per trajtimin e te semureve me probleme te shendetit mendor, ku parashikohet se kjo ministri e konsideron si prioritet zbatimin e nje politike te mosshtimit afatgjatë te te semureve, te cilet familjaret nuk kane kushte per t'i mbajtur e trajtuar, por sigurimin e kushteve te pershtatshme te jetese ne pavion nen kujdesin e nje stafi te trajnuar mire, jemi te mendimit qe ky proçes duhet te realizohet ne nje kohe sa me te shpejt te mundshme, pasi problemi qe na prezantohet eshte i rende dhe shume i dhimbshem per keto familjet qe kane të semure te tillë.

Ne tetor 2005 Ministrit te Shendetesise i eshte derguar nje informacion per problematiken qe ka dale nga nga shqyrtimi i ankesave ne fushen e shendetesise në vitet 2000-2004.

13. Ministria e Punëve të Jashtme

Gjatë vitit 2005 për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ambasadat dhe Konsullatat e Republikës së Shqipërisë jashtë vendit janë shqyrtuar gjithsej 50 ankesa. Nga këto ankesa 2 çështje janë në shqyrtim, 28 rezultojnë të jenë jashtë kompetencës së Avokatit të Popullit, 7 ankesa kanë rezultuar të pabazuara, kurse 13 të tjera janë zgjidhur në favor.

Pjesa më e madhe e çështjeve që lidhen me këtë Ministri, kanë të bëjnë me ankesat e qytetarëve shqiptarë për përfaqësitë e vendeve të huaja të akredituara në Shqipëri. Për të gjitha rastet, bazuar në specifikën e tyre, ankuesve ju është dhënë konsulenca e nevojshme juridike apo duke i kaluar për kompetencë edhe pranë Drejtorisë Konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Nga ankesat e shqyrtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit po përmendim:

1-Ankesën e dy punonjëseve (diplomate) të Ambasadës së Republikës të Shqipërisë në Francë, për lirimin nga detyra me Urdhrat nr.25 date 27.01.2005 dhe nr.53, date 14.02.2005 të Ministrit të Punëve të Jashtme. Të dyja diplomatet pretenduan se këto lëvizje ishin të parakohshme, të pamotivuara dhe në kundërshtim me Rregulloren e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë, miratuar me VKM nr.839 datë 17.12.2004.

Nga dokumentacioni doli se Ambasadës Shqiptare në Francë i ishte dërguar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme shkresa “Njoftim lirimi nga detyra” për ankuesen M.N dhe kthimin në Shqipëri, brenda një afati të caktuar, pa cituar asnjë lloj mbështetje ligjore për këtë veprim. Ndërkaq me një tjetër shkresë, nga e njëjta Drejtori e Ministrisë së Punëve të Jashtme, i është dërguar Ambasadës shkresa “Shtyrje e qëndrimit të diplomates” deri në një tjetër datë, edhe kjo pa asnjë lloj mbështetjeje ligjore të cituar. Ankuesja na vuri në dispozicion dhe një aktmarrëveshje të pamotivuar ligjorisht me disa sanksione, e lidhur me punëdhënësin, me kohëzgjatje afro 2 muajore. Mund të thuhet se kjo aktmarrëveshje ishte një akt juridik skandaloz dhe i turpshëm për ata që e kishin formuluar dhe miratuar. Në fakt ankuesja u kthye në Tiranë, në një punë fare të zakonshme në Ministrinë e Jashtme dhe në vend të saj u dërgua një person tjetër, i cili pas shtatorit 2005 u lëviz nga Ministri pauses në detyrë.

E njëjta gjë ka ndodhur dhe me diplomaten tjetër J.P. Njoftimet për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nuk shoqëroheshin me asnjë lloj baze ligjore. Pas katër ditësh të nxjerrjes së Urdhrit të Ministrit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, është “prapësuar” përmbajtja e Urdhrit të Ministrit, duke njoftuar ankuesen se qëndrimi i saj në Francë shtyhej për pak kohë. Dhe më pas në këtë periudhë është lidhur aktmarrëveshja mes Ministrisë së Punëve të Jashtme në cilësinë e punëdhënësit dhe J.P në cilësinë e punëmarrësit, me kohëzgjatje 3 muajore.

Rezultoi se ankueset nuk ishin informuar mbi shkaqet dhe bazën ligjore të lirimit nga detyra edhe pse nga vetë Ministria janë nxjerrë disa shkresa pa cituar motivimet përkatëse ligjore. Gjithashtu edhe aktmarrëveshja me klauzolat e saj duket e pambështetur në ligj.

Pika 28.1 e Rregullores së Shërbimit të Jashtëm të RSH përcakton se: *“Kushti bazë për përcaktimin e nevojës për një kthim të mundshëm është vlerësimi i punës së diplomatit në mision/post me karakteristikën “përgjithësisht mjaftueshëm”.* Por rezultonte se vlerësimi vjetor i punës së tyre ishte mjaft pozitiv.

Në këtë kontekst i kërkuam shpjegime zyrtare Ministrisë së Punëve të Jashtme, mbi gjithë praktikën e lirimit nga detyrat të dy punonjëseve të Ambasadës së RSH në Paris, si dhe mbështetjen përkatëse ligjore.

Nga ana e Ministrisë u pretendua se dy ankueset nuk i kishin drejtuar kërkesat për kundërshtimin e Urdhrave të lirimit dhe kthimin në Shqipëri, Ministrisë së Punëve të Jashtme, por kishin kërkuar vetëm zgjatjen e qëndrimit në Francë, gjë e cila ishte plotësuar.

Eshtë karakteristikë për këtë Ministri që punonjësit e saj kanë frikë të ankohen ose në rastin konkret dy punonjëseve që ishin në Paris ju bë presion pse u ankuan tek Avokati i Popullit. Disa diplomatë i janë ankuar në konfidence Avokatit të Popullit për mospajtim të tyre me gradat diplomatike që ju dhanë, duke i gjykuar ato jo reale dhe subjektive, por ankesa zyrtare kishin frikë të bënin. Fakt është që procesi i lëvizjeve të personelit që ndërmoi ish ministri zoti K. Islami në fillim të vitit 2005 dhe gradat e miratuara prej tij u anuluan me të drejtë nga ministri që e ka zëvendësuar zoti B. Mustafaj. Mund të ketë çfarëdolloj arsye për t'i justifikuar, por për paratë e taksapaguesve shqiptarë të harxhuara pa vend si pasojë e emërimeve të anuluar kush do përgjigjet?

2-Qytetarja B.D ju drejtua Avokatit të Popullit me një ankesë ku shprehej shqetësimi i ligjshëm i nënës lidhur me fatin e djalit të saj, i cili ka qenë emigrant në Itali dhe që prej vitit 1999 nuk dihej vendndodhja e tij.

Pas kërkesës sonë pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, kjo e fundit na shpjegoi se për këtë çështje kishte vënë në dijeni Ambasadën tonë në Romë, e cila kishte filluar përpjekjet për gjetjen e djalit të saj. Policia italiane ishte vënë në kontakt me Zyrën Konsullore të Ambasadës sonë, dhe më në fund u arrit në zgjidhjen pozitive të problemit.

Në funksion të realizimit të funksioneve tona kushtetuese e ligjore, bashkëpunimi me grupin e punës të ngritur pranë kësaj Ministrie, për hartimin e raporteve për zbatimin e Konventave në të cilat vendi ynë ka aderuar ka rezultuar i frytshëm. Përmendim këtu kontributin e dhënë nga Institucioni ynë në mbledhjen e Komitetit të Drejtave të Fëmijës të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) që mori në shqyrtim raportin fillestar të paraqitur nga shteti shqiptar për zbatimin e Konventës të Drejtave të Fëmijës më 12 Janar 2005, në Gjenevë.

Nisur nga praktikat që kemi patur me këtë ministri, rastet e trajtuara kryesisht kanë qenë probleme të marrëdhënieve të punës, që lidheshin me Drejtorinë e Personelit apo Drejtorinë Juridike. Theksojmë se duhet të mbahen parasysh dhe të respektohen kërkesat ligjore që kanë të bëjnë me Kodin e Punës, me Ligjin "Per statusin e Nëpunësit Civil" si dhe Ligjin organik "Për Shërbimin e Jashtëm në RSH". Kjo ministri duhet ta forcojë sektorin e saj juridik, jo vetëm brenda Ministrisë, por edhe tek njerëzit që ka caktuar dhe cakton në detyra konsullore. Mungesa e eksperiencës dhe e arsimit juridik për konsujt që janë emëruar jashtë vendit, i bën ata formale dhe është një nga shkaqet kryesore që emigrantët

shqiptarë nuk marrin ndihmën e duhur sipas ligjit “Për shërbimin konsullor”.

14. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (ish Ministria e Kultures Rinise dhe Sporteve)

Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2005 kanë ardhur gjithsej 5 ankesa, kurse 3 ankesa i përkasin vitit 2004. Janë të përfunduara 6 ankesa, 1 është zgjidhur në favor, 2 të pabazuara dhe 3 kanë qënë jashtë juridiksionit. Kane mbetur në shqyrtim për vitin 2006, 2 ankesa.

Problematika e ankesave që kanë patur të bëjnë me këtë Ministri ka qënë kryesisht e lidhur me marrëdhëniet e punës, konkretisht për nderprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit të kesaj Ministrie.

Nga ankesat që janë në shqyrtim përmendim ankesën nga një grup nepunesish të Ministrisë së Turizmit, Kultures, Rinisë dhe Sporteve, për nderprerjen e marrëdhënieve të punës në këtë Dikaster.

Në objektin e kesaj ankesë janë tre persona të cilët gëzojnë statusin e nepunesit civil. Motivimi për largimin nga shërbimi civil, për shkak të ristrukturimit dhe shkurtimit të vendit të punës në organike, sipas pretendimeve të ankuesëve, është bërë në kundërshtim me Ligjin Nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi Nepunesit Civil”, si dhe VKM-se Nr.360, datë 14.07.2000 “Për lirimin nga shërbimi civil”, sepse vendet e tyre të punës nuk janë shkurtuar dhe nderkohe janë vënë në punë me kontrata persona të tjere.

Duke pretenduar se në rastin konkret, nuk janë respektuar detyrimet ligjore të parashikuara, ankuesët kanë kërkuar nderhyrjen tone institucionale, me qëllim rivendosjen në vend të drejtave të pretenduara si të shkelura.

Lidhur me këto çështje, Zyra jone iu drejtua me kerkese të perseritur për shpjegime Ministrisë së Turizmit, Kultures, Rinisë dhe Sporteve. Në fundi na është dërguar dhe një informacion sipas të cilit rasti i ankuesëve dhe i kolegeve të tjere të shkurtuar për shkak të ristrukturimit të Dikasterit, është në shqyrtim e sipër nga kjo Ministri, e cila ka premtuar se për zgjidhjen permanente do të na informojë në vijimesi.

Kjo çështje konsiderohet ende e hapur nga Zyra jone, në pritje të qëndrimit të metejshëm zyrtar të Ministrisë. Por ankuesët na kanë njoftuar se pas ankesës së tyre, organi kompetent, Komisioni i Shërbimit Civil, ka vendosur anulimin e urdhrit të Ministrisë për nderprerjen e marrëdhënieve të punës dhe rikthimin në detyrë.

15. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave

Gjatë vitit 2005 kemi patur 4 ankesa te drejtuara ndaj Ministrise se Mjedisit, e emertuar ne Shtator 2005 si Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave dhe kryesisht me problematikën e ndotjes së mjedisit. Nga keto 3 ankesa kane qene jashte kompetenceve dhe 1 ankese vazhdon te jete ende ne shqyrtim. Ky numer i ulet i ankesave te paraqitura kryesisht ne fushen e mjedisit, tregon per nje ndikim ende te vogel qe ka ndotja e tij ne ndergjegjen e individeve dhe per nje vemendje te paket qe tregohet nga ana e tyre, ne reagimin per nje mjedis me te paster dhe per nje shendet me te garantuar. Gjithsesi Avokati i Popullit ka patur gjithmone ne qender te vemendjes realizimin e standarteve te kerkuara te mjedisit, jo vetem te sanksionuara ne aktet nderkombetare te ratifikuara nga shteti shqiptar, veçanerisht nga Konventa e Arhusit, por edhe nepermjet zbatimit korrekt te Ligjit Nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.

Siç dihet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave dhe Inspektorati i Mjedisit jane organe te ngarkuara me ligj, qe krahas te tjerash, hartojne politika, mbikqyrin dhe marrin masa parandaluese dhe vene sanksione ndaj cdo subjekti apo veprimtarie qe permban rrezik te shtuar ne fushen e ndotjes se ambjentit, demtimit te shendetit te njerezve dhe ekosistemit ne pergjithësi. Sipas te dhenave qe disponon Avokati i Popullit, problemet e ndotjes ne Shqiperi, referuar edhe raporteve nderkombetare zyrtare apo organizatave joqeveritare, vazhdojne te jene te medha dhe mjaft te drejtperdrejta per shendetin dhe jeten e qytetareve. Kjo gje del qarte me evidentimin e disa zonave mjaft te ndotura ne Shqiperi, si rasti i depozitimit te plastikës ne Lushnje, Arsenikut ne Fier, clirimit te lendeve toksike ne Fabriken e Çimentos Elbasan, ndotjes nga veprimtaria e Kompanise “Kurum” ne fushen e perpunimit industrial te celikut ne Elbasan etj.

Ne jemi te vetedijshem se keto zona tejet te ndotura kerkojne projekte dhe financime te medha per rehabilitim dhe pastrim. Por kjo nuk do te thote qe te nenvleresohet puna qe duhet te bejne organet e ngarkuara me ligj per konstatimin e ndotjes, marrjen e masave per shmangien nga rreziqe te ndryshme te popullsise qe banon perreth, shpalljen e ketyre zonave “karantine” me iniciative te Ministrise se Mjedisit dhe miratim te Keshillit te Ministrave, matjen e ndikimit ne mjedis te ndotjeve te ndryshme dhe penalizimin e subjekteve te cilesuara si shkaktare te saj.

Gjithashtu si pjese perberese e kesaj ministrie ndaj Drejtorise se Përgjithshme te Pyjeve dhe Drejtorisë se Shërbimit Pyjor në rrethe ka patur dy ankesa ne shqyrtim (*te permendura ne statistikat e mesiperme*).

Njëra kishte të bënte me suprimimin e Drejtorisë të Shërbimit Pyjor të Qarkut Elbasan dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës te ish

drejtuesve dhe punonjesve të tjerë, ankesë e cila vazhdon të jetë në shqyrtim. Ndërsa objekti i ankesës së dytë ishte kundërshtimi i një kontrate të dhënies së një sipërfaqe pyjore me qira një personi fizik. Ankuesit në këto rast ju sugjerua të ndiqte rrugën gjyqësore sepse me këtë marrëdhënie juridike të lidhur midis palëve prekeshin interesat e tij.

Avokati i Popullit është perpjekur që veprimtaria e ish Ministrise së Mjedisit dhe Inspektoratit të Mjedisit dhe atyre Rajonale të realizohet në zbatimin korrekt të ligjit “Per Mbrojtjen e Mjedisit”.

Nga marrëdhëniet që kemi patur me këto organe, në kuader të shqyrtimit të ankesave konkrete, kanë rënë në sy disa mangësi administrative, të cilat janë bërë shkak për mospermbushje të plote të detyrës së këtyre organeve karshi të drejtave të individëve.

Avokati i Popullit ka evidentuar dhe ka nderhyrë në disa raste ku nepermjet ankesave të qytetarëve në zona të ndryshme në vend, është vënë re se Inspektoratet Rajonale të Mjedisit luajnë një rol inaktiv në permbushjen e detyrave të tyre funksionale. Konkretisht është konstatuar se këto struktura nuk arrijnë të kryejnë inspektimet me minimale në baze të ankesave të paraqitura, pasi nuk kanë logjistiken e nevojshme dhe numri i nepunësve në dispozicion të këtij shërbimi është tejet i vogël. Kjo gjë ka sjellë që për verifikimin e ndikimit të ndotjes në terren, të kërkohej një kohë relativisht e gjatë, e cila shkakton pa të drejtë vazhdimin eventual të ndotjes së mjedisit apo rrezikimin e jetës dhe shëndetit të personave.

Gjithashtu është konstatuar se inspektimet dhe kontrollet ndaj subjekteve të ndryshme apo në terrenet e ndotura, kryhen vetëm nepermjet ankesave apo urdhrave që vijnë nga ministria e linjes dhe nuk janë pjesë e një plani apo nuk ushtrohen sipas një strategjie kontrolli në terren të planifikuar paraprakisht. Kjo mënyrë organizimi e punës, megjithë aktet e reja nenligjore që janë miratuar për këto lloje shërbimi, vazhdon të ngelet një handikap i madh, i cili duhet të përmiresohet konform legjislacionit në fuqi. Forca e ligjit që duhet të veprojë në kuader të mbrojtjes së mjedisit dhe parandalimit të ndotjes duhet të jetë e menjehershme, sepse nga vete natyra e saj, ajo përfaqëson një rrezik real që nuk i pengjan asnjë lloj fenomeni tjetër në fushën e administrimit shtetëror. Krahas kësaj, shpesh herë është konstatuar se prania në terren e inspektoreve të mjedisit nuk bashkeshoqerohet me mjete dhe pajisje matese për ndotjen. Kjo logjistike me mungesa të mëdha në aparaturo të posaçme bashkekohore, ka sjellë si pasojë që verifikimet e kontrollet të mbartin një peshe subjektive dhe të mos prezantojnë realisht ndikimet në terren të ndotjeve të ndryshme. Si rezultat i këtyre mangësive, Inspektorati i Mjedisit e ka të pamundur të kryejë ekspertiza të mirefillta të ndotjeve dhe të masë sasine specifike të tyre në ambient. Rast për t’u përmendur është edhe denoncimi i Avokatit të Popullit për rrezatimet e

antenate AMC – Vodafone, çka kerkoi angazhimin e specialisteve dhe aparatave te huaja per saktesimin e pretendimit te qytetareve. Si rrjedhim, mendojme se pajisja e ketyre strukturave me aparatat e nevojshme duhet te jete nje detyre primare e politikave qeveritare per mjedisin dhe do te perbeje nje shans te mire bashkepunimi edhe per Zyren e Avokatit te Popullit ne kryerjen e ekspertizave te ndryshme specifike ne terren.

Duke e konsideruar veprimtarine e Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave mjaft te rendesishme per permiresimin e cilesise se jetes dhe ambjentit qe na rrethon, mendojme se veprimtaria e saj duhet te jete me teper aktive ne te ardhmen me qellim permbushjen sa me te mire te standarteve te kerkuara .Si rrjedhim, Avokati i Popullit ka kerkuar dhe do te kerkoje me teper aktivitet dhe bashkepunim nga ana e Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave per te perballuar me sukses sfidat e ambjentit.

Probleme për pyjet

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve dhe Drejtorinë e Shërbimit Pyjor në rrethe ka patur 2 ankesa. Njëra kishte të bënte me suprimimin e Drejtorisë të Shërbimit Pyjor të Qarkut Elbasan dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të ish drejtuesve dhe punonjesve të tjerë, ankesë e cila vazhdon të jetë në shqyrtim. Ndërsa objekti i ankesës së dytë ishte kundërshtimi i një kontrate të dhënies së nje sipërfaqe pyjore me qira një personi fizik. Ankuesit ju sugjerua të ndiqte rrugën gjyqësore sepse me këtë marrëdhënie juridike të lidhur midis palëve prekeshin interesat e tij.

16. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

Gjatë vitit 2005 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit janë regjistruar 10 ankesa. Në favor të shtetasve janë zgjidhur 2 të tilla. Në këtë pjesë të Raportit, do të prezantojmë dhe ankesat që kemi patur për çështje të ligjit “Për tokën” dhe ankesat për pasurinë e ish kooperativave bujqësore.

a) Ankesa për çështje të Ligjit “Për Tokën”

Ankesat që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën” dhe kontestimet e ish pronarëve të tokave bujqësore lidhur me të, kanë një ulje të konsiderueshme me ato të vitit të kaluar. Kështu nga 53 ankesa të tilla për vitin 2004, në vitin 2005 janë të regjistruara 24, përveç 14 ankesave të mbartura nga viti 2004. Janë përfunduar 31 ankesa, nga të cilat 2 janë zgjidhur në favor të ankuesve duke u pajisur shtetasit Q.V. dhe Sh.L. me tokë bujqësore në pronësi nga

Komisionet e Tokave të Komunave Dushk të rrethit Lushnjë dhe Lukovë të rrethit Sarandë, ndërsa 7 të tjera janë në shqyrtim. Edhe këto kanë të përbashkët faktin, se ankuesit pretendojnë se nuk janë pajisur plotësisht apo pjesërisht me tokë bujqësore sipas normave për frymë.

Ulja e ndjeshme e ankesave për çështje që kanë të bëjnë me problemin e kalimit në pronësi private të tokës bujqësore është në rradhë të parë për faktin se ky proces, pas shumë debateve dhe oshilacioneve në segmentin kohor të 15 vjetëve, po i afrohet përfundimit të tij.

Megjithatë objekti i ankesave të familjeve bujqësore adresuar institucionit tonë mbetet i njëjtë: mosdhënia apo mosplotesimi me tokë bujqësore në pronësi i subjekteve që përfitojnë nga Ligji nr.7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën” dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të tij. Edhe shkaqet mbeten të njëjta : mos funksionimi i komisioneve të tokave në shumë fshatra, megjithëse ekzistojnë formalisht, mungesa e vullnetit të tyre për të trajtuar familjet e mbetura pa tokë për shkaqe të ndryshme, mos ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë me të cilat janë detyruar komisionet e tokës në fshat apo komunë për trajtimin e gjyqfituesve sipas legjislacionit për tokën. Por problemi më shqetësues mbetet mungesa e fondit të tokës bujqësore të lirë në dispozicion të komisioneve të tokave për t’u ndarë familjeve bujqësore që për shkaqe të ndryshme, kryesisht për krijimin e mbivendosjeve të parcelave nga puna e papërgjegjshme e disa komisioneve në fshatra dhe komuna, ka krijuar një kategori të veçantë subjektësh përfituese, pa tokë. Kjo është shumë e evidente në Komunitat Katund i Ri dhe Rrashbull të rrethit Durrës ku janë mase 214 familje pa tokë, në Komunën Milot, në Komunën Bogovë të Skraparit, etj. Shifra e familjeve të tilla nuk është e vogël, pavarësisht mungesës totale të statistikave. Një ankesë e veçantë ka qënë ajo e një grupi familjesh nga Ksamili që me të drejtë ankoheshin për faktin se 577 familje janë pa tokë për shkak të shpalljes së tokave të NB-se vendase si zonë elitare në fushën e turizmit. Këtë shqetësim të komunitetit të zonës së Ksamilit, në muajin Mars e përcollem dhe kërkuam nga ish Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, nga Komisioni Qeveritar i Tokës dhe nga ish Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit mendimin e tyre për këtë problem dhe për ndryshimet e nevojshme në aktet ligjore dhe nënligjore që këto institucione mendojnë se duhen bërë për zgjidhjen e shpejtë dhe përfundimtare të saj. Ish Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit ne përgjigjen e saj na bëri të ditur se ishin në dijeni të problemit dhe informacioni përkatës i kësaj Ministrie dhe i Komisionit Qeveritar të Tokës, i është dërguar Kabinetit të Kryeministrit. Në vazhdim doli VKM nr. 373, datë 31.5.2005 “Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.60, datë 21.2.1994 të Keshillit të Ministrave “Për dhënie toke në përdorim 577 familjeve fshatare, banorë të ish NB Ksamili” të ndryshuar” me të cilën familjet e ardhura në territorin e ish NB Ksamili pas datës 1.9.1991

dhe të regjistruara në gjëndjen civile të Komunës Ksamil deri në datën 16.5.2005, ju kalon toka në pronësi.

Po në muajin Mars të vitit të kaluar i është dërguar një rekomandim Komisionit Qeveritar të Tokës, me anën e të cilës i sugjerohej të bëhej evidentimi i të gjitha rasteve të mos dhënies të Tokës bujqësore në pronësi familjeve bujqësore dhe bashkëpunimin me institucione të tjera qëndrore që kanë detyra konkrete në këtë kuadër dhe me Komisionet e Tokave në Qarqe, Komuna dhe Bashki, për sigurimin e fondit të tokës për familjet që nuk janë pajisur me të. Për dijeni ky rekomandim ju dërgua zv/kryeministrit dhe Kryetarit të Komisionit Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese, Tregëtisë dhe Turizmit. Këshilli i Ministrave miratoi VKM nr.291, datë 6.5.2005 “Për disa ndryshime në VKM nr.230, datë 22.7.1991 “Për krijimin e komisioneve të tokave” ku i është dhënë një zgjidhje e pjesëshme rekomandimit, duke shtuar paragrafe që detyrojnë komisionet e tokave në fshat dhe komuna të trajtojnë familjet që ende nuk kanë gjetur zgjidhje ligjore. Megjithatë, mungesa e tokës bujqësore do të mbetet një problem edhe për këtë vit dhe pengesë serioze për përfundimin e zbatimit të ligjit “Për tokën”. Për më tepër që së shpejti do të fillojë edhe procedura e kompensimit të pronave subjekteve të shpronësuara, gjatë të cilës të ezaurohet edhe ai fond toke që mund të kalonte për familjet pa tokë.

Lidhur me ankesat që kishin të bënin me tokat e ish Ndërrmarjeve Bujqësore në rrethet e Korçës, Vlorës dhe Elbasanit, të pezulluara pjesërisht ose tërësisht për intervale të gjata kohe, konstatojmë se pas verifikimeve të bëra dhe realizimit të detyrave të lëna nga kontrollet e Prefektuarave dhe Departamentit të Kontrollit të Brëndeshëm Administrativ në Këshillin e Ministrave, kanë filluar të shqyrtohen për t’u dhënë zgjidhjen përfundimtare, me përjashtim të NB Uji i Ftohtë Vlorë, ku proçesi i verifikimit të vendimeve të Komisioneve të Tokës për dhënie të tokës në pronësi vazhdon.

b) Ankesa për pasurinë e ish kooperativave bujqësore

Për vitin 2005 ka patur edhe 3 ankesa të tilla. Të gjitha kishin të bënin me mosmarrjen e kontributit në vlerë të pasurisë së ish kooperativave bujqësore. Pas konfirmimit nga Drejtoria e Buxhetit në Ministrinë e Financave që shuma e këtyre kontributeve prej afro 50 milion lekësh e depozitur në Bankën e Kursimeve, pas privatizimit të saj nga Raiffaisen Bank, ka kalur në buxhetin e shtetit, ju kemi sugjeruar ankuesve rrugën gjyqësore për tërheqjen e këtij kontributi në vlerë si ish anëtar i ish kooperativës bujqësore.

17. Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

Komiteti i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk varet më nga Qeveria, por vepron si institucion qëndror i pavarur. Ai ka në varësi Komisionet pranë Qarqeve.

Ankesat e shtetasve për Komisionet e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) për vitin 2005 janë 39 ose 40% më shumë se në vitin 2004. Ndërsa 7 ankesa të tjera ishin të mbartura nga viti paraardhës. Nga këto, janë përfunduar 41 ankesa nga të cilat 10 janë zgjidhur në favor të ankuesve, dhe 5 të tjera kanë kaluar për trajtim për vitin 2006. Objekti i ankesave vazhdojnë të jenë pretendimet për zvarritje në shqyrtimin e kërkesave nga Komisionet për njohjen dhe kthimin fizik të pasurive të palujtëshme, si dhe kundër vendimeve të tyre përfundimtare. Nga verifikimet e bëra rast pas rasti, ka dalë se një pjesë e konsiderueshme e tyre ishin të pabazuara, pasi dokumentacioni i depozituar pranë Komisioneve ka patur mangësi të theksuara, të tilla si mungesa e gjeneve, mospërcaktimin e saktë të kufinjve për identifikim të pronës së pretenduar, mungesës të vendimeve gjyqësore në rastet e mos pasjes së aktit të pronësisë, e të tjera si këto, që kanë bërë praktikisht të pamundur shqyrtimin e tyre. Një pjesë e ish pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre, duke u ndodhur jashtë shtetit për motive ekonomike, nuk kanë patur kontakte me Komisionet për të verifikuar vonesat në trajtimin e kërkesave për njohje dhe kthimin e pronave. Për të gjitha këto raste, të vlerësuara si të pabazuara, j'u është sugjeruar ankuesve të plotësojnë sa më shpejt dokumentacionin e duhur, shoqëruar me kopjen e ligjit të ri dhe sqarimet e duhura për hyrjen në fuqi të tij dhe të kërkesave kryesore proceduriale për realizimin e këtij procesi. Nga shoqata të ndryshme lokale të të shpronësuarve, siç është ajo e fshatit Qeparo, ka patur kontestime për nene të veçanta të Ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" që kanë të bëjnë me kufizimet e sasisë së tokës bujqësore të kthyer, ose me mos njohjen dhe abrogimin e Ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën".

Nga çështjet e shqyrtuara, ato që kishin të bënin me kontestimet për vendimet e KKK te Pronave, duke qënë se janë jashtë juridiksionit tonë, ju është bërë e ditur se duhet bërë kundërshtimi i tyre në rrugë gjyqësore. Një ankesë tjetër, ajo që i takonte shtetasit F.B. banues në Tirane, është zgjidhur pozitivisht. Personi në fjalë ankohej për vonesa të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në shqyrtimin e kërkesës për njohje dhe kthim prone. Ndërhyrja jonë mundësoi shpejtimin e trajtimit të dosjes së personit të shpronësuar. Edhe ankesat e tjera të zgjidhura në favor të ankuesve kanë patur të njëjtën problematike.

Marrëdhëniet tona institucionale me Komitetin Shtetëror dhe me Komisionet e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në Qarqe, për periudhën që trajtojmë, kanë qënë të mira. Përgjigjet e kthyerat kanë qënë brënda afateve ligjore dhe të argumentuara në shpjegimet e tyre për çdo

rast. Megjithatë specifike për vitin 2005 ka qënë koha e shkurtër gjatë të cilës KKK të Pronave kanë ushtruar kompetencat e tyre. Shqyrtimi i dosjeve të subjekteve të shpronësuar ka filluar në muajin Prill të vitit 2005. Kjo ka ardhur në pjesën më të madhe, si pasojë e pezullimit të aktivitetit të tyre pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës” e në vazhdim, në pritje të daljes të akteve nënligjore në zbatim të tij, riorganizimit të Komisioneve vendore, dhe të përgatitjes dhe miratimit të metodologjisë për vlerësimin e pasurisë së palujtshme që do të kompensohet. Shkaku që 5 ankesa janë mbartur për shqyrtim të mëtejshëm për në vitin 2006, ka qënë pezullimi i tyre deri në përgatitjen e kuadrit të plotë nënligjor dhe rifillimit të punës normale të Komisioneve vendore. Për shkak të vështirësive që mbart zgjidhja teknike e problemit të kompensimit të pronave, janë kapercyer afatet e parashikuara nga vetë ligji.

Një problem që nuk po gjen zgjidhje, që njëkohësisht është edhe objekt i disa ankesave, është ai i kthimit të pronave në bazë të VKM nr.161, datë 8.4.1993 “Për disa ndryshime në VKM nr.452, datë 13.10.1992 “Për ristrukturimin e NB”. Thuajse në të gjitha rrethet ky proces ka ecur me shumë vështirësi, ndërsa në rrethin e Vlorës, kthimi i tokave të ish NB së në Ujin e Ftohtë është i pezulluar prej më se një viti nga Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, dhe nga muaji Dhjetor i vitit 2005 edhe nga Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme, për të bërë verifikimin e vendimeve të dhënies së tokave në pronësi, në të njëjtë kohë, nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Qarkut Vlorë dhe Komisioni i Tokës së Bashkisë së qytetit të Vlorës, si dhe evidentimin e tokave të lira për subjektet përfitues që për shkaqe të ndryshme nuk kanë marrë tokë në pronësi.

18. Ankesa për Sherbimet Sekrete

Gjatë vitit 2005 në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë ardhur 8 ankesa, kundër veprimeve apo mos veprimeve të Sherbimit Informativ Shtetëror (SHISH).

Për shkak të natyrës së këtyre sherbimeve, ankesat dhe kërkesat janë parë me përparësi dhe kujdes të posaçëm, duke i verifikuar në mënyrë të hollësishme. Si rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe verifikimit të tyre, ka rezultuar se 6 ankesa kanë qenë të pabazuara dhe një ankesë ka qenë e drejtë.

Po përmendim disa ankesa:

1. Dy persona, S.V. dhe L.DH. nga Tirana, jane ankuar se jane larguar nga detyra ne Sherbimin Informativ Shteteror pa te drejte.

Nga verifikimi ankesave dhe dokumentave te paraqitura, doli se ankuesi S.V., gjate kontrollit te ushtruar per zbatimin e detyrave te ngarkuara, e ka vleresuar punen e tij me te meta dhe dobesi te theksuara dhe se ne linjen qe ai mbulonte, ishin shkelur rregulloret perkatese te ketij sherbimi. Ndersa L.Dh., kishte shkelur parimin e sinqeritetit ne plotesimin e dokumentacionit, kur kishte filluar pune ne Sherbimin Informativ Shteteror.

2. Y.H. nga Lushnja eshte ankuar, se struktura te caktuara i pergjonin bisedat familjare. Por nga verifikimi hollesishem i kryer u vertetua se pretendimi tij ishte i pabazuar, per arsye se nje veprim i tille ka procedura ligjore shume rigoroze.

3. K.H. nga Tirana eshte ankuar se, pasi e kane larguar nga detyra nuk i jepnin urdherin dhe motivacionin e largimit nga puna. Pas nderhyrjes se zyres tone, e cila vleresoi se kerkesa ishte e drejte dhe e bazuar ne ligj, ju dha urdheri perkates me shkrim ankuesit per te vazhduar procedurat ligjore te ankimit ne gjykate.

4. N.A. nga Tirana eshte ankuar, se pasi ishte larguar pa te drejte nga puna, nuk i kishin llogaritur shtesen e pensionit si punonjese ilegale. Pas verifikimit te kryer nga zyra jone eshte vertetuar, se masa e pensionit ishte llogaritur sakte, sipas dokumentacionit te administruar ne dosje.

5. Pas shume kohesh nga Ministria e Mbrojtjes eshte zbatuar Rekomandimi i Avokatit te Popullit, per kthimin ne pune te ish punonjesit te SH.I.U.-ut M.SH., i cili ishte larguar padrejtesisht nga puna, çeshtje qe eshte pasqyruar ne Raportin vjetor 2004.

Perveç kesaj nga ana institucionit te Avokatit te Popullit, kur Sherbimit Informativ Shteteror, i eshte dashur ndihma jone ligjore dhe nderhyrja ne organet me te larta qendrore, per problemet qe kishin te benin me te drejtat e punonjesve te ketyre sherbimeve, siç ishte rasti i ligjit “Per Statusin e Punonjesit te Sherbimit Informativ Shteteror” ndihma e institucionit tone ka qene maksimale.

Kemi patur vërejtje ndaj Sherbimit Informativ Shteteror per zbatimin rigoroz te rregullores per masat disiplinore qe merren ndaj punonjesve te ketij sherbimi. Kjo per arsye, se shume here masat e dhena nga ky sherbim per largimin nga puna te punonjesve, nuk perputhen me nenet perkatese te Rregullores se brendeshme te ketij sherbimi. Zyra jone gjate bashkepunimit institucional me kete sherbim i ka terhequr vemendjen, lidhur me dhenien e urdherit te lirimit per punonjesit, ndaj te cileve merren masa per largimin nga puna. Megjithe vërejtjet e bera, ky sherbim vazhdon akoma te ndjekë kete praktike te gabuar ne marrredheniet me punonjesit e saj, te cileve per shkak te ketij

dokumenti, u mohohet e drejta e tyre ligjore per te ankimuar urdherin ne institucionet e tjera ligjore.

Keta persona te larguar pa te drejte nga puna u jane drejtuar organeve gjyqesore, ka ndodhur qe i kane fituar gjyqet dhe kerkojne zbatimin e vendimeve gjyqësore.

19. Veprimtaria e Nënseksionit të të Drejtave të Fëmijëve

Nënseksioni i të Drejtave të Fëmijëve u krijua në Prill të vitit 2004, si pjesë e Seksionit të Përgjithshëm të Institucionit të Avokatit të Popullit, mbi bazën e një marrëveshjeje midis Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Organizatës Save the Children. Avokati i Popullit synon te jape nje kontribut te veçante ne luften per mbrojtjen e te drejtave te femijeve, si me ane te trajtimit te ankesave individuale dhe te hetimit me iniciativen e tij te rasteve te bera publike, por edhe me ane te shqyrtimit te legjislacionit dhe rekomandimeve per ndryshime apo permiresime te nevojshme.

Organizatata jofitimprurëse vendase dhe te huaja, luajne nje rol te rendesishem duke u siguruar sherbime te ndryshme femijeve-viktima, si asistence ligjore falas, bejne pune hulumtuese, publikojne raporte mbi gjendjen e te drejtave te femijeve, si dhe organizojne trajnime te ndryshme per edukimin e zyrtareve publike duke rritur ndergjegjesimin e tyre. Per kete arsye, eshte i rendesishem krijimi i mekanizmave te bashkepunimit me to, dhe në këtë kuadër ka filluar dhe bashkëpunimi i Zyrës sonë me Save the Children. Nënseksioni aktualisht ka dy Ndhimëskomisionerë, një nga të cilët paguhet nga Save the Children.

Lidhur me veprimtarinë e Nënseksionit gjatë vitit 2005, si pjesë organike e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, mund të përqëndrohemi e të përmbledhim këto drejtime kryesore:

1. Permiresimi i ligjit organik "Per Avokatin e Popullit" dhe ndikimi ne punen e Nenseksionit.

Si rezultat i veprimtarisë 5 vjeçare të Institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave e lirive të individëve, u konsolidua mendimi se ishte i nevojshëm edhe amendimi (plotësimi) i ligjit "Për Avokatin e Popullit", për të zgjidhur disa probleme që dolën gjatë zbatimit në praktikë të tij për të mbrojtur fëmijët. Kjo gjë tashmë është bërë realitet me miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë të Ligjit nr.9398, datë 12.05.2005 "Për disa ndryshime në Ligjin nr.8454 date 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit". Ndër të tjera si më te rëndësishmem për tu përmendur në këtë kontekst janë neni 13 dhe neni 19/1 të këtij Ligji, që i dhane frymëmarrje dhe mundësi më të mëdha veprimi vetë nënseksionit

për të drejtat e fëmijëve, duke lejuar shqyrtimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të fëmijëve me iniciativë dhe pa pasur kufizimin për marrjen e pëlqimit të palës së dëmtuar. Në mënyrë të shprehur neni 19/1 i përmend institucionet shtetërore apo të administratës publike ku Avokati i Popullit apo personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit: burgje, dhoma paraburgimi, në reparte apo institucione shtetërore, spitale psikiatrike, në azile, në shtëpi fëmije. Pra janë përfshirë edhe shtëpitë e fëmijëve.

1.1. Raportimi ne Gjeneve per Konventen Mbi te Drejtat e Femijeve.

Në mbledhjen e datës 12 janar 2005, në Gjenevë, Komiteti i të Drejtave të Fëmijës të OKB-së që mori në shqyrtim Raportin Fillestar të paraqitur nga Shteti Shqiptar, për zbatimin e Konventës së të Drejtave të Fëmijës vlerësoi si një arritje në kuadrin e mbrojtjes së të Drejtave të femijeve në nivel institucional krijimin e Nenseksionit të të Drejtave të Femijeve pranë Zyres së Avokatit të Popullit.

Zbatimi i detyrimeve që dalin nga rekomandimi i mesiperm ishte një nga prioritetet e Nenseksionit në punën e tij gjatë vitit 2005 dhe perkon me objektivat e percaktuara në projektin e perbashket midis Zyres së Avokatit të Popullit dhe Save the Children.

1.2 Informacion për detyrat që dalin nën frymen e vezhgimeve dhe rekomandimeve të Komitetit për të Drejtat e Femijes.

Me datën 16.03.2005 Avokati i Popullit i dergoi Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë dhe Kryeministrit, një informacion lidhur me rekomandimet e Komitetit të të Drejtave të Femijes të OKB-së si dhe detyrat që i dalin Nenseksionit për të Drejtat e Femijeve.

2. Pjesëmarrja në punën për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Femijet dhe Planin e Veprimit të kësaj Strategjie, miratuar me VKM nr.368, datë 31.05.2005 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për femijet 2005-2010”. Nepermjet perfaqesuesit të tij në grupin e punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Femijet dhe Planin të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Femije, Nenseksioni ka mundur të identifikohet si një nga aktoret kryesore, që jo vetëm mëson pjesë në hartimin e këtyre dokumentave, por do të luajë një rol primar në implementimin e Strategjisë dhe të Planit të Veprimit të hartuar në përputhje me detyrat e vena nga Komiteti i të Drejtave të Femijes të OKB, gjatë shqyrtimit të raportit fillestar të Shqipërisë për zbatimin e Konventës dhe në përputhje me objektivat e shtetit shqiptar për implementimin e Konventës të të Drejtave të Femijes.

3. Konferenca Kombëtare vjetore.

Me 15 Dhjetor 2005 Nenseksioni per te Drejtat e Femijeve ne bashkepunim me UNICEF, Shqiperi dhe Save the Children, Shqiperi, organizuan Konferencen Kombetare me teme "Te gjithë se bashku ne mbrojtje te te drejtave te femijeve". Eshtë pasqyruar në veçanti në këtë Raport vjetor.

4. *Çeshtje konkrete te trajtuara nga Nenseksioni si dhe nga gjithë Institucioni i Avokatit te Popullit, gjate vitit 2005, qe kane lidhje me te drejtat e femijeve.*

Me qellim qe te stimuloje nje reflektim dhe veprimtari sa me te madhe ne drejtim te mbrojtjes se femijeve, Avokati i Popullit, ka trajtuar me perparesi rastet e abuzimit, keqtrajtimit dhe shkeljes se te drejtave te femijeve, qe ne fillim te ushtrimit te aktivitetit te tij ne fushen e mbrojtjes se te drejtave te njeriut.

Gjate vitit 2005, Zyra e Avokatit te Popullit duke perfshire dhe Nenseksionin per te Drejtat e Femijeve, ka shqyrtuar gjithsej 39 raste ankesash qe kishin lidhje me te drejtat e femijeve.

Nga keto jane ne shqyrtim 2 prej tyre, 15 kane rezultuar jashte juridiksionit apo kompetences se Avokatit te Popullit, 8 ankesa te pabazuara, 10 prej tyre jane zgjidhur ne menyre pozitive, 3 ankesa jane konkluduar me rekomandime te pranuar nga organet e administrates si dhe rezulton dhe 1 ankese per te cilen eshte bere rekomandim, por qe nuk eshte pranuar nga organi te cilit i jemi drejtuar.

Konkretisht, objekt i ketyre ankesave ne pergjithesi ka qene i lidhur me trajtimin e veçante te femijeve, me ndarjen e femijeve nga te rriturit ne dhomat e paraburgimit apo ne vendet e vuajtjes se denimit, me te drejten e prezences se prindit gjate pyetjes se tyre, me te drejten per nje gjykim sa me te shpejte, me te drejten per te jetuar me prindin qe i eshte besuar per rritje dhe edukim ne rastet e zgjidhjes se martesës, me mosregjistrimin e femijeve nga Zyrat e Gjendjes Civile prane Bashkive, probleme te mosperfitimit te se drejtes se kujdestarise per femijet me aftesi te kufizuara, probleme te mosperfitimit te pensionit familjar per femijet e mbetur jetime pas vdekjes se nje prindi, mostrajtimin e duhur mjekesor per femijet e semure, mosekzekutim vendimesh gjyqesore qe kane lidhje me femijet, etj,

Ashtu si ligjet e mjaft shteteve të tjera që e kanë këtë institucion, edhe ligji shqiptar nuk i ka dhënë Avokatit të Popullit fuqi vendimmarrëse në raport me organet e administratës, por vetëm të drejtën e rekomandimeve përkatëse.

Konkretisht po paraqesim permbledhtas tre rastet, dy prej te cilave eshte konkluduar me rekomandim nga Zyra jone.

1. Ankesa e prindit të vajzës Jonida Dervishi, është nje nga ankesat me te ndjeshme e me te dhimbshmet qe kane ardhur prane Zyres sone, lidhur me nje ngjarje te ndodhur ne vitin 1999 ne Berat kur tre

kriminele qe ndiqeshin nga Forcat e Nderhyrjes se Shpejte te Policise, kane hyre ne shtepine e nje qytetari dhe kane mare peng vajzen e tij 7 muajshe. Gjate asgjesimit te krimeleve nga forcat e policise, eshte plagosur rende ne bark dhe ne kembe vajza. Rasti është pasqyruar në pjesën e Raportit për Policinë.

2. Ankesa e A.K, nga Burreli, paraqitej shqetesimi i ligjshem i nje gjyshi per fatin e te mbeses se mitur me moshe 3 vjeçe e 6 muajëshe, shumë e sëmurë nga zemra dhe në rrezik për jetën. Rasti është përmendur në pjesën e raportit për Policinë.

3. Shtetasi V.Xh nga Bilishti, parashtroi se ne dt. 22 Nentor te vitit 2004, se bashku me familjen e tij, gruan dhe tre femije, si dhe 4 persona te tjere u nisen per te emigruar ilegalisht ne Greqi. Policia Greke i ndaloi duke i kthyer ne Shqiperi, por duke i mbajtur pa te drejte njerin nga femijet Me tu kthyer ne Bilisht ai eshte ankuar ne Komisariatin e Bilishtit per mbajtjen e padrejte te femijes nga ana e autoriteteve greke. Pas tre muajsh ne Follorine u zhvillua gjykimi per kthimin apo jo te femijes ne familjen biologjike. Kaluan 5 muaj nga gjykimi dhe famija nuk ka asnje njoftim, vetem se kane *degjuar nga televizioni grek qe femija eshte strehuar ne shtepine e femijes Selanik.*

Zyra jone kontaktoi dhe i kerkoi nje informacion lidhur me kete çeshtje Konsullates Shqiptare ne Selanik dhe me pas dhe Departamentit te te Drejtave te Femijeve prane Ombudsmanit te Greqise. Ky i fundit u investua seriozisht ne dhenien e ndihmeses per zgjidhjen e problemit. Kjo nepermjet gjetjes se mbeshtetjes aq te nevojshme financiare per testin e AND-se se femijes gjate procesit gjyqesor. Pritet që fëmija t’u kthehet familjarëve në Bilisht.

4. Permendim se me iniciative Avokati i Popullit inspektoi natën dy Qendra te Fshatit SOS. Ai u takua me te rinjte banore ne dy qendrat rinore, perkatesisht njera ne zonen e Tiranes se Re dhe tjetra ne rrugen “Don Bosko”. Kjo ne kuadrin e angazhimit te Zyres se Avokatit te Popullit per t’u njohur nga afer me kushtet e banimit ne keto qendra si dhe me problematiken e marredhenieve banore-edukatore-komunitet. Avokati i Popullit e shfrytezoi kete rast per t’u folur te rinjve per te drejtat e njeriut si dhe per rruget e mbrojtjes se tyre ne nje shtet demokratik.

Te rinjte e informuan Avokatin e Popullit per marredheniet me njeri-tjetrin dhe me kujdestaret, sikunder nuk hezituan te ngrene edhe disa probleme te natyres administrative. Krahas kesaj, te rinjte kerkuan ndihmen e Avokatit te Popullit per te bere te njohur prane autoriteteve me te larta publike, kerkesat e tyre per zbatimin e normativave te Ministrise se Arsimit si dhe per mundesi me te shumta per te rinjte e talentuar per te ndjekur shkollat profesionale.

5. Çeshtja e femijeve te zhdukur ne Greqi.

Avokati i Popullit është marrë me trajtimin e rasteve me natyrë me kompleksë dhe nderkombetare sic është ai i zhdukjes së rreth 500 femijeve Shqiptare nga një institucion i kujdesit të femijeve në Greqi. Hetimet e Ombudsmanit Grek konfirmuan se, në të vërtetë, një numër i madh femijesh, kanë ikur nga institucioni kujdestar “Agia Varvara” ku ata ishin vendosur gjatë periudhës 1998-2002, dhe zyrtarisht quhen të “zhdukur” sepse atyre nuk i dihet vendndodhja nga policia ose autoritete të tjera. Persa i përket trajtimit të çështjes “Agia Varvara” Departamenti i të Drejtave të Femijeve pranë Ombudsmanit të Greqisë ka theksuar se kanë vetëm rolin e “observerit”. Pra ata nuk nderhyjnë direkt për rikthimin e femijeve, por ndikojnë që Qeveria ta zgjidhë sa më shpejt dhe në interesin më të lartë të femijeve. Tashmë lista me emrat e këtyre femijeve është sjelle nga Ombudsmani Grek, dhe vijon korrespondenca me palën greke lidhur me këtë problem. Fale ndjekjes hap pas hapi nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit kjo çështje ka fituar përmasa nderkombetare dhe po ndiqet penalisht si në Shqipëri ashtu dhe në Greqi. Gjithashtu është përgatitur një Projekt marrëveshje zyrtare midis dy shteteve për të kthyer në siguri fëmijët e rrugës.

6. Fushata Sensibilizuese

6.1 Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndermarrë një fushatë sensibilizimi në shumë drejtime për njohjen dhe respektimin e të drejtave të femijeve dhe kjo është pasqyruar jo vetëm në korrespondencat tona nderinstitucionale por dhe në median elektronike dhe të shkruar. Për fat të keq në Shqipëri nuk ekziston ende një përmbledhje unike që të përfshijë të gjitha aktet ligjore dhe nën ligjore që kanë të bëjnë me të miturit, dispozitat që ekzistojnë në lidhje me të miturit janë të shpërndara në shumë akte të ndryshme ligjore.

Duhet të kujtojmë se duke parë me shqetësim pjesëmarrjen e gjere të femijeve në fushatat elektorale para vitit 2005, para zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, më 20.05.2005, në mjediset para godinës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Avokati i Popullit bëri një *Deklaratë per median*, me synimin e sensibilizimit të të gjitha forcave politike shqiptare për të mos përfshirë fëmijët në ethet e mitingjet elektorale. Në këtë Deklaratë u theksua se nuk duhet harruar që fëmijët nuk kanë pjekurine intelektuale, fizike apo mendore njesoj si të rriturit, dhe shpesh as vete ata nuk e kuptojnë qëllimin e këtyre organizimeve apo mitingjeve. Prandaj mosha për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur është caktuar 18 vjeç e lart. Është pikërisht kjo arsyeja që ata kanë nevojën për një mbrojtje të veçantë. Ata duhen mbrojtur jo vetëm nga neglizhenca apo abuzimi, por edhe nga përgjegjësitë që kalojnë tej aftësitë të tyre. Në jo pak raste në tubime gjë shprehje gjuha e konfliktualitetit dhe akuzave respektive teper të renda.

Mbrojtja e te drejtave te femijeve duhet te perbeje nje prioritet per te gjitha forcat politike. T'u kultivojme atyre tolerancen, nje fryme me te madhe mirekuptimi, humanizmin, shpirtin konkurues dhe ambicjet pozitive, por jo ndjenjen e ndarjes dhe konfliktualitetit, qe shpesh perçon fushata elektorale. Nuk duhet te harrojme qe mjedisi i jetes dhe i veprimtarise se femijeve luan nje rol percaktues ne edukimin dhe formimin e karakterit dhe personalitetit të tyre. Ata jane qytetaret e ardhshem dhe le t'i edukojme ata te jene sa me te denje per Shqiperine. Vetem keshtu do te kemi frytet e nje pune me vlere njerezore, edukuese e mbi te gjitha me vlere kombetare. Avokati i Popullit beson ne mirekuptimin e paleve politike si dhe angazhimin e tyre per nje fushate sa me qytetare dhe me mesazhe shprese, si per elektoratin e sotem ne teresi, ashtu edhe per elektoratin e neserm, pra shtresen e femijeve ne veçanti.

7. Projekti i perbashket 3 vjeçar me Save the Children.

Save the Children aplikoi prane SIDA-s (Agjensise Suedeze per Vendet në Zhvillim) për financimin e ngritjes së kapaciteteve institucionale dhe forcimin e ketij nenseksioni. Ky projekt u miratua ne Janar 2006 dhe do te shtrihet ne nje periudhe kohore prej tre vjetesh dhe perfshin shume aktivitete per mbrojtjen e te drejtave te femijeve ne perputhje me Konventen, instrumentat e tjere nderkombetare, ligjet dhe aktet nenligjore ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Gjithashtu ky projekt perfshin rritje te ndergjegjesimit te opinionit publik per misionin dhe rolin e Nenseksionit per te drejtat e femijeve, ndertim kapacitetesh, asistencë teknike, mbeshtetje infrastrukturore, forcim institucional, pune kerkimore, nderhyrje direkte ne rast shkelje te te drejteve te femijeve, pjesmarrje te femijeve, etj. Me konkretisht, disa nga aktivitetet me te rendesishme te projektit jane krijimi i nje ambjenti vetem per femijet prane zyres se Avokatit ne Tirane, ngritja e dy qendrave rajonale per femije, angazhim aktiv ne hartimin e raporteve alternative per zbatimin e Konventes, zgjerim te stafit te Nenseksionit jo vetem me juriste por edhe me punonjes sociale, psikologe, sociologe, mjeke etj, ngritjen e nje librarie per te drejtat e femijeve, bashkepunim dhe kloordinim i punes me institucionet shteterore dhe shoqerine civile, monitorim i legjislacionit aktual dhe propozime per ndryshim, etj.

Rezultatet e pritshme nga projekti me "Save the Children"

1. Forcim e kualifikim i metejshem i kapaciteteve njerezore te Zyres se Avokatit te Popullit e ne vecanti te Nenseksionit per te Drejtat e Femijeve per te bere nje mbrojtje me te mire e me te kualifikuar te te drejtave te femijeve.
2. Ketij synimi do i sherbeje dhe krijimi i nje biblioteke te veçante per te drejtat e femijeve, qe do t'i sherbeje grumbullimit te

informacionit mbi praktikat me te mira lidhur me mbrojtjen e te drejtave te femijeve.

3. Krijimi i nje baze te nevojshme per nje ambient miqesor per punen e Nenseksionit lidhur me te drejttat e femijeve.
4. Pra ne kuadrin e projektit te perbashket, forcimi i kapaciteteve do te perqendrohet mbeshtetje ne infrastrukture, burimet njerezore dhe kordinim.

Përmirësime të mëtejshme

-Ne kuadrin e punes qe do beje Nenseksioni eshte kryerja e studimeve krahasimore per perqasjen e legjislacionit shqiptar dhe zbatimin sa me te mire te detyrimeve te Konventes se Kombeve te Bashkuara mbi te Drejttat e Femijeve.

-Po keshtu nga Nenseksioni mbetet shume per tu bere ne kuadrin e sensibilizimit te opinionit publik, per ekzistencen, punen e misionin e tij ne mbrojtje te ketyre te drejtave. Kjo jo vetem me fushata promovimi, por dhe nepermjet mbajtjes se kontakteve te rregullta me mediat, duke publikuar rast pas rasti çeshtjet e trajtuara nga nenseksioni per shkelje te te drejtave te femijeve nga organet e administrates publike. Po keshtu pune me e mire ne kuader te ndergjegjesimit te femijeve e te te rinjve per te drejttat qe ata kane.

-Mbajtja e kontakteve te rregullta me mjaft OJF shqiptare dhe nderkombetare qe punojne ne fronte te ndryshme por me objekt te pergjithshem te punes se tyre-mbrojtjen e te drejtave te femijeve.

*
* *
*

Si perfundim, mund te themi se Avokati i Popullit eshte i angazhuar seriozisht te jape nje kontribut me rendesi te vecante ne fushen e mbrojtjes se te drejtave te femijeve. Kjo duke rritur ndergjegjesimin e individeve te komunitetit dhe te administrates publike ne lidhje me te drejttat dhe pergjegjesite reciproke ne mbrojtjen e garantimin e te drejtave te femijeve.

KREU I KATERT

1. Në ndjekje të rasteve të prezantuara në Raportet Vjetore 2001, 2002, 2003 dhe 2004.

Disa nga rastet (*ankesa, kërkesa apo rekomandime*) që janë prezantuar në Raportet e viteve 2001, 2002, 2003 dhe 2004 kanë përfunduar dhe gjatë këtij raporti janë pasqyruar në pjesët përkatëse ku trajtohet problematika e tyre. Prandaj në këtë Kre të këtij Raporti do të paraqesim shkurtimisht, disa nga rastet të cilat janë akoma në ndjekje edhe për vitin 2006.

1. Plotësimi i ligjit “Për të Drejtat e të Dënuarve” me aktet nënligjore për shpërblimin e punës së të dënuarve dhe ndryshime të Rregullores së Policisë së Burgjeve. Brenda vitit 2003 duhej të hartohej drafti nga Ministria e Drejtësisë. Meqënëse një gjë e tillë nuk u realizua në vitin 2003, plotësimi me akte nënligjore i ligjit të sipërcituar u fut në programin e vitit 2005. Nga verifikimet tona rezulton se edhe në vitin 2004 nuk është bërë gjë nga Ministria e Drejtësisë.
2. Rekomandim drejtuar Kuvendit të Shqipërisë “Për përgatitjen sa më shpejt të projekteve për plotësimin e legjislacionit për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe të ambientit nga rrezatimet jo jonizuese të telefonisë celulare”. Rekomandime me të njëjtën përmbajtje, i kemi drejtuar ish Kryeministrit, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë të Transporteve. Deri tani kemi përgjigje vetëm nga Ministria e Shëndetësisë e cila shprehet dakort lidhur me faktet e parashtruara në Rekomandimin tonë dhe konfirmon krijimin e një grupi pune, i cili nuk ka arritur në një konkluzion përfundimtar për shkak të mendimeve të kundërta rreth vendosjes së njesisë rregulluese. Kurse Ministria e Drejtësisë përgjigjet se po përgatitet projektligji për sa më sipër.
3. Rekomandim drejtuar Këshillit të Ministrave, që në mbrojtje të të drejtës kushtetuese të lirisë fetare të sanksionuar në nenin 24 të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave duhet të respektojë detyrimin kushtetues të parashikuar në pikën 5 të nenit 10, në të cilin parashikohet se: “Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare të rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet

përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen në Kuvend”. Ky rekomandim është përsëritur disa herë dhe ende ky detyrim kushtetues nuk është realizuar.

4. Propozimi drejtuar Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë për ndryshimin dhe përmirësimin e Vendimit të K.M. nr.552 datë 27.11.1999 “Për trajtimin ekonomik e financiar të familjeve të punonjësve të policisë të vrarë apo plagosur për shkak të detyrës”, për t’i shtrirë efektet e zbatimit të tij nga 01 janari 1991. Megjithëse nga ish Ministri i Rendit Publik z. Luan Rama u premtua para parlamentit se vendimi do të ndryshohej, në fakt ai nuk u bë. Ne e kemi përsëritur këtë rekomandim, por nuk kemi marrë përgjigje.

2. Çështje të filluara me iniciativën e Avokatit të Popullit

Sipas nenit 13 të Ligjit nr.8454, dt.4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ndryshuar me ligjin nr. 9398, datë 12.05.2005 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ndryshuar me ligjin nr. 8600, datë 10.04.2000””,

Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike, por me pëlqimin e të interesuarit ose të dëmtuarit.

Në rastet kur Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes me nismën e vet dhe kur kujdestari ose përfaqësuesi i tij ligjor nuk vepron, nuk kërkohet pëlqimi i të dëmtuarit kur është i mitur apo i paaftë mendërisht apo me aftësi të kufizuara ose për mbrojtjen e të drejtave të një numri të madh të individëve.

Në mbrojtje të interesave të një komuniteti të gjërë, të cilët mund të preken nga procedimi administrativ, Avokati i Popullit ka të drejtë të fillojë një procedim administrativ dhe të marrë pjesë në të, në përputhje me kërkesat e Kodit të Procedurës Administrative.

Këto ndryshime kanë hyrë në fuqi me 1 Korrik 2005. Për këtë arsye për vitin 2005 ka rritje të ndjeshme të çështjeve të ndjekura me iniciativë, në raport me vitin 2004.

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar totali i çështjeve të filluara me iniciativë gjatë vitit 2004 dhe 2005.

	2004	2005
- Ankesa të drejta ose zgjidhur në favor	4	11
- Jashtë kompetence ose juriksionit	0	4
- Të refuzuara për shkak se nuk u bënë ankesa individuale sipas ligjit, ose gjatë shqyrtimit u tërhoqën, ose në përfundim doli se ankesa ishte e padrejtë apo e pavërtetë	5	2
- Në shqyrtim	0	8
Totali	9	25

ANEKSE

1. Letra falenderimi nga qytetarët

Letër falenderimi

Unë Areti Ziu bëra një kërkesë tek Avokati i Popullit për të më zgjidhur hallin prej 7 vjetesh, drejtuar Zyrës së Përmbartimit Tiranë për mosekzekutimin e vendimit në favorin tim.

Falenderoj Avokatin e Popullit, për punën e mire të tij dhe Z. Gezim Lleshi për punën e kryer.

Tiranë, 18.05.2005

**Me respekt
Areti Ziu**

Letër falenderimi

Drejtuar: Avokatit të Popullit

TIRANË

Unë Bajame Disha mbasi kisha shumë kohë paditur se ku ndodhej djali im Inland Disha, iu drejtova Institucionit të Avokatit të Popullit, sikurse dhe Ministrisë së Jashtme.

Djali më kishte humbur që prej vitit 1999 dhe më tej nuk kisha asnjë haber. Me këtë çështje u morën Z. Iliaz Çeço si dhe Znj. Dorianë Pëllumbi, të cilët mbas punës së kryer, arritën të gjejnë djalin tim në Itali.

Falenderoj Avokatin e Popullit, për punën e shkëlqyer të Institucionit të tij.

16.05.2005

**Me respekt
Bajame Disha**

Letër falenderimi

Drejtuar: Avokatit të Popullit

TIRANË

Unë i quajturi Misim Hyseni, banues në Yzberisht, për ankesën time lidhur me Zyrën e Përmbarimit Tiranë për 7% për të cilën kërkoja, më është zgjidhur nga ana juaj si Institucion i Avokatit të Popullit.

Për zgjidhjen e këtij problemi shpreh falenderimet e mia.

Tiranë, 19.05. 2005

**Ju faleminderit
Misim Hyseni**

Letër falenderimi

Drejtuar: Avokatit të Popullit

TIRANË

Unë i ashtuquajturi Ilia Promate, mbasi nuk arrija të merrja certifikatën e mbesës time nga ana e Gjendjes Civile, iu drejtova Avokatit të Popullit të më ndihmonte në zgjidhjen e problemit tim.

Shpreh falenderimet e mia për punën e kryer nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit, mbasi më pajisi me 2 certifikatat. Falenderimet e mia në veçanti për Komisionerin z.Gëzim Lleshi, i cili shprehu gatishmërinë e madhe për vënien në vend të së drejtës së shkelur.

25.11.2005

**Me respekt
Ilia Promate**

Letër falenderimi

Drejtuar: Avokatit të Popullit

TIRANË

Ju faleminderit për interesimin tuaj duke bërë me dije se Rajoni i Telekomit Shkodër ka bërë përpjekje maksimalisht për të më pajisur me telefon.

Lagja ku banoj unë, nuk ka pasur ndërtim të rrjetit të ri.

Pas interesimit tuaj e nxitur nga ankesa ime, Drejtori Ndrek Rukaj ka njoftuar teknikun që të bëhet e pamundura për zgjidhjen e problemit tim.

Më datën 05.10.2005 kanë ardhur dy teknikë e kanë bërë një pajisje shtesë dhe përfundimisht unë jam abonent i rregullt i Telekomit.

Ju falenderoj juve për ndjekjen e problemit, njëkohësisht dhe Telekomin në Shkodër.

Shkodër, 15.12.2005

**Me respekt
Mark Fran Lumaj**

Letër falenderimi

Drejtuar: Avokatit të Popullit

TIRANË

Ne banorët e pallatit 20 Kodër-Kamëz ju falenderojmë për interesimin që treguat rreth shqetësimit tonë, duke vënë në lëvizje mekanizmat ligjore.

Ju falenderojmë edhe për përgjigjen pozitive në favorin tonë.

Edhe njëherë ju falenderojmë për punën tuaj.

Tiranë, 18.10.2005

**Me respekt nga të gjithë banorët e
këtij pallati.**

Letër falenderimi

Drejtuar: Avokatit të Popullit

TIRANE

Kam nderin dhe respektin më të madh që t'ju drejtohem, Ju dhe stafit tuaj me këtë letër falenderimi.

Kjo letër është minimumi i mirënjohjes nga unë e Gloria ime e vogël, pasi ju meritoni më shumë. Sot për sot institucioni që Ju drejtoni, është ajo derë ku populli i thjeshtë troket dhe zgjidh çdo hall që mund të ketë.

Këtë e tregoi rasti i vajzës time e cila pa ndërhyrjen tuaj nuk do të ishte pajisur me pasaportë për t'u kuruar jashtë shtetit dhe jeta e saj do të ishte rrezikuar.

Zoti Avokat,

Ju me të vërtetë e meritoni këtë emer të dashur për njerëzit në nevojë. Institucioni juaj për mua dhe familjen time është shumë i dashur, ai është si një “Nënë e Madhe” për të gjithë.

Duke përfunduar këtë letër të thjeshtë, unë ju falenderoj nga zemra, Ju dhe stafin tuaj.

Burrel, 03.12.2005

**Me respekt
Nena e Glorias
(Arjola Suçi)**

Letër falenderimi

**Drejtuar: Avokatit të Popullit
Z.Ermir Dobjani**

TIRANE

Më lejoni që t’ju shpreh mirënjohjen dhe falenderimet e mia më të sinqerta për mbështetjen tuaj të madhe që më dhatë në mënyrë të vazhdueshme e me përkushtim, që më në fund, unë të fitoj të drejtën time morale e ligjore.

Ju për vite e muaj me rradhë nuk i rreshtët përpjekjet tuaja kundrejt institucionit e kreut të Ministrisë së Rendit Publik, i cili i kishte veshët të mbyllura kundrejt këmbanës tuaj të pandërprerë, deri sa në krye të Ministrisë së Brendshme të vihej z.Sokol Olldashi, i cili për kënaqësinë tuaj dhe fatin e vajzës time Jonadës së vogël, të gjymtuar nga forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë të kësaj ministrie më dt.04.03.1999, të realizonte qëllimin tuaj fisnik dhe të drejtën time duke ekzekutuar një vendim gjykate.

Ky përkushtim në përpjekjet tuaja fisnike e humane mbetet shembull për çdo institucion që i shërben popullit.

Përshëndetje të përzemërta dhe me respekt të thellë dhe në emër të Jonadës së vogël të cilës i lehtësuat dhimbjen,

Pobrat – Kutalli – BERAT

Belul Dervishi

MEDIA E SHKRUAR PER VITIN 2005

PER VITIN 2005

NR	DATA	GAZETA	TITULLI	RUBRIKA
1	05.01.2005	ATSH	Avokati i Popullit kerkon transferimin e të ndaluarve shqiptarë nga Kroacia	Njoftim
2	07.01.2005	ZERI I POPULLIT	Hapet çështje penale për 502 fëmijët shqiptarë të zhdukur në Greqi	Njoftim
3	07.01.2005	KOHA JONE	Hapet çështje penale për 502 fëmijët shqiptarë të zhdukur në Greqi	Njoftim
4	07.01.2005	ALBANIA	Avokati i Popullit hap investigim për keqtrajtimin e romëve	Njoftim
5	07.01.2005	ATSH	Hapet çështje penale për zhdukjen e 502 fëmijëve shqiptarë në Greqi	Njoftim
6	08.01.2005	SHEKULLI	Prokuroria e Athinës heton skandalin e "Agia Varvaras"	Njoftim
7	11.01.2005	ALBANIA	Dobjani reagon për të burgosurit në Kroaci	Njoftim
8	14.01.2005	METROPOL	Inspektorët e "Dobjanit" takojnë grevistët	Njoftim
9	18.01.2005	PANORAMA	Moisiu e Nano diskutojnë progresin e A.P-së me Ombudsmanin e Danimarkës	Njoftim
10	18.01.2005	ZERI I POPULLIT	Kryeministri Fatos Nano takohet me Ombudsmanin danez, Hans Gameltoft Hansen	Njoftim
11	18.01.2005	DITA	Nano pret homologun danez të Dobjanit	Njoftim
12	18.01.2005	BALLKAN	Nano vlerëson rolin e Avokatit të Popullit	Njoftim
13	19.01.2005	KORRIERI	Dobjani - Dervishi, gara për Avokatin e Popullit	Artikull
14	19.01.2005	R.D.	Kryeministri kërkon të pushtojë edhe Institucionin e Ombudsmanit	Artikull
15	20.01.2005	SHEKULLI	Dobjani: Politika larg zgjedhjes se Avokatit të Popullit	Artikull
16	20.01.2005	R.D.	Kryetari i P.D. priti Avokatin e Popullit të Mbretërisë së Danimarkës. Hans Gameltoft Hansen	Artikull
17	20.01.2005	KORRIERI	Dobjani: Politika, larg Avokatit të Popullit	Artikull
18	20.01.2005	KOHA JONE	P.D. Konteston propozimin e PS-së për zëvendësimin e Dobjanit	Artikull
19	20.01.2005	Gazeta SHQIPTARE	Berisha: Nano kërkon një militant Avokat të Popullit	Njoftim
20	20.01.2005	REPUBLIKA	Nano kërkon të vërë militantët e tij në krye të Avokatit të Popullit	Artikull
21	20.01.2005	BALLKAN	Berisha: Vlerësoj Avokatin e Popullit	Njoftim
22	20.01.2005	Gazeta "55"	Dobjani i kundërvihet Fatos Nanos	Artikull
23	20.01.2005	REPUBLIKA	Xhafa-Hansen: Bashkëpunim më të madh në të ardhmen"	Artikull
24	20.01.2005	DITA	Avokati danez i Popullit përgëzon Dobjanin	Konferencë për Shtyp Dobjani-Hansen

25	21.01.2005	KORRIERI	Koçi: Dervishi, Avokat i Popullit, pa pëlqimin e P.S.	Njoftim
26	21.01.2005	BALLKAN	Koçi: Avokati i Popullit të mbetet jashtë politikës	Artikull
27	21.01.2005	Gazeta SHQIPTARE	Koçi: Dervishi kandidon pa lejen e P.S. për Avokat të Popullit	Njoftim
28	26.01.2005	PANORAMA	Çdo ditë 100 vetë te Avokati i popullit	Artikull
29	26.01.2005	KORRIERI	Ermir Dobjani, mbetet kandidatura e vetme	Artikull
30	27.01.2005	SOT	Dobjani, kandidaturë e vetme	Njoftim
31	04.02.2005	ALBANIA	Avokati i Popullit i Shqipërisë flet në fund të mandatit	Intervistë Ermir Dobjani
32	05.02.2005	R.D.	Avokati i Popullit vlerëson raportin e Amnesty International	Intervistë Ermir Dobjani
33	15.02.2005	KOHA JONE	Avokati i Popullit, PS-ja mbështet Dobjanin	Njoftim
34	15.02.2005	SOT	Tërhiqet Dervishi, PS pro Dobjanit	Njoftim
35	15.02.2005	PANORAMA	PS deklaron votën pro rizgjedhjes së Dobjanit	Njoftim
36	15.02.2005	ZERI I POPULLIT	Deputetët e PS: Do mbështesim Dobjanin për Avokat të Popullit	Njoftim
37	15.02.2005	KORRIERI	PS: Ermir Dobjani, Avokat i Popullit	Njoftim
38	15.02.2005	SHEKULLI	Avokati i Popullit, tërhiqet Dervishi, PS mbështet Dobjanin	Artikull
39	15.02.2005	DITA	Socialistët: Mbështesim Dobjanin për mandatin e dytë	Njoftim
40	15.02.2005	R.D.	Presioni i opozitës dhe i ndërkombëtarëve detyron PS-në të rishikojë pozicionin	Artikull
41	15.02.2005	BALLKAN	Dobjani: Nuk dihet fati i 500 fëmijëve	Intervistë Ermir Dobjani
42	18.02.2005	PANORAMA	Dobjani, sërisht Avokat i Popullit	Njoftim
43	18.02.2005	KOHA JONE	Ermir Dobjani rizgjidhet Avokat i Popullit	Njoftim
44	18.02.2005	ALBANIA	Dobjani rizgjidhet Avokat i Popullit	Njoftim
45	18.02.2005	SHEKULLI	Dobjani zgjidhet për herë të dytë Avokat i Popullit	Njoftim
46	18.02.2005	SOT	Dobjani fiton mandatin e dytë	Njoftim
47	18.02.2005	BALLKAN	Dobjani fiton mandatin e dytë si Avokat i Popullit	Njoftim
48	18.02.2005	DITA	Dobjani. Edhe pesë vjet Avokat i Popullit	Njoftim
49	24.02.2005	TIRANA TIMES	Mandati i dytë për Ombudsmanin shqiptar	Njoftim
50	01.03.2005	SOT	Avokati i Popullit nis hetimet	Artikull
51	08.03.2005	KORRIERI	Dobjani, mal me ankesa për institucionet.	Artikull
52	08.03.2005	REPUBLIKA	Opozita pro kompetencave të Avokatit të Popullit	Artikull
53	08.03.2005	"55"	Dobjani: Qeveria ka diskriminuar opozitën, gjatë vitit 2004	Artikull
54	08.03.2005	SHEKULLI	Dobjani: Transparenca në punën e administratave të firmave piramidale mbetet problem	Artikull
55	08.03.2005	KOHA JONE	Avokati i Popullit lexon raportin që përshëndetet si nga mazhoranca, edhe nga opozita.	Artikull
56	08.03.2005	KOHA JONE	Nano-Dobjani, takim para raportimit në Kuvend	Njoftim
57	08.03.2005	SOT	Dobjani: Votat t'i numërojnë 3 gjyqtarë	Artikull

58	08.03.2005	SOT	Beja: Dobjani flet në "vesh shurdh"	Artikull
59	08.03.2005	ALBANIA	Kryeministri uron Dobjanin	Njoftim
60	08.03.2005	ZERI I POPULLIT	Kryeministri Fatos Nano takon Avokatin e Popullit, Ermir Dobjani	Njoftim
61	08.03.2005	PANORAMA	Dobjani: Duam më shumë kompetenca	Njoftim
62	08.03.2005	BALLKAN	Dobjani: Duhet një strukturë për të mbrojtur fëmijët	Artikull
63	09.03.2005	REPUBLIKA	Avokati i Popullit, Ermir Dobjani, i tërheq vërej- tje Ministrisë të Rendit në raport: "Shkarkimet, të padrejta, subjektive dhe denigruese"	Artikull
64	09.03.2005	ALBANIA	Dobjani: "Probleme në trajtimin e të paraburgosurve"	Artikull
65	09.03.2005	ALBANIA	Dobjani: "Trafiku i femrave ka rënë kohët e fundit"	Artikull
66	11.03.2005	ALBANIA	Sistemi gjyqësor, qindra ankesa tek Avokati i Popullit	Njoftim
67	11.03.2005	REPUBLIKA	"Jepuni fund zvarritjeve të proceseve gjyqësore"	Artikull
68	26.03.2005	KORRIERI	Avokati i Popullit mbi sindikalizmin në Polici: Pse në fund të Europës?	Njoftim
69	26.03.2005	ATSH	Avokati i Popullit mbi sindikalizmin në Polici: Pse në fund të Europës?	Njoftim
70	21.04.2005	R.D.	Mijëra qytetarë, ankesa tek Avokati i Popullit për faturat afrofe	Artikull
71	27.04.2005	SHEKULLI	Konviktorët e keqtrajtuar: Do të shkojmë te Avokati i Popullit	Njoftim
72	28.04.2005	BALLKAN	Dobjani takon homologun nga Vojvodina	Njoftim
73	07.05.2005	DITA	Ermir Dobjani: Ndryshimet ligjore do të mundësonin më shumë mbrojtjen e fëmijëve	Artikull
74	07.05.2005	BALLKAN	Avokati i Popullit, Dobjani, takon drejtoreshën e UNICEF-it: Kemi ende për të bërë	Njoftim
75	17.05.2005	ALBANIA	Ish-të përndjekurit ankohen tek Avokati i Popullit	Artikull
76	19.05.2005	KORRIERI	Avokati i Popullit ka vendosur te padise penalisht dikasterin e Ministrisë së Rendit	Artikull
77	20.05.2005	BALLKAN WEB	Familjarët ankohen pranë Avokatit të Popullit, 114 policë të vrarë pa pension	Artikull
78	20.05.2005	Gazeta SHQIPTARE	Ankesa, 114 policë të vrarë pa pension. Familjarët ankohen pranë Avokatit të Popullit	Artikull
79	20.05.2005	KORRIERI	Rendi, "heshtje" ndaj Avokatit të Popullit	Artikull
80	20.05.2005	SOT	Protesta tek Dobjani: Jemi në harresë. Qeveria mashtron familjarët e policëve	Artikull
81	20.05.2005	ATSH	Avokati i Popullit kërkon shmangien e fëmijëve nga fushata elektorale	Njoftim
82	21.05.2005	SOT	Dobjani: Fëmijët larg fushatës	Njoftim
83	21.05.2005	ALBANIA	Gjendet emigranti, e ëma e qau për gjashtë vjet	Artikull
84	21.05.2005	"55"	Dobjani kritikon partitë politike për angazhimin e të miturve në fushatat elektorale	Artikull
85	21.05.2005	REPUBLIKA	Avokati i Popullit bën thirrje përpara hapjes së fushatës: "Mos përdorni fëmijët për fushatë"	Njoftim

86	21.05.2005	BALLKAN	Ermir Dobjani: Politika të qëndrojë larg fëmijëve	Artikull
87	25.05.2005	KORRIERI	Për fëmijët politika më e mirë, mospolitizimi	Artikull Ermir Dobjani
88	09.06.2005	KOHA JONE	Avokati i Popullit trajton problemin ne takimin me homologun polak	Njoftim
89	11.06.2005	ATSH	Zv.Kryeministri Dokle pret Ombudsmanin e Maqedonisë, Z. Ixhet Memeti	Njoftim
90	11.06.2005	SOT	Avokati i Popullit i Maqedonisë në Tiranë	Njoftim
91	11.06.2005	PANORAMA	Moisiu takon Avokatin e Popullit maqedonas	Njoftim
92	11.06.2005	BALLKAN	Takime me Presidentitn Moisiu, zv/kryeministrin Dokle dhe Dobjanin	Njoftim
93	16.06.2005	SOT	Familjarët apel shtetit dhe Avokatit te Popullit: Mbetet në Itali trupi i emigrantit	Artikull
94	29.06.2005	PANORAMA	Avokati i Popullit vizitë disaditore në Kinë	Njoftim
95	09.07.2005	Gazeta SHQIPTARE	Te paligjshme gjobat e Bashkisë	Artikull
96	12.07.2005	KOHA JONE	Avokati i Popullit i kërkoi ERRT-së të vendosë nën kontroll ligjor tarifat e telefonisë	Artikull
97	13.07.2005	SHEKULLI	Avokati i Popullit së bashku me ERRT-në, janë takuar për të mundësuar kontrollin e tarifave të telefonisë lëvizëse.	Artikull
98	16.07.2005	SOT	Avokati i Popullit, takim me kreun e Entit Rregullator te Telekomunikacionit	Artikull
99	22.07.2005	DITA	Avokati i Popullit u kërkon deputetëve gjermanë të japin leje qëndrimi për emigrantët në vështirësi	Njoftim
100	22.07.2005	Gazeta SHQIPTARE	Dobjani: Leje emigrantëve në Gjermani	Njoftim
101	22.07.2005	BALLKAN	Familjarët e Jonada Dervishit, ankesë tek Avokati i Popullit	Prononcim
102	22.07.2005	TEMA	Dobjani: Leje qëndrimi në Gjermani për emigrantët në nevojë	Njoftim
103	22.07.2005	REPUBLIKA	Dobjani mbron emigrantët në Gjermani	Artikull
104	22.07.2005	SOT	Avokati i Popullit kërkon azil për emigrantët në "gjak" dhe homoseksualët	Artikull
105	22.07.2005	PANORAMA	Avokati i Popullit takon parlamentarët gjermanë	Artikull
106	22.07.2005	Rilindja Demokratike	Dobjani: Të pajisen me leje qëndrimi emigrantët që janë larguar për gjakmarrje	Prononcim
107	22.07.2005	KORRIERI	Gjermania të mos i dëbojë shqiptarët	Artikull
108	22.07.2005	KORRIERI	Avokati i Popullit: Hetime për shfrytëzimin e monireneve	Artikull
109	22.07.2005	SHEKULLI	Avokati i Popullit ka kërkuar përkrahje për njerëzit në gjakmarrje, homoseksualët e gratë e divorcuara me fëmijë	Prononcim
110	22.07.2005	KOHA JONE	Avokati i Popullit, Dobjani bisedon me deputetët gjermanë për çështje të emigracionit	Njoftim
111	22.07.2005	ALBANIA	Dobjani: "Gjermania mos t'i dëbojë shqiptarët"	Artikull
112	22.07.2005	TIRANA OBSERVER	Dobjani: Falje të pjesshme për të dënuarit në Greqi	Intervistë Ermir Dobjani
113	24.07.2005	Gazeta "55"	Deformimet e drejtësisë në petkun e mos-zbatimit të ligjit	Artikull

114	26.07.2005	KOHA JONE	Dobjani: Gjermanëve u kërkova të drejta për homoseksualët	Artikull
115	26.07.2005	ALBANIA	Dobjani: "Kërkesat tona për emigrantët tanë në Gjermani"	Prononcim
116	26.07.2005	REPUBLIKA	Dobjani: Mos ktheni emigrantët që s'kanë të ardhme në Shqipëri	Artikull
117	28.07.2005	Gazeta R.D.	Avokati i Popullit: Të përmirësohen kushtet për gratë që vuajnë dënimin	Artikull
118	28.07.2005	SOT	Raporti i Avokatit të Popullit qorton Burgun 325	Artikull
119	28.07.2005	PANORAMA	Avokati i Popullit: Inspektimi në burg, gratë ankohen për kushtet	Njoftim
120	28.07.2005	Gazeta SHQIPTARE	Avokati i Popullit: Pagesa e grave të dënuara që punojnë, qesharake	Njoftim
121	20.07.2005	TRIBUNA JURIDIKE	Një akt nënligjor që duhet të ndryshojë, përmirësohet dhe zbatohet pa humbur kohë	Artikull Sotiraq Nushi
122	28.07.2005	ALBANIA	Avokati i Popullit në burgun e grave: "Mos përgjoni korrespondencën!"	Artikull
123	29.07.2005	KOHA JONE	Avokati i Popullit zbardh ankesat e Burgut 325 në Tiranë	Artikull
124	08.09.2005	PANORAMA	Reagon Avokati i Popullit: "Ferri i 8 kinezëve në burg"	Artikull
125	15.09.2005	KORRIERI	Kaminis: Do të mbrojmë të drejtat e shqiptarëve në Greqi	Njoftim
126	15.09.2005	KORRIERI	Davis: Pse kërkojnë shqiptarët azil në Shtetet e Bashkuara??	Njoftim
127	15.09.2005	KORRIERI	Grekët nuk na e japin vajzën e vogël që ia besuam një taksisti	Artikull
128	15.09.2005	Gazeta SHQIPTARE	Departamenti i shtetit interesim për azilantët	Njoftim
129	15.09.2005	PANORAMA	"Avokatët e Popullit" Greqi-Shqipëri në Tiranë	Njoftim
130	15.09.2005	SOT	Dobjani: Do të mbrojmë të drejtat e emigrantëve	Njoftim
131	15.09.2005	TEMA	Ombudsmeni Grek: Do të mbrojmë të drejtat e emigrantëve	Njoftim
132	16.09.2005	BALLKAN	Greqia, fajtorë për fëmijët e "Agia Varvara"	Artikull
133	16.09.2005	Gazeta SHQIPTARE	Ç'duhet të bëjnë të larguarit	Prononcim
134	16.09.2005	Gazeta SHQIPTARE	Dobjani "Problematike Ministria e Rendit"	Prononcim
135	16.09.2005	Gazeta SHQIPTARE	"Qeveria në monitorim nga ndërkombëtarët"	Intervistë Ermir Dobjani
136	16.09.2005	PANORAMA	Dobjani: Si do ta ruaj administratën	Prononcim
137	16.09.2005	SOT	Topalli takon Avokatin e Popullit të Greqisë	Njoftim
138	16.09.2005	SOT	Dobjani: Qeveria të mos largojë administratën	Prononcim
139	16.09.2005	BALLKAN	Dobjani: Monitorim kabinetit Berisha	Njoftim
140	16.09.2005	R.D.	Avokati i Popullit takohet me homologun grek	Njoftim
141	16.09.2005	R.D.	Topalli takon Avokatin e Popullit të Greqisë	Njoftim
142	16.09.2005	REPUBLIKA	Ombudsmeni grek Kaminis: Shteti grek, fajtor	Prononcim
143	16.09.2005	REPUBLIKA	Dobjani: Do të monitorojmë qeverisjen "Berisha"	Njoftim
144	16.09.2005	Gazeta "55"	Jozefina Topalli takon "Ombudsmenin" grek	Njoftim

145	16.09.2005	Gazeta "55"	Dobjani: Do monitoroj reformën në administratë	Intervistë Ermir Dobjani
146	16.09.2005	Gazeta "55"	Dobjani" Foro'il monitoraggio delle riforme nell'amministrazione	Prononcim
147	16.09.2005	ALBANIA	Greqi, formulari i ri për lejen e qëndrimit të emigrantëve	Artikull
148	16.09.2005	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit do të monitorojë lëvizjet në administratë	Konferencë Shtypi Dobjani- Kaminis
149	16.09.2005	KORRIERI	"Nuk do ta lë Berishën të luajë me administratën që la PS-ja"	Intervistë Ermir Dobjani
150	16.09.2005	KORRIERI	Avokati i Popullit grek Kaminis, takim edhe me Topallin e Kondin	Njoftim
151	17.09.2005	ZERI I POPULLIT	Dobjani: Si do ta ruaj administratën	Artikull
152	21.09.2005	PANORAMA	Avokati i Popullit, letër Berishës, Olldashit e Bumçit: Në qelitë e komisariateve gjendja alarmante	Artikull
153	28.09.2005	PANORAMA	Avokati i Popullit kërkon ndryshimin e ligjit për legalizimin	Artikull Ermir Dobjani
154	28.09.2005	KORRIERI	Avokati i Popullit i tërheq vëmendjen policisë së ndërtimit	Artikull
155	29.09.2005	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit kërkon ndryshimin e ligjit për legalizimet	Artikull
156	01.10.2005	"55"	Avokati i Popullit për emigrantët në Itali	Prononcim
157	01.10.2005	SOT	Dobjani takon krerët e Zyrave Rajonale në Itali	Njoftim
158	01.10.2005	TRIBUNA JURIDIKE	Të drejtat e të dënuarve dhe mbrojtja e tyre	Artikull Hajredin Hysa
159	01.10.2005	TRIBUNA JURIDIKE	Shkeljet e ligjit dëmtojnë interesat e individit dhe buxhetin e shtetit	Artikull Sotiraq Nushi
160	05.10.2005	TIRANA OBSERVER	Avokati i Popullit bën publike listën e 500 fëmijëve të zhdukur	Artikull
161	05.10.2005	Gazeta SHQIPTARE	Avokati i Popullit: Do shqyrtojmë ankesat për çdo rast	Njoftim
162	05.10.2005	ZERI I POPULLIT	Shoqata e talasemikëve tek Avokati i Popullit	Njoftim
163	05.10.2005	SHEKULLI	Avokati i Popullit nis hetimet për infektimin e talasemikëve	Njoftim
164	08.10.2005	PANORAMA	Avokati i Popullit, letët qeverisë së re për uljen e çmimeve	Artikull
165	08.10.2005	GAZETA ABC	Avokati i Popullit, dyshimet e mia për celularët	Artikull Ermir Dobjani
166	09.10.2005	KOHA JONE	Çfarë i shkruante Dobjani ish-ministrit Xhani?	Artikull
167	09.10.2005	PANORAMA	Avokati i Popullit premton shqyrtimin e kërkesave të peticionit	Artikull
168	09.10.2005	Gazeta SHQIPTARE	Studentët, do të lirohen godinat e zëna nga familjarët	Artikull
169	09.10.2005	ALBANIA	Denoncimet e prindërve trembin drejtorin e qytetit "Studenti"	Artikull
170	10.10.2005	PANORAMA	Avokati i Popullit letër Kabinetit Berisha	Njoftim
171	12.10.2005	PANORAMA	Avokati i Popullit vizitë grevistëve të "302"	Artikull

172	13.10.2005	KORRIERI	Dobjani-Berishës: Në privatizime të përdoren edhe letrat me vlerë	Artikull
173	18.10.2005	SHEKULLI	Ombudsmani austriak takon Avokatin e popullit, Presidentin dhe Ministrin e Drejtësisë	Njoftim
174	18.10.2005	KORRIERI	Zhdukja e 9-vjeçarit Carja, kërkohet ndihma e Avokatit të Popullit	Artikull
175	18.10.2005	DITA	Kryetari i Gjykatës së Lartë pret Ombudsmanin austriak	Njoftim
176	18.10.2005	REPUBLIKA	Avokati i Popullit zbret në Elbasan	Artikull
177	18.10.2005	SOT	Presidenti Moisiu takon Avokatin e Popullit të Austrisë	Njoftim
178	26.10.2005	KOHA JONE	Avokati i Popullit takon Rene Van Der Linden	Njoftim
179	28.10.2005	REPUBLIKA	Skandali i Agia Varvara, Krimet e Rënda nisin hetimin	Njoftim
180	29.10.2005	KOHA JONE	Dobjani, takim për luftën kundër rrëmbimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve	Njoftim
181	01.11.2005	DITA	Avokati i Popullit i dërgon shkresën kryeministrit Berisha: Të zgjatet skadenca pas 31 dhjetorit	Artikull
182	01.11.2005	PANORAMA	Dobjani: Të shtyhet afati i bonove të privatizimit	Artikull
183	03.11.2005	ALBANIA	Berisha pranon rekomandimet e Avokatit të Popullit për rishikimin e afatit të bonove	Artikull
184	04.11.2005	KORRIERI	Shoqërimet në polici: kërkesat e Dobjanit	Artikull
185	06.11.2005	Gazeta SHQIPTARE	Konkursi i pedagogëve të përsëritet, çështja u zgjidh pas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit.	Artikull
186	07.11.2005	SPORT EKSPRES	Avokati i Popullit për ndëshkimin e klubit Sportiv "Shkumbini"	Artikull
187	08.11.2005	KORRIERI	Dobjani: Ish-drejtori i Burgut të Bënçës të rikthehet në detyrë	Artikull
188	08.11.2005	SHEKULLI	Të dënuarit jetojnë në kushte të rënda	Prononcim Skënder Haluci
189	09.11.2005	BIZNESI	Ndërtuesit dhe Avokati i Popullit kundër prishjes së 8-katëshit	Artikull
190	09.11.2005	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit, letër ministrit Basha: Të ndalohen prishjet e paligjshme dhe dënohen urdhëruesit e tyre	Njoftim
191	09.11.2005	ALBANIA	Avokati i Popullit Dobjani ndërmjetëson, por nuk sugjeron	Artikull
192	10.11.2005	ALBANIA	Dobjani kundërshton prishjen e një pallati tetëkatësh pranë Fakultetit të Mjekësisë	Artikull
193	11.11.2005	KORRIERI	Dobjani: Shembja e 8-katëshit, e padrejtë	Artikull
194	15.11.2005	Gazeta SHQIPTARE	Mbikalimi, hyn Dobjani dhe KLSH	Prononcim Artur Lazebeu
195	16.11.2005	Gazeta SHQIPTARE	Avokati i Popullit, nis sot ballafaqimi për mbikalimin	Njoftim
196	16.11.2005	KORRIERI	Dobjani: Kryetarët e gjykatave, jo më shumë se 5 vjet në detyrë	Artikull
197	17.11.2005	Gazeta SHQIPTARE	Avokati i Popullit është përballur dje me argumentat kundër dhe pro për nyjën e Zogut të Zi	Artikull
198	18.11.2005	PANORAMA	Mbikalimi, Avokati i Popullit shqyrton dosjet	Njoftim
199	21.11.2005	SHEKULLI	Të dënuarit në Burrel, ankesë Dobjanit	Njoftim

200	22.11.2005	KORRIERI	Avokati i Popullit: Të zhbollohen punimet te "Zogu i Zi"	Artikull
201	22.11.2005	BALLKAN	Avokati i Popullit: Qeveria vendore i ka kompetencat për menaxhimin e infrastrukturës	Artikull
202	22.11.2005	SHEKULLI	Pas hetimit të çështjes, Avokati i Popullit rekomandon zhbllokimin e punimeve. Ndërtimorja, jo më praktika të tilla	Artikull
203	22.11.2005	Gazeta SHQIPTARE	Avokati i Popullit: Ekspertiza e 40 dokumenteve zbardh të vërtetën e punimeve të pezulluara prej 1 muaji	Artikull
204	22.11.2005	KOHA JONE	Punimet në mbikalimin e Zogut të Zi vazhdojnë të jenë të bllokuara. Rekomandimet e Avokatit të Popullit	Artikull
205	22.11.2005	ALBANIA	Letra e Avokatit të Popullit për Berishën "Bllokimi i mbikalimit, i padrejtë"	Artikull
206	22.11.2005	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit: Të rinisin punimet tek mbikalimi i Zogut të Zi	Artikull
207	22.11.2005	PANORAMA	Dobjani: Të zhbllokohet Zogu i Zi	Artikull
208	22.11.2005	SOT	Dobjani: Të zhbllokohen punimet e mbikalimit të "Zogut të Zi"	Artikull
209	23.11.2005	KORRIERI	Ndërtimorja: Avokati i Popullit nuk mund të rekomandojë vendime	Artikull
210	23.11.2005	ZERI I POPULLIT	Mbikalimi, akoma peng i luftës politike kundër Bashkisë Tiranës. KLSH dhe Avokati i popullit ka kërku-ar rifillimin e punimeve para 4 ditësh. Qeveria nuk reagon	Artikull
211	24.11.2005	Gazeta SHQIPTARE	Këmbëngulja e Avokatit të Popullit: Të rinisin punimet në objekt	Artikull
212	24.11.2005	SOT	Dobjani inspekton qelitë e paraburgimit	Njoftim
213	24.11.2005	DITA	Ministria e Drejtësisë dhe Avokati i Popullit investigime nëpër burgje	Njoftim
214	24.11.2005	ALBANIA	Avokati i Popullit, kërkon ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit Civil	Njoftim
215	25.11.2005	ALBANIA	Avokati i Popullit denoncon skandalin e mijëra letrave ankimore të qytetarëve	Artikull
216	04.12.2005	KORRIERI	Avokati i Popullit dhe Zyrat e Permbarimit: "Qytetarët nuk e kuptojnë procedurën tuaj strikte"	Artikull
217	07.12.2005	ZERI I POPULLIT	KLSH dhe Avokati i Popullit: Policia Ndërtimore të zhbllkojë punimet	Njoftim
218	08.12.2005	PANORAMA	Avokati i Popullit kërkoi që të shtyhej afati i skadencës për bonot e privatizimit	Artikull
219	13.12.2005	ALBANIA	Avokati i Popullit: "Zyrat e shtetit të respektojnë të drejtën e informimit"	Njoftim
220	14.12.2005	REPUBLIKA	Argumentat e Avokatit të Popullit për pafajësinë	Njoftim
221	19.12.2005	INTEGRIMI	Avokati i Popullit: Shkelje ligji, mënyra si na u caktua buxheti	Njoftim
222	19.12.2005	PANORAMA	KE: "Rekomandimet e Avokatit të Popullit, nuk janë zbatuar"	Artikull
223	20.12.2005	ALBANIA	Avokati i Popullit: "Të kthyerit në polici të bëjnë kujdes me qytetarët"	Artikull

MEDIA ELEKTRONIKE PER VITIN 2005

Nr.	ORGANI	DATA	RUBRIKA	PASQYRIMI
-----	--------	------	---------	-----------

1	Top. Chanel	05.01.2005	Avokati i Popullit kërkon kthimin e të ndaluarve shqiptarë në Kroaci	Prononcim Ermir Dobjani
2	TVSH	07.01.2005	Hapet çështje penale për 502 fëmijët shqiptarë të zhdukur në Greqi	Prononcim Ermir Dobjani
3	Tv.Klan, Top Chanel	07.01.2005	Avokati i Popullit hap investigim për keqtrajtimin e romëve	Prononcim Artur Lazebeu
4	News 24, Top Chanel, TVSH	17.01.2005	Avokati i Popullit pret Homologun e tij danez	Njoftim
5	News 24, TVA, TVSH, Top Chanel,	17.01.2005	Kryeministri Nano pret Ombudsmanin Danez	Njoftim
6	News 24, TVA, TVSH, Top Chanel,	17.01.2005	Presidenti Moisiu pret Ombudsmanin Danez	Njoftim
7	News 24, TVA, TVSH, Top Chanel,	18.01.2005	Kryetari i Parlamentit takohet me Avokatin e Popullit të Danimarkes, Z. Hans Gameltoft-Hansen	Njoftim
8	News 24, TVA, TVSH, Top Chanel,	19.01.2005	Kryetari i opozites Sali Berisha pret Ombudsmanin e Danimarkes	Njoftim
9	News 24, TVA, TVSH, Tv.Teuta, Top Chanel, Tv.Klan, Vizion +, Tv. Shijak	19.01.2005	Mbeshtesim stabilitetin e dhe vazhdimësinë e Avokatit të Popullit	Konferencë Shtypi Ermir Dobjani, Hans Gameltoft-Hanses
10	Zeri i Amerikës	03.02.2005	Avokati i Popullit i Shqipërisë flet në fund të mandatit	Intervistë Ermir Dobjani
11	Tv.Klan	18.02.2005	Avokati i Popullit për uljen e energjisë elektrike	Intervistë Ervin Karamuço
12	Top. Chanel	23.02.2005	Për kushtete e rënda të personave të paraburgosur në disa dhoma paraburgimi	Intervistë Jorgo Dhrami
13	Alsat	02.03.2005	Avokati i Popullit pret bashkëreporterët e Komisionit European	Prononcim Ermir Dobjani
14	Vizion +	02.03.2005	Avokati i Popullit dhe çështja e pronave	Prononcim Artur Lazebeu
15	Top. Chanel	03.03.2005	Pese vjet veprimtari	Emission Ermir Dobjani
16	News 24, TVA, TVSH, Tv.Teuta, Top Chanel, Tv.Klan, Vizion +, Tv. Shijak	07.03.2005	Raporti vjetor i Avokatit të Popullit	Njoftim

17	News 24, Nesër TV	25.03.2005	Sindikalizmi në Polici; pse në fund të Europës	Prononcim Ermir Dobjani
18	ATSH	26.03.2005	Avokati i Popullit mbi Sindikalizmin në Polici: Pse në fund të Europës	Njoftim
19	Top. Chanel	07.04.2005	Mbi personat e humbur apo të zhdukur	Intervistë Jorgo Dhrami
20	Tv. Klan	11.04.2005	Mbi emigrantin dhe ndihmën ligjore nga konfliktet tona jashtë shtetit	Intervistë Jorgo Dhrami
21	News 24, Vizion +, Tv.Klan, TVSH	26.04.2005	Ombudsmeni i Krahinës Autonome të Vojvodinës vizitë studimore pranë zyrës së Avokatit të Popullit	Njoftim
22	Tv.Arbëria	10.05.2005	Avokati i Popullit për problemin sindikalizmit në policinë e shtetit	Prononcim Sotiraq Nushi
23	News 24, TVA, TVSH, Tv.Teuta, Top Chanel, Tv.Klan, Vizion +, Tv. Shijak,	20.05.2005	Deklaratë për shtyp: Avokati i Popullit, "Të mos përdoren fëmijët për fushatë elektorale"	Prononcim
24	ATSH	20.05.2005	Avokati i Popullit kërkon shmangien e fëmijëve nga fushatat elektorale	Njoftim
25	TVSH	02.06.2005	Avokati i Popullit një dorë për njerëzit në nevojë	Emission Artur Lazebeu
26	Tv.Alsat, Tv.Klan	06.06.2005	Avokati i Popullit apel për mos-përfshirje të fëmijëve në fushatat elektorale	Prononcim Artur Lazebeu
27	TVSH	10.06.2005	Presidenti i Republikës pret Ombudsmenin e Maqedonisë z. Ixhet Memeti	Njoftim
28	ATSH	11.06.2005	Zv.Kryeministri Dokle, pret Ombudsmenin e Maqedonisë, z. Ixhet Memeti	Njoftim
29	BBC	12.06.2005	Avokati i Popullit dhe procesi i integritetit	Interviste Ermir Dobjani Ixhet Memeti
30	TNSH	07.07.2005	Te gjejmë njerëzit e zhdukur	Emissioni "Ku Je" Anila Nepravishta
31	Tv.Klan,	08.07.2005	Të paligjshme gjodat e Bashkisë	Prononcim Gëzim Lleshi
32	Tv.Alsat	12.07.2005	Avokati i Popullit kërkon uljen e tarifave të telefonisë	Prononcim Ervin Karamuço
33	Tv.Klan	13.07.2005	Avokati i Popullit kërkon uljen e tarifave të telefonisë	Prononcim Ervin Karamuço
34	TNSH	13.07.2005	Si do të punojmë për të gjetur njerëzit e zhdukur	Emissioni "Ku Je" Ermir Dobjani
35	Top. Chanel, Vizion +, Tv.A1, Tv.Klan, News 24	21.07.2005	Avokati i Popullit takon deputete gjermanë të Landit të Hessenit	Njoftim


36	Top Chanel, Vizion +, Koha Tv, Tv.A1, News 24	21.07.2005	Avokati i Popullit: Të zbatohet vendimi i Gjykatës për zhdëmtimin nga MRP të fëmijës së gjymtuar	Prononcim Sotiraq Nushi
37	Top Chanel, Vizion +, Koha Tv, Tv.A1, News 24	21.07.2005	Avokati i Popullit nis hetim për sëmundjet profesionale	Njoftim
38	"Dojçe Vele"	25.07.2005	Avokati i Popullit mbi emigrantët shqiptarë	Intervistë Ermir Dobjani
39	Tv.1	29.07.2005	Raporti i Avokatit të Popullit për përmirësimin e gjendjes në burgje	Prononcim Skënder Haluci
40	Top.Chanel	29.07.2005	Avokati i Popullit mbi sëmundjet profesionale	Prononcim Gezim Lleshi
41	Rai 3	20.08.2005	Avokati i Popullit në Shqipëri bashkëpunon me homologen e Valle D'Aosta	Intervistë Ermir DOBJANI
42	Tv.Koha	13.09.2005	Avokati i Popullit për ankesën e Belul Dervishit të cilin Ministria e Rendit nuk e dëmshpërblen për plagosjen e vajzës së tij	Emision Sotiraq Nushi
43	Top.Chanel	14.09.2005	Vogëlushit të sëmurë t'i jepet pasaportë	Prononcim Jorgo Dhrami
44	News 24, TVA, TVSH Top Chanel, Tv.Klan, Vizion +, Tv.Koha, Alsat, Tv.A1	15.09.2005	Kryetarja e Parlamentit Jozefina Topalli takon Avokatin e Popullit të Greqisë	Njoftim
45	News 24, TVA, TVSH, Top Chanel, Tv.Klan, Vizion +, Tv.Koha, Alsat, Tv.A1	15.09.2005	Dobjani dhe Kaminis per bashkepunimin midis dy zyrave	Konferencë Shtypi Ermir Dobjani, Yorgos Kaminis
46	News 24, Tv. Alsat, Tv.Klan, Vizion+	15.09.2005	Dobjani: Do monitoroj reformën në administratë	Njoftim
47	TVSH	16.09.2005	Avokati i Popullit për reformën në administratën publike	Intervistë Ermir Dobjani
48	Top.Chanel	19.09.2005	Nderhyrja e Avokatit te Popullit per Altin Daka i humbur ne Greqi	Interviste Jorgo Dhrami
49	Tv.Klan	28.09.2005	Avokati i Popullit kerkon ndryshimin e ligjit per legalizimin	Interviste Ermir Dobjani
50	Vizion +	28.09.2005	Avokati i Popullit kerkon ndryshimin e ligjit per legalizimin	Interviste Ermir Dobjani
51	TNSH	30.09.2005	Do të punojmë për të gjetur njerëzit e zhdukur	Emisioni "Ku je" Hajredin Hysa

52	Radio Bullgaria	02.10.2005	Avokati i Popullit në Shqipëri	Intervistë Doriana Pëllumbi
53	TNSH	03.10.2005	Dosja e emigrantit do të çohet në Itali	Emisioni "Ku je" Artur Lazebeu
54	Tv.Koha	04.10.2005	Avokati i Popullit merr në dorë skandalin e fëmijëve talasemikë.	Prononcim Artur Lazebeu
55	TVA	04.10.2005	Avokati i Popullit kërkon kontributin e komunitetit për identifikimin e fëmijëve të zhdukur	Prononcim Artur Lazebeu
56	Top.Chanel	04.10.2005	Avokati i Popullit bën publike listën e 500 fëmijëve të zhdukur	Intervistë Artur Lazebeu
57	TVA	04.10.2005	Jemi në hapat e para të hetimit për çështjen e talasemikëve	Prononcim Artur Lazebeu
58	TVA	06.10.2005	Avokati i Popullit dhe marrëdhëniet e tij me Qeverinë e re	Intervistë Ermir Dobjeni
59	Vizion +	07.10.2005	Avokati i Popullit për trajtimin e ankesës së shtetasës Nevila Bice për humbjen e vëllait të saj Erion Bici dhe Klarent Qyshko	Prononcim Sotiraq Nushi
60	Vizion +	08.10.2005	Qyteti Studenti t'u kthehet studentëve	Prononcim Artur Lazebeu
61	Tv.Klan	12.10.2005	Avokati i Popullit vizite tek te parburgosurit në greve urie në burgun 312	Interviste Skender Haluci
62	Tv.Klan	12.10.2005	Avokati i Popullit vizite tek te parburgosurit në greve urie në burgun 312	Intervistë Jorgo Dhrami
63	TVSH	17.10.2005	Presidenti i Republikës pret Ombudsmenin e Austrisë Z. Peter Kostelka	Njoftim
64	Tv.Teuta	17.10.2005	Ombudsmeni Austriak në Amfiteatrin e Durrësit	Intervistë
65	"Tv.4", Lushnje	17.10.2005	Avokati i Popullit "Ditët e hapura" në Lushnje	Intervistë Petrit Azemaj
66	Tv.Elbasan	17.10.2005	Avokati i Popullit pret banorët e Elbasanit në ditët e hapura	Intervistë Gëzim Lleshi
67	Tv.Apollon Fier	17.10.2005	Avokati i Popullit "Ditët e hapura" në Fier	Intervistë Petrit Azemaj
68	Kombi Tv. Fier	18.10.2005	Avokati i Popullit pret ankuesit në Fier	Intervistë Alket Jaupi
69	Tv.Berat	24.10.2005	Avokati i Popullit pret ankuesit në Berat, Kuçovë, Skrapar	Intervistë Artur Lazebeu
70	Malësi e Madhe Tv.Lokal	24.10.2005	Avokati i Popullit pret banorët e Malësisë së Madhe në Ditët e Hapura	Intervistë Gëzim Lleshi
71	Tv.Kuçova	24.10.2005	Avokati i Popullit: "Ditët e hapura" në Kuçovë, Berat, Skrapar	Intervistë Artur Lazebeu
72	News 24	25.10.2005	Avokati i Popullit takon Kryetarin e Asamblesë Parlamentare për Këshillin e Evropës, z. Rene Van Der Linden	Njoftim

73	AOS Tv. lokal Përmet	26.10.2005	Avokai i Popullit pret ankuesit në Përmet	Intervistë Alket Jaupi
74	Tv.Rozafa Shkodër	28.10.2005	Avokati i Popullit në Ditët e Hapura pret banorët e Shkodrës	Intervistë Gëzim Lleshi
75	TVA	28.10.2005	Avokati i Popullit në "Ditët e Hapura" me banorët e Shkodrës	Intervistë Gëzim Lleshi
76	Top.Chanel	31.10.2005	Avokati i Popullit për problemin e Bonove të Privatizimit	Prononcim Alket Jaupi
77	Tv.Maxhic- Korçë	02.11.2005	Avokati i Popullit "Ditët e hapura në Korçë"	Intervistë Fredri Paskali
78	Tv."Sot 7" Pogradec	01.11.2005	Avokati i Popullit në ditët e hapura pret banorët e Pogradecit	Intervistë Gëzim Lleshi
79	Tv.Kristal, Tv. Maxhik, Tv.Lobi,	02.11.2005	Avokati i Popullit në ditët e hapura pret banorët e Korçës	Intervistë Gëzim Lleshi
80	News 24, NTV	02.11.2005	Avokati i Popullit, Ermir Dobjani takon Raporterin e Posaçëm të OKB-së z. Juan Miguel Petit	Njoftim
81	Top Chanel,	07.11.2005	Avokati i Popullit inspektive në burgje	Prononcim Skender Haluci
82	Tv.Klan	08.11.2005	Avokati i Popullit inspektive në burgje	Prononcim Skender Haluci
83	Tv.Egnatia	08.11.2005	Të zbatohen vendimet gjyqësore	Intervistë Gëzim Lleshi
84	TNSH	08.11.2005	Do të punojmë për të gjetur njerëzit e zhdukur	Emisioni "Ku Je" Hajredin Hysa
85	Top Chanel	09.11.2005	Gratë në burgje	Emisioni "Top Show" Skënder Haluci
86	Tv.Amantia Vlorë	11.11.2005	Avokati i Popullit për ditët e hapura në Vlorë	Intervistë Jorgo Dhrami
87	Top Chanel	14.11.2005	Avokati i Popullit do të ndërhyjë për pezullimin e punimeve të Bashkisë	Intervistë Artur Lazebeu
88	Tv.Klan	15.11.2005	Avokati i Popullit mbi problemet e dala në Komisarariatet e Policisë me personat e shoqëruar	Intervistë Jorgo Dhrami
89	TVSH	15.11.2005	Avokati i Popullit, nis ballafaqimi për mbikalimin	Prononcim Artur Lazebeu
90	Tv.Klan	16.11.2005	Avokati i Popullit, ndërmjetësimi larg mediatizimit dhe politizimit	Prononcim Artur Lazebeu
91	News 24, TVA, TVSH, Top Chanel, Tv.Klan, Vizion +, Tv. Shijak,	21.11.2005	Avokati i Popullit: Te çbollokohen punimet tek Zogu i Zi	Njoftim
92	Tv.Alsat	22.11.2005	Avokati i Popullit për ankesat në burgun e Peqinit	Prononcim Skënder Haluci
93	A1	22.11.2005	Një ditë pune pranë Institucionit të Avokatit të Popullit	Emision

94	ATSH	23.11.2005	Avokati i Popullit thotë se ka ankesa ndaj vendimeve të formës së prerë, por nuk mund t'i ndryshojë ato	Njoftim
95	News 24, TVA, TVSH, Top Chanel, Tv.Klan, Vizion +, Tv. Shijak,	23.11.2005	Avokati i Popullit, OSCE, Ombudsmani Polak për Ligjin e Avokatit të Popullit mbi vendimet gjyqësore	Njoftim
96	Tv.Shijak	06.12.2005	Avokati i Popullit në lidhje me oponencën që ka bërë ky Institucion projektrregullore për paraburgimet në Shqipëri	Intervistë Skënder Haluci
97	TV.Arbëria	09.12.2005	Avokati i Popullit mbi detyrimet e KESH-it për dëmshpërblimin e qytetarëve	Intervistë Artur Lazebeu
98	ATSH	12.12.2005	Avokati i Popullit dhe USAID "E drejta e informimit kërkon transparencë dhe vullnet politik"	Njoftim
99	Top.Chanel	12.12.2005	Avokati i Popullit dhe USAID "E drejta e informimit kërkon transparencë dhe vullnet politik"	Njoftim
100	News 24, TVA, TVSH, Top Chanel, Tv.Klan, Vizion +, Tv. Shijak,	15.12.2005	Avokati i Popullit, Save the Children dhe Unicef, konferencë kombëtare "Të gjithë për fëmijët"	Njoftim
101	TVA	15.12.2005	Avokati i Popullit dhe shkurtimeve e buxhetit	Prononcim Ermir Dobjani
102	Vizion +	16.12.2005	Avokati i Popullit për trajtimin e ankesës së shtetasës Nevila Bice për humbjen e vëllait të saj Erion Bici dhe Klarent Qyshko	Prononcim Sotiraq Nushi
103	TVSH	16.12.2005	Jo vetëm Kafe	Emision Ermir Dobjani
104	Tv.Klan	17.12.2005	Avokati i Popullit dhe dëmshpërblimi i foshnjës së Beratit	Prononcim Sotiraq Nushi
105	Vizion +	20.12.2005	Identitet i verdhe	Emision Sotiraq Nushi
106	TNSH	30.12.2005	Avokati i Popullit në ndihmë të personave të humbur	Emisioni "Ku je" Artur Lazebeu


Ankesat e trajtuara gjate vitit 2005
Totali 2708




- Numri i ankesave të regjistruara gjatë vitit 2005
- Numri i ankesave të mbartura nga viti 2004

Mënyra e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave të përfunduara gjatë vitit 2005, pavarësisht nëse kanë qenë brenda ose jashtë juridiksionit


Totali 2428



**Mënyra e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave që kanë qenë brenda
juridiksionit gjatë vitit 2005
Totali 1286**




Gjendja e ankesave të marra në shqyrtim gjatë vitit 2005
Totali 2708




- Ankesa të përfunduara gjatë vitit 2005
- Ankesa që vazhdojnë të jenë në shqyrtim në vitin 2006

**Ankesa dhe kërkesa të paraqitura verbalisht pranë
Zyrës së Pritjes së Popullit gjate vitit 2005
Totali 2486**



- Ankesa verbale të regjistruara në sekretari për shqyrtim, pasi u bënë me shkrim
- Ankesa dhe kërkesa verbale, të cilave iu është dhënë përgjigje menjëherë, në zbatim të nenit 17/a dhe 17/b të ligjit.


Ankesa, kërkesa dhe njoftime të trajtuara nga zyra e AP gjatë vitit 2005
Totali 4361




Ankesa të trajtuara gjatë vitit 2005 (2300 të vitit 2005 dhe 408 të mbartura nga viti 2004)

Ankesa të paraqitura në zyrën e pritjes së popullit, gjatë vitit 2005, të cilave ju është dhënë përgjigje menjëherë



**Krahasimi i ankesave të ardhura për vitet 2000 - 2005,
(përfshirë edhe ato që ju është dhënë përgjigje menjëherë)
Totali 18789**



**Shperndarja e ankesave te regjistruara gjate vitit 2005 sipas institucioneve
Totali 2300 raste**



MEDIA E SHKRUAR PER VITIN 2005



MEDIA ELEKTRONIKE PER VITIN 2005

